



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-
Asociimit (PKZMSA)**

Dhjetor 2015
Prishtinë

Faqe e zbraztë

Përmbajtja

<i>Vendimi i Qeverisë për miratimin e PKZMSA-së</i>	5
HYRJE	6
Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian	10
1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE	12
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit	12
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor	12
1.1.2. Sistemi gjyqësor	18
1.1.3. Administrata publike	18
1.1.4. Avokati i Popullit	26
1.1.5. Politikat kundër korrupsionit	28
1.1.6. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë	29
1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	32
1.3. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare	32
2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE	41
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut	42
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit	64
3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË	86
3.1. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	86
3.2. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave	87
3.3. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve	98
3.4. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve	101
3.5. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit	110
3.6. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik	117
3.7. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive	121
3.8. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale	125
3.9. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës	131
3.10. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare	137
3.11. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat	147
3.12. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural	154
3.13. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë	170
3.14. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria	182
3.15. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit	183
3.16. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia	191
3.17. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet	205
3.18. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare	210
3.19. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat	216
3.20. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi	237
3.21. Kapitulli 20 i acquis-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë	244
3.22. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane	251
3.23. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	252
3.24. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	255
3.25. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria	288
3.26. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore	314
3.27. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura	315
3.28. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi	321
3.29. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit	348
3.30. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor	355

3.31. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë	359
3.32. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes	365
3.33. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar	369
3.34. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore	376
3.35. Kapitulli 34 i acquis-së: Institucionet	379
3.36. Kapitulli 35 i acquis-së: Çështjet e tjera	379
MATRICA E MASAVE AFATSHKURTRA	380



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/64
Datë: 16.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim –Asociimit (PKZMSA).
2. Buxheti për zbatimin e masave afatshkurtra dhe prioritetet afatmesme në kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) duhet të mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2016 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian të inkorporojë në Program të gjitha komentet relevante të pranuar gjatë konsultimeve publike.
5. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian të inkorporojë në Program të gjitha komentet e Komisionit Evropian.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

HYRJE

Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015, përmes *Vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër*¹, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e *Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër*.² Me këtë Republika e Kosovës ka kryer detyrimet e veta politike e formale sa i përket këtij procesi, dhe MSA do të hyjë në fuqi vitin e ardhshëm, pas përfundimit të procedurave të miratimit dhe ratifikimit nga ana e institucioneve të BE-së, më specifikisht dy (2) muaj pas përfundimit të procedurave ratifikuese nga të dyja palët (neni 144).

Si marrëveshja e parë kontraktuale mes dy palëve, MSA paraqet një fazë të re të marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Si marrëveshje ndërkombëtare, ajo përcakton mekanizmat dhe afatet zyrtare për zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën në mënyrë progresive me BE-në në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së. Për më tepër, MSA vendosë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes. Ajo përmban dhjetë 'tituj' (kapituj kryesorë, ose krerë), si dhe shtatë shtojca, pesë protokolle dhe një deklaratë të përbashkët:

- Kreu I: Parimet e përgjithshme;
- Kreu II: Dialogu politik;
- Kreu III: Bashkëpunimi rajonal;
- Kreu IV: Lëvizja e lirë e mallrave;
- Kreu V: Themelimi, ofrimi i shërbimeve dhe kapitali;
- Kreu VI: Përafrimi i ligjeve të Kosovës me *acquis*, zbatimimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës;
- Kreu VII: Liria, siguria dhe drejtësia;
- Kreu VIII: Politika e bashkëpunimit;
- Kreu IX: Bashkëpunimi financiar; dhe
- Kreu X: Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe ato përfundimtare.

Pjesa dërrmuese e MSA-së bazohet në *acquis*-më BE-së, përkatësisht tërësinë e normave juridike të zbatueshme brenda territorit të saj dhe nga të gjitha shtetet anëtare si subjekte juridike, dhe mbulon të gjitha fushat e politikave. Prandaj, Kosova, si shtet që synon anëtarësimin në BE, duhet që gjatë procesit deri te anëtarësimi të miratojnë tërë *acquis*-në dhe ta bëjë atë pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm. Me fjalë të tjera, miratimi dhe zbatimimi i *acquis*-së qëndron në themel të negociatave për anëtarësim dhe vetë anëtarësimit. Duke qenë kështu, zbatimimi i MSA-së implikon obligime juridike për Kosovën, dhe zbatimimi i saj bën të domosdoshëm përgatitje më gjithëpërfshirëse dhe afatgjata, duke filluar nga dokumenti kryesor kombëtar për këtë qëllim. Kjo fazë e re e aderimit në BE kërkon avancimin e kornizës aktuale të politikave për integrim evropian duke e bërë atë më ambicioze, më gjithëpërfshirëse dhe më të integruar. Pasi që do të ngritë të gjitha dimensionet e veçanta të procesit të aderimit në një nivel shumë më të ndërlikuar, periudha prej tani e deri në anëtarësimin e plotë do të kërkojë një nivel shumë më të lartë të përgatitshmërisë dhe kapaciteteve institucionale. Kjo pasi që zbatimimi i saj do të vë në lëvizje një numër të madh reformash të thella, por edhe të ndjeshme, politike e ekonomike, të cilat do të ndikojnë tek të gjithë akterët e publiku dhe fushat e jetës. Kjo pasi që MSA jo vetëm pasqyron vullnetin politik të të dyja palëve për jetësimin e perspektivës sonë evropiane dhe përbën platformë për transformime afatgjata, por do të jetë edhe test i gatishmërisë dhe kapaciteteve institucionale për të realizuar këto qëllime politike.

Prandaj, për të arritur zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje dhe të të gjitha këtyre reformave që kërkon ajo është hartuar Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

¹ Vendimi i Qeverisë nr. 01/55, fq. 2, në dispozicion në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_55-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf.

² Ligji nr. 05/L-069, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>.

(PKZMSA), i cili përbën dokumentin kryesor nacional të politikave për aderim në BE. Si i tillë, ai vendos një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të të gjitha reformave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA, respektivisht masat dhe prioritetet për përafrimin gradual të legjislacionit vendor me acquis-në e BE-së përmes transpozimit të kësaj të fundit në të, si dhe për zbatimin e legjislacionit të përafuar. Përveç kësaj, PKZMSA reflekton masa e prioritetet që rrjedhin nga mekanizmat politik dhe të politikave të marrëdhënieve Kosovë - BE, përkatësisht agjendën politike e të politikave të dalë nga Dialogu i Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) dhe të gjeturat e Raportit të KE-së për Kosovën 2015 (ish-Raportit të Progresit). Me fjalë të tjera, ndonëse do të avancohet për kah përmbajtja dhe struktura dhe mund të pësojë modifikime në emërtim, PKZMSA do të mbetet dokumenti kryesor strategjik nacional për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe në fazat e mëpastajme të aderimit në BE.

Parapërgatitjet për hartimin e PKZMSA-së, nën koordinimin e Ministrisë së Integritit Evropian, kanë filluar në janar 2015, ndërsa procesi i hartimit të tij në prill, bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 06/22, të 3 prillit 2015, për iniciimin e përgatitjes së tij.³ Bazuar në këtë vendim, puna në hartimin e dokumentit është organizuar në gjithsej dyzet (40) ekupe (disa fusha të kriterëve politike të rigrupuara në ato të standardeve evropiane, për shkak të ndërlikohjes së fushave). Përveç MIE-së si organ kryesor koordinues, përmes këtij vendimi janë caktuar edhe institucionet koordinuese për secilin kapitull të Programit, ndërsa niveli i tretë i koordinimit, ai horizontal, ishte ai i Departamenteve për Integrit Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) dhe Departamenteve Ligjore (DL), të cilët kanë koordinuar punën në hartimin e kapitujve përkatës, në bashkëpunim me të gjitha strukturat e institucioneve përkatëse që kanë për mandat zhvillimin e zbatimit e politikave për fusha të veçanta. MIE si institucioni kryesor koordinues ka qenë e përfshirë aktivisht në punën e të gjitha ekupeve.

Drafti përfundimtar i Programit ka kaluar në fazën e konsultimeve publike, të zhvilluara gjatë pjesës së dytë të nëntorit dhe pjesës së parë të dhjetorit. Përveç komenteve me shkrim të pranuar, pjesë e konsultimeve publike ishte një konferencë përmblyëse me organizata të shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara, i mbajtur më 3 dhjetor, ku u diskutua hollësisht me ta përmbajtja e këtij dokumenti.

Sa i përket përmbajtjes, PKZMSA përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme (për periudhën e ardhshme pesëvjeçare: 2016-2020) për zbatimin e MSA-së dhe përfarimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjislacionit të përafuar. Pra, ai përmban masa afatshkurtra (që mbulojnë vitin 2016) dhe prioritete afatmesme (që mbulojnë vitet 2017-2020), të ndara në dy kategori: masa e prioritete legjislative, dhe masa e prioritete zbatuese. Bazuar në strukturën e Kriterëve të Kopenhagës, të gjitha masat dhe prioritetet janë të ndara në tri blloqe: *Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike, dhe Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së*. Përveç reformave kyçe politike e ekonomike që kërkon MSA, ai parasheh masa konkrete në kuadër të 33 kapitujve të acquis-së së BE-së (me përjashtim të kapitullit 34 dhe 35, të cilët do të mbulohen në një fazë të mëvonshme të aderimit).

Në kuadër të bllokut të parë, PKZMSA vendos masat dhe prioritetet në fusha si demokracia dhe sundimi i së drejtës, pra të drejtat e liritë e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve (përfshirë lirinë e mediave), gjyqësori e politikat kundër korrupsionit (të gjitha në kuadër të kapitullit 23 të acquis-së), dhe bashkëpunimi rajonal. Me fjalë të tjera, duke rikonfirmuar synimin e saj për të kontribuar në stabilitetin politik e ekonomik të Evropës Juglindore, Kosova, duke përmbushur detyrimet e saj të marra përsipër në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit, përmes këtij programi do të vazhdojë të përmbushë parakushtet politike të theksuara nga BE-ja si kritere që do të tregojnë vullnetin e përgatitshmërinë politike të Kosovës për t'u bërë pjesë e familjes evropiane.

Blloku i dytë reflekton përpjekjet që do të bëhen për të siguruar rritjen e vazhdueshme ekonomike, bazuar në Kriteret e Kopenhagës për vendosjen e një ekonomie funksionale të tregut të aftë për të t'u bërë ballë presionit të konkurrencës e forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian. Masat konkrete fokusohen në arritjen e prioriteteve si konsolidimi i mëtejshëm i sektorit fiskal (me synim reduktimin e shpenzimeve publike dhe të deficitit buxhetor), stabiliteti i sistemit financiar dhe atij bankar, qeverisja e ndërmarrjeve

³ Vendimi i Qeverisë nr. 06/22, fq. 6, në dispozicion në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_22_te_Qeverise_2015_.pdf.

publike, mbështetja për ndërmarrjet, rritja e investimeve, nxitja e eksportit, rritja e konkurrueshmërisë së produkteve për eksport, përmirësimi i sigurisë juridike dhe reformat e përgjithshme strukturore.

Blloku i fundit përshkruan kornizën ligjore dhe atë institucionale të kapitujve të veçantë të *acquis*-së, prioritetet për përafrimin e legjislacionit dhe hapat konkretë që do të ndërmerren, si dhe nevojat për zbatimin e suksesshëm të masave të politikave dhe atyre institucionale si bazë për reformat ligjore dhe ekonomike, përfshirë ndarjen e buxhetit për zbatimin e tyre.

Marrë në tërësi, struktura e PKZMSA-së është e organizuar në dy pjesë: pjesa narrative dhe matrica e masave afatshkurtra. Pjesa narrative e secilit kapitull përmbledh detyrimet e MSA-së dhe detyrimet e dala nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE, gjendjen aktuale (kornizën ligjore, përfshirë nivelin e përafrimit të legjislacionit me *acquis*, kornizën e politikave, kornizën institucionale, dhe asistencën e jashtme), si dhe masat afatshkurtra dhe prioritetet afatmesme. Në anën tjetër, matrica e masave afatshkurtra në kuadër të secilit kapitull përvijon në mënyrë të hollësishme masat konkrete që do të ndërmerren për, të ndara në dy kategori: masa legjislative (të nën-ndara më tej në masa të legjislacionit kornizë dhe akteve nënligjore e akteve të tjera rregullative) dhe masa zbatuese (të nën-ndara më tej në masa të kornizës së politikave, reformave institucionale e ngritjes së kapaciteteve institucionale, dhe masa të zbatimit në praktikë). Gjatë hartimit të masave janë bërë përpjekje që të jenë sa më të zbatueshme dhe të ndërlidhen me Programin e Qeverisë, proceset e dokumentet e buxhetimit, si dhe me dokumente sektoriale.

Më tej, matrica e masave afatshkurtra është strukturuar në atë mënyrë që mundëson ndërlidhjen e masave legjislative me dispozitat e MSA-së (*Objektivat/Referenca kornizë*), identifikimin e akteve konkrete kombëtarë që do të përafrohen me *acquis* (*Aktet kombëtarë që do të harmonizohen*) e të akteve të *acquis*-së që për transpozim (*Aktet e acquis-së së BE-së që do të transpozohen*) dhe të institucioneve përgjegjëse e atyre mbështetëse, si dhe përcaktimin e afateve kohore (në tremujorë – K1, K2, K3 dhe K4), nivelit të transpozimit (të pjesshëm – P, ose të tërësishëm – T) dhe kostos së përafërt buxhetore (të ndarë në tri kategori – totali, buxheti shtetëror [BRK] dhe burimet e donatorëve). Ngjashëm, kjo matricë mundëson ndërlidhjen e masave zbatuese afatshkurtra me dispozitat e MSA-së (*Objektivat/Referenca kornizë*), përcaktimin e objektivave specifike (*Masat/veprimet*) dhe të treguesve për matjen e përmbushjes së tyre, si dhe të institucioneve përgjegjëse e atyre mbështetëse, të afateve kohore, dokumenteve referuese dhe kostos së përafërt buxhetore (të ndarë në të njëjtat kategori si masat legjislative).

PKZMSA përbën agjendën tonë evropiane, dhe si i tillë një udhërrëfyes të të gjitha reformave. Zbatimi i tij do të na mundësojë që menjëherë të trajtojmë sfidat e mëdha me të cilat përballemi si shoqëri. Procesi ligjvënës do të na ndihmojë që menjëherë të fillojmë të ndahemi nga praktikat negative që na përcjellin në të gjitha fushat e sferat e jetës. Ndër gjërat e para që duhet të adresojmë është forcimi i mëtejshëm i shtetit të së drejtës, duke luftuar korrupsionin, zbatuar reformën e administratës publike e të gjyqësorit. Kjo do të mundësojë që qytetarëve t'u mbrohet e drejta demokratike për të jetuar i lirë dhe me mundësi të barabarta.

Secili organ i administratës shtetërore do të jetë përgjegjës për zbatimin Programit dhe monitorimin e zbatimit të tij në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tij. Si mekanizmi qendror qeverisës në vend për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA, përgjegjësia për monitorimin dhe zbatimin e tij bie mbi Qeverinë e Kosovës, secilin anëtar të kabinetit dhe secilin organ të administratës shtetërore që e drejtojnë ata, si dhe mbi të gjitha institucionet e tjera të përfshira në përgatitjen e Programit. Rolin kryesor dhe të pazëvendësueshëm në këtë padyshim që Qeveria do të luajë (së bashku me autoritetet e BE-së) në kuadër të strukturave formale të stabilizim-asociimit, të cilat do të krijohen menjëherë pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

Përveç këtyre, Kuvendi do të jetë një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti miratimin e legjislacionit. Rol kyç në kuadër të tij do të ketë Komisioni për Integrim Evropian, si në aspektin shtyrjes përpara të agjendës legjislative, ashtu edhe atë të koordinuesit për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga Kuvendi. Së treti, Kuvendi do të ndikojë edhe në strukturat e stabilizim-asociimit, në kuadër të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit.

Ngjashëm me Kuvendin, rol kyç të drejtpërdrejtë në zbatimin e këtij dokumenti dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të tij do të kenë të gjitha institucionet e pavarura dhe Komunat.

Rol të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, dhe rrjedhimisht në zbatimin e PKZMSA-së, do të luajë edhe Zyra e BE-së në Kosovë.

Zbatimi i PKZMSA-së do të varet shumë nga ajo se sa do të arrijë secili institucion të vendosë pronësi mbi tërë procesin e zbatimit të masave konkrete, si dhe nga cilësia e koordinimit të përditshëm në nivel të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore të përfshira në këtë proces. Përgjegjësia kryesore për koordinim në nivel të secilit organ të administratës shtetërore edhe më tej do të jetë e strukturave përgjegjëse për integrim evropian (DIEKP-ve dhe strukturave të ngjashme), të cilat do të koordinojnë të gjitha aktivitetet e rregullta në kuadër të institucioneve të tyre për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të Programit në tërësi. Më specifikisht, detyra e tyre do të jetë që të monitorojnë nëse detyrat e përcaktuara në Program kryhen si duhet e me kohë dhe të mbajnë MIE-në të informuar për të gjitha çështjet e ndërlydhura me këtë. Ato do ta bëjnë këtë përmes mbledhjes së rregullt të informatave dhe përgatitjes së raporteve për përparimet e arritura në kryerjen e detyrave të parapara me PKZMSA në kuadër të fushave të tyre përkatëse të përgjegjësisë.

Koordinimi i përgjithshëm në nivel të Qeverisë do të jetë detyrë e Ministrisë së Integritimit Evropian.

Marrë parasysh se ky është dokument voluminoz dhe i ngarkuar në aspektin e përmbajtjes, ai është i ndarë sipas fushave të veçanta të përgjegjësisë së zyrtarëve të MIE-së përgjegjës për sektorë të veçantë të tij. Duke përcjellë zhvillimet në një sektor të caktuar, zyrtarët MIE-së do të jenë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij programi në nivel kombëtar, përmes kontakteve dhe bashkëpunimit të rregullt me homologët e tyre të sektorëve në organet përkatëse qeveritare që i mbulojnë. Ky sistem mundëson monitorimin e zbatimit në nivel operacional, si në nivel të njërit ashtu edhe shumë institucioneve të linjës që mbulojnë.

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Në vitin 1999, BE propozoi themelimin e *Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA)* për vendet e Ballkanit Perëndimor, si kornizë për procesin e anëtarësimit të tyre në të. PSA u lansua zyrtarisht në nëntor 2000, në Samitin e Zagrebit. Bazuar në Kriteret e Kopenhagës, BE aty kishte nënvizuar se perspektiva evropiane e këtyre vendeve do të përcaktohej në bazë të progresit të tyre drejt demokracisë së qëndrueshme, sundimit të së drejtës, ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal. Kjo perspektivë u rikonfirmua në Këshillin Evropian të Selanikut, të qershorit 2003. Kosova është pjesë e kornizës së PSA-së që nga Samiti i Selanikut. Më specifikisht, në prill 2005 Komisioni Evropian (KE) publiko komunikatën *E ardhmja evropiane për Kosovën*, kurse në vitin 2006 Këshilli miratoi Partneritetin e parë Evropian për Kosovën. Partneriteti i dytë Evropian është miratuar në vitin 2008.

Si përgjigje ndaj Partneritetit Evropian, Qeveria miratoi Planin e parë të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE) më 2008, duke e rishikuar atë çdo fundvit, pas publikimit të Raportit të Progresit. Bazuar në të njëjtën praktikë të hartimit e rishikimit të tij, PVPE ka qenë në fuqi deri në fund të vitit 2012, ndërsa është zëvendësuar me Planin e Veprimit për MSA (PVMISA) gjatë viteve 2013-2014, e i fundit është Plani i Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit (PVRP 2015).

Në anën tjetër, më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Republika e Kosovës deri më tani është njohur nga njëqindtetë (108) shtete, nga të cilat 23 shtete anëtare të BE-së.

Deri në fund të vitit 2009 dialogu politik dhe i politikave ndërmjet Kosovës dhe BE-së në kuadër të agjendës evropiane zhvillohej në korniza të Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim-Asociimit (MPSA). Por, në tetor 2009, KE publikoi komunikatën *Kosova – përmbushja e perspektivës së saj evropiane*, në të cilën propozoi thellimin dhe forcimin e perspektivës evropiane të Kosovës. Iniciativat kryesore të reja ishin: avancimi i dialogut politik e teknik në Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA); inicimin e dialogut të vizave, me perspektivë të liberalizimit eventual të vizave; zgjerimi i Masave Tregtare Autonome dhe një marrëveshje e mundshme tregtare me BE-në; korniza e marrëveshjes me Kosovën mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së saj në Programet e Komunitetit (BE-së); dhe aktivizimi i komponentit IPA për bashkëpunimin ndër-kufitar (BNK).

Procesi drejt MSA-së ka nisur në tetor 2011, kur KE, përmes Raportit të Progresit, kishte rekomanduar inicimin e Studimit të Fizibilitetit për MSA. Pas kryerjes së tij, gjatë verës 2012, *Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës* u publikua në tetor 2012, duke konstatuar se Kosova ishte e gatshme për t'i filluar negociatat për MSA pasi të përmbushte kriteret afatshkurtra (të cilat kishin të bënin me sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen e minoriteteve dhe tregtinë). Pas përmbushjes së këtyre kriterëve, ky propozim i Komisionit u miratua nga Këshilli i BE-së më 12 dhjetor 2012. Me pas, në prill 2013 KE publikoi raportin monitorues për zbatimin e kriterëve afatshkurtra dhe konfirmoi se Kosova kishte përmbushur të gjitha kriteret afatshkurtra për nisjen e negociatave për MSA.

Negociatat filluan më 28 tetor 2013, me takimin e parë të Kryenegociatorëve. Pas hapjes së negociatave, me fokus në kapitujt IV, V dhe VI, raundi i dytë i tyre, i mbajtur më 27 nëntor 2013, u fokusua në përmbylljen e këtyre tre kapitujve, me ç'rast gjithashtu u hapën negociatat për kapitujt I, III, VII, VIII, IX dhe X. Raundi i tretë dhe i katërt u zhvilluan në dhjetor 2013, respektivisht në shkurt 2014, kurse në raundi i pestë (më 24 mars 2014) u fokusua në kapitullin e fundit të mbetur, Kapitullin II, mbi dialogun politik. Pas pesë raundesh të negociatave, takimi përfundimtar i Kryenegociatorëve u mbajt më 2 maj 2014, në Prishtinë, me ç'rast u përmbyllën negociatat. Pas kësaj, MSA u miratua në parim nga Kryenegociatorët më 25 korrik 2014 me vendosjen e inicialeve, në Bruksel. Përfundimisht, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Qeveritë e Shteteve Anëtare, MSA u nënshkrua më 27 tetor 2015, në Strasburg, u miratua nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015 dhe u ratifikua nga Kuvendi më 2 nëntor 2015.

Sa i përket procesit të *liberalizimit të vizave*, ai ishte iniciuar në qershor 2012 me marrjen e Udhërrëfyesit nga KE (i cili përmbante gjithsej 97 kriteret, të ndarë në 4 blloqe). Më 1 shtator 2012 Kosova i dorëzoi KE-së Raportin e parë të gatishmërisë, kurse më 12 shkurt 2013 KE publikoi Raportin e parë të progresit për

vlerësimin e zbatimit të Udhërrëfyesit. Procesi më tej u intensifikua me organizimin e katër misioneve faktmbledhëse (të përbërë nga ekspertë të shteteve anëtare dhe KE-së) dhe nxjerrjen e dy raporteve vlerësuese mbi zbatimin e rekomandimeve të tyre. Pas nxjerrjes së raportit u përshpejtua realizimi i detyrave të dala nga këto vlerësime deri në misionin e fundit faktmbledhës, atë të korrikut 2015. Në vijim të përgatitjeve për këtë mision, në qershor 2015 KE-së iu dërgua raporti i fundit i gatishmërisë nga ana e institucioneve të Kosovës, i cili përmbante vlerësim gjithëpërfshirës mbi përmbushjen e rekomandimeve të mbetura. Misioni i fundit faktmbledhës u mbajt më 6-10 korrik dhe 13-16 korrik, ndërsa raportet e ekspertëve u dërguan në shtator 2015. Pas kësaj ka vazhduar puna në zbatimin e tetë rekomandimeve të nxjerra, kurse më 3 nëntor 2015 KE-së i është dërguar raporti i fundit mbi zbatimin e rekomandimeve të mbetura. Përfundimisht, brenda këtij viti pritet një vendim përfundimtar i Këshillit, pas nxjerrjes së raportit të fundit vlerësues nga ana e KE-së.

1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE

1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Kushtetuta

Republika e Kosovës funksionon bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila është miratuar nga Kuvendi më 9 prill 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga parime të cilat garantojnë zbatimin e drejtëpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, ku të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me këto marrëveshje dhe instrumente kanë zbatim të drejtëpërdrejtë. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e ngjajshme si ato të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit sa i përket lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimin e ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut, të gjitha këto të parapara me nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe në mesin e parimeve të përgjithshme demokratike të parapara në MSA, specifikisht në kuadër të Nenit 3.

Për të respektuar në plotni parimet kyçe që formojnë bazën e politikave të BE-së dhe Kosovës si dhe duke pasur parasysh që këto parime përbëjnë elementet thelbësore të MSA-së, Republika e Kosovës ka ndermarrë masat e nevojshme për të filluar së përmbushuri kriteret e MSA-së në fushat e lartë-përmendura përmes ndryshimeve të nevojshme kushtetuese. Konkretisht, për të përmbushur kërkesat e MSA (specifikisht Neni 3, 6), Kuvendi ka miratuar ndryshimin e amandamentit 24 të kushtetutës së Republikës së Kosovës që mundëson themelimin e Dhomave të Specializuara dhe një Zyre të Prokurorit të Specializuar, në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Poashtu, institucionet vendim-marrëse kanë miratuar propozimet për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës me ç'rast synohet që të arrihet avancim i mëtejshëm i pavarësisë së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës si dhe përmbushja e kriterëve që ndërlidhen me agjendën evropiane dhe të gjeturat e raporteve kryesore për vendin nga Komisioni Evropian.

Përfundimisht, Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për të përmbushur të gjitha obligimet e tjera që dalin nga MSA. Në këtë drejtim, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, Kosova do të kryej reformat kushtetuese të nevojshme, përfshirë ato në fushën e sigurisë, drejtësisë dhe fushat e tjera varësisht nga nevojat që shfaqen gjatë periudhës zbatuese në vitet në vijim.

Parlamenti

Ky kapitull mbulon fushëveprimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si organ ligjvënës që miraton ligje dhe rezoluta, dhe ndër të tjera shqyrton dhe miraton marrëveshje ndërkombëtare. Po ashtu, ky kapitull mbulon edhe aspektin mbikqyrës të Kuvendit që ka të bëjë me mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit, si dhe mbulon rolin e Kuvendit në procesin e integritimit evropian. Pika tjera të rëndësishme që trajtohen nga ky kapitull përfshijnë: reformat kyçe kushtetuese që kërkon aderimi në BE; përbërjen dhe strukturën, përfshirë imunitetin e deputetëve; funksionet e përgjithshme të Kuvendit; funksionimin e strukturave të Kuvendit (bazuar edhe në Rregulloren e punës), me fokus në çështjet relevante për kërkesat e IE, përfshirë ato të MSA-së; funksionin legjislativ të Kuvendit; funksioni mbikëqyrës të Kuvendit; funksionin zgjedhor të Kuvendit (cilat organe/autoritete të administratës shtetërore i zgjedh/emëron dhe shkarkon, dhe procedurat e përgjithshme); rolin e Kuvendit në procesin e harmonizimit të legjislationit kombëtar me acquis-në e BE-së dhe strukturat përgjegjëse; dhe zgjedhjet (legjislationin, sistemin zgjedhor, funksionimin dhe ecurinë e proceseve zgjedhore).

Kërkesat e MSA-së

MSA, në nenin 132, parashih funksionimin e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim (KPSA) si forum i përbashkët i deputetëve të Parlamentit Evropian dhe atyre të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të shkëmbyer mendimet rreth zbatimit të MSA-së. KPSA do të mblidhet në intervale kohore për të cilat do të dakordohen anëtarët e tij, por të paktën njëherë në vit, dhe do të kryesohet me rotacion nga deputetë anëtarë të tij nga të dy parlamentet. Ai gjithashtu do të hartojë rregulloren e tij të punës.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga raportet e BE-së për Kosovën, gjatë vitit 2016 Kuvendi do të miratojë Ligjin për Kuvendin, si dhe do të plotësohet dhe rregullohet Rregullorja për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE

Kërkesat nga Studimi i Fizibilitetit

Me kriteret afatmesme nga Studimi i fizibilitetit, nga Kuvendi kërkohet fuqizimi i rolit mbikëqyrës të parlamentit mbi ekzekutivin duke shqyrtuar projektligjet si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Kërkesat e dala nga DPSA

Në kuadër të DPSA-së, nga Kuvendi kërkohet të sigurojë emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura të cilat janë kompetencë e Kuvendit Po ashtu, si kërkesë e dal nga Raporti i Progresit për vitin 2014, Kuvendi do të zhvilloj mekanizmat për logaridhënie të anëtarëve të bordeve. Pra, Komisionet Parlamentare varësisht nga fushë-veprimi i tyre do të bëjnë mbikëqyrjen e punëve të institucioneve të pavarura si dhe do t'i ftoj këto institucione në raportim.

Kërkesat e dala nga Raporti i KE-së për Kosovën

Me qëllim të adresimit të kërkesës nga Raporti i KE-së për Kosovën "nevojiten përpjekje të mëtejshme nga Kuvendi dhe Komisionet e tij për të siguruar kontrollin e buxhetit sidomos në fusha siç është: shëndetësia, bujqësia, asistencë sociale, kultura dhe arsimit" Kuvendi ka paraparë themelimin e Njesisë për analiza buxhetore dhe financiare. Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike do të zhvilloj një mekanizëm për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Sistemi politik i Kosovës është i bazuar në parimet e demokracisë parlamentare. Kuvendi i Kosovës është institucion ligjvënës dhe zgjedhet drejtpërdrejt nga populli për një mandat katër vjeçar. Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës dhe fushë-veprimtarinë e vet e ushtron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Përbërja dhe struktura e Kuvendit përcaktohet me kapitullin e IV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 64 i Kushtetutës përcakton strukturën e Kuvendit, ndërsa paragrafi 1 i nenit 64 përcakton, si vijon; *Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të ofeshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.*

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të organeve, të trupave të punës së tij, të drejtat dhe detyrat e deputetëve.

Komisionet parlamentare pasqyrojnë përbërjen politike në Kuvend. Komisionet kanë Kryetarin dhe dy zëvendëskryetar që i përkasin grupeve të ndryshme parlamentare, ku së paku një zëvendëskryetar është nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryetarit.

Një nga rolet kyçe të Kuvendit, përveç përafrimit të legjislacionit vendor me Acquis të BE-së është edhe shqyrtimi dhe verifikimi i këtij përafrimi. Struktura përgjegjëse sa i përket procesit të harmonizimit të legjislacionit të BE-së përbëhet nga Komisioni për Integritime Evropiane i cili shqyrton procesin e harmonizimit të çdo ligji të miratuar në Kuvend, me legjislacionin e BE. Komisioni për Integritime Evropiane shqyrton jo vetëm tekstin e projektligjeve të proceduara në këtë komision, por edhe amendamentet e bëra nga komisionet funksionale, apo nga deputetët, duke siguruar pajtueshmërinë e këtyre amendamenteve me aktet juridike të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të administratës, Drejtoria për Standardizim dhe përafrim dhe harmonizim ligjor bënë verifikimin e deklaratës së MIE-së për përafrimin e Projektligjit me legjislacionin e BE-së si dhe mbikëqyrjen e përafrimit të legjislacionit me "Acquis e BE-së" dhe me standardet ndërkombëtare të

aplikueshme në Kosovë, për gjitha projektligjet dhe amendamentet e propozuara nga komisionet parlamentare që i propozohen Kuvendit të Kosovës për shqyrtim.

Korniza e politikave

Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës paraqet dokumentin bazë për aktivitetin e Kuvendit si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Hartimi i Programit të Punës është i bazuar në këto dokumente:

- Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Planet e punës së komisioneve parlamentare;
- Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i KE-së për Kosovën.

Dinamika e programit të punës realizohet në dy (2) pjesë: Sesioni pranveror dhe Sesioni vjeshtor, që përfshin punën e Kryesisë së Kuvendit, të grupeve parlamentare, të komisioneve parlamentare dhe të séances plenare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të administratës së tij, rregullisht mban trajnime lidhur me funksionimin e Administratës Shtetërore në Republikën e Kosovës, për Monitorimi dhe Vlerësimi i Fondeve IPA, për të drejtat e Qasjes në Dokumente Publike, Planifikimin dhe Menaxhimi i Projekteve me MS Project, Zbatimi i Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Menaxhimi Administrativ, Procesi i Komunikimit, Hartimi i Shkresave, Raporteve, Procesverbaleve si dhe Arivimi i Dokumenteve, Procedurat Disiplinore dhe Procedurat e Ankesave në Shërbimin Civil, Menaxhimi i Pasurisë Jofinanciare në OB, ISO 27001 – Information Security Management Systems Lead Implementer, si dhe Seminari lidhur me Ruajtja dhe Mbrojtja e Dokumenteve Zyrtare.

Korniza institucionale

Kuvendi për funksionimin e tij, nga radhët e veta e zgjedh Kryesinë e Kuvendit (Kryetarin dhe Nënkryetarët e Kuvendit) dhe emëron Komisionet parlamentare të përhershme dhe funksionale, si dhe Komisionet parlamentare ad-hoc. Në legjislaturën e V-te të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë gjithsej 14 komisione parlamentare, ku katër Komisione janë të përhershme dhe 10 tjera janë komisione funksionale. Të gjitha projektligjet kalojnë për shqyrtim dhe miratim në Komisionet parlamentare funksionale dhe Komisionet e përhershme parlamentare.

Funksionimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mënyrë taksative përcaktohet me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndër funksionet kryesore të Kuvendit është funksioni ligjvënës, ndërsa krahas këtij funksioni, Kuvendi ushtron edhe funksionin mbikëqyrës. Me qëllim të mbajtjes në përgjegjësi, Kuvendi mbikëqyr punën e institucioneve dhe organeve të cilat zgjedhën nga Kuvendi. Përveç kësaj, Kuvendi, kryesisht përmes Komisioneve parlamentare, mbikëqyr edhe zbatimin e ligjeve duke rekomanduar marrjen e masave në rast të mos zbatimit apo zbatimit jo adekuat të ligjeve të mbikëqyrura.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka gjithsej 120 deputet, përfshirë edhe vendet e garantuara për komunitetin jo shumicë në Republikën e Kosovës, ndërsa sa i përket imunitetit të deputetëve, neni 75 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 9 i Ligjit nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit përcakton garantimin e imunitetit të deputetit nga ndjekja penale nga paditë civile ose nga shkarkimi për veprimet e tyre brenda fushëveprimit dhe përgjegjësisive të tyre si deputetë të Kuvendit. Gjithashtu edhe në Rregulloren e Kuvendit është sanksionuar imuniteti i Deputetit, neni 22, paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje përcakton që Deputeti gëzon imunitet për deklaratimet gojore ose të shkruara, si dhe për veprimet e tjera, të kryera në cilësinë e deputetit të Kuvendit, ndërsa në neni 23 të kësaj Rregullores përcaktohet procedura e heqjes së imunitetit të deputetit.

Institucionet e pavarura të cilat zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe ato të propozuara nga Qeveria dhe të zgjedhura nga Kuvendi, raportojnë ashtu siç është e paraparë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Disa nga përgjegjësit kushtetuese që ka Kuvendi, janë edhe Zgjedhja e Qeverisë, Presidentit, dhe Institucioneve të Pavarura.

Sa i përket koordinimit, në nivel administrativ, të Kuvendit me Qeverinë, Njësia për Propozime dhe Parashtrësia është në koordinim me zyrtarin ndërlidhës të Qeverisë lidhur me procedimin e projektligjeve, raporteve, propozimeve për emërimet e anëtarëve të bordeve dhe shkresave tjera. Po ashtu, Kuvendi përmes zyrës për propozime dhe parashtrësia i procedon Qeverisë dhe Institucioneve tjera Vendime, Shkresa, Pyetje Parlamentare, Kërkesat për Interpelanca, etj. Kjo zyre bën dërgimin e Ligjeve të miratuara në Kuvend për dekretim tek Zyra e Presidentit, gjithashtu Zyra për propozime dhe parashtrësia i dorëzon Ligjet e Dekretuara në Gazetën Zyrtare për Publikim, gjithashtu Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm dhe sistem të konsoliduar të koordinimit të punës me Kuvendin e Kosovës. Rregullorja e Punës së Qeverisë nr. 09/2011 përcakton hollësisht obligimet dhe përgjegjësit e Qeverisë në këtë drejtim. Për të mundësuar që çështjet e lartpërmendura të realizohen me përpikëri dhe anëtarët e Qeverisë të informohen me kohë për të gjitha çështjet, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, kryen rolin e shërbimit mbështetës për anëtarët e Kabinetit Qeveritar dhe strukturat e tjera të Qeverisë në raport me obligimet ndaj Kuvendit. Përveç kësaj, bazuar në Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011, ka filluar procesi për emërimin e Anëtarit kujdestar të Qeverisë në punimet e Kuvendit.

Kuvendi ka bërë progres në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe konsultimet me shoqërinë civile. Numri i aktiviteteve monitoruese dhe niveli i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit është rritur. Kuvendi në mënyrë të rregullt shqyrton raportet e komisioneve parlamentare mbi zbatimin e ligjeve dhe miraton rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të ligjeve të monitoruara. Praktika e raportimit të ministrave në komisionet e Kuvendit është rritur. Është rritur numri i stafit mbështetës për komisionet. Kuvendi ka rritur numrin e konsultimeve me shoqërinë civile dhe me publikun. Kuvendi i Kosovës duke përfillur parimet e Strategjisë së Bashkëpunimit, ka miratuar Deklaratën për Partneritet mes Kuvendit dhe Shoqërisë Civile duke institucionalizuar bashkëpunimin në nivel partneriteti. Kuvendi ka angazhuar një zyrtar ndërlidhës për OJQ-të. Po ashtu, ka institucionalizuar partneritetin me shoqërinë civile përmes përgjegjësive të përbashkëta në çdo hap të procesit politik dhe vendimmarrës në hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe politikave duke përfillur Deklaratën për Partneritet mes Kuvendit dhe Shoqërisë Civile. Duke marrë për bazë parimet e Strategjisë së Kuvendit për informim dhe marrëdhënie me publik, Kryesia e Kuvendit me vendim ka themeluar Forumin për Transparencën Parlamentare i përberë nga deputetë, përfaqësues të administratës dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ky Forum është i thirrur që të avancojë dhe sigurojë angazhimin më të madh qytetar duke promovuar kulturën parlamentare përmes informatave, qasjes në informata dhe në punën e Parlamentit si dhe duke fuqizuar qytetarët në procesin legjislativ dhe rritjen e llogaridhënies.

Administrata e Kuvendit, nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendi, ofron shërbime profesionale, teknike, administrative si dhe shërbime të tjera mbështetëse të nevojshme për Kuvendin dhe organet e tij.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga MSA, dokumentet dhe raportet e BE-së për Kosovën, gjatë vitit 2016 Kuvendi do të miratojë Ligjin për Kuvendin. Me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, është në proces të hartimit të Projektligjit për Kuvendin. Me Ligjin për Kuvendin parashihet të arrihet pavarësia buxhetore e Kuvendit dhe të përcaktohet statusi i shërbyesve civil të Kuvendit.

Sa i përket *kornizës institucionale*, konkretisht me qëllim të përmirësimit të shërbimeve që ofrohen nga Drejtoria për standardizim, përafrim dhe harmonizim gjuhësor, në kuadër të kësaj Drejtorie është paraparë krijimi i Njesisë së veçantë për analiza ligjore dhe përafrim. Kjo Njësi do të bëjë analiza ligjore profesionale për të gjitha projektligjet që dorëzohen në Kuvend brenda afateve të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Me qëllim të adresimit të kërkesës nga Raporti i KE-së për Kosovën, “nevojiten përpjekje të mëtejshme nga Kuvendi dhe Komisionet e tij për të siguruar kontrollin e buxhetit sidomos në fusha siç është: shëndetësia, bujqësia, asistencë sociale, kultura dhe arsimit” Kuvendi ka paraparë themelimin e Njësisë për analiza buxhetore dhe financiare. Themelimi i Njësisë për analiza buxhetore dhe financiare do të rrit nivelin mbikëqyrës të Kuvendit në kontrollin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të shtetit. Kjo Njësi, po ashtu, do të ofroj analiza profesionale për çështjet buxhetore dhe financiare për komisionet parlamentare dhe deputetët.

Sa i përket *avancimit të politikave* parashihet të miratohet Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ndër-parlamentar.

Forcimi dhe ngritja e kapaciteteve në administratën e Kuvendit është paraparë me shtimin e pozitave të reja, pozitat aktuale të shpallura dhe trajnime.

Në kuadër të *zbatimit në praktikë*, Kuvendi i Kosovës do të përmirësojë mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullative, ku ndër sfidat kryesore është emërimi i anëtarëve të bordeve të institucioneve dhe autoriteteve të pavarura si dhe siguri i alokimit të mjeteve të mjaftueshme buxhetore për to. Në këtë drejtim, parashihet miratimi i planit të përbashkët Qeveri-Kuvend për kompletimin bordeve të institucioneve/agjencioneve të pavarura.

Gjithashtu, komisioni për mbikëqyrjen e financave publike do të zhvilloj një mekanizëm për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit.

Prioritetet afatmesme

Korniza Institucionale: Miratimi i Rregullores së re të Kuvendit. Kuvendi i Republikës së Kosovës synon që në periudhën afatmesme të miratoj Rregulloren e re për Kuvendin si dhe zhvillimin e një procesi ligjvënës efikas dhe gjithëpërfshirës.

Avancimi i Politikave: hartimi i planeve vjetore të punës së komisioneve parlamentare, planifikimi më i mirë i dinamikës së shqyrtimit të projektligjeve, Strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndër-parlamentar dhe Strategjia për Kuvendin 2015-2020.

Kapaciteti legjislativ i Kuvendit do të rritet më tej, sidomos për Departamentin e Kuvendit për Çështje Ligjore dhe Procedurale përmes rekrutimit të stafit në pajtim me Rregulloren për Përgjegjësitë dhe Organizimin e Administratës së Kuvendit. Gjithashtu, Kuvendi do të përmirësojë mbikëqyrjen e ekzekutivit, duke përfshirë edhe sektorin e sigurisë, përmes shqyrtimit të legjislacionit dhe monitorimit të implementimit të politikave dhe ligjeve. Në përgjithësi, do të forcojë procedurën legjislative në mënyrë që të sigurojë ekspertizë ndër-sektoriale dhe përputhshmëri me Acquis.

Plani Strategjik i Kuvendit 2015-2020, i cili do të mbuloj rolin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit për ofrimin e shërbimeve në mënyrë cilësore, do të ndihmoj deputetët për të përmbushur funksionin ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues. Plani do të siguroj një qasje të integruar për zhvillimin dhe forcimin e Kuvendit në periudhën afatmesme, për funksionim të mirëfilltë, si nga aspekti organizativ ashtu edhe në strukturë e përmbajtje.

Plani ka 5 objektiva dhe 24 nen- objektiva: të avancohet pavarësia institucionale, integriteti i Kuvendit, ngritja e kapaciteteve të Administratës së Kuvendit, të avancohet procesi i shqyrtimit dhe hartimit të ligjeve nga Kuvendi, të avancohet kapaciteti mbikëqyrës i Kuvendit, të avancohet transparenca, komunikimi me qytetarë dhe roli përfaqësues i deputetëve të zhvillohet dhe avancohet bashkëpunimi rajonal, evropian dhe ndërkombëtar, po ashtu Kuvendi parasheh themelimin e Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociim.

Zbatimi në praktikë: Organet përgjegjëse të Kuvendit do të sigurojnë një mbikëqyrje të fortë të shpenzimeve buxhetore të parlamentit gjatë vitit financiar.

Theks i veçantë do t'i kushtohet Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian, roli i të cilit do të përmirësohet akoma më shumë pasi që është organ kyç për monitorimin dhe shtyrjen para të reformave dhe kritereve në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe procesit të liberalizimit të vizave.

Gjithashtu, Kuvendi do të zhvillojë kapacitetet profesionale të administratës së saj përmes bashkëpunimit me parlamentet e vendeve tjera, përmes prioriteteve të dala nga Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Marrëdhënie ndër-parlamentare.

Reforma e sistemit zgjedhor

Ndër prioritetet kryesore të Kuvendit të Republikës së Kosovës mbetet dhe ndryshimi i legjislacionit përkatës që mundëson reformën e mirëfilltë zgjedhore, përkritazi me standardet e pranuar evropiane. Kjo synohet të arrihet në një periudhë afatmesme përmes adresimit të rekomandimeve të mundshme nga Komisioni i Venecias dhe të konkretizohet përmes arritjes së konsensusit të partive politike që përbëjnë Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Komisioni përkatës parlamentar që do të angazhohet për reformë zgjedhore pritet të adresojë aspektet kyçe të procesit zgjedhor në mënyrë që këto elemente të detajohen në ligje dhe të shërbejnë si mënyrë e ngritjes së sigurisë ligjore, si dhe ngritjes së besimit në proceset zgjedhore përkritazi me standardet dhe praktikatat më demokratike evropiane.

Në kuadër të reformës zgjedhore dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga raportet e BE-së për Kosovën, Kosova duhet të plotësoj-ndryshoj Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe të themelohet një autoritet i pavarur, jo KQZ-ja, që të jetë përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike. Konkretisht, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet që të themeloj Komisionin Ad Hoc për reformë zgjedhore, të cilit do t'i siguroj buxhet, për të përmbushur obligimet të cilat dalin nga ky proces. Ndërsa, me qëllim të zbatimit të Ligjit për Financimin e Partive Politike, Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të angazhohet në krijimin e një dikasteri në kuadër të KQZ-së ose në kuadër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Reforma zgjedhore në Republikë e Kosovës është e rregulluar sipas: Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme; Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar në nëntor 2010; Ligji nr. 03/l-174 për Financimin e Subjekteve Politike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozitat bazë me të cilat rregullohet procesi zgjedhor në Republikën e Kosovës.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji mbi Financimin e Subjekteve Politike i datës 16 shtator 2010, i ndryshuar në dhjetor të vitit 2011 dhe korrik të vitit 2013 përbëjnë atë që quhet legjislacion primar në të cilin bazohet i tërë sistemi zgjedhor në Republikën e Kosovës. Në kuadër të legjislacionit zgjedhor hynë edhe 17 Rregullat zgjedhore të nxjerra nga Komisioni Qendror i zgjedhjeve të cilat sqarojnë dispozitat e ligjit për zgjedhjet dhe japin më shumë hollësi të zbatimit të tij në praktikë.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës institucionet shtetërore garantojnë pjesëmarrjen e secilit shtetas në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike. Çdo shtetasi të Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjete vjeçare Kushtetuta i garanton të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në kuadër të institucioneve shtetërore nëpërmes procesit zgjedhor në të cilin vota e tij duhet të jetë personale e barabartë e lirë dhe e fshehtë.

Më tej, Ligji për zgjedhjet e përgjithshme i ndryshuar si me lartë rregullon sistemin zgjedhor, financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëmbajtjen e listës së votuesve, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike, përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin dhe funksionimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve, rregullat për

akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar, mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat, kodin e mirësjelljes së subjekteve politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve, procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve si dhe sanksionet dhe gjokat e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

Kushtetuta dhe Ligji për Përgjithshme në Republikën e Kosovës rregullojnë sistemin zgjedhor në Kosovë. Sipas Kushtetutës dhe Ligjit, Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Legjislacioni i mësipërm ka ofruar një bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Korniza ligjore që ka rregulluar zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe lokale edhe përkundër te metave, megjithatë ka siguruar një funksionim dhe ecuri normale të rrjedhjes së procesit të gjithmbarshëm zgjedhor në zgjedhjet lokale të 2013 dhe atyre parlamentare të 2014-tës. Zgjedhjet kanë kaluar qetë dhe pa ndonjë incident të madh. Qytetarët kanë shprehur të drejtën e tyre për të votuar, përfshirë edhe pjesën në veri të Kosovës. Hapja, votimi dhe procedurat përmblyëse në Ditën e Zgjedhjeve janë vlerësuar pozitivisht edhe nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtar, që paraqet përmirësim të dukshëm krahasuar me ecurinë dhe funksionimin e procesit në zgjedhjet të kaluara. Në kuadër të procesit të fundit zgjedhor, sistemi i ulëseve 'të rezervuara' i garantuara me kushtetutë për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë, i përdorur si masë e përkohshme për dy legjislaturat e kaluara, është zëvendësuar me sistemin e përhershëm të ndarjes së 20 ulëseve të 'garantuara'.

Përkundër një numri të madh përpjekjesh për të reformuar sistemin zgjedhor në Kosovë para zgjedhjeve të fundit për kryetar komune dhe zgjedhjet komunale në vjeshtë të vitit 2013, si dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 8 qershorit të vitit 2014, ajo nuk kishte ndodhur. Një varg të metash kanë përcjell këto procese zgjedhore të cilat janë identifikuar edhe nga raporti i fundit i progresit 2014 i Komisionit Evropian. Koha e shkurtër përgatitore (30 ditë) ka ndikuar negativisht në aspekte të caktuara të procesit teknik, siç ishte rritja e ndërjegjësimit të votuesve. Kjo gjithashtu e zvogëloi kohën e cila ishte në dispozicion për të paraqitur ankesat dhe parashtrësat para ditës së zgjedhjeve. Mbeten që të adresohen një sërë mangësish, duke përfshirë edhe përafrimin më të mirë të legjislacionit primar dhe sekondar mbi zgjedhjet, afatet e duhura kohore për ankesa dhe parashtrësa, saktësinë e listave të votuesve në mënyrë që sa më mirë të pasqyrojnë praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Me anëtarësimin e Kosovës në Komisionin e Venecias, pritët që mangësitë e identifikuar të adresohen. Në këtë drejtim, edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës rekomandimet për ndryshim plotësim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Zgjedhjet Lokale. Rekomandimet kanë qenë të bazuara në praktikën e kaluara gjatë implementimit të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Lokale.

1.1.2. Sistemi gjyqësor

Sistemi gjyqësor mbulohet në kuadër të bllokut 3: 3.24. *Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.*

1.1.3. Administrata publike

Administrata publike është një ndërlidhje në mes të qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe qytetarëve, që zbaton politikën publike të ndërmarra nga qeveria duke rritur kështu kohezionin social dhe besimin midis Shtetit dhe qytetarëve. Pra, administratën publike e përbejnë njësitë institucionale qeveritare, që rregullojnë funksionimin e shoqërisë. Administrata publike efektive është vendimtare për

zhvillimin e vendit duke zbatuar procedurat administrative transparente, të qarta dhe të thjeshta dhe shërbime të fokusuara tek qytetari, administrata publike po ashtu ndihmon bizneset gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duke u lehtësuar procedurat, dhe heqjen e barrierave burokratike.

Kërkesat e MSA-së

Në kuadër të kriterëve për fushën e administratës publike që duhet plotësuar nga qeveria dhe institucionet relevante të Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 120 të MSA-së, mbetet konsolidimi i plotë i kornizës ligjore (miratimi i legjislacionit primar dhe sekondar, plotësim/ndryshimi) si dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit në tërësi.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE

Kërkesat e dala nga GVRAP Qershor 2015

Kosova duhet ta miratoj Ligjin për Procedurë të Përgjithshme Administrative në mënyrë që të sigurojë një bazë për thjeshtimin dhe modernizimin e ofrimit të shërbimeve, në përputhje me standardet europiane. Planifikimi në fushën e Administratës Publike duhet të jetë më strategjik dhe i ndërlidhur me prioritetet e Qeverisë, strategjitë sektoriale, kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetin në dispozicion. Kriteri i rëndësishëm është përfundimi i procesit të klasifikimit të vendeve të punës. Sa i përket shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore nevojiten përpjekje të mëtejshme për të depolitizuar administratën dhe për të zbatuar plotësisht dispozitat relevante për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në shërbimet civil. Gjithashtu, numri dhe sistemimi i shërbyesve civil të cilët i takojnë komuniteteve jo shumicë nëpër ministri dhe institucione të tjera duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjithësi, Kosova do të ketë nevojë për të rritur më tej përpjekjet e saj për të përmirësuar profesionalizmin, llogaridhënien, efikasitetin dhe efektivitetin e administratës publike në të gjitha nivelet duke përfshirë këtu respektimin e vendimeve të KPMSHCK-së dhe zbatimin e vendimit rreth çështjes së ndërtesës për Avokatin e Popullit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Korniza ligjore në fushën e administratës publike është vendosur, megjithatë ende nuk është kompletuar. Legjislacioni primar i Shërbimit Civil është në përputhje me parimet e BE-së, por mangësitë shfaqen sidomos në rregullimin e procedurave administrative, përgjegjësinë publike, procedurat gjyqësore administrative; si dhe llogaridhënien e institucioneve publike.

Ligjet bazike mbi bazën e të cilave funksionon Administrata Publike janë:

LIGJIT nr. 03/L-149 SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS - Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale, si: administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale. Ky ligj përcakton rregullat për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, rregullat për pranimin në të, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimin në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë;

LIGJI nr. 03/L-147 PËR PAGAT E NËPUNËSVE CIVILË - Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, sipas përkufizimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku mjetet financiare për pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas këtij Ligji, Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë;

LIGJI nr. 03/L-189 PËR ADMINISTRATËN SHTETËRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS - Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore për organizimin, bashkëpunimin dhe menaxhimin e organeve të cilat ushtrojnë kompetenca ekzekutive. Me këtë ligj rregullohet fushëveprimi i organeve të administratës shtetërore. Administrata shtetërore kryen punët e administratës në suaza të të drejtave, përgjegjësisë dhe detyrave të Republikës së Kosovës. Administrata shtetërore funksionin e saj e ushtron dhe punët i kryen në bazë të kushtetutës, ligjit, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme. Punët e administratës shtetërore ngërthejnë zbatimin e drejtpërdrejt të ligjit, nxjerrjen e dispozitave për aplikimin e tyre, ushtrimin e mbikëqyrjes administrative dhe kryerjen e punëve të tjera administrative dhe profesionale.

LIGJI nr. 02/L-28 PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE - Dispozitat e këtij Ligji zbatohen nga të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale dhe kolektive. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen edhe nga personat fizikë dhe juridikë të cilëve me ligj, akt nënligjor ose kontratë u është dhënë e drejta për të ushtruar detyra dhe kompetenca me rëndësi publike. Parimet e përgjithshme të këtij Ligji janë të detyrueshme edhe për veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë në ato raste kur veprimtaria e tyre prek interesat publike. Dispozitat e këtij Ligji nuk zbatohen në format e mëposhtme të veprimtarisë së organeve të administratës publike: akte administrative me karakter rregullativ; akte administrative që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm të organeve të administratës publike; akte administrative që nxirren nga organet e administratës publike në kuadrin e transaksioneve private, në të cilat administrata publike është palë.

Në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është konsoliduar infrastruktura ligjore. Është miratuar Ligji për Organet e Shoqërisë së Informacionit, Korniza e Interoperabilitetit e Republikës së Kosovës, Strategjia për Qeverisjen Elektronike 2009-2015 dhe disa akte nënligjore dhe standarde që rregullojnë politikën në këtë fushë. Gjithashtu, aktet nënligjore që derivojnë nga Ligji për Organet e Shoqërisë së Informacionit janë të miratuara.

Korniza e politikave

Korniza strategjike për reformën e administratës publike është përcaktuar nga Këshillimi Ministror për Reformën e Administratës Publike, duke dhënë udhëzimet e nevojshme për rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse. Në këtë mënyrë, qasja për reformën e administratës publike është përcaktuar përmes Pakos Strategjike të Reformës së Administratës publike e përbërë nga tri dokumente të ndara, të përgatitura dhe menaxhuara nga portofolet kryesorë, më një nivel të koordinimit qendror. Në formësimin e qasjes së re të reformës, janë marrë parasysh çështjet kyçe të përcaktuara në strategjinë e zgjerimit të Komisionit Evropian dhe të paraqitura në hollësi nga OECD/SIGMA përmes Parimeve të Administratës Publike. Konkretisht, administrata publike në Republikën e Kosovës është duke u angazhuar që të funksionoj mbi bazën e parimeve dhe fushave kryesore të OECD/SIGMA, siç janë:

- Korniza strategjike e reformës së administratës publike;
- Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
- Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Llogaridhënia;
- Ofrimi i shërbimeve;
- Menaxhimi i financave publike.

Në përputhshmëri me këto parime, fushat përkatëse janë grupuar në tri "Shtylla të RAP-it", në kuadër të të cilave portfoliove kryesore i është dhënë përgjegjësia për zhvillimin e një ose më shumë dokumenteve strategjike. Tri shtyllat e kornizës strategjike për reformën në administratë publike janë:

- Shtylla e parë - zhvillimi dhe koordinimi i politikave - është nën përgjegjësinë e Zyrës së Kryeministrit
- Shtylla e dytë - shërbimi civil, burimet njerëzore, llogaridhënia dhe ofrimi i shërbimeve - është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Administratës Publike
- Shtylla e tretë - menaxhimi i financave publike - është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave.

Korniza e politikave për shtyllën e parë të reformës së administratës publike përbëhet nga:

Strategjia për përmirësimin dhe koordinimin e politikave 2016-2018 –paraqet orientimin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës si pjesë e shtyllës së dytë të Reformës së Administratës Publike. Dokumenti trajton planifikimin dhe koordinimin e politikave në nivelin qendror të qeverisë, por edhe në nivelin e ministrive të linjës. Si parim strategjia përmes veprimeve konkrete duke filluar nga viti 2015 synon vendosjen e një sistemi të planifikimit të integruar, për tu zbatuar gjatë periudhës së ardhshme tre vjeçare. Qëllimi kryesor i përmirësimit të sistemit të planifikimit në Kosovë është evitimi i fragmentimeve dhe dyfishimeve ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar.

Strategjia për rregullim më të mirë 2014-2020 – fokusohet në krijimin e një sistemi efikas rregullativ që i baraspeshon kostot me përfitimet ekonomike, mjedisore dhe sociale, duke respektuar parimet dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit rregullativ, për të siguruar që i gjithë legjislati e plotëson këtë standard. Strategjia gjithashtu, trajton sfidën kryesore që i jep formën suksesit të reformave rregullative, përmes bërjes më efektive të procedurave administrative për të mbajtur në minimum barrën e nevojshme administrative për qytetarët dhe biznesin. Për më tepër, strategjia synon forcimin e dialogut, përfshirjen e sektorit privat dhe sigurimi i ndikimit maksimal të tij në proces, me qëllim të arritjes së rezultateve. Komunikimi gjithashtu përfshinë aftësi më të mira të kontaktit me qytetarët në përgjithësi si dhe investitorët dhe analistët. Pra, në total strategjia ka tri objektiva kryesore strategjike: sistemin rregullativ lehtësues, zbatimin efikas, si dhe komunikimin efektiv.

Korniza e politikave për shtyllën e dytë të reformës së administratës publike përbëhet nga:

Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 përcakton qëllimet dhe politikat strategjike që Qeveria e Republikës së Kosovës synon ti arrij brenda periudhës së ardhme afatmesme me qëllim të përmirësimit të funksionimit dhe modernizimit të administratës publike, përmbushjes së obligimeve të saj ligjore dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.

Strategjia e trajnimit të nëpunësve civil të Kosovës ka për qëllim që ta përmirësojë kornizën ekzistuese për nëpunësit civilë të përcaktuar me strategjinë e mëparshme të trajnimeve (2011-2013). Strategjia ka në fokus trajnimin e nëpunësve civilë në Kosovë me synim të krijimit të administratës moderne, profesionale dhe kompetente në nivelin qendrorë dhe lokal, administrate e cila ofron shërbime publike cilësore për qytetarët dhe personat juridikë.

Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2016-2020 ka për qëllim rritjen e transparencës, përfshirjen dhe pjesëmarrjen qytetare, ngritjen e efikasitetit dhe eficiencës, shtimin e konkurrencës ekonomike, shtimin e njohurive si dhe harmonizimin e politikave me kornizën e qeverisjes elektronike të definuar në nivel evropian. Konkretisht, një qeverisje e mirë kërkon që informatat të prodhohen dhe të paraqiten në formë të thjeshtë, të qartë dhe të qasshme për qytetarin. Kjo qasje po ashtu nxit dhe inkurajon pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje. Gjithashtu, qeverisja elektronike përmes teknologjisë së komunikimit mundëson përdorimin e informatave të sektorit publik me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, rritjes së llogaridhënies, transparencës si dhe efikasitetit dhe efektivitetit qeverisës.

Korniza e politikave për shtyllën e tretë të reformës së administratës publike përbëhet nga:

Strategjia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015-2019 - Strategjia është një dokument që trajton pesë vitet e ardhshme duke synuar përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke lehtësuar shpenzim më efikas publik, shërbim publik më të mirë, sigurim të transparencës dhe shfrytëzimit adekuat të buxhetit shtetëror të Kosovës, granteve të donatorëve dhe fondeve të huazuara.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike: Reformat në menaxhimin e financave publike bazohen në objektivat e institucioneve për rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të shpenzimeve publike, duke përmirësuar praktikën e menaxhimit të parasë publike në pajtueshmëri me praktikën më të mira dhe standardet ndërkombëtare. Përmirësimi i MFP-së kërkon angazhim të gjitha institucioneve që shfrytëzojnë paratë publike, autoriteteve publike, prandaj sukcesi i ndërmarrjes së këtyre veprimeve për përmirësimin e MFP-së kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të institucioneve.

Korniza institucionale

Kosova ka konsoliduar në mënyrë të konsiderueshme *kornizën institucionale* në fushën e administratës publike:

Ministria për Administratë Publike është përgjegjëse për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të shërbimit civil dhe administratës publike; hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar për shërbimin civil; përcaktimin e normave dhe standardeve për organizimin funksional të institucioneve të administratës publike; propozimin dhe hartimin e politikave dhe strukturën e pagave dhe shpërblimeve në administratën publike; zhvillimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave të trajnimit, arsimimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore në shërbimin civil; krijimin dhe administrimin e sistemit të informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore në administratën publike;

Në kuadër të infrastrukturës teknike, për TIK, *Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)*- MAP ka të ndërtuar tani një infrastrukturë të avancuar për të mundësuar dhënien e shërbimeve elektronike përmes Rrjetit Shtetëror i cili mbulon të gjitha zyrat e administratës qendrore dhe lokale dhe Qendrës së të Dhënave Shtetërore. Kjo infrastrukturë u shërben të gjitha institucioneve të nivelit qendror edhe atij lokal. Arkitektura aktuale e kësaj infrastrukture është një bazë e fuqishme për dhënien e shërbimeve elektronike për qytetarë si dhe për modernizimin e administratës publike. Modernizimi i mëtejshëm i administratës publike kërkon mirëmbajtje dhe investime të vazhdueshme konform rritjes së shërbimeve elektronike, trendëve të zhvillimeve tekniko-teknologjike dhe rritjen e sigurisë.

Megjithatë, standardet minimale për konsultim publik së bashku me platformën “online” për shoqëri civile duhet të finalizohen në mënyrë që të mundësojnë reagimin e hershëm të publikut rreth legjislacionit, politikave dhe strategjive dhe të rrisin transparencën në kuadër të llogaridhënies si parim bazë për administratë publike.

Edhe përkundër arritjeve të mëdha në fushën e reformave të administratës, mbesin sfida të cilat vështirësojnë implementim më efektiv të reformave që ndërlidhen me kompletimin e kornizës ligjore, si dhe me ngritjen e kapaciteteve për monitorim dhe implementim të reformave. Strategjitë e kaluara për reformën e administratës publike nuk i kanë kushtuar vëmendje në masën e duhur shërbimeve publike-administrative. Nuk është bërë një inventarizim i plotë i shërbimeve publike-administrative të cilat ofrohen nga ana e institucioneve publike.

Është hartuar Strategjia për Modernizimit e Administratës Publike 2015-2020, gjithashtu edhe Plani i Veprimit 2015-2017 për zbatimin e kësaj strategjie, të cilat pritet të miratohen gjatë këtij viti. Qasja e re ka ndarë procesin e reformës në tri shtylla sipas përgjegjësive; 1. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe legjislacionit-Zyra e Kryeministrit; 2. Shërbimi Civil, menaxhimi i burimeve njerëzore, ofrimi i shërbimeve publike-administrative dhe llogaridhënia-Ministria e Administratës Publike; 3. Menaxhimi i financave publike-Ministria e Financave.

Vetëqeverisja lokale

Baza kushtetuese e vetëqeverisje lokale jepet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli X përcakton se “Njësia themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale”.

E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet me kushtetutë dhe rregullohet me ligj. Po ashtu, vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje lokale të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkruar. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Masat afatshkurtra

Masat afatshkurtra në fushën e administratës publike

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE, në kuadër të fushëveprimit të Administratës Publike, këto *masa legislative* afatshkurtra do të ndërmerren në mënyrë që të krijohet një shërbim civil apolitik, profesional, i bazuar në merita dhe i menaxhuar mirë:

- Kosova do të finalizoj kornizën ligjore përmes plotësimit dhe ndryshimet të legjislacionit të shërbimit civil. Plotësim-ndryshimet do të behën me qëllim të evitimit pengesave që janë identifikuar gjatë zbatimit të këtyre ligjeve. Konkretisht, ligjet që do të plotësohen dhe ndryshohen gjatë vitit 2016 janë: Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës; Ligji për organizim të administratës publike; Ligji për procedurë të përgjithshme administrative; Ligji për konflikt administrative; dhe hartimi i Ligjit mbi paga në sektorin publik. Gjithashtu do të plotësohen dhe ndryshohen aktet nënligjore ekzistuese dhe hartohen aktet e reja nënligjore që derivojnë nga plotësim-ndryshimet e ligjeve të lartpërmendura.

Katër ligjet bazike parashohin si në vijim:

PROJEKTLIGJI PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT nr. 03/L-149 SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS- Ky ligj ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-149 Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me këtë Projektligj plotësohen dhe ndryshohen zbraçëirat juridike që janë paraqitur pas miratimit të Ligjit për Shërbim Civil. Ky Projektligj është në proces të hartimit me qëllim të organizimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

PROJEKTLIGJI PËR PAGAT QË REALIZOHEN NGA BUXHETI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS- Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e pagës me përbërësit e saj, të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës Kosovës. Dispozitat e këtij ligji vlejné për të gjithë ata që përfitojné pagë nga Buxheti i Kosovës. Parimi bazë i këtij Projektligji është parimi i pagës së barabartë që nënkupton që secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për funksionin apo punën në pozitë të njëjta apo të krahasueshme;

PROJEKTLIGJI PËR ORGANIZIMIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE- Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i standardeve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e brendshëm, bashkëpunimin, menaxhimin dhe llogaridhënien e organeve të cilat ushtrojnë autoritet publike. Sipas këtij Projektligji administrata publike organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: paanshmërisë, depolitizimit dhe në interes të publikut, ligjshmërisë; përgjegjësisë; dekoncentrimit; transparencës dhe qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficientë dhe efektivitetit, subsidiaritetit, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të administratës publike, si dhe barazisë gjinore dhe parimi i një shoqërie multi-etnike të mbrohet dhe të promovohet;

PROJEKTLIGJI PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE- Ky Ligj ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, ose lidh një kontratë administrative, ose zbaton kompetencat e veta përmes akteve reale, që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave. Po ashtu, ky ligj parashihet të jetë në pajtueshmëri të plotë me direktivën 2006/123/ KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm".

Përmes këtyre ligjeve, si ligje horizontale do të kompletohet korniza ligjore për administratën publike. Gjithashtu, do të sigurohet zbatimi i kësaj kornizës ligjore, zbatimi i vlerësimit të performancës, zbatimi i sistemit të klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil, si dhe sistemi i ri i pagave për gjithë të punësuarit në sektorin publik sipas kornizës së re ligjore, ku përveç tjerash, do të zgjidhet çështja e nivelit të pagave e cila do të ishte sipas parimit pagë e njëjtë për punën e njëjtë. Sa i përket procesit të klasifikimit të vendeve të punës, kjo do të ndihmojë në përfshirjen e të gjitha institucioneve kyçe në fushëveprimin horizontal të Shërbimit Civil, duke përfshirë edhe qeverisjen lokale.

Po ashtu, në proces të miratimit në Qeveri është edhe Strategjia për trajnimin e nëpunësve civilë, e cila do të përcjellët nga Plani i veprimit të kësaj Strategjie, ku parashihen format dhe trajnime më të avancuara për nëpunësit civilë.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit, do të plotësohet korniza ligjore dhe do të hartohen dhe implementohen standardet në fushën e e-Qeverisjes duke u bazuar në standardet e Bashkimit Evropian të fushës së TI-së.

Masat zbatuese

Në drejtim të **avancimit të politikave** me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE, këto masa afatshkurtra do të ndërmerren:

- Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në praktika dhe analiza për mënyrën e qasjes së re në Reformat e Administratës. Siç përmendet dhe më lartë, është vlerësuar se menaxhimi më efikas i procesit dhe përpjekja për evitim të barrierave në organizimin dhe zbatimin e reformës si dhe nevoja për përqendrim në rezultate ka kushtëzuar qasjen për ndarjen e fushëveprimit dhe strukturave menaxhuese të saj në tri shtylla të Reformës së Administratës Publike më racionale dhe të cilat do të praktikohen që në 2016:
 - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe legjislacionit – menaxhimi i reformave në këtë fushë bie drejtpërdrejtë nën përgjegjësinë e Zyrës së Kryeministrit;
 - Shërbimi civil, menaxhimi burimeve njerëzore, ofrimi i shërbimeve publike administrative dhe ri-organizimi dhe llogaridhënia bie nën përgjegjësinë e MAP;
 - Menaxhimi i Financave Publike – bie nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave.

Sa i përket **kornizës institucionale**, kjo fushë është e rregulluar me Ligji nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Në këtë aspekt, Ministria e Administratës Publike (MAP) ka nxjerrë Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, ku ka pasur disa ndryshime në aspektin organizativ. Ndërsa, për të zhvilluar tutje **kornizën institucionale** do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Gjatë 2016 pritet themelimi i tri divizioneve të reja në MAP, siç janë: Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil (DASHC); Divizioni për Mbikëqyrjen e Proceseve Administrative në kuadër të Departamentit Ligjor (DL) dhe Divizioni i Prokurimit në kuadër të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI);
- Do të zhvillohet platforma e Interoperabilitetit/ndërveprimit të sistemeve elektronike të institucioneve të Kosovës, me të cilën synohet integrimi dhe shkëmbimi i të dhënave të sistemeve të ndryshme elektronike në mënyrë automatike;
- Gjithashtu, do të bëhet avancimi i portalit shtetëror në "e-Kosova", integrimi i qasjes në shërbimet elektronike përmes këtij portali si dhe ngritja e nivelit të sigurisë në TI në përgjithësi.

Në kuadër të **zbatimit në praktikë**, në këtë fushë gjatë vitit 2016 MAP dhe institucionet tjera përgjegjëse do të fokusohen në:

- Duke ditur që KPMSHCK është një nga institucionet kyçe të pavarura që ndërlidhet me administratë publike, e rëndësishme së lartë është që të sigurohet respektimi i vendimeve që lëshohen nga ky institucion që luan rol qendror sa i përket funksionimit të një administrate të përgjegjshme. Po ashtu, institucioni tjetër i pavarur që ndërlidhet me këtë fushë, gjegjësisht Avokati i Popullit do të jetë i zhvendosur në ndërtesën e Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me vendim të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike.
- MAP do të bëjë zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike e cilat përqendrohet në thjeshtëzimin dhe modernizimin e procedurave përmes zhvillimit të analizave të mirëfillta, të cilat mundësojnë një qasje strategjike, duke i ndërlidhur ato me shërbime administrative të cilat kanë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit; si dhe,
- Zbatimi i strategjive të reja, gjegjësisht Strategjia për Modernizimin e Administratës; Strategjia për Trajnimin e Nëpunësve Civilë; Strategjia për e-Qeverisje; do të mundësojë ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e politikave në fushën e administratës publike. Normalisht, zbatimi i mirëfilltë i legjislacionit në fushën e administratës publike do të kontribuojë në ofrimin e shërbimeve më të mira, si dhe avancimin e politikave në këtë fushë.

Masat afatshkurtra në fushën e vetëqeverisjes lokale

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA si dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të nevojshme për aderim në BE, në kuadër të *vetëqeverisjes lokale*, gjatë periudhës afatshkurtër fokusi kryesor do të jetë në *Masat zbatuese* si vijon:

- Në kuadër të *avancimit të politikave* apo forcimit të kapacitetit të administratës në nivel lokal dhe me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE, do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:
 - Miratimi i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të *zbatimit në praktikë* në këtë fushë, gjatë vitit 2016 MAPL dhe institucionet tjera përgjegjëse do të fokusohen në:

- Vazhdimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë së organeve të komunave përmes raporteve të monitorimit dhe vlerësimeve të akteve nënligjore të komunave nga organet mbikëqyrëse;
- Sigurim të përmirësimit të veprimit të organeve lokale për përmbushjen e mandatit të tyre ligjor përmes raporteve të auditorit të përgjithshëm dhe raportit mbi zbatimin e projekteve kapitale për Kuvendet e Komunave;
- Ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve;
- Ngritje të transparencës së punës dhe vendimmarrjes në nivel lokal përmes qasjes së qytetarëve në punën e Kuvendeve të Komunave dhe fushatave vetëdijësuese për mundësitë e qytetarëve për tu informuar mbi shërbimet publike;
- Realizimin e programeve të bashkëpunimit ndër-kufitar me vendet fqinje, si dhe mundësitë e kyçjes në programet trans-nacionale.

Prioritetet afatmesme

Prioritetet afatmesme në fushën e administratës publike

Për të realizuar misionin e saj, Ministria e Administratës Publike në periudhën afatmesme planifikon të krijoj një shërbim civil apolitik, profesional, të bazuar në merita dhe të menaxhuar mire. Kjo është planifikuar të arrihet përmes ri-organizimit të ministrive dhe organeve vartëse të tyre, finalizimit të procesit të klasifikimit të vendeve të punës, zbatimi të sistemit të ri të pagave dhe gradimeve si dhe zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Modernizim të Administratës Publike 2015-2017, duke siguruar gjithashtu burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, sidomos për Departamentin që menaxhon RAP-in. Po ashtu, MAP do të përmirësojë sistemin për menaxhim të burimeve njerëzore duke ndërlidhur atë me sistemin e pagave, pasi që të aprovohet dhe finalizohet procesi i klasifikimit të vendeve të punës, si dhe pas vitit 2016 pritet të bëhet gjithashtu ndërlidhja me Trustin Pensional.

Gjithashtu, Kosova do të rris përqindjen e grupeve jo-shumicë të nëpunësve civil në administratë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, pra 10% në nivel qendror (nga 8.75% sa është tani) dhe në proporcion të drejtë me popullsinë në kuadër të komunës relevante të nivelit lokal. Po ashtu do të sigurohet zbatimi i plotë i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Modernizim të Administratës Publike 2015-2020.

Kompletimi i kornizës ligjore dhe operative të RAP-it dhe finalizimit i reformave të kostimit do të formojnë bazën për përcaktimin e fushëveprimit të përgjithshëm dhe financiar të përkrahje buxhetore sektoriale. Kosova do të përqendrohet në fushën e RAP-it me program të vetëm për Përkrahje Buxhetore Sektoriale. Po ashtu, përmes IPA 2014 do të ketë përkrahje financiare nga Komisioni Evropian për zbatimin e Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative pasi që të miratohet. Gjithashtu, Qeveria o të sigurojë fonde të mjaftueshme për zbatimin e procesit të klasifikimit të vendeve të punës dhe në përgjithësi përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në periudhën afatmesme planifikohet të behet avancimin i qeverisjes elektronike me qëllim të rritjes së efektivitetit të shërbimeve dhe transparencës ndaj publikut. Po ashtu do të sigurohet zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të e-Qeverisjes 2016-2020. ASHI/MAP-i ka për qëllim modernizimin dhe ngritjen e cilësisë për ofrimin e shërbimeve elektronike e cila do të ndikojë në ngritjen e transparencës.

1.1.4. Avokati i Popullit⁴

Ky kapitull mbulon fushëveprimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), si institucion i pavarur kushtetues që monitoron, mbron dhe promovon të drejtat dhe liritë e njeriut. Në të përfshihen kriteret e dala në kuadër të procesit integruar të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, *Gjendja aktuale* e përmbushjes së mandatit dhe sfidave me të cilat përballët ky institucion dhe planet dhe prioritetet për të ardhmen.

Kërkesat e MSA-së

Duke qenë se Bashkimi Evropian i kushton rëndësi të veçantë të drejtave të njeriut, në mënyrë që të garantohet respektimi i tyre, ka imponuar disa parakushte, e një nga ato është janë edhe kriteret politike të Kopenhagës, të cilat ndër të tjera kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, ku hynë edhe Institucioni i Avokatit të Popullit.

Në këtë kuadër në Nenin 4 të MSA përcaktohet që “Kosova të angazhohet të respektojë të drejtën dhe instrumentet ndërkombëtare, por jo vetëm ato që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore, por edhe mbrojtjen e personave që u përkasin minoriteteve dhe luftimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze”. Në këtë nen nuk përmendet shprehimisht IAP, por tërthorazi është e vetëkuptueshme që nuk mund të garantohet pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare dhe instrumentet për të drejtat e njeriut, pa pasur mekanizma të pavarur efektiv për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave dhe të kërkojnë llogaridhënie nga autoritetet publike. Ndërsa në nenin 120 të MSA përveç që kërkohet administrate publike profesionale, efçente dhe llogaridhënëse, aty shprehimisht thuhet “Bashkëpunimi do të përfshij gjithashtu përmirësimin e efikasitetit dhe kapacitetit të organeve të pavarura që shërbejnë për funksionimin e administratës publike dhe për një sistem efikas të kontrolleve dhe balancave.”

Kërkesat e tjera të aderimit në BE

Kërkesat e dala nga Studimi i Fizibilitetit

Kushtet e funksionimit dhe sfidat e IAP janë adresuar edhe si kriteret afatshkurta të Studimit të Fizibilitetit, në të cilën është kërkuar që të alokohen zyra për IAP dhe të sigurohet pavarësia financiare përmes obligimit të qeverisë që propozimin për buxhet të IAP ta përfshijë në buxhetin e përgjithshëm dhe ta dërgojë në parlament pa ndryshime.

Kërkesat e dala nga DPSA

Në konkluzionet e dala nga takimi i DPSA-së kërkohet sigurimi i zyrave për IAP, duke përfshirë edhe zyrën qendrore në Prishtinë dhe ato rajonale si dhe fuqizimi i zbatimit dhe monitorimit të rekomandimeve të IAP. Të njëjtat kriteret janë përsëritur edhe në raportet e fundit të progresit.

Kërkesat e dala nga GVRAP Qershor 2015

Ndërsa në konkluzionet e GV RAP është rekomanduar që të përmirësohet dukshmëria dhe që Qeveria e RKS të angazhohet që të përfshihet në mënyrë konstruktive sa i përket zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit e po ashtu të garantojë bazën ligjore për pagat e IAP në përputhje me praktikën evropiane, duke përfshirë po ashtu periudhën deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat. Pavarësia financiare e Avokatit të Popullit do të jetë e garantuar në të ardhmen.

Përfundimisht, Republika e Kosovës duhet në përgjithësi të përmirësojë kushtet për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, si në aspektin e kompletimit të kornizës ligjore, garantimin e qëndrueshëm të pavarësisë financiare dhe funksionale, zhvendosjen e zyrave të institucionit në objekt publik, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, e deri te adresimi dhe përcjellja adekuate e zbatimit të rekomandimeve që u drejtohen autoriteteve publike në Republikën e Kosovës.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

⁴ Ky kapitull lidhet me kapitullin 3.24. Kapitulli 23 i *acquis*-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore (matrica e masave afatshkurtra).

Në vijim është listuar korniza kryesore ligjore e cila rregullon fushë-veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Avokatin e Popullit
- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Ligji për Barazi Gjinore
- Ligji për Qasjen në Dokumente Publike.

Me pakon ligjore për të drejtat e njeriut, e cila është përbërë nga Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Barazi Gjinore, e miratuar në korrik 2015, Institucionit të Avokatit të Popullit i janë bartur edhe disa përgjegjësi të reja (Për më shumë, shih 3.24: Kapitulli 23).

Me qëllim që IAP të jetë në harmoni të plotë me Parimet e Parisit për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, që janë kriteret minimale ndërkombëtare që duhet të plotësoj çdo institucion kombëtar për të drejtat e njeriut në një vend në mënyrë që të mund të konsiderohet kredibil dhe i denjë që të kryej mandatin e tij, Ligji i ri për Avokatin e Popullit është përpjekur që ta fuqizojë edhe me tutje rolin e këtij institucioni, duke shtuar dispozita që garantojnë pavarësi organizative, administrative dhe financiare. Për më tepër, me këtë ligj është shtrirë imuniteti funksional jo vetëm për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij, por për të gjithë stafin, pastaj Qeveria dhe komunat janë obliguar që të sigurojnë hapësira apo zyra të përshtatshme për punë në pronësi publike në mënyrë që të mundësohet kryerja efektive e funksioneve dhe përgjegjësi të IAP e gjithashtu është garantuar edhe pavarësia financiare. Sipas nenit 35 të këtij ligji përcaktohet:

- *“Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon atë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës, **cili nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm. Buxheti mund të shkurtohet vetëm me miratimin e Avokatit të Popullit.**”*
- *Në rast të shtimit të obligimeve dhe kompetencave të Institucionit të Avokatit të Popullit me këtë ligj dhe ligje të tjera, kjo përcillet edhe **me burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.***
- *Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij”.*

Megjithatë, në këtë ligj është bërë një lëshim që duhet të adresohet sa më shpejtë nga Qeveria e Kosovës. Neni 37 lidhur me pagat i ligjit, thotë: *“Pagat në Institucionin e Avokatit të Popullit rregullohen sipas ligjit përkatës për Pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës”,* mirëpo një ligj i tillë për pagat nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe nuk ekziston, prandaj çështja e pagave të stafit në IAP ka mbetur pa bazë të ligjshme ligjore.

Sa i përket transpozimit të *acquis* në legjislacionin kombëtar të kësaj fushe, deri më tani është arritur transpozim i *konsiderueshëm* (i pjesshëm), më konkretisht Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore (Për më shumë, shih 1.2.).

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka vazhduar të punojë në përmbushjen e misionit kushtetues që të jetë mbrojtës i të drejtave të qytetarëve të Kosovës vis-à-vis veprimeve të autoriteteve publike. Aktualisht, IAP veprimtarinë e vet e zhvillon në Zyrën Qendrore në Prishtinë dhe në zyrat rajonale në: Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë dhe në Mitrovicë, në jug e në veri.

Sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit është evidentuar rritje progresive nga viti në vit i numrit të pranuar të rasteve, gjë e cila dëshmon besimin që qytetarët kanë në këtë institucion. Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Administratës Publike (MAP) ka marrë vendimin me numër 102/2012, për kalimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) në ndërtesën të cilën aktualisht e ka në shfrytëzim Gjykata Kushtetuese, pasi kjo e fundit të transferohet në Pallatin e Drejtësisë dhe është në pritje të zbatimit të këtij vendimi. Në përgjithësi, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka vazhduar gradualisht të përmirësojë punën e tij në të gjithë Kosovën.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA si dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të nevojshme për aderim në BE, në kuadër të fushëveprimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, këto *masa legislative* afatshkurtra do të ndërmerren:

- Në vitin 2016 do të hartohen vetëm aktet nënligjore dhe rregulloret që derivojnë nga pako e ligjeve për të drejtat e njeriut në mënyrë që të arrihet zbatim efektiv i tyre, përkatësisht:
 - Rregullorja e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit,
 - Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative
 - Aktet nënligjore për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi
 - Aktet nënligjore për Ligjin për Barazi Gjinore

Masat zbatuese

Në drejtim të *avancimit të politikave* me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE, këto masa afatshkurtra do të ndërmerren:

IAP do të marrë masa për profilizimin e stafit dhe do të krijoj një plan të trajnimeve sidomos për stafin që merret me trajtimin e ankesave, sidomos sa i përket trajtimit të rasteve të diskriminimit dhe barazisë gjinore.

Gjatë vitit 2016 planifikohet të bëhet edhe një strategji për komunikim me publikun dhe promovim dhe të ndërmerren edhe disa fushata vetëdijësuese kundër diskriminimit në të gjitha format e tij, e po ashtu të organizohen disa seminare/tryeza të rrumbullakëta me shoqëri civile dhe media në të njëjtin aspekt me qëllim që të promovohen mandatet e reja që i janë dhënë me ligj IAP-së.

Sa i përket *kornizës institucionale*, në mënyrë që Institucioni i Avokatit të Popullit të arrijë të realizoj mandatet që dalin nga ligjet e reja, prioritet afatshkurtër do të jetë një ristrukturim i departamenteve që ekzistojnë në institucion dhe fuqizimi i tyre me kapacitete shtesë(burime njerëzore).

Në kuadër të *zbatimit në praktikë*, në këtë fushë gjatë vitit 2016 IAP dhe autoritetet e Kosovës, si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal, do të fokusohen si vijon:

- Sigurohen që rekomandimet dhe pyetjet e Avokatit të Popullit të përcillen në mënyrë adekuate, gjë që do të ndikojë në avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.
- Synohet edhe rritje sistematike e numrit të ankesave të pranuar në IAP, që do të jetë indikator i fuqishëm i besimit të qytetarëve në këtë institucion dhe ngritje e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre.
- Pritet të bëhet sigurimi i hapësirave të punës per IAP nga komunat/MAP.

Prioritetet afatmesme

Në bazë të mandatit dhe misionit të IAP-së, synimi dhe objektivi themelor i punës së IAP-it është që të arrijë hetimin e rasteve, sipas parashtrësive të qytetarëve, me qëllim që mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të realizohet me përgjegjësi, shpejtësinë e duhur dhe profesionalizëm. Në këtë drejtim, IAP në këtë periudhë do të rris edhe më tutje përqindjen dhe numrin e rasteve të shqyrtuara dhe hetuara dhe të rasteve të zgjidhura pozitivisht Po ashtu, IAP do të rris efikasitetin dhe numrin e trajtimit të rasteve *ex officio* dhe të analizave të ndryshme ligjore për shumëfish. Kjo e fundit do të arrihet përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale të bashkëpunëtorëve në IAP-it në fusha të caktuara, që do të përcillet me rritjen kualitative të trajtimit të rasteve, që vazhdimisht përcillet me një rritje kuantitative midis 10-15% për çdo vit; IAP do t'i kushtojë gjithashtu rëndësi anëtarësimit në rrjete të ndryshme ndërkombëtare, të cilat mundësojnë shkëmbimin e informatave rreth zhvillimeve më të reja në fushën e të drejtave të njeriut dhe përvojave të institucioneve të tjera simotra, në mënyrë që të njëjtat t'i zbatojë në Kosovë.

1.1.5. Politikat kundër korrupsionit

Politikat kundër korrupsionit mbulohen në kuadër të bllokut 3: 3.24. *Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.*

1.1.6. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë⁵

Ky Kapitull mbulon mbikëqyrjen demokratike civile ndaj institucioneve të sigurisë, i cili i referohet ushtrimit të kontrollit civil përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht përmes Komisioneve përkatëse parlamentare (Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcave të Sigurisë në Kosovë, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë), Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kërkesat që dalin Kriteret afatmesme të Studimit të Fizibilitetit, Raportit të Progresit, dhe mekanizmeve tjerë, Kosova vazhdon të jetë e fokusuar në forcimin e mbikëqyrjes civile demokratike të sektorit të sigurisë. Të theksohet se dispozitat e MSA-së nuk parashohin obligime në këtë fushë.

Kërkesat e dala nga Raporti i KE-së për Kosovën

Çështja e verifikimit të anëtarëve të Komisionit parlamentar për mbikëqyrje të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), e konstatuar nga Raporti i Progresit si verifikim joprofesional dhe partizan të sigurisë dhe se Kuvendi duhet të rrisë kapacitetin e saj dhe përmirësoj ekspertizën e saj për të mbikëqyrur këtë zonë, mbetet obligim i Kosovës që përmes plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimit të Sigurisë të themelohet Agjencinë për sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, si autoritet i sigurisë Kombëtare, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat e tjerë të Republikës së Kosovës, t' i involvon në procesin e vendimmarrjes së verifikimit të sigurisë dhe njëherit me arritjen e standardeve minimale të sigurisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara që janë në administrim të institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës. Komisioni përkatës parlamentar për Sigurinë do të jetë mekanizëm mbikëqyrës si kësaj agjencie dhe të njëjtit nuk do t' i nënshtrohen verifikimit të sigurisë.

Kërkesat e dala nga Studimi i Fizibilitetit

Në kuadër të kërkesave që dalin nga SF, Kuvendi i Kosovës duhet që të intensifikojë takimet dhe të forcojë mbikëqyrjen civile demokratike ndaj institucioneve të sigurisë. Në këtë aspekt Kuvendi i Kosovës, përmes Komisionit funksional parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës për çështje të sigurisë vazhdon të ndërmerr veprimet e duhura duke përfshirë seanca dëgjimore para komisionit, dëgjime publike, pyetje parlamentare, mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, kërkesa për raportime të ndryshme për çështje specifike dhe mbikëqyrje të shpenzimeve buxhetore. Komisioni përgatit raportin e monitorimit për zbatimin e Ligjit për Policinë e Kosovës dhe mbi shpenzimet nga ana e Policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë ka intensifikuar thirrjet në seanca dëgjimore dhe raportime të rregullta të Drejtorit të Agjencisë dhe Inspektorit të Përgjithshëm të AKI-së.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Për sa i përket mbikëqyrjes demokratike civile, Republika e Kosovës këtë segment e ka të mbuluar me **kornizën ligjore** si në vijim:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - Neni 65, paragrafi 12 - parashih mbikëqyrjen e politikës së jashtme dhe të sigurisë nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Ligji nr. 04/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me të cilin themelohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi të, mbi parimet e përgjithshme ku Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, siç është përcaktuar me Kushtetutë.

⁵ Ky kapitull lidhet me kapitullin 3.32. Kapitulli 31 i *acquis*-së: Politika e jashtme, e mbrojtjes dhe e sigurisë.

Ligji 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë – me të cilin themelohet një sistem unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informacioneve që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës si dhe për verifikimin e sigurisë së personave që kanë qasje në këto informacione.

Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë – me të cilin themelohet Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe përcaktohet funksionimi, kompetencat dhe fushë-veprimtaria e saj. Me dispozitat e këtij Ligji përcaktohet edhe roli i Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen e kësaj Agjencie, përmes Komisionit përkatës parlamentar.

Korniza e politikave

Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë – e miratuar në vitin 2014, ka përcaktuar objektivat strategjike të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, si në vijim: Pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial; rendi kushtetues; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës; dhe stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare përcaktojnë bazat për misionin dhe detyrat aktuale dhe të ardhshme të institucioneve në përgjithësi, dhe institucioneve të sigurisë në veçanti.

Në kuadër të interesave dhe sigurisë kombëtare nga Analiza e RSSS-së fushëveprimtaria e kësaj strategjie ndëlidhet me integrimin e RKS në BE apo NATO, pra Stabilitetin rajonal dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Korniza institucionale

Zinxhiri i kontrollit demokratik civil fillon nga Kuvendi (përmes komisioneve relevante parlamentare), Presidenti i Kosovës, si Komandant Suprem i FSK-së, Kryeministri dhe Ministri, kompetencat e të cilëve ushtrohen në thirrjen për raportim, emërimin, gradimin dhe mbikëqyrjen e financave. Funksionimi i Komisioneve parlamentare, përgjigja e eprorëve të forcave të sigurisë ndaj kërkesave për raportime në këto komisione, konstaton se aktualisht ekziston një frymë demokratike dhe mirëfilli e ndërtuar mbi bazën e përgjegjësisë.

Korniza institucionale për fushën e mbikëqyrjes demokratike civile të forcave të sigurisë përbëhet nga:

Presidenti i Republikës së Kosovës – në bazë të nenit 84, paragrafi 12 të Kushtetutës së Kosovës, është Komandant Suprem i FSK-së. Neni 131, paragrafi 7 parasheh se Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme. Mbi këtë bazë dhe mbi bazën e nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Presidenti ka pushtet të autorizoj dërgimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në veprime gjatë gjendjes emergjente ose gjatë veprimeve në mbështetje të paqes jashtë vendit, pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Presidenti ka kompetencë që: a) të emërojë Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës pas rekomandimit nga Qeveria; b) t'i miratoj të gjitha promovimet në gradën e Gjeneralit mbi rekomandimin e përbashkët të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës; c) t'i miratoj të gjitha ndryshimet e emërimit të Gjeneralëve sipas rekomandimit të përbashkët të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës; d) të ndajë dekorata, medalje, çmime dhe shpërblime.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (Komisioni për Mbikëqyrje) - Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetenca për të: a) ushtuar kontroll demokratik parlamentar mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës; b) mbikëqyrur dhe hetuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, financimin, personelin, pajisjet dhe dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës; c) përcaktuar me ligj të gjitha çështjet e ndërlidhura me organizimin, financimin, personelin, pajisjet dhe dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës; d) miratuar buxhetin vjetor dhe planin dhjetë vjeçar rotativ për Forcën e Sigurisë së Kosovës; e) miratuar dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë periudhave të jashtëzakonshme apo në operacione në mbështetje të paqes jashtë vendit. Kuvendi i Republikës së Kosovës themelon një Komision Parlamentar, i cili ka kompetencë që:

a) t'i kërkojë Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës të dorëzojë një raport vjetor dhe t'u përgjigjet pyetjeve personalisht, sipas nevojës. Raporti i dërgohet Presidentit dhe Kryeministrit; b) të kërkojë praninë e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në takimet e tyre dhe t'u përgjigjet pyetjeve; c) të shqyrtojë buxhetin e Forcës së Sigurisë së Kosovës para dorëzimit të tij për miratim në Kuvendin e Kosovës; d) të shqyrtojë të gjitha projektet për pajisje që janë të vlerës më shumë se një milion Euro, si të atyre që financohen nga Qeveria e Kosovës ashtu edhe të atyre që financohen nga donatorët, para dorëzimit të tyre për miratim në Kuvendin e Kosovës; e) t'i vë në dispozicion të Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake të gjitha informatat e nevojshme për t'i identifikuar të gjitha burimet e fondeve dhe pajisjeve që i janë dhënë Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryeministri - Në pajtim me Ligjin Nr 04/L-045 Kryeministri ka kompetencë që në mënyrë efektive ta mbikëqyrë dhe të ushtroj kontroll mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, përmes Ministrit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në zbatim të autoritetit nga Kuvendi i Kosovës, Kryeministri ka kompetencë që: a) të autorizoj Ministrin për Forcën e Sigurisë së Kosovës që të urdhërojë angazhimin dhe dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës; b) të angazhoj Forcën e Sigurisë së Kosovës për t'i ndihmuar autoritetet civile në përgjigje të fatkeqësive apo aksidenteve natyrore dhe fatkeqësive apo aksidenteve tjera; c) të përcaktoj dhe të modifikoj strukturën e Forcës së Sigurisë së Kosovës sipas nevojës, në konsultim me Presidentin dhe t'i nënshtrohet konfirmimit nga ana e Kuvendit, d) të përcaktoj minimumin e përfaqësimit të të gjitha komuniteteve brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.

Ministria e Forcës së Sigurisë/Ministri - Në pajtim me Ligjin për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka kompetencë për të ushtruar kontroll dhe administrim të përgjithshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfshirë edhe çfarëdo kompetenca, të cilat me ligj i janë caktuar Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës; Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës vepron si përfaqësues ndërkombëtar i Kosovës në çështjet lidhur me forcën e sigurisë së Kosovës në nivelin ministror, por ai mundet ta delegojë këtë funksion për aktivitete të caktuara. Ndërsa Ligji nr. 04/L-46 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përcakton kompetencat e Ministrit të FSK-së në mënyrë të detajuar, ku ndër të tjerash, kontrolli dhe administrimi i Ministrit përfshinë të gjitha fuqitë që bien mbi Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Këshilli i Sigurisë Kombëtare është një institucion tjetër mbikëqyrës i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili, sipas Ligjit nr. 04/L-45 merr në shqyrtim dhe këshillon në lidhje me të gjitha çështjet e ndërlidhura me sigurinë e Republikës së Kosovës, përfshirë përdorimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA si dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të nevojshme për aderim në BE, në kuadër të fushë-veprimit të mbikëqyrjes civile demokratike, si dhe përkitazi me obligimet që dalin nga Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (2014), për vitin 2016 parashihen këto **masa legislative**:

- Amandamenti i Kushtetutës së RK për misionin e ri të FSK-së dhe kalimin në Forca të Armatosura të Kosovës;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës - qëllimi i të cilit është përcaktimi i misionit të ri të Forcave të Armatosura të Kosovës, në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës, ristrukturimi i saj si dhe roli dhe kompetencat e zingjirit të kontrollit civil demokratik të këtyre forcave;
- Ligji për Komisionerin për Forcat e Armatosura dhe policinë e Kosovës;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.

Masat zbatuese

Në drejtim të **avancimit të politikave** me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE, këto masa afatshkurtra do të ndërmerren:

- Miratimi nga Kuvendi për Komisionerin;
- Themelimi i Agjencisë për Mbrojtjen e Informacioneve të Klasifikuara;

- Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë;
- Miratimi i Strategjisë së Mbrojtjes (që është derivat i Strategjisë së Sigurisë).

Në kuadër të *kornizës institucionale*, si masë afatshkurtër parashihet ristrukturimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes, ristrukturimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në përputhje me parimet e mbikëqyrjes civile demokratike, si dhe themelimi i institucionit të Komisionerit Parlamentar të Forcave të Armatosura dhe Policisë së Kosovës.

Sa i përket *zbatimit në praktikë*, gjatë vitit 2016 do të vazhdohet me raportimin e rregullt të institucioneve të Sigurisë pranë Komisioneve Funksionale Parlamentare, si dhe të vazhdohet me zbatimin e formave dhe mekanizmeve të mbikëqyrjes civile demokratike nga Komisionet funksionale parlamentare, përmes seancave dëgjimore, pyetjeve parlamentare, dëgjimeve publike, raportimeve për çështjet specifike.

Prioritetet afatmesme

Nuk është paraparë ndonjë prioritet.

1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Të drejtat e njeriut mbulohen në kuadër të bllokut 3: 3.24. *Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.*

1.3. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare⁶

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të promovojë fqinjësi të mirë dhe konstruktive me të gjitha shtetet e rajonit. Në përmbushje të politikës rajonale, Kosova mbetet e angazhuar në mënyrë konstruktive dhe pragmatike për të rritur bashkëpunimin rajonal efektiv. Qëllim kryesor mbetet forcimi i marrëdhënieve me fqinjët e parë, ngritja e nivelit aktual të shkëmbimeve të gjithanshme, avancimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Kosova vazhdon të mbështes dialogun e të gjitha niveleve, sigurinë rajonale, bashkëpunimin ekonomik, thellimin e shkëmbimeve tregtare, mbrojtjes dhe promovimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Kosova mbetet e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vazhdimin e dialogut, ku synohet të finalizohet me njohje reciproke, gjë që do të mundësonte ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes të dyja vendeve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe të mira fqinjësore në frymën evropiane.

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare mbetet një ndër prioritetet parësore të Qeverisë së Kosovës, si dhe vazhdojnë përpjekjet për t'u bërë anëtare e plotë e OKB-së, agjencive të saja të specializuara dhe të rrisë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e saj në mekanizmat multilaterale. Diplomacia multilaterale e Kosovës vazhdon të jetë në shërbim të avancimit të interesave shtetërore të Kosovës, zhvillimit demokratik dhe ekonomik të vendit, si dhe marrjes së përgjegjësi ndërkombëtare.

Republika e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në organizatën Rajonale në Evropën Juglindore - Regional Cooperation Council (RCC) - merr pjesë në takimet vjetore, takimet e bordit, të Koordinatorëve Nacional dhe në takimet sektoriale të RCC.

Sipas kërkesave në kuadër të anëtarësimit në BE që dalin nga MSA, Kriteret afatmesme të Studimit të Fizibilitetit, DPSA-së dhe mekanizmeve tjerë të këtij procesi në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe obligimeve ndërkombëtare Kosova vazhdon të zhvillojë bashkëpunim rajonal në respektimin e drejtave të njeriut, veçanërisht të minoriteteve, në nxitjen e bashkëpunimit rajonal lidhur me lëvizjen e personave, mallrave dhe shërbimeve, si dhe kapitalit. Rrjedhimisht, Kosova zhvillon dialog politik me qëllim të konsolidimit të përafrimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës në avancimin e formave të reja të

⁶ Ky kapitull lidhet me kapitullin 3.32. *Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e mbrojtjes dhe e sigurisë.*

bashkëpunimit, në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe promovon në mënyrë aktive bashkëpunimin rajonal.

Është thelbësore që Kosova vazhdon zbatimin në mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani në mes të Beogradit dhe Prishtinës, dhe angazhohet në mënyrë konstruktive në gamën e plotë të çështjeve me lehtësimin e BE-së, përfshirë Traktatin e Komunitetit të Transportit, bashkëpunimin gjyqësor, dhe marrëveshjet për punësim dhe politikat sociale në kuadër të EJL, punësimin dhe Rrjetin e Politikave Sociale dhe Rrjetit shëndetësor të EJL. Andaj duhet gjithashtu të sigurohet pjesëmarrja e plotë e Kosovës në Dekadën Rome.

Sipas Konkluzioneve të Këshillit, prill 1997, bashkëpunimi rajonal është një nga kushtet kryesore për të lidhur marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Gjithashtu, për të përmbushur detyrimet e dala nga SF dhe DPSA, Kosova vazhdon të sigurojë bashkëpunimin aktiv dhe konstruktiv me të gjithë partnerët rajonal. Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë konstruktive sa i përket dialogut me Republikën e Serbisë dhe në të njëjtën kohë ka intensifikuar përpjekjet për thellimin e raporteve të mira me vendet fqinje. Gjithashtu mbetet prioritet anëtarësimi dhe pjesëmarrja proaktive në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Baza ligjore për rregullimin e fushës për marrëveshjet ndërkombëtare përbëhet nga:

Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare. Me këtë ligj përcakton procedurën e lidhjes, nënshkrimit, ratifikimit, rezervave dhe deklaratave, ndryshimit dhe plotësimit, tërheqjes nga marrëveshja, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, si dhe është në pajtim me rregullat dhe parimet e pranuar universale të së drejtës ndërkombëtare, që rregullojnë lidhjen dhe ekzekutimin e traktateve ndërkombëtare, të kodifikuara në Konventën e Vjenës të 23 majit 1969 për të Drejtën e Traktateve, dhe Konventën e Vjenës të 21 marsit 1986 për të Drejtën e Traktateve ndërmjet Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose ndërmjet Organizatave Ndërkombëtare.

Ligji nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë si dhe Protokolleve zbatuese të Marrëveshjes bazë për normalizimin e marrëdhënieve. Me këtë ligj ratifikohet Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafruar më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 prill 2013, Vendimi nr. 01/126, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22 prill 2013, Rezoluta nr. 04-R-10, si dhe fushëveprimi i këtij ligji është Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe kjo Marrëveshje është pjesë përbërëse e këtij ligji. Ky ligj do të zbatohet nga Republika e Kosovës, me ndihmën e Bashkimit Evropian, (BE), Forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në Kosovë, (KFOR), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Ndërsa, baza ligjore për rregullimin e fushës për personat e zhdukur të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me:

Ligjin nr. 04/L-023 për persona të zhdukur, ligj I cili për qëllim ka të mbroj të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, po ashtu përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.

Korniza institucionale

Korniza institucionale për fushën e bashkëpunimit rajonal dhe obligimet nderkombëtare përbëhet nga institucionet në vijim:

Ministria e Punëve të Jashtme, përkatësisht *Departamenti për Marrëdhënie Rajonale* identifikon dhe përcakton një arkiv të komunikimit zyrtar, dhe të të dhënave lidhur me marrëveshjet dypalëshe me vendet e rajonit sikurse marrëdhëniet shumëpalëshe që lidhen me iniciativat dhe organizatat rajonale, si dhe përcjellë anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale;

Ministri për Dialog (pa portofol) - Në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria për Dialog në kuadër të fushë veprimtarisë ka detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen me realizimin e Dialogut të Brukselit për fqinjësi të mirë dhe normalizimin marrëdhëniesh ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e SHBA-ve. Në këtë kuadër detyrat dhe përgjegjësitë e saja janë: hartimi i dokumenteve programore dhe strategjike për dialogun e Brukselit, negociimi i marrëveshjeve në dialogun teknik të Brukselit, përgatitja e dokumenteve strategjike për negociim dhe pjesëmarrja në dialogun politik, zbatimi dhe monitorimi i marrëveshjeve të arritura, raportimi në BE për gjendjen a zbatimit të marrëveshjeve, zhvillimi i diplomacisë në mbështetje të dialogut dhe në përparimin e integritimit evropian të Kosovës të ndërlidhur me zbatimin e marrëveshjeve.

Fushëveprimtaria e së cilës bazohet në Programin e Punës së Qeverisë së Kosovës (2015-2018), Programin e Qeverisë për Dialogun e Brukselit (2014-2018) dhe Strategjinë Nacionale për Dialogun, komponentët kryesore të së cilave janë: negociimi i marrëveshjeve në dialogun e Brukselit, zbatimi dhe monitorimi i tyre, ndërlidhja me agjendën evropiane dhe me politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, dhe se procesi i dialogimit/negociatave dhe të marrëveshjeve të arritura duhet të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës.

Dialogu ka për qëllim zgjidhjen e çështjeve praktike ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovraane. Dialogu ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga SHBA-të. Dialogu ka dal si obligim nderkombëtar nga Rezoluta e OKB-së e shtatorit 2010 për të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës, në harmoni me Kushtetutën e vendit dhe Rezolutën e Kuvendit ka treguar gatishmërinë për përmbushjen e këtij obligimi, si dhe të objektivave për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe afrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian.

Zyra e Kryeministrit përkatësisht *Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur*;

Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal e cila përfaqëson Republikën e Kosovës si Koordinator Kombëtar për iniciativat për bashkëpunim rajonal në kuadër të vendeve të EJL si dhe koordinon aktivitetet e bashkëpunimit rajonal në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal direkt me Sekretariatit në Sarajevë.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999.

Sa i përket marrëdhënieve me bashkësinë nderkombëtare, Kosova ka plotësuar në masë të madhe Propozimin Gjithëpërfshirës të Pakos së Ahtisarit, dhe si rrjedhojë më 10 shtator 2012 Grupi Drejtues Ndërkombëtar ka shpallur të përmbyllur fazën e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, dhe të mandatit të Zyrës së Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Kosova ka arritur pajtim me Bashkimin Evropian për zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri në qershor të vitit 2016. Gjithashtu, Kosova në mënyrë koherente vazhdon përpjekjet për shtimin e njohjeve të Kosovës si shtet të pavarur dhe si rrjedhojë numri i njohjeve ka arritur në 111. Rrjedhimisht, Kosova është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim. Kosova gjithashtu merr pjesë në takimet e rregullta të CEFTA-s mirëpo vazhdon të ballafaqohet me pengesat e krjuara nga Serbia ku nga Sekretariati i CEFTA-

së kërkohet që në emër të Kosovës të nënshkruaj UNMIK , që paraqet shkelje të marrëveshjes së Bashkëpunimit Rajonal e arritur në Bruksel me 24 Shkurt 2012.. (Për më shumë, shih Kapitulli 31)

Kosova është anëtarësuar në organizatën për Procesin e Bashkëpunimit për Evropën Jug-Lindore (SEECIP), Iniciativën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI), Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, Komisionin e Venecias, Qendrën për Bashkëpunim në fushën e Sigurisë (RACVIAC), Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë. Poashtu, Kosova është e anëtarësuar me të drejta të plota në organizatat rajonale me karakter sportiv, përfshirë: Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit, Federatën Ndërkombëtare të Notit, Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, Federata Ndërkombëtare Hendbollit, Federatën Botërore të Taekwondo-së, Federatën Ndërkombëtare të Mundjes.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal Kosova vazhdon të ketë bashkëpunim të kënaqshëm me:

Shqipërinë

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit strategjik me Republikën e Shqipërisë në fushën ekonomike, politike, kulturore, sportive dhe fusha tjera, më 23 mars 2015, është mbajtur në Tiranë mbledhja e dytë e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të **Republikës së Shqipërisë** me ç'rast janë analizuar rezultatet e mbledhjes së parë dhe të dy kryeministrat kanë nënshkruar deklaratën e përbashkët "Për Bashkëpunim në Fushën e Zhvillimit Rajonal në Zonat Ndërkufitare Kosovë-Shqipëri". Poashtu, janë nënshkruar disa marrëveshje dhe memorandum bashkëpunimi nga ministrant përkatës, që thellojnë bashkëpunimin dypalësh në shumë fusha, si në vijim: Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "Për bashkëpunim te ndërsjellë në fushën e sigurisë", Protokollin për zbatimin e marrëveshjes kuadër "Për Bashkëpunimin në nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë", Protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë "Për Ndjekjen e Menjëhershme Ndërkufitare", Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë "Mbi shfrytëzimin e përbashkët te pasjeve për kontrollin e kufirit", Memorandum "Për bashkëpunimin në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural", Memorandum Bashkëpunimi mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë, Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë "Mbi forcimin e bashkëpunimit ne fushën e kontrollit te brendshëm", Memorandum bashkëpunimi "Për forcimin e bashkëpunimit" ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshje bashkëpunimi "Në fushën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Marrëveshje Bashkëpunimi "Për organizimin e përbashkët te mësimit te Gjuhës dhe Kulturës Shqipe ne Mërgatë", Marrëveshje Bashkëpunimi "Për bashkëpunim institucional për përparimin dhe zhvillimin profesional te mësimdhënësve në arsim parauniversitar".

Me Maqedoninë, Republika e Kosovës ka arritur marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të pensioneve dhe për forcimin e bashkëpunimit kulturor. Kanë hyrë në fuqi si dhe janë mbajtur negociatat dhe pritet avancimi në drejtim të përgatitjes për nënshkrim të marrëveshjeve si në vijim: Marrëveshja për riatdhesimin, Marrëveshje "Për Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Civile dhe Tregtare", Marrëveshja për "Asistence Ligjore në Çështjet Civile", Marrëveshje për "Njohje Reciproke të Patentë Shoferëve", Marrëveshja për "Kushtet e udhëtimit të qytetarëve të dy vendeve", dhe Marrëveshje për bashkëpunim në çështjet e integritimit evropian. Si çështje të hapur me Maqedoninë kemi rinimin e rastit të Butelit.

Malin e Zi

Republika e Kosovës ka nënshkruar Marrëveshjen për Kufirin Shtetëror me Malin e Zi më datë 26 gusht 2015. Gjithashtu, kanë kaluar si nisma disa marrëveshje dhe disa prej tyre janë negociuar: Marrëveshja për "Shkëmbimin dhe Mbrojtjen e Dyanshme të Informatave të Klasifikuara", Marrëveshja për "Promovimin Reciprok dhe Mbrojtjen e Investimeve", Marrëveshja për "Bashkëpunim Kulturor", Marrëveshja për "Transport Ndërkombëtar", Marrëveshja për "Bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale, Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi "lidhur me Pikën e përbashkët kufitare të Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi, me të cilën shënohet trekufiri dhe mirëmbajtja e tij", Protokoll

ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës, Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftën Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Sekretariatit Gjeneral të Qeverisë së Malit të Zi, Zyra për Luftën kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në bashkëpunim në Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi për Bashkëpunim në Sferën Ekonomike, Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi për “Zbatimin e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar, që financohet në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) 2014-2020”.

Bosnja dhe Hercegovina nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj për njohjen e Kosovës. Vizat për qëndrim të shkurtër për shtetasit e Kosovës lëshohen vetëm me ftesë nga misionet e huaja diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Bosnjë dhe Hercegovinë, ose për arsye humanitare. Si një masë reciproke, Kosova ka vendosur një regjim të vizave për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës që nga muaji janar. Në muajin gusht, Kosova ka bllokuar importet e ushqimeve me origjinë shtazore nga Bosnja dhe Hercegovina; në këtë drejtim, Kosova nuk duhet të vendosë kërkesa që shkojnë përtej atyre të pajtuara në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Tre programet ekzistuese të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë; Kosovë-Maqedoni; dhe Kosovë-Mali i Zi janë në proces të zbatimit. Realizimi i projekteve të financuara nga këto Programe si dhe puna dhe koordinimi me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe vendet fqinje për realizimin e dy projekteve strategjike, me Maqedoninë për hapjen e pikës kufitare në Stanqiq (Kosovë) – Belanovcë (Maqedoni) dhe me Shqipërinë për ndërtimin e rrugës kufitare (Shishtavecit/Shqipëridhe Dragash/Kosovë).

Programi për BNK Shqipëri-Kosovë – Në projektin Strategjik "Të Ndërtojmë së bashku një Rajon Tërheqës Turistik dhe të Begatë" në koordinimin me Zyrën e Komisionit Evropian janë hartuar Termat e Referencës për Kontratën për Shërbime që përfshinë studimin e fizibilitetit.

Programi për BNK-së Maqedoni-Kosovë - Ka vazhduar punën komisioni i përbashkët i ekspertëve për hapjen e pikës kufitare në Stanqiq (Kosovë) – Belanovcë (Maqedoni), lidhur me projektin strategjik në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë-Maqedoni.

Programi për BNK Mali i Zi-Kosovë - Është aprovuar Raporti i fazës së parë të vlerësimit nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë për Programin Kosovë - Mali i Zi për alokimet 2011-2013. Ka vazhduar faza e dytë e vlerësimit për vlerësimin e Plotë të Projekteve dhe hartimi i raportit Final të Vlerësimit i cili më pas do të dërgohet për Miratim në Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë.

Në kuadër të kompletimit të kornizës ligjore përmes ndryshimeve në legjislacionin kyç, përfshirë edhe në Kushtetutë, Kosova ka plotësuar dhe ndryshuar Kushtetutën e saj për të themeluar gjykatën speciale dhe zyrën e saj të prokurorisë. Në këtë drejtim është miratuar Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe Ligji për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara. Qeveria po ashtu duhet të miratojë strategjinë për drejtësinë tranzicionale, me ç'rast grupi punues ndërministror për ballafaqim me të kaluarën, në pajtim me nëngrupet punuese është duke bërë një analizë paraprake për hartimin e projekt strategjisë në një periudhë afatmesme lidhur me mekanizmat relevantë për të mbledhur informata në lidhje me hetimet mbi krimet e luftës dhe personat e zhdukur.

Republika e Kosovës është pjesëmarrëse aktive në nismat dhe organizatat multilaterale që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Për më tepër është anëtare e nismave rajonale të mëposhtme: Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA); Procesi BRDO (BP); Instrumenti Investues për Ballkanit Perëndimor (WWBIF); Komisioni për Investime i Evropës Juglindore (SEEIC); SEETO - Observatori i Transportit i Evropës Juglindore; Iniciativa elektronike e Evropës Juglindore (eSEE); Forumi i Bashkësisë Tregtare të Evropës Juglindore (SEETUF); Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore (NALAS); Rrjeti i Partneritetit Publiko Privat të Evropës Juglindore (SEPPPN); SHBA - Karta e Adriatikut (A-5); Nisma e Reformës Arsimore për Evropën Juglindore (ERI

SEE); Qendra Rajonale e Mjedisit (REC); Ballkani Perëndimor 6; Qendra për Bashkëpunim për Sigurinë (RACVIAC); Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI); Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF); Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC); Shkolla Rajonale për Administratë Publike (ReSPA); Rrjeti rajonal mjedisor për anëtarësim (RENA); Qendra Rajonale e të Mësuarit për Sipërmarrjen në Evropën Juglindore (SEECF); Task Forca për Avancimin dhe Ngritjen e Kapitalit Njerëzor (TFFBHC).

Në kuadër të dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, Kosova është përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces sa i përket edhe zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri tani. Tregues pozitiv në këtë aspekt janë: Marrëveshja mbi Zbatimin e Drejtësisë dhe Licensimi i kompanive të pjesës veriore të Kosovës për mallra të kontrolluara në kuadër të Marrëveshjes për Mbledhjen e të Hyrave Doganore në dy pikë kalimet kufitare Jarinje dhe Bërnjak + Asociacioni

Deri më tash mund të konstatohet se strukturat paralele janë shuar në fushën e policisë, në fushën e doganave dhe atyre të gjendjes civile dhe po vazhdohet edhe në fushën e drejtësisë, gjykatave dhe prokurorisë. Sa i përket të ashtuquajturës “Mbrotja Civile”, marrëveshja për shpërbërjen e saj parasheh integrimin e individëve (ish-pjesëtarë) të kësaj strukture në institucionet civile të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, pritet që të bëhet shuarja e plotë e kësaj strukture ilegale.

Përkundër arritjeve në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ende mbetin sfida të cilat vështirësojnë pozitën e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Mosnjohja nga 5 vendet anëtare të BE-s paraqesin sfidë në rrugën e Kosovës drejt procesit të integritimit Evropian. Po ashtu mungesa e njohjeve të mjaftueshme pengon anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë si në OKB, OSBE apo Këshill të Evropës, si rrjedhojë Kosova nuk është në gjendje të përfitojë plotësisht nga mekanizmat e vlerësimit të konventave përkatëse.

Sa u përket të arriturave në fushën me ballafaqim me të kaluarën, Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 15 tetor 2014, me vendimin nr. 02/200 ka miratuar Rregulloren (QRK) - nr. 18/2014 për punën e grupit punues për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtim.

Me Serbinë:

Në kuadër të dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, Kosova është përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces sa i përket edhe zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri tani. Tregues pozitiv në këtë aspekt janë: zbatimi i Marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit ndërshtetëror (IBM), për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore në dy pikë kalimet kufitare Jarinje dhe Bërnjak, licencimi i kompanive të pjesës veriore të Kosovës për mallra të kontrolluara, marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të sigurimit të automjeteve, për njohjen reciproke të certifikatave për produktet farmaceutike, ndërsa në proces të zbatimit janë marrëveshjet për drejtësinë, shuarjen e mbrotjes civile dhe njohjen e diplomave, telekomunikimit/kodi telefonik për Kosovën, energjinë, kadastrën dhe Asociacionin.

Deri më tash mund të konstatohet se strukturat paralele janë shuar në pak fusha si në fushën e policisë, në fushën e doganave dhe atyre të gjendjes civile dhe po vazhdohet edhe në fushën e drejtësisë, gjykatave dhe prokurorisë. Sa i përket të ashtuquajturës “Mbrotja Civile”, marrëveshja për shpërbërjen e saj parasheh integrimin e individëve (ish-pjesëtarë) të kësaj strukture në institucionet civile të Republikës së Kosovës, ku tanimë integrimi ka përfunduar, ndërsa në pritje është dorëzimi i objekteve. Nga 483 persona të integruar në institucionet e Kosovës, 105 prej tyre kanë filluar punën dhe marrin pagat ndërsa 328 të tjerë fillojnë punën dhe pagat do të marrin nga 1 janar 2016.

Mirëpo, shqetësues mbeten vazhdimi i ekzistimit të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë në shumë fusha në nivelin komunal dhe disa në qendror dhe sidomos në komunat veriore ku tashmë funksionojnë strukturat legale si rrjedhojë e marrëveshjes së parë. Heqja e gjithë këtyre strukturave ilegale do të hap rrugë për krijimin e Asociacionit për të cilën është arritur marrëveshja.

Zbatimi i marrëveshjes së drejtësisë, është në fazën finale. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës ka konfirmuar se ka përfunduar procesi i vlerësimit dhe intervistimit të kandidatëve për fazën e parë, dhe janë selektuar³⁴ gjyqtar dhe 9 prokuror të cilët kanë plotësuar kriteret e aplikimit, nga totali sipas marrëveshjes së Drejtësisë 48 gjyqtar dhe 15 prokurorë. Me 10 dhjetor 2015 Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës do të shpall konkurs për pozitat e paplotësuar për 14 gjyqtar dhe 6 prokurorë si dhe për 164 pozita për stafin administrativ të gjyqësorit dhe prokurorisë të Republikës së Kosovës ashtu siç parashihet me marrëveshje. Çështja e objekteve që është pjesë e planit të zbatimit të marrëveshja së Drejtësisë është po ashtu në procesin final ndërsa shpërbërja e strukturave paralele gjyqësore të Serbisë në Kosovë akoma nuk është zgjidhur. Shpërbërja kërkon përshtatje ligjore në Ligjin e Serbisë Nr. 116/2008 mbi Selitë dhe Juridiksionet Territoriale të Gjykatave dhe Zyrave të Prokurorëve. Afati i fundit ishte deri më 31 dhjetor 2013. Gjithashtu Serbia duhet të bëjë shkarkimin e gjyqtarëve dhe ndalojë pagat e personelit gjyqësorë të angazhuar në strukturat paralele gjyqësore në ditën e emërimit nga Presidentja.

Menaxhimi i Integruar të Kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë funksionon mjaft mirë, ndërsa në këtë fazë zbatimi është fokusuar në ndërtimin e objekteve të përhershme të IBM në gjashtë pikëkalimet kufitare mes dy shteteve. BE financon dhe realizon ndërtimin e tyre. Gjithashtu jemi pajtuar edhe për hapjen e dy pikë kalimeve të reja kufitare siç është ajo tek pika kalimit kufitarë në mes të Kamenicës dhe Medvegjës dhe në mes të Zubin Potokut dhe Novi Pazarit.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të Lëvizjes së Lirë është arritur Marrëveshja për njohjen reciproke të Policave të Sigurimeve të Automjeteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe se ky proces do të lehtësojë edhe më shumë qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në mes të të dyja shteteve. Marrëveshja në fjalë pas tre vitesh negociatash ka filluar së zbatuari nga data 12 gusht 2015 për shkak se pala serbe nuk ka qenë e gatshme të fillojë zbatimin konform marrëveshjes.

Sa i përket zbatimit të marrëveshjes për telekomunikacion/kodin telefonik dhe energji, në parim është arritur marrëveshja për planin për zbatim për telekomin në takimin e 25 gushtit 2015 në Bruksel Marrëveshja për telekom saktëson se Kosova do ta marrë kodin e saj shtetëror telefonik 383 nga ana e ITU dhe se aplikimin në emër të Kosovës do ta bëjë Austria. Në këmbim të heqjes së pengesave nga Serbia është ofruar një lejm i përkohshëm i shërbimeve mobile për një kompani të re me fushëveprim të kufizuar të regjistruar në Kosovë. Procesi i regjistrimit të kësaj kompanie në Kosovës është shoqëruar me vonesa për shkak se dokumentacioni i dorëzuar nga pala tjetër nuk ka qenë në harmoni me marrëveshjen e Brukselit dhe ligjet e Kosovës dhe pas dy muajve kompania ka marrë certifikatën e biznes nga ana Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve në MTI me datë 13 tetor 2015. Ndërsa në kuadër të shkëmbimit të dhënave më 2 dhjetor pala e Kosovës i ka dorëzuar ato në BE dhe jemi në pritje të dhënave edhe nga pala serbe me qëllim që të ecët drejt bashkëpunimit në mes të dy rregullatorëve të telekomit me ndërmjetësimin e BE-së. Marrëveshja në fjalë gjithashtu garanton shuarjen e strukturave paralele në këtë fushë.

Ndërsa sa i përket marrëveshjes së Energjisë dhe dakordimeve të 25 gusht 2015, Serbia deri më tani ka dështuar në regjistrimin e dy kompanive të reja (njëra për shërbime tregtare, tjetra për furnizimi dhe shërbime të mirëmbajtjes së shpërndarjes) në Kosovë. Arsyet për vonesa në regjistrimin e kompanive të reja janë të natyrës politike: (1) për të shmangur respektimin e ligjit të Kosovës për procesin e regjistrimit të biznesit dhe (2) vendosjen e pengesave që Operatori i Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) të fillojë operimin si një sistem i pavarur në kuadër të sistemit Evropian të transmisionit, bazuar në marrëveshjen e arritur ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E më 1 tetor të vitit 2015. Zbatimi i kësaj marrëveshje është paraparë për 30 nëntor të vitit 2015 duke e kushtëzuar Kosovën me lëshimin e një licence për furnizim për një kompani të re; megjithatë, Kosova nuk është në gjendje të lëshojë një licencë të tillë sepse kompania e re nuk është regjistruar akoma.

Serbia akoma refuzon qasjen në veri të operatorëve të energjisë në Kosovë (KOSTT dhe KEDS), duke shkelur kështu marrëveshjen për Energjinë. Qasja në pjesën veriore të vendit duhet të fillojë menjëherë pasi që KOSTT të fillojë funksionin si sistem i pavarur në sistemin evropian (ENTSO-E). Sa i përket operatorëve ilegal, përmes nënshkrimit të marrëveshjes, Serbia ka ri-konfirmuar zotimin e saj për shpërbërjen e operatorëve të tij të energjisë, të cilët operojnë në mënyrë ilegale në veri të Kosovës, një

obligim që është vonuar që nga shatori i vitit 2014, përkatësisht pas nënshkrimit të planit të veprimit të zbatimit për energjinë.

Në takimin e 25 gushtit 2015, në Bruksel palët janë pajtuar për fillimin e revitalizimit të urës mbi lumin Ibër në Mitrovicë dhe largimin e barrikadës së ashtuquajtur "parku i paqes". Procesi i revitalizimit ka filluar me 17 tetor 2015. Revitalizimi i urës do të kryhet deri në pranverë të vitit 2016, me ç' rast ura do të hapet për qarkullim për të gjithë qytetarët dhe automjetet. Po ashtu, sipas marrëveshjes është duke u punuar edhe për definimin e zonave kadastrale për fshatrat Suhadoll dhe Kroi i Vitakut, sipas linjës administrative mes Komunave të Mitrovicës Jugore dhe Veriore konform ligjeve të Kosovës dhe Planit të Ahtisaarit.

Bisedimet në Bruksel ka pasur gjithashtu për parimet e përgjithshme për Asociacionin e Komunave më shumicë serbe, bisedimet për këtë çështje fillimisht janë mbajtur në nivelin teknik gjatë muajit qershor dhe korrik 2015, pastaj kanë vazhduar në nivelin e kryeministrave dhe PL Mogherini dhe me 25 gusht 2015 është arritur Marrëveshja Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të themelohet dhe funksionoj në bazë të Kushtetutës dhe Ligjeve të Republikës së Kosovës dhe nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. dhe se kushti kryesor për themelimin e tij është i ndërlidhur me shuarjen e të gjitha strukturave ilegale të Serbisë që ende vazhdojnë të jenë në Kosovë. Fillimi i hartimit të statutit është duke u pritur vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mbi kushtetutshmërinë e marrëveshjes së Brukselit në këtë çështje (e arritur më 25 gusht 2015) konform kërkesës së dërguar nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Kurse për Fondin Zhvillimor për pjesën veriore, procesi është duke vazhduar nën udhëheqjen dhe koordinim e zyrës së BE-së në Kosovës me ç' rast projektet e para të komunës së Mitrovicës Veriore janë dorëzuar dhe aprovuar nga Bordi Menaxhues. Fondet e alokuara për këto katër projekte të para kapin shumën 2,515 Euro. Ndërsa deri në këtë kohë janë mbledhur mbi 7,8 milionë euro, konform marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore në pjesën veriore.

Masat afatshkurtra

Masat legislative (Nuk aplikohet)

Në drejtim të **avancimit të politikave** me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE, këto masa afatshkurtra do të ndërmerren:

- Qeveria e Kosovës do të shtoj aktivitetet diplomatike për shtimin e njohjeve si dhe anëtarësim në mekanizmat relevante ndërkombëtarë. Konkretisht, Qeveria do të miratoj Strategjinë e Politikës së Jashtme përmes së cilës synohet shtimi i njohjeve të reja si dhe anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtar;
- Sa i përket çështjes së personave të zhdukur, Qeveria do të shtojë përkushtimin për plotësimin e kornizës ligjore me qëllim të zbatimit më të mirë të Ligjit për Persona të Zhdukur dhe do të rris kapacitetet për procesin e identifikimit të mbetjeve mortore;
- Qeveria do të angazhohet në krijimin e mundësive për një koordinim më të mirë në mes të institucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të angazhuara në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, përmes hartimit të 'Strategjisë për Qasje të Përbashkët';
- Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, do të vazhdojë më intensifikimin e bashkëpunimit rajonal;
- Për të arritur kapacitetin e plotë të Departamentit për Mjekësi Ligjore në kuadër të përmbushjes së standardeve të kërkuara për praktika të qëndrueshme ligjore, Qeveria fillimisht do të hartojë një koncept dokument për Rregullimin e Fushës së Mjekësisë Ligjore dhe të miratoj legjislacionin zbatues për krijimin e një regjistri qendror dhe për mbylljen e rasteve.
- Gjithashtu, DML do të rekrutoj dhe zhvilloj profesionalisht ekspertizë të nevojshme në fushën e antropologjisë dhe mjekësisë ligjore në përgjithësi, duke pasur parasysh integrimin e stafit nga komuniteti jo-shumicë;
- Si dhe, me qëllim të promovimit të pajtimit dhe paqes së qëndrueshme, gjatë 2016 Qeveria do të hartojë strategjinë kombëtare për drejtësinë tranzicionale.

Sa i përket *zbatimit në praktikë*, Kosova do të përqendrohet tutje për të zgjidhur fatin e personave të zhdukur. Do të intensifikojë përpjekjet rreth shkëmbimit të informatave për varrezat e mundshme masive. Në 2016, Grupi Punues Ndërmintor për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim, nëpërmjet nën-grupeve tematike do të organizojë konsultime publike me palët me interes, përfshirë viktimat e luftës dhe komunitetet, me qëllim që të grumbullojë informatat e domosdoshme për hartimin e strategjisë.

Gjithashtu, Kosova do të vazhdoj me zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Prioritetet afatmesme

MPJ është në proces të konsolidimit të infrastrukturës së saj institucionale duke siguruar kështu një mbulim diplomatik/konsullor me shtrirje në të gjitha kontinentet për të forcuar shtetësinë e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Në periudhë afatmesme do të shtrijë më tutje rrjetin diplomatik në shtetet me fuqi rajonale dhe globale në mënyrë që të konsolidojë subjektivitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës dhe të anëtarësoj Republikën e Kosovës në Organizata Ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Kosova do të hapë misione të reja diplomatike dhe konsullore/zyra ndërlidhëse të fuqizoj ambasadat dhe do të rris numrin e diplomatëve në Bruksel, Nju Jork, Uashington, Gjenevë si dhe në kuadër të Akademisë Diplomatike dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme (si në departament politike ashtu edhe në administrativ).

Kosova do të përqendrohet për të zgjidhur fatin e personave të zhdukur. Do të intensifikojë përpjekjet rreth shkëmbimit të informative për varrezat e mundshme masive. Për të arritur kapacitetin e plotë të Departamentit për Mjekësi Ligjore në kuadër të përmbushjes së standardeve të kërkuara për praktika të qëndrueshme ligjore, Qeveria fillimisht do të hartojë një koncept dokument për rregullimin e fushës së mjekësisë ligjore dhe to të miratoj legjislacionin zbatues për krijimin e një regjistri qendror dhe për mbylljen e rasteve. Gjithashtu, do të rekrutoj dhe zhvilloj profesionalisht ekspertizë të nevojshme në fushën e antropologjisë dhe mjekësisë ligjore në përgjithësi, duke pasur parasysh integrimin e stafit nga komuniteti jo-shumicë.

Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë janë pengesa kryesore në procesin e normalizimit të situatës në pjesën veriore të Kosovës, prandaj shpërbërja e tyre është shumë e rëndësishme për zbatimin efektin të marrëveshjes. Serbia vazhdon të ndërhyj në Kosovë përmes ruajtjes së një pjesë të strukturave të saja paralele, në kundërshtim me marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore në mes të dy shteteve.

Marrëveshja për Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë ka paraparë në mënyrë implicite shuarjen e strukturave paralele të mbështetura nga Serbia në fushën e policisë, drejtësisë, mbrojtjes civile dhe atyre administrative (pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe funksionalizimit të komunave në pjesën veriore), më herët gjatë dialogut teknik është paraparë shuarja e strukturave paralele në fushën e energjisë, telekomit, shërbimeve të gjendjes civile, kadastrale si dhe të atyre doganore.

Sa i përket *zbatimit në praktikë*, në periudhë afatmesme do të hiqen strukturat paralele të Serbisë që vazhdojnë të shtohen dhe që shkelin Marrëveshjen e Brukselit për Normalizim të Marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

Plotësimi i kriterëve ekonomike për anëtarësim është i bazuar në kërkesat e dala në konkluzionet e Këshillit Evropian të vitit 1993 të quajtura si Kriteret e Kopenhagës. Ekonomia e tregut funksionale është kriteri i pare ekonomik i Kopenhagenit i cili përfshin:

- Ekzistimi i një konsensusi të gjerë për politikat esenciale ekonomike
- Arritjen e stabilitetit makroekonomik, duke përfshirë stabilitetin adekuat të çmimeve dhe qëndrueshmëri të financave publike dhe bilancit të jashtëm të pagesave;
- Ndërveprimin e lirë të forcave të tregut të bazuar në mekanizmat e ofertës dhe kërkesës, përfshirë vendosjen e çmimeve dhe liberalizimin të tregtisë;
- Eliminimin e barrierave të qenësishme ndaj hyrjes dhe daljes nga tregu (në aspektin e krijimit të shoqërive të reja ose falimentimit të atyre ekzistuese);
- Ekzistencën e sistemit ligjor, duke përfshirë edhe rregullimin e të drejtave të pronësisë, si edhe imponimin e zbatimit të ligjeve dhe kontratave;
- Konsensusin e gjerë për çështje kyçe të politikave ekonomike;
- Sektorin financiar të zhvilluar mjaftueshëm për të kanalizuar kursimet drejt investimeve produktive.

Kriteret e Mاستrihtit të njohura si kriterë ekonomike të konvergences kanë të bëjnë me integrimin monetar në kuadër të Euro zonës. Me saktësisht, shtetet që synojnë adoptimin e Euro duhet të përmbushin një numër të indikatorëve makroekonomik që masin:

- Stabilitetin e çmimeve përmes CPI;
- Qëndrueshmëri dhe adekuatshmerine e financave publike përmes limitimit të nivelit të deficitit buxhetor (në 3% e GDP) dhe nivelit të borxhit qeveritar në raport me BPV;
- Stabilitetin e normës afatgjate të interesit; dhe
- Stabilitetin e normës së këmbimit.

Bazuar në konkluzionet e Këshillit të vitit 2008⁷ dhe Këshillit për Çështje të Përgjithshme, Komisioni Evropian të vitit 2013 ka nisur në dy vitet e fundit një qasje të re për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës, të ngjashme me instrumentet dhe mekanizmat e vendeve anëtare. Në këtë kontekst, Strategjia e zgjerimit për Kosovën (dhe Ballkanin në përgjithësi) bazohet në tri shtylla bazë ndër të cilat edhe qeverisja ekonomike. Një nga instrumentet kryesore për të forcuar qeverisjen ekonomike është dialogu me BE përfshirë edhe përgatitjen e Programit për Reforma në Ekonomi. Andaj edhe vlerësimi i progresit në përmbushjen e kriterëve ekonomike do të jetë i ndërlidhur ngushtë me përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe programin e reformave ekonomike.

Si rezultat, objektivat dhe masat prioritare në kuadër të kriterëve ekonomike synojnë të reflektojnë substancën e reformave strukturore në Programin për Reforma në Ekonomi⁸. Natyrisht, të gjitha masat lidhen ngushtë me dokumentet strategjike të institucioneve të Republikës së Kosovës si Programi i Qeverisë 2015-2018, Strategjitë sektoriale, Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim. Dokumenti inkorporon edhe masat e dala nga Raporti për Vendin dhe Dialogu vjetor për Stabilizim Asociim për “Ekonomi, Kontroll Financiar, Statistika”.

Sa i përket përparimit në plotësimin e kriterëve ekonomike për anëtarësim⁹, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për krijimin e një ekonomie funksionale të tregut të aftë për t’u përballur me konkurrencën duke drejtuar buxhetin drejt investimeve që gjenerojnë rritje, dhe forcuar konkurrueshmërinë që do të kishte efekte pozitive edhe në zvogëlim të disbalancit të jashtëm. Duhet të vazhdojë privatizimi, dhe të punohet për rritjen e mbledhjes së tatimeve të brendshme. Qartësimi i procedurave të falimentimit do të kontribuonin pozitivisht në ekonomi. Ngjashëm, duhet të zhvillohet kapitali njerëzor për të reduktuar normën e lartë të papunësisë, të luftohet ekonomia informale dhe të forcohet sundimi i ligjit për të përmirësuar ambientin e biznesit për sektorin privat dhe konkurrencën në treg. Stabiliteti dhe politikat e qëndrueshme fiskale dhe zhvillimi i mëtejëm i tregut financiar që përmirëson qasjen në financa do të

⁷ Këshilli i Bashkimit Evropian

⁸ Meqenëse PRE 2016-2018 është aktualisht duke u përgatitur, masat prioritare të përfshira në këtë draft mund të plotësohen kur të finalizohet PRE

⁹ Bazuar në Raportin e KE-së për Kosovën 2015.

krijonjë mbështetje të mirë për zhvillimin e ekonomisë. Në funksion të rritjes së kapacitetit për të qenë më konkurrues, ende ka nevojë për reforma të konsiderueshme përfshirë ndër të tjera edhe sektorin e energjisë dhe zhvillimin e sistemit të arsimit.

2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut¹⁰

Bazat e Politikave Ekonomike

Ekziston një konsensus i gjerë për politika dhe reforma ekonomike të orientuara drejt tregut. Kjo reflektohet edhe në Programin e Qeverisë 2015-2018 ku nënvizohet se një nga parimet bazë të qeverisë është të promovojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien nëpërmjet ekonomisë sociale të tregut. Procesi i reformave ekonomike ka vazhduar me implementimin e reformave bazë në vitet e fundit. Transformimi i ndërmarrjeve shoqërore në kompani të reja me pronësi private ka vazhduar me një numër të madh ndërmarrjesh të privatizuara. Struktura të reja të bazuara në qeverisje korporative janë vendosur në ndërmarrjet publike, edhe pse ende duhet bërë shumë për përmirësimin e qeverisjes dhe performancës së tyre. Reformat strukturore kanë përfshirë edhe ristrukturimin dhe privatizimin e disa shërbimeve publike për të rritur efikasitetin ekonomik në ofrimin e shërbimeve. Sektori i telekomit është liberalizuar. Rrjeti i distribucionit të energjisë është privatizuar. Aeroporti kombëtar i aviacionit civil është dhënë në koncesion 20-vjeçar përmes partneritetit publiko-privat. Studimi i Fizibilitetit 2012¹¹ konkludon se mekanizmat për vendosjen e çmimeve janë përgjithësisht të lira dhe rregullohen përmes rregullatorëve të pavarur. Megjithatë, pavarësisht reformave, vendi ballafaqohet me një shkallë të lartë të papunësisë, strukturë ekonomike me bazë të vogël prodhuese, ndërmarrje publike joeficiente dhe deficit të lartë tregtar.

Ka vazhduar dialogu dhe partneriteti me përfaqësues të bizneseve, partnerët social dhe akterët tjerë sa i përket çështjeve të zhvillimit ekonomik dhe politikave sociale. Në këtë kuadër, odat ekonomike ofrojnë kontributin e tyre në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik rreth politikave dhe iniciativave për zhvillimin e sektorit privat dhe ambientit të biznesit. Bazuar në Ligjin për Këshillin Ekonomik Social (KES), dialogu social dhe çështjet e interesit të punëdhënësve dhe punëmarrësve diskutohen në Këshillin Ekonomik Social si mekanizëm i pavarur tri-palësh i përbërë nga përfaqësues të Qeverisë, organizatat e punëdhësve (Odat Ekonomike) dhe organizatat e punëmarrësve (anëtarët e sindikatave të punëtorëve).

Sa i përket **kornizës së politikave**, Programi i Qeverisë 2015-2018 është një nga dokumentet bazë i politikave në planin afatmesëm. Financimi i këtyre politikave dhe objektivave prioritare pastaj konkretizohet në ndarje indikative të mjeteve për sektorët përkatës në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Programi fokusohet në pesë shtylla kryesore prioritare: i) zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenia sociale, ii) sundimi i ligjit, iii) agjenda evropiane dhe politika e jashtme, iv) arsimit, shkenca, kultura, sporti dhe rinia, dhe v) shëndetësia moderne. Sa i përket politikave kyçe ekonomike, programi parashihet politika fiskale të favorshme dhe përmirësim të mjedisit biznesor përmes politikave konkurruese të tregut, luftimit të ekonomisë joformale dhe eliminimit të barrierave për biznes. Zhvillimi i sektorëve me rëndësi ekonomike si energjisë, infrastrukturës, bujqësisë, telekomunikacionit dhe shqërisë informative dhe turizmit janë objektiva prioritare. Masat tjera në kuadër të shtyllës së parë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenie përfshijnë promovimin e investimeve (përfshirë fondin e investimeve), mbështetjen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, privatizimin dhe përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve publike, dhe politikat sociale për të përmirësuar standardin e jetës dhe mirëqenies sociale. Aktualisht qeveria është duke hartuar Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit si dokument gjithëpërfshirës zhvillimor. Strategjia përfshin një periudhë afatmesme dhe do të reflektojë në masë të madhe shtyllat prioritare të programit të qeverisë.

Pjesë integrale e bashkëpunimit të përforcuar institucional në mes të Kosovës dhe BE-së në vitin 2014 është edhe pjesëmarrja për herë të parë në dialogun e strukturuar për qeverisjen ekonomike që zhvillohet midis vendeve kandidatë nga njëra anë, dhe institucionet e BE-së, veçanërisht Këshilli dhe Komisioni, nga ana tjetër. Në kuadër të këtij dialogu, për herë të parë Republika e Kosovës ka përgatitur edhe

¹⁰ Ky kapitull nuk përmban matricë të masave afatshkurtra.

¹¹ Studimi i Fizibilitetit i Komisionit Evropian për një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit mes BE dhe Kosovës.

Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) 2015. PRE është mjet i cili ka për qëllim të përmirësojë qeverisjen ekonomike duke ofruar një kornizë të qartë në zbatimin e reformave. Dokumenti përbëhet nga një analizë makroekonomike dhe fiskale, si dhe kornizën e përgjithshme të reformave prioritare strukturore për sektorë të caktuar. Ky dokument do të jetë në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, dokumentet tjera strategjike rreth reformave strukturore dhe menaxhimit të financave publike në planin afatmesëm. Përgatitjet kanë filluar në përgatitjen e programit për vitin 2016 (PRE është dokument tre-veçar që rishikohet çdo vit) i cili do të finalizohet deri në fund të janarit të 2016. Strukturalisht, dokumenti përmban reformat kryesore strukturore të ndara në tetë fusha prioritare që kanë impakt në rritje ekonomike, rritje të konkurrueshmërisë dhe në punësim: (i) menaxhimi i financave publike, (ii) infrastruktura, (iii) zhvillimet sektoriale (bujqësia, industria, shërbimet etj), (iv) ambienti i biznesit, qeverisja korporative dhe reduktimi i ekonomisë informale, (v) inovacioni dhe kapaciteti për absorbim teknologjik, (vi) integrimi tregtar, (vii) tregu i punës dhe punësimi, dhe (viii) gjithëpërfshirja sociale, promovimi i mundësive të barabarta dhe luftimi i varfërisë.

Kosova gjatë këtij viti ka negociuar Marrëveshje Stand-By me Fondin Monetar Ndërkombëtar, qëllimi i të cilit është të mbështesë ruajtjen e stabilitetit fiskal, ruajtjen e nivelit të ulët të borxhit publik, si dhe përmirësimin e kualitetit të shpenzimeve publike.

Stabiliteti makroekonomik

Bruto Produkti Vendor nominal për vitin 2014 vlerësohet të ketë qenë €5,567.5 milion (me çmime aktuale). Ndërsa BPV për kokë banori ishte € 3,084 në vitin 2014. Në vitin 2015 parashihet që BPV nominale të arrijë vlerën prej €5,849 milion.

Në vitin 2014 rritja reale e BPV-së ishte 1.2%, ndërsa për vitin 2015 kjo rritje është projektuar të përshpejtohet në 3.8%. Viti 2015 do të jetë periudhë stabilizimi, për t'i paraprirë një periudhë afatmesme me klimë më të qëndrueshme makroekonomike dhe ambient më të favorshëm të bërjes së biznesit, të cilës pritet t'i kontribuoj edhe hyrja në fuqi e ndryshimeve tatimore. Programi i Qeverisë është bazuar në sfidat e së kaluarës dhe ato aktuale dhe ka vënë theks të veçantë në zhvillimin ekonomik përmes stimulimit të prodhimit vendor. Këto ndryshime fiskale përkrahin në veçanti linjën prodhuese në sektorë të ndryshëm, përfshirë këtu sektorin e prodhimeve bujqësore, sektor ky që tashmë ka kohë që po mbështetet përmes subvencioneve shtetërore.

Edhe përkundër faktit që konsumi parashihet të zvogëlohet në raport me BPV-në edhe gjatë periudhës afatmesme 2016-2018, rritja e konsumit do të vazhdojë të jetë kontribut-dhënësi më i madh në rritjen e BPV-së kosovare, e mbështetur ndër të tjera, edhe nga remitancat. Për më tepër, kjo periudhë pritet të karakterizohet me përmirësim të dukshëm të investimeve. Megjithatë rimëkëmbja evropiane mbetet e ngadaltë (pasiguria në eurozonë u zvogëlua më pak se sa që ishte pritur), perspektiva e përgjithshme është pozitive prandaj nuk priten rënie drastike në transferet e emigrantëve nga eurozona, qoftë në formë të remitancave apo të investimeve në patundshmëri.

Megjithatë janë vërejtur shenja të përmirësimit në kategorinë e eksportit, niveli i eksporteve kosovare vazhdon të mbetet i ulët. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës ka parë eksportin si kategori me potencial për të kontribuar në rritjen e BPV-së. Andaj, duke marrë për bazë sfidat me të cilat përballen prodhuesit kosovar, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë ndryshime tatimore të cilat lehtësojnë barrën ekzistuese të bizneseve kosovare në prodhim. Në këtë mënyrë, produktet kosovare do të fillojnë që gradualisht të zëvendësojnë ato të importuara dhe do ta kenë më të lehtë qasjen në tregje ndërkombëtare. Aplikimi i këtyre ndryshimeve që nga ky vit do të lejojë që efektet e këtyre ndryshimeve të manifestohen që në fillim të periudhës afatmesme 2016-2018. Për më tepër, Programi i Qeverisë synon të mbështesë diversifikimin e eksporteve kosovare, karakteristikë kjo që shton qëndrueshmërinë e kontributit të kësaj kategorie në rritjen e BPV-së.

BPV nominale dhe rritja reale e saj (KASH 2016-2018)

Pershkrimi	2011	2012	2013	2014*	2015
ne miliona euro					
Konsumi	5,020	5,256	5,539	5,809	6,002
Investimet	1,531	1,387	1,471	1,486	1,587
Eksportet e mallrave dhe sherbimeve	959	922	927	1,091	1,176
Importet e mallrave dhe sherbimeve	2,737	2,649	2,611	2,807	2,917
BPV nominale	4,772.9	4,916.4	5,327	5,579	5,849
Rritja reale e BPV-së	4.8%	2.5%	3.4%	3.3%	3.8%
ICK	7.4%	2.4%	1.8%	0.4%	0.2%

Burimi: ASK dhe vlerësimet dhe parashikimet e njësisë së Makroekonomisë, MF.

*Vërejtje: ASK publikon të dhënat e llogarive kombëtare në fund të muajit shtator të vitit për vitin paraprak. Andaj, të dhënat për vitin 2014 e tutje janë vlerësim i departamentit të politikave ekonomike dhe publike.


Sa i përket ndikimit të krizës ekonomike, Kosova nuk ka lidhje të forta financiare dhe tregtare me vendet e ndikuara nga kriza. Ndikim të dukshëm nuk pati as përmes dërgesave nga diaspora që përfaqësojnë një komponentë të rëndësishme në financimin e ekonomisë së vendit. Kjo ngaqë pjesa më e madhe e tyre ka burimin në Gjermani dhe Zvicër, vende këto pak të prekura nga kriza. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë së Kosovës vazhdon të mbetet i përcaktuar nga zhvillimet në ekonominë botërore, e në veçanti asaj të Bashkimit Evropian. Kjo për faktin që pjesa më e madhe e eksportit të Kosovës është e orientuar në vendet e Bashkimit Evropian, ndërkohë që Gjermania dhe Zvicra paraqesin burimin kryesor të dërgesave nga diaspora kosovare dhe investimeve të huaja direkte në Kosovë. Pritjet për rënie të çmimeve ndërkombëtare të produkteve ushqimore dhe naftës pritet të reflektohen në rënien e vlerës së importit përderisa rritja e parashikuar e çmimeve ndërkombëtare të metaleve e shoqëruar me masat e reja të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për stimulimin e prodhimit pritet të nxisin eksportin e mallrave.

Bilanci i Pagesave

Pozicioni i bilancit të pagesave në Kosovë u karakterizua me rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2014 (figura 1). Deficiti prej 415.8 milionë euro i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale kishte arritur në 7.6 përqind të PBB-së në vitin 2014, nga 5.7 përqind sa ishte në vitin 2013. Në dy vitet paraprake, deficiti në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale kishte shënuar rënie, duke zbritur në nivelin më të ulët që nga viti 2007, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të deficitit tregtar që kishte rezultuar nga rritja e vlerës së eksporteve dhe rënia e vlerës së importeve, përderisa të gjitha kategoritë tjera në kuadër të bilancit të llogarisë rrjedhëse ishin karakterizuar me bilance pozitive. Në vitin 2014, rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse ishte kryesisht pasojë e rritjes së deficitit tregtar, si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave primare dhe sekondare.¹²

Vëllimi i shkëmbimeve tregtare të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe sektorit të jashtëm shënoi rritje për 10.6 përqind. Shkalla e hapjes tregtare arriti në rreth 71 përqind në vitin 2014 (66 përqind në vitin 2013). Vlerat e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2014 shënoi një rritje vjetore prej rreth 18 përqind, përderisa vlera e gjithësej mallrave dhe shërbimeve të importuara shënoi rritje prej rreth 8 përqind. Në raport me PBB-në, eksporti i mallrave dhe shërbimeve të Kosovës vazhdon të mbetet në nivel të ulët prej


Figura 2. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



¹² Në kuadër të Bilancit të Pagesave të Kosovës, llogaria e të ardhurave parësore përfshinë kategoritë "Kompenzimi i punonjësve" dhe "Të ardhurat nga investimet". Llogaria e të ardhurave dytësore përbëhet nga "Transferet Qeveritare" dhe "Transferet Private të cilat dominohen nga remitencat.

rreth 20 përqind në vitin 2014, përderisa raporti ndërmjet importit të mallrave dhe shërbimeve dhe PBB-së qëndroi në 51 përqind. Në vitin 2014, deficitin tregtar në mallra dhe shërbime arriti vlerën prej 1.7 miliard euro (rreth 31 përqind e PBB-së), që tregon për një rritje vjetore prej 2.3 përqind (rënie vjetore prej 2.5 përqind në vitin 2013).

Në pesë muajt e parë të vitit 2015, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 158.5 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 136.3 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky përqendrim i deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore. Në pesë muajt e parë të vitit 2015, deficitin në tregtinë e mallrave mbeti në nivel pothuajse të pandryshuar nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, përderisa llogaria e shërbimeve dhe të ardhurave parësore u karakterizuan me zvogëlim të bilancit pozitiv prej 11.2 përkatësisht 15.3 përqind. Në anën tjetër, deri në maj 2015, bilanci pozitiv i llogarisë së të ardhurave dytësore, që kryesisht përbëhet nga remitencat, ishte më i lartë për 0.3 përqind.




Deficitin e llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 1.0 miliard euro deri në qershor 2015, që paraqet një rritje prej 3.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 2). Gjithsej eksportet në qershor të vitit 2015 arritën vlerën 161.5 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 14.5 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve të plastikës dhe gomës, eksporteve të produkteve ushqimore si dh rritjes së eksporteve të makinerive dhe pajisjeve elektrike. Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, deri në qershor të vitit 2015, arriti në 1.2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1%. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e produkteve ushqimore, importet e metaleve bazë, importet e plastikës dhe gomës dhe importet e mjeteve të transportit. Si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së eksporteve në gjashtëmuorin e parë të vitit 2015, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 13.5 përqind, nga 12.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Tregtia në shërbime u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv deri në maj të vitit 2015. Bilanci i shërbimeve shënoi vlerën prej 108.4 milionë euro në pesë muajt e parë të vitit 2015 (122.0 milionë euro deri në maj 2014), përderisa rënie më të madhe në kuadër të bilancit të shërbimeve e shënoi kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit.


Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompenzimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve Kosovarë jashtë vendit. Të hyrat nga kompenzimi i punonjësve shënuan rritje vjetore prej 8.7 përqind në pesë muajt e parë të vitit 2015, duke arritur në 88.0 milionë euro.

Remitencat, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, vazhdojnë të kontribuojnë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vlera e gjithsej remitencave të pranuar në vend deri në maj 2015 arriti në 279.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 18.7 përqind (figura 3).



Komponent tjetër i rëndësishëm në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Bilanci i IHD-ve deri në maj 2015 arriti në 157.7 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 29.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondine investimeve në aksione dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 4). Sektorët që përfituan më shumë nga rritja e IHD-ve ishin sektori i patundshmërive, qiradhënies dhe aktiviteteve tjera biznesore, si dhe sektori i shërbimeve financiare.

Figura 4. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Gjithsej vlera e borxhit të jashtëm në fund të tremujorit të parë 2015 arriti në 1.7 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.8 përqind. Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm vazhdon të përbëhet nga borxhi i sektorit privat, që shënoi vlerën prej 1.3 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.8 përqind. Vlera e borxhit të jashtëm të qeverisë së përgjithshme arriti në 329.2 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.7 përqind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014.

Trendët në papunësi dhe punësim

Në vitin 2014, nga popullsia e përgjithshme e përllogaritur prej 1,811,521, popullsia në moshë pune (të moshës 15 deri 64 vjeç) ishte 1,202,489 persona. Prej ketyre, 41.6% merrnin pjesë në fuqinë punëtore (ekonomikisht aktivë). Kjo do të thotë se ata janë ose të punësuar ose të papunë (por aktivë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për punë). Pjesa tjetër prej 58.4% ishin ekonomikisht joaktivë. Personat ekonomikisht joaktivë përfshijnë studentët, amviset, punonjësit e dekurajuar dhe persona të tjerë, të cilët nuk ishin aktivë në kërkim të një pune dhe kjo kategori është shqyrtuar më hollësisht në kapitullin e ardhshëm. Tabela më poshtë përmbledh treguesit kryesorë të tregut të punës për periudhën 2012-2014.

Indikatorët kryesorë të tregut të punës 2012-2014

Treguesi	2012	2013	2014
Shkalla e jo-aktivitetit (%)	63.1	59.5	58.4
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)	36.9	40.5	41.6
Meshkuj	55.4	60.2	61.8
Femra	17.8	21.1	21.4
Shkalla e punësimit	25.6	28.4	26.9
Meshkuj	39.9	44.0	41.3
Femra	10.7	12.9	12.5
Të punësuar të përkohshëm (si % e të punësuarve)	73.0	68.8	71.6
Meshkuj	73.2	68.9	71.6
Femra	72.5	68.7	71.3
Të vetë-punësuar (si % e të punësuarve)	19.8	22.9	23.2
Meshkuj	22.7	26.0	26.1
Femra	8.3	12.8	13.6
Shkalla e papunësisë (%)	30.9	30.0	35.3
Meshkuj	28.1	26.9	33.1
Femra	40.0	38.8	41.6
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (% e grupmoshës 15-24)	55.3	55.9	61.0
Meshkuj	52.0	50.4	56.2
Femra	63.8	68.4	71.7
Papunësia afatgjatë	59.8	68.9	73.8
Meshkuj	59.1	71.0	73.0
Femra	61.3	68.9	75.6

Shkalla e punësimit ka shënuar rritje në vitin 2013, kurse në vitin 2014 është kthyer në vlerat e vitit 2012 (intervalat e konfidencës për vitet 2012 dhe 2014 mbivendosen pjesërisht mbi njëra tjetrën, shih Tabelën më lartë). Kjo do të thotë që punësimi po rritet afërsisht me hap të njëjtë si popullsia në moshë pune. Megjithatë, përqindja e popullsisë në moshë pune, që është ekonomikisht aktive (shkalla e pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore) ka shënuar rritje në vitin 2013 dhe 2014 (edhe pse jo statistikisht sinjifikante në vitin 2014).

Shkalla e papunësisë ishte e njëjtë në vitin 2013 dhe më pas shënoi rritje në vitin 2014 sepse numri i të punësuarve përcillte rritjen e popullsisë në moshë pune, por ai nuk përcillte rritjen më të shpejtë të popullsisë ekonomikisht aktive.

Inflacioni

Trendi i rritjes së ngadalësuar të nivelit të çmimeve, të matur me ndryshimet vjetore në indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK), ka vazhduar edhe në vitin 2014. Ngjashëm me vitin e kaluar, çmimet e ushqimit dhe transportit kanë shënuar ulje të lehtë, duke reflektuar rënien e çmimeve botërore të ushqimit dhe naftës, ndërsa komponentët tjerë si duhani dhe alkooli dhe shërbimet kanë shënuar ngritje. Siç është parashikuar, rritja e pagave në sektorin publik nuk duket të ketë ndikuar në rritjen e çmimeve apo edhe është shfrenuar nga efekti i rënies së çmimeve ndërkombëtare duke rezultuar kështu në nivel përafërsisht të pandryshuar të çmimeve. Çmimet e konsumit pritet të mbesin të ulëta në periudhën afatmesme, 0.2% në 2015 dhe mesatarisht 0.5% në periudhën 2016-2017. Normat e ulëta të inflacionit parashikohen si rezultat i stabilizimit/uljes së çmimeve të dy komponentëve me peshë më të madhe në IÇK, ushqimit dhe transportit, si rezultat i trendit të uljes së mëtejme të çmimeve të produkteve ushqimore dhe naftës në tregjet botërore, ndërsa grupet tjerë të produkteve dhe shërbimeve parashikohet të vazhdojnë të kompensojnë një pjesë të kësaj rënie.

Politikat monetare dhe fiskale

Politikat Monetare

Në vitin 2002, Kosova në mënyrë të njëanshme ka adoptuar euron si valutë ligjore dhe që nga atëherë euro de facto u bë monedha e Kosovës, prandaj, politika monetare në Kosovë është shumë e kufizuar. Instrumenti i vetëm tradicional i politikës monetare i cili është plotësisht në dispozicion të Bankës Qendrore përbëhet nga kërkesat e rezervës bankare. Që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar të Kosovës, bankat kanë mbajtur vazhdimisht rezerva të tepërta; prandaj, gjatë kësaj periudhe nuk është konsideruar si e nevojshme të ndryshohet norma e rezervës së detyruar.

Përdorimi i euros e kufizon rolin e Bankës Qendrore në funksionin e saj si huadhënës i fundit („lender of last resort” - LLR) për të ofruar kredi afatshkurta për bankat që potencialisht përballen me mungesa likuiditeti. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës dhe BQK-ja themeluan Asistencën e Likuiditetit Emergjent (Emergency Liquidity Assistance - ELA); një fond urgjence për të vepruar në rast të ndonjë mungese të likuiditetit në sektorin bankar. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës gjithashtu mban një nivel të duhur të bilanceve bankare si amortizues për të reaguar ndaj goditjeve të mundshme me të cilat përballen të ekonomisë. Në tabelën më poshtë mund të shihni normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale, mesatare vjetore.

Normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale, mesatare vjetore

Përshkrimi		2010	2011	2012	2013	2014	2015/ maj*
Indeksi	NEER	100.8	101.1	101.2	102.1	101.9	101.1
	REER (Total)	104.8	105.8	106.6	107.2	106.0	103.9
	REER(CEFTA)	105.8	106.6	106.9	107.7	107.4	106.2
	REER (EU)	106.4	106.9	108.6	107.8	107.3	106.3
<i>Burimi: BQK</i>							
<i>*muaji i fundit i disponueshëm në bqk-kos.org</i>							

Politikat fiskale

Në mënyrë të përmbledhur, të **hyrat vendore** regjistruan një rritje prej 9.2% krahasuar me periudhën janar-korrik të vitit 2014, ndërsa kanë shfaqur nën-realizim prej 2 pika të përqindjes krahasuar me parashikimin mujor të bazuar në buxhetin e rishikuar¹³. Të **hyrat nga dogana** kanë shënuar rritje prej 7.4% krahasuar me vitin 2014, duke përfaqësuar një mbi-realizim prej 0.5 pika të përqindjes në krahasim me planin e rishikuar për këtë periudhë. Për periudhën janar-korrik, të hyrat nga dogana janë parashikuar të arrijnë në 495.9 milionë euro (kumulative), e që paraqet realizim me normë prej 52.4% të parashikimit sipas buxhetit të rishikuar të vitit 2015 (ndaj 946 milionë euro). Të hyrat e arkëtuara në vend për këtë periudhë regjistruan rritje prej 9.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014 dhe arritën vlerën prej 198.4 milionë euro. Në krahasim me parashikimin mujor të rishikuar sipas buxhetit të aprovuar në muajin korrik (202.6 milionë euro deri në fund të muajit korrik), kjo kategori e të hyrave tregoi një realizim prej 98% përdërisa krahasuar me vlerën vjetore të rishikuar për të hyrat vendore (prej 340 milionë euro) të hyrat vendore janë realizuar me 58.3%. Të hyrat vetanake të komunave kanë regjistruar rënie prej 14.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014 përdërisa janë realizuar vetëm 67.0% krahasuar me planifikimin për këtë periudhë.

Shpenzimet totale regjistruan rritje prej 3.7% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014. Krahasuar me planin vjetor sipas buxhetit të rishikuar, shpenzimet totale u ekzekutuan me normë prej 48.1%. Shpenzimet e përgjithshme arritën vlerën prej 793.8 milionë euro përgjatë periudhës janar-korrik. Struktura e shpenzimeve vazhdon të dominohet nga shpenzimet në paga dhe mëditje si dhe subvencionet dhe transferet. Konkretisht, shpenzimet në paga dhe mëditje përfaqësuan 38.5% të shpenzimeve totale pasuar nga shpenzimet në subvencione dhe transfere (29.2%). Shpenzimet në mallra dhe shërbime dhe shpenzimet kapitale përfaqësuan 12.9% respektivisht 19.3%. Për të dhëna detaje rreth të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2015, ju lutem shihni tabelën 1 në aneks.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin fiskal, gjatë muajve të parë të vitit janë ndryshuar ligjet tatimore për të reflektuar **reformën fiskale** të paraparë me programin qeverisës. Më konkretisht, ndryshimet kryesore që mund të veçohen janë si në vijim:

- Heqja e barrierave për fiskalizim të të gjitha bizneseve përmes ndryshimit të udhëzimit administrativ nr. 15/2010 për pajisjet fiskale me qëllim të liberalizimit të tregut të këtyre pajisjeve. Kjo masë ka për qëllim rritjen e numrit të operatorëve në këtë treg gjë që do të ndikoj edhe në uljen e kostos, si të pajisjeve ashtu edhe të mirëmbajtjes, për bizneset. Me këtë masë synohet përmbyllja e procesit të fiskalizimit të të gjitha bizneseve gjë që do të mundësojë krijimin e një ambienti më të barabartë për të gjitha bizneset që operojnë në Republikën e Kosovës.
- Në të njëjtën kohë, Ministria e financave ka dizajnuar masat stimuluese për konsumatorët që mbledhin kuponët fiskal e cila rregullohet përmes një udhëzimi të veçantë administrativ. Këto masa kanë për qëllim zvogëlimin e evazionit fiskal dhe parandalimin e konkurrencës jo të barabartë dhe në të njëjtën kohë të mbrojnë konsumatorin.
- Ndryshimet në sistemin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar përmes uljes së pragut për regjistrim në TVSH nga 50.000 euro në 30.000 euro, përshkallëzimit të normës së TVSH në 8% për produkte të caktuara bazike dhe 18% për produktet tjera, heqjen e TVSH-së për linjat e prodhimit dhe inputet bazë për prodhuesit vendor.
- Me qëllim të zvogëlimin të barrierave administrative, do shkurtohen procedurat administrative dhe këtu mund të përmendim heqjen e kërkesës për certifikatë të eksportit dhe importit pasi që tashmë të gjitha bizneset në Kosovë posedojnë një numër identik fiskal.

Qeveria është e orientuar në ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal dhe në të njëjtën kohë ruajtjen e shpenzimeve produktive buxhetore. Në këtë kontekst vlen të ceket fakti që në fillim të këtij viti Qeveria e Kosovës ka negociuar një program 22 mujor me FMN, i cili është aprovuar nga Bordi i FMN-së. Meqenëse Kosova nuk karakterizohet me ndonjë rrezik fiskal dhe të bilancit të pagesave, si dhe nuk ka politikë monetare, ky program më shumë do të ketë fokusin në zhvillimin ekonomik të vendit. Me saktësisht, duke pasur parasysh nivelin e ulët të borxhit publik në raport në BPV-në si dhe nevojën që Kosova ka për ngritjen e infrastrukturës dhe rritjen ekonomike, marrëveshja është arritur me FMN që të krijohet një klauzolë e investimeve brenda Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

¹³ Parashikimi mujor është rishikuar konform rishikimit të buxhetit të aprovuar në Kuvend. Tabela me buxhetin e rishikuar është e publikuar ne website-in zyrtar te MF: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>.

(LMFPP) e cila i lejon Qeverisë financimin e projekteve jashtë rregullës fiskale përmes kredive nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare.

Rritja e pagave të sektorit publik dhe pensioneve prej 50% në vitin 2011 dhe rritja e dytë prej 25% në vitin 2014 ka ndryshuar në masë të konsiderueshme strukturën e buxhetit në favor të shpenzimeve rrjedhëse. Përveç kësaj, rritja e pagave në sektorin publik ka ndikuar në tregun e punës ku me rritjen prej 25% në prill 2014 shfaqet një divergjencë e konsiderueshme mes nivelit të pagës mesatare në sektorin privat dhe atij publik. Në këtë aspekt, Qeveria planifikon krijimin e një rregulli të veçantë brenda LPFPP i cili do të rregullon dhe ndërlidhë (anchor) rritjen e pagave të sektorit publik me rritje të produktivitetit. Në përputhje me këto kufizime në shpenzimet aktuale, Qeveria është e përkushtuar të mbajë një nivel të lartë të shpenzimeve kapitale gjatë periudhës 2016-2018. Ndërtimi i rrugëve të reja dhe përmirësimi i mëtejshëm i rrugëve ekzistuese dhe infrastrukturës hekurudhore, investimet në rritjen e efciencës së energjisë, zgjerimi i sistemit të ujitjes së tokave etj. do të përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve kapitale në periudhën e ardhshme.

Nga aspekti institucional, gjatë pjesës së parë të vitit është bërë vlerësimi PEFA nga ana e një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian. Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do të paraqesin bazën për hartimin e strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike e cila planifikohet të përfundojë në pjesën e parë të vitit 2016.

Sa i përket përshtatshmërisë së miksit të politikave makroekonomike, modeli ekzistues i rritjes ekonomike të vendit në bazë të hyrjeve të mëdha financiare ndërlidhet me rreziqe të mëdha. Në kuptim afatshkurtër, faktor kryesor i rrezikut do të ishte rënia e papritur e këtyre hyrjeve- e shkaktuar nga zhvillimet e pafavorshme ekonomike në vendet me diasporë më të madhe të Kosovës - dhe pasojat negative në raport me rritjen, financat publike dhe stabilitetin e jashtëm dhe të sektorit financiar. Në kuptim afatmesëm dhe afatgjatë, megjithatë, sfida kryesore për vendin është si të krijohen kushte të favorshme për nxitjen e rritjes së vetë-qëndrueshme të bazuar në rritjen e produktivitetit të brendshëm dhe konkurrueshmërisë së eksporteve, dhe ka për qëllim uljen e papunësisë së lartë, përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës fizike. Këto objektiva do të duhet të arrihen përbrenda kornizës së financave publike të qëndrueshme që nënkupton zhvillim të parashikueshëm në lidhje me pagat e sektorit publik, dhe ruajtjen e fleksibilitetit të tregut të punës. Të dyja janë të rëndësishme vendimtare marrë në konsideratë opsionet e politikave makroekonomike në dispozicion të një vendi pa politikë të vet monetare.¹⁴

Borxhi Publik

Korniza parësore ligjore për menaxhimin e borxhit shtetëror është Ligji për Borxhin Publik nr. 03/L - 175 i aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 29 Dhjetor 2009. Ky Ligj i krijon të drejtën Republikës së Kosovës “për të marrë hua, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryeqjënë dhe interesin e Borxheve të saja Shtetërore”. Për më shumë, sipas Ligjit, shumica e papaguar e borxhit të përgjithshëm në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë 40% të Bruto Produktit Vendor (BPV). Me ligj, edhe Garancitë Shtetërore trajtohen si borxh shtetëror gjatë llogaritjes së këtij kufizimi. Kurse sa i përket juridiksionit të cilit i nënshtrohet, borxhi mund të ndahet në borxh ndërkombëtar, dhe në borxh të brendshëm - ku borxhi i brendshëm i nënshtrohet juridiksionit vendor, ndërsa ai ndërkombëtar mund t’u nënshtrohet edhe juridiksioneve jashtë Republikës së Kosovës. Borxhi i brendshëm përbëhet në tërësi nga letrat me vlerë të tregtueshme, të emetuara nga Republika e Kosovës, kurse borxhi ndërkombëtar përbëhet nga huamarrjet prej institucioneve financiare ndërkombëtare dhe marrëveshjeve bilaterale me shtete tjera.

Ministria e Financave konform Ligjit, për të rritur transparencën e menaxhimit dhe përcaktojë përgjegjësitë menaxhuese brenda MF-së dhe jashtë saj, ka hartuar Rregulla dhe Procedura përkatëse, si:

- Rregullore QRK nr. 22/2013 mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve shtetërore, Garancive shtetërore dhe borxheve komunale
- Rregullorja MF-BQK nr. 01/2014 për tregun Primar dhe Sekondar të Letrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës

¹⁴ Programi Kombëtar për Reforma në Ekonomi 2015 (<https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Programi-Komb%C3%ABtar-p%C3%ABr-Reforma-n%C3%AB-Ekonomi>).

- Procedurë për regjistrimin në SIMFK të pranimeve dhe Pagesave të Borxhit Publik
- Procedurë për regjistrimin në SIMFK të Pranimeve dhe Pagesave nga Borxhet Ndërkombëtare shtetërore për projektet e caktuara.

Stoku i borxhit shtetëror: Si kontribues kryesor në rritjen e borxhit shtetëror janë borxhet e trashëguara, financimi i projekteve me huamarrje, dhe financimi i deficitit buxhetor. Në vitin 2009 Republika e Kosovës ka trashëguar borxhet nga ish-Jugosllavia, kurse në vitin 2010 janë bërë disbursime të kredisë nga programi me FMN, me qëllim përkrahjen buxhetore. Nga viti 2012 e tutje, Republika e Kosovës ka filluar edhe emetimin e letrave me vlerë dhe deri në vitin 2015 maturiteti është zgjatuar në 5 vite, dhe të hyrat nga këto emetime janë përdorur për financim të deficitit buxhetor. Një pjesë më e vogël ndërkaq është edhe si rezultat i disbursimeve nga kreditë me IFN për financimin e projekteve të ndryshme, kryesisht në fushën e infrastrukturës, energjisë, dhe ujit. Kjo kategori pritet të rritet në vitet në vijim sepse tashmë një numër i kredive janë nënshkruar dhe ratifikuar, por disbursimi nuk është bërë ende në plotësi.

Portofoli Aktual i Borxhit Shtetëror: në fund të 2014 borxhi shtetëror ishte 582.87 milion Euro, prej të cilave borxh i drejtpërdrejtë qeveritar vlerësohet të jetë 573.06 milion Euro ose 98.3% e total portofolit, kurse 9.8 milion Euro ose 1.7% është borxh i nën-huazuar. Në fund të vitit 2015, stoku i borxhit shtetëror parashihet të arrijë në shumë prej 740.24 ose 12.76% e BPV-së.

Stoku i borxhit të përgjithshëm

	2012	2013	2014	TM1 2015 R	TM2 2015
Borxhi Ndërkombëtar	336.60	323.76	326.35	329.21	330.59
<i>Niveli qendror</i>	336.46	321.73	316.54	318.71	314.78
Nën-huazimet	0.14	2.03	9.81	10.50	15.81
<i>Komunat</i>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Borxhi i Brendshëm	73.31	152.51	256.52	293.61	318.55
<i>Niveli Qendror</i>	73.31	152.51	256.52	293.61	318.55
<i>Komunat</i>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi Publik	409.92	476.27	582.87	622.82	649.14
Garancitë Shtetërore	0.00	0.00	10.00	10.00	10.00
Gjithsej Borxhi Publik (% e BPV-së)	8.44%	9.10%	10.63%	10.76%	11.21%

Shënim: Borxhi Ndërkombëtar ndryshon nëpër vite dhe tre-mujor edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutor.

Nëse përjashtojmë nga llogaritja pjesën e ri-financimit dhe konsiderojmë vetëm pjesë e financimeve të reja, Ministria e Financave do të jetë e përqendruar që nevojat e financimit, të cilat janë kryesisht për financim të projekteve kapitale, t'i plotësojë përmes borxhit ndërkombëtar – kredive nga institucionet financiare ndërkombëtare më saktësisht.

Huamarrja gjatë periudhës 2016-2018 do të bëhet për qëllimet e: (i) shërbimi/ri-financimi i borxhit ekzistues i cili matoron në këtë periudhë, (ii) financimi i projekteve zhvillimore të Qeverisë, dhe (iii) financimi i bilancit bankar.

Burimet e financimit me borxh ndërkombëtar, të ndara sipas llojit të financimit përfshijnë financimin e buxhetit (FMN) dhe financimin e projekteve ky hyjnë këto institucione financuese: Banka Botërore – Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim (ANZh), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Banka Evropiane Investuese (BEI), Banka e Këshillit Evropian për Zhvillim (BKEZh), Agjencia Gjermane për Rindërtim (KfW), Republika Federale e Austrisë, Banka Islamike për Zhvillim (IsDB), Fondi Saudit për Zhvillim (SFD), Fondi i OPEC për Zhvillim (OFID), dhe kreditues të tjerë me të cilët mund të nisim bashkëpunimin në të ardhmen.

Parashikimet makroekonomike për periudhën 2016-2018

Skenari i parashikimeve për periudhën 2016-2018 vlerëson se ekonomia do të fillojë rimëkëmbjen nga sfidat që karakterizuan vitin 2014. Viti 2015 do të jetë periudhë stabilizimi, për t'i paraprirë një periudhë afatmesme me klimë më të qëndrueshme makroekonomike dhe ambient më të favorshëm të bërjes së biznesit, të cilës pritet t'i kontribuoj edhe hyrja në fuqi e ndryshimeve tatimore. Programi i Qeverisë është bazuar në sfidat e së kaluarës dhe ato aktuale dhe ka vënë theks të veçantë në zhvillimin ekonomik përmes stimulimit të prodhimit vendor. Këto ndryshime fiskale përkrahin në veçanti linjën prodhuese në sektorë të ndryshëm, përfshirë këtu sektorin e prodhimeve bujqësore, sektor ky që tashmë ka kohë që po mbështetet përmes subvencioneve shtetërore.

Edhe përkundër faktit që konsumi parashihet të zvogëlohet në raport me BPV-në edhe gjatë periudhës afatmesme 2016-2018, rritja e konsumit do të vazhdojë të jetë kontribut-dhënësi më i madh në rritjen e BPV-së kosovare, e mbështetur ndër të tjera, edhe nga remitancat. Për më tepër, shohim se kjo periudhë pritet të karakterizohet me përmirësim të dukshëm të investimeve. Megjithëse rimëkëmbja evropiane mbetet e ngadaltë (pasiguria në eurozonë u zvogëlua më pak se sa që ishte pritur), perspektiva e përgjithshme është pozitive prandaj nuk priten rënie drastike në transferet e emigrantëve nga eurozona, qoftë në formë të remitancave apo të investimeve në patundshmëri.

Megjithëse janë vërejtur shenja të përmirësimit në kategorinë e eksportit, niveli i eksporteve kosovare vazhdon të mbetet i ulët. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës ka parë eksportin si kategori me potencial për të kontribuar në rritjen e BPV-së. Andaj, duke marrë për bazë sfidat me të cilat përballen prodhuesit kosovar, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë ndryshime tatimore të cilat lehtësojnë barrën ekzistuese të bizneseve kosovare në prodhim. Në këtë mënyrë, produktet kosovare do të fillojnë që gradualisht të zëvendësojnë ato të importuara dhe do ta kenë më të lehtë qasjen në tregje ndërkombëtare. Aplikimi i këtyre ndryshimeve që nga muaji korrik i këtij viti do të lejojë që efektet e këtyre ndryshimeve të manifestohen që në fillim të periudhës afatmesme 2016-2018, gjë që pasqyrohet edhe në rritjen e pjesëmarrjes së kategorisë së eksportit në BPV përgjatë kësaj periudhe.

Në përgjithësi, periudha 2016-2018 nuk do të sjellë ndryshime drastike në strukturën e kontribut-dhënësve në rritjen e BPV-së kosovare; pritet anojnë më tepër kah përmirësimi gradual i secilës kategori. Duhet pasur parasysh se fillimi i periudhës do të jetë një i 'kthjelljes' së përgjithshme në përpjekje për t'u rimarrë nga frenimet që karakterizuan vitin 2014.

Në periudhën afatmesme 2016 – 2018, kategoritë që pritet të shtyjnë rritjen ekonomike në Kosovë janë konsumi dhe investimet private dhe në masë më të vogël eksporti. Edhe pse në afat të shkurtër, reformat në sistemin tatimor mund të mos kenë efekt të madh, në afat më të gjatë kohor ato pritet të kontribuojnë në zëvendësimin e mallrave të importit me prodhime vendore dhe rritjen e eksportit të jo-metaleve. Andaj, këto ndryshime tatimore paraqesin mundësi për përmirësimin e bilancit të jashtëm tregtar, i cili vazhdon të jetë sfidë për ekonominë kosovare.

Ndërveprimi i forcave të tregut

Liberalizimi i çmimeve

Ligj nr. 03/L-185 për Rregullatorin e **Energjisë**, rregullon funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. Kjo përfshin energjinë elektrike, ngrohjes dhe gazit natyror. Bazuar në këtë ligj, rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësinë të miratojë metodologjitë tarifore të përgatitura nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Tregut dhe Operatori i Simitit të Shprëndarjes për tarifatat e vendosura për shërbimet e tyre të rregulluara të energjisë dhe të sigurojë se ato janë proporcionale dhe që zbatohen në mënyrë jodiskriminuese. Tarifatat për konsumatorin fundor do të reflektojnë plotësisht koston nga ndërmarrja e energjisë.

Sa i përket **tarifave të shërbimeve publike të ujit dhe kanalizimit**, bazuar në Ligjin 03L-086, tarifat vendosen nga rregullatori i ujit dhe mbeturinave bazuar në kërkesën dhe fizibilitetin e ofrimit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave si dhe duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e çmimeve nga perspektiva e konsumatorëve. Një ligj i ri është hartuar për këtë fushë dhe aktualisht është në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim dhe miratim. Metodologjia për caktimin e tarifave është e rregulluar me Rregullën për Caktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujësjiellit dhe Kanalizimit dhe Furnizimit me shumicë (R-02/U&K).

ZRRUK aplikon tarifa tri-vjeçare (2015-2017) të cilat gjatë kësaj periudhe mund të rikonfigurohen nëse e nevojshme. Rregullatori monitoron eficiencën operationale dhe financiare për të siguruar që tarifat përmbushin standardet relevante të ofrimit të këtyre shërbimeve. Rregullatori ka hartuar Kartën e Konsumatorëve që parasheh zhvillimin e marrëdhënieve kontraktuale ligjore midis ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve. Pra, Karta vendos obligimet dhe të drejtat ligjore të pjesëmarrësve. Për të siguruar cilësinë e ujit, rregullativa obligon secilin ofrues të shërbimeve që të jetë i pajisur me laborator testues për kontrollin e kualitetit të ujit.

Në bazë të Ligjit nr 04/L-109 për **Komunikime Elektronike (LKE)**, ARKEP ka të drejtë që t'i imponojë ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për kontrollimin e çmimeve dhe llogaritjen e kostos sipas dispozitave të nenit 35 të ligjit. Sipas nenit 40, rregullatori mund t'u imponojë ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) detyrimin për mbulimin e kostove dhe kontrollimin e çmimeve, duke përfshirë detyrimet për çmimet e bazuara në kosto dhe detyrimet lidhur me sistemet e llogaritjes së kostos, për ofrimin e llojeve specifike të interkonjeksionit dhe/ose qasjes, në situatë kur një analizë e tregut tregon mundësi të konkurrencës efektive që do të thotë që operatori përkatës mban çmimet në një nivel tepër të lartë, ose mund të zbatojë një ngjeshje të çmimeve, në dëm të shfrytëzuesve fundor.

Poashtu, në bazë të nenit 64 të ligjit, rregullatori për t'i mbrojtur interesat e shfrytëzuesve fundor dhe promovuar konkurrencën efektive, ka të drejtë të vendos nivelet më të larta të çmimit, ndërmarrë masa për kontrollim të tarifave individuale dhe të imponojë obligime për orientim të tarifave kah kostot apo çmimeve në tregjet e krahasueshme.

Në rast të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mes të operatoreve lidhur me interkonjeksion, gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes rregullatori vendos edhe për çmimet e interkonjeksionit. Rasti i fundit kur ka vendosur ARKEP lidhur me këtë çështje është në vitin 2012 me vendimin nr. 271, çmimet për interkonjeksion janë caktuar për terminim të thirrjeve mobile MTR dhe terminim të thirrjeve fikse FTR, si dhe për çmimet e numrave 8X për shërbime të veçanta dhe 9X për shërbime me vlerë të shtuar. Pra, këtu janë vendosur çmimet me shumicë.

Në bazë të Ligjit nr. 03/L - 173 për Shërbimet Postare, neni 6 paragrafi 1.3 përcakton se ARKEP miraton **tarifat për shërbimet universal dhe të rezervuara postare**, të propozuara nga operatori publik postar, si dhe në bazë të nenit 6 paragrafi 1.9, rregullatori mbikëqyrë përdorimin e tarifave të shërbimeve postare dhe propozon marrjen e masave ligjore në rast kur operatori postar nxjerr ose përdorë tarifa në kundërshtim me masat e perçaktuara me këtë ligj. Poashtu ARKEP me vendimin nr. 351 ka vendosur tarifat për shërbimet univerzale postare.

Kompania publike TRAINKOS JSC ka opcionin e caktimit të tarifave për hekurudhat e Kosovës bazuar në Ligjin nr. 04/L-63.

Në **fushën e arsimit**, tarifat e institucioneve private të arsimit caktohen lirshëm nga ato institucione të ofrimit të shërbimeve të edukimit. Ndërsa sipas Ligjit për Arsimin e Lartë¹⁵, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përmes legjislativitetit sekondar cakton tarifat maksimale që duhet paguar për studentët në institucionet publike të financuara nga ministria. Niveli i pagesës caktohet varësisht nga statusi rezidencial i studentit (Kosova apo jashtë Kosovës), natyra dhe kosto e programit të studimeve. Tarifat që paguhen në arsimin e lartë përfshijnë tarifën e pranimit, pagesën vjetore (tuition fee), tarifën e ri-hyrjes në

¹⁵ <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>.

provime dhe pagesën për kartën studentore. Këto tarifa aprovojen nga institucionet respektive të arsimit dhe konfirmohen nga MASHT.

Çmimet për shërbimet shëndetësore në sektorin privat caktohen në mënyrë të pavarur nga operatorët, ndërsa çmimet e shërbimeve shëndetësore të ofruara nga sektori public janë të uniforme për të gjithë Kosovën. Ato caktohen nga Minsitria e Shëndetësisë bazuar në analizën e kostos materiale dhe kostos së punës. Rregullimi i çmimit të produkteve medicinale dhe caktimi i marzhave për produkte medicinale dhe pajisje medicinale bëhet nga Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me institucionet tjera të qeverisë bazuar në Ligjin nr. 2013/04-L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale.

Madhësia e sektorit privat dhe privatizimi

Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV ka osciluar midis 85 dhe 90 pikë të përqindjes në periudhën 2011-2014 siç shihet në tabelën më poshtë. Investimet private janë kthyer në trendin rritës në 2014 pas një periudhe rënëse. Ndërsa konsumi privat bazuar në projeksionet për vitin 2015 pritet të ketë një rënie marginale krahasuar me vitin paraparak.

Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV, ne%, (burimi: KASH 2016-2018)

Pershkrimi	2011	2012	2013	2014 Vler.	2015 Proj.
Konsumi privat	88.4	90.5	87.3	87.7	85.6
Investimet private	21.0	17.0	17.7	19.3	19.7

Sa i përket kontributit të sektorëve/aktiviteteve ekonomike në BPV, sektori i shërbimeve dominon me mbi 50% të BPV-së. Aktivitetet kryesore që kontribuojnë në BPV përfshijnë sektorin e bujqësisë (përfshirë pylltarinë dhe peshkimin) me rreth 11.9% të BPV, industria nxjerrëse dhe përpunuese me rreth 12.4%, ndërtimtaria me 6%, tregtia me shumicë dhe pakicë me 12.4% dhe shërbimet tjera me 40.3% e BPV. Për të dhëna detaje rreth strukturës së BPV sipas aktiviteteve ekonomike, shih tabelën 2 në aneks.

Gjatë periudhës 2011-2013, sektori i shërbimeve është rritur në terma reale me 4.7% mesatarisht. Sektori i industrisë ka shënuar rritje mesatare reale me 7.3% gjatë kësaj periudhe. Tregtia, transporti dhe disa shërbimeve pritet të jenë nxitësit kryesorë të rritjes së sektorit të shërbimeve në tri vitet e ardhshme përfshirë këtu pjesërisht edhe efektet nga ndërtimi i autostradës R6. Edhe sektori i bujqësisë pritet të rritet në periudhën e ardhshme tre-vjeçare ndër të tjera edhe për shkak të rritjes së produktivitetit mbështetur nga rritja e subvencioneve të dhëna nga Qeveria.

Ndërsa në vitin 2014, aktivitetet ekonomike¹⁶ që kishin rritje reale ishin: tregtia me shumicë dhe pakicë me 8.2%, aktivitetet financiare dhe sigurimi me 4.4%, industria nxjerrëse me 4%, edukimi me 3.2%, furnizimi me energji elektrike dhe gaz avull me 1.2%, bujqësia përfshirë peshkatarinë me 0.8%, aktivitetet shërbyese me 1%.

Privatizimi

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është themeluar si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë, në bazë të Kuvendit të Kosovës me Ligjin nr 04 /L-034, mbi AKP-në. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), është e autorizuar për të administruar, shitur, transferuar dhe/ ose bërë likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tyre. Për të përmbushur këtë mision, Agjencia mban dhe administron çdo ndërmarrje (sipas mandatit të saj), në mirëbesim dhe për të mirën e pronarëve dhe kreditorëve të tyre, dhe i shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin. AKP është themeluar si trashëgimtare e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës (AKM) dhe të gjitha asetet dhe detyrimet e kësaj të fundit janë transferuar si asete dhe detyrime të AKP-së.

Procesi i transformimit të pronësisë shoqërore dhe privatizimit në Kosovë ka filluar me themelimin e AKM-së në vitin 2002. Metodatat e përdorura për privatizim të NSH-ve dhe asetet e tyre ishin Spin Off-i i rregull, Spin Off-i me kushte dhe Spin Off-i special. Përderisa Spin Off-i i Rregullt nuk ngërthen kushte

¹⁶ BPV 2008-2014, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

në vete përveç çmimit më të lartë i cili është kryer në një rund të ofertave, Spin Off-i me kushte dhe Spin Off-i special përveç çmimit më të lartë (50% të pikave) ofertuesi fitues është përcaktuar edhe në bazë të zotimeve për punësim (25% pikave) dhe zotimeve për investim (25% pikave) të ofruara nga ofertuesit dhe për më tepër, kjo metodë përfshinte dy runde të ofertimit dhe në rundën e dytë kanë marr pjesë vetëm tre ofertuesit me çmim më të lartë nga rundi i parë.

Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit metoda e privatizimit përmes Spin Off-it special nuk përdoret nga AKP pasi që puna me spin off-et speciale, të cilat janë trashëguara nga AKM-ja, ka dëshmuar të jetë tejet komplekse për menaxhmentin dhe Bordin e AKP-së. Disa prej ndërmarrjeve të privatizuara me Spin Off Special kanë prolonguar tej mase përbushjen e zotimeve për punësim dhe investime. Komplikimet kanë dalë për shkak të kontratave të lidhura bazuar në ligjin Anglez i cili nuk përkon me ligjet në fuqi në Kosovë. Privatizimi tani bëhet përmes dy metodave kryesore: Metodës së Spin Off-it dhe metodës së Likuidimit që ne e quajmë Shitje të Aseteve.

Numri total i ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara deri më tani është 329. Ndërsa janë edhe përafërsisht 270 ndërmarrje shoqërore që kanë mbetur për t'u privatizuar. ndërmarrje të reja janë krijuar përmes shitjes së NSH-ve ku nga një NSH janë krijuar një ose më shumë kompani të reja varësisht nga rentabiliteti i tyre. Gjatë gjithë procesit të privatizimit janë krijuar gjithsej 769 ndërmarrje të reja. Numri i investitorëve të regjistruar në databazën e Agjencisë është rreth 15,000 ndërsa aktualisht numri i investitorëve t para-kualifikuar është rreth 4,000. Agjenica sipas planit të saj të punës kishte planifikuar 7 (shtatë) Shtitje të Aseteve ne Likuidim për vitin 2015, por që në mungesë të Bordit nuk ka qenë e mundur që ky plan të realizohet. Në vitin 2014, gjithsej 145 kontrata janë nënshkruar dhe dorëzuar blerësve (102 nga të cilat ishin likuidime dhe 24 me procedurën spin-off).

Ndërsa zhvillimet kryesore sa i përket rezultateve financiare të fondeve në mirëbesim janë të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Përmbledhja e rezultateve financiare të fondeve në mirëbesim: Hyrjet kryesore gjatë tërë procesit

Të hyrat nga shitjet e asetëve (ndërmarrjet e reja dhe shitja e asetëve në likuidim)	661,903,143
Të hyrat nga komercializimi	5,020,552
Të hyrat nga qiraja e rregulltë	12,933,158
Fondet tjera në mirëbesim të NSH-ve (para likuidimit)	8,071,945
Të hyrat nga interesi në bankë (prej të cilave nga depozitimet kohore janë gjeneruar 7,2 milion)	34,845,282
Numri i transakcioneve hyrëse	177,346
Numri i transakcioneve dalëse	72,941
Gjithsej	250,287
Gjendja më 31 korrik 2015	
Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549
Fondi rezervë	1,534,217
Tarifa administrative	11,277,137
Gjendja e fondeve në bankë	550,144,225.43

Sa i përket shpërndarjes së 20% të të hyrave punëtorëve nga shitja e NSH-ve përmes privatizimit ose likuidimit, të dhënat kryesore janë prezantuar në tabelën më poshtë.

Shpërndarja e 20%, në EUR

Shpërndarja që nga fillimi i procesit	Vlera
Shuma e shpërndarjes së 20%-it për punëtorët e NSH-ve	96,216,840
Lista finale e punëtorëve	314
Vendime të formës së prerë nga Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme të Kosovës	92
Listat në pritje për shqyrtim nga gjykata	217
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat	43,000
Shuma e fondeve të gatshme për shpërndarje punëtorëve pas shqyrtimit tw ankesave nga gjykata	24,932,761

Hyrja dhe dalja e bizneseve nga tregu

Ligji për Shoqëritë Tregtare nr. 02/L-123 përcakton llojet e organizatave dhe llojin e aktiviteteve ekonomike që mund të zhvillojnë. Ai gjithashtu përcakton kushtet ligjore lidhur me të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, menaxherëve, përfaqësuesit ligjor të organizatave tregtare dhe palët e interesuara, që shërbejnë për të facilituar funksionimin dhe mbylljen në mënyrë të duhur dhe efektive.

Sa i përket **kornizës institucionale**, institucioni bartës për këtë është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. ARBK kryen regjistrimin e të gjitha organizatave të biznesit vendore dhe të huaja në përputhje me Ligjin nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit në fuqi për Shoqëritë Tregtare. Agjencia siguron informacion dhe bashkëpunon me Zyrën e Statistikave, Administratën Tatimore, Doganat, Shërbimin Policor dhe agjencive të tjera. Më tej, ajo regjistron të gjitha bizneset e reja, modifikimet e të dhënave të biznesit, mbylljes së bizneseve, lëshimin e certifikatës së regjistrimit me numër fiskal, certifikatën e tatimit mbi vlerën e shtuar, certifikatën e import-eksportit, si dhe ofron informata dhe formularët falas.

Ndërsa lidhur me **kapacitetet administrative** të ARBK, agjencia përbëhen nga 14 punëtorë, të organizuar në 1 drejtori (për çështje administrative dhe regjistrimit të biznesit) dhe 3 sektorë (Aprovuesit, Përpunimi i të dhënave dhe kolaterali). Përveç kësaj, ajo ka hapur 28 qendra komunale afariste (një stop shop).

Sa i përket politikave dhe reformave në këtë fushë, që nga viti 2013, Kosova ka bërë vazhdimisht përparim në lehtësimin e fillimit të një biznesi dhe lehtësimin e ofritit të shërbimeve përmes konceptit 'one stop shop'. Procedurat për hapjen e biznesit janë thjeshtësuar dhe shkurtuar dhe kjo mund të bëhet ose në cilëndo qendër komunale të ARBK-së varësisht nga lokacioni i shtrimit të aktivitetit të entitetit aplikues. Për bizneset individuale dhe ortakëritë, regjistrimi bëhet brenda 1 (një) dite. Ndërsa për shoqëritë aksionare dhe ato me përgjegjësi të kufizuar (L.L.C) regjistrimi bëhet brenda 2-3 ditëve.

Në dy-tre vitet e fundit, si rezultat i reformës së të bërit biznes Kosova kishte përparuar edhe në vlerësimin e Bankës Botërore të "Të Bërit Biznes". Kjo ka ndryshuar në raportin e fundit të vitit 2016 ku në vlerësimin e përgjithshëm vendi ka rënë për dy vende. Rënie të madhe ka pasur në kriterin për nisjen e biznesit (për 7 vende) dhe në furnizimin me energji elektrike (6 vende). Ndërsa Kosova renditet mjaft dobët sa i përket insolvencës (në vendin e 163). Sidoqoftë, vështirësitë kryesore për bizneset mbeten në qasjen në financa, zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen efektive të kontesteve në sistemin gjyqësor, furnizimin me energji elektrike dhe procedurave të bankrotimit dhe insolvencës. Një nga çështjet që pengon zhvillimin e biznesit është edhe shkalla e informalitetit në ekonomi (shih për shembull Raportin për Vëndin të Komisionit Evropian. Për më shumë rreth reformave në këtë fushë, shih Kapitullin 20 për Ndërmarrjet dhe industrinë.

Në vitin 2014, numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte i ngjashëm me numrin e ndërmarrjeve të reja të regjistruara në vitin 2013. Numri total i ndërmarrjeve të reja është rritur me rreth 1%, nga 9,484 në vitin 2013 në 9,616 në vitin 2014. Numri i ndërmarrjeve të reja gjatë katër viteve të fundit është rritur shumë ndjeshëm, me rreth 24%. Në këtë periudhë kohore, rrjeti i regjistrimit të biznesit one-stop ka rritur numrin e zyrave dhe cilësinë e shërbimeve për të rritur disponueshmërinë e shërbimit. Por brenda këtyre të dhënave ka pasur edhe raste kur njerëzit regjistrojnë një biznes si pjesë e kredisë, grantit, dhe aplikacioneve për viza por në të vertetë ato biznese nuk janë operuese.

Numri i bizneseve të regjistruara dhe të mbyllura 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014
Të regjistruara	7,747	7,909	9,655	9,485	9,616
Të mbyllura	1,427	947	1,118	1,515	1,663

Burimi: ARBK

Numri i bizneseve të regjistruara si të mbyllur është ngritur vazhdimisht duke pësuar një rritje prej 16% nga viti 2010 deri 2014. Megjithatë, ky numër është shumë nën-raportuar pasi që mbyllja e biznesit është

një detyrë administrative dhe kostot e këtij transaksioni janë midis 5-10 Euro varësisht nga lloji i korporatës.

Numri i bizneseve të regjistruara sipas madhësisë 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014
Mikro (1-9)	7,677	7,839	9,549	9,418	9,521
Të vogla (10-49)	61	63	92	59	84
Të mesme (50-249)	6	7	12	7	6
Të mëdha (250+)	2	0	2	1	2
Totali	7,746	7,909	9,655	9,485	9,613

Burimi: ABRK

Në anën tjetër, brenda periudhës 2010-2014, numri më i vogël i bizneseve të mbyllura ka qenë në vitin 2011 dhe ai më i larti në vitin 2014. Sidoqoftë, nëse krahasojmë vitin 2014 me atë paraprak, ky indikator ka qenë 10% më i ulët në 2014. Në tërësi, oscilimi me magnitudë më të madhe për regjistrim dhe hapje të bizneseve ka ndodhur në vitin 2013 ku kishte një zvogëlim 2% dhe rritje 36% respektivisht.

Bizneset mikro përbëjnë rreth 99% të bizneseve të reja të regjistruara përgjatë gjithë periudhës 2010-2014 (shih tabelën më lartë).

Sistemi ligjor

Mjedisi afarist, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative

Sistemi gjyqësor është faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe luan rol kyç në lehtësimin e investimeve, mbrojtjen adekuate të të drejtave kontraktuale të bizneseve dhe rritjen e sektorit privat. Ky sistem **është i rregulluar** me Kushtetuen e Republikës së Kosovës, Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ligji për gjykatat ka përcaktuar 7 gjykata Themelore të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata Themelore janë të ndara në regjione dhe atë si vijon: Gjykata Themelore e Prishtinës, Gjykata Themelore e Gjilanit, Gjykata Themelore e Prizrenit, Gjykata Themelore në Gjakovë, Gjykata Themelore e Pejës, Gjykata Themelore e Ferizajit, dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës.

Organizimin e Brendshëm të Gjykatës Themelore ligji për gjykatat ka përcaktuar si ne vijim:

- Departamenti për Çështjet Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;
- Departamenti i Përgjithshëm që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore;
- Departamenti për të Mitur, që vepron në kuadër të gjykatave themelore.

Ligji për gjykatat ka përcaktuar Gjykatën e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, me jurisdikcion territorial në gjithë Republikën e Kosovës e cila ka në strukturën e saj orgnaizative edhe Departmanetin për Çështje Ekonomike. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë. Gjykata Supreme përfshin kolegjin e apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme. Kushtetuta dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës parashohin që propozimi të Presidenti për emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve është kompetencë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në bazë të ligjit, organizimi, mbikëqyrja dhe funksionimi i duhur i gjykatave është kompetencë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në sistemin gjyqësor janë duke punuar 350 gjyqtarë.

Në lidhje me të **drejtën e pronës**, neni 119 pika 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetve ekonomike dhe sigurinë e pronës publike dhe private. Me këtë, forma e pronës publike dhe pronës private njihet si kategori kushtetuese. Me Kushtetutë garantohet e drejta e pronësise, dhe ofrohen garanci të cilat përjashtojnë mundësinë e

privimit në mënyrë arbitrare nga prona. Pasi që llojet e pronës janë përcaktuar me Kushtetutë, rregulimi i përmbajtjes së tyre i delegohet legjislativit. Legjislativi ka nxjerrë Ligjin nr. 03/1-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, i cili rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore si dhe rregullon pronësinë dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit, ndërsa ende nuk ka një ligj që rregullon pronën publike në përgjithësi.

Në kuadër të **reformës së sistemit të drejtësisë**, për të siguruar pavarësinë, paanshmërinë, transparencën, dhe për të ngritur efikasitetin e gjyqësorit, Qeveria e Kosovës miratoi katër ligjet e pakos së gjyqësorit (Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor).

Në Ligjin nr. 05/L -032 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-199 për Gjykatat janë paraparë edhe dispozitat ligjore për themelimin e **Divizionit për kontestet lidhur me investitorët e huaj**, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Krijimi i këtij divizioni ka për qëllim vazhdimin e reformës ligjore duke përmirësuar infrastrukturën ligjore me qëllim të lehtësimit të procedurave gjyqësore për investitorët e huaj.

Gjithashtu për të krijuar transparencë më të madhe në sistemin gjyqësor me anë të këtij ligji gjykatat janë të obliguara të publikojnë aktgjykimet e plotfuqishme në faqe të tyre zyrtare të internetit në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimin në pajtim me legjislacionin në fuqi. Pavarësia e gjyqësorit u siguroa tutje, me dispozitat ligjore të cilat i japin të drejtë Këshillave (Gjyqësor dhe Prokurorial), të cilët tani propozojnë buxhetin e tyre dhe e dërgojnë direkt atë për miratim në Kuvend.

Korniza ligjore për **fushën e ndërmjetësimit** rregullohet me Ligjin nr. 03/l-057 për Ndërmjetësim. Nga praktika e deritanishme zbatimi i formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ka rezultuar shumë i mirë. Konkretisht nga të dhënat statistikore që posedon Komisioni për Ndërmjetësim të cilat përcillen vazhdimisht nga Qendrat, për periudhën 2012-2015 janë:

- Rastet e referuara: 2,474
- Të zgjidhura: 1,797
- Të pa zgjidhura: 355.

Mirëpo, nga analizat dhe rekomandimet e sugjeruara në praktikë është konkluduar se duhet të ketë një koordinim më i mirë në mes të qendrës së ndërmjetësimit si dhe Gjykatës apo Prokurorisë dhe të jetë e sqaruar më tepër roli dhe rëndësia e qendrës së ndërmjetësimit, tarifatat e administrimit të rastit të ndërmjetësuar në një qendër të ndërmjetësimit, dhe mbulimi i kostos financiare nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Një ndër inovacionet e **procedurës përmbartimore**, dhe e cila ndikon në zbatueshmërinë e vendimeve, u arrit me anë të ligjit 04/L-139 për Procedurën përmbartimore, i cili zhvendosi përmbartimin prej gjykatave tek përmbartuesit privat, të cilët emërohen nga Ministria e Drejtësisë për kryerjen e autorizimeve publike të besuara, në përjashtim të kompetencës për të vendosur në procedurën e përmbartimit dhe të zbatoj përmbartimin në të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.

Në zyrat përmbartuese që nga fillimi e deri kah fundi i qershorit 2015 janë dorëzuar përafërsisht mbi 18,000 lëndë. Nga to 3,500 lëndë janë të kryera nga të cilat debitorëve iu janë kthyer mbi 25 milion euro kompanive dhe qytetarëve të Kosovës.

Në fillim problem me të madh ka shkaktuar titulli përmbartues privat, sepse debitorët nuk e trajtonin si institucion të themeluar në bazë të ligjit. Vendosja sipas prapësimit po e zvarrit po ashtu procedurën sepse sipas ligjit nuk ka një afat në bazë të cilit gjykatat duhet të vendosin në lidhje me prapësimin e debitorit. Sipas ligjit prapësimi duhet të dorëzohet në gjykatë, dhe kjo çështje është rregulluar me një qarkore të Gjykatës Supreme me të cilën është rregulluar dorëzimi i prapësimeve në zyrat përmbartuese.

Ndërsa sa i përket efikasitetit të sistemit gjyqësor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka deleguar përgjegjësitë nga Sekretariti i Këshillit Gjyqësor në gjykata në fushat e personelit, financave, prokurimit dhe logjistikës me qëllimin e rritjes së efikasitetit të sistemit. Raportet statistikore per gjashtemujorin e pare te 2015 lidhur me rastet civile pasqyrojne kete gjendje:

- Rastet e pazgjidhura ne fillim te vitit 43.187 lëndë,
- Lëndet të pranuar në pune 6.993 lëndë,
- Lëndë të zgjidhura 7.568 lëndë,
- Lëndë të pazgjidhura në fund 42.612 lëndë.

Raportet statistikore per gjashtemujorin e pare te 2015 lidhur me rastet ekonomike pasqyrojne kete gjendje:

- Rastet e pazgjidhura ne fillim te vitit 885 lëndë,
- Lëndët të pranuar në pune 265 lëndë,
- Lëndë të zgjidhura 129 lëndë,
- Lëndë të pazgjidhura në fund 1.021 lëndë

Agjencia e Pronës është themeluar si një agjenci e pavarur me mandat për pranimin, regjistrimin dhe zgjidhjen e kontesteve pronësore për pronat e paluajtshme private përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale (që burojnë nga periudha e luftës 1998-1999). Vendimet e marra nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Agjencisë mund të apelohe vetëm në Gjykatën Supreme të Kosovës. Agjencia që nga themelimi i saj ka pranuar 42.749 kërkesa pronësore dhe ka lëshuar vendime për 42.116 kërkesa pronësore deri më tani. Deri në fund të muajit prill të 2015, Agjencia kishte implementuar 33.113 vendime.

Sfidat kryesore të sistemit gjyqësor në Kosovë bazuar edhe në raportet ndërkombëtare përfshirë Raportin e Progresit konsistojnë në implementimin efektiv të kornizës gjyqësore, forcimin e kapaciteteve për funksionim efektiv dhe zgjidhjen e numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e ambientit për të bërë biznes.

Sa i përket **të drejtës së regjistrimit të pronës përmes sistemit kadastral**, regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme rregullohet me legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji mbi Hipotekat nr. 2002-4;
- Ligji mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nr. 2002-5;
- Ligji për ndryshime dhe plotesime të Ligjit për kadastrin nr. 02 L-96;
- Ligji Nr 04_L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2002 5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme;
- Ligji për Kadastër nr. 04-L/013;
- Ligji nr. 04/L-071 për sistemin e adresave;
- Ligji për Kadastrin Nr 2003/25 (ligji paraparak); dhe
- Ligji mbi Plotesimet dhe ndryshimet e Ligjit te RDPP 2003-13.

Ndërsa legjislacioni imlementues përbëhet nga rreth 15 udhëzime administrative. Të drejtat pronësore regjistrohen duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr 04/L-009 për Regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme, sipas të cilit regjistrohen në bazë të:

- vendimit të plotfuqishëm të gjykatës;
- vendimit të organit administrativ shtetëror;
- kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetentë;
- vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia kosovare e privatizimit;
- vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit;
- vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe
- dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

Regjistri i kadastrave mbahet në formë elektronike në nivel vendi, ndërsa i gjithë dokumentacioni kadastral mbahet në nivel të komunave si dhe shërbimet qytetarëve iu ofron në afërsi me vendbanimin d.m.th. në secilën komunë.

Të drejtat e pronave të paluajtshme përfshijnë pronësinë, hipotekat, servitutet, të drejtat e shfrytëzimit të pronave komunale, publike, shoqërore dhe pronave shtetërore; dhe barrët dhe ngarkesat pronësore.

Agjencia Kadastrale Kosovës (AKK) është institucion publik për regjistrimin, mbajtjen dhe përditësimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën e paluajtshme. Agjencia është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe për GIS. Po ashtu është autoriteti qendror për infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore. Agjencia është përgjegjëse për certifikimin e personave në Zyrat Komunale Kadastrale dhe licencimin e kompanive dhe gjeodetëve për kryerjen e matjeve kadastrale. Organizimi është në nivel vendi, dhe disa të drejta dhe detyrime janë të deleguara në bazë të ligjit për kadastër në pushtetin lokal, përkatësisht tek Zyrat Komunale Kadastrale. Aktivitetet e zyrove komunale janë të lidhura dhe pasqyrohen në bazën qendrore të të dhënave të Agjencisë.

Në vitet e fundit sistemi kadastral është konsoliduar dhe zhvilluar në shumë aspekte përfshirë projektet kryesore për rindërtimin e informacioni kadastral, regjistrimin e pronave të paluajtshme në 50 zona kadastrave në gjithë vendin me asistencë nga Banka Botërore, zhvillimin e databazës, regjistrimin e ndërtesave (që nuk ka ekzistuar më parë), sistemin e adresave (nga viti 2014 ka filluar të zbatohet edhe në nivel lokal), përpilimin e hartës topografike përfshirë hartat topografike digjitale, rëlevimet aerofotografike (janë bërë 4 rëlevime nga viti 2001, i fundit në 2013) etj. Po ashtu me asistencë të qeverisë Norvegjeze është ndërtuar gjeoportali - një web portal i cili paraqet informata gjeografike nga burime të ndryshme në mënyrë të unifikuar. Qëllimi kryesor i tij është ofrimi i shërbimeve online duke mundësuar qasje në të dhëna hapësinore për të interesuarit. Këto zhvillime të sistemit kadastral kontribuojnë në lehtësimin e ambientit biznesor duke ofruar shërbime më të mira për regjistrimin dhe menaxhimin e pronës, planifikimin hapësinor, ndihmesë në sistemin tatimor dhe në dizajnimin e politikave publike në shumë fusha. Gjithashtu kjo do t'i mundësojë sistemit gjyqësor zbatim më efikas të parimit të ligjshmërisë dhe të drejtave pronësore.

Për të rritur kapacitetet dhe menaxhimin efektiv të institucioneve publike të sistemit kadastral, do të bëhet organizimi vertikal i sistemit. Kjo e bën më të lehtë të menaxhohet sistemi i kadastrit të pronës së paluajtshme si dhe stafi i cili bënë regjistrimin, mbajtjen dhe përditësimin e të dhënave, pasi që do të organizohet nga një qendër.

Regjistrimi i të drejtave pronësore bëhet në Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) e cila evidencë monitorohet në bazë ditore, ndërsa publikohet çdo ditë web faqe te AKK-së¹⁷. Afati ligjor për aplikimin tek zyrat kadastrave për transaksionet e shitblerjes, trashëgimisë, pengut është 30 ditë. Por bazuar në të dhënat e fundit të zyrove kadastrave ky proces kryhet mesatarisht për 10 ditë.

Kosova renditet në vendin e 32-të për regjistrimin e pronës në Raportin e Bankës Botërore "Të Bërit Biznes" 2016¹⁸, që është rangimi më i lartë nga të gjitha vendet në regjion. Koha që kërkohet për regjistrim të pronës së paluajtshme është 27 ditë që është vetëm pesë ditë më shumë sesa në regjionin e Evropës dhe Azisë Qendrore (sipas Raportit Të Bërit Biznes 2016 të Bankës Botërore). Ndërsa kërkohen vetëm 6 procedura për regjistrim të pronës, dallim relativisht jo i madh në krahasim me numrin e procedurave në gjithë regjionin e Evropës dhe Azisë Qendrore (5.4). Gjerë me tani gjendja e regjistrimit është kjo:

- Numri i përgjithshëm i parcelave në territorin e Kosovës, gjerë me 05.08.2015 është 2.069.438;
- Numri i përgjithshëm i ndërtesave të regjistruara me 05.08.2015, është 18.104 njësi, ndërsa numri i përgjithshëm i pjesëve të ndërtesave është 34.549 njësi;
- Numri total i pronarëve të drejtave të pronës së paluajtshme të regjistruar deri me 05.08.2015 është 492.191 persona, nga të cilët 73.9% meshkuj, 15.4 femra dhe 10.7% subjekte juridike.

Sektori financiar

¹⁷ Të dhënat e përditësuara gjenden në: <http://akk-statistics.rks-gov.net/>

¹⁸ <http://www.doingbusiness.org/data/exploreconomies/kosovo/#registering-property>.

Kjo pjesë do të fokusohet kryesisht në stabilitetin dhe zhvillimin e sektorit financiar nga perspektiva e strukturës, madhësisë dhe efikasitetit të ndërmjetësimit financiar. Aspektet e natyrës legislative dhe kërkesat që dalin nga MSA do të elaborohen më gjerësisht në kapitujt tjerë relevant si kapitulli për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe ai për shërbimet financiare.

Në Kosovë autoriteti i vetëm mbikëqyrës dhe rregullativ i institucioneve financiare është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në vijim: BQK) e themeluar me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Objektivi parësor i BQK-së është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar duke përfshirë një sistem të sigurt dhe efikas të pagesave. Ky objektivi i BQK-së është i lidhur me detyrat dhe përgjegjësitëe saj si përgjegjëse kryesore për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës, siç janë bankat, institucionet mikro-financiare, institucionet financiare jo-bankare, kompanitë e sigurimit dhe fondet pensionale. Që nga themelimi i saj ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe praktika mbikëqyrëse të bazuara në standardet më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në funksion të stabilitetit financiar në Kosovë, kryesisht të bazuara në direktivat e BE-së dhe standardet e nxjerra nga mekanizmat ndërkombëtar të njohur për përgatitjen dhe harmonizimin e standardeve në fushën e mbikëqyrjes së bankave, sigurimeve dhe pensioneve, sic janë BCBS, IAIS dhe IOPS.

Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar me 10 banka, sektori i sigurimeve me 15 kompani sigurimesh, fondet pensionale (2 fonde), sektori mikro-financiar me 18 IMF (13 nga të cilat janë në pronësi të huaj) dhe tregu i letrave me vlerë. Sistemi financiar ka vazhduar të zgjerohet në mënyrë të vazhdueshme duke arritur shkallën e ndërmjetësimit financiar në 81.2% e BPV-së në vitin 2015¹⁹. Bankat janë ndërmjetësuesit financiar kryesor me rreth 69.3% të aseteve të sektorit financiar pasuar nga fondet pensionale dhe sektori i sigurimeve me 25.1% dhe 3% respektivisht. Për më shumë detaje rreth legjislacionit, aspekteve institucionale të sistemit financiar, shihni kapitujt për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe shërbimet financiare.

Në kuadër të BQK-së, si përgjegjës ekskluziv për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, janë themeluar departamentet dhe divizionet përkatëse për mbikëqyrjen e institucioneve financiare, si në vijim: Departamenti për Mbikëqyrjen e Bankave, Departamenti për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Departamenti për Licencim dhe Standardizim, Divizioni për Mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë dhe Divizioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, të cilët janë të vendosura në pjesën e Mbikëqyrjes Financiare.

Aktualisht, stafi i sektorit të mbikëqyrjes së institucioneve financiare përbëhet nga gjithsej 57 zyrtar, ndër të cilët, 23 janë në kuadër të Mbikëqyrjes së Bankave, 15 në kuadër të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, 9 në kuadër të Licencimit dhe Standardizim, 5 në Mbikëqyrje të Pensioneve dhe Tregut të Letrave me Vlerë dhe 5 në divizionin për Parandalimit të Pastrimit të Parave - AML.

Në vazhdimësi është investuar në zhvillimin profesional të stafit, të cilët kanë marr pjesë në shumë trajnime të organizuara nga institucione të njohura ndërkombëtare për organizimin e trajnimeve në fushën e bankave, sigurimeve dhe pensioneve si Rezerva Shtetërore e SHBA-ve (Federal Reserve), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB), Joint Vienna Institute, FSI, Banka Qendrore Evropiane (ECB) dhe bankat qendrore të vendeve të BE-së, si Deutsche Bundesbank, Banque De France etj. Në zhvillimin e projekteve të rëndësishme, BQK ka bashkëpunuar dhe është mbështetur nga këshilltar të FMN-së, BB-së dhe Thesarit Ameirkan, por edhe nga institucione tjera ndërkombëtare.

Gjithashtu, me rritjen e volumit të punëve, kryesisht duke u bazuar në Planin Strategjik 2015-2019, ndërlidhur me harmonizimin e legjislacionit me Acquis të BE-së dhe kërkesat e parashikuara të MSA-së, BQK ka në fokus rritjen dhe avancimin e kapaciteteve përmes rekrutimit të stafit të ri dhe trajnimit të stafit ekzistues për specializime më të avancuara.

¹⁹ Bazuar në parashkimet preliminare për BPV të BQK-së.

Sa i përket **bashkëpunimit**, BQK ka marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet rregullative dhe mbikëqyrëse të vendeve tjera, kryesisht vendeve ku janë të themeluara institucionet amë të bankave dhe kompanive të sigurimit me kapital të huaj, që operojnë në Kosovë. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, BQK merr pjesë edhe në kolegje të organizuara nga mbikëqyrësit e bankave amë, si dhe në iniciativat rajonale dhe konferencat e organizuara ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes së bankave, sigurimeve dhe pensioneve. BQK së fundi është pjesë edhe e Iniciativës së Vjenës e cila është një nismë me karakter ndërkombëtar ku përveç vendeve të Bashkimit Evropian marrin pjesë edhe vendet e rajonit si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Qëllimi i kryesor i kësaj iniciative është avancimi i nivelit të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare.

Zhvillimet në tregun financiar

Sektori bankar është kryesisht i përbërë nga asetet me pronësi të huaj me rreth 90.4% të aseteve të bankave. Sektori ka një shkallë të lartë të koncentrimin i cili ka tendencë rënë në vitet e fundit. Në qershor të 2015, pjesëmarrja në treg e tri bankave më të mëdha ka rënë në 65.3% nga 67.3% (në qershor të 2014). Shprehur me Indeks in e Herfindahl-HirschmanIndex për asete, shkalla e koncentrimin të tregut ka rënë nga 1,847 pikë në sa ishte në mes të vitit 2014 në 1,792 pikë në qershor të 2015.

Indikatorët kryesorë të sektorit bankar 2011-2014

	2011	2012	2013	2014
Numri i bankave	8	9	9	10
Gjithsej Asetet	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.7
Gjithsej asetet/BPV	55.0%	55.9%	57.4%	57.7%
*Asetet likuide (def. i gjerë)/Asetet gjithsej (%)	31.3%	32.6%	36.6%	32.8%
Kapitali	252.8	270.7	277.8	323.0
Kapitali/BPV	5.3%	5.4%	5.2%	5.9%
Gjithsej depozitat	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5
Gjithsej depozitat/BPV	43.7%	45.1%	46.0%	46.0%
Norma mesatare e interesit në depozita	3.6%	3.7%	2.4%	1.1%
Gjithsej kreditë	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4
Gjithsej kreditë/BPV	35.3%	34.9%	33.9%	34.1%
Norma mesatare e interesit për kredi	13.9%	12.9%	11.1%	9.2%
Kreditë për ndërmarrjet	1,145.9	1,191.1	1,215.2	1,254.2
Kreditë për ekonomitë familjare	510.9	542.6	563.9	621.6
Diferenca mes interesit në kredi dhe depozita	10.3%	9.2%	8.7%	8.1%
Kreditë jo-performuese (%)	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%
Shkalla e adekuatshërisë së kapitalit	17.6%	14.2%	16.7%	17.8%
Kthimi në asete	1.4%	0.7%	0.9%	2.0%
Kthimi në ekuitet	14.9%	7.1%	9.4%	20.3%
*Udhëzimi për kompilim i FMN: Asetet likuide (gjerë): Asetet likuide bazë + letrat me vlerë dhe asetet e tregtueshme deri në tre muaj; Gjithsej asetet: Gjithsej asetet (pa Dispozita) janë marrë për bazë				

Aktiviteti kreditues është rritur në vazhdimësi. Në qershor 2015 kreditë totale arritën në 2.01 miliard euro dhe patën një rritje vjetore prej 6.1%. Kreditë për ndërmarrjet kanë pjesëmarrjen më të madhe në portfolion e kredive me rreth 66.7%, ndërsa pjesa tjetër prej 33.3% përbëhet nga kreditë për ekonomitë familjare. Depozitat arritën vlerën 2.57 miliard euro në qershor të 2015 nga 2.42 miliard euro sa ishin në qershor të 2014, duke shënuar një rritje prej 6.3% (në qershor të 2014 rritja vjetore e depozitave ishte 10%). Rritja e ngadalësuar e depozitave i atribuohet kryesisht rënjes së dukshme të normës së kamatës që e ka karakterizuar sektorin bankar në këtë periudhë. Struktura e depozitave dominohet nga depozitat e ekonomive familjare me pjesëmarrje prej 74% në totalin e depozitave.

Likuiditeti i sektorit bankar vazhdon të jetë i kënaqshëm. Pjesëmarrja e asetet e përgjithshme likuide në asetet totale ishte 28.8% në qershor të 2015 (32.4% në qershor të 2014). Raporti kredi/depozita ra nga 78.1% në qershor të 2014 në 77.9% në qershor të 2015. Sektori bankar është mirë i kapitalizuar me nivel të kapitalizimit që në vazhdimësi tejkalon kërkesat minimale rregullatore. Në qershor të 2015, niveli i kapitalizimit është forcuar më tej me rritjen e normës së adekuatshërisë së kapitalit nga 17.4% (në qershor të 2014) në 19.0% në qershor të 2015. Kreditë jo-performuese ranë në 7.2% në qershor të 2015 (nga

8.2% sa ishin në qershor të 2014). Ato mbeten të mbuluara tejet mirë me Dispozita (rreth 119% ën qershor të 2015).

Dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe depozita u zvoglua në 6.8 pp (në qershor të 2015) nga 10.0pp në qershor të 2014. Norma mesatare e interesit në kredi ka vazhduar trendin rënës. Në qershor, norma mesatare e interesit në kredi ra në 7.6% ën qershor të 2015 nga 10.6% në qershor të 2014. Norma mesatare për ndërmarrjet ishte 7.4% në qershor 2015 (nga 10.5% në qershor të 2014), ndërsa për ekonomitë familjare, ajo ishte 8.2% në qershor të 2015 (10.8% në qershor 2014). Norma mesatare e interesit në depozita është rritur lehtë në qershor 2015 në 0.8% nga 0.6% sa ishte në qershor të 2014. Norma e interesit për depozitat e ndërmarrjeve ishte 1.0% në qershor 2015 (0.3% në qershor të 2014). Për depozitat e ekonomive familjare, norma mesatare e interesit në depozita ishte 0.8% (qershor 2015) krahasuar me 0.6% në qershor të 2014.

Sistemi bankar në qershor 2015 ka raportur profit prej 46.2 milion euro krahasuar me profitin prej 26.9 milion deri në qershor të 2014. Rritja e profitit të gjeneruar është kryesisht rezultat i zvoglimit të konsiderueshëm të shpenzimeve (shpenzimet e interesit të paguar për depozitat dhe shpenzimet për Dispozitat në humbjet e kredive).

Sektori mikrofinanciar mbetet kryesisht në pronësi të huaj ku rreth 92.3% të aseteve totale janë në pronësi të huaj. Në qershor të 2015, sektori kishte shkallë të koncentrimin prej 51.5%. Asetet totale të sektorit arritën në 116.3 milion euro (qershor 2015) duke shënuar një rritje vjetore prej 2.8%. Vlera e përgjithshme e kredive ka arritur në 77.9 milion euro në qershor të 2015 duke shënuar një rritje vjetore prej 2.8% (2.0% në qershor 2014). Rritja e kredive totale ishte rezultat i rritjes së kredive për ndërmarrjet, derisa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rënie. Aktiviteti i lizingut mikrofinanciar ka shënuar rritje vjetore prej 2.0% në qershor 2015 duke arritur vlerën prej 23 milion euro.

Deri në qershor të 2015, institucionet mikrofinanciare kanë shënuar profit prej 1.2 milion euro. Profiti erdhi si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi përderisa shpenzimet ranë kryesisht për shkak të reduktimit të Dispozitave në humbjet e kredive.

Sektori i sigurimeve karakterizohet me shkallë të ulët të pronësisë së jashtme (67.1% në mars 2015) dhe të koncentrimin të tregut (35.0% në mars 2015) në sistemin financiar. Një etreg operojnë 15 kompani të sigurimeve nga të cilat 10 janë me pronësi të huaj ndërsa 5 janë me pronësi vendore. Shumica prej tyre (12) ofrojnë shërbime jo-jetë, ndërsa tri ofrojnë shërbime jetë.

Asetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve shënuar rritje vjetore prej 11.5% duke arritur në 151.2 milion euro në qershor të 2015. Nga kjo, sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesëm më të madhe të aseteve të sektorit me 90.2%, ndërsa asetet e sigurimeve jetë përbëjnë 9.8%. Vlera e bruto primeve të shkruara deri në qershor arriti në 40.3 milion euro. Nga totali i bruto primeve, 97% janë sigurime jo-jetë, ndërsa primet e sigurimeve jetë janë vetëm 3.0%. Vlera totale e dëmeve të paguara deri në qershor 2015 arriti në 19.5 milionë euro, prej të cilave 12.3 milionë euro janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësisë ndaj palës së tretë. Deri në qershor 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 113.2 mijë euro të vitit paraprak. Thellimi i humbjes së sektorit reflekton kryesisht përkeqësimin e performancës financiare të një kompanie e cila me kërkesë të BQK-së është rikapitalizuar menjëherë me datën 1 korrik 2015. Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahas performancës pozitive financiare të sigurimit jetë. Deri në qershor 2015, sigurimi jo-jetë kishte humbje të theksuara prej 2.8 milionë euro (316.0 mijë euro në qershor 2014) krahas, sigurimi jetë i cili regjistroi profit në vlerë prej 236.3 mijë euro nga 429.2 mijë euro deri në qershor 2014.

Performanca financiare e sektorit ndikoi në përkeqësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përkeqësua në -3.6 përqind (-0.2% në vitin 2014) kurse ROAE në -10.2 përqind (-0.7% në vitin 2014).

Sa i përket numrit të institucioneve financiare në **fushën e pensioneve**, aktualisht në Kosovë janë dy fonde pensione, Fondi Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Struktura e aseteve të sektorit të pensioneve dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës që menaxhon me 99.5% të aseteve të përgjithshme dhe pjesa e mbetur prej 0.5% të aseteve që menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve. Asetet totale të sektorit në mars të 2015 arritën në 17.1 miliard euro duke shënuar një rritje vjetore prej 23.1%.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka vazhduar të rrisë asetet dhe kthimin pozitiv në investime edhe në muajt e parë të 2015. Në mars të 2015, vlera e aseteve totale të FKPK ka arritur vlerën 6.1 milion euro duke shënuar një rritje vjetore prej 10.6%. Kjo rritje i atribuohet kthimit në investime që në mars të 2015 arriti në 208.3 mijë euro.

Në fushën e tregut financiar, deri tani është zhvilluar vetëm tregu i borxhit të brendshëm, i rregulluar me Ligjin 04/L-175 mbi Borxhin Publik, në fuqi nga nëntori i vitit 2009 dhe me aktet nën ligjore, Rregullorja MF-BQK nr. 01/2014 për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës të nxjerra në vitin 2012 (amandamentuar me 2014).

Tregu i borxhit të brendshëm zhvillohet përmes emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, që funksionon me platformën elektronike të tregtimit të letrave me vlerë. Ky aktivitet realizohet në ankandet e letrave me vlerë dhe është i bazuar në sistemin e akterëve primar (bankave komerciale), me ç'rast personat fizik dhe juridik mund të marrin pjesë në treg përmes akterëve primar të cekur më lartë.

Emetimi i parë në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës është realizuar me 17 janar 2012 ku është emetuar një instrument me maturitet 3 muaj dhe është vazhduar me emetime 6 dhe 12 mujore. Përveç bonove të thesarit emetohen edhe obligacione me afat maturimi 2 dhe 3-vjeçare.

Masat prioritare afatshkurtra

- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike
- Implementimi i rregullës fiskale në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Marrëveshjen me FMN
- Krijimi i një mekanizmi për pagat e sektorit publik ku rritja e pagave do të jetë e lidhur me produktivitet (lidhja me rritjen nominale të BPV)
- Zbatimi i Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018
- Krijimi i bazës ligjore për falimentim-miratimi i ligjit për falimentim
- Privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore
- Zbatimi gradual i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për të gjitha bankat komerciale
- Reforma e prokurimit përfshirë prokurimin elektronik dhe zbatimin e prokurimit të centralizuar
- Zhvillimi i kornizës strategjike për të drejtat pronësore. Strategjia do të shërbejë si kornizë e reformave në këtë fushë për të zhvilluar kornizën ligjore të të drejtave pronësore, mundësuar zbatimin e drejtë dhe efektiv të këtyre të drejtave si dhe për të mbështetur politikat e orientuara drejt tregut dhe stimulimit të investimeve. Strategjia synon të krijojë një kornizë ligjore që definojnë qartë të drejtat pronësore përfshirë të drejtat e shitshme tokësore në harmoni me Dispozitat e MSA dhe acquis të BE-së. Analiza dhe objektivat e kësaj kornize strategjike do të shërbejnë si bazë për planifikimin e masave në vitet e ardhshme në fushën e të drejtave pronësore. (Strategjia pritet të aprovohet në fund të pjesës së parë të 2016).
- Miratimi i Projektligjit të integruar për Kadastër (K2 2016). Ky Projektligji do të përfshin dispozitat e ligjeve që gjerë me tani e kanë rregulluar regjistrimin e pronave si: për Kadastër (Ligji nr. 04/L-013 për kadastër), regjistrim të hipotekave (Ligji nr. 2002/4 për Hipotekat) dhe për regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme (Ligji nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, nxirren me 17 tetor 2002).Koncept dokumenti do të propozoj tri variante të organizimit vertikal të zyreve kadastrale komunale me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe vetëfinancimi si në vijim:
 - Organizim të shërbimit për kadastër në skemë vertikale, së bashku me vet-financim;
 - Organizim të shërbimit për kadastër në skemë vertikale, me financim nga Buxheti i Kosovës;

- Organizim të shërbimit për kadastrë në skemë vertikale, i financuar nga dy burime, nga tarifat e shërbimit dhe nga buxheti i Kosovës;
- Të vazhdohet me zhvillimin e databazës kadastrale.

Prioritetet afatmesme

- Qeveria do të vazhdojë me reformat që janë të rëndësishme në kontekst të stabilitetit makroekonomik dhe sektorit financiar përfshirë këtu edhe zbatimin e rregullës fiskale për deficitin buxhetor dhe ruajtjen e nivelit të shpenzimeve kapitale.
- Zbatimi gradual i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për të gjitha bankat komerciale
- Zëvendësimi i sistemit të IT-së SIGTAS për të rritur kapacitetet dhe modernizuar shërbimet tatimore
- Zbatimi i Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018
- Krijimin e fondit të investimeve dhe punësimit
- Privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore
- Reforma shëndetësore me fokus në kontributet obligative për sigurim shëndetësor
- Këshilli Gjyqësor do të ketë prioritet rritjen e numrit të gjyqtarëve më qëllim të zvoglimit të numrit të lëndëve në gjykata (KGJK)
- Organizimi vertikal i shërbimit të kadastrave i cili do të propozohet me projektligjet që pritet të aprovohen gjatë periudhës afatshkurtër, ku është domosdoshmëri funksionalizimi i shërbimit dhe përmbushje të parime themelore, në të cilat mbështet shërbimi i kadastrave
- Avancimi i vazhdueshëm i kornizës rregullative për sistemin bankar dhe të sigurimeve në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së.

2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit²⁰

Ky kapitull adreson pikën e dytë të kriterëve ekonomike të Kopenhagës për anëtarësim që ka të bëjë me kapacitetin e vendit për të përballuar dhe qenë konkurrues në tregun e BE-së. Faktorët kyq për të arritur këtë qëllim dhe në bazë të të cilëve Komisioni Evropian monitoron dhe vlerëson progresin drejt anëtarësimit përbëhet nga:

- zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe fizik në nivel të kënaqshëm ku vlerësohen aspekte të zhvillimit të arsimit, hulumtimeve dhe infrastrukturës,
- struktura adekuate sektoriale dhe e ndërmarrjeve, përfshirë kompozicionin sektorial, zhvillimin e NVM-ve dhe çështjet e ristrukturimit të ndërmarrjeve,
- shkalla e limituar e ndikimit të shtetit në konkurrueshmëri ku ndër të tjera shqyrtohet ndikimi i politikave dhe segmenteve të caktuara në ekonomi përfshirë këtu ndihmën shtetërore dhe mbështetja për NVM-të, dhe
- integrimi i mjaftueshmë tregtar i ekonomisë me vendet e BE-së.

Prioritetet e Qeverisë në vitet e fundit kanë qenë të orientuara në zhvillimin e kapitalit fizik përmes zhvillimit të infrastrukturës, zhvillimin e kapitalit njerëzor përmes reformave në arsim dhe masave për mbështetje të sektorit privat. Korniza strategjike që përcakton masat dhe objektivat prioritare përbehet nga Programi i Qeverisë 2015-2018, dhe dokumente strategjike sektoriale përfshirë Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2018, Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, Strategjinë Sektoriale të Punës etj. Zhvillimi i sektorëve me rëndësi ekonomike si energjisë, infrastrukturës, bujqësisë, telekomunikacionit dhe shoqërisë informative dhe turizmit janë objektiva prioritare. Ngjashëm si Programi i Qeverisë, ashtu edhe Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat synojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, politika sociale që rrisin mirëqenien, promovimin e investimeve (përfshirë fondin e investimeve), mbështetjen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, privatizimin dhe përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, në planin afatmesëm, përpjekjet do të intensifikohen në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ndërlihdjen më të mirë të edukimit me kërkesat e tregut.

Në kuadër të kornizës së bashkëpunimit regjional dhe procesit të integritit evropian, Republika e Kosovës është e angazhaur edhe në arritjen e objektivave të Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 dhe

²⁰ Ky kapitull nuk përmban matricë të masave afatshkurtra.

agjendës së ndërlidhjes infrastrukturore përfshirë edhe atë që tani quhet si 'Procesi i Berlinit'. Përmirësimi i konkurrueshmërisë, tregut të punës dhe politikave industriale, facilitimi i tregtisë midis vendeve të regjionit, përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore dhe tregu i energjisë janë disa nga objektivat kryesor në nivel regional. Republika e Kosovës ka integruar realizimin e tyre në kornizën e objektiveve strategjike dhe planet përkatëse të veprimit.

Sidoqoftë, përpjekjet duhet të vazhdojnë në adresimin e sfidave që lidhen me përmirësimin e kapacitetit konkurrues²¹ të vendit. Për këtë qëllim, vendi duhet të angazhohet në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ndërlidhjen me tregun e punës, sigurimin e furnizimit stabil me energji, zhvillimin infrastrukturor dhe eficiencën e energjisë, përmirësimin e ambientit të biznesit përfshirë edhe rritjen e kapacitetit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, luftimin e informalitetit në ekonomi, tërheqjen e investimeve të huaja dhe mbrojtjen e investitorëve për të mbështetur objektivat strategjike, zhvillimin e mekanizmave për ndihmën shtetërore dhe facilitimin e tregtisë.

Sa i përket **asistencës së jashtme**, në kuadër të qasjes sektoriale të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA II, është në fazën finale përgatitja e Dokumentit Planifikues Sektorial "Konkurrueshmëria" ku parashihet mbështetje afatmesme nga asistenca e Komisionit Evropian për realizimin e disa objektiveve specifike për të rritur konkurrueshmërinë dhe integruar ekonominë e vendit në ekonominë globale. Fushat ku është paraparë asistenca janë zhvillimi i sektorit privat, punësimi dhe edukimi.

Ngjashëm, procesi i Berlinit ofron edhe mbështetje financiare nga Komisioni Evropian dhe institucionet financiare ndërkombëtare për projektet e rëndësishme infrastrukturore. Më specifikisht, Kosova do të përfitojë mbështetje në infrastrukturën rrugore në kudër të korridorit Durrës-Prishtinë-Nish dhe në infrastrukturën hekurudhore në dy akset e saj kryesore. Për më shumë rreth instrumenteve tjera të asistencës dhe projektet konkrete, ju lutem shihni kapitujt respektiv në shtyllën e tretë të këtij programi.

Në vazhdim do të jepet një pasqyrë e zhvillimeve të secilit nga këta faktorë kyç të kriterit të dytë ekonomik të të qenit konkurrues.

Shtimi i kapitalit njerëzor dhe fizik

Kapitali njerëzor

Marrë parasysh se Kosova është një vend me më pak se dy milionë banorë, zhvillimi i kapitalit njerëzor është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe një shoqërie të dijes. Zhvillimi dhe transformimi i sistemi arsimor është orientuar në mënyrë që t'i shërbejë nevojave dhe kërkesave të shoqërisë në procesin e tranzicionit dhe zhvillimit ekonomik, të ofrojë mundësi të barabarta dhe të zhvillohet në harmoni me standardet evropiane. Reforma e arsimit bazohet në parimet e paanësisë, barazisë, cilësisë, të mësuarit gjatë gjithë jetës, efektshmërisë dhe eficiencës, autonomisë institucionale dhe sistemit të decentralizuar, dhe përgjegjshmërisë publike.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016 (PSAK) është dokumenti bazë sektorial që projektin zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë në kuadër të një kornize të mësimit gjatë gjithë jetës dhe të gjithëpërfshirjes në arsim. Ky plan bazohet në modelin e të nxënësve me nxënësin në qendër, në ofrimin e mundësive të barabarta dhe të arsimit cilësor për të gjithë. Nga këndvështrimi i strukturave arsimore, vend me rëndësi për organizimin e shërbimeve zë decentralizimi i udhëheqjes dhe organizimit të arsimit në nivel të komunave e të shkollës dhe zgjerimi i bazës financiare të arsimit. Ndërsa **Programi i Qeverisë 2015-2018**, definon se reforma strukturore në arsim fokusohet në rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim, sigurimin, garantimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit, menaxhimin e institucioneve të arsimit, integrimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, promovimin e shkencës dhe hulumtimeve, dhe financimin e arsimit dhe shkencës përmes rishikimit të formulës së financimit.

Në **arsimin parauniversitar** reforma është fokusuar në rishikimin e kurrikulës përkatësisht në zhvillimin e kurrikulës së re dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore në nivel të ministrisë, komunës dhe shkollës për zbatimin e kurrikulës së re. Kurrikula e re tashmë është pilotuar në zbatim në 92 shkolla. Sipas të

²¹ Sfidat janë të bazuara në Raportin e KE-së për Kosovën 2015.

dhënave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në Kosovë funksionojnë gjithsej 1153 institucione arsimore (778 shkolla amë dhe 375 paralele të ndara) të ndara në:

- Institucione parashkollore: 43 (36 amë, 7 paralele të ndara);
- Shkolla fillore: 985 (633 amë, 352 paralele të ndara);
- Shkolla të mesme: 119 (103 amë, 16 paralele të ndara);
- Shkolla speciale: 6 (të gjitha amë).

Numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në arsimin parauniversitar është 388.351, ndërsa numri i personelit të punësuar në këto institucione është 28.199 (prej tyre 23.480 mesimdhënes, personel administrativ 1.639 dhe personel ndihmes 3.080).

Numri i nxënësve sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë

Niveli	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Parashkollor	5370	2790	2580
Parafillor	20875	10739	10136
Fillor dhe i mesëm i ulët	275887	142460	133427
I mesëm i lartë	86219	45796	40432

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Të dhënat e përfshirjes në arsimin parauniversitar për periudhën 2010-2014 janë prezantuar në tabelën më poshtë.

Përfshirja në nivelet arsimore 2010-2014				
	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
Parashkollor (3-5 vjeç)	26.10%	27%	27.20%	26.70%
Parafillor (5 vjeç)	71.30%	74.00%	77.43%	75.62%
Fillor (6-)	98.10%	95.20%	98.56%	96.39%
Mesëm i ulët	96.40%	99.90%	98.61%	98.03%
Mesëm i lartë	91.80%	92.10%	88.67%	96.98%

Burimi: SMIA, MASHT


Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën ka pësuar rënje nga viti në vit. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët numri ka rënë nga 1485 (0,5%) sa ishte në vitin shkollor 2010/2011 në 354 (0,13%) në vitin shkollor 2013/2014. Situata është përmirësuar dhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë. Nga 354 (0,13%) sa ishte në vitin shkollor 2010/11 numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën në vitin shkollor 2013/2014 ka rënë në 354 (0,13%).

Kosova për herë të parë ka marrë pjesë në testin e PISA-s, ku kanë marrë pjesë 4830 nxënës të moshës 15 vjeçare.

Në **arsimin profesional**, qëllimi primar është përgatitja e kuadrove për tregun e punës. Ky nivel funksionon konform Ligjit të arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur dhe Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare. Përveç shkollave profesionale janë ngritur 4 qendra të Kompetencës. Sistemi i paraparë me legjislacionin në fuqi për Arsim dhe Aftësim Profesional 3+1+1 është në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Janë hartuar 142 planprograme mësimore të shtrirë në 17 fusha-sektor dhe 29 standarde të profesionit. Gjithashtu janë hartuar edhe udhëzuesi për shkollat profesionale dhe udhëzuesi për punëdhënësit dhe draft Strategjia për edukim dhe orientim gjithëpërfshirës në karrierë. Është themeluar dhe funksionalizuar Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të të Rriturve e cila synon të zhvillojë sistemin e arsimit profesional, kualifikime të bazuar në kompetenca të bazuar edhe në nevojat e tregut dhe të krijojë sistem të sigurimit të cilësisë. Agjencia nën ombrelën e vet ka edhe qendrat e kompetencës.

Për të avancuar menaxhimin e cilësisë në **arsimin parauniversitar**, përpjekjet janë fokusuar në ngritjen e cilësisë së brendshme, zbatimin e mekanizmave për vlerësim të cilësisë së jashtme dhe ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit.

Arsimi i lartë ofron mundësi studimi për të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi (nacional, racor, fetar, gjinor). Tanimë funksionojnë 6 universitete publike brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe 25 kolegje private. Secili nga këto institucione të arsimit të lartë qofshin publike apo private ofrojnë programe studimi të akredituara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës. Nuk ka kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë.



Brenda Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë funksionon edhe qendra NARIC, e cila bën barasvlerën e diplomave të arsimit të lartë të fituara jashtë Kosovës.

Kosova zyrtarisht nuk i është bashkuar procesit të Bolonjës por aplikimi për pranim formal është dorëzuar në vitin 2014. Baza ligjore harmonizon praktikat aktuale arsimore me prioritetet e deklaratave të Grupit të Bolonjës, sidomos në lidhje me harmonizimin e dispozitave të caktuara të ligjit me Ligjin dhe Kornizën Kombëtare për Kualifikime (No. 03/L-060) dhe lehtësimin të njohjes së mësimin paraprak dhe kualifikimeve të fituara në vendet tjera përmes qendrës NARIC.

Agjencia e Akreditimit të Kosovës bën vlerësimin e jashtëm të insitucioneve dhe programeve. Në vitin 2014 numri i përgjigjshëm i programeve të akredituara ka arritur në 573. Shumica e programeve janë të nivelit baqelor dhe master dhe 29 programe të doktratës të Universitetit të Prishtinës. Poashtu, të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit të lartë kanë Zyra të brendshme për sigurim të cilësisë dhe zyrtar për sigurim të cilësisë së mbrendshme.

Sa i përket mekanizmave të jashtëm për sigurim të cilësisë, në vitin 2014 është konfirmuar anëtarësimi i plotë i Kosovës në ENQA (Rrjetin Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë). Kosova zbaton Udhëzimet Standarde të Cilësisë dhe ka adoptuar praktikat e zbatueshme në Zonën Evropianë të Arsimit të Lartë.

Fusha e hulumtimeve shkencore ende mbetet e limituar. Mbështjeja për hulumtime konsiston në përkrahjen financiare përmes skemës së mobilitetit, dhe botimeve dhe publikimeve shkencore.

Sa i përket zhvillimeve në tregun e punës, pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës janë në moshë pune (15-64 vjeç). Në vitin 2011, 28% e popullsisë ishte më e re se 28 vjet dhe mosha mesatare e popullsisë ishte 30 vjet. Për shkak se popullsia e Kosovës është aq e re, popullsia e moshës së punës pritet të rritet me shpejtësi gjatë dekadës së ardhshme.

Nga ata në moshë pune, 58.4% nuk janë ekonomikisht aktiv, që do të thotë se nuk janë të punësuar dhe nuk kanë kërkuar punë në mënyrë aktive në katër javët e fundit dhe ose nuk janë në dispozicion për të filluar punën brenda dy javësh. Nga 41.6% të popullsisë që është ekonomikisht aktive, 35.3% (176,743 persona) janë të papunë. Kjo nënkupton se 64.7% (323.508) të personave ekonomikisht aktivë janë të

punësuar, që i bie se rsaporti punësim-popullësi (shkalla e punësimit) është 26.9%. Nga 58.4% e popullsisë në moshë pune që është joaktiv, 18.2% (128,400 njerëz) nuk kërkojnë punë, sepse besuan se nuk kishte punë në dispozicion. Punëtorët e dekurajuar përbënin 10.7% të popullsisë në moshë pune, me nivele të ngjashme për femrat dhe meshkujt.

Ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në të gjithë tregun e punës. Përafërsisht një në pesë femra (21.4%) të moshës së punës janë aktive në tregun e punës, në krahasim me tre të pestat (61.8%) e meshkujve të popullsisë në moshë pune. Ndër ata që janë në fuqinë punëtore, papunësia është shumë më e lartë për femrat sesa për meshkujt (41.6% në krahasim me 33.1%). Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 12.5%, krahasuar me 41.3% për meshkujt. Shkalla ekstremisht e ulët e punësimit të femrave rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë. Përgjegjësitë familjare ishin arsyeja kryesore për pasivitetin e femrave në tregun e punës (38.8% të të anketuarve femra kanë dhënë këtë arsye).

Papunësia e të rinjve është shumë e lartë në Kosovë. Në vitin 2014, kishte pothuajse dy herë më shumë gjasa që të rinjtë të jenë të papunë në krahasim me të rriturit. Në mesin e atyre të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 61.0% ishin të papunë. Papunësia është më e lartë në mesin e femrave të reja (71.7%) sesa meshkujt e rinj (56.2%). Pothuajse një e treta (30.2%) e grupmoshës 15 - 24 vjeç nuk ishin në arsim, punësim ose trajnim.

Vetëm 28.4% e të punësuarve kishin një kontratë të përhershme për punën e tyre kryesore, ndërsa 71.6% kishin kontrata të përkohshme, pa ndonjë dallim të madh mes dy gjinive. Diku 96.3% e respondentëve me kontrata të përkohshme raportuan se nuk kishin pasur në dispozicion asnjë lloj tjetër të kontratës. Paga mesatare sillej në mes € 300 deri 400 € në muaj.²²

Kapitali fizik

Në përgjithësi, investimet private kanë pasur një rënie në vitet 2012-2013, ndërsa në pjesën tjetër të periudhës 2011-2015 kanë ruajtur një nivel pak a shumë konstant. Në kontrast, investimet publike janë rritur gradualisht në periudhën 2011-2013 në masë të madhe edhe për shkak të investimeve në infrastrukturë, dhe kanë pësuar një rënie në dy vitet e fundit (që lidhet me përfundimin e projekteve të mëdha, p.sh autostradës Prishtinë-Vërmicë).

Investimet private dhe publike 2011-2015 (Burimi: KASH)

Pershkrimi	2011	2012	2013	2014 Vler.	2015 Proj.
Investimet Private	1,003	837	942	1,074	1,151
Investimet Publike	528	550	529	411	436

Vërejtje: Te dhënat për vitin 2014 janë vlerësim ndërsa për qëllime të parashikimit supozohet 96% ekzekutim i shpenzimeve kapitale

Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore ka qenë një nga prioritetet kryesore në vitet e fundit. Janë bërë shumë investime në rrugët nacionale që lidhen me korridoret regjionale, në rrugët regjionale dhe ato lokale. Aktualisht, vendi ka 1962 km rrugë nacionale dhe regjionale dhe 4761 km rrugë lokale (shih tabelën më poshtë).

Objektivat kryesor në këtë sektor përfshijnë: i) integrimi i Kosovës në rrjetin rajonal rrugor përmes zhvillimit të rrugëve 6 dhe 7 përgjatë korridoreve pan-evropiane, ii) zvogëlimi i shpenzimeve të transportit, dhe uljen e ngarkesës në trafik përmes rrugëve të reja përfshirë rrugët transit rreth qendrave urbane, iii) rritja e sigurisë përmes përmirësimit të sinjalizimit horizontal dhe vertical, përmirësimit të kualitetit të infrastrukturës rrugore dhe fushatave për sigurinë në rrugë, dhe iv) mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese që mundësojnë shërbime të mira të transportit privat dhe publik.

Vitin e kaluar është përfunduar pjesa e autostradës Prishtinë- Vërmicë që është pjesë e autostradës kombëtare Vërmicë-Merdare (R7) që lidhet me korridoret ndërkombëtare 8 dhe 10. Edhe segmenti Prishtinë-Milloshëvë i autostradës M2 është përfunduar. Në vijim do të elaborohen projektet kryesore infrastrukturore që janë duke u zhvilluar aktualisht dhe ato që janë duke u planifikuar.

²² Anketa e Fuqisë Punëtore 2014, ASK.

Zhvillimi i Drejtimit Rrugor 6 dhe 7 janë prioritet i Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar rrjetin e transportit dhe integruar plotësisht rrjetin rajonal. Zhvillimi i të dy rutave shihet të jetë me rëndësi primare për ekonominë e Kosovës dhe në mënyrë strategjike për rajonin, duke përbërë dy lidhjet kryesore në kuadër të rrjetit rajonal të transportit. Në të njëjtën kohë kjo lidh qytetet kryesore dhe qendrat ekonomike përbrenda Kosovës.

Rrjeti i infrastrukturës rrugore, në km

Kategoria	Gjatësia (në km)
Autoudhë (Autostrada Ibrahim Rugova)	78
Nacionale	588
Regjionale	1296
Nën-totali	1962
Komunale (Lokale)	
Lokale	4308*
Urbane	453*
Nën-totali	4761*
Gjithsej	6723

Drejtimi Rrugor 6 në kuadër të rrjetit të Transportit të Evropës Juglindore lidh Korridorët VIII dhe X në Maqedoni me Prishtinën dhe vazhdon më tutje me Malin e Zi, Kroacinë dhe Bosnjë - Hercegovinën. Në kuadër të procesit të Modifikimit të rrjetit bazik të EJT-së (2009) është përfshirë *Drejtimi rrugor 6 A Prishtinë- Sllatine (Aeroport) - Pejë - Mali i Zi - Kroaci dhe më tutje*. Në këtë drejtim rrugor janë duke u investuar mjete të konsiderueshme me qëllim të zhvillimit të tij.

Zhvillimi i **autostradës Vermicë - Prishtinë - Merdare** është përcaktuar si investim me prioritet të

lartë. Ky drejtim rrugor identifikohet si drejtimi rrugor rajonale nr. 7 në Rrjetin Kryesor të Transportit të Evropës Jug-Lindore që do të lidh Detin Adriatik- Shqipërinë Veriore, Prizrenin, Prishtinën dhe përmes Merdare deri në Nish (Serbi) me Korridorin X të TEN-it (Transport European Network). Në këtë kontest, është siguruar edhe përkrahje financiare në kuadër të agjendës “Connectivity” për vendet e Ballkanit përëndimor si bashkëiniciativë e Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Gjermanisë.

Sa i përket **Drejtimit Rrugor 6 Prishtinë- Hani i Elezit**, me 02 korrik 2014, është nënshkruar kontrata në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Kompanisë fituese Bechtel Enka për ndërtimin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, në vlerë prej 599,944,263.55 Euro (TVSH-ja e përfshirë). Punimet janë duke u zhvilluar në segmentin C1 të autostradës Kycja R6/R7- N2. Është duke u punuar në hapjen e trasesë, mbushje, tampon, asfaltim, nënkallime punime ne objekte dhe dislokim të instalimeve. Gjithashtu, janë duke u realizuar dislokimet e instalimeve përgjatë trasesë së Autostradës, ku përfshihet rrjeti i Hidrosistemit Ibër-Lepenc, dislokimi i instalimeve të KEK-ut, KOSTT-it dhe Ujësjellësit Rajonal Prishtina, ku paraprakisht është dashur të punohen projektet e dislokimit të instalimeve dhe më pas të miratohen nga ana e Kompanive publike.

Në segmentet C1 dhe C2 projektimi i trasës kryesore është në përputhje me standardet e TEM për karakteristikat gjeometrike për një shpejtësi projektuese prej 120km/h. Në segmentin C3 për shkak të kushteve të terrenit është ulur shpejtësia projektuese në 80 km/h. Afati i realizimit të punimeve është 42 muaj. Ky projekt është afatmesëm.

Projekti i **Autostradës “Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë”**: Qeveria e Republikës së Kosovës ka identifikuar ndërtimin e Autostradës Prishtinë –Gjilan – Dheu i Bardhe si një investim me prioritet të lartë për infrastrukturën dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ky drejtim rrugor lidhet me drejtimet kryesore rrugore të Evropës Juglindore Autostradat 6 dhe 7 si dhe me korridorin X në Serbi. Përvoja gjatë implementimit të projektit të ndërtimit të Autostradave 6 dhe 7 tregoi se Kosova është në gjendje të ndërtojë shpejt dhe me efikasitet infrastrukturën që do ti mundësoje zhvillimin ekonomik dhe integrimin në rrjetin rajonal të transportit. Është me rëndësi të fillohet me realizimin e projektit të ndërtimit të Autostradës Prishtinë –Gjilan – Dheu i Bardhë, që ky drejtim rrugor të përfshihet në hartën e Rrjetit Bazik të Transportit për Evropën Juglindore (Core Transport Network). Të gjitha fazat e realizimit të projektit do të duhej të menaxhoheshin nga një Komiteti Drejtues Ndërministror, i cili duhet që të formohet me Vendim të Qeverisë. Ministria e Infrastrukturës është në fazën përfundimtare të përgatitjes së projektit zbatues për ndërtimin e Autostradës Prishtinë –Gjilan – Dheu i Bardhe. Pas finalizimit të fazës së parë dhe definimit të trasesë dhe koston së përafërt të projektit, duhet që të vlerësohen opsionet e financimit

dhe të kryhen të gjitha studimet e nevojshme me qëllim të fillimit sa me të shpejte të implementimit të projektit. Plani tentativ për përfundimin e kesaj është fundi i vitit 2019.

Zgjerimi i **Rrugës Nacionale N25**, nga Rrethrotullimi Besi –Podujevë: për realizimin e këtij projekti tashme është filluar me hartimin e projektit të zgjerimit të rrugës N25, për segmentin e cekur. Rruga e zgjeruar do të ketë 4 shirita qarkullim (4x3.75m) me ndarje në mes me shiritin ndarës prej 1.50m. Në kycje dhe udhëkryqe do të punohet edhe shiriti shtesë me gjerësi prej 3.0m. Kryesisht udhëkryqet do të jenë në dy nivele (vetëm në raste specifike udhëkryqet do të projektohen në nje nivel). Fillimi i trasës së zgjerimit të rrugës do të jetë të rreth rrotullimi në Besi, kurse mbarimi do të jetë në udhëkryqin për Podujevë. Gjatësia e planifikuar e zgjerimit të rrugës Nacionale N25, është rreth 20km. Afati për hartimin e projektit, sipas vlerësimit të MI-s do të jetë 9 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës. Kostoja e projektit do të dihet pas punimit e projektit zbatues. Si pjese e projektit zbatues do te jete edhe elaborati i shpronësimit, para se te fillohet me implementimin e projektit duhet qe te fillohet me procesin e shpronësimit. Pas përfundimit të projektit zbatues dhe procesit të shpronësimit do të duhej që të fillohej me punimet në zgjerimin e rrugës, varësisht nga mundësitë buxhetore do të caktohen edhe gjatësitë e segmenteve për punime. Ky projekt nuk e cenon vazhdimin e korridorit të rrugës 7 Durrës – Morinë – Prishtinë – Merdare –Nish. Karakteri i këtij projekti është më tepër i nivelit të lidhjesse dy zonave gravituese asaj të Podujevës me Prishtinën dhe ngritjen e kapacitetit të rrugës ekzistuese. Plani tentativ për përfundimin e kesaj është fundi i vitit 2018.

Drejtimi Rrugor 7 Morinë - Prishtinë- Merdare: Pas lëshimit në qarkullim të segmenteve 1-9 Vermicë - Prishtinë - Besi, Ministria e Infrastrukturës në bashkëpunim me BERZH-in dhe EIB-në do të kryejë studimin e fizibilitetit dhe plotësimin e projektit preliminar për R7, segmenti Besi - Merdare (Kufiri me Serbinë). Tashmë janë definuar aktivitetet për termat e references. Pas përfundimit të këtyre Studimit të Fizibilitetit dhe plotësimit të Projektit Preliminar për segmentin Besi- Merdare, do të fillohet me ndërtimin e segmentit të mbetur të Autostradës në gjatësi prej 23 Km. Plani tentativ për përfundimin e kesaj është fundi i vitit 2018.

Vazhdimi i projektit të **zgjerimit të rrugës Nacionale N9, Prishtinë - Pejë:** Në bashkëpunim me Kornizën Investive të Ballkanit perëndimor²³ (Western Balkan Investment Framework) dhe BERZH-in ka filluar studimi i fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor për segmentin Kijevë–Zahaq (32 Km) dhe plotësimi i projektit zbatues, si parakusht për fillimin e implementimit të projektit. Ky studim pritet të përfundojë gjatë këtij viti dhe më pas do të përgatitet edhe marrëveshja e kredisë për financimin e ndërtimit të këtij segmenti rrugor. Plani tentativ për përfundimin e kesaj pjese është fundi i vitit 2018.

Vazhdimi i projektit të **zgjerimit të rrugës Nacionale N2, Prishtinë - Mitrovicë.** Gjatë tri viteve të ardhshme, Ministria e Infrastrukturës do të vazhdojë me zgjerimin e rrugës Nacionale N2 në drejtim të Mitrovicës. Për vazhdimin e këtij projekti do të jenë në dispozicion edhe 60 milion dollar amerikanë kredi nga Banka Islamike për Zhvillim, Fondi Saudit për Zhvillim dhe OFID-i.

Duke pasur parasysh që për realizimin e këtij projekti do të aplikohen proceduarat e Bankës Islamike për zhvillim, parashihet që realizimi i projektit të fillojë në vitin 2016, ndërsa proceduarat të përfundojnë brenda këtij viti. Plani tentativ për përfundimin e kesaj është fundi i vitit 2018.

Transporti hekurudhor

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAK OS) menaxhon me infrastrukturën hekurudhore në pronësi të shtetit. Kjo është një kompani publike me përgjegjësi të kufizuar me 100% të aksioneve të zotëruara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Rrjeti hekurudhor i Kosovës përbëhet nga 335,079 km të hekurudhës. Katër linjat hekurudhore kanë nevojë për nivele të ndryshme të rehabilitimit për t'i sjellur hekurudhat në standardet moderne të shpejtësisë dhe sigurisë. Gjatë vitit të kaluar, si trafiku i pasagjerëve edhe ai i mallrave kishin rritje. Një mirëmbajtje e kufizuar është bërë. Më konkretisht infrastruktura hekurudhore është si më poshtë:

²³ Iniciativë e përbashkët që grumbullon fondet e Komisionit Evropian, Bankës Investive Evropiane (EIB), Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (CEB), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Bankës Botërore, KfW etj.

- Rruga hekurudhore 10 (kufi me Serbinë - Leshak - Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit - Kufitare me Maqedoninë), me gjatësi prej 149.110 km, me vetëm një palë binarë, e pa elektrizuar, me gjerësi 1435 mm, Kategoria D3, masë e boshtit 22.5 ton dhe masë longitudinale 7.2 ton/m;
- Linja hekurudhore lindore (kufi me Serbinë - Podujevë - Prishtinë - Fushë Kosovë), me gjatësi prej 45.198 km, vetëm një palë binarë, e pa elektrizuar, me gjerësi 1435 mm, kategoria D3, masa e boshtit 22.5 ton dhe 16 ton, dhe masa longitudinale 7.2 ton/m dhe 5 ton/m;
- Linja hekurudhore perëndimore (Fushë Kosovë-Pejë) me gjatësi 81.940 km, vetëm një palë binarë, jo e elektrizuar, me gjerësi 1435 mm, Kategoria C2, masa e boshtit 20 ton dhe masa longitudinale 6.4 ton/ m; dhe
- Linja hekurudhore jug perëndimore (Klinë Xërxë-Prizren) me gjatësi 58.831 km, me vetëm një palë binarë, jo e elektrizuar, me gjatësi 1.435 mm, Kategoria D3 dhe B1, masa e boshtit 22.5 ton dhe 18 ton, dhe masa longitudinale 7.2 ton/m dhe 5 ton/m.

Ligji 04 /L-063 për Hekurudhat e Kosovës themelon Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave i cili përbëhet nga organe të pavarura, përveç organit të hetimit që është nën zyrën e kryeministrit për të monitoruar dhe për të rregulluar sektorin hekurudhor.

Ministria e Infrastrukturës ka zhvilluar Strategjinë Sektoriale të Transportit Multimodal 2015-2025 e cila përfshin edhe sektorin hekurudhor. Strategjia ka marrë parasysh edhe interoperabilitetin e sistemit hekurudhor Evropian, sigurinë dhe standardet e sistemin hekurudhor evropian, dhe strategjitë e zhvilluara sipas Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit në mes të partnerëve të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO).

Meqenëse rruga hekurudhore 10 që lidh Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë është pjesë e korridoreve dhe rrugëve hekurudhore të SEETO-s, është rrugë prioritare për modernizim. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) do t'i huazojë Republikës së Kosovës 36 milionë euro për infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS) në vitin 2015. Kredia do të financojë rehabilitimin urgjent dhe përmirësimin e seksionit jugor (Fushë Kosovë - kufiri maqedonas) të rrugës 10 (kufirin Kosovë-Serbi në kufirin Kosovë-Maqedoni) në Kosovë ("Projekti"). Projekti investohen në rinovimin e binarëve, sistemet e sinjalizimit, urat, kalimet në nivel të tokës dhe rehabilitimin e tuneleve. Në **planin afatmesëm**, prioriteti kryesor në sektorin e hekurudhave është modernizimi i rrjetit hekurudhor. Për masat detaje, shih kapitullin 14 për politikat e transportit.

Transporti ajror

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" që operon me shërbime të kombinuara civile dhe ushtarake. Në prill të vitit 2010 ka hyrë në fuqi Kontrata e partneritetit publiko-privat në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konsorciumit Turko - Francez Limak- Aeroport de Lyon për dhënien me Koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, dhe ky është një nga shembujt e suksesshëm të projekteve të Koncesionimit në Evropën Juglindore.

Terminali i ri, i cili është përruar më 23 tetor të vitit 2013 është një investim prej rreth 100 milion euro dhe ofron më shumë komoditet për udhëtarët, shërbime të nivelit të parë si dhe hapësirë të mjaftueshme dhe një mjedis social e relaksues për pasagjerët. Terminali i ri ka 44,000 m² dhe kapacitet që mundëson pritjen e rreth 4 milionë pasagjerëve në vit. Kjo e bën Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës lider në rajon si për nga hapësirat e terminalit po ashtu edhe nga kulla e kontrollit, dhe ka potencial ta shndërrojë Prishtinën dhe Kosovën në pikën lidhëse dhe qendër të aviacionit rajonal.

Cilësia dhe sasia e shërbimeve në këtë aeroport është rritur ndjeshëm. Si pjesë e rrjetit themelor regional dhe ndërkombëtar, mbetet si synim zgjerimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të këtij aeroporti.

Energjia

Prodhimi i energjisë elektrike në vend bëhet kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a) e cila përbëhet nga dy termocentrale (Kosova A dhe Kosova B) si dhe Minierat e Qymyrit. Prodhues të energjisë janë edhe pesë hidrocentrale të vogla (një është në kuadër të Ndërmarrjes Publike ibër Lepenci dhe 4 menaxhohen nga kompani private). Kapacitetet e instaluar të termocentraleve janë 1478 MW,

mirëpo për shkak të vjetërsisë së tyre, kapaciteti aktual operativ i tyre sillet rreth 915 MW. Kapacitetet e instaluara hidrike janë 45.84 MW.

Sistemi i transmisionit menagjohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT sh.a.). Ky sistem është i ndërlidhur me të gjitha sistemet fqinje në nivelin 400 kV, përveç me Shqipërinë, ku lidhja është vetëm në nivelin 220 kV. Aktivitetet e ndërtimit të linjës së re të tensionit prej 400 kV me Shqipërinë janë duke u zhvilluar dhe ndërtimi i kësaj linje ka filluar në fund të vitit 2014 dhe parashikohet të përfundojë brenda 24 muajve nga periudha e fillimit të zbatimit të projektit. Kjo do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve transmetuese ndërmjet dy vendeve dhe regjionit, ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë, dhe optimizmin e punës së dy sistemeve. Gjatësia e tërësishme e linjave të transmisionit (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është 1,223km.

Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike-KEDS, menagjon me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes(OSSh) ka në pronësi 624.5 km të rrjetit 35 kV, 1259.2 km të rrjetit 10(20) kV, 5743.5 km gjatësi të rrjetit 10 kV, rreth 50.1 km të rrjetit 6 kV dhe 11635.9 km gjatësi të rrjetit 0.4 kV. Po ashtu, në pronësi të OSSh-së janë 7863 trafostacione nga niveli 35/10 kV deri në nivelin 6/0.4 kV dhe 7610 nënstacione nga niveli 35/10 kV deri në nivelin 6/0.4 kV.

Përkundër progresit në rritjen e kapaciteteve të transmisionit dhe distribucionit, furnizimit me energji elektrike, rritjes së efikasitetit në shfrytëzimin e resurseve minerale, mbetet që edhe më tutje të këtë angazhim për përmirësimin e gjendjes aktuale. Sektori i energjisë elektrike si një prej faktorëve kyç për zhvillimin ekonomik dhe të mirëqenies shoqërore, edhe më tej përcillet me humbje komerciale dhe teknike dhe teknologji të vjetruar që nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për furnizim stabil me energji.

Sektori i ngrohjes përbëhet nga 4 ngrohore në gjithë Kosovën (Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan). Në fund të vitit 2014 Ngrohitorja e Prishtinës, Termokos është kyçur në sistemin e kogjenerimit në TC Kosova B që ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e performancës së furnizimit të qytetarëve të Prishtinës me ngrohje. Ekzistojnë potenciale të konsiderueshme energjetike për zhvillimin e sistemit të ngrohjes. Zhvillimi i sistemit të ngrohjes ndikon ndjeshëm në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike veçanërisht gjatë sezonit të dimrit kur kemi ngarkesa të mëdha në sistemin elektroenergjetik.

Kosova nuk ka rrjet të gazit natyror, por zhvillimet e kohëve të fundit në rajon, sa i perket projekteve ndërkombëtare, paraqesin një mundësi që duhet shfrytëzuar, por paraprakisht kërkohen studime dhe analiza teknike dhe financiare.

Me gjithë identifikimin e potencialeve energjetike nga burimet e ndryshme të energjisë, shfrytëzimi i këtyre potencialeve është tepër i vogël. Kjo situatë duhet ndryshuar me politika dhe masa konkrete në mënyrë që të diversifikohen burimet e energjisë si dhe të rritet siguria e furnizimit. Konsumatorëve duhet t'iu mundësohen sa më shumë alternativa për plotësimin e nevojave të tyre energjetike me produkte me kosto të përballueshme.

Sa i perket **kornizës rregullative dhe institucionale**, janë bërë disa hapa të rëndësishëm që krijojnë bazën për hapjen e tregut dhe nxitjen e konkurrencës në sektorin e energjisë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka autoritetin ligjor për të obliguar palët, që të ofrojnë në tregun e lirë sasi të caktuara të energjisë (aktualisht operon vetën një furnizues). Sipas dizajnit të tregut të energjisë elektrike, Kosova ka treg bilateral në të cilin pjesëmarrësit e licencuar blejnë dhe shesin energji për të mundësuar një sistem energjetik të balancuar. Ky treg shoqërohet me një mekanizëm balancues në të cilin Operatori i Sistemit të Transmisionit KOSTT pranon oferta për blerje dhe shitje të energjisë nga të licencuarit, për të menaxhuar diferencat e rrjedhave të cilat nuk janë të mbuluara me kontrata bilaterale. Ndarja ligjore mes distribuimit dhe furnizimit është bërë dhe të dy funksionet tashmë janë privatizuar. Ndërsa menaxhimi me mihjet e thëngjillit dhe gjenerimin e energjisë elektrike nga termocentralet bëhet nga kompania publike KEK.

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit të energjisë bëhet nëpërmjet infrastrukturës ligjore, që përgjithësisht është mjaft e kompletuar dhe mjaft e përafuar me aquis të Bashkimit Evropian (BE).

Gjithashtu që nga viti 2004 janë zhvilluar institucionet qeveritare, rregullatore dhe operatorë të aftë për të menagjuar me sukses sektorin e energjisë. Institucionet kryesore që udhëheqin me sektorin e energjisë janë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave të sektorit të energjisë dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ), që vepron si agjenci e pavarur rregullatorë që ka përgjegjësi për rregullimin e tregut të energjisë (energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë së ngrohjes);
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)- që vepron si agjenci e pavarur rregullatorë për rregullimin e aktiviteteve minerare ku bënë pjesë edhe thëngjilli;
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.) e cila është ndërmarrje publike që menagjon me rrjetin e transmisionit dhe ka rolin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut të energjisë elektrike.

Institucionet tjera qeveritare, siç janë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Financave (MF), si dhe Komisioni Kosovar i Konkurrencës, kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të sektorit të energjisë.

Tregu i komunikimeve elektronike

Në Kosovë sektori i TIK-ut ka rëndësi shumë të madhe ekonomike me vet faktin që në dhjetë vitet e fundit merr pjesë në GDP-në e Kosovës përreth shifrës 10%. Përveç rëndësisë ekonomike ky sektor ka ndikim shumë të madh edhe në kohezionin social, në sferën e edukimit, shëndetësisë, në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në përgjithësi si dhe në ngritjen e konkurrueshmërisë së përgjithshme të Kosovës në nivel global.


Sa i përket zhvillimeve në treg, **telefonja fikse** historikisht ka një zhvillim të ulët në vendin tonë. Me liberalizimin e këtij tregu është mundësuar edhe hyrja e operatorit alternativ (IPKO) që i bën konkurrencë operatorit deri atëherë monopolist PTK-së (TiK). Tashmë autorizim për të ofruar shërbime të telefonisë fikse ka edhe operatori Kujtesa. Megjithatë, penetrimi në telefoninë fikse nuk ka shënuar ngritje por varion nën vlerën 5%. PTK ka rreth 97.6% të të hyrave të këtij tregu ndërsa operatori privat IPKO ka vetëm 2.33% të të hyrave. Për ecurinë e penetrimit të tregut përgjatë viteve, ju lutem shihni aneksin.

Një trend i tillë i zhvillimit të ulët të telefonisë fikse vërehet edhe në nivel global. Shkalla e ulët e penetrimit varet nga evoluimi i vazhdueshëm i shërbimeve tjera që zëvendësojnë shërbimet e telefonisë fikse duke ofruar njëkohësisht vlera të shtuara në realizimin e komunikimeve elektronike. Normalisht, investimet janë të orientuara në drejtim të ofrimit të shërbimeve më atraktive ku kërkesa është shumë e madhe dhe kthimi i investimeve i pritshëm. Rrjetet e reja telekomunikuese janë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe alternativë e mjaftueshme në raport me rrjetet tradicionale të telefonisë fikse.

Tregu i telefonisë mobile ka shtrirjen më të gjerë në gjithë komunikimet elektronike. Të dhënat e fundit tregojnë se numri total i përdoruesve të telefonisë mobile në vendin tonë në fund të tremujorit të parë të 2015 ka arritur shifrën 1,676,287. Të hyrat e operatorëve mobil përbëjnë rreth 77% të të hyrave të gjithë tregut të komunikimeve elektronike. Aktualisht janë vetëm dy operator të licencuar për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile dhe mbulueshmëria e popullatës është gati 100%. Në tregun e telefonisë mobile ekzistojnë edhe dy operatorë Mobil Virtual (MVNO)²⁴ të cilët kanë lidhur kontrata me operatorët VALA dhe IPKO. Duke u bazuar në të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë del se penetrimi në telefoninë mobile arrin në 92.33% çka nënkupton përfshirje të lartë të popullatës në këto shërbime. Ky trend rritës ka vazhduar viteve të fundit. Sipas të hyrave, Vala ka rreth 56.2% të tregut të telefonisë mobile ndërsa IPKO ka rreth 37.9% (të dhënat e tremujorit të parë të 2015).

²⁴ Mobile Virtual Network Operator.

Penetrimi i telefonisë mobile 2007-2014




Çmimet e thirrjeve për minutë janë ndër më të lirat në rajon e Evropë dhe gjithashtu ofrohen pako të ndryshme atraktive për konsumatorë. Përkundër kësaj, çmimet e thirrjeve për minutë në roaming janë ende shumë të larta, veçanërisht roamingu me shtetet e rajonit lë shumë për të dëshiruar.

Furnizimi me internet për qytetarët e vendit tonë është relativisht i kënaqshëm. Më shumë se 50 operatorë të autorizuar nga ARKEP ofrojnë këtë shërbim në gjithë territorin e vendit kurse 5 prej tyre kanë qasje në nyjet komunikuese ndërkombëtare. Zyrtarisht penetrimi për familje ka arritur vlerën prej 65.15% apo për banorë 10.66%, kurse shpejtësia dhe kualiteti janë në nivel mjaftë të lartë. Praktikisht edhe penetrimi është më i lartë sesa norma zyrtare (mbi 70%).

Përveç internetit - me qasje fikse, tanimë ofrohet mundësia dhe është përhapur shumë shpejtë edhe interneti - me qasje mobile. Mobile Broadband apo qasja në internet brezgjere përmes rrjetit mobil për përdoruesit e telefonisë mobile në Kosovë është mundësuar që nga dhjetori i vitit 2013 (teknologjia - 3G) dhe tani në fillim të vitit 2015 edhe përmes teknologjisë më të re LTE apo 4G. Sipas të dhënave të raportuara në ARKEP, numri i përdoruesve aktiv që janë qasur në internet përmes kësaj teknologjie vazhdimisht është duke u rritur, ky numër në periudhën TM1 2015 ka arritur në 358,184 përdoruesish e që shënon një rritje të 26.12% krahasuar me TM4 2014. Penetrimi i qasjes mobile në internet përmes rrjetit 3G dhe 4G për periudhën TM1 2015 ka arritur në 19.74%. Sa i përket ndarjes së tregut sipas të hyrave, PTK merr pjesë me 22.27%, IPKO me 40.31%, Kujtesa me 24.48% dhe të tjerët me 12.48%. ndërsa nëse bazohemi në ndarjen e tregut sipas përdoruesve, PTK ka 17.7% të tregut, IPKO 47.1%, Kujtesa ka 24% dhe operatorët tjerë 11.2%.

Penetrimi i internetit, 2007-2014



Investimet e bëra nga operatorët e shërbimeve telekomunikuese për vitin 2014 në sektorin e telekomunikacionit (telefonja fikse, mobile, interneti) kapin shifrën prej 52,265,346 € e që shënon një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar (2013), ku investimet kanë kapur shifrën prej 27,906,383.39 €. Pjesën më të madhe e investimeve në tregun e komunikimeve elektronike gjatë vitit 2014 e përbënë telefonja mobile me rreth 59.4%, telefonja fikse me 4.56% dhe internet 36.05.

Sa i përket **kornizës rregulative dhe të politikave**, Ligji për Komunikimet Elektronike dhe legjislati i tjetër zbatues vendosin një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në harmoni me Direktivat e BE-së (Pakoja e Direktivave të vitit 2009, si amandamentim-plotësim i Pakos së Direktivave të vitit 2002 për sektorin e Komunikimeve Elektronike).

Ligji për Komunikimet Elektronike ndër të tjera ka krijuar bazën ligjore për kalimin nga regjimi i licencave në regjimin e autorizimeve të përgjithshme (ang. General Authorization) për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kjo nënkupton rritje të mundësive dhe përmirësim cilësor të ambientit për investime të reja dhe konkurrencë të drejtë e fer, çka edhe është një nga synimet (prioritetet) kryesore të Qeverisë.

Vizioni dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Kosovës për sektorin e teknologjisë informative, rrjedhimisht edhe për sektorin e Komunikimeve Elektronike janë të shprehura në dokumentin **“Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Axhenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020”**. Dokumenti i Politikave është në përputhje edhe me objektivat e përcaktuara në Komunikatën e Komisionit Evropian të datës 19 maj 2010 për Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve "Agjenda Digjitale për Evropën" (COM (2010) 245 final). Prioritetet Afatmesme bazuar në dokumentin e politikave për komunikimet Elektronike janë: zhvillimi i infrastrukturës së TIK, zhvillimi i shërbimeve dhe përmbajtjeve elektronike dhe promovimi i shfrytëzimit të tyre, avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK.

Në këtë dokument janë të transpozuar idetë dhe objektivat strategjike të parapara në Axhendën Dixhitale për Evropën por duke marrë parasysh dhe duke i ‘u përshtatur realitetit dhe gjendjes së sektorit të TIK në Kosovë.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Ekonomia kosovare vazhdon të dominohet nga sektori i shërbimeve në vitin 2014 me gati 57% të vlerës së shtuar si përqindje e BPV-së. Industria e përbën rreth 29% dhe bujqësia përbën rreth 14.5% të vlerës së shtuar si përqindje e BPV-së. Kjo strukturë ka mbetur mjaft stabile gjatë 5 viteve të fundit me përjashtim të bujqësisë, pjesëmarrja e të cilit sektor ka shkuar duke rënë (shih tabelën më poshtë).

Vlera e shtuar si përqindje e BPV

	2010	2011	2012	2013	2014
Bujqësia	16.2%	15.6%	14.8%	14.4%	14.5%
Industria	28.4%	28.8%	28.1%	28.2%	28.9%
Shërbimet	55.4%	55.6%	57.1%	57.4%	56.6%

Burimi: Banka Botërore

Edhe të dhënat e Agjencisë së Statistikave përstrukturën e Bruto Produktit Vendor sipas aktiviteteve ekonomike tregojnë se shërbimet dominojnë me kontributin në BPV (afërsisht gjysma e pjesëmarrjes totale të aktiviteteve në BPV, shih tabelën 2 në aneks). Vetëm tregtia me shumicë dhe pakicë merr pjesë me 12.4% në BPV. ndërsa pjesëmarrja e bujqësisë në BPV ka rënë nga 14.8% në vitin 2008, në 11.9% në vitin 2014. Një strukturë sektoriale e dominuar nga shërbimet vërehet edhe nga numri i bizneseve të regjistruara sipas sektorëve ekonomik (shih tabelën 3 në aneks). Pas shërbimeve, sektorët me numrin më të madh të bizneseve janë prodhimitaria dhe ndërtimtaria. Numri i bizneseve në të gjithë këta sektorë ka pasur afërsisht ritëm të njëjtë rritës përgjatë periudhës 2010-2014. Pra, bazuar në këta indikatorë, struktura sektoriale është duke lëvizur drejt shërbimeve.

Ndërmarrja aktive definohet si ndërmarrje që ka deklaruar qarkullim ose punonjës në organin tatimor të Kosovës për vitin referues. Është e qartë se duke përdorur popullsinë e ndërmarrjeve aktive gjatë një periudhe dy efekte mund të vërehen duke futur edhe një element të pasigurisë. Efekti i parë do të jetë ndryshimi i vërtetë në numër të ndërmarrjeve të një kategorie të caktuar me kalimin e kohës. Efekti i dytë është ndryshimi në regjistrimin, mbylljen dhe mbijetesën në të njëjtën kategori të ndërmarrjes. Pra nëse ka një numër relativisht të madh të hapjeve dhe mbylljeve në një periudhë të caktuar, numri i ndërmarrjeve

aktive gjatë kësaj periudhe ka gjasa të jetë më i lartë se ai për periudhat e mëparshme. Por kjo mund të reflektojë vetëm rritje paqëndrueshmërie, jo një rritje të vërtetë në rëndësinë ekonomike të kësaj kategorie.

Numri i ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë, 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014
Individuale	24647	28517	25014	25888	28105
% e totalit	56.6%	65.4%	54.5%	55.2%	56.0%
Mikro (1-9)	17014	13246	18689	18977	20138
% e totalit	39.1%	30.4%	40.7%	40.4%	40.1%
Të vogla (10-49)	1534	1487	1849	1724	1655
Të mesme (50-249)	289	289	312	298	275
Të mëdha (250+)	43	42	47	49	46
% e totalit (3 kategoritë)	4.3%	4.2%	4.8%	4.4%	3.9%
Totali	43527	43581	45911	46936	50219

Në vitin 2014, numri i bizneseve aktive është rritur me 15% që nga viti 2010 dhe me 7% që nga viti 2013. Që nga viti 2010, struktura e madhësisë së bizneseve aktive ka qenë relativisht e pandryshueshme me proësinë individuale që përbën rreth 56% të të gjitha ndërmarrjeve aktive, ndërmarrjet mikro që përbëjnë rreth 40%, dhe të vogla, të mesme, dhe ndërmarrjet e mëdha që përbëjnë pjesën e mbetur prej rreth 4% së bashku. Vetëm në vitin 2012, ndërmarrjet në pronësi individuale kishin pasur një rritje prej 10%.

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri/konkurrencë

Ndërmarrjet e mëdha shtetërore: aktualisht në Kosovë funksionojnë 8 ndërmarrje të mëdha publike qendrore me pronësi shtetërore (këtu nuk bënë pjesë Trepça). Në sektorin e energjisë operojnë KEK-u dhe KOSTT-i, në telekomunikacion PTK-ja dhe PK-ja, në transport vepron ndërmarrjet hekurudhore TrainKos dhe InfraKos, në sektorin e ujitjes vepron Ndërmarrja Ibër-Lepenci dhe në atë të ujësllësit, Kompania Regjionale e Ujërave - Prishtina²⁵. Vlera e aseteve që kanë këto ndërmarrje publike është 911 milion euro, kurse numri i të punësuarve gjithsej në to është 9.800 punonjës.

Në vitin financiar 2014 rezulton se nga këto 8 ndërmarrje, vitin kanë mbyllur me fitim financiar 5 ndërmarrje ndërsa Ndërmarrjet: “Posta e Kosovës”, “Ibër-Lepenci” dhe “InfraKos” e kanë mbyllur vitin me humbje financiare.

Ristrukturimi i ndërmarrjeve

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike dhe kushtet e Traktatit për Komunitetin e Energjisë mbi shthurjen/ristrukturimin e sektorit elektroenergjetik, në vitin 2006 është themeluar kompania Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT sh.a.) si subjekt i pavarur. Ky aktivitet më parë është zhvilluar në kuadër të Ndërmarrjes KEK.

Procesi i shthurjes së aktiviteteve brenda sektorit të energjisë elektrike ka vazhduar më pas me ndarjen e gjenerimit nga distribucioni dhe furnizimi me energji elektrike. Në kuadër të shthurjes së plotë të aktiviteteve të sektorit energjetik, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes vendimeve nr. 04/36 dhe 03/38 ka urdhëruar shthurjen ligjore të KEK sh.a., duke themeluar subjektin e ri ligjor: Kompania Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim të Energjisë Elektrike (KKDFE sh.a. /KEDS) dhe më pas është bërë privatizimi i kësaj kompanie. Në fund të vitit 2014 është ndarë ligjiërisht aktiviteti i shpërndarjes nga ai i furnizimit duke u ndarë në dy kompani: KEDS si kompani e shpërndarjes dhe KES/CO si kompani e furnizimit me energji elektrike.

Reformat strukturore në sektorin e energjisë janë ende në vazhdim dhe kanë për qëllim të sigurojnë konkurrencë në tregun e energjisë, sipas parimeve të përgjithshme të konkurrencës së hapur, mos-diskriminimit, transparencës, barazisë, respektimit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë. Në legjislacionin që po përgatitet përfshihen të gjitha kërkesat e Pakos së Tretë të BE-së për sektorin e energjisë që nënkupton hapje të plotë të tregut, pavarësi e rregullatorit, dhe shthurje të plotë ligjore të aktiviteteve brenda sektorit.

²⁵ Në sektorin e ujit operojnë gjithsej 6 ndërmarrje rajonale ndërsa në atë të ujitjes 2.

Përveç në sektorin e energjisë, ristrukturimi i ndërmarrjeve është bërë edhe në sektorët tjerë. Që nga 2008 janë ristrukturuar Ndërmarrja e Post Telekomunikacionit PTK (nga Vala dhe Telekom) është ndarë Posta e Kosovës) dhe Hekurudhat e Kosovës ku janë ndarë në entitete të veçanta biznesore InfraKos dhe TrainKos.

Trepça si një nga ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë administrohet nga AKP-ja. Kjo është një entitet i disa njësive të biznesit të përcaktuara si asete thelbësore dhe jo-thelbësore të vendosura në rajone të ndryshme të Kosovës. Aktivitetet kryesore në të cilat ndërmarrja është përqendruar e që përbëjnë njësitë aktive të biznesit janë: (1) Minierat dhe flotacioni, Stantërg, (2) Miniera dhe flotacioni Kishnica dhe Novo Bërdo, Prishtinë, dhe (3) Miniera dhe flotacioni Trepça Kopaonik, Leposaviq.

Në këtë fazë në ndërmarrje janë të punësuar rreth 2,500 punëtorë që marrin rroga të rregullta. Në aspektin e biznesit bazë, ndërmarrja aktualisht ka katër miniera aktive dhe tri flotacione operative, me kapacitete prodhuese relativisht të mira në vitet e fundit.

Trepça është nën moratorium për riorganizimin dhe në bazë të Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, afati i fundit për dorëzimin e planit të riorganizimit është 1 nëntor 2016. Ndërkohë Qeveria është mandatuar nga Kuvendi që të përgatis opcione për këtë ndërmarrje të rëndësishme për ekonominë e vendit para fundit të afatit të moratoriumit.

Ndihma shtetërore

Ligji nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore vendosi bazën për zhvillimin e sistemit të ndihmës shtetërore, principet dhe procedurat për dhënie të ndihmës shtetërore. Ligji përmban definicionet bazë përfshirë atë të ndihmës shtetërore, vendos mekanizmin dhe kornizën për kontrollin e ndihmës shtetërore. Ai po ashtu krijon bazën për themelimin e inventarit gjithëpërfshirës të ndihmave shtetërore dhe sistemin e raportimit. Ligji është aktualisht në procedurë ndryshimi që ndër të tjera edhe do të rezultojë me përafrim të mëtutjeshëm me legjislacionin bazë të BE për këtë fushë. Draft ligji për ndihmën shtetërore pritet të aprovohet në pjesën e parë të 2016. Ligji transpozon parimet bazë të legjislacionin primar të Acquis (nenet e Traktatit për Funkcionimin e BE-së). Ligji po ashtu do të rregullojë kornizën institucionale për kontrollin dhe monitorimin e ndihmave, krijimin e inventarit dhe raportimit të ndihmës shtetërore. Ndërsa rregullat e acquis të kësaj fushe do të transpozohen përmes legjislacionit dytësor pasmiratimit të ligjit.

Korniza institucionale konsiston në Komisionin e ndihmës Shtetërore dhe Zyrën për ndihmë shtetërore. Bazuar në ligjin aktual, Komisioni i Ndhimës Shtetërore është organi vendimmarrës për ndihmë shtetërore. Komisioni vepron mbi baza "Ad hoc" dhe është i pavarur në vendimmarrje dhe ushtrimin e funksioneve të tij. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, tre ministra, një përfaqësues i shoqërisë civile dhe kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Zyra për Ndhimën Shtetërore është përgjegjëse për marrjen, analizën dhe mbikëqyrjen e njoftimeve si dhe të dhënave të tjera lidhur me skemat e ndihmës. Zyra që nga themelimi funksionon me kapacitete jo të plota. Nga 6 zyrtar të lejuar me Ligjin për ndihmën shtetërore, pagat me buxhet janë lejuar vetëm për 5 zyrtar, por në marrëdhënie pune janë aktualisht vetëm 2 zyrtarë. Për më shumë detaje rreth masave në këtë fushë, ju lutem shihni Kapitullin 8 Politikat e Konkurrencës.

Aktualisht nga ndihma shtetërore përfitojnë sektori i hekurudhave, sektori i postës, sektori i energjisë dhe sektori i ujit. Ndhimja shtetërore në vitin 2013 ka qenë ishte 26.5 milion euro, nga e cila për investime kapitale janë dedikuar 5.0 milion euro dhe për subvencione 21.5 milion euro. Në vitin 2014 ndihma shtetërore ka qenë 17.4 milion euro nga e cila për investime kapitale janë dedikuar 12.0 milion euro dhe për subvencione 5.4 milion euro. Ndhimja shtetërore e përdhëyer në raport me GDP-në është 0.005% të GDP-së në 2013 dhe 0.003% të GDP-së në 2014. Po ashtu subvencionohen edhe disa sektorë të bujqësisë në formë të pagesave direkte. Në vitin 2014, këto pagesa direkte kanë qenë 19,2 milionë euro (sektorët e bimëve, hortikultura dhe bagëtia) që është më pak se 0.5% e BPV. Në vitin 2015, subvencionet në bujqësi ishin 23 milionë. Në vitin 2015 nga ndihma shtetërore përfitojnë sektori i energjisë, sektori i postës, sektori i hekurudhave, sektori i ngrohjes dhe sektori i ujit. Vlera e përgjithshme e kësaj ndihme për të gjithë

sektorët është 13.9 milion euro apo 0.0025% të GDP-së. Pra ndihma shtetërore ka pasur një rënie të vazhdueshme që nga 2013.

Integrimi tregtar

Hapja tregtisë matur me eksportin e një vendi në mallra dhe shërbime në raport me BPV-në tregon rëndësinë relative të transaksioneve ndërkombëtare ndaj transaksioneve të brendshme. Në vitin 2014, hapja e tregtisë u rrit në 74.2% nga 69.1% sa ishte në vitin 2013. Tregtia e mallrave ka përbërë më pak se 1% të rritjes, ndërsa tregtia në shërbime përbërë rreth 4% të kësaj rritje.

Në vitin 2014, deficitin tregtar për mallra dhe shërbime së bashku u rrit në 1.88 miliardë euro nga 1.85 miliardë euro sa ishte në vitin 2013. Deficiti i përgjithshëm tregtar reflekton deficitin tregtar të mallrave të cilat u rritën gjithashtu në vitin 2014 në 2.21 miliardë euro nga 2.16 miliardë euro në vitin 2013. Tregtia në shërbime nga ana tjetër, tregon një suficit tregtar me një rritje 0.34 miliardë në vitin 2014 krahasuar me 0.31 në vitin 2013.

Në vitin 2014, eksportet në mallra mbuluan 13% të importeve, një rritje prej rreth 1% nga viti 2013. Në vitin 2014, eksportet arritën në 324 milionë euro, një rritje prej 10% nga viti 2013. Në vitin 2014, importet arritën në 2.5 miliardë, një rritje prej 3.6% nga 2013. Kosova importon nga mbi 130 vende dhe eksportet në mbi 60 vende. Bashkimi Evropian (BE) dhe vendet anëtare të CEFTA janë rajonet më të rëndësishme tregtare të Kosovës dhe së bashku përbëjnë rreth 71% të tregtisë së përgjithshme të mallrave në vitin 2014. Bashkimi Evropian përbërë 41.2% dhe CEFTA përbërë 29.6% e të gjithë tregtisë së mallrave. Edhe pse BE ka qenë partneri më i madh tregtar në vitin 2014, pjesëmarrja e saj ka rënë me gati 3% nga pjesa e saj të 43.8% në vitin 2013. Kjo rënie vë në një rënie prej 1% të pjesëmarrjes së importeve të BE-së dhe rënie prej 10% në pjesëmarrjet e eksporteve të BE-së në totalin e eksporteve. Tregtisë në mallra me BE-në është ulur me rreth 2% nga viti 2013 në vitin 2014 për shkak të një rënie prej 17% në vlerën e eksportit nga 2013. Rënia vë për shkak të një rënie prej rreth një e treta të produktit më të madh eksportues ferronikelit të Kosovës për në destinacionin më të madh, Itali.

Vendet kryesore për eksportet në BE

Shteti	Vlera 2013 (Milion Euro)	Vlera 2014 (Milion Euro)	Pjesëmarrja 2013 (%)	Pjesëmarrja 2014 (%)	Pjesëmarrja e BE 2013 (%)	Pjesëmarrja e BE 2014 (%)
Italia	74.363	49.660	25.3	15.3	62.8	50.6
Gjermania	10.985	11.339	3.7	3.5	9.3	11.6
Austria	6.327	6.416	2.2	2	5.3	6.5
Polonia	3.870	5.782	1.3	1.8	3.3	5.9
Bullgaria	1.026	3.820	0.4	1.2	0.9	3.9
Totali	96.571	77.016	32.9	23.7	81.6	78.5

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Top pesë vendet për eksportet në BE ishin Italia e ndjekur nga Gjermania, Austria, Polonia dhe Bullgaria. Këto pesë vende përbëjnë 78.5% të vlerës totale të importit të BE-së dhe 23.7% të vlerës totale të importit. Italia është i vetmi vend i BE-së që merr më shumë se 5% të totalit të eksporteve të Kosovës duke e bërë atë vendin më të rëndësishëm për eksportet në BE. Tabela më poshtë paraqet më shumë detaje për eksportin e Kosovës në këto vende.

Në vitin 2014, importet nga BE-ja ishin rreth 1 miliard euro, një rënie prej 0.2% nga viti 2013. Pesë vendet më të mëdha importuese të BE-së janë Gjermania e ndjekur nga Italia, Greqia, Sllovenia, dhe Poloni. Vetëm Serbia importon më shumë në Kosovë se Gjermania. Këto pesë vende të BE-së përbëjnë 68% të vlerës totale të importit të BE-së dhe 29% të vlerës totale të importit. Tabela më poshtë paraqet më shumë detaje rreth importit të këtyre vendeve.

Në vitin 2014, vendet e CEFTA merrnin pjesë me 39.2% të eksporteve dhe 28.4% të importeve të Kosovës. Në vitin 2014, eksportet në rajonin e CEFTA-s ishin rreth 127 milionë Euro, një rritje prej 21.7% nga 2013. Top destinacionet e eksportit në CEFTA ishin Shqipëria, Maqedonia, dhe Serbia. Këto vende renditen e

dyta, e katërta, dhe e gjashta respektivisht nga të gjitha destinacionet e eksportit. Vendet më të rëndësishme për importet nga CEFTA janë Serbia në vendin e parë dhe Maqedonia në të gjashtin.

Vendet kryesore të importit nga BE

Shteti	Vlera 2013 (Milion Euro)	Vlera 2014 (Milion Euro)	Pjesëmarrj a 2013 (%)	Pjesëmarrj a 2014 (%)	Pjesëmarrja e BE 2013 (%)	Pjesëmarrja e BE 2014 (%)
Gjermania	252.594	273.029	10.3	10.8	23.3	25.3
Italia	228.519	202.866	9.3	8	21.1	18.8
Greqia	145.546	137.551	5.9	5.4	13.4	12.7
Slovenia	61.314	66.708	2.5	2.6	5.7	6.2
Polonia	36.595	55.820	1.5	2.2	3.4	5.2
Totali	724.568	735.973	29.6	29	66.9	68

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sa i përket strukturës së eksporteve të Kosovës, ajo dominohet nga metalet. Këto produkte në mënyrë të vazhdueshme përbëjnë mbi gjysmën e eksporteve. Produktet kryesore hyjnë ferronikeli, xehet e papërpunuara dhe skrap i hekurit. Ndërsa importet e Kosovës janë më të diversifikuara ku produktet kryesore janë derivatet e naftës, automjetet dhe pajisjet e makinerisë dhe transportit.

Në vitin 2014, eksportet e shërbimeve mbulonin 177% të importeve, një rënie prej rreth 20% nga 2013. Eksportet në shërbime arritën 771 milionë €, një rritje prej 24% nga 2013. Importet arritën në 434.5 milionë €, një rritje prej 39% nga viti 2013. Kjo rezultojë me një bilanc pozitiv tregtar prej € 336.5 milionë që paraqet një rritje prej 9% krahasuar me vitin 2013. Sektorët kryesorë të shërbimit ishin udhëtimet me 379 milionë €, që i atribuohet kryesisht diasporës kosovare; shërbimet e komunikimit me 19.5 milionë €; dhe shërbimet qeveritare me 14 milionë €, që i atribuohet kryesisht EULEX-it, KFOR-it, misioneve diplomatike dhe OJQ-ve.

Sa u përket Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Kosovë, bilanci i IHD-ve ka pasur tendencë rënëse në periudhën 2010-2014. Afërsisht rreth gjysma e këtyre investimeve vijnë nga vendet e BE dhe Evropës, dhe pjesa tjetër nga SHBA, Turqia, vendet e regjionit etj. Nga IHD prej vendeve të BE-së, prijnë ato nga Austria, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Sllovenia, Italia etj.

IHD hyrëse sipas shteteve, në milionë Euro

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	368.5	384.4	229.1	280.2	151.2
Austria	21.1	19.6	0.4	10.7	30.3
Gjermania	91.5	66.6	49.5	21.7	29.4
Slovenia	34.0	16.2	9.3	7.0	-9.4
Mbretëria e Bashkuar	38.9	80.1	14.3	10.7	-39.5
Zvicra	35.1	30.9	43.8	41.7	38.2
Holanda	17.2	4.7	-25.6	-0.1	-7.8
Luksemburgu	0.4	0.5	0.8	2.3	1.2
Franca	3.8	0.2	6.3	3.8	3.3
Bullgaria	0.0	3.4	8.1	5.6	14.5
Kroacia	1.8	2.9	0.4	1.3	1.1
Malta	0.9	0.2	4.3	3.1	0.1
Qipro	0.0	1.0	0.3	0.3	0.3
Sllovakia	0.0	0.0	...	0.2	0.1
Çekia	0.0	1.3	0.3	0.2	0.4
Spanja	0.1	...	0.2	0.2	0.1
Italia	6.6	1.7	4.4	8.7	3.3
Greqia	5.9	0.4	0.3	-0.4	-0.6
Të tjera	111.0	154.7	112.0	163.3	86.3

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Sa i përket strukturës së IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik, sektori i patundëshmërisë ka dominuar në vitet 2012-13 me rreth gjysmën e investimeve. Në vitin 2014 ky sektor ka marrë mbi 90% të IHD-ve. Sektoët tjerë kryesorë për investimet e huaja direkte në periudhën 2010-2014 kanë qenë shërbimet financiare, ndërtimi, transporti, industria etj. Për më shumë detaje rreth IHD sipas aktiviteteve ekonomike, shih tabelën 4 në aneks.

Bilanci i IHD-ve u karakterizua me përkeqësim në vitin 2014 me rënie prej 151.3 milionë euro nga 280.2 milionë euro sa ishin në vitin 2013. Bilanci i IHD-ve deri në qershor 2015 arriti në 163.6 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 39.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 4). Sektorët që përfituan më shumë nga rritja e IHD-ve ishin sektori i patundshmërive, qiradhënies dhe aktiviteteve tjera biznesore, si dhe sektori i shërbimeve financiare.

Masat afatshkurtra

- Të vazhdojë procesi i licencimit të mësimdhënësve
- Në kuadër të menaxhimit të cilësisë së arsimit parauniversitar synohet që të:
 - Përgatitet programi bazik për arsim gjithpërfshirës për të gjithë mësimdhënësit
 - Bëhet hartimi i standardeve të profesionit dhe planprogrameve sipas kërkesave të tregut të punës si dhe rishikimi i të gjitha kurrikulave ekzistuese dhe lidhja e tyre me tregun e punës
- Vazhdimi i zhvillimit të infrastrukturës rrugore
- Në sektorin e energjisë, përveq zhvillimeve rreth kornizës legislative dhe të politikave, do të punohet në zhvillimin e sistemit të transmisionit:
 - Instalimi i Transformatorëve të dytë 300 MVA në NS 400/110 kV Ferizaj 2 dhe në NS 400/110 kV Pejë 3;
 - Implementimi i një seri projektesh në rrjetin e transmisionit të cilat përmirësojnë sigurinë e furnizimit nga pikëpamja e transmisionit dhe sigurojnë zhvillim nga këndvështrimi i furnizimit me energji elektrike (NS Mitrovica, NS Drenasi, NS Fushë Kosova, NS Prishtina 6, NS Dragashi, etj.);
- Zhvillimi i bazës ligjore për krijimin e Fondit për garantimin e kredive për të përmirësuar qasjen në financa
- Funkcionalizimi i Agjencisë së Punësimit
- Zhvillimi dhe përafrimi i mëtejshëm i kornizës ligjore për ndihmën shtetërore me Acquis të BE-së
- Zhvillimi i opsioneve dhe ofrimi i zgjidhjes për pronësinë dhe organizimin e Trepçës para skadimit të moratoriumit për riorganizim
- Miratimi i legjislacionit për mbrojtjen doganore të pronësisë intelektuale.

Prioritetet afatmesme²⁶

- Në planin afatmesëm në arsimin e lartë, fokusi do të jetë në profilizimin e institucioneve të arsimit të lartë për të adresuar kërkesat e tregut të punës. Në arsimin parauniversitar, do të fillojë zbatimi i kurrikulës së re dhe do të vazhdohet me hartimin e standardeve të reja të profesionit.
- Të vazhdojë licencimi i mësimdhënësve
- Planifikohet që në Komunat në të cilat nuk ka fare institucione parashkollore publike të bëhet ndërtimi i tyre dhe të bëhet rrjetëzimi i arsimit dhe aftësimit profesional.
- Zhvillimi i infrastrukturës rrugore
- Modernizimi i rrjetit hekurudhor
- Plotësimi i caqeve indikative për eficiencën e energjisë, në harmoni me Planin e Veprimit për Eficiencë të Energjisë (2010-2018), përmes zbatimit të masave të Energjisë Eficiente
- Plotësimi i caqeve të energjisë nga BRE-të, në përputhje me parashikimin në Planin Kombëtar të Veprimit për BRE (2011-2020), përmes zbatimit të projekteve konkrete në fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

²⁶ Prioritetet afatmesme mund të plotësohen pas finalizimit të Programit për Reforma në Ekonomi.

- Implementimi dhe funksionalizimi i projektit Linja interkonektive 400 kV NS Kosova B - NS Tirana 2.
- Instalimi i transformatorit të tretë në NS 110/10 kV Prishtina 2.
- Rialokimi i linjës 110kV, nr 1806, NS 110/35kV Gjakova 1 - NS 110/10kV Gjakova 2. (Për detajet rreth të gjitha masave përfshirë edhe ato legislative, shihni kapitullin 15 për energjinë)
- Vazhdimi i reformës së të bërit biznes për të përmirësuar dhe lehtësuar zhvillimin e NVM-ve
- Funksionalizimi dhe zhvillimi i Fondit për garantimin e kredive
- Në sektorin e industrisë, rritja e konkurrencës së brendshme nëpërmjet zhvillimit grupor (clusters) dhe përkrahja e zhvillimit të grupimeve nëpërmjet krijimit të një kornize institucionale.

Të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit 2015

Pershkrimi	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul
	ne mil. Euro						
Kufitare-Dogana	51.1	104.4	167.2	242.2	318.4	402.5	498.2
Kthimet nga Dogana	- 0.2	- 0.4	- 0.6	- 0.8	- 1.1	- 1.4	- 2.3
Tatime vendore ATK	41.2	62.6	83.9	126.3	141.7	162.5	198.4
Kthimet nga ATK	- 1.8	- 4.3	- 6.9	- 9.3	- 11.8	- 13.6	- 17.0
Të hyra jo tatimore - Qeveritare	2.9	6.2	9.7	11.3	18.3	22.6	27.4
Të hyra vetanake -Qeveria qendrore	4.4	8.2	12.0	16.5	18.6	21.1	23.8
Të hyra vetanake Komunitat	3.8	7.5	11.3	14.4	19.9	25.0	29.8
Taksa koncesionare	1.5	1.5	1.5	2.9	2.9	2.9	4.9
Tantiemat	0.5	0.6	7.0	13.2	13.6	14.0	20.6
Të hyrat e dedikuara te AKP	5.5	5.5	5.5	5.5	5.5	5.5	5.5
Dividenta	-	-	-	10.0	10.0	10.0	10.0
Pranimet buxhetore	109.0	191.8	290.6	432.3	536.0	651.1	799.3
Huazimet nga IFN	0.7	0.7	2.7	2.9	3.0	3.9	39.6*
Letra me vlere	6.8	11.7	37.1	32.3	47.1	62.0	60.7
Grante te percaktuara te donatoreve	0.5	2.8	3.7	4.3	4.4	4.5	8.0
Gjithsej pranime	117.0	207.0	334.0	471.8	590.5	721.5	907.5
	-	-	-	-	-	-	-
Paga dhe meditje	42.2	84.2	126.5	168.9	213.4	258.5	302.7
Mallra dhe shërbime	1.3	16.3	28.3	47.1	64.0	77.0	88.4
Shpenzime komunale	1.1	4.2	6.1	9.6	11.4	12.5	13.4
Subvencione dhe transfero	25.2	60.9	92.6	133.9	164.1	196.4	229.6
Shpenzime kapitale	0.1	12.6	31.9	48.8	75.3	115.6	151.6
Rezerva	-	-	-	-	-	-	-
Pagesat buxhetore	70.0	178.3	285.5	408.4	528.2	660.0	785.7
Servisimi borxhit	0.1	3.6	13.8	14.3	17.7	18.7	19.8
Grante te percaktuarara te donatoreve	0.1	1.0	1.8	5.1	5.7	6.3	7.3
Gjithsej pagesat (Pagesat - shpenzimet)	70.2	182.9	301.1	427.7	551.6	685.0	812.8

Burimi: Raportet ditore te Thesarit, MF

*Këtu është pranuar tranche-i i pare nga FMN pas negociimit te marrëveshjes Stand-By kete vit

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteve ekonomike 2008-2014


Nace Rev.2	Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV-së sipas aktiviteve						
		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
A	Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	14.8	14.1	13.6	12.8	12.2	12.0	11.9
B	Industria nxjerrëse	3.1	2.3	3.1	2.6	2.3	2.2	2.1
C	Industria përpunuese	11.1	12.1	11.1	10.3	10.9	11.0	10.3
D	Furnizimi me energji elektrike, me gaz	2.1	2.3	2.5	2.6	2.5	2.7	2.8
E	Furnizimi me uje	0.5	0.6	0.7	0.7	0.7	1.0	0.8
F	Ndërtimtaria	6.6	6.6	6.4	7.5	6.7	6.6	6.0
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	11.6	12.5	12.2	11.1	12.1	12.3	12.4
H	Transporti dhe magazinimi	3.3	3.8	3.9	3.9	3.7	4.4	3.5
I	Hotelet dhe restorantet	0.6	0.5	0.6	0.7	0.8	0.9	0.9
J	Informimi dhe komunikimi	0.8	0.8	0.8	0.9	1.1	1.0	2.0
K	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	3.3	3.2	3.4	3.6	3.8	4.0	4.0
L	Afarizmi me pasuri të patundshme	11.0	10.2	9.5	8.7	8.6	8.9	9.0
M	Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	1.1	1.2	1.2	1.3	1.4	1.4	1.4
N	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	0.2	0.3	0.3	0.4	0.4	0.4	0.6
O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	11.1	10.3	9.9	9.9	9.8	9.3	9.0
P	Edukimi	2.6	2.8	2.8	3.2	3.2	3.1	3.9
Q	Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	0.9	1.1	1.3	1.4	1.4	1.4	1.8
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0.1	0.1	0.3	0.3	0.4	0.4	0.4
S	Shërbime të tjera	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
T	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbimet e pa diferencuara që prodhojnë aktivitetet e familjeve për përdorim vetanak	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-	-
	BVSH me çmime bazë	84.8	85.0	83.8	81.9	82.4	83.3	82.9
	Tatimet në produkte	15.2	15.0	16.2	18.1	17.6	16.7	17.1
	Subvencionet ne produkte							
	Bruto Produkti Vendor	100	100	100	100	100	100	100

Numri i bizneseve aktive sipas aktiviteteve ekonomike

NACE Rev 2 Sektorët	2010	2011	2012	2013	2014
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	18859	18445	19549	20178	20878
Prodhimtaria	4149	4253	4641	4807	5259
Akomodimi dhe shërbimet e ushqimit	3389	3335	3677	3862	4183
Ndërtimtaria	2546	2589	2998	3333	3646
Aktivitetet tjera të shërbimeve	2933	2930	3210	3086	3543
Aktivitetet profesionale, shkencore, teknike	1802	1906	2261	2646	2905
Transporti dhe magazinimi	2668	2563	2703	2725	2770
Shendetësia dhe aktivitetet e punes sociale	1162	1205	1260	1377	1445
Informimi dhe komunikimi	911	934	1063	1180	1315
Bujqësia, pylltaria, peshkimi	470	489	654	767	1006
Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	616	630	695	740	863
Art, zbavitje dhe rekreacion	435	453	517	605	678
Edukimi	423	432	499	508	559
Afarizmi me pasuri të patundshme	82	86	87	372	344
Industria nxjerrëse	208	191	225	230	240
Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e pastrimit të ujit	161	160	196	199	212
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	168	150	157	165	173
Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	99	94	112	92	132
Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicioner ajri	45	46	50	66	68
Të tjera	2401	2690	1357	0	0
Totali	43527	43581	45911	46938	50219

Tregu i komunikimeve elektronike

Penetrimi i telefonisë fikse sipas viteve²⁷



²⁷ Burimi: ARKEP, "Pasqyrë e tregut të komunikimeve elektronike për TM1 2015"

Investimet e Huaja Direkte

Tabela 4 IHD sipas aktivitetit ekonomik (në %)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%
Bujqësia	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Minierat	4.8%	-1.4%	-10.9%	-5.0%	2.7%
Industria	27.4%	12.2%	12.0%	4.1%	-22.5%
Energjetika		0.0%	1.0%	17.4%	8.9%
Ndërtimi	14.7%	34.6%	13.6%	6.2%	-13.1%
Shërbimet tregtare, Hotele dhe Restorante	1.8%	3.0%	4.1%	5.2%	5.5%
Transporti dhe Komunikimi		0.1%	0.2%	0.3%	0.3%
Shërbime Financiare	-4.3%	7.5%	14.1%	18.2%	-6.0%
Patundshmëria, Qeradhënia dhe aktivitetet tjera biznesore	10.7%	8.6%	9.8%	1.6%	27.7%
	20.5%	15.7%	50.5%	48.6%	94.0%
Shërbimet tjera /1	0.4%	2.9%	0.8%	1.2%	1.5%
Aktivitete të tjera të pa klasifikuara diku tjetër	23.8%	16.4%	4.8%	2.2%	0.9%

Burimi: BQK

3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË

3.1. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis*-në e BE-së²⁸

Neni 74 i MSA-së në mënyrë përcakton qartazi përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së. Më në detaje, ky nen përkufizon fushat prioritare të *acquis* që duhet të transpozohen në legjislacionin vendor, në fushën e tregut të brendshëm, fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, si dhe fushat e lidhura me tregti.

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovë nr. 09/2011, Rregullores për Shërbimin Ligjor Qeveritar, nr. 13/2013, si dhe të Udhëzimit Administrativ për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, nr. 03/2013, është kompletuar korniza ligjore vendore për procesin e përafrimit. Njashtu janë përpiluar edhe: 'Udhëzuesi Praktik për përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e BE-së' dhe 'Manuali Praktik për Plotësimin e Tabelave dhe Deklaratës së Përputhshmërisë', dokumente këto udhëzuese për procesin e përafrimit të legjislacionit.

Në përgjithësi, përgjegjësia për zhvillimin e politikave dhe përafrimin e legjislacionit i bie institucioneve përkatëse përgjegjëse për hartimin e legjislacionit. Institucioni që e propozon një projekt akt normativ duhet të bëjë përafrimin ligjor me aktet relevante të BE-së, si dhe të vlerësojë përputhshmërinë e projektaktit normativ me *acquis* të BE-së.

Në funksion të përafrimit ligjor sipas standardeve evropiane, ky proces realizohet dhe vlerësohet nga institucionet gjegjëse përmes përpilimit të Deklaratës e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelave të Përputhshmërisë (TeP). Këto dokumente janë instrument dhe shërbejnë për vlerësimin e përputhshmërisë së një projekt akti normativ me *acquis*, të cilat përpilohen nga institucioni propozues i projekt aktit normativ. Mbi këtë bazë, pastaj Ministria e Integritimit Evropian lëshon Opinion Ligjor të Përputhshmërisë (OeP) me të drejtën e BE-së për projekt aktin normativ. Projektakti normativ, së bashku me DeP, TeP dhe OeP, i dërgohen Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit që shqyrton përputhshmërinë e e projektaktit me Kushtetutën dhe rendin juridik, zhvillimin procedural të aktit dhe me standardet e hartimit të akteve normative. Si rrjedhojë, pas miratimit të projektligjit nga Qeveria, ai dërgohet në Kuvend për miratim. Pakoja e projektligjit me të gjitha dokumentet relevante dërgohet në Komisionin për Legjislacion, Komisionin për Integritim Evropian, si dhe sipas fushëveprimtarisë së projektligjit, mund të dërgohet edhe tek komisionet tjera, të cilët bëjnë rishikimin, analizën, si dhe sipas nevojës plotësim-ndryshimin e projektligjit përkatës dhe më pas dërgohet për miratim.

Në saje të zhvillimeve në të ardhmën e afërt për ngritjen e kapaciteteve profesionale për përafrimin ligjor me *acquis* të BE-së, do të vazhdojnë ciklet e trajnimeve të cilat do të bëhen për shërbyesit civil në administratën publike të cilët merren me hartimin e projekt akteve normative dhe përafrimit e tyre me *acquis* të BE-së. Trajnimet profesionale në fushën e "Përafrimit të Legjislacionit Vendor me Legjislacionin e Bashkimit Evropian" do të realizohen në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Administratë Publike.

Pjesë e zhvillimeve afatmesme në fushën e përafrimit ligjor do të jetë krijimi i një platforme elektronike që do të ketë funksion: ruajtjen e TeP dhe DeP; Plotësimin e Tep; dhe ndërlidhjen e aktit vendor me *acquis* të BE-së, përcaktimin e shkallës së përafrimit si dhe ndërlidhjen me PKZMSA-në.

Kjo platformë do të ndihmojë në përmbushjen dhe identifikimin e saktë të dispozitave të MSA-së të cilat janë zbatuar përmes transpozimit të akteve të BE-së në aktet përkatëse ligjore të vendit.

Vlen të theksohet që Kosova në mënyrë graduale do përafrohet edhe me kërkesat ligjore që derivojnë nga konventat, traktatet dhe obligimet për anëtarësim në organizata tjera që derivojnë nga MSA-ja.

Njëherit, përkthimi i legjislacionit të BE-së është pjesë integrale e procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së. Njëra ndër përgjegjësitë e Ministrisë së Integritimit Evropian që derivon nga

²⁸ Ky kapitull nuk përmban matricë të masave afatshkurtra.

Vendimi nr. 6/121 i datës 22.04.2010 për fushëveprimin e MIE-së është poashtu “Koordinimi i përkthimit të legjislacionit të BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Në këtë kontekst, procesi i përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian është i rregulluar me “Rregulloren për Procesin e Përkthimit të Legjislacionit të Bashkimit Evropian në Gjuhët Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 02/2015”, e cila përcakton procedurat e përkthimit, koordinimin e procesit të përkthimit, si dhe unifikimin e terminologjisë të Acquis të BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në funksion të përmbushjes së obligimeve ligjore, si dhe ndërmarrjes së veprimeve për realizimin e përkthimit të *acquis*, në kuadër të masave afatshkurta, MIE do të bëjë identifikimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian të përkthyer deri më tani në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, autoritetet, si dhe organet tjera të administratës shtetërore. Aktet e përkthyer nga institucionet tjera do t’i nënshtrohen procedurës së rishikimit dhe MIE do të krijojë një databazë fillestare të këtyre akteve të përkthyer.

Në sajë të ngritjes së kapaciteve profesionale dhe bashkëpunimit në këtë fushë, më 26 mars 2014, Ministria e Integritimit Evropian e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Integritimit Evropian e Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi për krijimin e Komisionit Teknik për Përkthimin e Legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit, për koordimin e agjendës së përbashkët të përkthimit të akteve të BE-së bazuar në aktet relevante për përafrim të përcakutara në MSA, si dhe shkëmbimin e akteve ligjore të përkthyer të BE-së nga të dy vendet. Gjithashtu, Ministria e Integritimit Evropian dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me datë 13 mars 2015 kanë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi në fushën e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Në sajë të masave afatmesme, synohet të realizohet përkthimi i akteve ligjore të BE-së në gjuhën shqipe, që do të planifikohet në bazë të Programit Vjetor Legjislativ të Qeverisë, si dhe në bazë të prioritetëve dhe afateve kohore brenda periudhave tranzitore të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Gjithashtu, në funksion të realizimit të përkthimit profesional të *acquis* të BE-së në versionin e gjuhës serbe, do të shqyrtohen dhe bëhen përpjekje në identifikim e mundësive dhe përzgjedhjen e modaliteteve për realizimin e përkthimit të *acquis* të BE-së me institucionet relevante të cilat mund të kontribuojnë në këtë proces, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin rajonal.

3.2. Kapitulli 1 i *acquis*-së: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull mbulon kërkesat që dalin nga legjislacioni i BE-së me qëllim të sigurimit të qarkullimit plotësisht të lirë të produkteve në tregun e brendshëm dhe respektimit e zbatimit të këtij parimi të përgjithshëm nga secili shtet anëtar. Për të siguruar respektimin dhe zbatimin e këtij parimi themelor të funksionit të tregut të brendshëm, me qëllim që produktet të përmbushin standardet dhe kërkesat për t’u tregtuar në tregun e brendshëm të BE-së, zbatimi i këtij kapitulli nga ana e shteteve aderuese u kërkon atyre që të vendosin tërë kornizën ligjore e rregullative, në harmoni me atë të BE-së, për ‘qasjen e vjetër’ (që përcakton kërkesat specifike për produkte) dhe ‘qasjen e re’ (që përcakton specifikimet esenciale për produkte). Harmonizimi i legjislacionit vendor arrihet përmes transpozimit të plotë të *acquis*-it të BE-së në kuadër të fushëveprimit të këtij kapitulli deri në anëtarësimin e plotë. Përveç kësaj, shteteve aderuese gjithashtu u kërkohet të zhvillojnë dhe zbatojnë politika nacionale për të siguruar zbatimin e legjislacionit të harmonizuar me atë të BE-së, si dhe të vendosin dhe funksionalizojnë plotësisht tërë sistemin institucional dhe kapacitetet institucionale që nevojiten për të zbatuar këtë legjislacion e politika, si dhe për të zbatuar masat horizontale e procedurale në fushat specifike të standardizimit, vlerësimit të konformitetit, akreditimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut.

Lëvizja e lirë e mallrave është një element kyç në krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. Nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), parandalojnë Shtetet Anëtare që të miratojnë dhe vendosin kufizime të pajustificuara ndaj tregut të lirë të mallrave brenda tregut të brendshëm, përveç tregtisë brenda BE-së. Dispozitat e TFBE-së nuk përjashtojnë ndalesat e justifikuar, dhe zbatohen proporcionalisht, mbi bazën e moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, apo mbrojtjes së pronësisë industriale e

komerciale, si dhe të kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh. mbrojtja e mjedisit). Masat që kanë efekt të barasvlershëm me kufizim sasior, përveç disa përjashtimeve, gjithashtu janë të ndaluara. Kjo sidomos nënkupton eliminimin e barrierave teknike në tregti dhe respektimin e parimit të njohjes së ndërsjellë, përfshirë procedurat e shkëmbimit të informatave.

Legjislacioni i qasjes së re dhe globale mbulon pajisjet e tensionit të ulët (LVD), kontabilitetin elektromagnetik (EMC), lodrat, makinerinë, ashensorët, emetimet e zhurmës nga pajisjet për përdorim jashtë objekteve, emetimet e ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo rrugore, pajisjet personale mbrojtëse (PPM), pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera shpërthyes (ATEX), pajisjet mjekësore, pajisjet e gazit, veglat nën presion, instalimet e teleferikut, produktet e ndërtimit, artizanate rekreative, kërkesat e eko-projektimit për produktet e lidhura me energjinë (ErP), dhe pajisjet terminale të radio dhe telekomunikacionit (R&TTE). Legjislacioni i qasjes së vjetër mbulon fushat e automjeteve motorike dhe kimikateve²⁹.

Kërkesat e MSA-së

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës (MSA), "duke pasur parasysh angazhimin e palëve ndaj tregtisë së lirë, në përputhje me parimet përkatëse të Organizatës Botërore të Tregtisë të cilat duhet të zbatohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese", nën Titullin IV "Lëvizja e lirë e mallrave" përmban disa dispozita thelbësore, relevante për Kapitullin 1 të Acquis-it të BE-së

Në nenin 20 thuhet se BE-ja dhe Kosova gradualisht do të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimale prej 10 vjetësh, duke filluar nga hyrja e MSA-së në fuqi. Në nenin 22 ("koncesionet e BE-së për produktet industriale") thuhet se **kufizimet sasiorë** mbi importet në BE dhe **masat me efekt të njëjtë**, për produktet me origjinë në Kosovë, do të shfuqizohen në datën e hyrjes së MSA-së në fuqi. Kosova ka marrë përsipër të njëjtin koncesion për produktet industriale me origjinë në BE (neni 23). Në nenin 24 ("Detyrimet dhe kufizimet mbi eksportin") të dy palët shpallin se me hyrjen e MSA-së në fuqi do të heqin të gjitha **kufizimet sasiorë** mbi eksportet dhe **masat ekuivalente**.

Neni 35 i MSA-së e definon çështjen e indikatorëve gjeografik mirëpo kjo çështje shtjellohet në kapitullin 7 të Pronësisë Intelektuale. Neni 42 i jep të drejta palëve që të marrin masa mbrojtëse në rast të gjetjes së veprimeve të dumpingut, këto veprime duhet të jenë në pajtim me rregullat e OBT-së, pjesa që implementon artikullin 6 të GATT-it 1994.

Ndërsa tek mbrojtja e tregut, MSA kërkon të aplikohet Neni XIX i GATT 1994 dhe rregullat e OBT-së për mbrojtje të tregut. Neni 43 kërkon që masat e mbrojtjes së tregut të merren vetëm për qëllimin e adresimit të problemit, dhe po i njëjti nen cek se këto masa nuk guxojnë të merren në një periudhë më të gjatë se dy vite.

Neni 80, thekson që Kosova duhet gradualisht të arrijë përputhshmërinë me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së për sigurinë e produktit dhe të sjellë infrastrukturën e cilësisë, siç janë procedurat Evropiane të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015 vlerëson se në përgjithësi duhet të përmirësohet bashkëpunimi ndër-institucional për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Në këtë kontekst, është deklaruar që ende nuk ka asnjë dëshmi në lidhje me përafrimin e Rregullores për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH). Ky raport gjithashtu potencon që edhe më tutje duhet të përmirësohet infrastruktura e cilësisë.

Në mënyrë më specifike, për sa i përket *standardizimit*, potencohet fakti që Agjencia Kosovare për Standardizim duhet të konsolidohet si një institucion, dhe të zgjerohet shitjen elektronike të standardeve (funksionin e-commerce).

²⁹ Farmaceutikët dhe kozmetikët janë të mbuluara në Kapitullin 28.

Në lidhje me *vlerësimin e konformitetit*, është vlerësuar që duhet edhe më tutje të bëhet harmonizimi i legjislacionit vendorë me rregullat e BE-së si dhe përdorimi dhe zbatimi i vlerësimit të konformitetit duhet të forcohet tutje.

Për *Metrologjinë*, është theksuar që kapaciteti operacional i laboratorëve duhet të rritet për të përmbushur standardet e nevojshme të cilësisë.

Në lidhje me *mbikëqyrjen e tregut*, kërkohet të përmirësohen mekanizmat e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në Kosovë si dhe zbatimi duhet të forcohet tutje.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Cështjet horizontale

Legjislacioni në fushën e *Standardizimit* rregullohet me Ligjin për Standardizim nr. 03/L-14, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 98/34/KE (amandamentuar me Direktivën 98/48/KE).

Deri më tani, 8,000 Standarde Evropiane (EN) dhe Ndërkombëtare janë miratuar si standarde të Kosovës. Standardet, zakonisht blihen nga Trupi i pranuar i Standardeve Kombëtare të Shqipërisë DPS dhe miratohen përmes metodës së ballinës (faqes së parë).

Korniza ligjore në fushën e *Akreditimit* rregullohet me Ligjin nr. 03/L-069 për Akreditim. Ky ligj përcakton rregullat e funksionimit të sistemit të akreditimit të organit kompetent për vlerësimin e konformitetit. Ky ligj transponon pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 9 korrik që përcakton kërkesat për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut që kanë të bëjnë me vënien e produkteve në treg.

Korniza ligjore për *Vlerësim të Konformitetit* në Kosovë përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Me këtë ligj rregullohet mënyra e përcaktimit të kërkesave teknike për produkte, procedura të vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara si dhe nxjerrjen e rregulloreve nga ana e Ministrive kompetente. Ky ligj transponon pjesërisht Rregulloren (KE) 768/2008 dhe Vendimin nr. 768/2008/KE i Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 9 korrik 2008 mbi një Kuadër të Përbashkët për Marketingun e Produkteve, dhe Shfuqizimi i Vendimit të Këshillit 93/465/KEE.

Për zbatim të këtij ligji, janë nxjerr aktet nënligjore si në vijim:

- Rregullorja nr. 08/2014 për Mënyrën e Shkëmbimit të Informacioneve dhe Notifikimin e Rregulloreve Teknike, Procedurave të Vlerësimit të Konformitetit dhe Standardeve, që transponon pjesërisht Direktivën 98/34/KE.
- Rregullorja nr. 13/2012 mbi Njoftimin në Lidhje me Produktet që Paraqesin Rrezik për Konsumatorët, transponon pjesërisht Direktivën 2001/95/KE.
- Rregullorja nr. 08/2013 për Mënyrën e Themelimit dhe Funksionimit të Shkëmbimit të Shpejtë e Sistemit të Informimit për Produktet e Rrezikshme, që transponon pjesërisht Direktivën 2001/95/KE.
- UA nr. 16/2011 për Mënyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit, që transponon pjesërisht Vendimin nr. 768/2008/KE.

Sa i përket *Procedurave të Njoftimit*, Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit gjithashtu ka krijuar bazën ligjore për transpozimin e Direktivës 98/34/KE dhe Amandamentin 98/48/KE në legjislacionin vendor. Me këtë është nxjerrë Rregullorja nr. 08/2014 për mënyrën e shkëmbimit të informacioneve dhe notifikimin e rregulloreve teknike, procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe standardeve, e cila ka të bëjë me detyrimin e Shteteve Anëtare për të njoftuar njëri-tjetrin me rregulloret që planifikojnë t'i miratojnë me qëllim të shmangies së krijimit të pengesave të panevojshme për tregti. Për momentin kjo rregullore paraqet një bazë për të njoftuar dhe

informuar shtetet anëtare të CEFTA-s në lidhje me punën rregullore dhe të standardeve të cilat janë në përgatitje e sipër.

Sistemi *metrologjik* i Kosovës është i bazuar në Ligjin nr. 2010/03-L-203 mbi Metrologjinë. Me këtë ligj rregullohet sistemi i njësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike si dhe përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë. Për zbatim të tij, është nxjerr UA nr. 15/2011 për Kërkesat Teknike Metrologjike dhe Procedurat e Vlerësimit të Konformitetit për Peshoret Ko-automatike, e cila transpozon pjesërisht Direktivën 2009/23/KE.

Sa i përket *Mbikëqyrjes së Tregut*, korniza ligjore e Kosovës për zbatimin e sigurisë dhe përputhshmërisë së produkteve sigurohet nga Ligji mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit i cili përcakton kornizën horizontale për mbikëqyrjen e tregut. Ai është pjesërisht i përafuar me Rregulloren (KE) nr. 765/2008.

Ligjet tjera përkatëse për mbikëqyrjen e tregut janë Ligji nr. 04/L-078 mbi Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Ligji nr. 03/L-181 mbi Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese.

Bazën ligjore për *Kontrollet Kufitare të Jashtme* përben Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili transpozon pjesërisht Rregulloren 765/2008(KE) dhe Vendimin 768/2008 (KE). Ky ligj mundëson bashkëpunim dhe komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe Drejtorisë Doganore, e cila mund të informojnë autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në lidhje me importet e bllokuara. Në qoftë se Drejtoria Doganore nuk është e informuar për aktivitetet e ndërmarra nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut brenda tri ditëve, importet e bllokuara do të lirohen nëse nuk ka kufizime të tjera për lirim të tyre. Nëse autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konstatojnë se produkti është i rrezikshëm, ata mund të ndalojnë qarkullimin e tij në tregun e Kosovës.

Qasja e re dhe ajo globale

Legjislacioni kornizë për fushat që hynë nën kategorinë e Qasjes së Re është Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Pajisjet e tensionit të ulët (LVD)

Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 02/2012 për Pajisjet Elektrike të Projektuara për Përdorim Brenda Kufijve të Caktuara të Tensionit, e cila transpozon pjesërisht Direktivën 2006/95/KE.

Kosova ka një numër të vogël të prodhuesve të cilët vendosin produktet e mbuluara nga Direktiva e pajisjeve me tension të ulët (2006/95/KE) në tregun e brendshëm të BE-së.

Përputhshmëria elektromagnetike (EMC)

Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 07/2012 mbi Përputhshmërinë Elektromagnetike, e cila transpozon pjesërisht Direktivën 2004/108/KE. Kosova ka një numër të vogël të prodhuesve të cilët vendosin produktet në treg që janë të mbuluara nga Direktiva 2004/108/KE.

Siguria e lodrave

Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 05/2013 për Sigurinë e Lodrave e cila transpozon pjesërisht Direktivën 2009/48/KE.

Kosova ka një numër të vogël të prodhuesve të cilët vendosin produkte në treg që janë të mbuluara nga Direktiva 2009/48/KE.

Makineritë

Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 04/2013 mbi Sigurinë e Makinerive e cila transpozon pjesërisht Direktivën 2006/42/KE.

Sa iu përket emetimeve të zhurmës nga pajisjet që përdoren jashtë objekteve, legjislacioni i Kosovës ende nuk është harmonizuar me Direktivën 2000/14/KE.

Emetimet e zhurmës nga pajisjet që përdoren jashtë objekteve

Legjislacioni i Kosovës ende nuk është harmonizuar me Direktivën 2000/14/KE.

Ashensorët

Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 09/2012 mbi Ashensorët dhe Komponentët e Sigurisë, e cila transponon pjesërisht Direktivën 95/16/KE.

Në Kosovë, ka 1 prodhues të pajisjeve që mbulohet nga Direktiva 95/16/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen kryesisht nga importuesit dhe shpërndarësit.

Pajisjet personale mbrojtëse (PPE)

Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 08/2012 mbi Pajisjet Personale Mbrojtëse, e cila transponon pjesërisht Direktivën 89/686/KEE.

Në Kosovë, nuk ka prodhues të pajisjeve që mbulohen nga Direktiva 89/686/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes (ATEX)

Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 04/2012 mbi Pajisjet dhe Sistemet Mbrojtëse të Destinuar për Përdorim në Atmosfera Potencialisht Shpërthyes e cila transponon pjesërisht Direktivën 94/9/KE.

Pajisjet e gazit dhe bojlerët me ujë të nxehtë

Legjislacioni për pajisjet e gazit rrjedh nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, përmes Rregullos nr. 06/2016 për Pajisjet që Djejin Karburantet e Gazta, e cila transponon pjesërisht Direktivën 90/396/KEE. Ndërsa fusha që mbulohet nga Direktiva 92/42/KEE e cili është relevant për bojlerët me ujë të nxehtë nuk është transpozuar ende në legjislacionin Kosovar.

Në Kosovë, ka shumë pak prodhues të pajisjeve të mbuluara nga Direktivat 2009/142/KE dhe 92/42/KEE. Detyrimet për operatorët ekonomikë zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Pajisjet nën presion

Kjo fushë rregullohet me Ligjin nr. 2006/02-L-103 për Pajisjet nën Presion i cili transponon pjesërisht Direktivën 97/23/KE.

Në Kosovë, nuk ka prodhues të pajisjeve të mbuluara nga Direktiva 97/23/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Enët e thjeshta nën presion (SPVD)

Korniza ligjore bazohet në Ligjin nr. 02-L-103 për Pajisje nën Presion. UA mbi Enët e Thjeshta nën Presion si masë zbatuese e ligjit në fjalë, transponon pjesërisht Direktivën 2009/105/KE.

Në Kosovë, nuk ka prodhues të pajisjeve që mbulohen nga Direktiva 2009/105/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Aerosolët Dispensiv

Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për miratimin e Rregullos nr. 13/2014 mbi Aerosolët Dispensiv, e cila transponon pjesërisht Direktivën 75/324/KEE.

Në Kosovë nuk ka prodhues të pajisjeve që mbulohen nga Direktiva 75/324/KEE dhe amandamentimet e saj. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Teleferikët

Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për miratimin e Rregullores nr. 05/2012 mbi Teleferikët për Transport Njerëzish, e cila transponon pjesërisht Direktivën 2000/9/KE.

Në Kosovë nuk ka prodhues të produkteve dhe sistemeve që mbulohen nga Direktiva 2000/9/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Produktet ndërtimore

Ligjit nr. 04/L-181 për Produktet Ndërtimore dhe Aktet Nënligjore të tij transponojnë pjesërisht Rregulloren 305/2011.

Sektori i ndërtimit i tregut të Kosovës në krahasim me tregjet e vendeve të tjera evropiane është mjaft i vogël. Megjithatë ekzistojnë disa prodhues të produkteve ndërtimore.

Barkat Rekreative

Baza ligjore për këtë fushë gjendet në Ligjin nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Megjithatë, Kosova ende nuk ka miratuar legjislacionin detyrues i cili do të duhet të transponojë Direktivën 94/25/KE.

Kërkesat e eko-dizajnit për produktet e ndërlidhura me energjinë (ErP) dhe etiketimi energjetik i produkteve ende nuk është transponuar Direktiva horizontale 2009/125/KE për eko-dizajn (dhe as aktet përkatëse vertikale ligjore).

Në Kosovë, ekziston një numër i vogël i prodhuesve të pajisjeve që mbulohen nga Direktiva 2009/125/KE (eko-dizajni) dhe aktet e ndërlidhura ligjore për zbatim. E njëjta gjë vlen edhe për Direktivën horizontale 2010/30/BE për Etiketimin e Produkteve të lidhura me energjinë dhe aktet nënligjore mbështetëse të saj. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen kryesisht nga importuesit dhe shpërndarësit.

Radio Pajisjet dhe Pajisjet terminale telekomunikuese (R&TTE)

Legjislacioni primar i Kosovës, përkatësisht Ligji për Komunikimet Elektronike nr. 04/L-109 transponon pjesërisht Rregulloren 136/2009/KE. Sa i përket fushës së konformitetit të pajisjeve radio dhe pajisjeve telekomunikuese, Rregullorja nr. 025/B/13 transponon pjesërisht Direktivën 1999/5/KE, e cila tutje nevojitet të ndryshohet për të qenë në përputhje me Direktivën 2014/53/KE.

Eksplzivët për përdorime civile dhe artikuj piroteknikë

Ligjin nr. 2011/04-L-022 për Përdorimin Civil të Eksplzivëve dhe aktet nën-ligjore transponojnë pjesërisht Direktivën 93/15/KE për Eksplzivë dhe Direktivën 2013/29/KE për Piroteknikë.

Produktet dhe pajisjet mjekësore

Deri më tani, produktet dhe pajisjet mjekësore janë të rregulluara me Ligjin nr. 04-L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Sa i përket pajisjeve ky ligj aktualisht nuk transponon legjislacionin e nevojshëm të BE-së siç janë:

- Direktiva 93/42/KEE mbi pajisjet mjekësore,
- Direktiva 90/385/KE mbi pajisjet mjekësore aktive të implantueshme,
- Direktiva 98/79/KEE mbi pajisjet mjekësore diagnostikuese *in vitro*.

Ky ligj nuk ka transponuar legjislacionin e BE-së për produkte medicinale me përjashtim të Direktivës bazë 2001/83 e cila pjesërisht është përafëruar me UA nr. 01/2015 për Autorizim për Marketing për Produkte Medicinale.

Kosova aktualisht ka një prodhues vendor të pajisjeve mjekësore (Klasa I) për tregun e brendshëm. Janë 147 shitës me shumicë të licencuar për shitjen me shumicë të pajisjeve mjekësore.

Kozmetikët

Legjislacioni i Kosovës nuk është në përputhje ende me *acquis*. Baza ligjore në mënyrë të pjesshme mund të gjendet në Ligjin Nr. 04-L-190 i ndryshuar me Ligjin Nr. 2010/03-L-188 për Produktet dhe Pajisje Medicinale.

Organi qeveritar përgjegjës është Ministria e Shëndetësisë. Aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut kryhen nga Inspektorati Shëndetësor.

Qasja e vjetër

Sa i përket Qasjes së vjetër, përveç prodhuesve të produkteve përkatëse, shteti është gjithashtu përgjegjës për sigurinë e produkteve dhe për këtë arsye duhet krijuar dhe fuqizuar autoritetet përkatës shtetërore për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit (p.sh. regjistrimi, vlerësimi dhe miratimi).

Automjetet motorike

Ligji nr. 02-L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, me qëllim të krijimit të procedurave dhe përcaktimit të kushteve për ofrimin e shërbimeve të homologimit të automjeteve që do të hyjnë në komunikacionin rrugor, ka miratuar Udhëzimin Administrativ nr. 2008/8 për Homologimin e Automjeteve. Ky akt transponon pjesërisht Direktiva 2007/46 mbi Automjetet Motorike dhe Direktivën 2002/24 për Automjetet Motorike me dy ose tre rrota.

Në Kosovë nuk ka prodhues të produkteve (automjeteve) që mbulohen nga direktivat e lartë përmendura. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Emetimet e ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo-rrugore

Në Kosovë, nuk ka prodhues të produkteve (automjeteve) që mbulohen nga Direktiva 97/68 mbi makineritë e lëvizshme jo-rrugore. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Kimikatet - Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve (RVAK)

Legjislacioni i Kosovës ende është në fazën fillestare të transpozimit të legjislacionit të BE-së në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (RVAK) me të gjitha amendamentet. Ndërsa sa i përket përcaktimit të kërkesave teknike dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit për produktet e mbuluara nga Rregullorja (KE) 1907/2006, vlenë të theksohet që Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate transponon pjesërisht rregulloren në fjalë.

Aktualisht, në Kosovë ka disa prodhues të produkteve të mbuluara nga Rregullorja (KE) 1907/2006. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen kryesisht nga importuesit dhe shpërndarësit.

Kimikatet (Klasifikimi, Etiketimi dhe Paketimi (KEP))

Ligjin nr. 04/L-197 për Kimikate dhe UA nr. 17/2014 për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Kimikateve të Rrezikshme transpozojnë pjesërisht Rregulloren (KE) 1272/2008 për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve.

Praktika e mirë laboratorike (GLP)

Direktiva 2004/9/KE përcakton detyrimin e Shteteve Anëtare të përcaktojnë autoritetet përgjegjëse për inspektimet GLP në territorin e tyre. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat e raportimit dhe tregut të brendshëm (= pranimi i ndërsjellë i të dhënave). Direktiva kërkon që Udhëzimet e Rishikuara OECD për Procedurat e Monitorimit të Pajtueshmërisë për GLP dhe Udhëzimi OECD për Ushtrimin e Inspektimit të Stabilimentit Testues dhe Auditimet e Studimit duhet të ndiqen gjatë inspektimeve laboratorike dhe auditimeve të studimit.

Direktiva 2004/10/KE kërkon nga Shtetet Anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që laboratorët që kryejnë studimet e sigurisë në produktet kimike të jenë në përputhje me Parimet e OECD-së të Praktikave të mira laboratorike.

Detergjentet

Korniza ligjore për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit përbëhet nga Ligji për Kimikate nr. 04 /L-197 dhe Rregullorja nr. 02/2015 për Detergjentet që transponojnë pjesërisht Rregulloren (KE) 648/2004.

Plehrat

Korniza ligjore e përbërë nga Ligjit nr. 2003/10 mbi Plehra Artificiale, UA nr. 10/2006 për Cilësinë e Plehrave Artificiale, UA nr. 17/2007 për Formimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Rregullues dhe Bordit Këshillues për Plehrat Artificiale, dhe UA nr. 04/2009 mbi Vendosjen e Taksës për Licencimin e Subjekteve që Merren me Importin dhe Tregtinë e Plehrave Artificiale transponojnë pjesërisht Rregulloren (KE) 2003/2003.

Në Kosovë, nuk ka prodhues të produkteve që mbulohen nga Rregullorja (KE) 2003/2003. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Prekursorët e barërave

Ligjin nr. 02/L-128 për Barna Narkotike, Psikotropet dhe Prekursorët transponon pjesërisht Rregulloren (KE) 273/2004.

Në Kosovë, nuk ka prodhues të produkteve që mbulohen nga Rregullorja (KE) 273/2004. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Masat procedurale

Transparenca në lidhje me çmimet dhe rimbursimin e produkteve mjekësore

Kosova ende nuk e ka përafruar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së në këtë fushë. Në anën tjetër BE-ja ka krijuar një kornizë të përbashkët procedurale nëpërmjet miratimit të të ashtuquajturës Direktiva e Transparencës (Direktiva e Këshillit 89/105/KEE) për të siguruar që vendimet kombëtare për çmim dhe rimbursim të bëhen në mënyrë transparente dhe të mos prishin funksionimin e Tregut të Brendshëm.

Qelqi i kristaltë

Rregullorja nr. 04/2012 mbi Produktet e Qelqit të Kristaltë transponon pjesërisht Direktivën 69/493/KE.

Në Kosovë, nuk ka prodhues të produkteve që mbulohen nga Direktiva 69/493/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Tekstilet

Ekzistojnë tre akte ligjore që rregullojnë etiketimin e tekstileve, Rregullorja nr. 11/2012 mbi përmbajtjen e lëndës së parë dhe etiketimin e tekstilit, Rregullorja nr. 1/2012 mbi Metodën për Analizën Sasiore të Përzierjes së Trefishtë të Fibrave të Tekstilit dhe Rregullorja nr. 12/2012 mbi Metodën për Analizën Sasiore të Përzierjes së Dyfishtë të Fibrave të Tekstilit të cilat transponojnë pjesërisht Direktivën 73/44/KEE dhe Direktivat 96/73/KE dhe 2008/121/KE.

Aktet e mësipërme ligjore sa i përket transpozimit të legjislacionit të lartpërmendur kanë paraprirë Rregulloren (BE) 1007/2011 e cila tani është pjese e *acquis* së tanishme.

Në Kosovë, janë disa prodhues të tekstileve që mbulohen nga Rregullorja (BE) 1007/2011. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen kryesisht nga importuesit dhe shpërndarësit.

Këpucët

Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 10/2012 mbi Etiketimin e Materialeve të Përdorura në Komponentët Kryesorë për Këpucë për shitje tek konsumatori, e cila transponon pjesërisht Direktivën 94/11/KE.

Aktualisht në Kosovë ka disa prodhues të këpucëve dhe/ose komponenteve të tyre në nivelin mikro që mbulohen nga Direktiva 94/11/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik kryesisht do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Cështjet horizontale

Sa i përket infrastrukturës së cilësisë, Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë pranë Departamentit të Industrisë në MTI është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dhe politikave për infrastrukturën e cilësisë dhe çështjen e konformitetit në përgjithësi. Njësia në fjalë po ashtu monitoron funksionimin e këtyre dikastereve.

Organ kompetent për fushë e *standardizimit* është Agjencia për Standardizim (AKS), e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë e cila është trupi i vetëm përgjegjës i standardeve kombëtare. Vlen të ceket që Kosova nuk është anëtare e ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim dhe Komisioni ndërkombëtar i elektroteknikës) dhe e CEN/CENELEC (Komisionet Evropiane për Standardizim dhe për Standardizim Elektroteknik).

Sa i përket fushës së *Akreditimi*, Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) është trupi i vetëm akreditues në vend i përcaktuar me Ligjin për akreditim nr. 03/L-069 dhe Ligjin nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim. DAK është në procesin e përfundimit të vlerësimit nga vlerësues të Ko-operimit Evropian të Akreditimit (EA).

Në fushën e *Metrologjisë*, agjencia për Metrologjinë e Kosovës (AMK) është njësia bazë e sistemit të metrologjisë në Kosovë. Agjencia e Metrologjisë ka përmirësuar kapacitetin e saj për të përmbushur funksionet e veta mbikëqyrëse. Agjencia është e ndarë në dy dikastere, pjesën industriale dhe pjesën ligjore, aktualisht janë pesë laboratorë funksional.

Inspektorati i tregut është organi kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për produktet industriale jo ushqimore, momentalisht ekziston zyra qendrore e inspektoratit të tregut ndërsa zyra të njëjta kane edhe komunat. Ligji aktual për mbikëqyrjen e tregut njih vetëm një trup inspektues mirëpo ende nuk kemi arrit të zbatojmë ligjin, për shkak të pamundësisë së bartjes së buxhetit.

Ekziston databaza që në vete ka informacione për produktet e rrezikshme në treg, aktualisht i mungojnë edhe disa elemente për të qenë në përputhje me databazën e RAPEX-it.

Në lidhje me *mbrojtjen e konsumatorit*, Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorit i cili vepron në kuadër të MTI-së është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dhe politikave që rregullojnë çështjen e mbrojtjes së konsumatorit. Departamenti në fjalë po ashtu pranon edhe ankesat të cilat mandej adresohen tek institucionet relevante (për më shumë detaje, shih kapitullin 28).

Qasja e re dhe globale

Sa i përket kornizës institucionale, kategoria e qasjes së re dhe globale ka një numër të madh të institucioneve që janë përgjegjëse dhe bartëse për politikë bërjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për transpozimin dhe zbatim për fushat në vijim: *Përputhshmëria elektromagnetike, siguria e lodrave, Makineritë, Emetimet e zhurmës nga pajisjet që përdoren jashtë objekteve, Ashensorët, Pajisjet personale mbrojtëse (PPE), Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes (ATEX), Pajisjet e gazit dhe bojlerët me ujë të nxehtë, Aerosolët Dispensiv, Teleferikët.*

Sa i përket *produkteve ndërtimore*, institucion përgjegjës për përafrimin ligjor është Ministria e tregtisë dhe industrisë, e cila gjithashtu siguron mbikëqyrjen e tregut për produktet e ndërtimit, përmes Inspektoratit të Tregut (plasmani në treg). Inspektorati i ndërtimit, i cili është pjesë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e vëzhgon përdorimin e produkteve të ndërtimit. Aktualisht, në Kosovë janë 10 laboratorë të akredituar në fushën e produkteve të ndërtimit.

Tutje, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) është institucion përgjegjës për *pajisjet nën presion dhe enët e thjeshta nën presion (SPVD)*, ku mbikëqyrja e tregut zbatohet nga inspektorati për pajisjet nën presion (pjesa e Inspektoratit të Energjisë). MZHE është gjithashtu përgjegjëse për Kërkesat e eko-dizajnit për produktet e ndërlidhura me energjinë dhe etiketimi energjetik i produkteve, ku mbikëqyrja e tregut zbatohet përmes Inspektoratit të Energjisë

Në lidhje me *Barkat Rekreative* Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse e cila gjithashtu siguron mbikëqyrjen e tregut nëpërmjet inspektorateve të saj.

Institucion përgjegjës si për përafrimin ligjor ashtu edhe për mbikëqyrjen e tregut në fushën e *Radio Pajisjet dhe Pajisjet terminale telekomunikuese (R&TTE)* është Autoriteti Rregullativ për Komunikimet Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Fusha e *eksplozivëve për përdorim civil dhe produktet piroteknike* rregullohet nga Ministria e punëve të brendshme si për përafrimin ligjor ashtu edhe për mbikëqyrjen e tregut.

Në lidhje me *Produktet dhe Pajisjet mjekësore*, institucione përgjegjës janë Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Kosovës për Produkteve dhe Pajisje Medicinale AKPPM. Zbatimi dhe mbikëqyrja e tregut bëhet nga Inspektorati Shëndetësor.

Qasja e vjetër

Sa i përket kapaciteteve institucionale në vijim janë paraqitur përgjegjësitë sipas fushave të caktuara. Në fushën e *Automjeteve Motorike*, Ministria e Infrastrukturës (MI) është autoriteti kompetent për nxjerrjen e kornizës ligjore përfshirë këtu transpozimin e legjislacionit të BE-së në legjislacionin vendorë. Kompetencat e "autoritetit aprovuës" kryhen nga Ministria e Infrastrukturës, ndërsa kompetencat e "shërbimeve teknike" kryhen nga trupat privat të autorizuar nga Ministria e Infrastrukturës. Departamenti i Automjeteve brenda MI është autoritetet përgjegjëse për të kryer mbikëqyrjen e tregut të automjeteve motorike (vetura, autobusë, kamionë, traktorë) në territorin e Kosovës.

Sa i përket *Emetimet e ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo-rrugore*, institucion përgjegjës për transpozimin e legjislacionit të BE-s në legjislacionin kombëtar aktualisht është MTI.

Në lidhje me *Kimikatet* dhe *Detergjentet* Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është autoriteti kompetent për transpozimin e Rregullores (KE) 1907/2006. Mbikëqyrja e tregut kryhet nga Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Inspektoratit fito sanitar.

Autoriteti kompetent për nxjerrje të legjislacionit në lidhje me *Plehrat* është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa mbikëqyrja e tregut zbatohet nga Inspektorati fito-sanitar.

Autoriteti kompetent për legjislacion në fushën e *Prekursorëve të barërave* është Ministria e Shëndetësisë, ndërsa zbatimi ekzekutohet nga Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM). Mbikëqyrja e tregut kryhet nga AKPPM-ja dhe Inspektorati Shëndetësor.

Masat procedurale

Në lidhje me *Transparencën në lidhje me çmimet dhe rimbursimin e produkteve mjekësore* autoriteti kompetent është Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM).

Sa i përket *Qelqit të kristaltë, Tekstilët dhe Këpucët* autoriteti kompetent për transpozimin dhe zbatimin është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa mbikëqyrja e tregut zbatohet nga Inspektorati i Tregut.

Masat afatshkurtra

Masat horizontale

Korniza legjislative

Në planin afatshkurtër, parashihen të realizohen aktivitetet në vijim:

- Miratimi i ligjit për Standardizim i cili do të transpozoi pjesërisht Rregulloren (BE) 1025/2012 për Standardizim Evropian;
- Miratimi i Ligjit nr. 03/L-069 për Akreditim i cili do të transpozoi plotësisht Rregulloren (KE) nr. 765/2008 që përcakton kërkesat për Akreditim dhe mbikëqyrje të tregut Rregulloren 764/2008 të KE dhe Vendimin nr. 768/2008;
- Miratimi i Rregullores mbi Instrumentet Jo-automatike të Peshimit, e cili do të transpozoi plotësisht Direktivën 2014/31/BE mbi Instrumentet Jo-automatike të Peshimit (NAWI);

- Miratimi i Rregullores mbi instrumentet matëse (MID) e cila do të transpozohet plotësisht Direktivën 2014/32/BE mbi Instrumentet Matëse;
- Do të miratohet UA për Administrimin e Trupave të Vlerësimit të Konformitetit i cili do të transpozohet pjesërisht Vendimin 768/2008/KE në një kornizë të përbashkët për marketingun e produkteve;
- Parashihet të miratohet UA për Njohjen e Dokumenteve të Huaja të konformitetit, i cili do të transpozohet pjesërisht Vendimin 768/2008/KE në një kornizë të përbashkët për marketingun e produkteve;
- Miratimi i Udhëzimit për Administrativ mënyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit.

Korniza e politikave

- Do të miratohet Strategjia për Infrastrukturë të Cilësisë si pjesë të Strategjisë për Sektorin Privat 2016-2020
- Do të bëhet përmirësimi i kornizës së politikave me qëllim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe kombëtar të standardizimit, me që rast do të miratohet Plani i Biznesit për Agjencinë Kosovare të Standardizimit
- Do të bëhet zgjerimi i bashkëpunimit me mekanizmat evropian dhe ndërkombëtar në fushën e Akreditimit, në kuadër të së cilës planifikohet të nënshkruhet marrëveshja me EA/MLA(BLA)
- Do të punohet në procesin e aplikimit në mekanizma evropian dhe ndërkombëtarë në fushën e Standardizimit dhe Metrologjisë
- Parashihet të zhvillohen aktivitete për ngritje të kapaciteteve të stafit të Infrastrukturës së Cilësisë
- Do të punohet tutje në rritjen e numrit të trupave të akredituar për vlerësimin e konformitetit
- Do të adaptohen Standarde të reja Evropiane dhe Ndërkombëtare
- Inspektorati i Tregut do të bëjë inspektimin e bizneseve në sipas planit dhe sipas kërkesës së konsumatorit
- Gjithashtu, do të kryhen analiza të zbrastësive sa i përket transpozimit të *acquis* në fushën e konformitetit

Qasja e re dhe ajo globale

Në planin afatshkurtër, parashihet të realizohen aktivitetet në vijim:

Pajisjet e tensionit të ulët (LVD),

- Miratimi i Rregullores mbi Pajisjet e Tensionit të Ulët e cila do të transpozohet plotësisht Direktivën 2014/35/BE mbi Pajisjet e Tensionit të Ulët

Përputhshmëria elektromagnetike (EMC)

- Miratimi i Rregullores mbi Pajtueshmërinë Elektromagnetike e cila do të transpozohet plotësisht Direktivën 2014/30/BE mbi Pajtueshmërinë Elektromagnetike.

Ashensorët

- Miratimi i Rregullores mbi Sigurinë e Ashensorëve cila do të transpozohet plotësisht Direktivën 2014/33/BE mbi Ssigurinë e Ashensorëve.

Pajisjet e gazit dhe bojlerët e ujit të nxehtë

- Miratimi i Rregullores mbi Kërkesat e Efiçencës për Bojlerët e Rinj të Ujit të Nxehtë të Ndezur me Lëndë Djegëse të Lëngët ose të Gaztë e cila do të transpozohet pjesërisht Direktivën 92/42/KEE mbi kërkesat e efiçencës për bojlerët e rinj të ujit të nxehtë të ndezur me lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë.
- Miratimi i Rregullores mbi Pajisjet me Gaz, e cila do të transpozohet plotësisht Direktivën 2009/142/KE mbi Pajisjet me Gaz.

Pajisjet nën presion

- Miratimi i Rregullores mbi Pajisjet nën Presion e cila do të transpozohet pjesërisht Direktivën nr. 2014/68/BE mbi Pajisjet nën Presion.

Veglat e thjeshta nën presion (SPVD)

- Miratimi i Rregullores mbi Enët e Thjeshta nën Presion, e cila do të transpozohet pjesërisht Direktivën nr. 2014/29/BE mbi Veglat e Thjeshta nën Presion.

Qasja e vjetër

Në planin afatshkurtër, parashihet të realizohet aktiviteti në vijim:

Prekursorët e Barërave

- Plotësim/ndryshimi i Ligjit nr. 2007/02-L-128 për Barna Narkotike Prekursor dhe Substanca Psikotrope, i cili do të transpozohet pjesërisht Rregulloren (KE) Nr 1920/2006, Vendimin 2001/419

për Transmetimin e Mostrave të Substancave të Kontrolluara dhe Vendimin 2005/387 në Shkëmbimin e Informacionit, Vlerësimin e Rrezikut dhe Kontrollin e Substancave të Reja Psikoaktive.

Prioritetet afatmesme

Në planin afatmesëm parashihen të realizohen aktivitete si në vijim:

Masat horizontale

- Anëtarësimi i plotë i institucioneve metrologjike në BIPM, Euramet, Welmec, dhe OIML;
- Anëtarësimi i plotë i Kosovës në ISO, IEN dhe CEN CENELEC;
- Kosova të ketë 80% të sektorëve industrialë të mbuluara me trupat e vlerësimit të konformitetit;
- Deri në vitin 2017 të ketë inspektoratin plotësisht funksional të tregut me kapacitete të zgjeruara;
- Rritja e numrit të stafit për 40%, fokusi do të jetë në Metrologji;
- Deri në vitin 2017 të themelohen laboratorët për kohën dhe shpeshhtësinë;
- ASK të adoptoj deri në 15,000 standarde si standarde të Kosovës.
- Ofrimi i mundësisë së shitjes së standardeve online (E-Commerce).

Qasjen e re dhe globale

- Transpozimin në legjislacionin vendor të acuqis së BE-së mbi qasjen e re të produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut (me fokus në Rregulloren mbi Sigurinë e Produkteve të Konsumit dhe Rregulloren për Mbikëqyrjen e Tregut të produkteve);
- Përafrimi sistematik me direktivën horizontale të eko-dizajnit për vendosjen e kërkesave të eko-dizajnit për produktet e lidhura me energjinë dhe masat e saj zbatuese (përafërsisht 20 aktet ligjore) në bazë të Ligjit të Rishikuar për Eficiencën e Energjisë,
- Përafrimi sistematik me direktivën horizontale për etiketimin e energjisë për indikacionin nga etiketimi dhe informacioni standard i produktit të konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera nga produktet e lidhura me energjinë dhe masat e saj zbatuese (përafërsisht 15 aktet ligjore) në bazë të Ligjit të ri për Eficiencën e Energjisë;
- Përafrimi i plotë i legjislacionit të Kosovës mbi produktet ndërtimore me Rregulloren (EU) 305/2011 përmes Ligjit të ri për produktet ndërtimore dhe akteve nënligjore të tij.

Qasja e vjetër

- Sistemi i miratimit të tipit të automjeteve motorike në Kosovë i përafuar me kornizën ligjore të BE-së;
- Transpozimi i Direktivës 2007/46 mbi kornizën për miratimin e automjeteve motorike, dhe aktet ligjore përkatëse sektoriale të BE-së (përafërsisht 60);
- Transpozimi i Direktivës 2002/24 mbi miratimin e tipit të automjeteve motorike me dy ose tre rrota, dhe aktet ligjore përkatëse sektoriale të BE-së (përafërsisht 15); dhe
- Transpozimi i Direktivës 2003/37/KE mbi miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë dhe pyjorë, dhe aktet ligjore përkatëse sektoriale të BE-së (përafërsisht 25).

Masat procedurale

- Analizë e zbrazëtirave të legjislacionit në aspektin e përafrimit të legjislacionit Kosovar me parimet e përgjithshme të Lëvizjes së Lirë të Mallrave e rregulluar në Nenet 34-36 të TFBE-së.

Mbështetja e donatorëve

Aktualisht ekziston një projekt i IPA-së që e mbështet lëvizjen e lirë të mallrave i cili ka filluar të zbatohet në tetor të vitit 2014 dhe do të zgjasë deri në tetor të vitit 2016. Ai fokusohet në tre seksione: Përafrimi i legjislacionit, Rritja e vetëdijes dhe ngritja e kapaciteteve institucionale. Përveç kësaj, është bërë kërkesa për një projekt të ngjashëm në dokumentin e planifikimit sektorial për IPA 2 (2016-2017). Ky kapitull gjithashtu mbështetet në mënyrë indirekte nga GIZ dhe projekti rajonal SIDA në infrastrukturën e cilësisë, ku MTI është pjesë e Komitetit Drejtues.

3.3. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve

Acquis në këtë kapitull parashihet që qytetarët e një shteti anëtar BE-së të kenë të drejtën për të punuar në një shtet tjetër Anëtar. Punëtorët migrantë BE-së duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët vendas në lidhje me kushtet e punës, kushtet sociale dhe avantazhet e taksave. *Acquis* gjithashtu

përfshinë një mekanizëm për të koordinuar dispozitat e sigurimeve shoqërore kombëtare për personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një Shtet tjetër Anëtar.

Kërkesat e MSA-së

Sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), neni 55 parasheh që një kompani e BE-së e themeluar në Kosovë apo një kompani Kosovare e themeluar në BE, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin e themelimit, ka të drejtë të punësojë në një degë të saj punëtorë të cilët janë shtetas të BE-së apo Kosovës respektivisht, nëse ky personel është personel kyç – i specifikuar me paragrafin 2 të këtij neni.

Gjithashtu neni 79, paragrafi 9, sa i përket punësimit dhe lëvizjes së punëtorëve lidhur me përmbushjen e kontratave publike, *acquis* i BE-së në lidhje me shtetasit e vendeve të treta do të zbatohet për sa i përket qytetarëve të Kosovës në BE. Në lidhje me shtetasit e BE-së në Kosovë, Kosova do tu japë të drejta reciproke punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar ngjashëm me ato të qytetarëve të Kosovës në BE sa i përket punësimit dhe lëvizjes së punëtorëve lidhur me përmbushjen e kontratave publike.

Bazuar në Studimin e Fizibilitetit, Kosova ka nevojë që të sigurojë trajtim të barabartë për sa i përket kushteve të punës, shpërblimit dhe shkarkimit të punonjësve të cilët janë të themeluar ligjërisht në territorin e saj. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët rezidentë të ligjshëm të një punonjësi të punësuar ligjërisht në Kosovë do të kenë qasje në tregun e punës gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar të punonjësit/ses. Kosova do të duhej të vendoste rregullat për koordinimin e kufizuar të sistemeve të sigurimeve sociale për shtetasit e BE-së të punësuar ligjërisht në Kosovë dhe anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta.

Duke iu referuar konkluzioneve të fundit të DPSA-2015, Kosova inkurajohet të vazhdojë me negociimin, nënshkrimin dhe implementimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e sigurimeve sociale, me vendet e BE.

Në kuadër të takimit të DPSA-së për Inovacioni, Kapitali Njerëzor, Politikat Sociale dhe Shoqërinë e Informacionit, Kosova inkurajohet që të vazhdojë me negociimin dhe arritjen e marrëveshjeve bilaterale në sigurime shoqërore me Shtetet Anëtare të BE-së. Gjithashtu, rekomandohet finalizimi i Strategjisë Sektoriale 2014-2016 dhe Plani i saj i Veprimit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Legjislacioni ekzistues në këtë fushë është fillestar. Në shumicën e rasteve nuk ka fare sistem të sigurimit apo nuk ka sistem të përshtatshëm për koordinim. Prandaj, negociimi për marrëveshje bilaterale për sigurimet social dëshkohet të jetë i vështirë dhe disa degë të sigurimeve sociale ende nuk ekzistojnë në Kosovë.

Elementet kryesore të kornizës institucionale dhe ligjore në lidhje me trajtimin e barabartë të punëtorëve janë të vendosura. Punësimi i shtetasve të huaj, rregullohet më Ligjin për të Huajt nr. 04/-L-219, përgjegjëse e së cilit është Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është institucion mbështetës, e cila bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2014, për Procedurën e Lëshimit të Lejes së qëndrimit për të huaj dhe vërtetimit për lajmërimin e punës, lëshon vërtetimet për lajmërimin e punës për shtetasit e huaj që punojnë në Kosovë.

Në kuadër të Ligjit për të Huaj janë transpozuar Rregulloret dhe Direktivat në vazhdim:

- Rregullorja 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 13 qershor 2009 mbi themelimin e Kodit të Komunitetit për vizat;
- Direktiva 2009/52/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 18 qershor 2008 mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjësit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm;
- Direktiva 2009/50/KE e Këshillit Evropian e datës 25 maj 2009 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar;

- Direktiva 2008/115/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian e datës 16 dhjetor 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet e anëtare për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt
- Direktiva 2005/71/KE e Këshillit Evropian e datës 12 tetor 2005 mbi procedurat specifike për pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime të kërkimeve shkencore;
- Direktiva 2004/81/KE e Këshillit Evropian e datës 29 prill 2004 mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente;
- Direktiva 2004/114/KE e Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2004 mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim studimi, programe të shkëmbimit për nxënës, trajnim pa pagesë ose shërbim vullnetar;
- Direktiva 2003/109/KE e Këshillit e datës 25 nëntor 2003 në lidhje me statusin shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë;
- Direktiva 2003/86/KE e Këshillit e datës 22 shtator 2003 mbi të drejtën e bashkimit familjar;
- Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 16 dhjetori 1996 në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve;
- Direktiva 2011/98/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2011 mbi procedurën unike të aplikimit për leje unike për shtetasit e vendeve të treta për qëndrim dhe punë në territorin e një Shteti Anëtar dhe në një sërë të drejtash të përbashkëta;
- Rregullorja 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 15 mars 2006 për themelimin e Kodit të Komunitetit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përgjatë kufijve.

Mbikëqyrja dhe zbatimi i dispozitave të kornizës ligjore për lëvizjen e lirë të punëtoreve bëhet nga MPB, dhe nga MPMS përmes Departamentit të Punës dhe Punësimit, i cili është i autorizuar për pjesën e lëshimit të vërtetimeve të lejeve të punës, si dhe Inspektorati i Punës, i cili mbikëqyrë implementimin e legjisllacionit dhe kontrollon lejet e punës.

MPMS si institucion mbështetës, për MPB, ka iniciuar për transponim direktivat:

- Direktiva 2009/52/KE e Parlamentit të Europës dhe Këshillit e datës 18 qershor 2009 për sigurimin e standardeve mbi sanksionet dhe masat kundër punëdhënësve të shtetasve të vendit të tretë me qëndrim ilegal;
- Direktiva 2009/50/KE e Këshillit Evropian e datës 25 maj 2009 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime të punësimit me kualifikime të larta;
- Direktiva 79/7/KEE e Këshillit Evropian e datës 19 dhjetor 1978 për trajtimin e parimit të barabartë të grave dhe burrave në aspektin e sigurimit social.

Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti i miratuar në vitin 2014 hapë rrugë për lidhjen e marrëveshjeve ndërshtetërore lidhur me sigurimet sociale. Marrëveshjet për Sigurime Sociale, duhen të jetë të koordinuara sipas rregulloreve në vazhdim:

- Rregullorja 883/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 29 prill 2004 për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe
- Rregullorja 987/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 16 shtator 2009 që përcakton procedurën për zbatimin e Rregullores 883/2004 për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka hartuar Ligjin nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, që shtetasve të huaj iu jep të drejtë të punësojnë ose në ndonjë mënyrë tjetër të kontraktjnë persona fizik që janë shtetas të një vendi të huaj për qëllim të angazhimit të personave të tillë për të siguruar apo performuar në Republikën e Kosovës, shërbime profesionale, të menaxhimit, administrative, mbikëqyrjes, apo të konsultimit ose funksione teknike. Poashtu personave të tillë fizik do t'i lejohet të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Kosovës për periudhën e kërkuar me kontratën e tyre me investitorin e huaj në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

Fusha e Projektligjit për Investimet e Huaja nuk është e rregulluar me Legjislacionin e BE-së. Megjithatë, Komisioni European thekson që politika e BE-së për investimet është e përqendruar në sigurimin e investitorëve dhe investimeve të tyre me siguri ligjore dhe të qëndrueshme, të parashikueshme, me mjedis të rregulluar në të cilën mund të ushtrojnë biznesin e tyre, në përputhje me rregullat ekzistuese ndërkombëtare që janë më të rëndësishmet në këtë fushë, si Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime e OBT (GATS), Udhëzimet për Ndërmarrjet Shumëkombëshe në kuadër të OECD-së, si dhe instrumenteve të tjera të OECD-së. Aktualisht, fokusi qëndron në negociimin e rregullave të investimeve në kontekst të marrëveshjeve të tregtisë preferenciale që BE-ja negocion me vendet e treta.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Kosova po ashtu ka ndërmarrë masa për të ndihmuar shtetasit e huaj në fusha të caktuara. Për shembull, në sektorin e ndërtimit Kosova njihet licenca të huaja, duke bërë lehtësime për kompanitë e huaja që të sjellin punëtorë për të punuar në Kosovë. Avokatëve, të cilët janë banorë të përhershëm, iu është lejuar edhe të ofrojnë shërbime në Kosovë.

Mungesa e statistikave të besueshme në tregun e punës e bën të vështirë për të vlerësuar nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të fuqisë punëtore të huaj. Një vlerësim i tregut të punës do të ndihmojë Kosovën për të përcaktuar se kur ka një nevojë për rekrutim të punëtorëve të vendeve të treta.

Deri më tani Kosova ka nënshkruar dy marrëveshje në fushën e sigurimeve me ish Republikat e Jugosllavisë, edhe pse Marrëveshjet i referohet periudhave të sigurimit deri në vitin 1999:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për konfirmimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës në pension nr. Dekretit: DMN-003-2013 mars – 2013, implementimi i kësaj marrëveshje ka filluar në nëntor 2013, si dhe
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi, për konfirmimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës në pension nr. Dekretit: No. 147-1287/2013, implementimi i kësaj marrëveshje ka filluar në maj 2014.

Sa u përket masave të zbatuara, MPMS ka hartuar Strategjinë Sektoriale e Punësimit 2014-2020 dhe Planin e Veprimit 2014-2016.

Masat afatshkurtra

Ministria e Punës dhe Mirëqenies, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, po punon për të forcuar bashkërendimin e sigurimeve shoqërore me disa shtete të Bashkimit European. Me Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale 2014-2016, në fushën e sigurimeve shoqërore parashihet fillimi i negociimit të marrëveshjeve të reja në fushën e sigurimeve Sociale me 5 shtete anëtare të BE-së: Zvicra, Austria, R.F e Gjermanisë, Kroacia dhe Sllovenia. Duhet të theksohet se mbarëvajtja e këtyre negociatave nuk varet vetëm nga pala kosovare, prandaj nuk mund të parashikohet një afat kohor për arritjen e marrëveshjeve në fjalë.

Prioritetet afatmesme

Qeveria e Kosovës, e ka në fokus të përpjekjeve të saj negociimin dhe arritjen e marrëveshjeve, lidhur me sigurimet shoqërore për qytetarët e saj që jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës si edhe për punëtorët e Shteteve Anëtare të BE-së të punësuar në Kosovë, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian. Kjo përfshinë lidhjen e marrëveshjeve për sigurimet shoqërore me shumë vende. MPMS në peridhën afatmesme do të rishikojë të gjitha skemat pensionale të cilat financohen nga shteti. Për këtë, MPMS do të hartojë një ligj të ri për pensionet të cilat financohen nga shtetit duke iu pershtatur rrethanave në Kosovë, mundësive buxhetore dhe standarteve ndërkombëtare në fushën e pensioneve.

3.4. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Legjislacioni i BE-së për të drejtën e themelimit dhe lirisë për të ofruar shërbime kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë që e drejta e themelimit e shtetasve të BE-së dhe personave juridik në çdo Shtet Anëtar dhe lirinë për të ofruar shërbime ndër-kufitare të definuara në Nenet 49 dhe 56 të TFBE, nuk pengohet nga legjislacioni kombëtar, përveç rasteve të përjashtimeve të vendosura në traktatin e BE-së. Legjislacioni bazë për këtë fushë konsiston në Direktivën 2006/123 KE për shërbimet në tregun e brendshëm (“Direktiva e Shërbimeve”). Edhe praktikat gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë janë pjesë e *acquis* dhe duhet të respektohen.

Në lidhje me **të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime**, Direktiva e Shërbimeve synon të lehtësojë themelimin dhe ofrimin e shërbimeve në vendet tjera anëtare dhe të ofrojë shërbime ndër-kufitare mes vendeve anëtare. Meqenëse direktiva është instrument horizontal që mbulon një fushë të gjerë të shërbimeve, implementimi i saj kërkon kombinim të masave legjislative, organizative dhe praktike. Dispozitat e direktivës në një masë të konsiderueshme bazohen në praktikat gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushat e lirisë së themelimit dhe ofrimit të shërbimeve dhe komplimentojnë instrumentet ekzistuese të BE. Direktiva obligon vendet anëtare të krijojnë një ‘Pikë të vetme kontakti’ dhe të marrin pjesë në një sistem elektronik të informacionit³⁰ për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunim në mbikëqyrjen e shërbimeve midis vendeve anëtare.

Sa i përket **njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale**, Direktiva 2005/36/KE e amendamentuar nga Direktiva 2013/55/BE vendos rregullat rreth njohjes së diplomave dhe kualifikimeve tjera ndërmjet vendeve anëtare. Kjo lehtëson ushtrimin e profesionit të qytetarëve të BE-së nga një vend në një tjetër për profesionet e rregulluara. Direktiva gjithashtu rregullon ofrimin e përkohshëm të shërbimeve nga profesionistët (Titulli II i Direktivës) dhe një kurrikulë të përbashkët të trajnimeve minimale për disa profesione të rregulluara (Kapitulli III i Titullit III të Direktivës). Gjithashtu, ekziston legjislacioni që rregullon ushtrimin e profesionit për gjyqtarët, agjentët komercial dhe njohja e kualifikimeve profesionale që lidhet me përdorimin, tregtimin dhe distribuimin e produkteve toksike. Në lidhje me kapacitetin administrativ, kërkohet që të ketë një kontakt nacional për pranimin e kërkesave për njohje të kualifikimeve profesionale dhe për bashkëpunim administrativ me autoritetet e vendeve anëtare.

Në fushën e **shërbimeve postare**, legjislacioni bazë përbëhet nga Direktiva e parë Postare 97/67/KE (direktiva kornizë) e amendamentuar nga direktiva e dytë Postare dhe Direktiva e tretë Postare 2008/6/KE që synojnë krijimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare duke hapur këtë treg ndaj konkurrencës në mënyrë graduale, dhe ofrimin e një shërbimi universal postar të kualitetit të lartë për shfrytëzuesit. Sa i përket kapacitetit administrativ, kërkohet krijimi i një autoriteti të pavarur kombëtar rregullator për të siguruar implementimin adekuat të legjislacionit të BE.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat kryesore të MSA që rregullojnë këtë fushë janë të përfshira në nenet 51, 56, 57, 58, 59 dhe 74. Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqi të MSA-se të sigurojë trajtim të barabartë kompanive të BE-se me ato vendore sa i përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës. Neni 57 i MSA-se definon që pas 6 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim Asocimit (KSA) duhet të krijoj modalitetet për të zgjeruar dispozitat e kapitullit mbi ofrimin e shërbimeve për shtetasit e BE-se dhe qytetarëve të Kosovës. Neni 58 i MSA-se obligon Kosovën që pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, KSA-ja të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive lejimin e ofrimit të shërbimeve nga kompanitë e BE-se, nga kompanitë Kosovare ose nga shtetasit e BE-se dhe qytetarët e Kosovës të cilat janë të vendosur në territorin e njërës Pale, për persona tjerë përveç atyre për të cilët dedikohen shërbimet.

Sipas Nenit 74 të MSA-se, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Kosova detyrohet që të përafroj legjislacionin e saj ekzistues dhe të ardhshme me *acquis*-in e BE-së, si dhe të siguroj hyrjen në fuqi dhe zbatimin në mënyrë të duhur. Në një fazë të hershme, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësorë të *acquis*-it të BE në fushën e Tregut të Brendshëm si dhe në fushat e lidhura me tregti.

³⁰ Sistemi Informativ i Tregut të Brendshëm.

Sa i përket profesioneve të rregulluara, sipas Nenit 56 të MSA-se, Këshilli për Stabilizim-Asocimit (KSA) obligohet që brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, do të shqyrtojë se cilët hapa janë të nevojshëm për njohjen reciproke të kualifikimeve, me qëllim që të lehtësohet ky proces për shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës që të fillojnë dhe ndjekin veprimtaritë e rregulluara profesionale respektivisht në Kosovë dhe në BE.

Studimi i Fizibilitetit i Komisionit Evropian i vitit 2012 për MSA ndërmjet BE dhe Kosovës, në pjesën e konkluzioneve dhe rekomandimeve thekson se për të përmbushur obligimet e MSA-së, Kosova duhet të zbatoj legjislacionin kornizë në fushën e tregut të brendshëm dhe tregtisë, përfshirë këtu edhe përmirësimin e statistikave të bizneseve.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015, sa i përket *Lirisë për të ofruar Shërbime*, thekson që Kosova është në një fazë të hershme të përafrimit të legjislacionit të saj me Direktivën e Shërbimeve. Si rezultat duhet të punohet në këtë drejtim më shumë gjatë viteve të ardhshme.

Në lidhje me *Shërbimet Postare*, raporti për vendin nënvizon që ofrimi i shërbimeve universale ende pengohet nga vështirësitë politike në komunat me shumicë Serbe. Në këtë kontekst, vihet në pah fakti që shërbimet postare ndërkombëtare ofrohen në të gjitha administratat postare me përjashtim të Serbisë, për shkak të mungesës së një marrëveshjeje ndërmjet dy vendeve. Në aspektin teknik është vlerësuar që përkundër disa reduktimeve në lidhje me limitin e peshës për shërbimet e rezervuara në vitet e mëparshme, këto ende nuk janë në përputhje me *acquis*.

Në fushën e *njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale*, Raporti për vendin thekson që Kosova duhet të shtojë përpjekjet e saj për të përafruar legjislacionin vendor me Direktivën për Kualifikime Profesionale. Për të arritur këtë, Kosova duhet të hartoj një listë të kërkesave minimale të trajnimeve për profesionet e rregulluara për tu përfshirë në legjislacionin vendor dhe një plan veprimi për harmonizimin e legjislacionit për kualifikime profesionale me *acquis*. Tutje, kërkohet që të miratohet një kornizë në tërë Kosovën në lidhje me profesionet e rregulluara.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime

Në Kosovë ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative që rregullon aspekte të veçanta të shërbimeve. Ndërsa një kornizë e vetme legjislative do të vendoset me transpozimin e direktivës së shërbimeve.

E drejta e themelimit të shoqërive tregtare në Kosovë rregullohet me Ligjin nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare i vitit 2011. Përmes kësaj kornize ligjore rregullohen kushtet e regjistrimit të bizneseve vendore dhe të huaja në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë. Për implementimin e Ligjit nr. 04/L-006, është nxjerr UA nr. 18/2011 i cili ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015. Këto akte ligjore transpozojnë pjesërisht Direktivën 77/91/KEE për koordinimin e masave mbrojtëse, Direktivën 78/855/KEE, lidhur me bashkimet e ndërmarrjeve publike me përgjegjësi të kufizuar (shoqëri aksionare), Direktivën 82/891/KEE në lidhje me ndarjen e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar (shoqëri aksionare), Direktivën 89/667/KEE mbi kompanitë private me përgjegjësi të kufizuar një -anëtarësh (Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar) Direktivën 2005/56/KEE, mbi shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara për bashkimin ndërkufitar, Direktivën 89/666/KEE në lidhje me kërkesat për dhënie informata shpjeguese në lidhje me degët e hapur në një Shtet Anëtar nga lloje të caktuara të shoqërisë të qeverisura nga ligji i një shteti tjetër. Informata më të detajuara mbi Shoqëritë Tregtare gjenden në Kapitullin 6 të PKAA-së.

Po ashtu, në këtë fushë, ekziston Ligji nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave i vitit 2013. Ky ligj rregullon lejet dhe licencat për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare i cili aktualisht aplikohet në të gjithë sektorët ku nevojitet licencim profesional. Me qëllim të zbatimit të këtij Ligji, është miratuar Rregullorja nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave. Kjo Rregullore ka për qëllim të

përcaktoj procedurat për themelimin, administrimin dhe funksionimin e regjistrit qendror të lejeve dhe licencave në nivelin qendror të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, rregullon kushtet e hyrjes, qëndrimit, punësimit, të drejtat dhe detyrimet e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Për implementim të këtij te fundit është nxjerrë UA nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit për Lajmërimin e Punës, i cili rregullon aspektet procedurale që ndjek organi administrativ (Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migrim së bashku me Departamentin për Punë dhe Punësim në MPMS) me rastin e lëshimit të leje qëndrimeve (sidomos atyre për qëllim pune në Republikën e Kosovës).

Ligji dhe UA e lartë përmendur transponojnë pjesërisht legjislacionin e mëposhtëm të fushës së migrimit::

- Rregulloren nr. 810/2009 mbi Themelimin e Kodit të Komunitetit për vizat;
- Direktivën 2009/52/KE për Parashikimin e Standardeve Minimale të Sanksioneve dhe Masave ndaj Punëdhënësve për Punonjësit nga Vendet e Treta me Qëndrim të Paligjshëm.
- Direktivën 2009/50/KE për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune me kualifikim të lartë.
- Direktivën 2008/115/KE për Kthimin Shtetasve të Vendeve të Treta me Qëndrim Ilegal.
- Direktivën e 2005/71/K për Procedurat Specifike për Pranimin e Shtetasve të Vendeve të Treta për Qëllime të Kërkimeve Shkencore.
- Direktivën 2004/81/KE për Lejet e Qëndrimit të Lëshuara ndaj Shtetasve të Vendeve të Treta që janë Viktima të Trafikimit të Qenieve Njerëzore ose që kanë qenë Subjekt i një Veprimi për Lehtësimin e Imigracionit të Paligjshëm, të cilët Bashkëpunojnë me Autoritetet Kompetente.
- Direktivën 2004/114/KE për Kushtet e Pranimit të Shtetasve të Vendeve të Treta për Qëllime Studimi, Programe të Shkëmbimit për Nxënës, Trajnim pa Pagesë ose Shërbim Vullnetar.
- Direktivën 2003/109/KE në lidhje me Statusin e Shtetasve të Vendeve të Treta që janë Rezidentë Afatgjatë.
- Direktivën 2003/86/KE për të Drejtën e Bashkimit Familjar.
- Direktivën 96/71/KE në lidhje me Transferimin e Punëtorëve në Kuadër të o
- Ofrimit të Shërbimeve.
- Direktivën 2011/98/BE për Procedurën Unike të Aplikimit për Leje Unike për Shtetasit e Vendeve të Treta me Qëndrim dhe Punë në Territorin e një Shteti Anëtar dhe në një sërë të Drejtash të Përbashkëta.

Në fushën e investimeve të huaja, ekziston Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, i cili për çdo aktivitet që përfshinë ofertën, ofrimin apo prodhimin e mallrave, shërbimeve, pronës dhe/ose punë për dikë në kthim me ndonjë lloj të pagesës apo kompensimit, të inkurajuar investime nga furnizuesit e sektorit privat të mallrave dhe shërbimeve.

Fusha e ofrimit të shërbimeve juridike, rregullohet me Ligjin për Avokatinë, Ligji për Noterinë dhe Ligji për Procedurën Përmbarimore. *Ligji për Avokatinë*, lidhur me ushtrimin e avokatisë nga avokatët e shteteve tjera, lejon ushtrimin e profesionit të avokatit në territorin e Republikës së Kosovës nën kushtet e reciprocitetit. Avokat i huaj i cili e ka fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit të avokatit në shtetin amë, mund të ushtrojë profesionin e avokatit në Republikën e Kosovës në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë dhe aktet tjera të Odës së Avokatëve të Kosovës. *Ligji për Noterinë*, definon se detyrën e noterit mund ta ushtrojë personi i cili duhet të jetë banor i përhershëm i Kosovës. *Ligji për Procedurën Përmbarimore*, përcakton që për përmbarues privat mund të emërohet personi i cili plotëson kushtet e përcaktuara me ligj dhe njëra ndër to është që të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Fusha e turizmit, rregullohet me Ligjin nr. 04/L-176 për Turizmin, i cili rregullon veprimtarinë turistike dhe hoteliere. Ligji në fjalë, transponon plotësisht Direktivën 90/314/KE, për Paketën e Udhëtimit, Paketën e Shërbimeve dhe Paketën e Turneve.

Shërbimet postare

Shërbimet Postare në Republikën e Kosovës rregullohen me Ligjin nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare i cili rregullon ofrimin e shërbimeve postare, mënyrën e kryerjes së shërbimeve postare, rolin e Qeverisë dhe Rregullatorit në sektorin postar, të drejtat dhe detyrimet e operatorëve postar dhe shfrytëzuesve.

Ligji në fjalë, transponon pjesërisht Direktivën 97/67/KE, Direktivën 2002/39/KE dhe Direktivën 2008/06/KE për Faktin e Kufizimeve sa i Përket Zonës së Rezervuar. Për implementim të këtij ligji, është nxjerr edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2012/05 për "Licencim të Operatorëve Postar" i cili përcakton Kriteret dhe Rregullat e Licencimit të Operatorëve Postar, pastaj Rregullorja për "Standardet e kualitetit të realizimit të shërbimeve universale postare" Nr. 004/B/14 i nxjerrur nga ARKEP, Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 01/2015 për "Rregullat për ushtrimin e kontrollit të operatorëve postar" dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2015 për "Pullën Postare".

Tregu postar në Republikën e Kosovës është i liberalizuar dhe i hapur për konkurrencë që nga maji i vitit 2006, ku përveç Operatorit publik postar NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A., shërbime postare ofrojnë edhe 10 operatorë privat, të cilët ofrojnë shërbime korrier dhe ekspres. Por, shërbimet universale janë të liberalizuara pjesërisht dhe me çmime të ndryshme të cilat identifikohen si zonë e rezervuar dhe një pjesë është ekskluzivitet i operatorit publik postar gjegjësisht Posta e Kosovës sh.a. (PK). Ligji parasheh shërbime të rezervuara me kufizime në çmime për (PK) në peshë deri në 1 kg. Kjo peshë vjen duke u zvogëluar me Vendime nga Autoriteti Rregullator për Komunikimet Elektronike dhe Postare (ARKEP), duke u referuar në ligjin ekzistues të shërbimit postar, dhe është në përputhje me paragrafin 1.4 të nenit 6 të Ligjit 03/L-173. Ky nen është në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore në BE dhe ne duhet rregulluar atë me Ligjin që parashihet të amendamentohet në vitin 2017. ARKEP ka bërë ndryshimin e kufirit të peshës (Vendimi Nr 432, i cili parashikon reduktimin e kufirit të peshës për shërbimet e rezervuara: nga 1 janari 2014 në 500 gr. ndërsa nga 1 Janari 2016 do të jetë në 100 gr. Ref. Vendimi nr. 432, nr. Prot. 046/B/13 i Dhjetorit 2013. Pra, operatorët tjerë postar në raport me operatorin publik postar obligohen që dërgesat postare me peshë 0-100 gr. t'i tarifojnë me çmim jo më të vogël se trefishi i çmimit që operatori publik i tarifon të njëjtat. Poashtu në amendamentim të ligjit duhet ndryshuar disa kompetenca të ARKEP-it që për momentin i ka në dispozicion ti kalojnë MZHE-së.

Zbatimi i Direktivës 2008/06/KE e cila ka për qëllim të heq zonën e rezervuar, ka qenë e detyruar për t'u zbatuar nga shtetet anëtare deri më 31 Dhjetor 2012, ndërsa Republika e Kosovës ende nuk ka filluar me zbatimin e saj, por sipas të tri Direktivave të cekura më lartë, zona e rezervuar është duke rënë në formë graduale deri në heqjen e saj d.m.th. në peshën 0 apo arrijen e liberalizimit të plotë. Masat e planifikuara në dokumentin "Politikat Strategjike të Shërbimit Postar në Republikën e Kosovës 2013-2017" dhe në planin e saj të veprimit përcaktojnë një afat kohor për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me Direktivat e BE-së, deri në fund të 2017.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Harmonizimi me *Acquis*-in në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale dhe programeve të aftësimit profesional është në një fazë të hershme. Megjithatë, në Kosovë, kjo fushë rregullohet me Ligjin e Kualifikimeve Kombëtare, në bazë të cilit është zhvilluar Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK), mekanizëm që mundëson transparencë, mobilitet dhe cilësi në sistemin e kualifikimeve. KKK zbatohet përmes verifikimit të standardit të profesionit, validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të ofruesve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit të lartë. Pra sistemi i kualifikimeve rregullohet përmes Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, kornizë kjo që është e mbështetur në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) si mekanizëm i klasifikimit të kualifikimeve kombëtare ofron bazë për bashkëpunim dhe njohje reciproke të kualifikimeve ndërmjet KKK dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Avancimi i vazhdueshëm i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve nënkupton se Korniza Kombëtare e Kualifikimeve rifreskohet me kualifikime të reja varësisht nga kërkesa e tregut vendor dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Në këtë fushë, ekziston edhe Ligji për Arsim të Lartë në Republikën e Kosovës, qëllimi i të cilit është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane duke përfshirë edhe institucionet arsimore private. Më tej, aktet nënligjore për zbatimin e tij rregullojnë dhe përcaktojnë licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë, kriteret dhe procedurat e validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të ofruesve të AAP, kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit, njohjen e mësimit paraprak, dhe kriteret e

procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional - proceset e brendshme.

Me qëllim të sigurimit të cilësisë, në përputhje me kërkesat e Kornizës Evropiane për Sigurim të Cilësisë, është miratuar Korniza Kombëtare për Sigurim të Cilësisë bazuar në UA nr. 32/2014 për Kriteret dhe Procedurat për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional – proceset e brendshme, e cila është pjesë e Raportit të Vetëvlerësimit që plotësojnë ofruesit e AAP. Korniza Kombëtare për Sigurim të Cilësisë zbatohet nga Autoriteti Kombëtarë për Kualifikime.

Gjithashtu politikat e BE sa i përket sistemit të kualifikimeve në Kosovë janë ndjekur edhe me rastin e vendosjes së pikëve/kredive të kualifikimeve profesionale sipas ECVET- European Credit in Vocational Education and Training, (ku 10 orë është e barabartë me një ECVET kredi).

Gjithashtu janë në fuqi një sërë aktesh nënligjore të cilët rregullojnë zhvillimin dhe verifikimin e standardeve profesionale, përdorimin e standardeve profesionale gjatë zhvillimit të moduleve mësimore, për modifikimet dhe përshtatjen e nevojshme për zhvillimin e qasjes në programet dhe kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional për nxënësit me aftësi të kufizuar apo nevoja të tjera të veçanta, për përkrahjen e vlerësimit dhe certifikimit të kualifikimeve modulare, mbi zhvillimin e kualifikimeve modulare, vlerësimi dhe certifikimin në KK, pakon e veglave, njohjen e mësimit paraprak, monitorim, etj.

Në këtë drejtim sa i përket njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, vetëm katër profesione (kontabilistë, arkitektë, inxhinierë dhe juristë) aktualisht janë të rregulluara me bazë ligjore në Kosovë. Kualifikimet e huaja profesionale janë të njohura përderisa ato janë të certifikuara nga një autoritet i akredituar në vendin e origjinës.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime

Aspekti institucional në fushën e shërbimeve posedon shtrirje horizontale, pasi që ekziston një numër i ministrive dhe rregullatorëve të ngarkuara me përgjegjësi brenda kontekstit të gjerë të shërbimeve. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është institucioni bartës për shërbimet tregtare. Departamenti i Tregtisë në kuadër të MTI-se i cili merret ekskluzivisht me çështjen e shërbimeve ka 10 zyrtarë të punësuar. Departamenti në fjalë ofron mbështetje dhe promovon lëvizjen e lirë të mallrave, të shërbimeve tregtare dhe të kapitalit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. Të gjitha aktivitetet, negociatat, bilaterale dhe multilaterale, përfshirë edhe rishikimin e legjislacionit dhe transpozimin e Direktivës së Shërbimeve të BE-së janë duke u bërë në partneritet me një grup pune të vendosur me institucionet tjera relevante.

Institucionet tjera që kanë kompetenca të caktuara në fushën e shërbimeve përfshijnë: Bankën Qendrore të Kosovës e cila është institucion kryesorë në rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve financiare.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka në kompetence të saj shërbimet e teknologjisë informative dhe të telekomunikimit përderisa Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit është përgjegjës për Shërbimet e Telekomunikacionit. Po ashtu, është themeluar organi koordinues për legjislacionin e shërbimeve si trup i koordinimit horizontal të çështjeve lidhur me këtë fushë.

Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është institucioni përgjegjës për implementimin e politikave qeveritare që kanë të bëjnë me tërheqjen e investimeve të huaja, përkrahjen e eksporteve, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe zhvillimin e zonave ekonomike. KIESA funksionon në bazë të Ligjit nr. 04/L- 220 për Investimet e Huaja, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Aktualisht në KIESA janë 18 zyrtarë të cilët ushtrojnë punën e ndarë në dy drejtori: Drejtoria për Zhvillimin e Ndërmarrjeve dhe Zonave Ekonomike, si dhe Drejtoria për Promovimin e Investimeve dhe Eksporteve.

Ministria e Drejtësisë është institucioni kryesorë që rregullon dhe harton legjislacionin në fushën e shërbimeve juridike. Si institucione zbatuese janë Oda e Avokatëve, e cila është organizatë profesionale e pavarur e avokateve me cilësinë e personit juridik e themeluar në pajtim me Ligjin 04/L-193 për Avokatin dhe Statutin e Odes, e cila është kompetente për ushtrimin e autorizimeve publike dhe kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm. Pastaj, Oda e Përmbauesve Privat e cila është themeluar duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, si organizatë profesionale jo profitabile të cilës i bashkohen të gjithë përmbauesit privat. Tutje, për veprimtarinë e Noterëve ekziston Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës e cila është person juridik në të drejtën publike, që vepron në pajtim me Ligjin nr. 03/L-010 mbi Noterinë. Kjo e fundit është e pavarur në veprimtarinë e saj. Të gjithë noterët janë detyrimisht anëtar të Odës që nga dita e caktimit në pozitën e noterit dhe anëtarësia e tij apo e saj mbaron në ditën e lirimit të postit.

Në nivel qendror, Divizioni i Turizmit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për fushën e turizmit. Përderisa, në nivelin lokal ekzistojnë Drejtoritë e Turizmit, Drejtoritë e zhvillimit Ekonomik, varësisht nga organizimi komunal.

Ministria e Shëndetësisë është organ kompetent në fushën e shërbimeve shëndetësore. Në bazë të Ligjit nr. 04 /L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, një pjesë e shërbimeve shëndetësore do të ofrohen nga Odat pas bartjes së kompetencave nga ministria. Odat e profesionistëve shëndetësor janë organizata të pavarura të cilat mbrojnë dhe prezantojnë interesat profesionale të profesionistëve shëndetësor, sigurojnë standarde të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, edukimin e vazhdueshëm profesional, regjistrimin e profesionistëve shëndetësor dhe lëshimin e licencave, rilicencimi, revokimi i licencave, shkollimin specialistik dhe nën-specialistik.

Sa i përket zbatimit, është përmirësuar baza e të dhënave e vendosur në MTI për tregtinë e shërbimeve. Baza e të dhënave përmban një listë të detajuar të legjislacionit dhe ajo është e organizuar në bazë të sektorëve dhe specifikon agjencitë qeveritare përgjegjëse për masat e ndryshme. Baza e të dhënave gjithashtu përmban komente të shkurta mbi çështje të mundshme për masa të caktuara, siç janë kufizimet e qasjes në treg ose dispozitat e mundshme diskriminuese. Baza e të dhënave është një mekanizëm shumë i vlefshëm. Megjithatë, baza e të dhënave duhet të plotësohet dhe përditësohet dhe nuk përbën një listë të plotë për çdo masë që përfshihet në kërkesat e Direktivës së Shërbimeve.

Vlen të ceket që, Negociatat për shërbimet midis vendeve të CEFTA-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova) janë të ndara në 6 grupe dhe kanë filluar në vitin 2014 me një fokus kryesor në shërbimet profesionale, turizëm, mjedis, shërbime rekreative, komunikim, shërbimet në ndërtim dhe shërbimet e distribuimit, arsimit dhe ato shëndetësore.

Shërbimet postare

Ministria e Zhvillimit Ekonomik është institucioni përgjegjës për nxjerrjen e ligjeve dhe hartimin e politikave në sektorin postar. Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është organ rregullator, i cili zbaton dhe mbikëqyrë kornizën rregullatore bazuar në Ligji nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike dhe Ligjin nr. 03/L-173 për Shërbime Postare, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Në kuadër të kornizës së politikave në sektorin e shërbimeve postare, ekziston dokumenti strategjik "Politikat Strategjike të shërbimit Postar në Republikën e Kosovës 2013-2017. Përmes këtij dokumenti Qeveria e Kosovës synon që ta avancojë sektorin e shërbimit postar, duke ngritur efikasitetin dhe efektivitetin në realizimin e shërbimeve universale postare, në mënyrë që këto shërbime të plotësojnë nevojat e konsumatorëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve postare, krijimin e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar të sektorit postar, qasje të lehtë të shtresave me nevoja sociale në shërbime universale postare, dhe zhvillimin ekonomik të sektorit postar dhe ekonomisë së vendit.

Objektivat kryesore të këtij dokumenti janë:

- Ofrimi i Shërbimit Universal Postar dhe zgjerimi i rrjetit në tërë territorin e Republikës Kosovës;
- Ndryshimi i Kodit postar dhe aplikimi i sistemit elektronik të adresave
- Krijimi i ambientit të përshtatshëm ligjor dhe rregullator për ofrimin e shërbimeve postare;

- Informatizimi i rrjetit postar dhe shërbimeve postare;
- Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe bashkëpunimi rajonal në Sektorin Postar.

Tutje, tregu Postar në Republikën e Kosovës është i liberalizuar dhe i hapur për konkurrencë që nga maji i vitit 2006, ku përveç Operatorit publik postar NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A., shërbime postare ofrojnë edhe 10 operatorë privat, të cilët ofrojnë shërbime korrier dhe ekspres.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Institucioni kryesor për zhvillimin e legjislacionit dhe politikave është Ministria e Arsimit është Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). MASHT ka të themeluar Autoritetin Kombëtar për Kualifikime, i cili është organ publik i pavarur, në pajtim me ligjin për Kualifikime Kombëtare në Kosovë. AKK është përgjegjës për mbikëqyrjen e kualifikimeve kombëtare krahas me MASHT, Agjencinë Kosovare për Akreditim dhe organe tjera profesionale, të aprovuara për këtë qëllim me vendim qeveritar. Në veçanti, është përgjegjëse për kualifikimet profesionale. Të gjitha kualifikimet në KKK, kenë rezultate të qarta, që janë lëndë e vlerësimit me cilësi të siguruar. Institucionet/Ofrues të ndryshme mund të parashtrajnë kualifikimet e tyre për përfshirje në kornizë, ndërkaq Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, vendosë se cilat kualifikime profesionale mund të futen në Kornizën Kombëtar të Kualifikimeve. AKK, akrediton institucionet për vlerësimin e nxënësve dhe lëshimin e certifikatave për kualifikimet në KKK. AKK ka 6 të punësuar.

Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave e themeluar me vendim të MASHT-t nr. 331/01-B në nëntor 2008. Ky institucion operon në kuadër të MASHT dhe bën njohjen e gradave universitare dhe shkollave të larta profesionale, të cilat janë të rregulluara me UA nr. 08/2010 për Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Për titujt e fituar nen nivelin e 5, nuk i nënshtrohen procedurës në qendrën NARIC.

Masat afatshkurtra

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime

Në planin afatshkurtër, parashihen të realizohen aktivitetet në vijim:

- Miratimi i Ligjit për Shërbimet i cili do të transpozoi plotësisht Direktivën 2006/123/KE për Shërbime në Tregun e Brendshëm të BE-së;
- Miratimi i Ligjit për Turizëm i cili do të transpozoi pjesërisht Direktivën 93/13/KE për Kushtet e Pabarabarta Kontraktuese, Direktivën 2008/122/KE për Mbrojtjen e Konsumatorëve lidhur me Aspektet e Ndryshme të Ndarjeve Kohore, Produktit Pushimorë Afatgjatë, Kontratave të Rishitjes dhe Shkëmbimit si dhe Direktivën 2011/14/KE për Aplikimin e të Drejtave të Pacientëve në Përkujdesin Shëndetësor Ndër-kufitar;
- Do të bëhet plotësim/ndryshimi i Ligjit për të Huajt në mënyrë që të transpozohet Direktiva 2014/66/KE për Kushtet e Hyrjes dhe Qëndrimit të Qytetarëve të Vendeve të Treta në skemën e një Transferimi Brenda Korporatës.
- Realizimi i analizës së mangësive (gap analysis) me qëllim të vlerësimit të legjislacionit horizontal në lidhje me harmonizimin e mëtutjeshëm me Direktivën e Shërbimeve;
- Pjesëmarrja në negociata në kuadër të CEFTA-së me që rast do të negociohen Shërbimet e Financave, të Transportit dhe Audiovizuale.
- Me qëllim të përmirësimit të dhënave statistikore të shërbimeve MTI do të funksionalizojë dhe popullojë me të dhëna databazën lidhur me shërbimet në Kosovë.

Shërbimet postare

Në planin afatshkurtër, në fushën e shërbimeve postare parashihen të realizohen aktivitete në kuadër të planit të veprimit të dokumentit strategjik “Politikat Strategjike të Shërbimit Postar në Republikën e Kosovës 2013-2017” si në vijim:

- Finalizimi i koncept dokumentit për plotësim/ndryshimin e ligjit ekzistues për shërbimet postare;
- Do të punohet tutje në aplikimin e sistemit elektronik;
- Informatizimi i rrjetit dhe shërbimeve postare;
- Bashkëpunimi me administratat tjera postare të vendeve rajonale;

- Zbritja e zonës së rezervuar të shërbimit postar prej 500 gr në 100 gr, dhe zbritja e saj në formë graduale, i cili aktivitet do të transpozohet pjesërisht Direktivën 97/67/KE mbi Rregullat e Përbashkëta për Zhvillimin e Tregut të Brendshëm të Shërbimeve Postare në Komunitet dhe Ngritjen e Cilësisë së Shërbimeve.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Në planin afatshkurtër, parashihen të realizohen aktivitetet në vijim:

- Miratimi i Ligjit për Profesionet e Rregulluara, i cili do të rregullojë këto profesione: atë të Mjekut, Stomatologut, farmacistit, Infermierit, mamisë, Fizioterapeutit, Veterinerit, Arkitektit, Inxhinierit, Mësimdhënësit e të gjitha niveleve për arsimin para-universitar, Psikologut dhe punetori social. Ky ligj do të transpozohet pjesërisht Direktivën 2005/36/KE për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale dhe Direktivën 2013/55/KE për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale e cila e amendon Direktivën 2005/36/KE;
- AKK do të bëjë akreditimin e ofruesve që të do vlerësojnë njohurit paraprake të kandidatëve. Pra do të fillojë zbatimin i UA për Njohjen e Mësimit Paraprak për të parën herë në vend. Kjo nënkupton se ofruesit e AAP do të kenë mundësi që të akreditohen nga AKK që të bëjnë vlerësimin e Njohës së Mësimit Paraprak;
- AKK do të vazhdojë edhe me procesin e akreditimit të nivelit të 5 të KKK, nivel ky që tregon se kandidatet janë të përgatitur për tregun e punës, pra janë profesionist të asaj fushe;
- AKK do të fillojë me procesin e monitorimit të institucioneve të akredituara nga AKK, ku përmes këtij procesi do sigurohet dhe rritet edhe me tepër cilësia në arsimin dhe aftësimin profesional.

Prioritetet afatmesme

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime

Në planin afatmesëm, prioritet do të jepet aktivitetëve në vijim:

- Ligji për tregtinë në shërbime parashihet të zbatohet plotësisht brenda periudhës 5 vjeçare me që rast do të rishikohen/ndryshohen të gjitha ligjet horizontale të Kosovës që ndërlidhen me tregtinë në shërbime, si dhe të transpozohen Direktivat dhe Rregulloret tjera relevante të BE-së. Kjo do të kontribuojë për t'u siguruar që ligjet sektoriale nuk bien në kundërshtim me Acquis të BE-së;
- Do të vazhdojë projekti i BE-së për implementimin e Direktivës së Shërbimeve, me që rast do të harmonizohet edhe më tej legjislacioni për shërbimet; Planifikohet të krijohet Pika e Vetme e Kontaktit (Point of Single Contact) brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që do t'i thjeshtësojë të gjitha procedurat administrative dhe ofrojë qasje të lehtë, ushtrim të aktivitetit të ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike. Në kuadër të këtij projekti do të punohet në ngritjen e kapaciteteve në sektorin e shërbimeve në MTI;
- Në lidhje me shërbimet juridike, planifikohet të nxirren akte të tjera ligjore për të transpozuar rregulloret dhe direktiva tjera të BE-së lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së avokatëve në shtetet anëtare të BE-së përveç atyre në të cilat i kanë marrë kualifikimet, pastaj aktivitetet e agjentëve komercial, si dhe njohjen e kualifikimeve profesionale për aktivitetet që ndërlidhen me përdorimin, tregtimin dhe distribuimin e produkteve toksike. Në këtë kategori do të merren parasysh Direktiva 74/557/KE për lirinë e themelimit dhe ofrimit të shërbimeve (personat e vetë-punësuar dhe ndërmjetësuesit e përfshirë në tregtinë me produkte toksike); Direktiva 74/556/KE për masat transitorie lidhur me tregtinë në produkte toksike dhe përdorimin profesional të produkteve të tilla; Direktiva 86/653/KE që mbulon agjentët e vetë-punësuar komercial. Direktiva 92/2002/KE mbulon ndërmjetësimin e sigurimeve përkatësisht ndërmjetësuesit e sigurimeve; Direktiva 96/26/KE që mbulon operatorët transportues dhe operatorët e transportit të pasagjerëve; Rregullorja nr. 1071/2009/ për themelimin e rregullave të përbashkëta sa i përket kushteve që duhet të përmbushen për të zhvilluar profesionin e operatorit të transportit rrugor;
- Në fushën e investimeve të huaja, parashihet që deri në vitin 2018, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë të kalojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës.
- Në KASH 2016-2018 parashihet rritja e stafit në 9 (nëntë) zyrtarë nga 4 që janë tash në Divizionin e Turizmit në kuadër të MTI-së;
- Në fushën e shërbimeve shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë gjatë periudhës 2017-2020 parashikon fuqizimin e mëtutjeshëm të Zyrës për trajtim jashtë vendit përmes riorganizimit dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe personelit përmes trajnimeve brenda dhe jashtë

vendit. Në funksion të zbatimit të Ligjit të Odave të Profesionistëve shëndetësor do të realizohet bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë/Bordet tek Odat e profesionistëve shëndetësor ku do të përfshihen edukimi i vazhdueshëm profesional, licencimi dhe rilicencimi i profesionistëve shëndetësor, edukimi specialistik dhe nën-specialistik;

- Ministria e Shëndetësisë gjatë kësaj periudhe do të bëjë harmonizimin e legjislacionit vendor me këto akte juridike të BE që rregullojnë fushën e trajnimeve të infermierëve, mamive, mjekëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor dhe njohjen e kualifikimeve profesionale në pajtueshmëri me Direktivën nr. 2005/36 për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Shërbimet postare

Në planin afatmesëm, prioritet do ti jepet aktiviteteve në vijim:

- Nxjerrjen e legjislacionit sekondar me qëllim të implementimit të ligjit për shërbime postare;
- Parashihet të vazhdon realizimi i aktiviteteve në kuadër të planit të veprimit të dokumentit strategjik “Politikat Strategjike të Shërbimit Postar në Republikën e Kosovës 2013-2017”.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Në planin afatmesëm, prioritet do ti jepet aktiviteteve në vijim:

- Nxjerrjen e legjislacionit sekondar me qëllim të implementimit të ligjit për Profesionet e Rregulluara;
- Në sektorin e kualifikimeve profesionale, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve planifikon të krijoj programin e posaçëm që të do të mundësoj operimin e sistemit elektronik të monitorimit për institucionet e akredituara të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP). Ndër tjerash, planifikon të trajnoj personat përgjegjës të institucioneve të akredituara për mënyrën e përdorimit të programit në fjalë.

Mbështetja e donatorëve

Në fusha e të drejtës së themelimit dhe lirisë për të ofruar shërbime, u pranua asistence teknike nga projekti për zhvillimin e mëtejshëm të politikave tregtare të Kosovës. Ky projekt filloi në vitin 2011 dhe përfundoi në vitin 2015, i cili u financua me shumën 2.8 milion euro nga Bashkimi Evropian. Projekti në fjalë nuk ishte i destinuar vetëm për shërbime, por ndërkohë janë zhvilluar disa aktivitete në fushën e shërbimeve.

Projekti për Direktivën e Shërbimeve, parashihet të filloj në vitin 2016. Qëllimi i këtij projekti është të ndërtoj kapacitete brenda MTI-së me qëllim që të transpozohet dhe zbatohet Direktivën e Shërbimeve të BE-së në tregun e brendshëm të Kosovës. Komisioni Evropian është financuesi i këtij projekti.

3.5. Kapitulli 4 i *acquis*-së: Lëvizja e lirë e kapitalit

Shtetet anëtare duhet të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit dhe pagesave, me disa përjashtime, si brenda BE-së, ashtu edhe mes Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. *Acquis* i këtij kapitulli është i bazuar në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, në veçanti nenet 63-66. Definicioni i llojeve të ndryshme të kapitalit bëhet në Aneksin I të Direktivës 88/361/KEE. Praktikë gjyqësore të Gjykatës Evropiane e Drejtësisë dhe Komunikatat e Komisionit ofrojnë interpretime shtesë të neneve të mësipërme.

Legjislacioni i BE-së përfshinë edhe rregullat për pagesa ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon që entitetet që janë subjekt i kësaj direktive të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet e dyshimta, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë dhe për transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Kjo direktivë gjithashtu kërkon që entitetet të ndërmarrin hapa shtesë si mbajtja e evidencës, trajnimet dhe krijimi i procedurave të brendshme të entiteteve të kësaj fushe. Një kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative dhe zbatuese, përfshirë edhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale. Direktiva e re është harmonizuar por shkon përtej rekomandimeve për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të Task Forcës për Veprim Financiar (FATF).

Acquis e kësaj fushe gjithashtu përbëhet nga Konventat nr. 141 dhe nr. 198³¹ të Këshillit Evropian dhe legjislacioni i BE-së për bashkëpunim në fushën e drejtësisë dhe policisë (përfshirë Veprimin e Përbashkët 98/699/JHA, Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/500/JHA dhe Protokollin e vitit 2000 që zgjeron kompetencat e Europol-it në fushën e pastrimit të parave). Ngjashëm, Vendimi i Këshillit 2000/642/JHA i vitit 2000 vendos kornizën e bashkëpunimit midis Njësive të Intelegjencës Financiare të vendeve të BE-së.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimet e Kosovës në MSA në lidhje me lëvizjen e lire të kapitalit dalin nga Nenet 51, 63, 64, 65 dhe 89.

Neni 51 i MSA-së, obligon Kosovën të ofroj mundësinë që filialet dhe degët e shoqërive të BE-së, brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e MSA-së, të gëzojnë të drejtën e përvetësimit dhe gëzimit të drejtave të pronësisë mbi pasuritë e patundshme sikurse kompanitë Kosovare.

Neni 64 i MSA-së, parashikon detyrimet që rrjedhin në lidhje me çdo pagesë apo transfer në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet BE-së dhe Kosovës në përputhje me Nenin VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve duke përfshirë huat financiare dhe kreditë, ku merr pjesë një rezident i njërës prej Palëve.

Neni 65 i MSA-së obligon Kosovën brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, t'i ofroj trajtim kombëtar shtetasve të BE-së që blejnë pasuri të patundshme në territorin e saj.

Neni 89 i MSA-së, parasheh bashkëpunimin e palëve në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Në lidhje me kërkesat që dalin nga Raporti i KE-së për Kosovën 2015, është theksuar që në lidhje me *Liberalizimin e Lëvizjes së Kapitalit*, sa i përket blerjes së patundshmërisë nga qytetaret e huaj, dispozitat në ligjet përkatëse, akte zbatuese dhe praktikat administrative janë ende një pengesë për trajtim të barabartë. Vështirësi të tjera, p.sh. në regjistrimin e pronës, duhet të adresohen.

Sa i përket *sistemit të pagesave*, është cituar që nevojiten përpjekje të mëtejshme për të vazhduar përafrimin me acquis.

Në lidhje me *parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizimit*, Raporti për Vendin nënvizon që duhet të bëhen më shumë përpjekjeve për të arritur rezultate të prekshme në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Në Kosovë kjo fushë ka bazën fillimisht në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht në nenin 119 paragrafin 2, ku garanton të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme. Neni 121 paragraf 2 dhe 3 i Kushtetutës jep parimet e përgjithshme që “personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja mund të sigurojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare si dhe personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të sigurojnë të drejta të koncesionit dhe të drejta të tjera për shfrytëzim dhe/ose eksploatim të resurseve në pronësi publike, përfshirë këtu resurset natyrore, dhe të infrastrukturës në pronësi publike.”

Tutje, ekziston Ligji nr. 02/L-33 për Investimet e Huaja, i cili u jep investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre trajtim të njëjtë dhe të barabartë me ndonjë investitor vendor dhe investimeve vendore.

³¹ Kjo e zgjeron konventen 141 dhe është ratifikuar edhe nga BE.

Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore nr. DL-016-2009, si ligj bazë lidhur me pronësinë, nuk e specifikon mundësinë e fitimit të drejtës për paluajtshmëritë nga personat fizik apo juridik. Në anën tjetër, *acquis* e BE-së përmban mundësinë, për persona fizik dhe juridik të fitojnë të drejtën në paluajtshmeri në çfarëdo shteti anëtar të BE-së. Legjislacioni në BE lidhur me këtë çështje ndryshon vetëm për shtetasit jashtë BE-së.

Sistemi i pagesave

Sa i përket kornizës ligjore, sistemi i pagesave në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili e përcakton Bankën Qendrore si autoritetin e vetëm përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave të Republikës së Kosovës, me qëllim të garantimit të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të tij. Ligji nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave i cili e transponon pjesërisht Direktivën 2007/64/KE të Parlamentit Evropian. Ky i fundit përcakton rregullat sipas të cilave autorizohen institucionet e pagesave që ofrojnë shërbime të pagesave dhe licencohen operatorët e sistemeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë nga Banka Qendrore, kushtet dhe standardet sipas të cilave mund të ofrohen shërbimet e tilla dhe mund të funksionojnë sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së pagesave dhe mjetet dhe procedurat sipas të cilave Banka Qendrore i ushtron kompetencat e saja mbikëqyrëse.

Në pajtim me këto ligje është zhvilluar edhe legjislacioni sekondar i cili përfshinë shtatë rregullore dhe katër udhëzime administrative të cilat pjesërisht transponojnë Direktivën 2007/64/KE mbi Shërbimet e Pagesave në Tregjet e Brendshme, Rregulloren nr. 1409/2013 e Bankës Qendrore Evropiane për statistikën e Pagesave (ECB/2013/43) dhe Rregulloren nr. 260/2012 mbi Vendosjen e Kriteve Teknike dhe Biznesore për Transfere Krediti dhe Debitim Direkt.

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Kjo fushë rregullohet me Ligjin 03/L-196, për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i cili është nxjerrë në tetor të vitit 2010. Ligji në fjalë përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin dhe parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë në mënyrë efektive. Ky ligj themelon edhe Njësinë për Inteligjencë financiare, si institucion qendror i pavarur kombëtar, përgjegjës për marrjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.

Ligji përkatës është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2013 me ligjin 04/L-178 i cili është përafëruar me standard ndërkombëtare të Task forcës për Veprim Financiar (FATF) dhe Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për qëllime të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Sa i përket kapaciteteve institucionale, Ministria e Drejtësisë është institucioni kryesorë për nxjerrjen e legjislacionit dhe zhvillimin e politikave për çështje pronësore. Kjo ministri posedon Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave i cili është bartës i procesit të koordinimit të aktereve kyç për hartimin e Strategjisë Kombëtare, Sektoriale për të Drejtat Pronësore. Institucione tjera të ndara nëpër dikastere të ndryshme apo si Agjencione të pavarura të cilat merren me çështjet pronësore janë: Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamenti i Shpronësimit, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, etj), Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Ministria e Financave (Departamenti i Tatimit në Pronë), etj.

Sa i përket kornizës së politikave, deri më tani nuk ka pasur asnjë strategji përkatëse e cila në mënyrë të unifikuar rregullon çështjen pronësore. Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore e cila parashihet të miratohet gjatë vitit 2016 ka pikërisht këtë rol: harmonizimin e politikave dhe përgjegjësiwe institucionale me qëllim të përmirësimit të legjislacionit dhe institucioneve zbatuese, duke përmirësuar definimin e të drejtave pronësore dhe ushtrimit të tyre.

Njëkohësisht, Ministria e Drejtësisë ka krijuar Komisionin për hartimin e Kodit Civil të parë të Republikës së Kosovës. Kodi Civil do të përqendrohet në tri shtylla: ligji për familje dhe trashëgimi, ligji për detyrimet, si dhe ligji për të drejtat pronësore.

Sistemi i pagesave

Sa i përket kapaciteteve institucionale dhe administrative, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është ekskluzivisht përgjegjëse për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave. BQK e ka për objektiv parësor “të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave”. Për këtë arsye promovimi dhe mbikëqyrja e sistemeve të sigurt, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, është një nga detyrat kryesore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Roli i BQK-së, në drejtim të nxitjes dhe funksionimit normal të sistemit të pagesave, konsiston në tre drejtime kryesore; roli i operatorit në ofrimin e sistemeve dhe infrastrukturave të nevojshme për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe të letrave me vlerë; roli i mbikëqyrësit në hartimin dhe zbatimin e parimeve dhe standardeve për zhvillimin e sigurt dhe efikas të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, si dhe në sigurimin e përputhshmërisë me parimet dhe standardet e vendosura, si për sistemet e administruara nga vetë BQK-ja ashtu edhe për ato të administruara nga operatorë të tjerë; dhe roli i katalizatorit në nxitjen e ndryshimeve për funksionimin e sigurt dhe efikas të sistemit të pagesave, duke influencuar në zhvillimin dhe integrimin e sistemit të pagesave në mënyra të ndryshme.

Në kuadër të strukturës organizative të BQK-së, funksionon Departamenti i Sistemeve të Pagesave (DSP), i cili është përgjegjës për operimin e sistemeve të pagesave ndërbankare në pronësi të BQK-së dhe për mbikëqyrje dhe analiza në fushën e sistemeve të pagesave në përgjithësi. Puna e Departamentit të Sistemeve të Pagesave është e ndarë në dy divizione të veçanta: Divizioni i Operimit të Sistemeve dhe Divizioni i Mbikëqyrjes dhe Analizave të Sistemeve. Në Departamentin e Sistemeve të Pagesave gjithsej janë 7 punëtor.

Sa i përket kornizës së politikave, Banka Qendrore e Kosovës posedon Planin Strategjik 2015-2019 në zbatim të të cilit, në kuadër të sistemit të pagesave synon:

- Implementimin e një sistemi modern të shlyerjes individuale të pagesave në kohë reale (anglisht: Real Time Gross Settlement - RTGS) si dhe sistemi automatik të kliringut (ACH);
- Rishikimin dhe plotësimin e rregullativës që ka të bëjë me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave në pajtim me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare;
- Avancimin e përgjithshëm të funksionit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Kosovë;
- Mbështetja e modernizimit të mëtejshëm të shërbimeve të pagesave dhe promovimi i bashkëpunimit mes akterëve të sistemit kombëtar të pagesave;
- Avancimi i rolit të BQK-së si katalizator për progres në lëmin e pagesave në Republikën e Kosovës;
- Implementimi në pagesa vendore i formatit ndërkombëtar të numrit të llogarisë bankare.

Në Kosovë kliringu dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave realizohet vetëm në valutë Euro dhe atë nëpërmjet sistemit të vetëm të pagesave në vend – Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), në përputhje të plotë me rregullat dhe procedurat e funksionimit të sistemit.

Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), funksionon me efikasitet, siguri dhe qëndrueshmëri të lartë, tash e 15 vite.

Ka vazhduar rritja dhe përmirësimi i infrastrukturës së SWIFT-it për pagesa ndërkombëtare, që nga 1 shkurti 2015 zyrtarisht ka filluar regjistrimi në formatin IBAN për llogaritë bankare në Kosovë të ndërlydhura për transaksionet ndërkombëtare.

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit

Në kuadër të Njësisë për Inteligjencë Financiare (NJIF), funksionon Zyra e Drejtorit të NJIF e cila ka Departamentin e Operatives dhe Analizës; Departamentin e Pajtueshmërisë dhe Inspektimit, Departamentin Ligjor dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtarë, Departamenti për Menaxhimin e Sistemit të

Teknologjisë Informativë dhe Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Në Njësisë për Inteligjencë Financiare janë të punësuar gjithsej 18 zyrtarë. Banka Qendrore e Kosovës ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sa i përket sektorit financiar. BQK ka arritur memorandum të bashkëpunimit me njësinë për Inteligjencë Financiare në kuadër të Ministrisë së Financave për ngritjen e bashkëpunimit dhe kompetencat mbikëqyrëse për sektorin financiar.

Në kontekstin e kornizës së politikave, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar me 28 janar 2014 Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Këto dokumente të politikave përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut kombëtar nga fenomenet e dëmshme të trajtuara nga kjo strategji.

Krahas kësaj Strategjie Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Vlerësimi i sistemit të Kosovës në luftimin e pastrimit të parave dhe në luftimin e financimit të terrorizmit është bazuar në Rekomandimet e FATF-së të vitit 2003 dhe në Rekomandimet e veçanta mbi Financimin e Terrorizmit të vitit 2001 të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) dhe është përgatitur duke përdorur metodologjinë e vlerësimit LPP/LFT 2004. Pyetësor të ndarë, po ashtu të bazuar në Metodologjinë e FATF.

Masat afatshkurtra

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Planifikohet të miratohet Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore, qëllimi i së cilës është qartësimi i pronësisë, identifikimi i fushave ku duhet ndërhyrë, tek ligjet substanciale dhe procedurale të Kosovës, por edhe të propozojë masat për përmirësimin e efektshmërisë së mekanizmave institucionalë që merren me të drejtat pronësore. Në këtë Strategji gjithashtu do të përfshihet çështja e të drejtave të huajve në paluajshmëri.

Sistemi i pagesave

Në planin afatshkurtër, parashihen të realizohen aktivitetet në vijim:

- Adoptimi i rregullorës për Sistemin e Numrave Standard të Llogarive Bankare e cila do të transponon Direktiven 2007/64/KE mbi Sistemin e Pagesave;
- Adoptimi i Rregullores për Instrumente të Pagesave Elektronike e cila do të transponon Direktiven 2009/110/KE;
- Adoptimi i Rregullores së Sistemit Ndërbankar të Pagesave KIPS (Kosovo Interbanking Payment System).
- Implementimi i Standardeve të IBAN-it për llogaritë bankare dhe transaksionet e pagesave kombëtare si:
 - Zbatimi i algoritmit adekuat dhe kontrollit të saktësisë së llogarisë.
 - Futja e kontrollit për IBAN
 - Përshtatja e sistemeve "core" në banka komerciale
 - Përafrimet me ATS standarde
- Implementimi i sistemit të ri të pagesave (ATS/RTGS+ACH), do të realizohet sipas standardit ISO 20022 me përkrahje të Bankës Botërore. Si rezultat do të bëhet përshtatja e llogarive bankare në sistemet e bankave komerciale dhe në sistemet e BQK-së nga ana teknike dhe legale. Sistemi i ri "ATS" do të zëvendësojë komplet sistemin ekzistues "SEKN" si sistem i vetëm kliringu për pagesa në vend, deri në këtë periudhë.

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në planin afatshkurtër, parashihet të realizohen aktivitetet në vijim:

- Miratimi i ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;

- Adoptimi i Rregullores së re për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit për institucionet financiare;
- Kryerja e vlerësimit të rrezikut sektorial për sektorët më të ndjeshëm ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Krijimi i grupit punues për hartimin e vendimit në lidhje me Listën e Konsoliduar të Individeve dhe Entiteteve që i perkasin apo që janë të asociuar me Talibanet dhe Organizaten Al-Qaida, sic është krijuar dhe mirembahet nga Keshilli i Sigurimit i KB (Rezoluta 1267 e Keshillit të Sigurimit e Kombeve të Bashkuara);
- Miratimi i vendimit nga Qeveria në lidhje me Listën e Konsoliduar të Individeve dhe Entiteteve që i perkasin apo që janë të asociuar me Talibanet dhe Organizaten Al-Qaida, sic është krijuar dhe mirembahet nga Keshilli i Sigurimit i KB (Rezoluta 1267 e Keshillit të Sigurimit e Kombeve të Bashkuara);
- Rritja e bashkëpunimit operativ të NJIF-K-së me partnerët dhe homologët vendorë dhe të huaj me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe konfiskimit e të ardhurave nga krimi.
- Zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 për të cilat NJIF-K ka përgjegjësinë primare ose rolin mbështetës;
- Monitorimi i aktiviteteve në kuadër të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018
- Ofrimi i trajnimeve për banka, zyrtarë kadastrale komunale dhe noterë;
- Kapacitetet e Njësisë së Inteligjencës Financiare parashihet të fuqizohen me trajnime të posaçme të stafit, me fokus të veçantë në luftën kundër krimit të organizuar, analiza operationale dhe strategjike etj. Në këtë mënyrë do të fitohen njohuri nga ekspertë të vendeve që kanë pasur dhe kanë përvojë në luftimin e krimit të organizuar;
- NJIF në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorial në baza kohore do të përcjell indikatorë të azhurnuar tek subjektet raportuese si dhe do të nxjerrë dhe përcjell lista ndërkombëtare të shteteve, personave dhe organizatave potenciale që mund të jenë subjekt i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
- Kampanja për sensibilizimin për deklarimin e mjeteve monetare mbi pragun e përcaktuar me ligj në hyrje/ dalje në pikat kufitare;
- Zbatimi i aktiviteteve mbikëqyrëse të pajtueshmërisë për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Prioritetet afatmesme

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Në planin afatmesëm, parashihet implementimi i Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore e cila do të bëjë qartësimin e pronësisë, do të identifikojë fushat ku duhet ndërhyrë, përfshirë ligjet substanciale dhe procedurale të Kosovës, por edhe të propozojë masat për përmirësimin e efektshmërisë së mekanizmave institucionale që merren me të drejtat pronësore. Tutje do të rregullohet edhe fusha e të drejtave të huajve në paluajtshmëri.

Sistemi i pagesave

Në planin afatmesëm, në kuadër të Planit Strategjik 2015-2019j, BQK për sistemin e pagesave ka paraparë:

- Avancimin e rregulloreve dhe metodologjisë së raportimit të instrumenteve të sistemit të pagesave (2017);
- Harmonizimi i Politikave dhe Standardeve për Mbikëqyrje të Sistemeve të Pagesave, sipas Parimeve të CPSS-IOSCO, Rregullores së BQE-së për mbikëqyrjen e kërkesave mbi sistemet e pagesave me rendësi sistematike, dhe Korniza e rishikuar e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave me pakice (2019);
- Implementimi i Direktives 2007/64/KE mbi Sistemin e Pagesave (2019);

- Rregullimi i funksionimit të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike përmes hartimit të Rregullores për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të institucioneve të parasë elektronike të bazuar në Direktivën 2009/110/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi marrjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike (2019).

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në planin afatmesëm, parashihihen të realizohen aktivitetet në vijim:

- Përafrimi i legjislacionit vendor me Direktivën 2015/849 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit;
- Plotësim-ndryshimi i Kodit Penal në lidhje me veprën penale të Financimit të Terrorizmit për të qenë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Direktivën 2015/849 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Sanksione Ndërkombëtare për të qenë në harmoni me standardet ndërkombëtare;
- Azhurnojë, ndryshojë dhe amendamentojë instrumentet ligjore sekondare në bashkëpunim me institucionet relevante për të siguruar implementim të plotë dhe korrekt të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Azhurnojë, ndryshojë dhe amendamentojë Procedurat Standarde të Operimit për të siguruar implementim të plotë dhe korrekt të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe proceset efikase të punës në NJIF-K;
- Vlerësimi i II i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- Vlerësimi dhe Implementimi i rrezikut sektorial për sektorët më të ndjeshëm ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Pjesëmarrja e stafit profesional të NJIF-K në trajnime të specializuara për luftimin e financimit të terrorizmit, analizave operacionale, analizave strategjike dhe inspektimeve të pajtueshmërisë;
- Trajnimi i subjekteve raportuese në lidhje me legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Trajnimi i profesionistëve dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit në luftë kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve ekonomiko-financiare për teknikat e hetimeve të veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Kryerja e analizave strategjike duke implementuar Procedurën Standarde të Operimit për Analiza Strategjike;
- Anëtarësimi i Kosovës në Moneyval;
- Rritja e stafit për 3 persona në NJIF;
- Njësia e Inteligjencës Financiare duhet të fuqizojë edhe më tutje teknologjinë informative, zhvillimin e softuerëve të posaçëm përmes së cilëve do të mirëmbahen lista të azhurnuara të shteteve të cilat janë më shumë të ekspozuara dhe mund të paraqesin rrezik potencial të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
- Anëtarësimi i NJIF-K në Egmont Group.

Mbështetja nga donatorët

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Sa i përket mbështetjes në dispozicion, Ministria e Drejtësisë dhe institucione tjera relevante janë përfituese të projektit me titull “Mbështetjen në hartimin e Kodit Civil dhe Rregullimin e Çështjeve Pronësore” të financuar nga Komisioni Evropian i cili po implementohet nga Konzorciumi GIZ. Qëllimi i përgjithshëm i këtij Projekti është fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë. Ndërsa qëllim i veçantë është mbështetja e Kosovës në hartimin e një Kodi Civil gjithëpërfshirës dhe modern në pajtim me acquis të BE-së dhe përmirësimin e koherencës së përgjithshme të kornizës rregullatorë mbi të drejtën pronësore, që do të ndikojë në rritjen e sigurisë së të drejtave pronësore në Kosovë.

Ministria e Drejtësisë dhe insitucione tjera relevante janë përfituese gjithashtu të Programit për të Drejtat Pronësore i financuar nga USAID. Qëllimi i këtij projekti është Koordinimi më i mirë dhe caktimi i prioritetëve të politikave; Procedurat Gjyqësore lidhur me pronësinë të përmirësohen; të theksohen drejtat e femrave për përdorimin e pronësisë në praktikë; komunikim më i mirë, qasje në informacion dhe

kuptimi i të drejtave pronësore. Projekti mbështet gjithashtu Ministrinë në hartimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore.

Sistemi i pagesave

Banka Qendrore e Kosovës është përfituese e projektit për Zhvillimin e Sistemit të ri Nderbankar të Pagesave "ATS/ACH+RTGS", përkrahur teknikisht dhe financiarisht nga Banka Botërore. Qëllimi i projektit është implementimi i Sistemit të ri të Pagesave Ndërbankare, të quajtur ATS (Automat Transfer System) që përmban dy module: 1. Real Time Gross Settlement System (RTGS) dhe Automat Clearing House (ACH). Ky sistem do të minimizon rreziqet në sistem të pagesave, rritë efikasitetin dhe sigurinë në sistem të pagesave si dhe do të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Buxheti për implementimin e këtij projekti në total është **1,870 milionë USD**, nga të cilat fonde: **1,270 milionë Euro** për softuer dhe harduer, tjerat për ndërlidhje me sisteme në BQK dhe jashtë BQK-së (me institucionet pjesëmarrëse, 10 bankat komerciale, Thesari/MF, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, etj).

3.6. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik

Legjislacioni i BE-së (*acquis*) për prokurimit publik bazohet në **parimet e përgjithshme** të transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe mos-diskriminimit që dalin nga Traktati për Funkcionimin e BE-së, Pjesa III, Titulli IV dhe Titulli VII dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Këto parime të përgjithshme janë të zbatueshme për të gjitha procedurat e prokurimit përfshirë edhe procedurat që janë jashtë fushëveprimit të direktivave të BE-së për prokurimin, siç janë për shembull procedurat e prokurimit nën vlerën minimale të BE-së.

Dhënia e **kontratave publike** për punë, furnizime dhe ofrim të shërbimeve koordinohet nga dy direktiva specifike: Direktiva 2004/18/KE e zëvendësuar nga Direktiva 2014/24/BE për prokurimin publik, dhe Direktiva 2004/17/KE e zëvendësuar nga Direktiva 2014/25/BE për koordinimin e procedurave të prokurimit të entiteteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare. Këto direktiva ofrojnë edhe kornizën për aplikimin e prokurimit elektronik. Direktiva 2009/81/KE rregullon dhënien e disa kontratave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Për implementim të këtyre direktivave kërkohen kapacitete administrative adekuate për të siguruar që të gjitha fushat që lidhen me prokurimin publik funksionojnë në mënyrë eficiente përfshirë aspektet kyç të politikë-bërjes, hartimin e legjislacionit, monitorimin, kontrollin, aspektet operacionale dhe statistikat adekuate.

Legjislacioni i BE-së gjithashtu përbëhet nga tri direktiva për **shqyrtimin e ankesave** dhe disponueshmërinë e mjeteve juridike. Këto direktiva ofrojnë Dispozitat për vendosjen e procedurave të pavarura dhe efektive të shqyrtimit mbi vlerat e caktuara kundrejt vendimeve të marra nga autoritetet kontraktuese. Institucionet për shqyrtim duhet të jenë të pavarura dhe të kenë kapacitetet adekuate për të garantuar efektivitetin dhe efikasitetin e veprimit të sistemit të prokurimit. Në harmoni me principin e mbrotjes juridike që del nga rendi ligjor i BE-së, mekanizmat për shqyrtim kërkohet të veprojnë edhe jashtë fushëveprimit të zbatimit të direktivave përkatëse.

Kërkesat e MSA-së

Neni 79 përmban Dispozitat për prokurimin publik. Sipas këtij neni, nga hyrja në fuqi e MSA-së kompanitë kosovare pavarësisht se a janë të themeluara në BE apo jo, u lejohej qasje në aplikimin për kontratat publike sipas rregullave të prokurimit të BE-së me trajtim të barabartë me kompanitë e vendeve të BE-së. Qasja e njëjtë iu ofrohet kompanive të BE-së të themeluara në Kosovë nën Kapitullin I, Titullin e V-të të kësaj marrëveshjeje. Ndërsa për kompanitë e themeluara në BE, qasja e tyre në kontratat publike në Kosovë vlen me përjashtimet e parapara në paragrafin 5 të nenit 79.

Hapja e dhënies së kontratave publike konsiderohet si objektiv i dëshirueshëm mbi bazën e mos-diskriminimit dhe reciprocitetit duke ndjekur veçanërisht rregullat e OBT-së. Këto rregulla bazohen në Marrëveshjen për Prokurimin Qeveritar (MPQ) të nënshkruar edhe nga BE-ja dhe të cilat negociohen gjatë negociatave për anëtarësim në OBT. Sipas nenit V të Marrëveshjes, vendet në zhvillim mund të negociojnë trajtim preferencial për prokurimin publik brenda një periudhe tranzitore.

Paragrafi 9 i nenit 79 definon se prokurimi publik për fushën e shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe BE-së do të jetë në harmoni me nenet 56-60 të MSA-së ku ofrohen Dispozita për trajtim reciprok në mënyrë progresive për shërbimet, profesionet e rregulluara, vetë-punësimin, transportit. Modalitetet dhe periudhat tranzicionale për këto fusha do të jenë në harmoni me konventat respektive (p.sh në fushën e transportit) dhe do të rishikohen nga Këshilli i MSA-së. Ndërsa paragrafi 5 definon periudhën tranzicionale për heqjen e çfarëdo preference ekzistuese për kompanitë kosovare apo kompanitë e BE-së të themeluara në Kosovë dhe për kontratat e dhëna nën kriteret e tenderit më të favorshëm ekonomikisht dhe çmimit më të ulët, me një preferencë të çmimeve. Periudha tranzicionale është 5 vite dhe reduktimi i preferencës në çmim duhet të fillojë gradualisht që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015, kërkon që legjislacionin për prokurim publik ti bëhet përafrim i mëtejshëm që me qenë në përputhje me legjislacionin e BE-së. Konkretisht, ligji për prokurim publik edhe me tutje favorizon ofruesit vendas, gjë që duhet të ndryshohet. Edhe më tutje Kosova ka nevojë të forcoj kapacitetet dhe të siguroj funksionimin e duhur të organeve të prokurimit publik, në veçanti përmes emërimit në kohë të anëtarëve të bordeve kompetente. Kërkohej që të përmirësohet zbatimi i proceseve të prokurimit publik, përmes përdorimit të duhur të procedurave tenderuese, blerjen e centralizuar, dhe zhvillimin e prokurimit elektronik. Rregullat për mbrojtjen dhe sigurinë e ndjeshme të prokurimit duhet të hartohen. Në kontekstin e politikave, duhet të miratohet Strategjia dhe Plani i Veprimtimit 2015-2020 për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik.

Ky raport edhe me tutje i konsideron shqetësuese kufizimet e kapaciteteve, hetimet e korrupsionit si dhe procesin e emërimeve në Bordin e OSHP-së. Aktualisht vetëm tre nga pesë anëtarët e bordit të OSHP-së janë të zgjedhur, gjë që kufizon seriozisht aktivitetet e këtij institucioni, duke përfshirë edhe shqyrtimin e prokurimeve me vlera të larta dhe komplekse. Andaj, kërkohej që kapaciteti zbatues të forcohet në të gjitha nivelet për të siguruar zbatim dhe fuqizim.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Legjilacioni bazë për sistemin e Prokurimit Publik në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-042, të cilit ju është bërë plotësim-ndryshimi në pjesën e parë të vitit 2014. Ky ndryshim ka verë në pah ndryshimin për Përparesinë e Ofertuesve Vendor apo preferenca vendore e vendosur në këtë ligj i cili deri me tani nuk ka prodhuar asnjë efekt për bizneset vendore meqenëse nuk është implementuar.

Rregullorja e koncesioneve u largua nga ligji për të parandaluar konfuzionin dhe mospërputhjen me ligjin specifik mbi procedurën e koncesionit që ishte miratuar në vitin 2005. Një numër i rëndësishëm i legjislacionit sekondar që mundëson zbatimin e Ligjit është përgatitur, duke përfshirë format standarde për secilin lloj të njoftimit, kodin e etikës, një formular për raportimin e kontratave të nënshkruara, format standarde të dosjeve së tenderëve, një formular për parashtrim të ankesave për Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe udhëzime për procedurat me vlerë minimale.

Sa i përket legjislacionit dytësor për implementimin e ligjit bazë të prokurimit publik, ai përbëhet nga gjithsej 81 akte nën ligjore, duke përfshirë A01 Rregulloren për prokurimin Publik dhe A02 Udhëzuesin Operativ për prokurim publik si dhe dokumentet standarde për përdorimin e tyre për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit publik.

Ligji bazë i prokurimit është aktualisht në procedurë të ndryshimit. Ndër të tjera ndryshimet kryesore konsistojnë në largimin e preferencës në çmim të përfshirë në amandamentimin e vitit 2014, do të ofrojë Dispozitat bazë për fushën e sigurisë dhe do të krijojë bazën ligjore për prokurimin elektronik. Direktivat relevante nga fusha e Prokurimit Publik të cilat do të transapozohen pjesërisht me ndryshimin e ligjit janë:

- Direktiva 2014/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 për prokurimet publike mbi koordinimin e procedurave për caktimin e fituesit në kontratat publike

të punës, shërbimit dhe furnizimit, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, të cilat Shtetet Anëtare duhet të përputhet me të brenda 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi.

- Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2014/25/KE e datës 26 shkurt 2014, në prokurimin nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17 /KE.
- Direktiva e Parlamentit Evropian 2007/66/KE mbi Mjetet Juridike, e datës 11 Dhjetor 2007.

Korniza ligjore përgjithësisht është e harmonizuar në përputhje me standardet e BE-së, dhe nuk është diskriminuese, përveç preferencës për ofertuesit vendor në tenderët ku zbatohet kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme dhe i çmimit më të ulët të ofruar. Këto preferenca përbëjnë shkelje të kërkesave të Acquis-së dhe standardeve të BE-së në këtë fushë por të cilat do të eliminohen me ndryshimet e ligjit që janë duke u bërë në kohën kur po përgatitet ky program.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Struktura qendrore e prokurimit publik të Kosovës përbëhet nga rregullatori për prokurim publik, organi shqyrtues i ankesave si organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe agjencia qeveritare për prokurimet e centralizuara. Kjo strukturë është në harmoni me kërkesat dhe standardet e BE-së për fushën e prokurimit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) vepron në cilësinë e një agjencie të pavarur rregullative dhe është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e Sistemit të Prokurimit Publik. Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, Komisioni është përgjegjës për hartimin dhe shpërndarjen e legjislacionit sekondar, duke përfshirë edhe rregullat e prokurimit, doracakët, udhëzimet, formularët standard, kontratat model dhe për të përgatitur rekomandimet për përmirësim të LPP-së dhe sistemit të përgjithshëm të prokurimit publik për Qeverinë dhe Parlamentin.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është përgjegjës për kryerjen e funksioneve të dhëna me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjit për Procedurën për dhënien për koncesioneve, lidhur me trajtimin e ankesave në relacion me këto ligje. Ky organ është një trup kuazi-gjyqësor, kompetent për shqyrtimin e vendimeve administrative të lëshuara nga institucionet qendrore të prokurimit për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe për të rishikuar ankesat nga tenderuesit nën procedurën e shqyrtimit.

Gjatë ushtrimit të funksionit të shqyrtimit të ankesave, OSHP-ja udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe mos-diskriminimit, transparencës dhe informimit të publikut, mbrojtjes së të dhënave personale, sekretit shtetëror ose tregtar, parandalimit të konfliktit të interesit, parandalimit të korrupsionit, ruajtjes së vlerës për para dhe mbrojtjes së interesit publik.

Konform, Ligjit për Prokurim Publik Nr 04 L/042, Organi Shqyrtues i prokurimit përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarët e Bordit përderisa Bordi i OSHP-së mbështetet nga stafi civil i cili udhëhiqet nga kryesuesi i sekretariatit të OSHP-së.

Agjencia Qëndrore e Prokurimit (AQP) funksionon si një agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave me përgjegjësi të gjerë në lidhje me procedurat e prokurimit të nivelit qendror. AQP zbaton dhe kryen funksione dhe përgjegjësi të specifikuar në Ligjin e prokurimit Publik përderisa funksioni kryesor i Agjencisë është prokurimet qendrore.

AQP vendosë se cilado procedurë e prokurimit që duhet të udhëhiqet nga një autoritet kontraktues në Kosovë, të udhëhiqet nga vetë AQP në vend të autoritetit kontraktues, për arsye të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime, siç është definuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Ky organ është përgjegjës për përpilimin e listës së mallrave apo artikujve të përdorimit të përbashkët ku është miratuar edhe UA për Prokurimet e Centralizuara dhe AQP tashmë është duke i zhvilluar aktivitetet e prokurimit për artikujt që janë të vendosur në këtë listë.

Qeveria e Republikës së Kosovës duke filluar nga mesi i vitit 2000 ka inicuar një numër reformash në sistemin e prokurimit publik me qëllim që prokurimi publik të bëhet më efikas dhe më transparent dhe

në përputhje me kërkesat, udhëzimet themelore të prokurimit dhe praktikat më të mira të BE-së. Tashmë ekziston një strukturë e përpunuar e sistemit të prokurimit publik për punë, shërbime dhe mallra. Sistemi ka rezultuar nga miratimi i Udhëzimeve të BE-së për prokurimin publik të ndërtuara gjatë dekadës së fundit.

Sa i përket **politikave** në fushën e prokurimit, aktualisht është hartuar strategjia kombëtare e prokurimit publik e cila përcakton objektivat zhvillimor të fushës së prokurimit për pesë vitet e ardhshme (2015-2020). Gjithashtu, ka filluar edhe hartimi i strategjisë për menaxhimin e financave publike një nga shtyllat e së cilës ka të bëjë me prokurimin publik. Strategjia e Financave Publike pritet të aprovohet nga Qeveria në pjesën e parë të vitit 2016. Në këtë kontekst, Qeveria në muajt në vijim do të shqyrtojë nëse është e nevojshme të adoptojë edhe draft-strategjinë për prokurimin publik. Sidoqoftë, objektivat kryesor të fushës së prokurimit do të jenë pjesë e planifikimit strategjik, së paku me strategjinë për menaxhimin e financave publike.

Në kuadër të reformave të Programit të Qeverisë 2015-2018 është edhe aplikimi i prokurimit publik në shpenzimin e parasë publike. Kjo reformë e prokurimit do të mundësojë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe thjeshtësimin e procedurave të prokurimit. Prokurimi elektronik vlerësohet se do të ndikojë në zvoglimin e shpenzimeve tenderuese dhe atyre administrative (shih programin e Qeverisë, faqe 16).

Në aspektin e politikave është në fuqi strategjia e trajnimeve 2014-2018 e cila ka për qëllim të rrisë cilësinë dhe sasinë e trajnimit të prokurimit publik në Kosovë, duke kontribuar kështu në zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të stafit.

Objektivat prioritarë të strategjisë së trajnimeve janë rritja e vazhdueshme e numrit të zyrtarëve të prokurimit, dhe formimi i një ekipi të zyrtarëve të prokurimit me njohuri të thella dhe të gjithanshme teorike dhe praktike, të cilët mund të mbështesin zyrtarët dhe stafin tjetër. Kjo do të rezultojë në një efikasitet të autoriteteve kontraktuese, të cilat zbatojnë procedura efektive të prokurimit me cilësi të lartë dhe të kontribuojë në transparencë, përgjegjshmerinë dhe qeverisjen e mirë në Kosovë.

Për më tepër Pani Strategjik i OSHP-së 2014-2017 përcakton objektivat kryesor zhvillimor të këtij institucioni. Plani përmban pesë objektiva strategjik që konsistojnë në: i) profesionalizmin, efikasitetin dhe vendimarrjen direkte në shërbim të operatorëve ekonomik,) rritjen e transparencës ndaj operatorëve ekonomik, iii) zhvillimin e mëtejshëm të komunikimit me publikun, iv) forcimin e bashkëpunimit me palët e interesit përfshirë institucionet tjera të prokurimit, operatorët ekonomik, publikun, dhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe v) ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Masat afatshkurtra

Në planin afatshkurtër fokusi do të jetë kryesisht tek *masat legislative* përmes ndermarrjes së hapave të nevojshëm përgatitor dhe institucional në harmoni me Dispozitat e MSA-së.

Legjislacioni i BE-së që do të transpozohet pjesërisht me plotësim-ndryshimin e ligjit për Prokurim Publik nr. 04/L-042, janë:

- Direktiva 2007/66/KE mbi mjetet juridike,
- Direktiva 2009/81/KE mbi fushën e mbrojtjes,
- Direktiva 2004/18/KE, Direktiva 2014/24/KE dhe Direktiva 2014/25/KE.

Gjatë periudhës afatshkurtër fokusi gjithashtu do të jetë në reformat e kapaciteteve institucionale, kornizën e politikave dhe zbatimin në praktik përfshirë edhe:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurim Publik (2015-2020),
- Miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit (2016), të nxjerrë nga KRPP për monitorimin e aktiviteteve të Prokurimit.
- Aplikimi i platformës së sistemit të E- prokurimit,
- Nxerrja e udhëzuesit operativ për E-prokurim,
- Trajnime për e-prokurim, për të gjithë zyrtarët e prokurimit,

- Integrimi i sistemit të e-prokurimit në web faqen e KRPP-së,
- Ngritja e kapaciteteve administrative, trajnimet për nivelin bazik dhe të avancuar,

Prioritetet afatmesme

Në aspektin operativ për periudhën afatmesme në fokus do të jetë përmbushje e obligimeve të dala nga MSA -ja dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 5, ku do t'i jepet prioritet implementimit të planeve strategjike për prokurimin publik, zbatimit të strategjisë së trajnimeve si dhe hartimit të legjislacionit sekondar. Për më tepër gjatë periudhës 2017-2020 në fokus do të jenë këto prioritetet afatmesme:

- Zbatimi i Planit Strategjik të OSHP-së (2014-2017),
- Zbatimi i Strategjisë së Trajnimeve për Prokurimin Publik (2014-2018).
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurim Publik (2015-2020),
- Hartimi i legjislacionit sekondar konform ndryshimeve të dala nga plotësim/ndryshimi i LPP-së,
- Rritja e cilësisë së trajnimeve për Prokurim Publik.

Mbështetja nga donatorët

Reforma e sistemit të prokurimit publik në Kosovë është mbështetur gjerësisht nga projektet përkatëse të financuara nga Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore.

Projekti i asistencës teknike mbështetur nga Komisioni Evropian "Përmirësimi i Kapaciteteve Administrative në fushën e Prokurimit Publik në Kosovë" i cili është projekti i katërt me radhë që financohet nga Komisioni Evropian, ka filluar në dhjetor të vitit 2013, dhe parashihet të zgjatë deri në qershor 2015. Gjatë vitit 2014 ky projekt e ka ndihmuar KRPP-në, si dhe sistemin e prokurimit publik të Kosovës në përgjithësi në:

- Përgatitjen e Draft Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e Prokurimit Publik dhe Planin e Veprimit,
- Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të Trajnimit në fushën e Prokurimit Publik,
- Mbeshtetje në propozimet për amendamentimin e LPP-së, nr. 04/L-042;
- Përgatitjen e draft- Udhëzuesve Administrativ për: Specifikimet Teknike dhe disponueshmërinë e fondeve,
- Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2014
- Udhëzuesin për aplikimin e kriterëve ekonomike dhe financiare të përzgjedhjes
- Udhëzuesin për aplikimin e kriterit me çmim më të ulët, në rast të shërbimeve të shumta, dhe kontratat me çmim për njësi;
- Udhëzuesin për aplikimin e kriterit me çmim ekonomikisht më të favorshëm me rastin e dhënies së kontratës;
- Rregullat që kanë të bëjnë me marrëveshjet kornizë dhe
- Freskimin e Rregulloreve të Brendshme të KRPP-së dhe AQP-së.

Banka Botërore gjatë vitit 2014, e ka ndihmuar KRPP-në, si dhe sistemin e prokurimit publik të Kosovës me disa projekte përfshirë projektin për zhvillimin i sistemit të prokurimit elektronik (2014 - 2015), projektin për matjen e performancës në sistemin e prokurimit publik në Kosovë (2013 - 2015) dhe projektin për përgatitjen e manualit të çmimeve mesatare për njësi për punë, mallra dhe shërbime (2013 - 2015).

3.7. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive

Legjislacioni për Kompani përmban rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e kompanive dhe kërkesat për raportim financiar që synojnë të përkrahin të drejtën e themelimit.

Në fushën e **të drejtës së kompanive**, Direktiva 2009/101/KE për korrdinimin e masave mbrojtëse që kërkohen nga kompanitë për mbrotje të interesave të anëtarëve dhe palëve të treta (e njohur më parë si Direktiva e Parë e të Drejtës së Kompanive) përmban kërkesa për shpalesjet obligative. Direktiva e Dytë e së drejtës së Kompanive 2012/30/BE konsiston në rregulla për themelimin e ndërmarrjeve publike me

përgjegji të kufizuar dhe kapitalin e tyre. Direktiva e Njëmbëdhjetë e së Drejtës së Kompanive (89/666/EEEC) rregullon kërkesat për shpallje për degët e hapura në një vend anëtar dhe të qeverisura nga një vend tjetër. Direktiva e Dymbëdhjetë e së Drejtës së Kompanive (2009/102/KE) kërkon që vendet anëtare të njohin në ligjet e tyre kompanitë me përgjegjësi të kufizuar me një anëtar. Direktiva 2004/109/KE (Direktiva e Transparencës) kërkon harmonizimin e kërkesave për transparencë për kompanitë e listuara.

Direktiva e Tretë (78/855/KEE) dhe e Gjashtë (82/891/KEE) e së Drejtës së Kompanive harmonizojnë rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve në kontekstin e bashkimeve dhe ndarjeve të kompanive me përgjegjësi të limituar publike vendore. Në këte fushë acquis përmban edhe disa direktiva tjera që rregullojnë aspektet ndër-kufitare të funksionimit të kompanive.

Legjislacioni i BE-së gjithashtu përmban disa rregullore që rregullojnë forma legale Evropiane të caktuara siç janë për shembull Grupimi i Interesave Ekonomike Evropiane dhe Kompania Evropiane – *Societas Europaea* duke lënë në kompetencë të vendeve anëtare të rregullojnë operacionet dhe strukturën e brendshme. Katër Rekomandime të Komisionit (2004/913/KE, 2005/162/KE, 2009/385/KE, dhe 2009/384/KE) adresojnë principet e qeverisjes korporative për pagesë drejtorëve dhe pagesën në institucionet financiare, pavarësinë e komiteteve të bordit dhe drejtorëve jo-ekzekutiv.

Në fushën e **raportimit financiar dhe auditimit**, rregullat e acquis përcaktojnë paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara të ndërmarrjeve publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar (Direktiva e Shtatë e së Drejtës së Kompanive), pasqyrës së të hyrave dhe profitit (Direktiva e Katërt e së Drejtës së Kompanive) duke përfshirë edhe rregullat e thjeshtuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa entitete me interes publik. Këto direktiva gjithashtu caktojnë kërkesat për auditim, dhe obligimet për shpallje dhe publikim të të dhënave. Përveç kësaj, acquis përcakton rregullat për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore.

Ekzistojnë edhe rregullore që i detyrojnë kompanitë të cilat janë të listuara në një treg të rregulluar, në mënyrë që llogaritë e tyre të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të adoptuara nga Komisioni Evropian. Së fundi, Direktiva e Tetë e së Drejtës së Kompanive (2006/43/KE) për Auditimin Ligjor harmonizon rregullat duke përfshirë mes të tjerash, miratimin dhe regjistrimin e auditorëve ligjor, sigurimin e jashtëm, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e auditorit dhe zbatimin e mundshëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Kërkesat e MSA-së

Obligimet që dalin nga Msa për transpozimin gradual të legjislacionit të BE dhe implementimin efektiv burojnë nga neni 74 i marrëveshjes. Këto obligime përfshijnë edhe fushën e të drejtës së kompanive dhe paragrafi 3 i nenit 74 i jep përparësi transpozimit të legjislacionit të tregut të brendshëm dhe atij tregtar në fazën e parë të periudhës tranzitore.

Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqi të MSA-se të sigurojë trajtim të barabartë kompanive të BE-së me ato vendore sa i përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës.

Sa u përket kërkesave të *Raportit për Vendlin 2015*, është theksuar që në fushën e të drejtës së kompanive, Kosova duhet të miratoj ligjin i cili definon rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

Në fushën e **raportimit financiar dhe auditimit**, kërkohet të miratohet plotësimi/ndryshimi i Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Sa u përket kapacitetit të strukturave të mbikëqyrjes institucionale të auditimit, është theksuar që duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme. Zbatimi mbetet i dobët dhe përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për të siguruar zhvillimin e besueshme dhe efikas të raportimit financiar, në përputhje me praktikën e BE-së. Gjithashtu, është ngritur si çështje harmonizimi i rregullave të Kosovës me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Ligji nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për **Shoqëritë Tregtare** përbën kornizën bazë ligjore. Në vitin 2015 është hartuar UA nr. 18/2011 i cili ka hyrë në fuqi me 21.07.2015. Ligji në fuqi për Shoqëri Tregtare përcakton llojet e shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë tregtare në Kosovë, cakton kushtet e zbatueshme të regjistrimit për secilin lloj të shoqërive tregtare, përcaktonë për secilin lloj të shoqërive tregtare dispozitat ligjore për kapacitetin dhe strukturën juridike si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, menaxherëve, drejtorëve, përfaqësuesve juridik dhe palëve të treta, dhe përcaktonë dispozitat ligjore të cilat nxisin dhe lehtësojnë themelimin, funksionimin dhe shpërbërjen e rregullt dhe efektive të shoqërive tregtare.

Direktivat e transpozuara pjesërisht nga ky ligj janë: Direktiva 77/91/KEE e datës 13 dhjetor 1976 për koordinimin e masave mbrojtëse, Direktiva 78/855/KEE e 9 tetorit 1978 në bazë të nenit 54 (3) (g) të Traktatit lidhur me bashkimet e ndërmarrjeve publike me përgjegjësi të kufizuar (shoqëri aksionare), Direktiva 82/891/KEE e 17 dhjetorit 1982 në bazë të nenit 54 (3) (g) të Traktatit, në lidhje me ndarjen e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar (shoqëri aksionare) Direktiva 89/667/KEE të 21 dhjetorit 1989 mbi kompanitë private me përgjegjësi të kufizuar një -anëtarësh (Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar) Direktiva 2005/56/KEE të Parlamentit dhe Këshilli Evropian e datës 26 tetor 2005 mbi shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar për bashkimin ndërkufitar, Direktiva 89/666/KEE e 21 dhjetorit 1989 në lidhje me kërkesat për dhënie informata shpjeguese në lidhje me degët e hapur në një Shtet Anëtar nga lloje të caktuara të shoqërisë të qeverisura nga ligji i një shteti tjetër.

Ndersa sa i perket **kontabilitetit dhe auditimit**, Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nr. 04/L-014 ka hyrë fuqi në gushtë të vitit 2011. Ky ligj ka zëvendësuar Regulloren e Unmikut 2001/30 për Themelimin e Bordit të Raportimit Financiar të Kosovës, dhe Regjimit të Raportimit Financiar të Organizatave Afariste.

Me këtë ligj rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar i shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesional, licencimi i auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit.

Ky ligj përmban dispozita që pjesërisht transpozojnë aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian: Direktiva e katërt e Këshillit 78/660/KEE e 25 korrikut të vitit 1978, Direktiva e shtatë e Këshillit 83/349/KEE e 13 qershorit 1983, Direktiva e Këshillit 90/605/KEE e 8 nëntorit 1990, Direktiva 2001/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 shtator 2001, Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 17 majit 2006, Direktiva 2006/46/KEE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2006 dhe Direktiva 2009/49/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 qershor 2009.

Në bazë të ligjit janë lëshuar 12 Udhëzime Administrarive për implementimin e ligjit. Udhëzimet Administrative transpozojnë plotësisht Direktivën 4 (për llogaritë vjetore të disa llojeve të Kompanive), Direktivën 7 (për llogaritë e konsoliduara) dhe Direktiva e 8 (mbi miratimin e personave përgjegjës për të kryar auditimet statutores) të Këshillit Evropian.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Në fushën e të **drejtës së kompanive**, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. ARBK ka gjithësej 16 zyrtar dhe ka të hapura 28 Qendra Komunale të Bizneseve (one stop shop). ARBK ka 1 drejtorat edhe 3 sektorë, Drejtorati për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit, Sektori i Aprovuesve, Sektori për Procesimin e të Dhënave, Sektori i Pengut.

Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) është organ i pavarur profesional dhe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të KKRF-së me propozim të institucionit emërohen nga

Qeveria dhe përfaqësojnë institucionin si në vijim: një anëtar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovë, një anëtar nga universitetet që ofrojnë arsimim superior universitar me lëndë mësimore në kontabilitet dhe auditim, një anëtar nga Ministria e Financave, një anëtar nga shoqatat profesionale e licencuar nga KKRF-jadhe tre (3) anëtarë nga komuniteti i biznesit.

Funksionet e KKRF-së janë: të hartojë dhe aprovojë Standardet e Kontabilitetit të Kosovës në pajtim me Standarde ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK/SNRF dhe direktivat relevante të BE-së, mbikëqyrë dhe zbaton standardet e auditimit në përputhje me SNA dhe direktivat relevante të BE-së, licencimi dhe mbajtja e regjistrit të auditorëve dhe firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, adoptimi i standardeve të etikës profesionale, kualitetit të brendshëm të firmave audituese, mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor.

KKRF-ja nostrifikon certifikatat ndërkombëtare të auditorëve dhe kontabilistëve.

Korniza e politikave konsiston në Programin e Qeverisë 2015-2018, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, dhe Strategjia e Evropës Juglindore 2020.

Programi i Qeverisë 2015-2018, në kuadër të shtyllës për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, punësim dhe mirëqenie ka si objektive edhe politikat tregtare konkurruese dhe përmirësimin e mjedisit biznesor. Në këtë kontekst, prioritetet kryesore kanë të bëjnë me funksionalizimin e zonave të lira, luftimin e ekonomisë jo-formale, plotësimin dhe implemtimin e legjislacionit për themelimin, funksionimin dhe mbylljen e bizneseve dhe zvogëlimin e burokracisë, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sidomos aktiviteteve prodhuese dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, dhe lehtësimin dhe promovimin e investimeve përfshirë partneritetet për investime strategjike. Aktualisht, qeveria është duke hartuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim si dokument gjithëpërfshirës dhe orientues strategjik. Zhvillimi i NVM-ve dhe sektorit privat do të jenë komponente esenciale të strategjisë.

Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017 paraqet elementet e ndërlidhura me aktivitetet e sektorit që kjo ministri mbulon, duke përfshirë këtu edhe Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, e që janë pjesë e orientimit dhe vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Qëllimi i kësaj Strategjie është që të adresojë sfidat si dhe të adoptojë ndryshimet që kanë të bëjnë me zhvillimin e industrisë dhe të sektorit privat, e që janë ndryshimi në kornizën ligjore, atë institucionale dhe të politikave.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe integritetit³², Republika e Kosovës angazhohet në inkorporimin në politikat e saj të prioriteteve të Strategjisë së Evropës Juglindore. Gjithashtu Kosova merr pjesë aktive në dialogun regional në kuadër të Këshillit për bashkëpunim Regional. Po ashtu Kosova është aktive dhe përfshirë në vlerësimin e Komisionit Evropian në kuadër të kornizës së politikave për NVM-të përmes Aktit të Biznesit të Vogël.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushave të kapitullit 6, do të ndryshohet dhe plotësohet ligji për shpërqëritë tregtare. Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, me qëllim të transpozimit të këtyre akteve të acquis:

- Direktivën nr. 2011/35/BE për bashkimin e kompanive publike me përgjegjësi të kufizuara;
- Direktivën nr. 2007/36/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të 11 korrikut 2007;
- Direktivën nr. 2009/101/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të 16 shtatorit 2009;
- Direktivën 2009/102/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 16 shtator 2009, Rregullores së Këshillit nr. 2157/2001, datë 8 tetor 2001, mbi statutin për një kompani evropiane (SE);
- Direktivën nr. 2012/30 /BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të 25 tetorit 2012;

³² Për më shumë në këtë aspekt, ju lutem shihni kapitullin 20 për politikat e ndërmarrjeve dhe industrisë.

- Rekomandimit të Komisionit për plotësim-ndryshimin e Rekomandimit nr. 2004/913/KE dhe Rekomandimit nr. 2005/162/KE mbi regjimin për shpërblimin e drejtorëve të kompanive të listuara; dhe
- Direktivën nr. 2006/43/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të 17 majit 2006.

Gjithashtu gjatë këtij viti është duke u hartuar Projektligji për Falimentim. Ky ligj do të rregullojë kornizën që ka të bëjë me falimentimin dhe josolvencën e shoqërive tregtare, dispozitat për mbrojtjen, likuidimin dhe shpërndarjen e aseteve të debitorit falimentues të kreditorët dhe dispozita për riorganizimin dhe lirimin nga borxhi për shoqëritë tregtare.

Ndërsa sa i përket Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim është paraparë që të harmonizohet tërësisht me Direktivën 4 (për logarit vjetore të disa llojeve të Kompanive) Direktivën 7 (për logarit e konsoliduara) dhe Direktiva e 8 (mbi miratimin e personave përgjegjës për të kryar auditimet statutore) të Këshillit Evropian.

Në kuadër të kapaciteteve institucionale, planifikohet të themelohen 3 one-stop shops në komunat me shumicë Serbe. Për funksionalizimin e këtyre one-stop shops, do të organizohen edhe trajnime për stafin me qëllim të forcimit të kapacitetit të tyre në kryerjen e detyrave.

Në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit është paraparë që në vitin 2016 të bëhet unifikimi i numrit të regjistrimit të biznesit në një ID të vetme dhe eliminimi i katër numrave nga Doganat e Kosovës, ATK-ja dhe ARBK-ja dhe në këtë formë numri i biznesit do të jetë numër primar.

Prioritetet afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 6, fokusi gjatë periudhës 2017-2020 do të jetë në këto prioritetet afatmesme:

- Zhvillimi dhe funksionalizimi i plotë i regjistrimit online të bizneseve.
- Funksionalizimi i plotë i one stop shopeve (përfshirë edhe hapjen dhe funksionalizimin e shërbimeve one-stop shop në veri të vendit).
- Pas miratimit të Ligjit bazë për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim parashihet transpozimi i direktivave të BE-së që kanë të bëjnë me raportimin financiar.

Mbështetja nga donatorët

Agjencia për regjistrimin e bizneseve është duke u përkrahur nga USAID-i në kuadër të projektit Partneriteti për Zhvillim (Partnership for Development) për termat e referencës, analiza e proceseve të punës dhe analizë se si duhet të bëhet unifikimi i numrit. Buxheti i paraparë 10.000,00 euro. Ky projekt ka për qëllim rritjen dhe përmirësimin e ambientit të biznesit, për zhvillim të sektorit privat për të rritur mundësitë e punësimit në Kosovë.

ARBK është gjithashtu duke u përkrahur gjithashtu në përgaditjen e ligjit të ri për shoqëritë tregtare nga IFC. Buxheti i paraparë 10.000,00 euro. Projekti i klimës së investimeve në Kosovë i IFC-së dhe Projekti keshillëdhënës për reformë i bazuar në indikatorë, ofrojnë shërbime këshilluese për të ndihmuar forcimin e zhvillimit të sektorit privat në Kosovë dhe menaxhohen nga Departamenti i IFC-së për Evropë dhe Azinë Qendror.

3.8. Kapitulli 7 i *acquis*-së: E drejta e pronësisë intelektuale

Legjislacioni i BE-së në këtë fushë definojnë rregullat e harmonizuara për mbrojtjen e pronësisë industriale, të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Në fushën e **të drejtave të pronësisë industriale**, *acquis* vendos rregullat për mbrojtje ligjore të markave tregtare (Direktiva 2008/95/KE) dizajnit dhe pjesërisht rregulla të harmonizuara për patentat (kushtet

për licencim obligativ të patentave tregtare). Për sistemin e patentave në BE është me rëndësi anëtarësimi në Konventën Evropiane të Patentave dhe Organizatën Evropiane të Patentave.

Acquis gjithashtu përfshin Rregulloren (KE) nr. 40/94 dhe Rregulloren (KE) nr. 06/2002 të cilat rregullojnë dizajnin industrial dhe markat tregtare në BE. Pjesëmarrja në Protokollin e Madridit dhe Marrëveshja e Hagës janë të rëndësishme jo vetëm për sistemin e markave tregtare dhe dizajnit në BE por edhe për regjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial dhe markave tregtare. Gjithashtu ekzistojnë edhe Dispozita (në kuadër të dy Rregulloreve) për certifikatat e mbrojtjes suplementare³³ që iu ofrojnë autorëve të shpikjeve mbrotje shtesë në rastet kur patenta mbulohet nga një autorizim administrativ marketingu që nuk lejon përfitime të plota nga shfrytëzimi i patentës (sidomos në fushën e farmaceutikës, produkteve të bimëve etj).

Në fushën e **të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta**, objektivi kryesor është harmonizimi i disa aspekteve të shoqërisë informative në linjë me zhvillimet teknologjike. Këtu bën pjesë edhe legjislacioni i BE që rrjedh nga obligimet ndërkombëtare të traktateve për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të miratuara në kornizën e Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale (EİPO). Direktiva 2006/115/KE rregullon të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta të mbajtësit. Kjo direktivë rregullon disa të drejta të përafërta përfshirë të drejtën e riprodhimit, transmetimit, dhe distribuimit. Direktiva 2006/116/KE e amendamentuar nga Direktiva 2011/77/BE vendos periudhën e mbrojtjes për lloje të ndryshme të punëve dhe çështje tjera të ndërlidhura për vendet anëtare të BE. Ekzistojnë edhe disa direktiva tjera që rregullojnë transmetimet audio-vizuale ndërkufitare (satelitore), të drejtën e rishitjes së përfitimeve të autorit, mbrojtjen e programeve kompjuterike, databazave, digjitalizimin, dhe ekspozimin online për veprat jetime, autorët e të cilave ose nuk dihen ose nuk mund të lokalizohen (kontaktohen).

Sa i përket **zbatimit** të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale, legjislacioni i BE-së kërkon që vendet anëtare të aplikojnë masa dhe ndëshkime efektive dhe proporcionale për falsifikimin dhe piraterinë e mallrave. Kjo synon të krijojë trajtim të barabartë për mbajtësit e të drejtave në gjithë BE-në. Rregullorja (KE) nr. 1383/2003 i jep rol të rëndësishëm administratave doganore në parandalimin dhe ndalimin nga qarkullimi të produkteve që shkelin të drejtën industriale ose të drejtën e autorit. Implementimi i *acquis* në këtë fushë kërkon kapacitete dhe struktura adekuate dhe efektive. Duhet të ekzistojë një institucion që pranon aplikacionet për mbrojtje në të gjitha fushat e pronësisë intelektuale. BE është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë e cila administron Marrëveshjen për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Industriale.³⁴

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat e MSA-së kërkojnë që institucionet kosovare përgjegjëse për pronësinë intelektuale të ofrojnë fillimisht kornizën ligjore të harmonizuar me direktivat dhe rregulloret e BE-së, si dhe të ofrojnë mbrojtje të njëjtë të këtyre të drejtave në Kosovë në nivel të njëjtë me ato të vendeve të BE-së. Neni 77 dhe 78 i MSA-së e obligon Kosoven që të marrë të gjitha masat e nevojshme për garantim të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale duke përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave. Më specifikisht, bazuar në nenet e MSA, Kosova duhet që:

- Të krijojë një sistem të pronësisë intelektuale në Kosovë konform standardeteve ndërkombëtare në fushën e pronësisë intelektuale;
- T'i kushtohet vëmendje bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, duke qenë se Kosova nuk është nënshkruese e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare apo rajonale, ashtu sikurse nuk është anëtare e asnjë organizate ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e pronësisë intelektuale;
- Kosova obligohet që të hartojë legjislacionin dhe politikën në atë mënyrë që të jenë konform parimit të trajtimit kombëtar (National Treatment Principle) përmes së cilit Kosova dhe BE do t'i japin kompanive të njëra-tjetres trajtim jo më pak të favorshëm se atë që ata i japin nga ana e tyre ndonjë vendi të tretë nën Marrëveshjet dypalëshe;
- Kosova kërkohet që konform Nenit 109 të MSA-së, të ketë bashkëpunim në fushën audio-vizuale përmes bashkëpunimit për nxitjen e industrisë audio-vizuale në Evropë, si dhe për të përkrahë bashkë-prodhimin në fushat e kinemasë dhe mediave audio-vizuale, ku sipas këtij neni bashkëpunimi mund të përfshijë, programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe

³³ Supplementary protection certificates (SPCs)

³⁴ TRIPS.

profesionistëve në industrinë e mediave audio-vizuale, ashtu si edhe asistencën teknike për mediat publike dhe private të Kosovës, me qëllim të përforsimit të pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropian;

- Të bejë përafrimin e politikave të saj për rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të BE-së;
- Të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis të BE-së në sferen e përvetësimit të së drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimin si dhe të siguroj dhe fuqizoj pavarësinë e autoriteteve rregullatore përkatëse;
- Të angazhohet në mbrojtjen e Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimeve të Originës konform Neneve 2, 6, 7, 8 të Marrëveshjes për Njohjen, Mbrojtjen dhe Kontrollin Reciprok të Emrave të Verërave, Pijeve Alkoolike dhe Verërave të Aromatizuara të MSA-së;
- Të inkurajoj bashkëpunimin në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik konform Nenit 118 të MSA-së, mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, qasjen e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara nga nivelet e përshatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015, thekson që Kosova duhet të zhvilloj një kornizë ligjore për të zbatuar detyrimet që dalin nga MSA. Projektligji për masat doganore duhet të miratohet dhe të jetë në përputhje me rregulloren përkatëse të BE-së. Në aspektin e kapaciteteve institucionale, kërkohet të emërohet Drejtori i Agjencisë për Pronësi Industriale dhe të adresohen rastet e mbledhura të aplikimeve në Agjencinë për Pronësi Industriale. Bashkëpunimi në mes institucioneve dhe zbatimit të legjislacionit duhet të përmirësohet tutje.

Përpjekjet për të siguruar zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale duhet të shtohen. Në mënyrë specifike kërkohen përpjekje më të mëdha për të siguruar zbatimin, duke përfshirë edhe masat ligjore të arritshme dhe efektive që mund të ndërmerren nga mbajtësit e të drejtave dhe koordinimi më i mirë administrativ mes institucioneve të përfshira. Duhet të bëhen dispozita zbatuese në skemat private për të drejtat e autorit dhe pirateria digjitale, të cilat janë thelbësore për zbatimin e ligjit. Duhet të ngritet vetëdija e bartësve dhe e përdoruesve të të drejtave të pronësisë intelektuale. Policia duhet të themeloj një njësi të specializuar për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Legjislacioni bazë për të drejtat pronësore intelektuale është kompletuar me ligjet të cilat rregullojnë fushat e caktuara si dhe me legjislacionin sekondar gjegjës që kanë të bëjmë me regjistrimin e objekteve pronësore industriale. Ligji për Patenta nr. 04/L - 029 përcakton kushtet dhe procedurat për regjistrimin e patentës, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave duke përfshirë dhe dispozitat ndëshkuese. Ky ligj është plotësisht i harmonizuar me:

- Rregulloren (KE) nr. 1610/96 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 korrik 1996 mbi krijim e çertifikatës së mbrojtjes shtesë oër produktet mbi mbrojtjen e bimëve,
- Rregullorja e KE-së Nr 816/2006 mbi licencimin e detyrueshëm të patentave që lidhen me prodhimin e farmaceutikëve për eksport në vendet me probleme të shëndetit publik.
- Direktivën 98/44/KE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 06 korrik 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike,
- Direktivën 2004/48/KE E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datën prill 2007 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale,
- Rregulloren e KE-së Nr 469/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 06 maj 2009 në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për produkte medicinale.

Ligji për Marka Tregtare nr. 04/L - 026 përcakton kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave. Ky ligj zbatohet për subjektet që i nënshtrohen procedurës së regjistrimit për fitimin e markës tregtare në Agjencinë për Pronësi Industriale përfshirë markat komunitare dhe regjistrimet ndërkombëtare të markës tregtare që vlejné në Republikën e Kosovës. Ky ligj është plotësisht i harmonizuar me:

- Direktivën 2008/95 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2008 për të përafuar ligjet e Shtetëve Antare në lidhje me markat tregtare.
- Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ligji për Dizajnin Industrial nr. 04/L – 028 përcakton kushtet dhe procedurat për regjistrimin e dizajnit industrial, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave dhe dizjani komunitar. Ky ligji është plotësisht i harmonizuar me:

- Direktivën 98/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor mbi mbrojtjen e dizanit industrial.
- Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ligji për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës përcakton rregullat për mënyrën e fitimit dhe mbrojtjes së emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik të produkteve. Ligji zbatohet për të gjitha produktet për të cilat mbrojtja e emërtimeve të origjinës ka origjinë nga një rajon, vend specifik ose shtet. Ky ligji është plotësisht i harmonizuar me:

- Rregulloren e BE-së Nr 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 Nentor 2012 mbi skemat e cilësisë për produkte bujqësore dhe ushqimore;
- Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 510/2006 e datës 20 mars 2006 mbi Mbrojtjen e Treguesve Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës së Produkteve Bujqësore dhe Produkteve Ushqimore;
- Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta nr. 04/L – 065 rregullon të drejtat e autorit që, në bazë të pronësisë intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, në vijim e drejta e autorit; të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të përafërta me të drejtat e autorit; administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta; mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta; zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj. Ky ligji është plotësisht i harmonizuar me:

- Direktivën 93/83/KE e 27 shtatorit 1993 mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllore;
- Direktivën 2001/29/KE e 22 majit 2001 mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura në shoqërinë e informacionit;
- Direktivën 2001/84/KE e 27 shtatorit 2001 mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit në një vepër origjinale arti;
- Direktivën 96/9 /KE e 11 marsit 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave (OJ L 077, 27/03/1996);
- Direktivën 2006/115 /KE të 12 dhjetorit 2006 mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën kreditimit dhe në disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale;
- Direktivën 2009/24 / BE-së më 23 prill 2009 mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike;
- Direktivën 2011/77 / BE i 27 shtatorit 2011, harmonizimin e afatit të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura (OJ L 265, 11/10/2011) që ndryshon Direktivën 2006/116 /KE të 12 dhjetorit 2006;
- Direktivën 2012/28 / BE i 25 tetor 2012 (OJ L 299, 27/10/2012) mbi përdorimet e lejuara të caktuara të veprave jetimë;
- Direktivën 2014/26 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e (OJ L 84, 26/02/2014), për menaxhim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura dhe licencimi multi-territoriale të drejtave në veprave muzikore për përdorim në internet në të brendshme tregut;
- Direktivën 2004/48 /KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ligji për Masat Doganore rregullon procedurat për veprim nga Dogana për mallrat të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale. Ligji po ashtu përcakton masat për mbrojtjen

e të drejtave të pronësisë intelektuale që merren nga Dogana kur mallrat janë gjetur se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Ky ligji është plotësisht i harmonizuar me:

- Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 1383/2003 e 22 korrik 2003 në lidhje me masat doganore ndaj mallrave të dyshuara për shkelje të drejtave të caktuara të pronësisë intelektuale dhe masat që duhet ndërmarrë kundër mallrave që shkelin këto të drejta;
- Rregulloren (BE) Nr 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 12 qershorit 2013 në lidhje me zbatimin doganor të drejtave të pronësisë intelektuale dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE);
- Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ligji për Inspektoratin e Tregut përcakton parimet, organizimi, kompetencat dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në territorin e Republikës së Kosovës. Pjesa që ka të bëjë me pronësinë intelektuale e këtij ligji është plotësisht i harmonizuar me Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Kodi Penal i Kosovës parasheh si vepra penale cenimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Pjesa që ka të bëjë me pronësinë intelektuale e këtij Kodi është e harmonizuar me Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Legjislacioni sekondar përbëhet nga 12 udhëzime administrative për zbatimin e kornizës bazë ligjore të mësipërme.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Kosova ka të themeluara institucionet të cilat janë përgjegjëse për regjistrimin, administrimin dhe zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale. Secili institucion ka të përcaktuar mandatin i cili është i rregulluar me legjislacionin në fuqi. Në vijim do të prezantohet struktura institucionale në fushën e pronësisë intelektuale në Kosovë.

Agjencia e Pronësisë Industriale vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i cili është institucion përgjegjëse për ekzaminimin e aplikacioneve të objekteve të pronësisë industriale, hartimin e legjislacionit, propozimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë intelektuale, dhe promovimin e të drejtave pronësore industriale. API benë regjistrimin e të gjitha kërkesave të pronësisë industriale përmes databazës së IPAS-it. Për më tepër API e realizon aktivitetin e vet përmes veprimtarisë së një staf të përbërë prej 8 punëtorëve me kontratë të përhershme, 2 zyrtarë të transferuar përkohësisht dhe 6 ekspertë lokalë me kontratë të përkohshme. Në kuadër të API-së ekziston edhe Komisioni për Ankesa që merret me Ankesat e palëve kundër vendimeve të API-së.

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta është organ administrativ që vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Veprimtaria themelore e Zyrës është hartimi i legjislacionit; dhënia/marrja e lejes së shoqatave për administrimin kolektiv të drejtave; mbikëqyrja e veprimtarisë së shoqatave kolektive për administrimin e të drejtave; promovimi i drejtës së autorit dhe drejtave të përafërta. ZDA ka një staf të përbërë prej 5 zyrtarëve me kontratë të përhershme.

Dogana e Kosovës – Sektori për Pronësi Intelektuale funksionon në kuadër të Doganës dhe ka për detyrë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale për mallrat që hyjnë në/ose dalin nga territori i Kosovës, me kërkesë të bartësve të së drejtës/përfaqësuesve ose “ex-officio”, si dhe administrimin e kërkesave për veprim në kuadër të mbrojtjes së pronësisë intelektuale. Autoritetet doganore mund të marrin masa në të gjitha procedurat doganore; import, eksport, transit, ri-eksport, magazinim doganor, përpunim të brendshëm etj.

Inspektorati i Tregut në Republikën e Kosovës funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, në fushën e pronësisë intelektuale, sigurinë e produkteve dhe shërbimeve, tregtimit të naftës dhe derivateve të naftës, parandalimin e praktikave të pa drejta tregtare luftimin e ekonomisë jo formale, shërbimeve hoteliere dhe turistike etj.

Policia e Kosovës është e angazhuar në mbrojtjen e të drejtave pronësore intelektuale në Kosovë përmes Sektorit të Hetimeve dhe Krimeve Ekonomike (**DHKEK**) dhe Sektorit për Krime Kibernetike të cilët merren me parandalimin, hetimin dhe luftimin e piraterisë dhe falsifikimit, konkretisht shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit.

Këshilli Shtetëror për Pronësi Intelektuale është themeluar më 16 shtator 2011 është trup koordinues dhe këshillëdhënës, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është të forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet gjitha institucioneve të përfshira në administrimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësore intelektuale, me fokus në promovimin, koordinimin dhe monitorimin e këtyre të drejtave.

Task Forca kundër Piraterisë është themeluar me 30 janar 2013 dhe detyra kryesore e Task Forcës është luftimi i piraterisë, ndalimi i shitësve të paligjshëm në treg dhe sekuestrimi i materialeve pirate në treg. Task Forca, zbaton strategjinë kundër piraterisë dhe falsifikimit dhe planin e veprimit të saj, përmes veprimeve të koordinuara në mes të institucioneve pjesëmarrëse kompetente.

Strategjia për zhvillimin e Sektorit Privat 2013 -2017 me theks të veçante mbrojtja e pronësisë intelektuale ka për qëllim është zhvillimi i një sistemi për mbrojtjen e Pronës Intelektuale në Republikën e Kosovës në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane dhe praktikat e mira. Duke pasur parasysh se sistemi për mbrojtjen e PI-së është faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe është një parakusht për krijimin e një ekonomie bashkëkohore të tregut dhe tërheqjen e investimeve të jashtme, krijimi i një sistemi efikas për mbrojtjen dhe regjistrimin e pronës intelektuale në Kosovë paraqet prioritet në veprimet e Qeverisë së Kosovës si në rregullimin e tregut të brendshëm ashtu edhe në bashkëpunime ndërkombëtare ekonomiko-tregtare

Strategjia kundër Piraterisë dhe Falsifikimit 2012-2016 –objektiva kryesore janë ka uljen e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit dhe rritja e produktivitetit në industrinë kreative; Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit; Luftimin e ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja; Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe Arritja e standardeve Evropiane.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushave të kapitullit 7, do të zbatohen këto masa afatshkurtra që prekin reformat e kapacitetet institucionale, kornizën e politikave dhe zbatimin në praktikë:

- Miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Masat Doganore që do të harmonizojë ligjin me Rregulloren (BE) nr. 608/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian që ka të bëjë me zbatimin doganor të të drejtave të pronësisë intelektuale
- Hartimi i Strategjisë për Pronësinë Intelektuale 2016-2020,
- Takimet e Këshillit Shtetërorë për Pronësi Intelektuale;
- Aksionet dhe takimet e Task Forcës;
- Hartimi i legjislacionit implementues (UA) që dalin nga ligjet bazë
- Dhënia e vazhdueshme e rekomandimeve për qeverinë e Kosovës në fushën e IPR-it përmes takimeve të rregullta të Këshillit për Pronësi Intelektuale;
- Ngritja e kapaciteteve në Agjencinë për Pronësi Industriale, më rast do të bëhet rekrutimi i Kryeshefit i Angjenisë për Pronësi Industriale;
- Aktivitetet Vetëdijësuese për Pronësi Intelektuale;
- Trajnime në fushën e pronësisë industriale, piraterisë digjitale, për përfaqësuesit e autorizuar të pronësisë industriale, për përfaqësuesit e shoqatave kolektive, për zyrtarët për promovimin e të

drejtave të pronësisë industriale, trajnimi për përfaqësuesit të rinj për përfaqësuesit e Task Forcës kundër Piraterisë;

- Ndërmarrja e vazhdueshme e veprimeve doganore;
- Ndërmarrja e vazhdueshme e aksioneve të Taskforcës kundër Piraterisë;
- Shqyrtimi i ankesave në kundër vendimeve të API-së.

Prioritetet afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 7, fokusi gjatë periudhës 2017-2020 do të jetë në këto prioritetet afatmesme:

- Ngritja e kapaciteteve në institucionet e pronësisë intelektuale;
- Hartimi i Strategjisë së re kundër Falsifikimit dhe Piraterisë 2017 - 2020 (ZDA dhe Task Forca)
- Miratimi i Ligjit për Aktivitetet e Inovacionit;
- Përmirësimi i Legjislacionit në fushën e krimeve kibernetike. Në planin e veprimit për zbatimin e strategjisë së Policisë së Kosovës parashihet edhe përmirësimi i legjislacionit për të qenë në harmoni me piraterinë dixhitale.
- Anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare dhe Rajonale në fushën e Pronësisë Intelektuale. Ky aktivitet varet nga anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe agjencitë e specializuara të Kombeve të bashkuara. Institucionet synojnë që në planin afatmesëm të angazhohen për t'u përgatitur për anëtarësim.
- Nënshkrimi i Marrëveshjeve, Traktateve, Konventave Ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale. Kjo varet nga anëtarësimi i Kosovës në institucionet ndërkombëtare por institucionet do të punojnë në këtë drejtim në planin afatmesëm.
- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes një projekti të binjakëzimit.

Mbështetja nga donatorët

Projekti i mbështetjes teknike "Forcimi i Sistemit të IPR-it në Kosovë: i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-se në Kosovë dhe implementuar nga Pohl Consulting and Associates në bashkëpunim me Danish Patent and Trademark Office, ka filluar më 5 shkurt 2013 dhe i cili me një periudhë të zgjatur prej 6 muajsh ka përfunduar më datën 04 Nentor 2015.

Sa i përket mbështetjes së vazhdueshme në këtë fushë parashihet që mbështetja të vazhdojë edhe në periudhën në vazhdim në kuadër të Dokumentit Planifikues Sektorial "Konkurrueshmëria".

3.9. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës

Konkurrenca është një nga parimet bazë të tregut të brendshëm të BE. Acquis në fushën e konkurrencës përfshin anti-trustin dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Kapitulli përmban legjislacionin, rregullat dhe procedurën për sjelljen jo-konkurrese të ndërmarrjeve siç janë marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimi me pozitën dominuese në treg. Këtu po ashtu hyjnë analiza e bashkimit të ndërmarrjeve, dhe funksioni parandalues i qeverisë në dhënien e ndihmës shtetërore që çrregullon konkurrencën në treg. Legjislacioni i BE në fushën e konkurrencës buron nga Traktati për Funkcionimin e BE (TFBE). Më konkretisht, neni 37 i TFBE rregullon monopolet shtetërore të karakterit komercial, nenet 101-105 kanë të bëjnë me rregullat e zbatueshme për ndërmarrjet, neni 106 me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, dhe nenet 107-109 të traktatit kanë të bëjnë me rregullat e zbatueshme për ndihmën shtetërore.

Kërkesat e MSA-së

Sa i përket **politikave të konkurrencës**, dispozitat e MSA-së kërkojnë që Republika e Kosovës të zbatojë rregullat e konkurrencës dhe që **gradualisht të përafrojë** legjislacionin e saj me legjislacionin e BE duke filluar nga hyrja në fuqi e marrëveshjes (nenet 74, 75, MSA). Neni 75 "Konkurrenca dhe Dispozitat tjera" definon përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës dhe ofron kornizën për funksionimin e marrëveshjes në lidhje me tregtinë mes BE dhe Kosovës në të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet nga

grupe ndërmarrjesh dhe praktikat e bashkërenduara midis ndërmarrjeve që parandalojnë, kufizojnë ose çrregullojnë konkurrencën.

Marrëveshja mëton përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me Acquis, implementimin efektiv si dhe sigurimin e mekanizmave të monitorimit dhe transparencës kompatibil me rregullat e BE. Në esencë, kjo ka të bëjë me:

- Kartelet dhe marrëveshjet mes ndërmarrjeve,
- Abuzimi me pozitën dominuese, dhe
- Bashkimet, blerjet (e një kompanie nga një tjetër) në tregun relevant të Kosovës.

Ndërsa dispozitat e MSA për **ndihmën shtetërore** (nenet 75.1 – 75.7), kërkojnë që Kosova të mos japë ndihma shtetërore që çrregullojnë ose kërcënojnë të çrregullojnë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje ose produkte të caktuara për atë që kjo afekton tregtinë midis BE-së dhe Kosovës. Kosova duhet gradualisht të përafrojë legjislacionin e saj me atë të BE-së dhe të themelojë një autoritet funksionalisht të pavarur i cili do të ketë fuqinë ligjore të kontrollojë ndihmën shtetërore.

Më specifikisht, bazuar në nenet e MSA, Kosova duhet që:

- Të adoptojë legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe të sigurojë që një autoriteti funksionalisht të pavarur i janë dhënë të drejtat e nevojshme për dhënien dhe kthimin e ndihmave;
- Të aplikojë rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore, përfshirë përjashtimet në bllok, ndihmën de minimis, shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik, dhe rregullat e transparencës për ndërmarrjet publike;
- Të krijojë një inventar të skemave të ndihmës shtetërore që ekzistojnë para hyrjes në fuqi të ligjit (skemat ekzistuese të ndihmës) brenda një periudhe tre-vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes;
- Të sigurojë harmonizimin e skemave të ndihmës shtetërore brenda tri viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes;
- Të bëjë një “hartë regjionale të ndihmës shtetërore” që ka të bëjë me të dhënat për BPV për kokë banori të harmonizuara me nivelin NUTSII brenda një periudhe 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes dhe ta diskutojë me Komisionin Evropian për nevoja të harmonizimit me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore regjionale. Ndërkohë, i gjithë territori i Kosovës do të trajtohet si regjionet më pak të zhvilluara për qëllime të aplikimit të limiteve të ndihmës regjionale; dhe
- Të raportojë në baza vjetore tek Komisioni Evropian për ndihmat shtetërore në Kosovë përmes një raporti vjetor pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

Dispozitat e MSA për ndihmën shtetërore theksojnë rëndësinë e zhvillimit të legjislacionin kompatibil me rregullat e BE-së dhe vendosjes së mekanizmave monitorues dhe të transparencës.

Studimi i Fizibilitetit i Komisionit Evropian i vitit 2012 për MSA ndërmjet BE dhe Kosovës, në pjesën e konkluzioneve dhe rekomandimeve thekson se për të përmbushur obligimet e MSA-së, Kosova duhet të bëjë progres ndër të tjera në fushën e tregut të brendshëm dhe tregtisë duke përfshirë edhe implementimin e kornizës ligjore të konkurrencës.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015 vlerëson që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vazhdon të mos jetë funksional. Kërkohet që të emërohen anëtarët e Komisionit Kosovar të Konkurrencës. Ky dokument thekson, që stafi, hapësira për punë, dhe trajnimet për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës të jenë të përshtatshme, si dhe të rifilloj zbatimin sa më shpejtë që është e mundur. Bashkëpunimi mes AKK-së dhe autoriteteve të tjera rregullatore duhet të forcohet.

Sa u përket politikave të anti-trustit dhe bashkimeve, edhe me tutje nuk po zbatohet legjislacioni sekondar në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Sa i përket ndihmës shtetërore, kërkohet të miratohet plotësim/ndryshimi i ligjit për ndihmën shtetërore, në veçanti për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e Komisionit për Ndihmë Shtetërore. Gjithashtu, kërkohet të fillohet me zbatimin e ligjit pa vonesa. Zyra për ndihmë shtetërore, duhet të kompletohet me staf që të ketë kapacitet për shqyrtimin e skemave ekzistuese të ndihmës.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Konkurrenca

Legjislacioni bazë për fushën e konkurrencës konsiston në Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar/plotësuar në vitin 2014. Ky ligj definon rregullat dhe masat për mbrojtjen konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimin e Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe procedurat për implementimin e këtij ligji.

Ligji ofron definicionin e aspekteve relevante të konkurrencës, si ‘marrëveshjet’, ‘ndërmarrjet’, ‘tregu relevant’, ‘pozita dominuese’. Ligji po ashtu përmban Dispozita për marrëveshjet e ndaluara, marrëveshjet kartel, abuzimin me pozitën dominuese, praktikat e ndaluara, përqëndrimet dhe bashkimin e ndërmarrjeve, zhvillimin e procedurave hetimore, masat ndëshkuese dhe implementimin e masave ndëshkuese dhe bashkëpunimin me institucionet tjera.

Ligji ka inkorporuar brenda principet, rregullat dhe dispozitat bazike të BE-së për konkurrencë nga Traktati për Funkcionimin e BE-së. Ligji po ashtu pjesërisht ka transponuar Rregulloren e Këshillit 1/2003/KE, Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 773/2004, dhe Rregulloren e Këshillit 139/2004/KE (të ashtuquajturat ‘Rregulloret bazë të konkurrencës’).

Sidoqoftë, ende nuk ka rregullore zbatuese për përjashtimet në bllok e as rregullore për industri specifike – marrëveshjet vertikale. Për më shumë, udhëzuesit dhe udhëzimet për implementim të kornizës ligjore nuk janë të zhvilluara. Legjislacioni dytësor për implementimin e ligjit bazë të Konkurrencës përbëhet nga 8 aktet legjislative dytësore. Legjislacioni dytësor që pjesërisht transponon legjislacion të BE përfshin:

- Udhëzimin Administrativ nr. 02/2011 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës – relevant, që pjesërisht transponon Njoftimin e Komisionit për Definimin e Tregut Relevant për qëllime të legjislacionit të konkurrencës së Komunitetit (OJ/C 372 e 9 Dhjetorit 1997),
- Udhëzimin Administrativ nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël, që pjesërisht transponon Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet e rëndësishme të vogël (de minimis) që nuk kufizojnë konkurrencën sipas nenit 81 pika 1 (tani neni 101) i Traktatit që themelon Komunitetin Evropian (OJ/C 368/13, e datës 22 Dhjetor 2001),
- Udhëzimin administrativ nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve, që prek sipërfaqësisht disa elemente të Kërkesës dhe kriterëve për bashkimin/përqendrimin të definuar në Rregulloren e Komisionit Nr 802/2004 që implementon Rregulloren e Këshillit nr. 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve. Megjithatë, kjo rregullore është amendamentuar nga Rregullorja Implementuese e Komisionit nr. 1269/2013 bashkë me anekse, dhe duhet që legjislacioni jonë dytësor të rishikohet në planin afatmesëm për t’u përafëruar më tutje me këtë legjislacion sekondar mjaft voluminoz për përqendrimin.

Ndihma shtetërore

Legjislacioni bazë që rregullon këtë fushë konsiston nga Ligji nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore. Ligji vendosi bazën për zhvillimin e sistemit të ndihmës shtetërore, principet dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore. Ligji përmban definicionet bazë përfshirë atë të ndihmës shtetërore, vendos mekanizmin dhe kornizën për kontrollin e ndihmës shtetërore. Ai po ashtu krijon bazën për themelimin e inventarit gjithëpërfshirës të ndihmave shtetërore dhe sistemin e raportimit.

Sa i përket legjislacionit implementues, procedurat detale dhe përmbajtja e formularëve notifikues, procedurat për ndihmat jo-legale, ato të monitorimit dhe raportimit janë rregulluar me Rregulloren 1/2012 të Ministrisë së Financave për Procedurat dhe Formatin e Njoftimit për Ndihmën Shtetërore e cila pjesërisht transponon Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 794/2004 e 21 prillit 2004 që implementon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 659/1999 që definon rregullat detale për aplikimin e Nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian.

Ndërsa rregullat e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë dhe mënyrën e implementimit janë të rregulluara me Rregulloren nr. 01/2013 të Ministrisë së Financave për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Konkurrenca

Bazuar në ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është institucioni kryesor për parandalimin dhe ndalimin e praktikave kundër konkurrencës përfshirë marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese, përqendrimet ose shitjen dhe blerjen e aksioneve në ndërmarrje, dhe aspektet e avokimit në fushën e konkurrencës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës konsiston nga **Komisioni i Konkurrencës** si organ vendimmarrës kolegjal dhe nga **Sekretariati** që përbëhet prej shërbyesve civil profesional, hetuesve dhe stafit mbështetës. Sipas ligjit, Komisioni i Konkurrencës është pjesë e Autoritetit, dhe menaxhon me punën e tij. Përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Ekzistojnë rregulla për të garantuar pavarësinë e Komisionit nga bizneset. Komisioni raporton dhe mbikëqyr nga Parlamenti i Kosovës.

Sekretariati i AKK-së është organ administrativ i autorizuar nga ligji të bëjë hetimin, përgatit raportet e hetimit dhe i përcjell ato tek Komisioni për vendimmarrje dhe bën monitorimin për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe efektive në treg. Sekretariati përbëhet nga 2 departamente, Departamenti ligjor dhe i Administratës, Departamenti për Mbikëqyrje të Tregut dhe nga Zyra për Ndhmë Shtetërore. I pari zhvillon politikën e menaxhimit të personelit dhe koordinon procesin e hartimit të legjislacionit, ndërsa departamenti i dytë heton shkeljet e konkurrencës në treg në harmoni me legjislacionin në fuqi. Sipas ligjit, departamenti për mbikëqyrjen e tregut zhvillon procedura hetimore, mbikëqyr tregun dhe propozon masa për vendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit ose çrregullimit të konkurrencës në treg.

Aktualisht Autoriteti i Konkurrencës e realizon aktivitetin e tij nëpërmjet veprimtarisë së 11 nëpunësve civil. Mungesa e hapësirave të punës po e pamundëson punësimin edhe të 6 nëpunësve civil, me çka po dëmtohet dhe limitohet kapaciteti funksional i Autoritetit.

Ndhmja shtetërore

Korniza institucionale konsiston në Komisionin e ndihmës Shtetërore dhe Zyrën për ndihmë shtetërore. Bazuar në ligjin aktual, Komisioni i Ndhmës Shtetërore është organi vendimmarrës për ndihmë shtetërore. Komisioni vepron mbi baza "Ad hoc" dhe është i pavarur në vendimmarrje dhe ushtrimin e funksioneve të tij. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, tre ministra, një përfaqësues i shoqërisë civile dhe kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Zyra për Ndhmën Shtetërore është përgjegjëse për marrjen, analizën dhe mbikëqyrjen e njoftimeve si dhe të dhënave të tjera lidhur me skemat e ndihmës. Zyra që nga themelimi funksionon me kapacitete jo të plota. Nga 6 zyrtar të lejuar me Ligjin për ndihmën shtetërore, pagat me buxhet janë lejuar vetëm për 5 zyrtar, por në marrëdhënie pune janë aktualisht vetëm 2 zyrtarë. Një nga shkaqet kryesore të mosplotësimit të stafit edhe me 3 zyrtarë është mungesa e hapësirave të punës. Kompletimi i zyrës me këtë staf dhe hapësirat e punës janë çështje prioritare për të siguruar funksionalitetin e saj.

Mbështetja nga donatorët

Aktualisht institucionet bartëse të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore aktualisht nuk kanë mbështetje me ndonjë projekt të veçantë. Sidoqoftë, projekti i BE-së në kuadër të IPA për "Asistencë Teknike për Zhvillimin e Mëtutjeshëm të Politikave Tregtare të Kosovës" përmes një komponenti ka mbështetur Autoritetin e Konkurrencës me gap analiza për aspektin legjislativ dhe administrativ. Ngjashëm, ky projekt përmes ekspertëve ndërkombëtar ka mbështetur konkurrencën dhe ndihmën shtetërore respektivisht, për të ndihmuar në identifikimin e nevojave dhe masave kyçe në kuadër të hartimit të PKAA për kapitullin e politikave të konkurrencës.

Ndërsa, në kuadër të hartimit të 'Dokumentit Planifikues Sektorial për Konkurrueshmërinë' ku hyn edhe fusha e konkurrencës, në bashkëpunim me partnerët e Zyrës së BE-së në Kosovë, është duke u planifikuar mbështetje përmes asistencës teknike për AKK-në. Kjo mbështetje do të përkrahte përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit, çështje që lidhen me kapacitetin administrativ dhe kapacitetet njerëzore. Ndërsa, për të adresuar disa nga nevojat e menjëhershme për vitin 2016, është duke u diskutuar me ZBE mundësia e një projekti 'twinning light' për këtë vit. Kjo është ende vetëm ide fillestare që mbetet të zhvillohet në koordinim me ZBE dhe aktorët vendorë. Një parakusht esencial për të shtyrë përpara mbështetjen nga donatorët është funksionaliteti i AKK, më konkretisht kompletimi i Komisionit të Konkurrencës me komisionerë.

Masat afatshkurtra

Konkurrenca

Në planin afatshkurtër, fokusi do të jetë në një numër të limituar masash legjislative dhe administrative të nevojshme për funksionalizim të aktiviteteve të AKK-së. Në aspektin ligjor, marrëveshjet e ndaluara janë të rregulluara me ligjin e konkurrencës (neni 4) përfshirë edhe përjashtimet grupore (neni 5). Rrjedhimisht, është e natyrshme dhe prioritare që përjashtimet grupore të rregullohen me rregullore të veçanta sa më shpejt që është e mundur dhe në harmoni me rregullat e BE-së. Kjo konsiston në transpozimin e rregulloreve të mëposhtme të Këshillit dhe Komisionit:

- Tek përjashtimet grupore për marrëveshjet horizontale, transpozimin e Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 2821/71 e 20 Dhjetorit 1971 për aplikimin e Nenit 81(3) (më parë Neni 85(3)) i Traktatit të Komunitetit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara; dhe
- Tek përjashtimet grupore për marrëveshjet vertikale, transpozimin e Rregullores së Komisionit (BE) nr. 330/2010 për aplikimin e Nenit 101(3) të traktatit për Funksionimin e BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara

Sa i përket kapacitetit institucional, në planin afatshkurtër, fokusi do të jetë në përmirësimin e kapacitetit funksional të Autoritetit të Konkurrencës. Kjo përfshinë fillimisht sigurimin e hapësirave adekuata të punës dhe punësimin e stafit profesional të paraparë me organogram dhe me buxhet. Gjithashtu, zhvillimi i një programi për trajnimin profesional të stafit është i nevojshëm, por kjo çështje do të jetë një prioritet përgjatë periudhës afatmesme. Në vitin 2016, fokusi i trajnimit profesional do të jetë në fushën e mbikëqyrjes së tregut konkretisht specializimi në fushën e marrëveshjeve, përqendrimeve dhe pozitës dominuese, si dhe hetimeve dhe analizës së tregut si një nga fushat kyçe të veprimtarisë së Autoritetit. Për shkak të buxhetit të limituar, trajnimet janë paraparë nën supozimin që do të gjenden burime për trajnim nga projektet e donatorëve.

Ndihma shtetërore

Objektivi i përgjithshëm i masave prioritare në planin afatshkurtër dhe afatmesëm është zhvillimi i sistemit efektiv të ndihmës shtetërore përmes ndërmarrjes së hapave të nevojshëm përgatitor si në aspektin legjislativ, po ashtu edhe në atë institucional në harmoni me Dispozitat e MSA-së.

Në planin afatshkurtër, prioritet është harmonizimi i bazës ligjore me acquis bazuar në dispozitat e MSA, zhvillimi i kapacitetet administrativ dhe ndërmarrja e hapave fillestar drejt vendosjes së sistemit të monitorimit të ndihmës shtetërore. Ligji është aktualisht në procedurë ndryshimi që ndër të tjera edhe do të rezultojë me përafrim më të mirë me legjislacionin bazë të BE për këtë fushë. Draft ligji për ndihmën shtetërore pritet të aprovohet gjatë vitit 2015. Ligji transponon parimet bazë të legjislacionin primar të Acquis (nenet e Traktatit për Funksionimin e BE-së). Ligji po ashtu do të rregullojë kornizën institucionale për kontrollin dhe monitorimin e ndihmave, krijimin e inventarit dhe raportimit të ndihmës shtetërore. Meqenëse ligji bazë nuk përmban substancë të rregullave të ndihmës shtetërore e as kriteret për vlerësimin e kompatibilitetit të kategorive të caktuara të ndihmës, është e nevojshme që të zhvillohet dhe aprovohet legjislacioni sekondar për implementimin e ligjit bazë. Ky legjislacion sekondar do të transpozojë elemente bazë të legjislacionit të BE-së të ndihmës horizontale, vertikale, përjashtimet në bllok dhe disa nga instrumentet specifik të ndihmës të cilat janë të nevojshme për zbatimin e legjislacionit primar të Kosovës. Gjithashtu pas miratimit të ligjit, do të jetë e nevojshme që të rishikohen

rregulloret aktuale për t'u harmonizuar me ligjin bazë dhe për të definuar dhe zhvilluar aspektet procedurale (Rregullorja nr. 1/2012/MF për procedurat dhe formatin e njoftimit të ndihmës shtetërore).

Përveç aspektit rregullativ, është me prioritet që të ndërmerren masa për përmirësimin e kapacitetit administrativ për të siguruar funksionimin efektiv të ndihmës shtetërore. Në planin afatshkurtër është e domosdoshme që të sigurohet stafi i nevojshëm për Zyrën për ndihmë shtetërore. Ky staf duhet që në vitin 2016 të trajnohet fillimisht në trajnime bazë për parimet, procedurat dhe funksionimin e sistemit të ndihmës shtetërore. Për shkak të buxhetit të limituar, trajnimet janë paraparë nën presupozimin që do të gjenden burime për trajnim nga projektet e donatorëve.

Në funksion të zbatimit të legjislacionit, ZNSH gjatë vitit 2016 do të fillojë krijimin e listës së institucioneve dhënëse të ndihmës shtetërore (të vendosura para se të hynte në fuqi ligji) që më pas do të shërbejë për hartimin e skemave ekzistuese të ndihmës në linjë me afatet e definuara në MSA. Krijimi i inventarit përbën bazën për rishikimin dhe monitorimin e mëvonshëm të ndihmës shtetërore. Një hap tjetër i rëndësishëm për zbatimin e legjislacionit është edhe mbledhja e të dhënave për ndihmën shtetërore që jepet aktualisht përfshirë iniciativat e reja që kanë elemente të ndihmës. Për të filluar me këtë proces është me rëndësi të krijohet një formë standarde për mbledhjen e të dhënave dhe të nisin procedurat e notifikimit. Ky informacion, ndër të tjera do të shërbejë edhe për përgatitjen e raportit vjetor të ndihmës shtetërore.

Prioritetet afatmesme

Konkurrenca

Në aspektin legjislativ, në planin afatmesëm, do t'i jepet prioritet zhvillimit dhe hartimit të akteve ligjore dhe procedurale që do të afronin konkurrencën me standardet e BE-së për procedura ligjzbatuese 'të drejta', 'të hapura', dhe 'të parashikueshme'. Kjo nënkupton, në terma gjeneral transpozim të legjislacionit të BE-së në fushat si më poshtë:

- Përafrim i mëtejshëm i legjislacionit primar vendor me legjislacionin relevant të BE-së, përfshirë transpozimin e rregullave më detaje
- Adoptimin e rregullave specifike për sektor të BE,
- Transpozimin e "Direktivës për bashkimet" dhe rregulloreve zbatuese në legjislacion vendor

Ngjashëm, në aspektin e zhvillimit të kapacitetit administrativ, fokusi do të jetë në zhvillimin profesional të stafit përmes programeve të trajnimit dhe zhvillimit të udhëzuesve, procedurave dhe memories institucionale si elemente esenciale për implementimin e rregullativës dhe funksionimin efektiv të konkurrencës. Pra, objektivat kryesor në planin afatmesëm janë:

- Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore përfshirë programe të trajnimit profesional të stafit të Autoritetit të konkurrencës,
- Krijimi i memories institucionale përfshirë praktikat gjyqësore (case law), çështjet e politikave të konkurrencës, udhëzuesit, procedurat, ruajtjen e dokumentacionit përmes njw sistemi të informimit etj,
- Zhvillimi i aktiviteteve të vetëdijësimit me partnerët relevant përfshirë ndërmarrjet, asociacionet e biznesit, shoqërinë civile etj
- Zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet e konkurrencës në vendet tjera të regjionit, Be-së etj.

Ndihma shtetërore

Në planin afatmesëm, objektivat kryesor synojnë zhvillimin e sistemit të ndihmës shtetërore, përfshirë anën legjislative dhe institucionale për zbatim efektiv të MSA dhe rritjen e vetëdijes dhe informacionit për rregullat e ndihmës shtetërore. Kjo gjithashtu do të adresojë çështjet specifike të rregullave për sektorin e energjisë bazuar në kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Më konkretisht, institucionet do të angazhohen në përafrimin dhe implementimin e legjislacionit në harmoni me Dispozitat e MSA. Kjo përfshin legjislacionin dhe udhëzuesit procedural për ndihmat shtetërore sektoriale, regjionale, shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik, përjashtimin nga obligimi për njoftim të disa ndihmave shtetërore, përafrimin e skemave të ndihmës me kriteret e paragrafit 2, neni 75 i MSA.

Gjithashtu, do të vazhdojë puna në kompletimin e inventarit të ndihmës si dhe mbledhja e të dhënave si dy hapa të rëndësishëm për notifikimin dhe monitorimin e skemave të reja të ndihmës dhe për nevoja të raportimit. Rëndësi do t'i kushtohet po ashtu zhvillimit të kapaciteteve njerëzore përfshirë trajnimet për dhënësit e ndihmave, institucionet lokale dhe palët tjera relevante dhe aktivitetet e vetëdijësimit. Pra, objektivat kryesor në perspektivën 2017-2020 janë:

- Zhvillimi dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me atë të BE-së dhe implementimi efektiv
- Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit të ndihmës shtetërore
- Zhvillimi i sistemit informativ për monitorimin e ndihmës shtetërore
- Forcimi i kapacitetit administrativ përfshirë zhvillimin e resurseve njerëzore dhe aktivitetet e vetëdijësimit,
- Krijimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ndihmës shtetërore.

3.10. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përfshin rregullat për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushën bankare, sigurimit, pensione, shërbimet e investimeve dhe tregjet e letrave me vlerë si dhe në lidhje me infrastrukturën e tregut financiar. Sistemi i ri Evropian i Mbikëqyrjes Financiare (ESFS) hyri në fuqi në janar të vitit 2011. Ky sistem përbëhet nga një rrjet i mbikëqyrësve financiarë kombëtarë duke punuar së bashku me tre Autoritetet e reja Mbikëqyrëse Evropiane - me Autoritetin Bankar Evropian (EBA), me Autoritetin e Letrave me Vlerë dhe Tregjeve Evropiane (ESMA) si dhe me Autoritetin e Sigurimeve Evropiane dhe Pensioneve të Punës (EIOPA). Përveç kësaj, Bordi i Rrezikut Sistemik Evropian (ESRB) është themeluar për të monitoruar dhe vlerësuar kërcënimet e mundshme ndaj stabilitetit financiar që lindin nga zhvillimet makro-ekonomike dhe nga zhvillimet në sistemin financiar në tërësi.

Në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**, acquis përcakton kërkesat për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredituese si dhe kërkesat në lidhje me llogaritjen e kapitalit të institucioneve kredituese dhe firmave investuese. Direktivat e tanishme për kërkesat e kapitalit, të cilat përkthejnë standardet ndërkombëtare Bazel II në ligjin e BE-së, është zëvendësuar në vitin 2014 me një pako të bazuar në marrëveshjen e Basel III. Acquis në këtë sektor gjithashtu parashtron rregullat në lidhje me mbikëqyrjen shtesë të konglomerateve financiare dhe me marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike. Acquis përcakton rregullat lidhur me llogari vjetore të konsoliduara të bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensione të punës**, disa Direktiva përcaktojnë rregulla lidhur me autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sigurimit të jetës dhe të jo-jetës dhe risigurimi i ndërmarrjeve. Acquis përcakton rregullat për mbikëqyrjen e sigurimit plotësues të grupeve. Dispozita të veçanta ekzistojnë në sektorin e jo-jetës për bashkë-sigurimin, ndihmë turistike, sigurimit të kredisë dhe sigurimit të shpenzimeve ligjore. Kjo përfshin një kuadër rregullativ të kujdesshëm për aktivitetet e risigurimit në BE që synojnë heqjen e pengesave për të arritur risigurimin biznesor.

Në fushën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve rreth investimeve**, Direktiva 2004/39/KE mbi tregjet në instrumente financiare (MiFID) së bashku me ndryshimet e saj dhe Masat zbatuese, përcakton një regjim të plotë rregullator që mbulon autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e firmave investuese dhe tregjeve të rregulluara. Në lidhje me **infrastrukturën e tregut financiar**, acquis synon të heq pengesat në zona tregtare, duke rritur efikasitetin e infrastrukturës së tregut dhe nxitjen e stabilitetit financiar.

Së fundi, acquis ka një kornizë gjithëpërfshirëse rregullative dhe mbikëqyrëse për investimet alternative, fondet kapitale dhe ato shoqërore, duke rritur transparencën ndaj investitorëve dhe autoriteteve publike.

Kërkesat e MSA-së

Në kuadër të MSA, nga Kapitulli 9 Shërbimet Financiare, rrjedhin detyrimet për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në fushën e shërbimeve financiare, perkatësisht në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve bankare, të sigurimeve dhe shërbimeve tjera në fushën financiare, si dhe

përafrimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator (përkatësisht nenet 50, 96 dhe aneksit 6 të MSA-së), me legjislacionin e Bashkimit Evropian, statutin e Bankës Qendrore Evropiane dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Bazuar në Raportin e KE-së për Kosovën 2015 për çështjet që lidhen me shërbimet financiare edhe më tej legjislacioni vendor duhet të harmonizohet me *acquis*. Raporti nënvizon se Kosova ende nuk është pjesë e sistemit të "kartonit të gjelbër". Gjithashtu, përmendet që tregu i shërbimeve financiare mbetet në një fazë të hershme të zhvillimit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Sa i përket **sektorit bankar**, korniza ligjore dhe rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave në Republikën e Kosovës përfshinë:

- Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) (me tutje Ligji për BQK-në);
- Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012) (me tutje Ligji për Bankat);
- Ligjin nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (me tutje Ligji për Sistemin e Pagesave);

Në kuadër të legjislacionit ekzistues, në vijim është paraqitur edhe legjislacioni sekondar (rregullat, rregulloret dhe udhëzimet) të nxjerrë nga BQK duke u bazuar dhe në zbatim të ligjeve të lartcekura (Ligji për BQK-në, Ligji për Bankat dhe Ligji për Sistemin e Pagesave) që adresojnë licencimin, organizimin, operimin, kërkesat për menaxhimin e rrezikut dhe kërkesat për mbikëqyrjen prudenciale të bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Kjo kornizë rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave është e bazuar në Parimet Bazike të Komitetit të Basel-it dhe Standardet e Basel II, sidomos me miratimin e Ligjit për Banka në vitin 2012 dhe rregulloreve në zbatim të tij, të adaptuara kryesisht në vitin 2013:

- Rregullore për Adekuatshmëria e Kapitalit të Bankave;
- Rregullore për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave (e plotësuar 27.02.2015);
- Rregullore për Auditimin e Jashtëm të Bankave;
- Rregullore për Bashkimet dhe Përvetësimet e Bankave;
- Rregullore për Depozitën Ekuivalente me Kapitalin për Degët e Bankave të Huaja;
- Rregullore për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave;
- Rregullore për Ekspozimet e Mëdha;
- Rregullore për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Bankave;
- Rregullore për Hapjen e Zyreve Përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës;
- Rregullore për Kontrollin e Brendshme dhe Auditimi i Brendshëm i Bankave;
- Rregullore për Kufizimet në Mbajtjen e Pasurisë së Paluajtshme dhe të Luajtshme;
- Rregullore për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Huaja;
- Rregullore për Mbikëqyrjen e Konsoliduar e Grupeve Bankare;
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor të Bankave;
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut Operacional;
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit të Bankave;
- Rregullore për Minimumin e Rezervave të Bankës;
- Rregullore për Ndryshimet në Llogaritë e Kapitalit;
- Rregullore për Norma Efektive e Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje të Bankave;
- Rregullore për Publikimin e Informacionit nga Bankat;
- Rregullore për Raportimin e Bankave në BQK;
- Rregullore për Rrezikun nga Aktiviteti me Valuta të Huaja;
- Rregullore për Transaksionet me Personat e Ndërlidhur dhe Ekspozimet ndaj Punëtorëve;
- Rregullore për Kasafortën;
- Rregullore për Kreditë Hipotekare;

- Rregullore për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme;
- Rregullore për Kërkesat Minimale të Sigurisë;
- Rregullore për Debitimin Direkt të SEKN;
- Rregullore për Mbështetje Emergjente me Likuiditet;
- Rregullore për Pagesat Ndërkombëtare;
- Rregullore për Kliringun dhe Funksionimin e Llogarive për Shlyerje;
- Rregullore për Sistemin e numrave standardë të llogarive bankare;
- Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative;
- Rregullore për Procesin e Brendshëm të Trajtimit të Ankesave;
- Rregullore për Regjistrin e Kredive;
- Rregullore për Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare;
- Rregullore për Auditimin e Jashtëm të Institucioneve Mikro Financiare;
- Rregullore për Kontrollin e Brendshëm dhe Auditimi i brendshëm i Institucioneve Mikrofinanciare;
- Rregullore për Kufizimet në Mbajtjen e Pasurisë së Paluajtshme dhe të Luajtshme për Institucionet Mikro Financiare;
- Rregullore për Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit për Institucioneve Mikrofinanciare;
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor të Institucioneve Mikrofinanciare;
- Rregullore për Norma Efektive e Interesit dhe Kërkesat për Shpalesje për Institucione Mikrofinanciare;
- Rregullore për Raportimin e Institucioneve Mikrofinanciare në BQK;
- Rregullore për Regjistrimin, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e institucioneve financiare jobankare;
- Rregulla për Auditimin e Jashtëm dhe Auditorët e Jashtëm të Institucioneve financiare;
- Rregulla për Pagesën Direkte dhe Indirekte të Kredive në Para të Gatshme;
- Rregulla për Parandalimi i Shpërlarjes së Parave dhe Financimit e Terrorizmit.

Ligji për bankat dhe rregulloret e lartcekura kanë vendosur bazën ligjore për adaptimin e kërkesave të Direktivës 2006/48/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 14 qershor 2006 për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë së Institucioneve Kreditore dhe Direktivës 2006/49/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 14 qershor 2006 për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Shoqërive Investuese dhe Institucioneve Kreditore, të cilat janë zëvendësuar në vitin 2013 me miratimin e Direktivës 2013/36/BE për Qasjen në Aktivitetin e Institucioneve Kreditore dhe Mbikëqyrjen Prudenciale të Institucioneve Kreditore dhe Firmave Investuese (CRD IV) dhe Rregullores (BE) nr. 575/2013 për Kërkesat Prudenciale për Institucionet Kreditore dhe Shoqëritë Investuese (CRR).

Sa i përket **Fondit të Sigurimit të Depozitave**, që nga viti 2011 është themeluar me anë të Ligjit nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-133 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë. Ky ligj rregullon sigurimin e depozitave të personave fizik dhe juridik, themelimin, qeverisjen, autoritetin e Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë.

Sistemi i Sigurimit të Depozitave ("SSD") është themeluar si projekt zhvillimor në kuader të bashkëpunimit bilateral Gjermano-Kosovar, ku në vitin 2011 është nënshkruar Marrëveshja trepalëshe e Financimit dhe Projektit në mes të Qeverisë së Kosovës (përmes MF), Qeverisë Gjermane (përmes KfW-së) dhe FSDK-së (si Agjenci për Ekzekutimin e Projektit) për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në Kosovë përmes një kontributi në kapital si donacion për FSD-në në shumë totale prej 15.5 milion €, ku 11 milion € janë dhënë nga Qeveria e Kosovës (përmes MF) ndërsa Qeveria Gjermane (nëpërmjet KfW) ka siguruar 4.5 € kontribut në kapital, dhe 0.5 milion € në shërbime të shoqëruara këshillimore. Kësti i tretë i paguar nga Qeveria e Kosovës (përmes MF) në shumën prej EUR 2.9 milion është financuar nga kredia e IDA-së (nëpërmjet BB). Në mbështetje të rritjes së limitit të sigurimit në € 5,000 nga 01.01.2018, FSDK ka pranuar një kontribut shtesë nga Qeveria Gjermane (përmes KfW) në vlerë prej EUR2 milion në vitin 2013. Ky projekt tre-vjeçar është përfunduar në korrik të vitit 2015.

Karakteristikat kryesore të SSD-së në Kosovë janë: pavarësia e agjencisë së sigurimit të depozitave, anëtarësimi i detyrueshëm i të gjitha institucioneve që pranojnë depozita, financimi "paraprak" ("ex-

ante”), sistem i premiumit diferencues, mbulueshmëria e sigurimit që përfshin individët dhe personat juridik, shuma e kufizuar e sigurimit të depozitave, rregulli i sigurimi i depozitave: për depozitues, për çdo bankë, lartësia e synuar e FSD-së, politikë konservatore e investimeve.

Sa i përket fushës së **sigurimeve**, korniza ligjore dhe rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sigurimeve në Republikën e Kosovës përfshinë:

- Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
- Ligji nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (me tutje Ligji për Sigurimin nga Autopërgjegjësia)
- Rregullore nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit (me tutje Rregullore nr. 2001/25) (e cila do të shfuqizohet me Ligjin e Ri për Sigurime të Përgjithshme, i cili tani është në fazën finale të miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës).

Ligji nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe rregulloret në zbatim të tij janë pjesërisht në harmoni me Direktivën Evropiane 2009/103/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 16 shtator 2009, për sigurimin ndaj përgjegjësisë civile lidhur me përdorimin e mjeteve motorike, dhe implementimin e obligimit për sigurim ndaj kësaj përgjegjësie.

Rregullorja nr. 2001/25 është nxjerrë në vitin 2001 nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), përmes të cilës është përcaktuar autorizimi i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (paraardhësja ligjore e BQK-ë) për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve. Rregullorja ka përcaktuar kriteret dhe afatet për licencimin e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve, më tutje rregullorja përcakton ndalesën që askush nuk mund të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit në Kosovë, nëse nuk është licencuar nga autoriteti mbikëqyrës i vendit.

Me qëllim të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit në fushën e sigurimeve me direktivat Evropiane është hartuar Draft Ligji për Sigurimet, i cili tani është në procesin final të miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky draft ligj pjesërisht është i harmonizuar me Direktivën Evropiane 2009/138 EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 25 nëntor 2009 për themelimin dhe vazhdimin e veprimtarisë së biznesit të sigurimeve dhe ri-sigurimeve (Solvency II) dhe Direktiven Evropiane 2002/92/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 9 dhjetor 2002 për ndërmjetësimin në sigurime. Përmes këtij Draft Ligji janë vendosur bazat për përafrim të mëtejme me *acquis* të BE-së. Ky Draft Ligj rregullon parimet dhe rregullat themelore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve, ri-siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera relevante, në mënyrë që industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës të operojë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe transparente në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të policëmbajtësve.

Rregulloret e adaptuara bazuar dhe në zbatim të Ligjit për BQK-në, Ligjit për sigurimin nga autopërgjegjësia dhe Rregullores nr. 2001/25, të cilat janë cekur më lartë, janë si vijon:

- Rregullore për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia;
- Rregullore mbi depozitimin e aseteve si garancë, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin;
- Rregullore për Fondin e Kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve;
- Rregullore për Implementimin e Sistemit BONUS-MALUS;
- Rregullore për Kushtet e Përgjithshme të Policës së Sigurimit nga Autopërgjegjësia;
- Rregullore për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime;
- Rregullore për Procedurat e Trajtimit të Kërkesave për Kompensimin e Demëve nga Autopërgjegjësia;
- Rregullore për Standartet e Raportimit dhe të Mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimit;
- Rregullore për Licencimi i kompanive të sigurimeve dhe degëve të huaja;
- Rregulla për Aktivitetin që ka të bëjë me Sigurime;
- Rregullin mbi Anëtarësimin dhe Kontratat e Jashtme;
- Rregullin mbi Burimin e Produkteve Financiare;

- Rregulli mbi Kontrollin e brendshëm;
- Rregulli mbi Themelimin e një Forumi të Arbitrazhit për t'i Zgjedhur Kundërshtimet mbi Dëmet;
- Regulla për licencimin e rregulluesve/mbikëqyrësve të dëmeve të sigurimit;
- Rregulli mbi Ndryshimin e Rregullit mbi Standardet e Kontabilitetit dhe Kërkesat për mbajtjen e shënimeve për Kompanitë e Sigurimit dhe Ndërmjetësuesit e Sigurimit;
- Rregulli mbi përshkrimin e kërkesave për rezerva të kompanive të sigurimit;
- Rregulli mbi Përshkrimin e Kërkesave Shtesë, që të Përfshihen në Letrën Angazhuese të Revizorit të Jashtëm;
- Rregulli mbi Qeverisjen e Përbashkët të Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit;
- Rregulli mbi Shitjen e Sigurimeve Përmes Internetit;
- Rregulli mbi Transaksionet me Palët e Afërta;
- Rregulli mbi Validitetin dhe Shumën e Aksionarëve dhe Dëmeve të Kreditorve, në Likuidim;
- Rregulli në ndryshimin e Rregullit mbi Klasët e Sigurimit të Përgjithshëm të Njohura nga BPK-ja.

Këto rregullor dhe rregulla janë pjesërisht të harmonizuara me Direktivat e BE-së në fushën e sigurimeve, të cilat rregullojnë çështjet si: sigurimin jo-jetë, sigurimin jetë, ndërmjetësimin në sigurime, sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, kërkesat prudenciale për menaxhimin e rrezikut, kërkesat minimale të kapitalit, si dhe çështje tjera me rëndësi për fushën e sigurimeve. Në përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin në fushën e sigurimeve me acquis të BE-së, siç u cekë edhe më lartë, Draft Ligji i ri për sigurime është në fazën finale të miratimit dhe BQK-ja ka filluar përgatitjet për nxjerrjen dhe amandamentimim e akteve nënligjore në zbatim të Draft Ligjit.

Sa i përket fushës së **pensioneve**, ligji për BQK i ka përcaktuar fondet pensionale si institucione financiare. Prandaj ky ligj përcakton kompetencën ekskluzive të BQK-së për të licencuar, rregulluar dhe mbikëqyrur Fondet Pensionale të Kosovës.

Korniza ligjore dhe rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve pensionale në Republikën e Kosovës përfshinë:

- Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Ligji për Fondet Pensionale) dhe rregulloret e BQK-së për Fondet Pensionale.

Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale dhe rregulloret në zbatim të tij janë pjesërisht në harmoni me Direktivën e BE-së 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 3 qershor 2003 për aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve e pensioneve të punësimit, me anë të cilit janë përcaktuar bazën për harmonizimin e plotë të kërkesave të kësaj direktive.

Rregulloret e adaptuara bazuar në Ligjin për BQK-në dhe Ligjin për Fondet Pensione: korniza rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e pensioneve pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Fondet Pensionale është si në vijim:

- Rregullore për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për tërheqje të mjeteve nga FKPK
- Rregullore për Raportet dhe Informatat që Kërkohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës;
- Rregullore për Licencimin e Menaxhuese të mjeteve për mjetet e fondeve pensionale;
- Rregullore për Pagesat e pensioneve individuale të kursyera;
- Rregullore për Licencimi i Fondeve Plotësuese Punëdhënëse të Pensioneve;
- Rregullore për Licencimin e Ofruesve të Pensioneve plotësuese individuale;
- Rregullore për Llogaritë individuale të Pjesëmarrësve;

Këto rregullore zbatohen kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Fondet Pensionale që kontribuojnë në përafrim të metejmë me kërkesat e direktivës. Përveç këtyre rregulloreve, për rregullimin dhe mbikëqyrjen e pensioneve ekzistojnë edhe rregullat në vijim:

- Rregulla mbi Benefitet e Pensionit Programet e Aplikueshme të Pensioneve Suplementare Individuale;
- Rregulla mbi Financimin dhe Vlerësimin aktuarial të Rregullimit Pensional me Benefit të Definuar;

- Rregulla mbi Investimet e Mjeteve të Pensioneve;
- Rregulla që parashkruan kërkesat në letrën e angazhimit të revizorit të jashtëm të Fondit të Pensionit dhe Siguruesve të Pensionit;
- Rregulla mbi Mbajtjen e shënimeve në Fondet Pensionale dhe Siguruesit e Pensioneve;
- Rregulla mbi Mjetet e Pensioneve dhe Vlerësimin i Mjeteve të Pensioneve;
- Rregulla mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Përcaktimin e Përfituesve të Pensioneve;
- Rregulla mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Transferet dhe Pagesat e Transferit të Mjeteve të Pensionit;
- Rregulla mbi ndryshimin e rregullës për Kujdestarin e Mjeteve të Pensioneve;
- Rregulla mbi ndryshimin e rregullës për Menaxherët e Pronave të Mjeteve të Pensioneve;
- Rregulla mbi shuarjen e Pensioneve Individuale Suplementare;
- Rregulla mbi pjesëmarrjen në Fondin e Pensionit dhe Kategoritë profesionale të nëpunësve;
- Rregulla mbi raportet dhe informatat tjera të kërkuara nga Fondi i Pensionit dhe Siguruesi i Pensionit që të parashtrohen;
- Rregulla për themelimin e Fondit të Pensionit;
- Rregulla mbi themelimin e Pensionit Suplementar Individual nga Siguruesit e Pensionit;
- Rregulla mbi Vlerën e Benefiteve të Pensionit e aplikueshme për Fondin e Pensionit Suplementar Pundhënës;
- Rregulla mbi Vlerën e Kontributeve të Pensionit.

Në fushën e *tregut financiar*, deri tani është zhvilluar tregu i borxhit të brendshëm, përmes emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, që funksionon përmes platformës elektronike të tregtimit të letrave me vlerë. Ky aktivitet realizohet përmes organizimit të ankandëve të shpallura nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe menaxhimit të tyre nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Organizimi i ankandëve të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës është i bazuar në sistemin e akterëve primar (bankave komerciale), me ç'rast personat fizik dhe juridik mund të marrin pjesë në treg përmes akterëve primar të cekur më lartë.

Emetimi i parë i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës është realizuar me 17 janar 2012 ku është emetuar një instrument me maturitet 3 muaj dhe është vazhduar me emetime 6 dhe 12 mujore. Përveç bonove të thesarit emetohen edhe obligacione me afate maturimi 2 dhe 3-vjeçare. Me 24 maj 2014 është shënuar transaksioni i parë i tregtimit të letrave me vlerë në tregun sekondar, me ç'rast është realizuar transaksioni i shitblerjes së letrave me vlerë në mes të Akterit Primar dhe klientit. Deri tani janë realizuar një numër i konsiderueshëm i këtyre transaksioneve, kryesisht në mes të Akterëve Primar dhe klientevë të tyre, e poashtu edhe transaksione në mes vetë Akterëve Primar.

Është vërejtur një zgjerim i bazës së investitorëve që marrin pjesë në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, ku përpos personave fizik marrin pjesë edhe Fondet Pensionale si dhe Kompanitë e Sigurimeve.

Poashtu në gusht 2015 janë realizuar edhe transaksionet e blerjes së letrave me vlerë përmes tregut sekondar nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në raport me Nenin 11 të Ligjit No. 03/L-209.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës është i rregulluar me Ligjin 04/L-175 mbi Borxhin Publik, në fuqi nga nëntori i vitit 2009 dhe me aktet nën ligjore, Rregullorja MF-BQK nr. 01/2014 për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës të nxjerra në vitin 2012 (amandamentuar me 2014).

Ndër qëllimet strategjike është edhe **sigurimi i sistemeve ndërbankare efikase dhe cilësore për transferim të fondeve dhe të letrave me vlerë**, që nënkupton avancimin e mëtejshëm të sistemit depozitar qendror të letrave me vlerë (Central Securities Depository - CSD), platformës elektronike për tregtim (Electronic Trading Platform - ETP), si dhe angazhimin në themelimin e një sistemi bashkëkohor të tregut ndërbankar të parasë dhe tregut të kapitalit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të ligjit përkatës. BQK-ja është institucioni kyç pjesëmarrës dhe rregullativ në sistemin financiar të Republikës së Kosovës dhe ka pavarësi dhe autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Objektivi parësor i BQK është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Në funksion të këtij objekti, për sa i përket fushës së shërbimeve financiare, janë themeluar departamentet përkatëse të mbikëqyrjes së institucioneve financiare, përfshirë mbikëqyrjen e bankave, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale dhe institucioneve tjera financiare jobankare.

Veprimtaria e BQK-së sigurohet nga organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj. Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Bordi i Bankës Qendrore do të përbëhet nga Guvernatori, dhe dhe tre (3) anëtarë joekzekutivë, të cilët do të ngarkohen me detyrën e miratimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrativit dhe të aktiviteteve të Bankës Qendrore. Anëtarët jo-ekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore nuk do të jenë anëtarë të personelit të Bankës Qendrore. BQK gjithashtu është mbikëqyrëse e aktiviteteve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Aktivitetin e përgjithshëm të FKPK-së e rregullon Kuvendi i Kosovës, ndërsa e mbikëqyrë Banka Qendrore e Kosovës (BQK). FKPK është krijuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, që nënkupton se secili kontribuues kursen për pension në një llogari personale. FKPK është institucion i themeluar në dhjetor të vitit 2001 dhe ka filluar aktivitetin në gusht të vitit 2002 për të administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë.

Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë ia jep FKPK-së, përmes Bordit Drejtues, kompetencat dhe të drejtat e administruesit të besuar për fondet pensionale (Neni 5.1), dhe i përcakton atij të drejtat lidhur me fondet pensionale (Neni 5.2). FKPK e ka zyrën e saj kryesore dhe të vetme në Prishtinë, kurse shërbime për kontribuuesit dhe përfituesit e kursimeve për pension kryhen edhe në gjashtë qendrat e tjera të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në: Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan. FKPK udhëhiqet nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga: pesë anëtarë profesionalë me përvojë së paku 10 vjeçare në lëmin e pensioneve; dy anëtarë përfaqësues, njëri i punëdhënësve dhe tjetri i të punësuarve; një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës. Të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Kosovës me mandat 3-vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes. Nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë ditë.

Byroja Kosovare e Sigurimit është themeluar me 07.09.2011 nga 10 kompanitë e sigurimit të licencuara për të operuar në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Byroja Kosovare e Sigurimit është organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Qeveria e Republikës së Kosovës e njeh statusin e Byrosë Nacionale të Sigurimit me të drejta të pakufizuara, në cilësi të byrosë paguese dhe byrosë trajtuese, që garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve nga sistemi i kartonit ndërkombëtarë të sigurimit. Byroja financohet nga anëtarët e saj dhe veprimtaria e së cilës mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës. Në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit funksionon Fondi i Kompenzimit, Sigurimi Kufitar, Qendra Informativë e Sigurimit dhe Kartoni i Gjelbër.

Krahas realizimit të një mbikëqyrje të kujdesshme, të vazhdueshme dhe të pavarur ndaj të gjitha institucioneve financiare të licencuara nga BQK, departamentet përkatëse të mbikëqyrjes së institucioneve financiare kanë për qëllim zhvillimin e sigurt të veprimtarive financiare, si atyre bankare, sigurimeve dhe pensioneve, si dhe krijimin e kushteve për realizimin e shëndosh të procesit të ndërmjetësimit financiar në Republikën e Kosovës, për zhvillimin e sektorit financiar dhe rrjedhimisht zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Në zbatim të Planit Strategjik 2015-2019, BQK ndër të tjera synon:

- Zhvillimin e funksioneve mbikëqyrëse në pajtim me praktikat dhe standardet bashkëkohore;
- Zhvillimin e sistemeve bashkëkohore ndër-bankare në Republikën e Kosovës;
- Nxitjen e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës; dhe
- Kontributin në proceset për integrim në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera ndërkombëtare.

Masat Ligjore Afatshkurta për Përafrimin e Legjislacionit 2016

Sa i përket sektorit Bankar janë paraparë:

- Miratimi i rregullores për njohjen e agjencioneve për vleresime të jashtme kreditore;
- Miratimi i rregullores për menaxhimin e rrezikut të normave të interesit në librat e bankës;
- Miratimi i plotësimit të rregullores për ekspozimet e mëdha;
- Miratimin e plotësimit të rregullores për menaxhimin e rrezikut kreditor;
- Plotësimi i rregullores për mbështjetjen emërgjente me likuiditet.

Këto rregullore janë paraparë si masa ligjore afatshkurta në funksion të përafrimit të legjislacionit me CRD IV dhe CRR. Disa nga këto masa ligjore janë të paraqitura si prioritete edhe në raportin e progresit për Kosovën të vitit 2014, si dhe janë pjesë e veprimeve të dala nga DPSA. Një ndër të cilat është edhe miratimi i Ligjit për institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, i cili aktualisht është në shqyrtim nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa.

Sa i përket sektorit të sigurimeve janë paraparë:

- Nxjerrja e rregullores për Solvencën I;
- Amandamentimi i rregullores për raportimin e siguruesve;
- Amandamentimi i rregulloreve që kanë të bëjnë me licencimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve.

Gjatë hartimit të ndryshimeve të rregullativës për licencim të siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime do të merren për bazë parimet e përcaktuara me Direktivat Evropiane (2009/138 EC dhe 2002/92/KE) që kanë të bëjnë veçanërisht me përshtatshmërinë e aksionareve, anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë dhe verifikimin e prejardhjes së kapitalit aksionar.

Sa i përket sektorit të pensioneve janë paraparë:

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Fondet Pensionale, BQK në vazhdimësi është angazhuar në hartimin e kornizës rregullative konform kërkesave të këtij ligji dhe parashikohet që në periudhën afatshkurtër edhe disa nga rregullat do të amandamentohen me qëllim që të harmonizohen kërkesat e Ligjit dhe *acquis* të BE-se për fushën e pensioneve. Gjate vitit 2016 janë parapar qe te amandamentohen këto rregullore:

- Rregullorja mbi Mjetet e Pensioneve dhe Vlersimi i Mjeteve të Pensioneve
- Rregullorja mbi Kujdestarin e Mjeteve të Pensioneve
- Rregullorja mbi Investimet e Mjeteve të Pensioneve
- Rregullorja mbi Vlerën e Kontributeve të Pensionit.

Prioritetet ligjore afatmesme për Përafrimin e Legjislacionit 2017-2020: Sa i përket sektorit Bankar janë paraparë:

- Plotësimi i rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit në mënyrë që të adaptoj kërkesat për definicionin e kapitalit sipas Basel III, të harmonizoj plotësisht peshimet me rrezik ndaj rrezikut kreditor sipas qasjen së standardizuar, të adaptoj kërkesat e kapitalit ndaj rrezikut të tregut, si dhe të njohë faktorët mitigues të rrezikut kreditor në pajtim me qasjen e standardizuar;
- Adaptimi i standardeve të Shtyllës së II dhe Shtyllës së III të Kornizës së Basel-it për Kapital;
- Adaptimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe raportit të leverazhit bazuar në standardet e reja të njohura si Bassel III.

Këto standarde janë pjesë e Direktivës 2013/36/BE dhe Rregullores (BE) nr. 575/2013 të BE-së, të njohura si CRD IV dhe CRR, pra pjesë e *acquis* të BE-së dhe janë paraparë të adaptohen për përafrimin e plotë të legjislacionit sa i përket fushës së mbikëqyrjes së bankave në kuadër të përmbushjes së plotë e

kërkesave të parapara me MSA, përkatësisht nenit 96 dhe aneksit 6 të saj, sa i përket shërbimeve financiare.

Sa i përket sektorit të sigurimeve janë paraparë:

Në planin afatmesëm do të punohet në përafrimin e mëtutjeshëm të rregullatives së sigurimeve në Kosovë me direktivat përkatëse evropiane. Rregullativa ekzistuese do të nenshtrohet ndryshimeve/amandamentimeve për ta zbatuar Draft Ligjin për Sigurime që pritet të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2016.

Sa i përket sektorit të pensioneve janë paraparë, në planin afat mesëm e gjithë korniza rregullative e BQK-se në fushën e pensioneve do të amandamentohet konform kërkesave të Ligjit për Fondet Pensionale dhe acquis të BE-së për fushën e pensioneve.

Masat zbatuese Afashkurta 2016 – sa i përket sektorit Bankar janë paraparë:

- **Avancimi i kornizës raportuese për banka, IMF dhe IFJB**

Në mars të vitit 2015 ka filluar procesi i ndërtimit të softuerit për raportimin e institucioneve financiare në BQK "Off-Site Regulatory Reporting Software (ORSS)", i cili projekt është mbështetur nga Banka Botërore. Projekti pritet të përfundoj brenda gjashtë muajve dhe përfshinë edhe trajnimin e stafit të BQK-së, bankave, kompanive të sigurimit, Fondëve Pensionale, IMF-ve dhe IFJB-ve për përdorimin e softuerit për raportim në BQK. BQK ka krijuar kornizën e re raportuese (format e reja të raportimit) të përshtatura në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) në kohë reale dhe web based, dhe në harmoni me kërkesat rregullative ku përfshihet edhe manualët e raportimit. Korniza e re raportuese pritet të implementohet në pajtim me fazat e progresit të ndërtimit të softuerit, dhe në janar 2016 do të kalohet në raportim të plotë me softuare-in e ri. Kjo do të i ndihmojë BQK-se që të avancoj analizat e brendshme me mekanizma të hershëm të paralajmërimit që do të ndikoj në mbikqyrjen më adekuate të të gjitha Institucioneve Financiare të mbikqyrura nga BQK-ja.

- **Plotësimi i Manualit për Likuidimin e Bankave**

Në funksion të përgatitjes së procedurave të nevojshme operacionale për zbatimin e kërkesave të Ligjit për Banka për zgjidhjen e bankave me probleme, përfshirë administrimin dhe likuidimin e bankave, BQK planifikon që gjatë vitit 2016 të finalizoj edhe plotësimin e manualit për likuidimin e bankave, për të qartësuar veprimet operacionale përmes caktimit të personave përgjegjës dhe definimit të procedurave në rast të krizave që mund të rrjedhin nga bankat me probleme.

Sa i përket **Fondit të Sigurimit të Depozitave**, në vijim janë paraqitur qëllimet strategjike të FSDK-së për vitin 2016:

- Aktivitetet të planifikuara për 2016: Implementimi i Sistemit për Kompensimin e Depozitoreve (Softëare) dhe simulimi me bankat anëtare për testimin gatishmërisë së plotë operacionale në rast të ngjarjes së siguar.
- Aktivitet të planifikuara për 2016: Avancimi i kornizës së bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me BQK në fushat e nevojshme për përmbushjen e mandatit të institucionit: 1) Rishikimi i korniza aktuale të bashkëpunimit dhe zhvillimi i kornizës së re të bashkëpunimit; 2) Plotësimet dhe ndryshimet teknike në memorandumun e mirëkuptimit me BQK-në për përfshirjen e fusha të tjera të bashkëpunimit; 3) Krijimi i një programi vjetor të ekzaminimit "onsite" (mbi temat për sigurimin të depozitave); 4) Finalizimi i plan kontigjent në përputhje me rekomandimet e misionit për asistencë teknike të FMN-së
- Aktivitet të planifikuara për 2016: Implementimi i dispozitave të Rregullës së FSDK-së për informimin e klientëve të anëtarëve: Më 01.01. 2016, limiti i sigurimit të depozitave do të ngritet nga 3,000 euro në 4,000 euro; FSDK do të furnozojë bankat me fletëpalosje me informata bazë për depozitorët.
- Aktivitet të planifikuara për 2016: Studimi i Direktivës 2014/49 /BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit mbi skemat e garantimit të depozitave³⁵ dhe Udhëzimet teknike të Autoritetit Bankar

³⁵ Directive 2014/49/EU of the European Parliament and of the Council of 16 April 2014 on deposit guarantee schemes, OJ L 173, 12.6.2014.

European (EBA) mbi metodat për llogaritjen e kontributeve të SGD. Zhvillimi koncept dokumentit për avancimin e metodologjisë për diferencim të riskut të bazuar Udhëzimet teknike të EBA. Diskutimi me akterët kryesor dhe palët e interesit të koncept dokumentit në vitin 2017 dhe implementimi i sistemi të ri të premieeve sipas Udhëzimet teknike të EBA në vitin 2018

Sa i përket sektorit të sigurimeve janë paraparë:

- **Aplikimi i Mbikëqyrjes së Siguruesve Bazuar në rrezik.**

Me qëllim të aplikimit të një mbikëqyrjes efektive të siguruesve me qasje proaktive gjatë ekzaminimit të siguruesve është përgaditur draft manuali për mbikëqyrjen On-Site me anë të cilit BQK do të aplikoj qasjen e mbikëqyrjes të bazuar në rrezik. Draft manuali i mbikëqyrjes On-Site paraqet një qasje të re të mbikëqyrjes së siguruesve me fokusim kryesor në rreziqet më të mëdha ndaj të cilave ekspozohen siguruesit, mbulesat risiguruese etj. Si pjesë e procedurave të ekzaminimit, manuali përfshin: pjesën para ekzaminimit, gjatë ekzaminimit dhe pas ekzaminimit.

- **Avancimi i kornizës raportuese për Siguruesit**

Me 16 mars 2015 ka filluar procesi i ndërtimit të softuerit për raportimin e siguruesve në BQK – “**Off-Site Regulatory Reporting Software (ORSS)**”, i cili projekt është mbështetur nga Banka Botërore.

Fillimisht, BQK në bashkëpunim me kompaninë PricewaterhouseCoopers ka krijuar kornizën e re raportuese (format e reja të raportimit) të përshtatura në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe në harmoni me kërkesat rregullative ku përfshihet edhe manuali e raportimit.

Korniza e re raportuese pritet të implementohet në pajtim me fazat e progresit të ndërtimit të softuerit. Në këtë fazë nga siguruesit është kërkuar që menjëherë të fillojnë përgatitjet duke përshtatur softuerët e tyre në drejtim të gjenerimit të informatave karshi formave të reja të raportimit.

Sa i përket sektorit të pensioneve janë paraparë:

- **Manuali për Mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale**

Me qëllim të avancimit të mbikëqyrjes së Fondeve Pensionale dhe në mënyrë që të ngritjes së efikasitetit në aktivitetet e mbikëqyrjes së pensioneve është përgaditur draft manuali për mbikëqyrjen e fondeve pensionale. Ky Draft Manual paraqet një qasje të re të mbikëqyrjes së fondeve pensionale me fokusim kryesor në rreziqet e mëdha ndaj të cilave ekspozohen fondet pensionale, duke orientuar resurset njerzore dhe kohën. Draft manuali i mbikëqyrjes On-Site, si objektivi kryesor i mbikëqyrjes pensionale është për të garantuar sigurinë e fondeve të grumbulluara në llogaritë pensionale dhe të garantojë përputhshmërinë e aktiviteteve të fondeve pensionale me ligjet që rregullojnë veprimtaritë pensionale. Në manual përfshihen të gjithë fazat procedurale të ekzaminimit siç janë: periudha para përgatitore e ekzaminimit, gjatë ekzaminimit, si dhe faza përfundimtare Raporti final. Draft manuali pritet të implementohet gjatë vitit 2016.

- **Softueri i Raportimit të Institucioneve Financiare**

Me 16 mars 2015 ka filluar procesi i ndërtimit të softuerit për raportimin e fondeve pensionale në BQK “**Off-Site Regulatory Reporting Software (ORSS)**”, i cili projekt është mbështetur nga Banka Botërore. Projekti pritet të përfundoj brenda vitit 2016, i cili përfshinë edhe trajnimin e stafit të BQK-së, dhe fondeve pensionale për përdorimin e softuerit për raportim në BQK.

Prioritetet zbatuese afatmesme

Sa i përket sektorit Bankar janë paraparë:

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të mbikëqyrjes së bankave në aplikimin e standardeve të Kornizës së Basel-it për Kapital (Basel Capital Framework) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS);
- Trajnimin e stafit në fushën e mbikëqyrjes së konsoliduar;
- Analizimin dhe adaptimin e praktikave më të mira të vendeve të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit;

- Ngritjen e kapaciteteve për administrimin e situatave emergjente në rast të krizave dhe zgjidhjen e bankave me probleme;
- Themelimin e një programi periodik të testimit, të njohur si “stres testing” dhe adaptimi i një sistemi të paralajmërimit të hershëm.

Sa i përket Fondit të Sigurimit të Depozitave, në vijim janë paraqitur qëllimet strategjike të FSDK-së për vitin 2015-2017:

- Rritja e kapaciteteve organizative dhe teknike për të arritur përgatitje dhe gatishmëri të plotë operacionale për përmbushje efektive të mandatit për sigurim të depozitave – Parashih zhvillimin dhe implementimin e Sistemit për Kompenzimin e Depozitave që do të mundësojë kompensim të shpejtë dhe të saktë të depozitave të siguruar. Dorezimi i të dhënave për përcaktimin e depozitave të siguruar nga bankat anëtare të FSDK do të përcaktohet me rregulle që pritet të hartohet dhe të konsullohet në vitin 2016.
- Avancimi i bashkëpunimit me partneret e rrjetit të sigurisë, anëtarët dhe përforcimi i bashkëpunimit me partnerët në sektorin financiar – Kryesisht parashih avancimin e kornizës bashkëpunuese me BQK-ne dhe akterëve të tjerë në fushat e përbashkëta për të plotësuar mandatin në mënyrë më të mirë.
- Rritja e vetëdijes publike përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe efektiv - DGDS Evropiane parashtron kërkesën teknike ashtu që emri i institucionit dhe niveli i mbulesës të përfshihen në deklaratën e xhirollogarisë së depozitorit për klientët ekzistues, kurse konsumatorëve të rinj u jepet letra e cila nënshkruhet si pranim dhe konfirmim. Të gjitha këto kërkesa ndaj bankave është e rregulluar me Rregullën e Informimit të klientëve e cila është në fuqi.
- Avancimi i sistemit diferencial të premive dhe të raportimit nga bankat anëtare - Sipas LSD ligj FSDK zbaton sistemin e diferencues të premium e cila mundëson që të vlerësojë ekspozimin e rrishtit ndaj FSD dhe që bazohet në vlerësim ekzaminues të BQK-së. Direktiva Evropiane dhe Udhëzimet teknike të EBA do të merren si baze e avancimit të sistemit të premiumit differences.
- Arritja e pajtueshmërisë së plotë me parimet themelore - Në maj të vitin 2015 FSDK ka kryer vlerësim në përputhshmëri me Parimet Themelore të rishikuara në bashkëpunim me IADI dhe është në pritje të pranimin të raportit përfundimtar. Rekomandimet e dala nga vlerësimi do të merren për baze në avancimin e metutjeshëm të legjislacionit sekondar mbi sigurimin e depozitave.

Sa i përket sektorit të sigurimeve janë paraparë:

- **Plotësimi i Manualit të Mbikëqyrjes Off-site** - Në periudhën afatmesme do të rishikohet manuali i mbikëqyrjes off-site i cili manual ka për qëllim mbikëqyrjen më të përafërt të sigurueseve dhe risigurueseve përmes raportimit dhe monitorimit, posaqërisht përmes testeve të paralajmërimit të hershëm (Early Warning Test – EWT);
- **Fuqizimi i resurseve në fushën e Solvencës** – Trajnimin dhe kualifikimin e stafit të mbikëqyrjes së sigurimeve në aplikimin e standardeve të Solvencës I;
- **Stres-test** - Krijimin programit dhe skenarion për testimin e sigurueseve të njohur si programi i “stres testing”.

Sa i përket sektorit të pensioneve janë paraparë:

Në funksion të përmbushjes së detyrave të saj dhe për implementimin efektiv të planit strategjik dhe përgjegjësi të dala nga MSA për sa i përket përafrimit të legjislacionit me Direktivat e BE-së në fushën e mbikëqyrjes së sigurueseve, BQK planifikon të vazhdojë me:

- Trajnimin dhe kualifikimin e stafit të mbikëqyrjes së pensioneve në aplikimin e standardeve dhe parimeve baze të IOPS;
- Trajnimin e stafit në fushën e mbikëqyrjes së konsoliduar të pensioneve;
- Analizimin dhe adaptimin e praktikave më të mira të vendeve të BE-së në fushën e mbrojtjes së pjesëmarrësve dhe përfituesve në/nga fondet pensionale.
- Ngritjen e kapaciteteve për administrimin e situatave emergjente në rast të krizave dhe zgjidhjen e fondeve pensionale.

3.11. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull mbulon Komunikimet Elektronike, shërbimet e Shoqërisë së Informacionit, dhe politikat audio-vizuele përmes të cilave rregulloret Evropiane e promovojnë dhe inkurajojnë konkurrencën, zhvillimin dhe qasjen më të gjerë të shërbimeve bashkëkohore dhe teknologjive të reja, me theks të veçantë në interesat e shfrytëzuesve të fundëm.

Në fushën e komunikimeve elektronike *acquis* e BE-së ka për qëllim të eliminojë pengesat për operimin efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, promovimin e konkurrencës dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në sektor, duke përfshirë disponueshmërinë e shërbimeve moderne universale. Çështjet kryesore të cilat do të mbulojnë në fushën e komunikimeve elektronike janë: qasja brezgjere, standardizimi, interkoneksioni, tregu dhe analizat e tregut, shërbimet universale dhe të drejtat e përdoruesve, çështjet e privatësisë, dixhitalizimi, dhe spektri frekuencor. Çështjet kryesore në fushën e shërbimeve për shoqëri të informacionit janë: siguria e informacionit, e-geverisja, e-shëndetësia, e-nënshkrimi, e-tregëtia dhe sektori publik. Çështjet kryesore në politikat audio-vizuele janë: shërbimet mediale audio-vizuele, shërbimet publike për radio emetim, mbrojtja e të miturve, trashëgimia filmike, dhe diversiteti kulturor.

Kërkesat e MSA-së

Nenet relevante të MSA janë Kapitulli VIII, përkatësisht neni 111 që ka të bëjë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, neni 110 mbi Shoqërinë e Informacionit si dhe neni 109 – mbi bashkëpunimi në fushën audio-vizuele. Neni 111 ka të bëjë me forcimin e bashkëpunimit në fushat e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Kosova të legjislacionit të BE-së në sektor pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurimit dhe forcimit të pavarësisë së autoriteteve rregullatorë relevante.

Neni 110 ka të bëjë me bashkëpunimin në fushën e shoqërisë e informacionit që mbështet kryesisht përafrimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së. Objektivat globale do të jenë në përgatitjen e shoqërisë në tërësi për epokën digjitale, si dhe identifikimin e masave për të siguruar interoperabilitetin e rrjeteve dhe shërbimeve. Neni 109 ka të bëjë me bashkëpunimin dhe nxitjen e industrisë audio-vizuele në Evropë, dhe përkrahjen e bashkëprodhimit në fushat e kinemasë dhe mediave audio-vizuele duke përfshirë ndër të tjera, programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve në industrinë e mediave audio-vizuele. Ky nen gjithashtu adreson asistencën teknike për mediat publike dhe private të Kosovës, me qëllim të forcimit të pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropiane, përafrimin e politikave mbi rregullimin e përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të BE-së, harmonizimin e legjislacionit dhe përvetësimin të së drejtës së autorit si dhe fuqizimin e pavarësisë së autoriteteve rregullatorë përkatëse.

Kërkesat nga Raporti i KE-së për Kosovën

Në kontekst të kërkesave të dala nga RP në fushën e komunikimeve elektronike, shoqërisë së informacionit dhe politikave audio-vizuale, kërkohet që Kosova të vazhdojë përpjekjet për të perafaruar dhe kompletuar kornizën ligjore në drejtim të harmonizimit me *acquis* e BE-së. vazhdon të sfide mbete që Kosova akoma nuk e ka siguruar kodin e vet shtetëror dhe vazhdon të përdor tre kode të ndryshme për telefoninë fikse dhe mobile. Në përgjithësi, nga RP. Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe institucionale, RK rekomandon që të forcohet pavarësia dhe kapaciteti i rregullatorit të telekomunikacionit (ARKEP-it) dhe të medias (KPM-së). Ndërkaq si çështje urgjente të dala nga RK dhe që kërkojnë vëmendjen e institucioneve të Kosove janë ndërmarrja e hapave konkret në drejtim të kalimit nga transmetimi analog në transmetim digjitale, si dhe gjetja e një zgjidhje afatgjatë për qëndrueshëm për financimin e transmetuesit publik, RTK-në.

Kërkesat nga DPSA

Ndërkaq, bazuar në kërkesat e dala të DPSA-së në fushën e komunikimeve elektronike, shoqërisë së informacionit dhe politikave audio-vizuale është paraparë që të behet plotësimi i kornizës ligjore dhe strategjike. Në këtë kontekst, kërkohet që Ligji për Komunikimet Elektronike të plotësohet tutje me legjislacion sekondar, harmonizimi i mëtejme i legjislacionit në fushën e politikave audio-vizuale me Direktivën e Shërbimeve Audio-Vizuele (AVMSD), si dh të miratohet dhe sigurohet zbatimi efikas i Strategjisë për digjitalizim. Për më tepër, kërkesë e DPSA-së është të sigurohet që kanali i RTK-së në gjuhën serbe të emetohet jashtë platformës kablllore me fillimin e transmetimit digjital tokësor nga RTK.

Po ashtu, kërkohet që të shqyrtohen mundësitë për të zhvilluar statistika kompatible me Eurostat-in në fushën e TIK-ut dhe të shoqërisë së informacionit. Gjithashtu, ndër kërkesat e tjera nga DPSA janë edhe krijimi i Komitetit Koordinues për sektorin e TIK nën Këshillin e Zhvillimit Ekonomik; miratimi i Strategjisë së Kosovës për Teknologji Informativë (Kosovo IT Strategy); vazhdimi i implementimit të mekanizmave mbrojtës të konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike; raportimi i numrit të vendimeve të marra për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ndërkaq në kontekst të ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe profesionale, rekomandohet që të sigurohet staf i mjaftueshëm në Ekipin për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike (CERT), të vazhdohet forcimi i kapaciteteve administrative në fushën e shoqërisë së informacionit dhe politikave të agjendës digjitale, si dhe të sigurohet bashkëpunim efektiv ndërmjet organeve qeveritare relevante në TIK (MZHE, MAP, ARKEP).

Komunikimet Elektronike

Korniza legislative dhe ajo e politikave

Sa i përket përafrimit dhe harmonizimit të kornizës ligjore primare në sektorin e komunikimeve elektronike me acquis të BE-së, është miratuar Ligji për Komunikimet Elektronike i cili ka për qëllim rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme për qytetarët. Për më tepër ky ligj transpozon pjesërisht Direktivën 2002/21/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/140/KE; Direktivën 2002/19/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/140/KE; Direktivën 2002/20/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/140/KE; Direktivën 2002/22/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/136/KE; Direktivën e Komisionit 2002/77/KE; Direktivën 2002/58/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/136/KE në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privacitetit; Direktivën 2009/136/KE; Direktivën 2009/140/KE; Direktivën 1999/5/KE; Rekomandimin e KE-së 2003/311/KE; Rekomandimin e KE-së 2007/879/KE; Rekomandimin e KE-së 98/322/KE; Rekomandimin e KE-së 2005/698/KE; Vendimin e KE-së për klasifikimin e radio pajisjeve dhe pajisjeve terminale 200/299/KE.

Ndërkaq sa i përket kompletimit dhe përafrimit të kornizës ligjore sekondare me acquis-n e BE-së, ARKEP ka miratuar rregulloret të cilat transpozojnë plotësisht direktivat e BE-së, si në vijim:

- Rregullorja për Ndarjen e Llogarive (012/B/14 01 prill 2014) (Direktivën 2002/19/KE- Direktiva mbi Qasjen); Rekomandimin e KE-së 98/322/KE mbi interkoneksionin në tregun e liberalizuar të telekomunikimeve (Pjesa 2 - Ndarja e llogarive dhe llogaritja e kostos), dhe Rekomandimi i Komisionit Evropian 2005/698/KE mbi ndarjen e llogarive dhe Sistemet e Llogaritjes së kostos sipas Kornizës Rregullatore për Komunikime Elektronike;
- Rregullorja për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave (Vendimi nr. 376/2002/KE);
- Rregulloret për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike (043/B/13 09 Dhjetor 2013) ((Direktivën 2002/22/KE mbi Shërbimet Universale; Direktivën 2009/136/KE (Aneksi III);
- Rregullorja teknike për radio pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese dhe kompatibilitetin elektromagnetik (Njohja e Konformitetit) (Direktivën 2002/22/KE mbi Shërbimet Universale; Direktivën 2009/136/KE (Aneksi III);
- Rregullorja mbi Pagesat për shfrytëzimin e radio frekuencave (Vendimi nr. 376/2002/KE)
- Rregullorja për llogaritje të kostos sipas metodës së shpërndarjes së plotë kostos (FDC) (043/B/12 22 qershor 2012) (Direktivën 2002/19/KE (Direktiva mbi Qasjen); Rekomandimin e Komisionit Evropian 98/322/KE t mbi interkoneksionin në tregun e liberalizuar të telekomunikimeve (Pjesa 2 - Ndarja e llogarive dhe llogaritja e kostos), dhe Rekomandimi i Komisionit Evropian 2005/698/KE mbi Ndarjen e llogarive dhe Sistemet e Llogaritjes së kostos sipas Kornizës Rregullatore për Komunikime Elektronike;
- Rregullorja për të drejtën e shtegut dhe shfrytëzimin e përbashkët të Infrastrukturës (Direktivës 2002/21/KE të Parlamentit dhe Këshillit evropian të datës 07/03/2002 për krijimin e një kornize të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), të ndryshuar me Direktivën nr. 2009/140/KE, të datës 25/11/2009);
- Rregullorja për Interkoneksionin (033/B/11 3 qershor 2011 (Direktivës 2002/21/KE të Parlamentit dhe Këshillit evropian të datës 07/03/2002 për krijimin e një kornize të përbashkët

për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), të ndryshuar me Direktivën nr. 2009/140/KE, të datës 25/11/2009);

- Rregullorja për bashkë-shfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të lakut dhe nën-lakut lokal (024/B/11 18 prill 2011) (Direktivës 2002/21/KE të Parlamentit dhe Këshillit evropian të datës 07/03/2002 për krijimin e një kornize të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), të ndryshuar me Direktivën nr. 2009/140/KE, të datës 25/11/2009); dhe
- Rregullorja për Sigurimin e Qasjes (012/B/11 11 shkurt 2011) (Direktivës 2002/21/KE të Parlamentit dhe Këshillit evropian të datës 07/03/2002 për krijimin e një kornize të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), të ndryshuar me Direktivën nr. 2009/140/KE, të datës 25/11/2009).

Në anën tjetër, sa i përket rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në fushën e *komunikimeve elektronike*, rol kyç ka Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) e cila propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit; harton dhe miraton politika dhe strategji; monitoron dhe harton raporte të rregullta periodike mbi zbatimin e dokumenteve strategjive për sektorin e postës, komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit. Po ashtu, MZhE identifikon, propozon dhe përcakton standarde për teknologjinë informative në nivel kombëtar. Në sektorin e komunikimeve elektronike shqyrton pajtueshmërinë me standardet evropiane që përfshijnë tarifatat dhe taksat, cilësinë e shërbimeve dhe të standardeve teknike; krijon politikën e punës për promovimin e konkurrencës dhe shqyrton nevojat e konsumatorëve.

Ndërkaq, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është autoritet rregullator kombëtar në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe atyre postare, kryen detyrat e përcaktuara nga legjislacioni tjetër në fuqi, miraton legjislacionin sekondar, si dhe zbaton politikatat dhe strategjitë kombëtare të sektorit të komunikimeve elektronike dhe atyre postare. Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bëhet duke u bazuar në parimet e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të burimeve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, dhe proporcionalitetit. ARKEP siguron konkurrencë efektive, mbrojtje të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kritereve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mos-diskriminim.

Masat afatshkurtra

Në kontekst të plotësimit të kornizës strategjike me dokumente që kanë të bëjnë me implementimin e legjislacionit të BE-së në fushën e komunikimeve elektronike, MZhE ka miratuar strategjinë për Politikatat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike- Agjenda Digjitale për Kosovën 2013 - 2020, e cila është në përputhje me Agjendën Digjitale të BE 2020 dhe ka qëllim përcaktimin e prioriteteve, objektivat dhe detyrat e zhvillimit të TIK-ut për t'i maksimizuar përparësitë sociale dhe ekonomike që i ofrojnë ato teknologji, kryesisht interneti, si instrument shumë i rëndësishëm për aktivitete ekonomike dhe sociale, shfrytëzimi i të cilit mundëson ofrimin apo pranimin e shërbimeve, punëve, qasje në argëtim, komunikim dhe shprehje të lirë të mendimeve. Ky dokument transpozon Komunikatën e Komisionit (COM (2010) 245/final2) të datës 26/08/2010 "Afhenda Digjitale për Evropën". Në këtë drejtim, ARKEP ka miratuar planin afatmesëm 2015- 2017 i cili ka për qëllim adresimin e objektivave rregullatore të parapara me kornizën rregullatore (Legjislacioni primar dhe sekondar).

Ndërkaq, sa i përket legjislacionit sekondar, MZhE dhe ARKEP planifikojnë që të gjitha rregulloret dhe udhëzimet Administrative për implementimin e Ligjit për Komunikime Elektronike të finalizohen deri në fund të vitit 2016, përkatësisht të miratojnë UA dhe rregulloret si në vijim:

- UA për kushtet që duhet ti plotësojnë ofruesit e shërbimeve të tregtisë elektronike;
- Përgatitja dhe miratimi i rregullores për net neutralitet;
- Përgatitja dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e kërkesave minimale për kualitet të shërbimeve (USO);
- Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores për Planin Kombëtar të Numeracionit (e cila do të bëhet pas marrjes së kodit shtetëror telefonik);
- Përgatitja dhe miratimi i Rregullores për Bartshmërinë e Numrave; dhe
- Përgatitja dhe miratimi i rregullores për kodin e internetit ccTLD.

Si masa zbatuese në kuadër të ngritjes së kapaciteteve teknike dhe profesionale në fushën e *komunikimeve elektronike*, gjatë vitit 2016, planifikohet forcimi i kapaciteteve përmes trajnimeve të avancuara në fushat si në vijim: në fushat e zhvillimit të infrastrukturës brezgjërë, si dhe në çështjen e analizës dhe rregullimit të tregut, menaxhimit të resurseve të kufizuara frekuencore dhe numerike. Po ashtu, duhet të forcohet pavarësia dhe kapaciteti i ARKEP-it nga ndërhyrja e qeverisë, si dhe sifde mbeten pagat e ulëta dhe buxhetit.

Në anën tjetër, sa i përket mbështetjes dhe fondeve të siguruara nga donatore e jashtëm për implementimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e komunikimeve elektronike, janë ndarë fonde nga Banka Botërore për implementimin e dy projekteve në vlerë si më poshtë:

- Bashkë-shfrytëzimi efikas i resurseve të Infrastrukturës telekomunikuese (Facilitation of Efficient Infrastructure Sharing for Kosovo) – 275,000 \$;
- Programi për infrastrukturën brez-gjërë në zonat rurale (Rural Broadband Program) – 475,000 \$.

Prioritetet afatmesme

Ndërkaq, në periudhën 2017-2020 fokusi kryesor do të jetë zbatimi i objektivave të specifikuar në Agjendën Digjitale të Kosovës për ofrimin e shërbimeve brezgjëra, siguria e rrjetave dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Nxitja e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike brezgjërë, për të ngritur efikasitetin e rregullimit të tregut dhe për të bërë përpjekje që të gjithë banorëve të Kosovës të u sigurohet qasje në internet me shpejtësi më të lartë së 30 Mbps deri në vitin 2020.

Për më tepër, ARKEP do të implementoj projektin për ngritjen e stacioneve fikse monitoruese të spektrit radio frekuencor në nivel nacional, projektin për monitorimin e parametrave të kualitetit të qasjes në internet; si dhe projektin për qasjen on-line në databazen e ARKEP për krahasimin e tarifave në mes ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Sipas KASH-it 2016 – 2018-të, buxheti i përgjithshëm i planifikuar për ARKEP është ndjeshëm më i ultë se sa ai i planifikuar dhe miratuar nga Bordi i ARKEP, që në fakt e pamundëson realizimin e prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara sipas dokumenteve dhe politikave të sektorit. Megjithatë, ARKEP pret që me rishikimin vjetor të KASH-it për vitet në vijim të përfshihen aktivitetet e prioritetizuara në përputhje me objektivat me Agjendën Digjitale dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Po ashtu, pritet të ndërmerren hapa konkret nga institucionet e Kosovës për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare të telekomunikacionit duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me çështjet postale. Buxheti për realizimin e aktiviteteve do të planifikohet sipas KASH-it duke përfshirë edhe asistencën nga donatorët.

Shoqëria e Informacionit

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Sa i përket harmonizimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së në fushën e shoqërisë së informacionit, Kosova ka arritur me sukses të hartoj legjislacion të konsiderueshëm që është në përputhje me kornizën rregullative të BE-së. Për më tepër, korniza ligjore primare konsiston në:

- Ligjin për Shërbimet e Shoqërisë Informatike i cili përcakton dokumentacionin në formë elektronike juridikisht të barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në format të letrës, për të lehtësuar shërbimet elektronike që përfshijnë, por që nuk kufizohen në shitblerje që bëjnë konsumatorët nëpërmjet Internetit (eTregtia), shërbimet elektronike bankare dhe ato financiare (ePagesa), ofrimin e shërbimeve qeveritare (eQeverisja), blerjen në formë elektronike nga ndërmarrjet (eProkurimi) dhe aplikimin e nënshkrimit elektronik. Në kuadër të këtij ligji janë transpozuar Direktiva 1999/93/KE; Direktiva 2000/31/KE; dhe Direktiva 2007/64/KE;
- Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik i cili ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë me masa konkrete, parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike, duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale; dhe

- Ligjin për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit, i cili ka qëllim përcaktimin e organeve përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe kompetencat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e tyre;
- Korniza e Interoperabilitetit të Republikës së Kosovës, ka për qëllim të ofroj sugjerime dhe rekomandime të për ndërveprueshmeri të sistemeve, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të fushës së teknologjisë së informacionit. Për më tepër, kjo kornize është bazuar në Kornizën Europiane të Interoperabilitetit,

Sa i përket rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në fushën e shoqërisë së informacionit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të legjislacionit, politikave, strategjive. Për më tepër, identifikon, propozon dhe përcakton standarde për teknologjinë informative në nivel kombëtar si dhe përkrah teknologjinë informative dhe inovative.

Në anën tjetër, Ministria e Administratës Publike (MAP), përkatësisht Agjencia për Shoqërinë e Informacionit propozon dhe koordinon të gjitha politikat që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës, harton dhe siguron zbatimin e strategjisë së qeverisjes elektronike dhe të planit të veprimit përkatës si dhe implemton një varg aktiviteteve të rëndësishme që ndërlidhen me shoqërinë e informacionit.

Masat afatshkurtra

Në kuadër të aktiviteteve implementuese për vitin 2016 në fushën e shoqërisë së informacionit, MZHE ka planifikuar të fillojë në vitin 2016 me një pilot projekt për të mbledhur të dhënat: Statistika mbi përdorimin e TIK-ut dhe tregtisë elektronike (e-Commerce) nga ndërmarrjet, në bazë të pyetësorëve të standardizuar të Eurostatit.

Ndërkaq, Agjencia për Shoqërinë e Informacionit për vitin 2016 planifikon të miratoj dhe filloj të implementoj Strategjinë për Qeverisje elektronike 2016-2020, e cila ka për qëllim të ofroj orientimet dhe udhëzimet e nevojshme për të lehtësuar menaxhimin efikas dhe të sigurt të aplikimit të Teknologjisë së Informacionit në institucione shtetërore më synim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe arritjen e objektivave zhvillimore. Gjithashtu, është planifikuar zhvillimi i një kornize të sigurisë së informacionit bazuar në standardin ISO – ISMS; zhvillimi i metodologjisë për menaxhimin e projekteve bazuar në standardin PRINCE2; si dhe krijimi i sektorit të CERT-it (computer emergency response team) qeveritar. Standardet e theksuara më lartë, do të realizohen në bashkepunim dhe koordinim me Bankën Botërore.

Ndërkaq, në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale është paraparë krijimi i Komitetit Koordinues për sektorin e TIK nën Këshillin e Zhvillimit Ekonomik dhe miratimi i Strategjisë së Kosovës për Teknologji Informative (Kosovo IT Strategy).

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve teknike dhe profesionale në fushën e shoqërisë së informacionit, planifikohet forcimi i kapaciteteve përmes trajnimeve të avancuara në fushat si në vijim: në fushat e zhvillimit të infrastrukturës brezgjërë, e-Tregtisë (e-commerce), e-Aftësit (e-Skills), si dhe në çështjen e analizës dhe rregullimit të tregut, menaxhimin e resurseve të kufizuara frekuencore dhe numerike.

Prioritetet afatmesme

Sa i përket aktiviteteve të planifikuara për realizimin e prioriteteve afatmesme 2017-2020, në kontekst të hartimit të dokumenteve strategjike, programeve dhe planeve në fushën e shoqërisë së informacionit pritet të miratohen dokumentet si në vijim:

- Hartimin dhe miratimin e Strategjisë Nacionale për Teknologji Informative; dhe
- Hartimi i Strategjisë për Sigurinë Kibernetike.

Në anën tjetër, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit për realizimin e prioriteteve afatmesme 2017-2020 planifikon:

- Fuqizimin e interoperabilitetit të sistemeve elektronike dhe shtimin numrit të sistemeve elektronike ekzistuese që do të ndërliken përmes kësaj platforme;
- Avancimin e portalit ekzistues shtetërorë në portal e-Kosova, me qëllim të rritjes së numrit të shërbimeve elektronike për qytetarët dhe institucionet; dhe
- Realizimin e projektit Qendra e Rimëkëmbjes në Rastet e Fatkeqësive (Disaster Recovery Center).

Përveç plotësimit të kornizës strategjike, në periudhën 2017-2020, fokusi kryesor do të jetë në zbatimin e objektivave të specifikuara në Agjendën Digjitale të Kosovës për ofrimin e shërbimeve brezgjëra si dhe sigurinë e rrjetave dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Buxheti për realizimin e prioritetve afatmese do të planifikohet sipas KASH-it me përkrahje edhe nga donatorët.

Politikat audio-vizuele

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Sa i përket harmonizimit të kornizës vendore legjislative me legjislacionin e BE-së në fushën e politikave audio-vizuele është miratuar ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve i cili ka për qëllim përcaktimin e kompetencave për KPM dhe promovimin e zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale, dhe audio-vizuele. Për më tepër, ky ligj është i përafuar me Direktivën AVMSD 89/552/KEC. Më tej, KPM ka miratuar edhe një serë aktesh nënligjore, të cilat janë të përafuar me direktivën e lartpërmendur (AVMSD):

- KPM 2013/01 - Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio - Vizuele - 2013;
- KPM 2013/02 - Rregullorja për të Drejtën e Autorit - 2013;
- KPM 2013/03 - Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio - Vizuele - 2013;
- KPM 2013/04 - Rregullorja e KPM për dhënie të Licencës - 2013;
- Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM - pjesa e parë - 2013;
- KPM 2014/02 - Rregullorja për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM - 2014;
- KPM 2014/03 - Rregullorja për Nivelin dhe mënyrën e pagesës së Tarifës për Licencë - 2014;
- Rregullorja e distribuimit kabllor të programeve radio televizive në Kosovë - 2007; dhe
- Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuele në Republikën e Kosovës - 2010.

Sa i përket rolit dhe përgjegjësi institucionale në fushën e politikave audio-vizuele, Komisioni i Pavarur për Media është institucion i pavarur i cili është kompetent për rregullim, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. Për më tepër, KPM ka për qëllim të promovoj zhvillimin e një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audio- duke rregulluar të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

Masat afatshkurtra

Në kontekst të planifikimit të akteve legjislative me qëllim të përafritimit të mëtejshëm të kornizës legjislative me legjislacionin e BE-së (AMSD), përkatësisht kalimi nga transmetimi tokësor analog në digjital, KPM planifikon të hartoj dhe miratoj rregulloret si më poshtë:

- Rregullorja për licencim;
- Hartimi i pakos së dokumentacionit për licencim të ofruesve të përmbajtjes;
- Rregullorja për kategorizim të ofruesve të përmbajtjes dhe MUX;
- Hartimi i pakos së dokumentacionit për licencim për operatorin e multipleksit
- Hartimi i rregullores për përcaktimin e kriterëve për rregullën must-carry (bartje e obligueshme);
- Rregullorja për nivelin dhe pagesën e taksës për licencë për ofruesit e përmbajtjeve programore dhe për operatorët e MUX;
- Rregullorja për pronësi të mediave dhe parandalim të koncentrimin të mediave;
- Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve për licencimin e ofruesve të përmbajtjes;
- Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve për licencimin e MUX;
- Rregullorja për përcaktimin e kriterëve për përmbajtjet programore në një Multipleks;
- Rregullorja për krijimin e fondit për stimulim të programeve;
- Rregullorja për Numërimin Logjik të Kanaleve (LNC);

- Rregullorja për Udhëzuesin Elektronik të Programit (EPG) dhe Udhëzuesin Interaktiv të Programit (IPG); dhe
- Rregullorja për definimin e standardeve dhe parametrave për pranues (setupbox) të sinjalit televiziv digjital.

Sa i përket aktiviteteve që kanë të bëjnë me miratimin e dokumente strategjike me qëllim implementimin efektiv të acquis së BE-së në fushën e politikave audio-vizuale KPM ka dërguar në Qeveri për miratim Strategjinë për kalim në transmetim digjital tokësor, e cila do të përcaktoj, në mënyrë të gjithanshme, procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor analog në transmetim tokësor digjital në pajtim të plotë me standardet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-së) dhe të Komisionit Evropian.

Në kontekst të ndërmarrjes sa hapave për ngritje të kapaciteteve teknike dhe profesionale në fushën e politikave audio-vizuale, KPM planifikon që përmes instrumentit të TAIEX-it të përgatitë zyrtarët e saj për sfidat e reja që pritet të sjellë transmetimi digjital. Ndërkaq çështje kryesore mbetet të forcohet pavarësia dhe kapaciteti i KPM-së nga ndërhyrja e Qeverisë, rritja e pagave që për momentin vlerësohet të jenë të ulta, si dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare.

Prioritetet afatmesme

Prioritet kryesor i KPM-se është implementimi i Strategjisë së Digjitalizimit dhe Planit të Veprimit, edhe pse aktualisht në bazë të KASH nuk ka buxhet të caktuar për pjesën e implementimit të digjitalizimit, por pritet që me rishikimin e KASH-ti të përfshihen aktiviteteve të prioritetuara nga KPM për vitet në vijim. Po ashtu, në këtë drejtim pritet një përkrahje e rëndësishme edhe nga donatorët.

3.12. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Kapitulli për bujqësi përfshinë një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumica prej të cilave janë të zbatueshme.

Zbatimi i duhur dhe efektiv i këtyre rregullave si dhe përforsimi dhe kontrolli me efikas nga një administratë pulike janë thelbësore për funksionimin e politikave të Përbashketa Evropiane (PPE). Për funksionimin e PPB kërkohet ngritja e menaxhimit dhe cilësisë së sistemeve të tilla siç janë Agjencioni i Pagesave, Sistemi i Integruar i Kontrollit të Bujqësisë (SIKB) si dhe kapacitetet për të zbatuar masat e zhvillimit rural.

Ky kapitull kërkon që Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat mbështetëse direkte të fermës dhe të zbatojnë organizmin e përbashkët të tregut për produktet e ndryshme bujqësore.

Dëtyrimi për të përafuar legjislacionin e Kosovës në Kapitullin 11 me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 74 dhe 102 të MSA-së. Sipas nenit 102 të MSA-së, bashkëpunimi mes palëve do të zhvillohet në të gjitha fushat prioritare që lidhen me Acquis-në e BE-së. Këto fusha përfshijnë fushën e bujqësisë, skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore, sigurinë ushqimore, fushën e veterinarisë dhe fitosanitarisë. Bashkëpunimi veçanërisht do të synojë modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro industrial në Kosovë, në veçanti për të arritur kushtet sanitare të BE-së. Bashkëpunimi nën MSA gjithashtu synon përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe të zhvillimit rural, menaxhimin e sektorit të pylltarisë në Kosovë dhe mbështetjen graduale në përafrimin e legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me acquis të BE-së.

Kërkesat e dala nga komunikimi me KE përgjatë procesit të Dialogut të Stabilizim Asocimit përfshinë vazhdimin e plotësimit të kornizës ligjore primare dhe sekondare në kuadër të sektorit. Gjatë takimeve të fundita, theks të veçantë iu është kushtuar mbrojtjes së tokës si dhe fuqizimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me autoritet komunale për qartësimin e zbatimit të legjislacionit për shfrytëzimin të tokës, mbrojtjes dhe konsolidimit të sajë. Reduktimi i ndotjes së tokës si dhe themelimi i një sistemi për monitorim të rregullt dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim duhet të merren parasysh. Po ashtu, rritja e

skemës së granteve, rishikimi i sekemës së pagesave (vonesat në rimbursim) dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile janë disa nga kërkesat kryesore që theksohen në takimet e Dialogut të Procesit të Stabilizim Asocimit.

Në Raportin e KE-së për Kosovën 2015, të pika 5.2.2, Komisioni Evropian ka identifikuar disa sfida. Sfidë mbetet mungesa e stafit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) për të siguruar monitorim adekuat dhe procedim të shpejtë të pagesave. Gjithashtu në kuadër të AZhB duhet të themelohet Njësia e Auditimit të Brendshëm. Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të ndaluar ndërrimin ilegal të destinimit të tokës bujqësore, i cili vazhdon të jetë pengesë për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor. Në vitin e ardhshëm Kosova duhet në veçanti të përmirësojë konsolidimin e tokës me qëllim të racionalizimit të tokës bujqësore, krijimit të një tregu transparent të tokës dhe zbatimit të sanksioneve. Sa i përket këmbimit tregtar, ka ende mospërputhje të statistikave të tregtisë bujqësore në mes të Eurostatit dhe atyre kombëtare. Kosovës i mungojnë standardet dhe masat minimale cross-compliance (masat që kushtëzojnë pagesat direkte me ndikimet mjedisore) në fushën e sigurisë së ushqimit, shëndetit e mirëqenies së kafshëve dhe mjedisit.

Korniza ligjore dhe ajo e politikave në fushën e bujqësisë

Sektori i bujqësisë është një nga sektorët kryesor i cili kontribuon dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Në mandatin e MBPZHR me theks të veçantë në krijimin e kushteve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, ministria ka bërë progres në përafrim të legjislacionit kombëtar më Acquis të BE-së, kryesisht në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duke përafruar legjislacionin vendor më një numër të madh të direktivave dhe rregulloreve të BE-së:

Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Ligji nr. . 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. . 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, përcaktojnë politikat për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, objektivat dhe masat në bazë të Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Ligji është pjesërisht i përafruar me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 19 janar 2009, që ndryshon Rregulloren, (KE) nr. 1290/2005, (KE) nr. 247/2006, (KE) nr. 378/2007 dhe shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003 Publikuar në Gazeta Zyrtare.

Korniza ligjore e Kosovës përmbanë edhe Ligjin Nr 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë, Ligji nr. 04/L-253 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimit të Bujqësisë. Me këtë Ligj rregullohet përmbajtja, organizimi dhe zbatimi i Regjistrimit të Bujqësisë në vitin 2013, në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ligji përcakton krijimin, përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të cilat e organizojnë, ndihmojnë dhe kryejnë regjistrimin, periudhën e mbledhjes së të dhënave, dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e regjistrimit, procedurën për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të regjistrimit, si dhe formën e publikimit dhe shpërndarjes së të dhënave duke siguruar ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave individuale të regjistrimit. Ligji është përafruar pjesërisht me: Rregulloren nr. 1166/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 Nëntor 2008 për strukturën e anketave të fermave dhe metodat e anketimit të prodhimeve bujqësore që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 571/88;

Ashtu siç u përmend edhe më lartë, toka bujqësore mbetet një nga prioritetet kryesore ku ky sektor duhet të fokusohet. Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore përcakton shfrytëzimin, mbrojtjen, rregullimin dhe qiradhënien e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore nuk është i përafruar me legjislacionin e BE-së.

Gjithashtu Kosova ka edhe Ligjin nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës. Me këtë ligj rregullohet baza ligjore për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimin e tokave bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore në funksion të shfrytëzimit më racional dhe më ekonomik. Në kuadër të këtij ligji përcaktohen edhe përgjegjësitë e institucioneve që janë kompetente për rregullimin e tokës, procedurat për rregullimin e tokës, planifikimi, financimi dhe zbatimi i këtij procesi. Ligji nuk është i përafruar me legjislacionin e BE-së.

Ligji nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore dhe Ligjit nr. 03/L-198 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore. Me këtë ligj rregullohet themelimi dhe funksionimi i subjekteve që ofrojnë shërbime dhe shfrytëzuesve të shërbimeve. Ligji adreson organizimin dhe krijimin e kushteve optimale për ujitjen e tokës bujqësore në Kosovë, mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve të prodhimeve bujqësore. Përmes këtij Ligji rregullohet organizimi dhe administrimi i ujitjes të tokës bujqësore, kompetencat dhe përgjegjësit e subjekteve, regjistrimi i kompanive të ujitjes, shoqatave të përdoruesve të ujit për ujitje, tarifatat e ujit për ujitje, afarizmin e shoqatave dhe çështje të tjera lidhur me ujitjen dhe kullimin. Ligji nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore dhe Ligji nr. 03/L-198 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore, si i tillë deri më tani nuk është i përafuar me legjislacionin e BE-së.

Nësektor i rëndësishëm në kuadër të bujqësisë është edhe blegtoria. Ky nësektor adresohet përmes Ligjit nr. 04/L-191 për Blegtorinë. Me këtë Ligj rregullohet mbrojtja, përmirësimi dhe ruajtja e cilësive të burimeve gjenetike të kafshëve për shtimin e prodhimeve blegtorale, përmirësimin e cilësisë së prodhimeve blegtorale, ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve. Ligji në fjalë përcakton kushtet dhe praktikatat blegtorale, për një mbarështim të mirë të kafshëve në fermë, metodat dhe teknologjitë e mbarështimit të kafshëve, kushtet për hartimin dhe miratimin e programeve racore, ndryshimet dhe ruajtja e cilësive të kafshëve. Për më tepër, ruajtja e ndryshueshmërisë gjenetike dhe racat autoktone, shërbimet shkencore dhe profesionale në blegtori, banka gjenetike për kafshët, ndërmarrjet e mbarështuesve të kafshëve, tregu dhe tregtimi i materialeve racore, inspektimi dhe fondet e nevojshme gjithashtu janë çështje të cilat adresohen në kuadër të këtij ligji. Ligji është i hartuar me tabelat e përputhshmërisë dhe pjesërisht është i përafuar me një numër të direktivave të BE-së: Direktiva e Këshillit 2009/157EC; Direktiva e Këshillit 87/328/EEC; Direktiva e Këshillit 88/661 EEC; Direktiva e Këshillit 90/118 EEC; Direktiva e Këshillit 90/119 EEC; Direktiva e Këshillit 89/361 EEC; Direktiva e Këshillit 90/427 EEC; Direktiva e Këshillit 91/174 EEC dhe Direktiva e Këshillit 94/28/KE.

Ligji nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve. Me këtë ligj rregullohen procedurat për mbrojtjen e varieteteve të bimëve, dhënien dhe mbrojtjen e të drejtës së seleksionuesit të bimëve, si dhe siguron kushte për varietetet e të gjitha gjinive dhe llojeve bimore duke përfshirë edhe kryqëzimet në mes të gjinive dhe llojeve që mund të mbrohen me këtë ligj. Ligji është përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit Evropian (KE) nr. 2100/94 nga 27 Gusht 1994 për të drejtat e bashkësisë së bimëve; Direktivën Implementuese të Komisionit 2014/97/BE e datës 15 tetor 2014 për plotësimin e Direktivës Implementuese e Këshillit 2008/90/KE në lidhje me regjistrimin e furnizuesve të varieteteve dhe listës së zakonshme të tyre.

Ligji nr. 2003/5 për Farërat rregullon prodhimin dhe tregtimin me farëra të varieteteve bimore dhe patateve për farë në prodhimtarinë bujqësore. Ky ligj aplikohet për farërat e varieteteve të ndryshme bimore në prodhimtarinë bujqësore dhe patateve për farë si të vendit po ashtu edhe nga importi – pra të gjitha llojet të përfshira në listën e Programit 1 të cilat kanë për qëllim prodhimin dhe shitjen në Kosovë. Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 66/402/KEE, datë 14 Qershor 1966, për marketingun e drithërave.

Kosova gjithashtu posedon edhe Ligjin nr. 2003/10 për Plehrat Artificiale, i cili rregullon regjistrimin, kontrollin, tregtimin dhe sigurimin e mbrojtjes së cilësisë së plehrave artificiale në Kosovë. Ligji është pjesërisht i përafuar me Rregulloret e BE-se nr. 2003/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 13 tetor 2003 që ka të bëjë me plehrat.

Bujqësia organike mbetet një nga segmentet më të rëndësishme të kapitullit të bujqësisë. Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike krijon bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik si dhe siguron funksionimin efikas të tregut duke garantuar konkurrencë të drejtë, besimin e konsumatorëve dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Ky ligj përcakton objektivat dhe parimet për sa iu përket: të gjitha fazave të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së produkteve organike dhe kontrollit të tyre; përdorimit të indikatorëve që ju referohen etiketimit dhe reklamës së prodhimeve organike dhe është i përafuar pjesërisht me Rregulloret e BE-së (KE) nr. 834/2007 të datës 28 Qershor 2007 dhe Rregullores (KE) nr. 889/2008.

Verërat janë një nga produktet për të cilat është diskutuar intenzivisht gjatë negociimit të MSAsë për shkak të rëndësisë që posedojnë në tregun e Kosovës dhe potencialit që ka kjo nënfishë për eksport në vendet e BE-së.

Ligji nr. 02/L-8 për Verërat, Ligji nr. 04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat rregullon prodhimin dhe qarkullimin e rrushit për prodhimin e verës, kushtet e vënies në qarkullim të verës dhe produkteve të tjera të përpunimit të rrushit dhe verës, mbrojtjen e verës së prodhuar në rajonin e caktuar gjeografik i cili dallohet me kushtet e veçanta klimatike, tokësore dhe kushteve tjera. Ky ligj është pjesërisht i përafuar me: Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 436/2009 26 maj 2009 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008 sa i përket regjistrimit të vreshtave, deklaratat e detyrueshme dhe grumbullimin e informacionit për të monitoruar tregun e verës, dokumentet shoqëruese për ngarkesat e produkteve të verës dhe sektorin e verës, regjistrat që duhen të mbahen; Rregullorjen e Këshillit (KE) Nr 479/2008 e datës 29 prill 2008 mbi organizimin e përbashkët të tregut në verë; Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 555/2008 e datës 27 qershor 2008 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008 mbi organizimin e përbashkët të tregut në verë për sa i përket programeve mbështetëse, tregtin më vendet e treta, potencialin e prodhimit dhe në kontrollet në sektorin e verës; Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 606/2009 e datës 10 korrik 2009 që përcakton rregulla të caktuara të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008 sa i përket kategorive të produkteve të hardhisë së rrushit, praktikatat enologjike dhe kufizimet e aplikueshme; Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 607/2009 e datës 14 korrik 2009 që përcakton rregulla të detajuara specifike për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008 në lidhje me emërtimet e mbrojtura të origjinës dhe treguesit gjeografikë, termat tradicionale, etiketimin dhe prezantimin e produkteve të caktuara të sektorit të verës; Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 491/2009 e 25 maj 2009 për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr 1234/2007 krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe mbi dispozita të veçanta për produkte të caktuara bujqësore (Rregullorja për tregun e përbashkët CMO) dhe Rregulloren e Komisionit dhe Këshillit Evropian (BE) nr. 1308/2013 për themelimin e organizatës së përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore e cila shqufizon Rregulloren e Këshillit nr. 922/72; nr. 234/79; nr. 1037/2001; dhe nr. 1234/2007.

Në aspektin e sigurimit të shëndetit publik, Kosova ka miratuar Ligjin nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit. Më këtë Ligj rregullohet prodhimi, grumbullimi, përpunimi, tregtimi i duhanit të pa përpunuar dhe produkteve të tij në Republikën e Kosovës. Ligji nuk është i përafuar me legjislacion të BE-së.

Për të siguruar implementimin e ligjeve në fuçi, MBPZHR gjithashtu ka miratuar Ligjin nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësor. Me këtë Ligj përcaktohet puna, kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit. Megjithatë, ky Ligji ende nuk është i përafuar me legjislacion të BE-së.

Theks i veçantë përgjatë viteve të fundit u është kushtuar ofrimit të shërbimeve këshilluese çofatë nga ana e palës kosovare ashtu edhe nga ana e BE-së. Ligji nr. 04/L-074 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, rregullon organizimin dhe zbatimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, ngritjen e njohurive, trajnimin për menaxhimin e fermës, si dhe rritjen e të ardhurave në fermë. Ligji është i përafuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 dt.19 janar 2009, e cila përcakton rregullat e përbashkëta për skemat mbështetëse direkte për fermer sipas politikave të përbashkëta bujqësore dhe krijimin e skemave mbështetëse të caktuara për fermerë, që ndryshojnë Rregulloret (KE) nr. 1290/2005, (KE) nr. 247/2006, (KE) nr. 378/2007 dhe shfuqizojnë Rregulloren (KE) nr. 1782/2003.

Ligji nr. 2003/9 për Kooperativat Bujqësore, rregullon themelimin, funksionimin e punës së Kooperativave të bujqve në funksion të zhvillimit të bujqësisë dhe rritjes së produktivitetit të punës së bujqve. Ligji deri më tani nuk është i përafuar me legjislacion të BE-së.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni kryesor i cili merret me hartimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e bujqësisë duke përfshirë, prodhimtarinë bimore, blegtorinë, shfrytëzimin e tokës bujqësore me qëllim të mbrojtjes së saj si dhe zhvillimin rural, sigurinë ushqimore dhe pylltarinë. Në kuadër të MBPZHR -së janë dy agjencione: Agjencioni i Pyjeve të Kosovës (APK) dhe

Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), tetë departamente (Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përbashkëta, Departamenti Ligjor, Departamenti për Zhvillim Rural-Autoriteti Menaxhues, Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje, Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika, Departamenti për Pylltari dhe Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave), si dhe Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë. Në MBPZHR janë të punësuar gjithsej 353 punëtor.

Politikat e MBPZHR për sektorin e bujqësisë (drithërave, pemëve, perimeve dhe blegtorisë)

Sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës është 1.1 milion hektarë, 53 % e së cilës është tokë bujqësore dhe 41 % është tokë pyjore. Sektori i bujqësisë kontribuon 12.0% të BPV-së dhe llogaritet që punëson afërsisht 4.6% të totalit të punësuarve. Prandaj, sektori i bujqësisë mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë më qëllim të përmirësimit të bilancit tregtar, uljen e papunësisë, sigurinë e produkteve ushqimore, mbrojtjen e ambientit si dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve në përgjithësi.

Me qëllim të zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar disa dokumente strategjike.

Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2013 mbetet kryesori për këtë kapitull dhe ka për qëllim ristrukturimin e sektorit agrorural në linjë me atë të BE-së, përmirësimin e standardit të jetesës së popullatës rurale dhe komunitetit bujqësor në Kosovë, përfshirë uljen e varfërisë, përkrahjen e zonave me pak të favorizuara. Strategjia në fjalë përcakton metoda të sigurta të prodhimit të bujqësore të qëndrueshme që gjenerojnë punësim dhe mundësi punësimi, si dhe ruajtjen e burimeve dhe të trashëgimisë natyrore. Kjo Strategji bazohet në: Rregulloren e Këshillit 1698/2005, të Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EFARD), dhe përbehet në 4 boshte dhe 8 shtylla.

Në fushën e hortikulturës, Republika e Kosovës ka të miratuar Strategjinë për Sektorin e Hortikulturës 2009-2013. Qëllimi i kësaj strategjie është shtimi i të ardhurave dhe aftësive konkurruese të sektorit të hortikulturës. Gjithashtu, strategjia ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve prodhuese, përmirësimin e kualitetit të produkteve, në funksion të zëvendësimit të importeve në raport me prodhimet vendore.

Duke u nisur nga fakti që Kosova ka rreth 41% të tokës me pyje, mbetet prioritet për Qeverinë që të siguroj mbrojtjen dhe menaxhimin cilësor të pyjeve. MBPZHR ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, e cila ka për synim shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore përmes ofrimit të një kornize institucionale dhe rregullative duke siguruar mekanizmat e përhershëm financiar për zhvillimin e sektorit.

Ndërkaq sa i përket konsolidimit të tokës, Kosova ka Strategjinë për Konsolidimin e Tokave e cila ka afatin kohorë prej 2010 deri në 2020. Qëllimi i strategjisë është realizimi i projekteve të konsolidimit të tokës me qëllim të shfrytëzimit racional të tokës bujqësore, zgjedhjen e çështjes së pronësisë, sigurimin e zotërimit të tokës, rritjen e madhësisë së fermës, konkurrencën në treg, zhvillimin e infrastrukturës, mbrojtjen e ambientit, trashëgimin kulturore dhe ndihmën për të zhvilluar aktivitete alternative bujqësore.

Rol të rëndësishëm brenda kapitullit 11 për të zhvilluar edhe më tutje sektorin ka edhe Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2012-2016. Qëllimi i strategjisë është avancimi i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, identifikimi i kërkesave për shërbime këshilluese si dhe zgjedhjen e tyre nëpërmjet këshilltarëve të rritit të shërbimeve këshilluese, si dhe organizimi i shërbimeve këshilluese në nivelin qendror dhe lokal.

Buxheti i shpenzuar në kuadër të masave mbështetës me PBZHR 2007-2013 ka qenë 82,642,382.86 Euro. Për projektet e zhvillimit rural/investime kapitale janë dhënë 48,017,257.86 milion Euro, ndërsa për Pagesa direkte 34,625,124.90 milion Euro (ose 58% është shpenzuar për projekte Zhvillimit Rural dhe 42% është shpenzuar për pagesa direkte/subvencione). Ndërsa në vitin 2014, pjesëmarrja e buxhetit të bujqësisë në buxhetin e përgjithshëm është rritë për 1.71%.

Bashkimi Evropian është donatori më i madh për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në Kosovë. Përkrahja e BE-së mbulon ndërtimin e institucioneve, skemat e granteve për fermerët dhe industrinë e përpunimit të ushqimit dhe përkrahjen për sektorin e OJQ-ve. Për periudhën 2007-2012 nën IPA 2008, IPA 2009, IPA 2010 dhe IPA 2011 janë zbatuar 45 projekte në fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në vitin 2009 në bazë të Skemave të Granteve të financuar në kuadër të IPA, pasuar nga projektet IPA 2011, IPA 2012 dhe IPA 2013 si dhe IPA II me buxhet rreth 50 milion euro. Banka Botërore përmes Projektit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka ndihmuar Qeverinë e Kosovës në promovimin e aftësisë konkurruese dhe rritjes në nënsektorët e blegtorisë dhe hortikulturës gjatë dekadës së ardhshme nëpërmjet zbatimit të masave të përzgjedhura nga strategjia bujqësore dhe zhvillim institucional.

Sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural është përkrahur dhe nga donator tjerë si: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) përmes Projektit për Përkrahje të Zhvillimit të Bujqësisë në Kosovë (2011 – 2016) me rreth 2,000,000.00 Euro; Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA), gjatë vitit 2013-2014 e ka mbështetur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural më 6,170,801.00 €. Gjithshtu edhe USAID përmes projektit -Mundësitë e Reja në Bujqësi (NOA), gjatë periudhës 2011-2015 ka sektorin e bujqësisë e ka përkrahur më gjithsejtë 15,900,000.00 Euro. Qeveria Gjermane(GIZ) përmes projektit “ Fondit Konkurrues për Hortikulturë” ka përkrahur sektorin e hortikulturës me 1,000,000.00 Euro

Masat afatshkurtra

MBPZHR me Programin Legjislativ për vitin 2016 planifikon hartimin projektligjeve si në vijim:

- Projektligjit për Rregullimin e Tregut për Prodhime Bujqësore i cili do të përafrohet me legjislacionin e BE-së: Rregullorën e BE – së nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 Dhjetor 2013 për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikave të përbashkëta bujqësore e cila shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 352/78, (KE) nr. 165/94,(KE) nr. 2799/98, (KE) nr. 814/2000, (KE) nr. 1290/2005 dhe (KE) nr. 485/2008; Rregullorën e BE – së nr. 1307/2013 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 Dhjetor 2013 që përcakton rregullat për pagesat direkte për fermerë sipas skemave mbështetëse në kuadër të kornizës së politikave të përbashkëta bujqësore dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit të EC – së nr. 637/2008 dhe Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009; Rregullorjën e BE – së nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 Dhjetor që përcakton organizmin e përbashkët të tregut për produktet bujqësore e cila shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72 (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007.
- Projektligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i cili do të përafrohet me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 të datës 19 Janar 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta për skemat mbështetëse direkte për fermerë sipas politikave të përbashkëta bujqësore dhe krijimin e skemave mbështetëse të caktuara për fermerë, që ndryshojnë Rregulloret (KE) nr. 1290/2005, (KE) nr. 247/2006, (KE) nr. 378/2007 dhe shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003.
- Projektligji për Farëra dhe Materialin Fidanor, i cili do të përafrohet me legjislacionin e BE-së: Direktivën e Këshillit 66/401/KEE për tregtimin e farës - bimëve foragjere; Direktivën e Këshillit 66/402/KEE për tregtimin e farës së drithërave; Direktivën e Këshillit 2002/53/KE për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore, Direktivën e Këshillit 2002/54/KE për tregtimin e farës së panxharit, Direktivën e Këshillit 2002/55/KE për tregtimin e farës bimore, Direktivën e Këshillit 2002/56/KE për tregtimin e farës së patateve, Direktivën e Këshillit 2002/57/KE për tregtimin e farës vajore dhe bimë fibrash, Direktivën e Këshillit 68/193/KEE për tregtimin e materialit për riprodhim vegjetativ të hardhisë, Direktiva e Këshillit 1998/ 56 për tregtimin e materialit riprodhues të bimëve dekorative; Direktiva e Këshillit 2002/53 për tregtimin e materialit riprodhues dhe materialin fidanor, përveç farës, Direktiva e Këshillit 2008/90 për tregtimin e materialit riprodhues bimor të frutave dhe bimëve frutore të destinuar për prodhimin e frutave.
- Projektligji për Pijet e Forta Alkoolike i cili përafrohet më Rregulloren nr. 110/2008 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 Janar 2008, për definicionet, përshkrimin, prezantimin, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë për pijet e forta alkoolike, e cila e shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 1576/89 dhe Rregulloren (KE) Nr 1334/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

- Projektligji për Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (RrDhKF) i cili do të përafrohet pjesërisht me Rregulloret e BE-së : Rregullorën Implementuese të Komisionit (EU) 2015/220 e datës 3 shkurt 2015 e cila përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1217/2009 për ngritjen e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Bashkimin Evropian; Rregullorën e Deleguar të Komisionit të BE – së nr. 1198/2014 e datës 1 Gusht 2014/për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1217/2009 për ngritjen e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Bashkimin Evropian; dhe Rregullorjën Implementuese të Komisionit të BE – së nr. 385/2012 e datës 30 Prill 2012 për kthimin e fermës që do të përdoret për përcaktimin e të ardhurave të fermave bujqësore dhe analizimin e funksionimit të biznesit të pronave të tilla. I përafrohet pjesërisht me Rregulloret e BE-së: Rregullorën Implementuese të Komisionit (EU) 2015/220 e 3 Shkurtit 2015 e cila përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1217/2009 për ngritjen e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Bashkimin Evropian

Prioritetet afatmesme

MBPZHR përmes politikave dhe strategjive zhvillimore edhe në periudhën afat mesme do të orientohet në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji do ke krijojnë mundësinë që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm i resurseve bujqësore, duke rritur sipërfaqet me kultura bujqësore dhe prodhimtarinë në të gjithë sektorët e bujqësisë. MBPZHR gjatë periudhës afatmesme synon implementimin e masave në kuadër të strategjive sektoriale si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e fondeve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Toka bujqësore

Me qëllim të shfrytëzimit, mbrojtjes, rregullimit dhe qiradhënies së tokës bujqësore, ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, është aprovuar Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, i cili deri më tani nuk është i përafrohet me legjislacionin të BE-së.

Për zbatim të Ligjit për Rregullimin e Tokës, MBPZHR, ka nxjerr UA për klasifikimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore nr. 02/2012, ka krijuar komisionin për rregullimin e tokës ma vendim nr. 05/2012, UA për metodologjinë e sqarimit të pronësisë në projektet e papërfunduara të rregullimit të tokës nr. 07/2012, UA për vlerësimin e pjellorisë dhe përshtatshmërisë nr. 08/2012, UA për kriteret dhe përmbajtjen e marrëveshjes me shkrim nr. 09/2012 dhe UA për kompensim financiar për drunj, të mbjella dhe objekte tjera të paluajtshme në tokë të këmbyer nr. 10/2012.

Nga të dhënat statistikore të kryera nga Inventarizimi Nacional i pyjeve që është kryer në vitin 2012, shfrytëzimi i tokës bujqësore në vitin 2012 ka qenë 470,400 ha (tokë bujqësore, livadhe dhe kullosa), ndërsa vetëm 296,830 ha janë të shfrytëzuara për kultivim. Sipërfaqja e tokës bujqësore është duke u zvogëluar vazhdimisht për shkak të mungesës së planifikimit hapësinor dhe pamundësisë së zbatimit të Ligjit mbi Tokat Bujqësore dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tokës bujqësore dhe pengimin e ndërrimit të destinimit në tokë ndërtimore. Mesatarja e tokës bujqësore për banorë në Kosovë është shumë e vogël 0,15- 0,18 ha, që është më pak se gjysma e mesatares së BE-së. Fragmentimi dhe madhësia e vogël e parcelave bujqësore paraqesin problem të vazhdueshëm për mbështetjen e qëndrueshme të prodhimtarisë bujqësore. Sipas anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore të ASK-së të vitit 2013, 49% e fermave të ekonomive shtëpiake të anketuara kanë më pak se 1 ha.

Kosova, ka bërë edhe klasifikimin kadastral të tokës, i bazuar në kushtet natyrore dhe ekonomike të prodhimit të kulturave, i cili përdoret për të përcaktuar të ardhurat kadastrale. Prandaj, bazuar në Ligjin për Tokën Bujqësore nr. 02/L-26 neni 10 paragrafi 10.1 është përgatitur klasifikimi i ri i përshtatshmërisë së tokës bujqësore.

MBPZHR ka hartuar politika reformuese dhe ka krijuar mekanizmin për implementimin e këtyre politikave, sa i përket shfrytëzimit dhe rregullimit të tokës.

Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020 dhe Plani i Veprimit 2010-2020 për zbatimin e Strategjisë është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me nr. 09/21 dt. 26.06.2011. Qëllimi i Strategjisë për Konsolidimin e Tokës 2010-2020, është të krijoj një vizion afatgjatë për implementim të rregullimit të tokës në Kosovë. Qeveria e Kosovës ka vendosur që reforma e tokës bujqësore duke përfshirë shfrytëzimin, planifikimin e përdorimit dhe rregullimi i tokës të jene një nga politikat prioritare për MBPZHR. Aktivitetet për konsolidimin e tokës, tashmë janë përkrahur edhe PBZHR 2007-2013. Sipas vlerësimit afatmesëm të MBPZHR 2007-2013, masa për konsolidimin e tokave bujqësore ka pasur efekt për reduktimin e dukshëm të ngastrave. Deri më tani janë konsoliduar 2,697.00 ha.

Lidhur me menaxhimin e tokave në MBPZHR ekziston Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregjeve, në kuadër të cilit është Divizioni për Toka Bujqësore. Funkzioni kryesor i këtij departamenti është hartimi i politikave bujqësore dhe tregtare, hartimi i dispozitave më të përshtatshme për zbatimin e politikës bujqësore përmes përcaktimit të skemës përkrahëse për fermerët dhe tregjet si dhe kornizës përkatëse ligjore. Departamenti është përgjegjës për vendosjen e kornizës teknike për prodhimtarinë blegtorale dhe bimore si dhe standardet e ndërlidhura me cilësisë e prodhimtarisë bujqësore.

Konsolidimi i tokës bujqësore është financuar me vite nga buxheti i Kosovës, vlera e shumës aktuale për rregullim të tokës bujqësore është 500,000.00 euro.

Nga asistenca IPA 2008, është mbështetur përmes projektit Mbështetje e Mëtuftjeshme e Shfrytëzimit të Tokave në vlerë prej 1.8 Milion euro.

Gjithashtu, më qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndërtimet e pa planifikuara urbane është duke u zbatuar Projekti “ Implementimi i Planifikimit Hapësinor Rural”, i financuar nga BE në vlerë prej 2 milion euro, i cili do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në Kosovë, duke përmirësuar procedurat dhe metodologjinë e Planifikimit Hapësinor Rural.

Fuqizimi i bashkëpunimit me autoritete komunale lidhur me qartësimin e definicioneve në zbatimin e legjislacionit për shfrytëzimin e tokës dhe konsolidimin në pikëpamje të mbrojtjes së tokës nga ndërtimet ilegale dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ për Mbrojtjen e Tokës, është konkluzion nga takimi i DPSA-së. Në Raportin e Progresit të vitit 2014, sfidë mbetën planet për menaxhimin e tokave rurale të cilat duhet vendosur në nivelin komunal. Forcimi i koordinimit mes palëve me interes të përfshira në lejet e ndërtimit dhe të zoonimit duke shmangur ndryshimet e paligjshme të shfrytëzimit të tokës bujqësore mbetet sfidë në vazhdimësi. Sfidë tjetër është edhe efektiviteti i konsolidimit të tokës, krijimi i një tregu transparent të tokës, zbatimi i sanksioneve në parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në tokat bujqësore të cilat mbeten pengesa për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor.

Masat afatshkurtra

- Ruajtja e tokës bujqësore nga ndërtimi i destinimit prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
- Vazhdimi i Projektit për komasacionin e pa-përfunduar të tokës bujqësore dhe komasacionin me baza vullnetare në komunat tjera;
- Zgjerimi i sipërfaqeve të monitoruara nga ndotja; dhe
- Themelimi i sistemit për monitorimin e rregullt të tokës nga ndotja.

Prioritetet afatmesme

- Plotësim ndryshimin i Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore;
- Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Pleherat Artificiale i cili do të përafrohet me Regulation (EU) Nr 2003/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me plehrat artificiale, 13 tetor 2003;
- Plotësim ndryshimi i Ligjit për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve; dhe
- Vazhdimi i Projektit për konsolidimin e pa-përfunduar të tokës bujqësore dhe konsolidimin në baza vullnetare në komunat tjera; dhe

Pagesat direkte

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i amendamentuar më Ligjin nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural si dhe Programin

për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR) 2014-2020, MBPZHR për ç' do vit përgatitë Programin për pagesat Direkte. Për zbatimin e Ligjit dhe Programit për Pagesat Direkte është nxjerrë Udhëzimi Administrativ nr. 02/2014, datë 04.09.20154 për pagesa direkte.

Më qëllim të rritjes së prodhimitarisë bujqësore, MBPZHR, ka filluar më skemën e pagesave direkte në vitin 2007. Qëllimi i pagesave direkte ka qenë rritja e prodhimitarisë bujqësore, rritjen e konkurrencës në treg karshi prodhimeve bujqësore të importuara nga jashtë. Gjithashtu, pagesat direkte krijojnë një lidhje ndërmjet fermerëve dhe administratës me qëllim të nxitjes së fermerëve që të zhvillojnë biznesët në bujqësi.

Masat afatshkurtra

Përmes programit për pagesa direkte synohet përkrahja e drejtpërdrejtë për prodhimtarinë bujqësore dhe blektorale për tre sektorë kryesor: drithërat, hortikultura dhe blegtoria me 16 nën sektorë tjerë. Prioritet afatshkurtër është:

- Përgatitja e Programit për Pagesa Direkte, duke i marr parsysh standardet dhe masat që kushtëzojnë pagesat direkte kryesisht me ndikimet mjedisore në fushën e sigurisë së ushqimit, shëndetit e mirëqenies së kafshëve dhe mjedisit.

Ndërsa, duke u bazuar në Konkluzionet e DPSA për subvencionet (pagesat direkte) do të forcohet edhe më tej bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe rishikimi i skemave të pagesave si dhe zvogëlimi i vonesave në rimbursimin e investimeve të bëra në fermat bujqësore.

Prioritetet afatmesme

- Rishikimi i Programit për Pagesa Direkte;
- Zbatimi i Programit për Pagesa Direkte; dhe
- Zgjerimi i Programit për Pagesat Direkte me nën sektorë tjerë.

Bujqësia organike

Bazuar në Rregulloret e BE-së (KE) nr. 834/2007 të datës 28 Qershor 2007 dhe Rregullorës (KE) nr. 889/2008, si dhe ndryshimeve të dala nga rregulloret është bërë ndryshim plotësimi i Ligjit për Bujqësi Organike nr. 02/L-122.

Ligji për Bujqësinë Organike nr. 04/L-085 aplikohet për prodhimet organike: prodhimet bujqësore me origjinë bimore të pa përpunuara, kafshët si dhe prodhimet blektorale të papërpunuara, të prodhuara në pajtim me parimet e prodhimitarisë organike dhe rregullat specifike të inspektimit të tyre.

Për zbatimin e Ligjit për Bujqësi Organike është nxjerr UA nr. 10/2013 për detyrat, përgjegjësitë, përbërja e komisionit për Bujqësi Organike, me të cilin përcaktohen detyrat përgjegjësitë për të mbështetur zhvillimin, promovimin dhe koordinimin e prodhimit organik në Kosovë.

Bujqësia organike në Kosovë është në fazën fillestare të zhvillimit të saj. Sipërfaqja nën konvertim organik është 85 ha (16 lloje), kryesisht për bimë mjekuese, të cilat eksportohen si produkte të certifikuara bio. Viteve të fundit, disa fermerë janë duke kaluar në prodhimtari organike me përkrahje nga Shoqata e Bujqësisë Organike në Kosovë (SHBOK).

Vetëdija për përfitimet e vërteta të prodhimit organik është ende e kufizuar dhe aktualisht asnjë prodhim i rëndësishëm nuk del nga tregu. Për të stimuluar prodhuesit organik, në Programin për Zhvillim të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020 është futur skema për bujqësi organike. Deri tani nuk ka pasur një skemë të veçantë përkrahse, por përparësi i është dhënë fermerëve organik në kuadër të skemave përkrahëse investuese. Pilot zbatimi i skemës për Bujqësi Organike do të kontribuojë në zhvillimin e Bujqësisë organike në Kosovë.

MBPZHR, ka krijuar bazën e të dhënave për prodhuesit organikë në Kosovë si dhe është krijuar edhe një listë e fermerëve potencial që janë të interesuar që një pjesë të prodhimit të tyre të kalojnë në prodhime organike. Bazuar në të dhënat statistikore, në Kosovë 58 ha janë bimë medicinale si prodhime organike të çertifikuar. Bujqësia organike është një proces që fillon me konvertim në vitin e parë dhe më pas vazhdon

më prodhim. Prandaj prodhimet organike duhet të përcillen dhe çertifikohen çdo vit. Sipas të dhënave nga Shoqata e Bujqësisë Organike më pemë si prodhime organike janë 4 ha, me Vreshta 1 ha dhe 0.10 ha perime në serë.

Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje është përgjegjës për bërjen e politikave dhe legjislacionin në këtë sektor. Në kuadër të Departamentit ekziston Njësia për Bujqësi Organike e cila është themeluar në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2010. MBPZHR, bazuar në UA nr. 10/2013, dt. 22.07.2013 ka themeluar Komisionin për Bujqësi Organike më detyrat, përgjegjësitë dhe përbërjen e komisionit për bujqësi organike si dhe Autoritetin e Kontrollit që është AUV. Në bazë të ligjit, bazuar edhe në Rregulloren nr. 834/2007 të BE-së deri më tani në Kosovë operojnë dy trupa të kontrollit të prodhimeve organike "Bioinspecta" (Zvicër) në bashkëpunim me Albinspect (Shqipëri) si dhe Procert (Maqedoni). Bujqësia Organike është përkrahur vazhdimisht nga asistenca e TAIEX-it.

Përveç krijimit të një Autoriteti funksional të Kontrollit për Bujqësi Organike, sfidë mbetet zbatimi i Ligjit për Bujqësi Organike (konkluzion i DPSA-së).

Masat afatshkurtra

- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për Sistemin e Kontrollës, Autoritetit të Kontrollit, Organet e Kontrollit si dhe Rregullat për Zbatim të Kontrollit;
- Miratimi i Udhëzimit Administrative për prodhimtarin Blegtorale;
- Miratimi i Udhëzimit Administrative për prodhimtarinë Bimore;
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për plotësimin dhe ndryshimin e UA nr. 10/2013 për Detyrat Përgjegjësitë dhe Përbërja e Komisionit për Bujqësi Organike;
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për paketimin, deponimin dhe transportin e prodhimeve organike;
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ- Kriteret standardet dhe kushtet për importin e produkteve organike në Kosovë;
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ që përmbanë kriteret specifike për Logo;
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat specifike për etiketimin dhe përmbajtjes së saj;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Zhvillimin e Bujqësisë Organike.

Prioritetet afatmesme

- Hartimi i Programit Kombëtar për Bujqësi Organike.

Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (RrDhKF)

Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave Bujqësore (RrDhKF) është një instrument që shërben për vlerësimin e të ardhurave të ekonomive bujqësore dhe ndikimin e Politikave të Përbashkëta Bujqësore në BE dhe në vendin tonë. Në vitin 2004, në MBPZHR u themelua RrDhKF si pilot projekt në fazë testuese që përfshinte 50 ferma. Ky numër u zgjerua në 159 ferma në 2005. Mbështetja për FADN ka vazhduar me projektet e binjakëzimit 2009 -2014 në zhvillimin e politikave si dhe në zbatimin e Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke rritur numrin e fermave në mostër nga 300 respektivisht në 400 ferma. RrDhKF (FADN) është duke u forcuar dhe rritur gradualisht, ndërsa tani numri i fermave në mostër është 1,000 ferma.

Me qëllim të ofrimit të të dhënave për efektet e politikave bujqësore, MBPZHR ka përgatitur raportin e tretë vjetor të RrDhKF që përmban të dhënat kryesore mikro-ekonomike për fermat e Republikës së Kosovës të vitit 2014.

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, bënë mbledhjen dhe analizën e të dhënave ekonomiko statistikore. Të dhënat ndihmojnë MBPZHR -në dhe institucionet tjera që të prodhojnë raporte dhe analiza të detajuara ekonomike mbi bazën e të cilave do të ndërmerren edhe masat e duhura.

Buxheti aktual është 15,370 euro, RrDhKF është mbështetur nga BE-ja përmes asistencës së TAIEX-it.

Masat afatshkurtra

- Miratimi i Projektligjit Ligjit për **RrDhKF**, i përafuar pjesërisht me Rregulloret e BE-së: Rregullorën Implementuese të Komisionit (EU) 2015/220 e 3 Shkurtit 2015 e cila përcakton rregullat për zbatimin e Rregullorës së Këshillit (KE) Nr 1217/2009 për ngritjen e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Bashkimin Evropian (ANNEX I, ANNEX II, ANNEX III, ANNEX IV, ANNEX V, ANNEX VI, ANNEX VII, ANNEX VIII); Rregullorën e Deleguar të Komisionit (EU) nr. 1198/2014 e 1 Gushtit 2014/plotësim ndryshimi i Rregullorës së Këshillit(KE) nr. 1217/2009 për ngritjen e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Bashkimin Evropian;dhe Rregullorën Implementuese të Komisionit (BE) Nr 385/2012 e 30 prillit 2012 në kthimin e fermës që do të përdoret për përcaktimin e të ardhurave të fermave bujqësore duke analizuar funksionimin e biznesit të pronave të tilla.
- Punësimi i 4 zyrtarëve.

Prioritetet afatmesme

- Nxjerrja e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për RrDhKF;
- Rritja e numrit të fermave në mostër nga 1000 ferma në 1250 ferma;
- Krijimi i platformës informative - Sistemi i Integruar Informativ Bujqësore (SIIB-it) duke zhvilluar edhe modulet e sistemit për kontroll të integruar, modulit të të drejtave të menaxhimit dhe modulit të kontabilitetit si dhe ndërlidhjen e tyre në mes veti; dhe
- Publikimet e rregullta periodike dhe vjetore.

Vreshtaria

Sipas Ligjit nr. 02/L-08 për Verëra i amendamentuar me Ligjin nr. 04/L-019 për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-08, Kosova është përcaktuar si një njësi territoriale vreshtare e ndarë në dy regjione vreshtare: Regjioni i Kosovës dhe Regjioni i Dukagjinit. Ligji është pjesërisht i përafuar me Rregulloret e Komisionit (KE) Nr 436/2009 26 maj 2009 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008, Rregullorën e Këshillit (KE) Nr 479/2008 e datës 29 prill 2008 mbi organizimin e përbashkët të tregut në verë; Rregullorën e Komisionit (KE) Nr 555/2008 e datës 27 qershor 2008 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008 mbi organizimin e përbashkët të tregut në verë, Rregullorën e Komisionit (KE) Nr 606/2009 e datës 10 korrik 2009 që përcakton rregulla të caktuara të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008; Rregullorën e Komisionit (KE) Nr 607/2009 e datës 14 korrik 2009 që përcakton rregulla të detajuara specifike për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 479/2008; Rregullorën e Këshillit (KE) Nr 491/2009 e 25 maj 2009 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 1234/2007 për krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe mbi dispozita të veçanta për produkte të caktuara bujqësore (Rregullorja për tregun e përbashkët CMO) dhe Rregullorën e Komisionit dhe Këshillit Evropian (BE) nr. 1308/2013 për themelimin e organizatës së përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore e cila shfuqizon Rregulloret e Këshillit nr. 922/72; nr. 234/79; nr. 1037/2001;Nr. 1234/2007.

Për zbatimin e Ligjit për verërat janë nxjerrë një numër i madh i udhëzimeve administrative: UA për regjistrat e brendshëm dhe të jashtëm të ndërmarrjeve prodhuese të rrushit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera nr. 21/2008, UA për përcaktimin e Territorit Vreshtar në Kosovë nr. 03/2009, UA për caktimin e kriterëve për importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera nr. 11/2009, UA për catimin e parametrave të analizave fiziko-kimike të verës nr. 15/2009, UA për caktimin e kriterëve për vënien e shënimeve në etiketë nr. 16/2009, UA për caktimin e lartësisë së kompensimit material për shërbimet e kryera në lëmin e vreshtarisë dhe verëtarisë të ofruara nga Instituti i Vreshtarisë nr. 02/2013, UA për regjistrimin e kultivuesve të rrushit, prodhuesve të verërave dhe prodhimeve tjera nga rrushi i verës nr. 06/2013, UA për caktimin e kushteve për shënimin e verërave me prejardhje të mbrojtur gjeografike dhe shënimin e lokaliteteve me indikacione të mbrojtura gjeografike nr. 01/2014; dhe UA për caktimin e kriterëve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptik të verës nr. 04/2014.

Republika e Kosovës aktualisht sipas regjistratit të vreshtave ka 3,191 hektar me vreshta. Sipërfaqet e vreshtave janë të shtrira në tetë zona vreshtare, ku vetëm zona vreshtare e Rahovecit dhe Suharekës përbëjnë 90% të sipërfaqeve më vreshta në të gjithë territorin vreshtar të Republikës së Kosovës.

MBPZHR ka krijuar sistemin kadastral të vreshtarisë që mundëson identifikimin e parcelave të bujqve dhe mbledhjen e të dhënave të tjera të rëndësishme për këtë sektor. Sistemi integron të gjitha të dhënat në një bazë të vetme të dhënave në "Postgre SQL" që mundëson paraqitjen e të dhënave tekstuale dhe grafike të përcjella me formularët, raportet dhe statistikat e tjera. Sistemi i Kadastrës së vreshtave dhe kontrollit të kualitetit të verës është një sistem nacional i cili funksionon në bazë të Ligjit nr. 04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat.

Për menaxhimin dhe kontrollin e kualitetit të verërave, MBPZHR në vitin 2014 ka funksionalizuar Sistemin për Menaxhimin dhe Kontrollin e kualitetit të verës, i cili ka për qëllim mirëmbajtjen, azhurnimin dhe plotësimin e të dhënave për një funksionim të qëndrueshëm dhe kualitativ për sektorin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë.

Përgjegjës për sektorin e vreshtarisë dhe verëtarisë, analizat fiziko-kimike dhe organoleptike, është Departamenti për Vreshtari dhe Verëtar, në kuadër të të cilit funksionon edhe Laboratori i Enologjisë, i akredituar me standardet e ISO/IEC 17025 si laborator testues për verëra.

Masat afatshkurtra

- Miratimi i Projektligjit për Pijet e Forta Alkoolike. Ky Projektligj pjesërisht është i përafuar me Rregulloren nr. 110/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për definicionet, përshkrimin, prezantimin, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë për pijet e forta alkoolike, e cila e shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 1576/89;
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për përcaktimin kriterëve dhe procedurave të regjistrimit për përpunuesit, importuesit, tregtuesit e brendshëm, eksportuesit e pijeve alkoolike; dhe
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tarifave për shpenzime të procedurës për regjistrim.

Prioritetet afatmesme

- Rritja e sipërfaqeve të reja me vreshta dhe rritja e cilësisë dhe promovimi i verërave brenda dhe jashtë Kosovës;
- Zbatimi i masave për produktet e verës dhe pijeve alkoolike të referuara në Protokollin 2 të MSA-së e që kanë të bëjnë me përcaktimin e origjinës dhe treguesit e mbrojtur gjeografik, dhe
- Rekrutimi i një zyrtari, i cili do të jetë përgjegjës për zbatim të ligjit të pijeve të forta alkoolike.

Zhvillimi rural

Me qëllim të përafrimit të politikave vendore rurale më Politikën e Përbashkëta të Bujqësisë të BE-së në vitin 2009 është aprovuar Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili më pas është amendamentuar me Ligjin nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Ligji është pjesërisht i përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 73/2009 19 janar 2009.

Për zbatimin e Ligjit dhe Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë nxjerrë këto Udhëzime Administrative: UA për kriteret e mbështetjes së strategjive zhvillimore lokale-qasja LEADER, UA për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural, dhe UA për pagesat direkte në bujqësi. Këto Udhëzime Administrative rregullisht nxjerrën për çdo fund të vitit kalendarik pas programimit të masave mbështetëse.

Sa u përket politikave mbështetëse, nga viti 2009, MBPZHR ka filluar me skemat e mbështetjes kombëtare, bazuar në PBZHR 2007-2013. Politikën e mbështetjes të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural janë: i) pagesat direkte në mbështetje të drejtpërdrejt të hyrave për fermerët dhe ii) Projektet e zhvillimit rural si mbështetje të investimeve.

Në funksion të zhvillimit afatgjatë të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, është hartuar Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, me të cilin janë parapare masat për bujqësi dhe zhvillim rural. Këto masa janë hartuar sipas rregullave dhe procedurave të IPARD-it dhe PPB lidhur me shkallën e përkrahjes, pranueshmërisë së investimeve dhe shpenzimeve, kriteret e selektimit, procedurat e informimit/shpalljeve publike, aplikimit si dhe procedurat e ankesave. Programi për Bujqësi dhe

Zhvillim Rural (PBZHR) 2014-2020, përfshinë këto objektiva për rritjen e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor; përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma dhe jashtë fermave; mbrojtjen e mjedisit dhe e resurseve natyrore, nëpërmjet investimeve në ujitje, trajtim të mbetjeve, si dhe në energji të ripërtërishme.

Përcaktimi dhe adresimi i objektivave, bëhet përmes zbatimit të masave për projektet e zhvillimit rural:

- Masa:101 Investimet ne Asetet fizike në ekonomit bujqësore;
- Masa:103 Investimet ne Asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin produkteve bujqësore;
- Masa:202 Agro-mjedisi dhe bujqësia organike;
- Masa:203 Mirëmbajtja dhe mbrojtja e pyjeve;
- Masa:302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve;
- Masa:303 Përgatitja dhe Zbatimi i Strategjive Zhvillimore lokale -Qasja LEADER;
- Masa për Ujitjen e tokave bujqësore;
- Masa:401 Përmirësimi i trajnimeve;
- Masa:402 Shërbimet këshillimore; dhe
- Masa:501 Asistenca teknike.

Për hartimin e programit për Zhvillim Rural 2014-2020, janë marrë parasysh objektivat strategjike të BE-së për zhvillimin rural, duke u fokusuar në gjashtë prioritetet në periudhën e ardhshme të programimit: nxitja e transferimit të njohurive inovative në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale; rritja e aftësisë konkurruese në të gjitha sektorët e Bujqësisë dhe për të rritur qëndrueshmërisë e fermave; promovimi i organizimit të zinxhirit ushqimor dhe menaxhimit të rrezikut në bujqësi; rimëkëmbja, ruajtja dhe përmirësimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pylltaria; promovimi i shfrytëzimit efikas të burimeve dhe mbështetja e kalimit drejt një ekonomie me karbon të ulët; dhe promovimi i përfshirjes sociale, reduktimi i varfërisë dhe zhvillimin ekonomik në zonat rurale.

MBPZHR me datë 31.01.2012 me vendim nr. 36, Ref. ZSP-61/12 ka themeluar Autoritetin Menaxhues, në kuadër Departamentin të Politikave të Zhvillimit Rural. Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për programimin, monitorimin, vlerësimin, raportimin, menaxhimin financiar, informimin si dhe për koordinimin e përgjithshëm të programit. Gjithashtu është themeluar edhe Komiteti Monitorues i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Pra, përgjegjës për politika rurale është Departamenti i Zhvillimit të Politikave Rurale/Autoriteti Menaxhues, i cili harton monitoron dhe vlerëson e programit vjetor dhe afat-gjatë të zhvillimit rural, si dhe përcjell ndryshimin/ plotësimin në përputhje me Shtyllën II PPB BE-së.

Me përkrahjen e fondeve të BE-së nëpërmjet Projektit *Strategjitë e Zhvillimit Lokal (SZHL)* të zbatuar gjatë viteve 2007-2009, në Kosovë janë themeluar 30 Grupe Lokale të Veprimit (GLV) me partneritet publik-privat të cilat gjenden në drejtoritë komunale për bujqësi. GLV-të kanë nga 25-30 anëtarë (nga fusha të ndryshme: përfaqësues komunal, OJQ lokale, fermerë, biznese, ekspertë vullnetarë nga fusha të ndryshme).

Marrëveshja kornizë IPA lidhur me Rregullat e Bashkëpunimit më Asistencën e KE-së dhe Implementimin e Asistencës-komponentës së pestë të IPA-së për Zhvillim Rural-IPARD, është nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe KE në Prill të vitit 2015, për mbështetje financiare. Në të ardhmen, bujqësia dhe zhvillimi rural do të jenë sektorët përfitues nga kjo marrëveshje, më qëllim të përafrimit gradual më standardet dhe politikat e BE-së duke përfshirë edhe *acquis*.

Masat afatshkurtra

- Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- Miratimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (2014-2020);
- Përgatitja për akreditim e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Autoritetit Menaxhues;
- Miratimi i procedurave të brendshme për Autoritetin Menaxhues, në bazë të detyrimeve të dala nga Korniza e Marrëveshjes Sektoriale; dhe
- Funkcionalizimi i Komitetit Monitorues për PBZHR.

Prioritetet afatmesme

- Përgatitja e skemave mbështetëse kombëtare, bazuar në PBZHR 2014-2020, projektet të cilat nuk mbështeten nga programi IPA-II (masat e konsolidimit të tokës, infrastrukturës dhe ujitjes së tokave bujqësore);
- Përafrimi i politikave kombëtare me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së;
- Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- Zbatimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural; dhe
- Akreditimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Autoriteti Menaxhues.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, është themeluar me Ligjin nr. 04/L-090 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit me nr. 03/L-98 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Ndërsa në bazë të Rregullores nr. 01/2012 për detyrat, përgjegjësitë, kompetencat dhe strukturën organizative të AZHB-ës të datës 09.01.2013, Agjencia është përgjegjëse për implementimin e programeve për mbështetje në bujqësi dhe zhvillim rural.

Për zbatimin e masave dhe programit për mbështetje përmes subvencioneve dhe granteve rurale, AZHB ka themeluar platformën softuerike duke u bazuar në Rregulloren e BE-së 1306/2013 për Pagesa Direkte dhe Rregulloren e BE-së nr. 1303/2013 për Grantet Rurale. Gjithashtu në AZHB ekziston edhe Regjistri Elektronik i Fermerëve, në të cilin regjistrohen fermerët me të gjitha të dhënat personale dhe koordinatat e fermës, të dhënat për tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, të dhënat për mekanizëm si dhe vendi dhe data e regjistrimit.

Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (SIPT)

Sa i përket zhvillimeve institucionale, respektivisht Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (SIPT) në kuadër të AZHB ekziston edhe programi i identifikimit të parcelave. Ky program mundëson digjitalizimin e të gjitha parcelave të kulturave bujqësore që subvencionohen nga AZHB-ja për sipërfaqe. SIPT është i lidhur edhe me kadastrën e tokës, ku përmes geoportalit shfrytëzohen të dhënat e parcelave, ndërsa SIPT-Mobile është modul i SIPT i cili përdoret nga Inspektorët për kontroll në teren. Përmes këtij moduli inspektorët shohin të gjitha parcelat e digjitalizuara që kanë aplikuar për subvencione. Gjithashtu ky modul lidhet edhe me GPS. Përmes sistemit të LPIS është bërë aplikimi për 27 kultura bujqësore në vitin 2014, ndërsa tanimë MBPZHR posedon edhe ortofotot e vitit 2012.

Agjencioni disponon edhe me Programin për Menaxhimin e Granteve i cili përmban pesë module: Moduli për Aplikim për Grante dhe Kërkesës për Pagesë në të cilin bëhet aplikimi për grante sipas masave dhe nën-masave dhe plotësimi i kërkesës për pagesë; Moduli për Menaxhimin e Granteve me të cilin bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve dhe poentimi sipas kriterëve të UA, si dhe përpilimi i kontratës që nënshkruan AZHB-ja me fermer; Moduli i Autorizimit të Pagesave ku bëhet kalkulimi i pagesave dhe përpilimi i vendimeve për pagesë; Moduli i Kontrollit në Teren me të cilin bëhet pranimi i lëndëve për kontroll në teren caktimi i inspektorëve për kontroll në teren; dhe Moduli i Pagesave Direkte me të cilin bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve, përzgjedhja e mostrës për kontroll, kalkulimi i pagesave, hartimi i listës për pagesë dhe përpilimi i vendimeve.

Përveç këtyre programeve ekziston edhe Softueri për Indikator i cili është i lidhur me Grant Menaxhmentin në të cilin regjistrohen indikatorët matës të projekteve gjatë kohës së aplikimit.

Programet softuerike të zhvilluara deri më tani janë bazë e mirë për krijimin e Sistemit të Administrimit të Integruar dhe Sistemit të Kontrollit (SAISK) gjatë periudhës 2016-2018 duke zhvilluar edhe modulet e sistemit për kontroll të integruar, modulën e të drejtave të menaxhimit dhe modulën e kontabilitetit si dhe ndërlihdjen e tyre në mes veti. Programet e përshkruara janë duke u avancuar e sidomos Grant Menaxhmenti, duke shtuar module të reja siç janë moduli për skanimin elektronik të dokumentacionit, menaxhimin të dokumentacionit, menaxhimin të borxhit, analiza e riskut etj. E gjithë kjo punë për zhvillimin e kapaciteteve të TI është duke u bërë në mbështetje të projektit të KE "Mbështetje e mëtutjeshme e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në fuqizimin e strukturës administrative për implementimin dhe monitorimin e fondeve të vendit dhe BE-së në të ardhmen". Buxheti për këtë projekt është 990,860.00 Euro, i cili do të mbështetë AZHB-së deri në tetor të vitit 2016.

AZHB është përkrahur pra, nga Projektet e KE-së (IPA I) si dhe donatorë tjerë si BB, DANIDA, Agro Konsulting European. Në kuadër të AZHB janë 6 divizione me 50 të punësuar.

Sipas analizës së zbrazëtirave, në AZHB ka mungesë të stafit dhe mangësi në strukturë organizative të disa njësive shumë të rëndësishme për funksionim të AZHB-së për implementimin e programeve mbështetëse dhe plotësimin e kriterëve të akreditimit.

Në AZHB është e nevojshme të bëhet ndarja e funksioneve dhe përgjegjësi sipas Anexit 1 të Marrëveshjes Sektoriale dhe nenit 10 (1) të Marrëveshjes Kornizë me të cilën përcaktohen qartë funksionet dhe përgjegjësitë e secilës sektorë brenda AZHB-së. Është e nevojshme që në afatin sa ma të shkurtë të themelohen Drejtoria e Financave, Auditori i Brendshëm, Sektori i Kontrollit të brendshëm.

Masat afatshkurtra

- Themelimi i Njesisë së Auditorit të Brendshëm në kuadër të Agjencisë së Pagesave;;
- Zhvillimi kapacitetëve të TI-së nga projekti i KE "Përkrahje e mëtutjeshme Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përfundimin e strukturës administrative, zbatimin dhe monitorimin e fondeve kombëtare dhe të BE – së";
- Zbatimi i standardeve minimale për operatorët të cilët do të përfitojnë nga skemat e pagesave;
- Përfundimi, menaxhimi dhe kontrolli financiar i pagesave direkte dhe masave për zhvillimin rural duke ndërtuar dhe azhurnuar Regjistrin e Fermave, Regjistrin e Kafshëve dhe Regjistrin e Vreshtave;
- Themelimi i 7 drejtorive: Drejtoria për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural, Drejtoria për Autorizimin e Pagesave, Drejtoria e Pagesave Direkte, Drejtoria e Inspektoratit Teknik, Drejtoria e Regjistrave, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe 20 sektorëve për zbatimin e Programit për Pagesa Direkte dhe Programit të Zhvillimit Rural (masat:101,103,302,303,501 dhe ujitja e tokave bujqësore);
- Rekrutimi i 19 zyrtarëve nga projekti i Bankës Botërore në kuadër të AZHB-së.

Prioritetet afatmesme

- Rekrutimi i 61 zyrtarëve, për implementimin e masave nga programi IPA II;
- Trajnimin permanent, lidhur me procedurat e implementimit dhe përdorimin e programeve softuerike;
- Zhvillimi i moduleve të sistemit për kontroll të integruar;
- Modulit të të drejtave të menaxhimit; dhe
- Modulit të kontabilitetit si dhe ndërlidhjen e tyre në mes veti.

Shërbimet këshillimore

Shërbimet këshilluese teknike në Kosovë janë të rregulluara me Ligjin nr. 04/L--074, për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i përafuar pjesërisht me Rregullores së Këshillit (KE) nr. 73/2009, dt 19 janar 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta për skemat mbështetëse direkte për fermer sipas politikave të përbashkëta bujqësore dhe krijimin e skemave mbështetëse të caktuara për fermerë, që ndryshon Rregulloret (KE) nr. 1290/2005, (KE) nr. 247/2006, (KE) nr. 378/2007 dhe shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003.

Për zbatimin e Ligjit, MBPZHR ka nxjerrë këto Udhëzime Administrative: UA nr. 05/2013 për organizimin, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e shërbimeve këshilluese të nivelit qendror dhe lokal, formën dhe mënyrën e raportimit, dhe UA nr. 07/2014 për plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Organizimin, Përgjegjësitë, të Drejtat dhe detyrimet e Shërbimeve Këshilluese të Nivelit Qendror dhe lokal si dhe formën dhe mënyrën e raportimit.

Për ofrimin e shërbimeve këshilluese kombëtare në mënyre të drejt dhe sa më funksionale në tërë territorin e Kosovës, si dhe për zbatimin e politikave zhvillimore, MBPZHR ka miratuar Strategjinë e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2012 – 2016, nr. 02/87, dt. 17.08.2012.

Bazuar në këtë strategji, shërbimet këshillimore për bujqësi dhe zhvillim rural ofrohen nga dy kanale (burime) kryesore:

- Këshilltarët nga sektori publik (MBPZHR dhe komunat); dhe
- OJQ-të, këshilltarët vendorë dhe ndërkombëtar, kooperativat, furnizuesit e inputeve, veterinarët dhe shoqatat e fermerëve.

Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike si bartes i shërbimeve këshillimore në bashkëpunim dhe bashkërendim me departamentet e tjera të MBPZHR harton informata për ngjarjet/materialet dhe mbështet bujqit në procesin e parashtrimit të kërkesave. Departamenti është i përbërë nga tri divizione: Divizioni i Shërbimeve Këshilluese Teknike, Divizioni i Shërbimeve Fushore të Ekstensionit dhe Divizioni për Monitorim, Koordinim, Informim dhe TI.

Sfide edhe më tutje mbetet konsolidimi i shërbimeve këshilluese si dhe kompletimi i legjislacionit sekondar.

Qeveria e Kosovës është duke mbështetur këtë sektor që nga viti 2009 përmes projektit “Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese “. Projekti ka shumën 117,000.00 Euro për çdo vit kalendarik.

Shërbimet këshilluese përveq KE janë mbështetur edhe nga donator tjerë si BB, GIZ. Shuma e projekteve është rreth 2,154,566.00 Euro.

Masat afatshkurtra

- Përditësimi i strategjisë së shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitet 2016 – 2020;
- Fuqizimi i mëtejshëm i 34 qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural;
- Rritja e numrit të fermerëve dhe palëve tjera me interes deri në 4,500 që marrin trajnime për bujqësi dhe zhvillim rural; dhe
- Promovimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore kombëtare dhe ndërkombëtare për përkrahjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Prioritetet afatmesme

MBPZHR planifikon rritjen e numrit të fermerëve dhe palëve tjera me interes që përfitojnë nga trajnimet sipas vitëve në vijim:

- 4,000 fermerë në vitin 2017;
- 4,200 fermerë në vitin 2018;
- 4,400 fermerë në vitin 2019 dhe
- 4,600 fermerë në vitin 2020.

Politikat doganore (koncesionet tarifore) për produktet bujqësore sipas MSA-së

Importet nga BE

Produktet bujqësore

- Kosova, që nga hyrja në fuqi e MSA-së, do të shfuqizojnë tarifatat doganore për 1,044 nga 2,564 produkte bujqësore nga BE-ja. Ndërsa 164 produkte bujqësore të BE-së tashmë janë të liruara nga tarifa doganore me Ligjin Ligji nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor.
- 256 produkte sensitive bujqësore (180 bujqësore dhe 76 të procesuara bujqësore) të rëndësishme për fermerët e Kosovës do të mbrohen për 7 vjet (*lëngje frutash si lëng molle, mango, luleshtrydhe, kumbulla etj, xhem dhe marmelatë, patate, miell, mish dhe mish i shpezëve si dhe djathë*).
- Tarifa doganore e Kosovës do të reduktohet gradualisht për një periudhë 5-vjeçare për import të kafes dhe produkteve të saj (për llojin e pa pjekur dhe pa kafeinë) nga BE dhe për 7 vite për llojet e kafes me kafeinë (të pjekur dhe pa pjekur).

- 14 produkte kanë qenë të pa-negociueshme dhe nuk janë përfshirë në marrëveshje, gjë që do të thotë se tarifa Kosovare do të mbetet e njëjtë (10%) për ato produkte (që kryesisht përfshijnë produkte të *qumështit dhe krem, kos, patate, molle, verë*).
- Patatja (e papërpunuar), qumështi (me disa produkte të qumështit si kremi dhe jogurti që nuk përmbajnë sheqer ose fruta të shtuar), dhe vera e rrushit nuk janë përfshirë fare në marrëveshje për shkak të rëndësisë që kanë për prodhuesit vendor. Pra, tarifa doganore prej 10% mbetet në fuqi për këto produkte. (Për lloje tjera dhe nën-produkte të këtyre produkteve, tarifat do të hiqen gradualisht brenda 5 dhe 7 viteve).
- 12 produkte shumë të rëndësishme për prodhimin bujqësor të Kosovës (8 bujqësore dhe 4 të përpunuara bujqësore) do të mbrohen për 10 vjet (*produkte të qumështit, fruta dhe perime, ujë, birra dhe produkteve të grurit*).
- Kosova do të shfuqizojë tarifën doganore për 487 produkte të peshkut me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Për 1 produkt të peshkut tarifa doganore e Kosovës do të hiqet gradualisht për 5 vite (makarel), për një produkt peshku (produkte të caktuara trofte) tarifa hiqet gradualisht për 7 vite

Eksporti në BE

Produktet bujqësore

- Tarifat doganore do të hiqen plotësisht (nga hyrja në fuqi) për produkte bujqësore (gjithsej janë 2,564 produkte bujqësore, te përpunuara bujqësore dhe produkte peshku), përveç mishit, verës dhe produkteve të sheqerit.
- BE heq tarifat doganore nga hyrja në fuqi e marrëveshjes për të gjitha produktet e mishit (të freskët dhe të ngrirë) përveç për mishin e viçit ('baby beef'). Për produktet e kafshëve të kapitujeve 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinar (produkte të ndryshme të lëkurës), ku aplikohet tarifa doganore 'ad valorem' (20%) dhe tarifa doganore specifike (20%), eliminimi përfshin vetëm tarifën 'ad valorem'.
- Për produktet e mishit të viçit (baby beef), BE do të fiksojë tarifën doganore të aplikueshme për eksport nga Kosova në BE në 20% tarifë 'ad valorem' dhe 20% tarifë specifike (tarifa preferenciale) brenda limitit të kuotës vjetore prej 475 tonë (shprehur në peshë trupore)
- BE heq tarifat doganore për llojet e kafes me kafeinë nga hyrja në fuqi e marrëveshjes
- Patatja dhe qumështi hyjnë në mesin e produkteve bujqësore për të cilat BE heq tarifat doganore nga hyrja në fuqi e MSA.
- Eksporti në BE i verës së rrushit të freskët dhe 'sparkling wine' koncesionohet/lirohet nga tarifa doganore deri në limitin e caktuar me kuota. për verën e rrushit kuota është 40,000 hektolitër, dhe për 'sparkling wine' kuota është 10,000 hektolitër.
- Trofta dhe Krap: Aplikohet kuota. Tarifa doganore në BE nuk vlen deri në volumin prej 15 tonë për vit për troftë. Kuota për krap është 20 tonë në vit. Pas kësaj sasive, aplikohet tarifa doganore e BE.

3.13. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Kërkesat e MSA-së

Qasja e integruar e BE-së në sigurinë e ushqimit ka për qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda Bashkimit Evropian nëpërmjet masave koherente fermë-deri në-tryezë dhe monitorimit të duhur, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm.

Kapitulli i 12-të mbulon rregullat e detajuara në fushën e sigurisë së ushqimit. Politikat e përgjithshme të gjërave ushqimore vendosin rregullat e higjienës për prodhimin e ushqimit. Për më tepër, *acquis* ofron rregulla të detajuara në fushën e veterinarisë, të cilat janë kyçe për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë e ushqimit me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Në fushën e fitosanitarisë, rregullat e BE-së mbulojnë çështje si cilësia e farës, materiali për mbrojtjen e bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqyeshmëria e kafshëve.

Detyrimi për të përafuar legjislacionin e Kosovës në Kapitullin 12 me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 74 dhe 102 të MSA-së. Neni 102 i MSA-së parasheh këtë bashkëpunim i cili duhet të zhvillohet në mes të Palëve në të gjitha fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e bujqësisë, si dhe në skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produkteve ushqimore, sigurinë ushqimore, fushën veterinare dhe fitosanitare. Bashkëpunimi veçanërisht do të synojë modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial në Kosovë, në veçanti për të arritur kushtet sanitare të BE-së, për të përmirësuar menaxhimin e ujit dhe të zhvillimit rural, si dhe për të zhvilluar aspektet e lidhura të sektorit të pylltarisë në Kosovë dhe mbështetjen e përafritit gradual të legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me *acquis* të BE.

Përveç detyrimeve nga MSA-ja, Kosova po ashtu duhet të përmbushë kërkesat që dalin nga Raporti i Progresit, Studimi i Fizibilitetit dhe nga takimet e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Këto dokumente vënë në pah disa nga fushat kryesore të Kosovës për përmirësim, siç janë ndërtimi i një fabrike për përpunimin e nënprodukteve shtazore dhe masat përcjellëse; lufta kundër tregtisë ilegale me kafshë, sidomos me Serbinë, dhe përmirësimi i mëtejshëm i bazës së të dhënave për identifikimin, regjistrimin dhe lëvizjen e kafshëve; harmonizimi i certifikatave shëndetësore veterinare me shtetin e Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës; mbingritja e stabilimenteve ushqimore; transferimi i inspektorëve komunalë në AUV; miratimi i pakos ligjore; implementimi më sistematik dhe zbatimi i legjislacionit ekzistues; hartimi i planit shumëvjeçar të kontrollit për sëmundjet e kafshëve; zgjerimi i fushës së akreditimit të laboratorit të AUV, si dhe nënshkrimi i kontratës për mirëmbajtje, kalibrim dhe servisim të pajisjeve laboratorike.

Korniza legjislative dhe e politikave në fushën e sigurisë së ushqimit

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me *acquis* të BE-së, të përcaktuar në Rregulloren nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive-Shtojca-14, pika i (krijon politikën dhe zbaton e ligjet për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, blegtorisë, prodhimit dhe mbrojtjes së bimëve, zhvillimit rural dhe vendosjen e standardeve të cilave duhet të zbatohen) dhe pika viii (në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor mbikëqyrë kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve).

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) është institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, si dhe për kontrollet fitosanitare. AUV është themeluar në bazë të Ligjit nr. 21/2004 mbi Veterinarinë dhe është zgjeruar me Ligjin nr. 03/L-016 për Ushqimin.

AUV, si akter kryesor në fushën e sigurisë së ushqimit, zbaton një pjesë të rëndësishme të *acquis* së BE-së nga Pakoja Higjienike.

Në fushën e sigurisë së ushqimit, është miratuar legjislacioni në vijim:

- Ligji nr. 03/L-016 për Ushqimin, i cili rregullon parimet e përgjithshme dhe kërkesat për higjienën e ushqimit dhe ushqimin e sigurtë për njerëz si dhe ushqimin për kafshë, obligimet e subjekteve që ofrojnë me ushqim për njerëz dhe me ushqim për kafshë. Ky ligj adreson edhe çështjen e higjienës dhe ushqimit të sigurtë për njerëz dhe ushqimit për kafshë, kërkesat e përgjithshme që kanë të bëjnë me deklarimin ose emërtimin e ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë, kushtet e përgjithshme për vendosjen në treg të ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë, si dhe të ushqimit i cili përmban organizma të modifikuar gjenetikut ose përbëhen nga to. Për më tepër adreson sistemin e kontrollit zyrtar të ushqimit, laboratorët e autorizuar testues dhe referent, menaxhimin me krizat dhe rastet emergjente, themelimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ky ligj zbatohet në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, deponimit dhe shpërndarjes së ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë, përveç prodhimit primare, përgatitjes, veprimtimit dhe deponimit të ushqimit në ekonominë familjare të cilët nuk janë të destinuara për shitje në treg. Ligji është i përafuar pjesërisht me Rregulloren nr. 178/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;

- Ligji nr. 04/L-114 për Pasurimin e Miellit, i cili përcakton rregullat që zbatohen për pasurimin e miellit për konsum, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve të cilat shkaktohen nga mungesa e hekurit dhe acidit folik dhe sipas gjendjes nutritive dhe në baza vullnetare edhe me vitaminë A, B12 dhe zink, i cili nuk transponon ndonjë legjislacion të BE-së;
- Rregullorja nr. 10/2011 për Kontrollin Zyrtar të Ndërmarrja për të Siguruar Verifikimin e Përputhshmërisë me Ligjin për Ushqimin dhe Ushqimin për Kafshë dhe Rregullave për Shëndetin dhe Mirëqenien e Kafshëve dhe transponon pjesërisht Rregulloren nr. 882/2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregullorja nr. 11/2011 për Higjienën e Prodhimeve Ushqimore, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 852/2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregullorja nr. 12/2011 për Përcaktimin e Rregullave Specifike të Higjienës së Ushqimit me Prejardhje Shtazore, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 853/2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregullorja nr. 13/2011 për Përcaktimin e Rregullave Specifike për Organizimin e Kontrolleve Zyrtare të Ushqimit me Prejardhje Shtazore të Dedikuara për Konsum nga Njerëzit, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 854/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregullorja nr. 27/2012 për Kriteret Mikrobiologjike të Produkteve Ushqimore, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 2073/2005;
- Rregullorja nr. 17/2012 për Caktimin e Lartësisë së Pagesës së Shërbimeve të Agjencisë, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 882/2004 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian;
- Rregullorja (MTI) nr. 09/2013 për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 1169/2011 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian;
- Rregullorja nr. 28/2013 për Aditivët Ushqimorë, e cila transponon pjesërisht Rregulloret e BE-së Nr. 1331/2008, Nr. 1332/2008; nr. 1333/2008 dhe Rregullorja nr. 1334/2008;
- Rregullorja nr. 43/2013 për Caktimin e Niveleve Maksimale për Kontaminues të Caktuar në Produkte Ushqimore për Njerëz dhe Substanca të Padëshirueshme në Ushqim për Kafshë, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 1881/2006 dhe Rregulloren nr. 333/2007 të Komisionit Evropian.

AUV ka kryer një vlerësim të bizneseve agro-ushqimore në Kosovë (industria e qumështit, mishit, thertoreve, depove ftohtëse dhe produkteve të qumështit). Aktualisht ka 125 operatorë aktiv të biznesit të ushqimit dhe 11 operatorë joaktiv që merren me produkte me origjinë shtazore. AUV ka miratuar edhe 25 operatorë nga vendet e rajonit, të cilët kanë të drejtë të importojnë produkte ushqimore me origjinë shtazore në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të procedurave për miratimin e operatorëve të biznesit ushqimor, AUV ka krijuar një skemë të rregullt për kontrollet zyrtare. Operatorët e biznesit ushqimor janë kategorizuar në bazë të rrezikut nëpër grupe (të ulët, të mesëm dhe të lartë) dhe janë paraparë tre deri në gjashtë kontrolle në vit.

Plani Vjetor Kombëtar i Kontrolleve dhe Mostrimit përfshin shpeshhtësinë e kontrolleve zyrtare të institucioneve të vendit, kontrollet kufitare, planin kombëtar të monitorimit të mbetjeve dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve. Këto shpeshhtësi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të kryera gjatë procesit të kategorizimit, ndërsa mostrimi është planifikuar sipas rregullave të miratuara me Rregulloren nr. 27/2012 mbi Kriteret Mikrobiologjike.

Drejtoria e cila merret me çështjet e sigurisë ushqimore në kuadër të AUV është Drejtoria e Shëndetit Publik, e cila ka të punësuar 5 (pesë) zyrtarë.

Laboratori

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë i AUV ka filluar veprimtarinë në vitin 2007. Në vitin 2008 dhe 2009 respektivisht janë ndërtuar ndërtesat e Laboratorit të Ushqimit dhe Laboratorit të Shëndetit të Kafshëve. Këto janë të ndara në sektorë, si vijon:

- Sektori i Mikrobiologjisë Ushqimore dhe Preparatorisë;
- Sektori i Kimisë Ushqimore dhe Mbetjeve Veterinare;
- Sektori i Analizave të Qumështit;

- Sektori i Serologjisë dhe Diagnostikës Molekulare;
- Sektori i Bakteriologjisë; dhe
- Sektori i Pato-Anatomisë.

Funksionet dhe detyrat e Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë (LUV) janë të rregulluara me Ligjin nr. 2004/21 për Veterinarinë (neni 38,39,40, 41 dhe 42), ndërsa sipas Udhëzimit Administrativ MA-NR. 21/2007 të datës 14.08.2007 janë përcaktuar: funksioni, kompetencat dhe përgjegjësitë e LUV.

Fushëveprimi i LUV përfshin testimin e parametrave fizik, kimik dhe mikrobiologjik të ushqimit me prejardhje shtazore, mbetjeve në ushqim dhe ushqimit të kafshëve. LUV poashtu monitoron dhe diagnostifikon sëmundjet e kafshëve, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të kafshëve, shëndetit publik dhe sigurisë ushqimore.

LUV është i pajisur me pajisje bashkëkohore dhe mbështetje kompjuterike, ashtu që të mund të testojë produktet me metodat e testimit nga fusha e zbatimit të akreditimit. LUV është akredituar nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës me standardin ISO 17025 me 11 shkurt 2014 dhe është rivlerësuar me 12 dhe 13 shkurt 2015. LUV ka të akredituara 50 metoda për analizimin e ushqimit dhe diagnostifikimin e sëmundjeve të kafshëve.

Momentalisht, në LUV janë të punësuar 32 punonjës. Stafi i LUV është profesional dhe në mënyrë të vazhdueshme ka qenë pjesë e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit. Momentalisht në LUV ekziston projekti i cili financohet nga BE dhe do të bëjë trajnimin e punonjësve të Laboratorit të Shëndetit të Kafshëve në diagnostifikimin e sëmundjeve. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015 do të fillojë edhe projekti tjetër i financuar nga BE i cili do të bëjë ngritjen e kapaciteteve të stafit të Laboratorit të Ushqimit, gjegjësisht Sektorit të Mikrobiologjisë Ushqimore dhe Preparatorisë dhe Sektorit të Kimisë Ushqimore dhe Mbetjeve Veterinare.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë po ashtu ka rolin e saj në çështjet e sigurisë së ushqimit në bazë të Ligjit nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, nga i cili ka rrjedhur Rregullorja (MTI) Nr 09/2013 për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 1169/2011.

Masat afatshkurtra

Sa i përket fushës së sigurisë së ushqimit, gjatë vitit 2016 planifikohet miratimi i legjislacionit të mëposhtëm, i cili do të transpozojë pjesërisht legjislacionin e BE-së:

- Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-016 për Ushqimin, i cili përcakton rregullat e përgjithshme dhe kërkesat për higjienën e ushqimit dhe ushqimin e sigurt për njerëz dhe ushqimin për kafshë, si dhe themelimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ky ligj zbatohet në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, deponimit dhe shpërndarjes së ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë, përveç prodhimit primare, përgatitjes, veprimit dhe deponimit të ushqimit në ekonominë familjare që nuk është i destinuar për shitje në treg. Ligji do të jetë i përafëruar pjesërisht me Rregulloren nr. 178/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të dt. 28 janar 2002;
- Rregullorja për Miratimin dhe Regjistrimin e Operatorëve të Biznesit për Ushqim për Kafshë, bazuar në Ligjin nr. 03/L-016 për Ushqimin dhe Rregulloren nr. 10/2011 mbi Kontrollin Zyrtar të kryera për të siguruar verifikimin e pajtueshmërisë me Ligjin mbi ushqimin për kafshë dhe ushqimin, Rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, dhe do të përafërohet pjesërisht me Rregulloren nr. 882/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;
- Rregullorja mbi Përcaktimin e Rregullave Shëndetësore për Nënproduktet e Kafshëve dhe Derivatet e Tyre të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor, e cila do të përafërohet pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 1069/2009 dhe Rregulloren (KE) nr. 142/2011;
- Rregullorja mbi materialet dhe artikujt që janë të destinuara të jenë në kontakt me ushqimin, e cila do të përafërohet pjesërisht me Rregulloren (KE) Nr 1935/2004;
- Strategjia për Avancimin e Operatorëve të Biznesit me Ushqim (OBU), e cila do të bazohet në veprime të cilat duhet të ndërmerren nga operatorët me qëllim të arritjes së standardeve të BE;

- Plani Vjetor Kombëtar për Kontrollë Zyrtare dhe Mostrim, përfshirë Planin për Monitorimin e Mbetjeve;
- Plani i trajnimit për çështjet e sigurisë ushqimore për inspektorët dhe Operatorët e Bizneseve Ushqimore, përmes së cilit trajnim do të shpërndahen informacione mbi aplikimin e njohurive teknike në lidhje me standardet e sigurisë ushqimore, praktikat e mira të prodhimit dhe higjienës, parakushtet për miratim dhe praktikat e mostrimit.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, në vitin 2016 planifikohen këto aktivitete:

- Transferimi i inspektorëve të sigurisë ushqimore nga niveli komunal në AUV;
- Trajnime mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të reja për stafin e laboratorit; financuar nga projektet e Asistencës Teknike të BE-së;
- Aktivitete arsimore dhe trajnuese për Operatorët e Biznesit me Ushqim dhe zyrtarët që do të kryejnë detyrat për zbatimin e rregullave higjienike;
- Aplikimi për zgjerim të fushës së akreditimit me metoda të reja për siguri ushqimore dhe cilësi, si dhe për diagnostifikimin e sëmundjeve të kafshëve;
- Përgatitja e specifikave teknike për tenderin për mirëmbajtje, servisim dhe kalibrim të pajisjeve laboratorike;
- Rekrutimi i dy (2) ekspertëve në Drejtorinë e Shëndetit Publik;
- Avancimi dhe funksionalizimi i sistemit të teknologjisë informativë për e-inspektimet si dhe ngritja e kapaciteteve teknike përmes projektit të financuar nga BE në kuadër të IPA 2015, në vlerë prej 2,000,000.00 Euro;
- Kërkesa për ekspertizë nga programi i TAIEX me qëllim të kryerjes së analizës së zbrastësirave ligjore në nivelin nacional për politikën sanitare, përmes së cilës do të ofrohet një pasqyrë e nivelit të transpozimit të legjislacionit të BE-së në nivelin nacional dhe të identifikohen hapat që duhet ndërmarrë për të vazhduar përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit nacional me *acquis*.

Prioritetet afatmesme

Sa i përket aktiviteteve legjislative mbi sigurinë e ushqimit, është paraparë që gjatë periudhës 2017-2020 të miratohen rregulloret e mëposhtme, të cilat do të transpozojnë pjesërisht legjislacionin e BE-së:

- Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar, i cili do të përafrohet me legjislacionin e BE-së që pritet të identifikohet pas analizës së zbrastësirave në këtë sektor;
- Rregullorja për Aditivët Ushqimorë, bazuar në Direktivën 2002/46/KE dhe Rregulloret që plotësojnë këtë direktivë;
- Rregullorja për Produkte Ushqimore me Ngrirje të Shpejtë, bazuar në Direktivën e Këshillit 89/108/KEE;
- Rregullorja për Ujërat Minerale, bazuar në Direktivën 2009/54/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregullorja mbi Ushqimet e Reja (Novel Food) dhe Përbërësit e Rinj Ushqimor, bazuar në Rregulloren (KE) Nr 258/97;
- Rregullorja për Cilësinë e Qumështit, e cila përcakton zhvillimin e strategjisë për qumështin e freskët nga ferma në pikat e përpunimit. Kjo rregullore do të jetë kombëtare dhe do të përcaktojë rregullat për trajtimin e qumështit të freskët, i cili nuk është në përputhje me rregulloren për pakon higjienike;
- Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në baza vjetore, sipas Udhëzimit Administrativ MA nr. 26/2005 "Për masën mbi monitorimin e substancave të caktuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore"; dhe
- Ndërtimi i fabrikës për përpunimin e mbetjeve shtazore.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve njerëzore, gjatë periudhës 2017 – 2020 planifikohet:

- Trajnimi i personave kompetentë nga Operatorët e Biznesit të Ushqimit mbi zbatimin e rregullave të reja në lidhje me prodhimin, përpunimin, shpërndarjen dhe vendosjen e produkteve në treg, ku AUV do të ofrojë të gjitha programet dhe dokumentet e nevojshme (udhëzimet dhe PSO-të) për të lehtësuar zbatimin;
- Rekrutimi i pesë (5) ekspertëve në Drejtorinë e Shëndetit Publik.

Njëjtë sikurse në fushën e sigurisë ushqimore, edhe në fushën e veterinarisë MBPZHR është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me *acquis* të BE-së, përderisa AUV është institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

Politikat e veterinarisë në Kosovë janë të rregulluara me tri ligje të cilat janë të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, si në vijim:

- Ligji nr. 2004/21 mbi Veterinarinë, i cili rregullon funksionimin e përgjithshëm të sektorit veterinar në Kosovë dhe nuk transponon ndonjë legjislacion të BE-së;
- Ligji nr. 02/L-10 për Mirëqenien e Kafshëve, i cili rregullon mbajtjen, kujdesin, strehimin, mbarështimin, transportimin dhe çështjet tjera lidhur me mirëqenien e kafshëve, i cili nuk transponon ndonjë legjislacion të BE-së;
- Ligji nr. 03/L-016 mbi Ushqimin, i cili rregullon parimet e përgjithshme dhe kërkesat që kanë të bëjnë me higjienën e ushqimit dhe ushqimin e sigurt për njerëz si dhe ushqimin për kafshë, obligimet e subjekteve që afarojnë me ushqim për njerëz dhe me ushqim për kafshë sa i përket higjienës dhe ushqimit të sigurt për njerëz dhe ushqimit për kafshë;
- Ligji nr. 02/L-111 për Bletari, i cili rregullon mbarështimin e bletëve, masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve, mbikëqyrjen e objekteve të prodhimit dhe ruajtjes së prodhimeve të bletëve dhe i cili nuk transponon ndonjë legjislacion të BE-së.

Politikat e veterinarisë plotësohen me udhëzime relevante administrative, të cilat kanë për qëllim zbatimin e detyrave të veçanta të përcaktuara në legjislacionin primar. Këto dokumente janë zhvilluar duke transpozuar pjesërisht legjislacionin përkatës të BE-së:

- UA nr. 12/2012 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve, bazuar në Rregulloren (KE) nr. 1760/2000 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 820/97; Rregulloren (KE) nr. 494/98 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullosës së Këshillit (KE) Nr 820/97; Rregulloren (KE) nr. 911/2004 që zbaton Rregulloren (KE) nr. 1760/2000 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Rregulloren (KE) nr. 21/2004 që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003 dhe Direktivat 92/102/KEE dhe 64/432/KEE; dhe Direktivën 2008/71/KE.

Fusha e veterinarisë është poashtu e rregulluar me legjislacion sekondar kombëtar, përkatësisht me rregullore si dhe PSO të cilat rregullojnë ndalimin e lëvizjes së lirë dhe marketingut të shpezëve të gjalla në mënyrë që të parandalojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, ndalimin e importimit të shpezëve të freskëta, ruajtjen e ushqimit për shpezë nga sëmundjet ngjitëse, importin e produkteve me origjinë shtazore nga BE-ja, thjeshtësimin e procedurave të importit dhe lejimin e importit nga shtetet e BE-së pa leje importi.

Importimi i kafshëve të gjalla

Sa i përket importit të kafshëve të gjalla, me qëllim të luftimit të tregut ilegal të kafshëve të gjalla, në kuadër të IBM-së është themeluar një grup punues. Anëtarët e grupit punues janë përfaqësues të Policisë së Kosovës, Doganave dhe AUV-it. Ky grup punues takohet rregullisht dhe ka miratuar PSO-në mbi konfiskimin e mallrave të kontrabanduara. Institucionet e lartpërmendura kryejnë veprime të përbashkëta të rregullta.

Shëndeti i kafshëve

Përveç me Ligjin nr. 2004/21 për Veterinarinë, sektori i veterinarisë rregullohet me Ligjin nr. 03/L-016 mbi Ushqimin dhe Rregulloret mbi Pakon Higjienike. Sa i përket shëndetit të kafshëve, janë miratuar aktet nënligjore në vijim:

- UA MA-Nr. 33/2006 mbi Masat për Kontrollin e Mortajës Klasike të Derrave, bazuar në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1251/2008 që zbaton Direktivën e Këshillit 2006/88/KE;
- UA MA-Nr. 27/2006 mbi Kontrollin, Parandalimin dhe Çrrënjosjen e Sëmundjes „Afta Epizootike“ në Kosovë, bazuar në Direktivën e Këshillit 2003/85/KE që shfuqizon Direktivën 85/511/KEE dhe Vendimet 89/531/KEE dhe 91/665/KEE dhe ndryshimin e Direktivës 92/46/KEEAI V_UA_2004_07;

- UA MA-Nr. 24/2005 për Luftimin e Sëmundjes Zoonotike të Shpezëve “Gripi i Shpezëve” bazuar në Direktivën e Këshillit 2005/94/KE që shfuqizon Direktivën 92/40/KEE.

Plani i Kontrollit Kombëtar Vjetor hartohet nga AUV dhe qëllimi i tij është mbrojtja e shëndetit publik dhe të kafshëve. Me këtë plan parashihen masat të cilat të ndërmerren në parandalimin, zbulimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive dhe parazitare të kafshëve.

Mirëqenia e kafshëve

Mirëqenia e kafshëve në Kosovë rregullohet me Ligjin nr. 02/L-10 mbi Mirëqenien e Kafshëve, shoqëruar nga legjislacioni sekondar në vijim:

- UA MA-Nr. 31-2006 për Transportimin e Kafshëve, bazuar pjesërisht në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1/2005 dhe që ndryshon Direktivat 64/432/KEE dhe 93/119/KE dhe Rregulloren (KE) nr. 1255/97;
- UA MA-Nr. 24-2006 për Therjen Humane të Kafshëve, bazuar pjesërisht në Direktivën e Këshillit 93/119/KE;
- Rregullorja nr. 12/2014 për Përcaktimin e Standardeve Minimale për Mbrojtjen e Viçave, bazuar pjesërisht në Direktivën e Këshillit 2008/119/KE;
- Rregullorja nr. 17/2014 për Mbrojtjen e Kafshëve të Cilat Mbahen për Qëllime Blegtorale, bazuar pjesërisht në Direktivën e Këshillit 98/58/KE;
- Rregullorja nr. 03/2015 për Përcaktimin e Standardeve Minimale për Mbrojtjen e Derrave, bazuar pjesërisht në Direktivën e Këshillit 2008/120/KE.

Ushqimi për kafshë

Ushqimi për kafshë rregullohet me Ligjin nr. 03/L-016 mbi Ushqimin, si dhe:

- Rregulloren nr. 43/2014 për Përcaktimin e Nivelit Maksimal të Kontaminuesve të Caktuar në Produktet Ushqimore dhe Substancat e Padëshiruara në Produktet për Ushqimin e Kafshëve, që transponon pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 1881/2006 të Komisionit, siç ndryshohet me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1126/2007 dhe Rregulloren (KE) nr. 565/2008.

Ushqimi për kafshë gjithashtu rregullohet me akte tjera nënligjore kombëtare, si:

- UA MA-Nr. 26/2005 mbi Masat për Monitorimin e Materieve të Caktuara dhe Mbetjeve të tyre në Kafshët e Gjalla dhe në Produktet me Prejardhje Shtazore, i cili është i bazuar pjesërisht në Direktivën e Këshillit 96/23/KE që shfuqizon Direktivat 85/358/KEE dhe 86/469/KEE dhe Vendimet 89/187/KEE dhe 91/664/KEE, Vendimin e Komisionit 97/747/KE i bazuar në Direktivën e Këshillit 96/23/KE dhe Vendimin e Komisionit 98/179/KE.

Kontrolli kufitar veterinar

Kontrolli kufitar veterinar bazohet në Ligjin nr. 03/L-016 mbi Ushqimin dhe Ligjin nr. 21/2004 për Veterinarinë, si dhe aktet nënligjore:

- UA nr. 18/2005 për Kontrollin Veterinar të Importimit, Kalimit Transit të Produkteve Ushqimore dhe Joushqimore me Origjinë Shtazore, të Kafshëve të Gjalla dhe të Materialit për Mbarështimin e Kafshëve, e cila është transponon pjesërisht Direktivën 91/496/KEE dhe Direktivën 97/78/KE;
- Rregullorja 18/2012 për Përcaktimin e Kushteve të Shëndetit të Kafshëve, Shëndetit Publik dhe Certifikimin Veterinar për Qumësht dhe Produkte të Qumështit, e cila transponon pjesërisht Rregulloren e Komisionit (EU) nr. 605/2010.

Aktualisht, kontrollet kryhen në nëntë (9) pika të kontrollit kufitar, respektivisht në Vërmicë, Han të Elezit, Dheu i Bardhë, Merdare, Stançiq, Jarinjë, Kullë, Aeroport dhe Hekurudha. Kriteret mikrobiologjike të kontrolleve zyrtare në pika të kontrollit janë të bazuara në Rregulloren 27/2012 për Kriteret Mikrobiologjike në Produktet Ushqimore, e cila transponon pjesërisht Rregulloren nr. 2073/2005 të BE-së. Duhet të ceket se sistemi TRACES është duke u shfrytëzuar 100% për eksport në shtetet e BE-së për produkte joushqimore me prejardhje shtazore (animal by-products), ndërsa për import shfrytëzohet pjesërisht në dy pika kufitare, përkatësisht në Han të Elezit dhe Merdare.

Inspektimi veterinar në Republikën e Kosovës rregullohet gjithashtu me legjislacion kombëtar që nuk transponon ndonjë Direktivë të KE, siç është Ligji nr. 2004/33 për Blegtorinë dhe UA-të përcjellëse që

rregullojnë çështje si, kriteret për kontrollimin e cilësisë për ushqimin e kafshëve dhe aditivëve, përbërësit e ushqimit për kafshët, përcaktimin e çështjeve mbi ushqimin e përbërë të kafshëve dhe themelimin e komisioneve punuese për ushqimin për kafshë, që ndihmojnë institucionet dhe subjektin e afarizmit me ushqimin për kafshë.

Laboratori

Shih "Laboratori" në nën-kapitullin "Siguria Ushqimore".

Qeverisja Lokale

Përveç inspektorëve në nivel të AUV, kontrollet zyrtare kryhen edhe nga inspektorët komunalë sanitarë, bujqësorë dhe veterinarë. Në mënyrë që të ketë qasje të unifikuar dhe të integruar të kontrolleve, është kërkesë edhe e KE që inspektorët komunalë të transferohen në kuadër të Agjencisë. Sidoqoftë, në mënyrë që të ndodhë një transferim i tillë, duhet të amandamentohet Ligji nr. 03/L-049 mbi Financat e Pushtetit Lokal, i cili pritet të ndryshohet dhe miratohet gjatë vitit 2016.

Drejtoria e cila merret me çështjet veterinarë në kuadër të AUV është Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve. Kjo drejtori ka të punësuar 14 (katërmbëdhjetë) zyrtarë.

Sa i përket kapaciteteve të inspektoratit veterinar kufitar, të punësuar në sektor janë: një (1) shef i sektorit, 14 inspektorë veterinarë dhe dy (2) zyrtarë për menaxhimin e mostrave nga Pikat e Kontrollit Kufitar.

Masat afatshkurtra

Përveç planifikimit për kontrollin e sëmundjeve dhe programeve të gjurmimit, korniza ligjore në vitin 2016 do të plotësohet me legjislacion në fushën e ushqimit për kafshë dhe mirëqenien e kafshëve. Disa nga aktet ligjore dhe nënligjore që do të miratohen në vitin 2016 janë:

- Ligji nr. 2004/21 për Veterinarinë, me të cilin rregullohet luftimi dhe parandalimi i sëmundjeve infektive të kafshëve, praktikat mjekësore veterinarë, qarkullimi i kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, kontrolli veterinar i importit, eksportit dhe kalimit transit të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të institucioneve qeveritare dhe komunale si dhe të individëve në këtë fushë. Ligji do të transpozohet pjesërisht Direktivat e Këshillit: 64/432/KEE; 77/391/KEE; 78/52/KEE; 88/407/KEE; 80/1095/KEE; 82/894/KEE; 89/556/KEE; 90/429/KEE; 91/68/KEE; 92/35/KEE; 92/65/KEE; 92/66/KEE; 92/118/KEE; 92/119/KEE; 2000/75/KE; 2000/258/KE; 2001/89/KE; 2002/60/KE; 2002/99/KE; 2003/85/KE; 2004/68/KE; 2009/156/KE; 2005/94/KE; 2006/88/KE; 2008/71/KEE; 2009/158/KE; Vendimet e Këshillit 91/666/EEC dhe 95/410/KE; Rregulloret nr. 1760/2000 dhe nr. 21/2004.
- Rregullorja për Miratimin dhe Regjistrimin e Operatorëve të Biznesit me Ushqim për Kafshë, bazuar pjesërisht në Rregulloren 852/2004/KE; Direktivën 98/51/KE; Rregulloren 882/2004/KE;
- Rregullorja mbi Përdorimin e Ushqimit për Kafshë, bazuar pjesërisht në Rregulloren (KE) nr. 767/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1831/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 79/373/KEE, Direktivën e Komisionit 80/511/KEE, Direktivat e Këshillit 82/471/KEE, 83/228/KEE, 93/74/KEE, 93/113/KE dhe 96/25/KE dhe Vendimi i Komisionit 2004/217/KE;
- UA lidhur me Ndalimin e Përdorimit në Ferma të Substancave të Caktuara të cilat kanë Veprim Hormonal ose Tireostatik dhe ß-agonistët, bazuar pjesërisht në Direktivën e Këshillit 96/22/KE dhe shfuqizimin e Direktivave 81/602/KEE, 88/146/KEE dhe 88/299/KEE;
- Rregullorja mbi Substancat Aktive Farmakologjike dhe Klasifikimin e Tyre Sipas Limitit Maksimal të Mbetjeve në Artikuj Ushqimorë me Origjinë Shtazore, bazuar pjesërisht në Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 37/2010;
- UA lidhur me Futjen në Treg dhe Administrimin e Somatotropinës së Gjedit, bazuar pjesërisht në Vendimin e Këshillit 1999/879/KE dhe shfuqizimin e Vendimit 90/218/KEE;
- UA lidhur me Performancën e Metodave Analitike dhe Interpretimi i Rezultateve, bazuar pjesërisht në Vendimin e Komisionit 2002/657/KE që zbaton Direktivën e Këshillit 96/23/KE;
- Realizimi i një ankete me qëllim identifikimin e sëmundjeve në tërë territorin e Kosovës përmes së cilës do të bëhet monitorimi i gjendjes epidemiologjike në vend dhe rajon dhe të merren masat

adekuate, si dhe të përgatitet parandalimi, minimizimi dhe luftimi i sëmundjeve endemike dhe ekzotike në vend;

- Planet e kontigjencës për sëmundjet e kafshëve;
- Plani shumëvjeçar për kontrollin dhe eradikimin e sëmundjeve të kafshëve;
- Përgatitja e planit vjetor kombëtar duke u bazuar në gjendjen epidemiologjike nga vitet paraprake.

Aktivitetet në vijim poashtu planifikohet të zhvillohen në vitin 2016:

- Vaksinimi i deleve dhe dhive në tërë territorin e Kosovës kundër sëmundjes së brucelozës (*Brucella melitensis*);
- Vaksinimi i derrave në tërë territorin e Kosovës kundër mortajës klasike të derrave;
- Vaksinimi kundër tërbimit, ekinokokozës dhe dehelmintizimi i qenve në tërë territorin e Kosovës;
- Vaksinimi i pulave kundër sëmundjes Newcastle;
- Furnizimi me medikamente për kafshë kundër rriqrave për shkak të sëmundjes së etheve hemorragjike Krime Kongo në komunat e Malishevës, Suhareke, Rahovec dhe Klinë.
- Hulumtime përmes gjakut mbi sëmundjet infektive të gjedhit, si bruceloza, leukoza dhe gjuha e kaltër;
- Gjurmimi i sëmundjes së TBC-së dhe mastitit tek gjedhi;
- Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve shtëpiake.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe njerëzore planifikohet:

- Krijimi i sektorit të ushqimit për kafshë;
- Rekrutimi i tre personave në sektorin e ushqimit për kafshë;
- Transferimi i inspektorëve veterinarë nga niveli komunal në AUV;
- Blerja e materialeve shoqëruese dhe pagesa e veterinarëve për aktivitetet e planifikuara, me buxhet të aprovuar në shumë prej EUR 1,274,000.00;
- Aftësimi profesional i zyrtarëve nga drejtoria e laboratorit dhe drejtoria e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve përmes projektit të AT;
- Blerja e materialit biologjik për kryerjen e aktiviteve të vaksinimit për vitet 2016-2017, e cila do të realizohet përmes një projekti të financuar nga BE.

Prioritetet afatmesme

Kosova do të marrë parasysh ndryshimet në *aquis* të BE-së në të ardhmen dhe, si rezultat, do të sigurojë ndryshimin e legjislacionit kombëtar mbi politikat veterinarë bazuar në atë të BE-së.

Gjatë periudhës 2017-2020, planifikohet të përafrohet legjislacioni në vijim me atë të BE-së:

- Ligji nr. 02/L-10 për Përkujdesjen (Mirëqenien) ndaj Kafshëve, që rregullon kujdesin, strehimin, mbarështimin, transportimin dhe çështje të tjera të lidhura me përkujdesjen ndaj kafshëve, i cili ligj do të transpozohet pjesërisht Rregulloren Nr. 998/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Rregulloren e Komisionit Nr. 1082/2003, Direktivën e Këshillit 88/166/KEE dhe Direktivën e Këshillit 98/58 EC.

Me qëllim të përmirësimit të sektorit të veterinarisë, disa nga aktivitetet që do të ndërmerren gjatë periudhës 2017-2020 janë:

- Krijimi i sistemeve për kontrollin e sëmundjeve;
- Gjurmimi i sëmundjeve;
- Sistemet për monitorimin e sëmundjeve;
- Parapërgatitja për emergjenca;
- Menaxhimi efikas i epidemive të sëmundjeve;
- Eliminimi dhe çrrënjësja e sëmundjeve;
- Funkcionalizimi i plotë i sistemit për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, duke përfshirë lëvizjen e tyre, raportimin e ngordhjeve, therjeve dhe lejitimit në treg;

- Krijimi i sistemit të monitorimit të produkteve mjekësore veterinarë në tërë territorin e Kosovës dhe kontrollit të ushqimit për kafshë, duke përfshirë nivelet e importit dhe prodhimit primar vendor.

Gjatë kësaj periudhe do të fuqizohen edhe kapacitetet administrative/profesionale për të përmirësuar implementimin e legjislacionit dhe politikave në vend.

Korniza legjislative dhe e politikave në fushën e fitosanitarisë

Politikat e fitosanitarisë në Kosovë rregullohen me legjislacionin në vijim i cili është transpozuar pjesërisht me *acquis* të BE-së:

- Ligji nr. 03/L-029 për Inspektoratin Bujqësor, i cili nuk është i përafuar me legjislacionin e BE-së dhe përcakton organizimin, kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit në punët inspektuese në fushat e bujqësisë, siç janë: tokat bujqësore, mbrojtja e bimëve, pylltarisë etj. Në kuadër të këtij ligji, inspektori bën kontrollin e hapësirave afariste, objekteve, pajisjeve, veglave, prodhimit, përpunimit, qarkullimit, transportit, eksportit, importit dhe tranzitit të mallrave;
- Ligji nr. 02/L-95 mbi Mbrojtjen e Bimëve, i përafuar pjesërisht me Direktivën 2000/29/KE. Ligji ka për qëllim mbrojtjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera, zbatimin e masave mbrojtëse biologjike të bimëve, përcaktimin e përgjegjësive dhe masave për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm për bimë, produkte bimore, objekteve të tjera dhe çrrënjosjen e tyre, mbledhjen dhe shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave me vendet tjera, financimin dhe kompensimin për kryerjen e punëve në mbrojtjen e bimëve, si dhe përcaktimin e obligimeve të organeve kompetente për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe punët e inspektorit fitosanitar;
- Ligji nr. 03/L-042 mbi Produktet për Mbrojtjen e Bimëve, i përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 91/414/KEE, kurse udhëzimet e nxjerra nga ky ligj janë të bazuara në: Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 1107/2009, e cila shfuqizon Direktivën e Këshillit nr. 79/117/KEE dhe Direktivën nr. 91/414/KEE; Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nr. 1272/2008, e cila shfuqizon Direktivën nr. 67/548/KEE dhe 1999/45/KE, Rregulloren e KE nr. 1907/2006; Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian nr. 396/2005 për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 91/414/KEE. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i vendosjes në treg dhe kontrolli i substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, autorizimin, qarkullimin, përdorimin, mbetjeve në bimë dhe produkte të bimëve, mbajtjen e shënimeve të personave fizik dhe juridik të përfshirë për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, kërkesat teknike për pajisje të përdorura për zbatim dhe elementet e tyre, përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe monitorimin e tij;
- Ligji nr. 03/L-016 mbi Ushqimin, i përafuar pjesërisht me Rregulloren nr. 178/2002 të Parlamentit Evropian, që përcakton parimet dhe kërkesat e përgjithshme të ligjit për ushqimin, si dhe masat e sigurisë sipas Rregullores 2008/630/KE;
- Ligji nr. 2004/13 për Materialin Fidanor që rregullon çështjet e ndërlidhura me prodhimin, tregtinë, importin, eksportin e materialit fidanor, si dhe regjistrimin e prodhuesve dhe tregtarëve të materialit fidanor dhe i përafuar me Direktivën nr. 2008/72/KE;
- Ligji nr. 2003/5 për Farërat e Kosovës, i cili nuk është i përafuar me legjislacionin e BE-së dhe rregullon çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtimin me farëra të varieteteve bimore dhe patateve për farë në prodhimtarinë bujqësore. Aplikohet për farërat e varieteteve të ndryshme bimore në prodhimtarinë bujqësore dhe patateve për farë si të vendit po ashtu edhe nga importi të synuara për prodhim dhe marketing në Kosovë. Ky Ligj nuk është i përafuar me legjislacionin e BE-së.
- Ligji nr. 2003/10 mbi Plehrat Artificiale i publikuar nga përfaqësuesi i aprovuar i UNMIK-ut dhe nuk është i përafuar me legjislacionin e BE-së;
- Ligji nr. 04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat, me të cilin rregullohet prodhimi dhe qarkullimi i rrushit për prodhimin e verës, prodhimi dhe kushtet e vënies në qarkullim të verës dhe produkteve të tjera të përpunimit të rrushit dhe verës, mbrojtja e verës së prodhuar në rajonin e caktuar gjeografik i cili dallohet me kushtet e veçanta klimatike, tokësore dhe kushteve tjera dhe është pjesërisht i përafuar me: Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr.

479/2008; Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 479/2008; Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 555/2008 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008; Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 606/2009 që përcakton rregulla të caktuara të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008; Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 607/2009 që përcakton rregulla të detajuara specifike për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008; Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 491/2009 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 1234/2007 dhe Rregulloren e Komisionit dhe Këshillit Evropian (BE) nr. 1308/2013 për themelimin e organizatës së përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit nr. 922/72; nr. 234/79; nr. 1037/2001;Nr. 1234/2007;

- Ligji nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve, metë cilin rregullohen procedurat për mbrojtjen e varieteteve të bimëve, për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtës së seleksionuesit të bimëve, dhe siguron kushte për varietetet e të gjitha gjinive dhe llojeve bimore duke përfshirë edhe kryqëzimet në mes të gjinive dhe llojeve që mund të mbrohen me këtë ligj. Ligji është i përafuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2100/94; Direktivën Implementuese të Komisionit 2014/97/BE që zbaton Direktivën e Këshillit 2008/90/KE;
- UA nr. 11/2010 mbi regjistrimin e prodhuesve, përpunuesve, importuesve, shpërndarësve, deponuesve, paketuesve, eksportuesve të bimëve, shitësit me shumicë të bimëve, pjesëve tjera dhe produktet e bimëve, e bazuar pjesërisht në Direktivën nr. 2000/29/KE.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me *acquis* të BE-së, të përcaktuar në Rregullorja nr. 02/2011- Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) është institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, si dhe për kontrollet fitosanitare.

Kosova tashmë ka përgatitur listën e sëmundjeve të bimëve të pranishme në territorin e saj si Shtojcë të Ligjit për mbrojtjen e bimëve.

Kontrollet bazohen në Planin Kombëtar Vjetor për Kontrollin Zyrtarë dhe Mostrim. Listat kontrolluese (check-listat) janë përgatitur dhe inspektorët janë trajnuar nëpërmjet projektit të binjakëzimit "Asistenca e Mëtejshme për AUV."

Kontrolli fitosanitar

MBPZHR gjithashtu harton legjislacionin në fushën e fitosanitarisë, duke përfshirë përgatitjen e listës së parazitëve dhe dëmtuesve karantinë, miratimin e importit dhe eksportit, si dhe koordinimin e punës së Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë në kryerjen e analizave diagnostifikuese.

Inspektorët fitosanitarë janë përgjegjës për:

- Inventarizimin e agjentëve të dëmshëm biologjik (sëmundjeve, dëmtuesve, barojave të këqija etj.) sipas kulturës;
- Monitorimin e listës së parazitëve karantinë dhe atyre me interes ekonomik (Lista A dhe Lista B);
- Kontrollin e farës, materialit fidanor dhe objekteve për mbrojtjen e bimëve;
- Inspektimin e akterëve të përfshirë në prodhimin e bimëve në aspektin e mbrojtjes së bimëve;
- Bashkëpunimin ndërkombëtar me institucionet për mbrojtjen e bimëve;
- Promovimin e aktiviteteve për mbrojtjen e bimëve (broshura, manuale, fletushka, trajnime, këshillime, etj.).

Inspektorati Kufitar është përgjegjës për kontrollin kufitar në Han të Elezit, Merdare, Dheu i Bardhë, Jarinje dhe Vërmicë. Nëse është e nevojshme, kontrolli mund të kryhet edhe në pikat në aeroport dhe hekurudha në Prishtinë.

Qeverisja Lokale

Përveç inspektorëve në nivel të AUV, kontrollet zyrtare kryhen edhe nga inspektorët komunalë sanitarë, bujqësorë dhe veterinarë. Shih "Qeverisja lokale" në nën-kapitullin "Siguria Ushqimore"

Laboratori fitosanitar dhe i farërave

Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) është themeluar me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2003 për rolin dhe mandatin e IBK-së të dt. 18.06.2003.

IBK është institut publik kërkimor, në kuadër të MBPZHR -së dhe përgjegjës për monitorimin e tokave bujqësore dhe ujit për ujitje, monitorimin e shëndetit të integruar të bimëve, kontrollin e zinxhirit ushqyes, kontrollin analitik laboratorik të cilësisë së ushqimit, certifikimin e farërave dhe prodhimit organik, si dhe realizimin e projekteve kërkimore, aplikative dhe prodhuese, në fushën e prodhimit bimor dhe blegtoral.

Aktualisht ka të punësuar 32 zyrtarë, ndërsa sa i përket akreditimit është në procedurë të adresimit së jokonformiteteve të dalta nga vlerësimi i Komisionit të Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës. IBK posedon pajisje dhe teknologji laboratorike si dhe mekanizëm bujqësor.

Drejtorja e cila merret me zbatimin e çështjeve fitosanitare në kuadër të AUV është Drejtorja e Inspektoratit, e cilaka të punësuar 83 zyrtarë, prej të cilëve 20 inspektorë fitosanitarë.

Masat afatshkurtra

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2016 dhe me qëllim të plotësimit të kornizës ligjore në fushën e fitosanitarisë, do të miratohen:

- Ligji për Farëra dhe Materialin Fidanor, i cili rregullon prodhimin dhe marketingun e farërave të varieteteve dhe patateve në prodhimtarinë bujqësore, i cili do të transpozohet pjesërisht Direktivën e Këshillit 66/401/KEE, Direktivën e Këshillit 66/402/KEE; Direktivën e Këshillit 2002/53/KE; Direktivën e Këshillit 2002/54/KE; Direktivën e Këshillit 2002/55/KE; Direktivën e Këshillit 2002/56/KE; Direktivën e Këshillit 2002/57/KE; Direktivën e Këshillit 68/193/KEE; Direktivën e Këshillit 1998/56/KE; Direktivën e Këshillit 92/33/KEE; Direktivën e Këshillit 2008/90/KE; dhe Direktivën e Këshillit 1999/105/KE;
- UA mbi pasaportat bimore, që do të bazohet pjesërisht në Direktivat 92/90/KEE, 92/105/KEE, 92/90/KEE dhe 93/50/KEE.

Në vitin 2016, sektori i Fitosanitarisë gjithashtu planifikon të:

- Fuqizojë masat për kontrollet fitosanitare duke ndërmarrë masa shtesë për rritjen e kontrolleve në të gjitha subjektet që merren me prodhimin, përpunimin, tregtinë dhe importin e bimëve dhe produkteve të bimëve;
- Rrisë numrin e mostrave të marra;
- Zbatojë përdorimin e listave kontrolluese (check-listave);
- Fuqizojë më tej kontrollin kufitar duke inspektuar çdo ngarkesë të materialeve të importuara;
- Azhurnojë në vazhdimësi listën e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, në vitin 2016 planifikohet:

- Transferimi i inspektorëve fitosanitarë nga niveli komunal në AUV;
- Blerja e pajisjeve shtesë për inspektorët në terren;
- Trajnimi i inspektorëve mbi përdorimin e pajisjeve të reja përmes buxhetit të Kosovës, si dhe projektit Twinning në kuadër të IPA 2015 "Support to strengthening Kosovo's plant protection and production system and capacities."

Prioritetet afatmesme

Në fushën e fitosanitarisë, do të miratohet dhe përafrohet pjesërisht me *acquis* të BE-së legjislativi në vijim:

- Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Plehrat Artificiale, i cili do të përafrohet me Rregulloren (EU) nr. 2003/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;
- Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve, i cili do të transpozohet pjesërisht Rregulloren e (KE) nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 79/117/KEE dhe 91/414/KEE;

- Rregullorja mbi tregtinë e farërave të patateve në tërë territorin e Republikës së Kosovës, e cila do të përafrohet pjesërisht me Direktivën e Këshillit 66/402/KEE;
- Rregullorja për mbetje të pesticideve në bimë, e cila do të përafrohet me Rregulloren nr. 396/2005/KE;
- Rregullorja për zonat e mbrojtura të bimëve, e cila do të përafrohet me Rregulloren nr. 92/70/KEE;
- Programi kombëtar për monitorimin/inspektimin e sëmundjeve të bimëve.

Po ashtu, MBPZHR, AUV dhe Fakulteti i Bujqësisë gjatë periudhës 2017-2020 do të fokusohen në:

- Kompletimin e inventarit për sëmundje dhe dëmtues;
- Kontrollin e përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe tregtimin e tyre;
- Zgjerimin e listës së llojeve të bimëve për të cilat do të jepen pasaporta.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të sektorit fitosanitar, gjatë kësaj periudhe planifikohet:

- Ngritja e numrit të stafit;
- Themelimi i grupeve të ekspertëve;
- Regjistrimi në organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve, siç është IPPC, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve dhe shkëmbimit të përvojave të përbashkëta në aspektin e politikave fitosanitare;
- Aplikimi për asistencë nëpërmjet IPA II dhe ndihmës tjetër të huaj për fuqizimin e administratës fitosanitare.

3.14. Kapitulli 13 i *acquis*-së: Peshkataria

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo kërkon futjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për pjesëmarrje në politikën e peshkimit të përbashkët, e cila mbulon politika të tregut, të burimeve dhe menaxhimit e stokut kombëtar, inspektimin dhe kontrollin, veprimet strukturore dhe kontrollin e ndihmës shtetërore. Në disa raste, marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizata ndërkombëtare duhet të përshtaten.

Sipas nenit 103 të MSA-se, palët do të shqyrtojnë mundësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në akuakulturë dhe në sektorët e peshkatarisë. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në këto fusha, dhe parimet e menaxhimit dhe ruajtjen e burimeve të peshkatarisë bazuar në rregullat e zhvilluara nga organizatat relevante ndërkombëtare dhe rajonale të peshkatarisë.

Sektori i akuakulturës dhe peshkatarisë rregullohet me Ligjin nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 10 tetor 2006. Më këtë ligj rregullohet menaxhimi me resurse peshkore dhe veprimtaria e peshkatarisë dhe akuakulturës që ushtrohet në ujërat e territorit të Kosovës. Ligji ende nuk është i përafëruar me legjislacionin të BE-së.

Për zbatimin e Ligjit janë nxjerrë këto Udhezime Administrative: UA për Peshkim sportiv-rekreativ dhe pajisjet për peshkim sportiv-rekreativ nr. 27/2007, UA për Licencimin e aktiviteteve në akuakulturë nr. nr. 09/2008, dhe UA për përcaktimin e regjioneve-zonave të peshkimit nr. 07/2009.

Sektori i peshkatarisë në Kosovë nuk është shumë i zhvilluar, megjithatë Kosova ka një potencial të konsideruar të ujerave të ëmbla, duke krijuar mundësi të mëdha punësimi, profiti dhe mundësi tjera për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Sektori i akuakulturës në Kosovë krahasuar me vendet e regjionit dhe të Evropës është i vogël dhe prodhohet sasi minimale e mishit të peshkut rreth 614 t/vit. Në Kosovë kultivohet peshku troftë e cila konsumohet në restorante kurse shumë pak ose fare gjendet në treg.

MBPZHR në bashkëpunim me Federatën e Peshkatarëve Sportiv të Kosovës (FPSRK) merr vendime për zonat e peshkimit, sasinë e peshkut për peshkim, pajisjet për peshkim etj. Ndërsa sa i përket akuakulturës vendimet merren vetëm nga MBPZHR dhe si të tilla ekzekutohen nga Inspektorati. Sipas legjislacionit në fuqi licencimi nga lëmia e akuakultures në shkallë vendi është përgjegjësi e MBPZHR ndërsa licencimi i

peshkatarëve për peshkim sportive-rekreativë është kompetence e deleguar në FPSRK. Federata e peshkatarëve sportivë të Kosovës raporton tek MBPZHR për numrin e licencave të lëshuara. Ndërsa për zhvillimet në peshkimin, ripeshkëzimin dhe sasinë e peshkut të peshkuar MBPZHR informohet nga Federata Peshkatarëve Sportivë

Kosova ka dy forma të sigurimit të peshkut për konsum: Nga kultivimi i peshkut në ferma të peshkut (hurdhja) dhe nga aktiviteti i peshkimit sportiv-rekreativ. Në Kosovë janë 28 ferma(hurdha) të peshkut me prodhimtari vjetore rreth 614 t/v. Struktura e sektorit kryesisht dominohet nga hurdhat te vogla. Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese është rreth 50%. Nga totali i përgjithshëm rreth 60/t sigurohen nga peshkimi sportiv-rekreativ.

Sa i përket asistencës, sektori i peshkatarisë është mbështetur nga GIZ po ashtu me asistencë teknike 1,200,000.00 Euro.

Masat afatshkurtra

Do të kërkohet ekspertizë nga programi i TAIEX më qëllim të kryerjes së analizës së zbrastësirave ligjore në nivelin nacional për Ligjin e Peshkatarisë dhe Akuakulturës. Kjo analizë do të jep një pasqyrë se sa është transpozuar deri më tani legjislacioni i BE-së në nivel nacional dhe se cilat janë hapat që duhet ndërmarrë për të vazhduar përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit nacional me Acquis.

Prioritetet afatmesme

- Avansiumi i bazës ligjore në fushën e peshkatarisë dhe akuakulturës; dhe
- Inventarizimi i peshqve.

3.15. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit

Ky kapitull mbulon pjesën e politikave të transportit nga MSA-ja. Legjislacioni i transportit të BE-së synon të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe ekologjikisht të qëndrueshme me një sistem të integruar të transportit sa më miqësor. Për më tepër, acquis i transportit mbulon sektorët e transportit rrugor, hekurudhor, rrugorë, ujore, transportin e multimodal, aviacionin dhe transportin detar. Në këtë kontekst, legjislacioni i transportit ndërlidhet me standardet teknike; standardet e sigurisë; standardet sociale; duke përfshirë edhe kontrollin e ndihmës shtetërore si dhe liberalizimin e tregut në kontekst të tregut të brendshëm të transportit. Po ashtu, politika e transportit është e mbuluar edhe nga Titulli VI, nenet 90-100 të TFEU.

Kërkesat e MSA-së

Transporti në MSA mbulohet nga Kapitullin II-të i Marrëveshjes - Ofrimi i Shërbimeve. Nenet relevante janë Nenet 53, 60, 61, 62 dhe 113. Neni 53 parasheh obligimet që do të rrjedhin nga Traktati i Transportit si dhe obligimet e marra përsipër përmes Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA). Neni 60 përveç që do të merr për bazë Traktatin e Komunitetit të Transportit dhe Marrëveshjen HPEA, parasheh një përafrim gradual të legjislacionit në fushën e transportit me qëllim të avancimit të liberalizimit të qasjes së ndërsjelltë të Palëve në tregje dhe lehtësimin e lëvizjes së udhëtareve dhe mallrave si dhe përfshirjen e çdo konvente ndërkombëtare që merret me sigurinë rrugore. Neni 61 dhe 62 fokusohen kryesisht në transportin e mallrave transit nga Kosova përmes BE-së me destinacion në vend të tretë ose anasjelltas. Neni 113 parasheh bashkëpunimin e palëve në fushat prioritete që lidhen me acquis të BE-së në fushën e transportit.

Në fushën e transportit, *studimi i fizibilitetit* identifikon MSA-në si dokument strategjik që do të kontribuojë në ristrukturimin dhe modernizimin e Kosovës në sistemet e transportit dhe përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e lëvizjes së lirë të mallrave dhe udhëtarëve, duke arritur standarde të krahasueshme me ato që mbizotërojnë në BE. Po ashtu, *studimi i fizibilitetit* identifikon procesin e përafrimit të legjislacionit të transportit me atë të BE-së, si mundësi që do të kontribuoj pozitivisht duke i lejuar Kosovës qasje progresive dhe lehtësira në tregjet e transportit të BE-së dhe anasjelltas.

Kërkesat nga Raporti për Kosovën

Në kontekst të kërkesave të dala nga Raporti për Kosovën (RK), në fushën e transportit rrugor, Kosova do ta përafroj më tej kornizën ligjore primare me *acquis* e BE-së duke me miratuar e Ligjin për Patentë Shofer, Ligjin për Automjete dhe Ligjin për Rregullat e Komunikacionit Rrugor. Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Kosova duhet të siguroj që lista e prioriteteve “masat e lehta/buta” të prezantuara dhe dakorduara në Samitin e Vjenës nga takimi i BP6, të zbatohen plotësisht para samitit të ardhshëm të BP6, që pritet të mbahet në qershor të vitit 2016. Po ashtu, RP vlerëson së buxheti aktual është i pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e rregullt të autostradës R7. Nder kërkesat tjera të dala nga RP janë edhe përshtatja e legjislacionit të Kosovës më atë të BE-së sa i përket qasjes në treg, profesionit të operatorëve të transportit rrugorë dhe takografëve digjital.

Ndërkaq, në sektorin e *hekurudhave*, RK vlerëson se duhet të forcohen kapacitetet profesionale të ARH-së, si dhe duhet të sigurohet pavarësia e saj në procesin e licencimit dhe rregullimit të tregut. Sa i përket procesit të licencimit të operatoreve të rinj, RK vë në pah se përkundër vendimit që ARH-ja e kishte licencuar një operator të ri hekurudhor, më vonë ARH e kishte tërhequr licencën dhe tani kjo çështje vazhdon të mbetet pjesë e shqyrtimeve gjyqësore. Për më tepër, RK kërkon që të emërohet hetuesi për aksidente dhe incidente hekurudhore në KHAIA. Po ashtu, RK vlerëson se Kosova duhet të intensifikoj përpjekjet në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës hekurudhore të Kosovës.

Sa i përket kërkesave të dala nga RK në fushën e *aviacionit civil*, sfidë mbetet lidhja e marrëdhënieve kontraktuale nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me EASA-në. Po ashtu, kërkesë e drejtpërdrejt e RK-në është certifikimi i ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror nga AAC. Sfidë tjetër që rrjedh nga RK është zbatimi i Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, adaptimi i legjislacionit që siguron navigacion ajror dhe siguri të shërbimeve profesionale.

Kërkesat nga DPSA

Në kuadër të kërkesave të dala nga takimi i DPSA-së *Infrastruktura*, në fushën e transportit rrugor kërkohet vazhdimi i përafritimit të legjislacionit me *acquis* e BE-se. Po ashtu, nga takimi i DPSA-së rrjedh që Kosova duhet vazhdimisht të informoj Komisionin Evropian për kontrollet e automjeteve në rrugë; (numrin e testeve dhe rezultateve, ofrimin e shënimeve rreth inspektimeve të automjeteve, çfarë ndodh me automjetet të cilat nuk e kalojnë inspektimin) si dhe rreth zhvillimeve të aplikimit të metodologjisë ndërkombëtare lidhur me statistikat për aksidentet rrugore. Për më tepër, nga konkluzionet e këtij takimi rekomandohet që të sigurohet një studim përmes TAIEX-it lidhur me kualifikimet e teknikëve për inspektim të automjeteve. Në vazhden e kërkesave tjera të dala nga DPSA *Infrastruktura* janë edhe ofrimi i afateve kohore rreth bazës së shënimit të infrastrukturës rrugor, afatet kohore lidhur me koncesionimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së autostradës R7, si dhe ofrimi i informatave rreth fuzionimit të SSTMM, duke përfshirë edhe përpjekjet për t'u anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare.

Sa i përket fushës së transportit *hekurudhor*, bazuar në konkluzionet e DPSA-së *Infrastruktura*, Kosova duhet ta informoj në vazhdimësi Komisionin Evropian në lidhje me zhvillimet në çështjet e mëposhtme:

- Zhvillimet në rastin e revokimit të licencës për operatorin hekurudhor Railtrans;
- Zhvillimet rreth emërimit të bordit të ARH-së
- Qasjen në objektet hekurudhore të Trainkos-it për riparimin dhe mirëmbajtjen për operatorët e rinj që hyjnë në treg;
- Rreth subvencioneve për Infracos dhe Trainkos;
- Zhvillimet rreth marrëveshjes në pikë kalimin kufitar me Maqedoninë; dhe
- Rreth zhvillimeve sa i përket emërimit të hetuesit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore në Komisionin Hetimor – KHAIA.

Ndërkaq, në fushën e *aviacionit civil* nga takimi i DPSA *Infrastruktura* kërkohet që të informohet KE-ja rreth implementimit të Ligjit të Shërbimeve të Navigimit Ajror, transpozimit të Rregullores së BE-se nr. 1070/2009; si dhe rreth procesit të certifikimit të ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror.

Transporti rrugor

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Sa i përket harmonizimit të legjislacionit në *transportin rrugor*, Ligji për Siguri në Komunikacion përcakton bazat kryesore të ndërsjella të marrëdhënieve dhe sjelljeve të pjesëmarrësve si dhe subjekteve tjera në komunikacionin rrugor; kushtet bazë që duhet t'i përmbushin rrugët shikuar në zhvillimin e komunikacionit rrugor; sistemi i shenjave të komunikacionit; shenjat që japin personat e autorizuar zyrtar; detyrat në rast aksidentit në komunikacion rrugor; përgatitja e kandidatëve për shofer; dhënia e provimit për shofer; si dhe kushtet për të fituar të drejtën për drejtimin e mjeti. Për më tepër, ky ligj ka transpozuar plotësisht direktivat si në vijim: Direktiva 2006/126/KE, Direktiva 2000/30/KE dhe Direktiva 96/96/KE. Po ashtu, ky ligj ka transpozuar pjesërisht Direktivën 2008/68, Direktivën 95/50, Marrëveshjen Evropiane për Transport Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), Konventën Ndërkombëtare për Transportin e Mallrave përmes Hekurudhës (CIM) dhe Konventën për Transport Ndërkombëtar (COTIF), Rregullat për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Hekurudhë (RID). Ndërkaq, Ligji mbi Transportin Rrugor ka si qëllim rregullimin dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese në treg, ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave si dhe rregullimin e regjimit të ngasjes dhe pushimit. Për më tepër, ky ligj ka transpozuar pjesërisht Direktivën 1071/2009, Direktivën 1072/2009 dhe Direktivën 1073/2009.

Për më tepër, në drejtim të plotësisimit dhe harmonizimit të mëtejme të kornizës ligjore sekondare, MI ka miratuar Udhëzimet Administrative (UA) përmes të cilave ka transpozuar pjesërisht *acquis-in* e BE-së, si në vijim:

- UA nr. 02/2015 për programin e edukimit, zbatimit mënyrën e trajnimit dhe të vlerësimit të këshilltarit të sigurisë (Direktiva 96/35/KE e ndryshuar me Direktivën 2008/68/KE);
- UA nr. 06/2014 mbi përmbajtjen dhe formën e procesverbalit për mostra dhe dokumentit të kontrollit të mallrave të rrezikshme (Direktiva 95/50/KE);
- UA nr. 05/2014 për lëshimin e lejeve për kryerjen e transportit ndërkombëtar të mallrave për operatorët rezident;
- UA nr. 04/2014 për transport të jashtëzakonshëm;
- UA nr. 03/2014 mbi kriteret e llogaritjes së kompensimit për transport të jashtëzakonshëm;
- UA nr. 02/2014 për dhënien e pëlqimit për kyçe, instalime dhe shfrytëzim të tokës në rrugë nacionale dhe rajonale;
- UA nr. 1/2014 mbi caktimin e tarifave për shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale;
- UA nr. 2013/7 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të mallrave (Direktiva 1071/2009, 1072/2009 dhe 1073/2009);
- UA nr. 2013/9 për rrjetin e linjave dhe rëndin e udhëtimit në transportin ndër-urban të udhëtarëve me autobus;
- UA nr. 2013/10 për trajnimin dhe dhënien e provimit për menaxher dhe shofer të operatorit të transportit publik rrugor të udhëtarëve dhe mallrave (Direktiva 1071/2009);
- Kodi i mirësjelljes nr. 01/2013 për drejtuesit e autobusëve dhe personelin tjetër UA nr. 2013/8 për licencimin e stacioneve të autobusëve; dhe
- UA nr. 2013/11 për lëshimin e lejeve për kryerjen e transportit të rregullt-ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve qasje dhe transit nëpër territorin e Kosovës.

Sa i përket miratimit të strategjive dhe programeve që kanë të bëjnë me implemtimin e legjislacionit të transpozuar të BE-së, në fushën e *transportit rrugor* MI-ja ka miratuar Strategjinë Sektoriale dhe të Transportit Multimodal 2015-2-25 (SSTMM) dhe Planin e veprimit 5 vjeçar. SSTMM përmban pesë objektiva strategjike të cilat ndërlidhen me zhvillimin dhe lidhjen me korridoret pan-evropiane, ngritjen dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve në transport për pasagjerë dhe mallra, ngritjen dhe përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugor, ngritjen e nivelit të bashkëpunimi dhe anëtarësimit në organizata rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe krijimin e një strukture funksionale njerëzore të motivuar dhe kompetente për sektorin e transportit. Po ashtu, është miratuar Strategjia për Siguri në Komunikacionin Rrugor 2016-2020 si dhe Programi për Siguri në Komunikacionin Rrugor që kanë si qëllim primar zvogëlimin e numrit të aksidenteve dhe personave të vdekur në trafik, ngritjen e vetëdijesimit të pjesëmarrësve në trafik dhe grupe tjera të interesit.

Në kuadër të rolit dhe përgjegjësiwe institucionale, roli i MI-së në fushën e *transportit rrugor* ndërlidhet me krijimin e ambientit të përshtatshëm për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemeve të

transportit dhe të kapaciteteve njerëzore për ofrimin e shërbime cilësore, për mjedis të pastër ekologjik, për rritje ekonomike dhe integrim në organizata dhe struktura ndërkombëtare. Bazuar në obligimet e dala nga MSA, MI angazhohet për krijimin e një sistem plotësisht të integruar të transportit për të gjithë qytetarët sipas standardeve Evropiane me ç'rast synon zgjedhjen e transportit më efikas dhe më të leverdishëm me qëllim plotësimin e nevojave të qytetareve, garantimin e ruajtjes së e mjedisit si dhe thellimin e bashkëpunimit me vendet fqinje për integrim në strukturat rajonale e ndërkombëtare.

Për më tepër, fushat përkatëse të transporti janë të mbuluara nga ana e departamenteve si në vijim:

- Departamenti i inspektoratit mbulon fushën e inspektimeve, me ç'rast mbikëqyr implementimin të ligjeve bazike në fushën e transportit rrugor;
- Departamenti i infrastrukturës rrugore mbulon fushën e hartimit të programit të investimeve në infrastrukturë rrugore, mirëmbajtjen dhe sinjalizimin e rrjetit rrugore ekzistues;
- Sekretariati i sigurisë rrugore përgjegjësi kryesore ka ndërmarrjen e masave, qëllimi i të cilave është zvogëlimi i aksidenteve si dhe implementimin e fushatave senzibilizuese dhe ngritjen e vetëdijesimit dhe edukimit të pjesëmarrësve në trafik;
- Departamenti i transportit tokësor është përgjegjës për hartimin e politikave, rregullimin e tregut, licencimin e operatoreve të udhëtareve, mallrave dhe mallrave të rrezikshme në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, krijimin e lehtësirave si dhe inicimin e marrëveshjeve me të gjitha vendet në fushën e transportit tokësor;
- Departamenti automjeteve harton politikat në fushën e automjeteve dhe patentë shofereve si dhe ofron shërbimet e vlerësimit të kandidateve për patentë shofer;

Masat afatshkurtra

Në kontekst të avancimit të mëtejshëm të kornizës legislative, në fushën e *transportit rrugor*, planifikohet të miratohen dhe përafrohen me *acquis* e BE-së ligjet dhe UA si në vijim:

- Ligji për Patentë shofer - ka për qëllim të përcaktoj kushtet dhe kriteret për marrjen e patent shoferit, licencimin e auto shkollave, ligjëruesit profesional, shofer instruktorët, pyetësit, aftësimin e kandidatëve për shofer, dhënien e provimit për patentë shofer, programin e trajnimit për trajner nga fusha e patentë shoferit, trajnimet periodike për shoferët profesionalisht të cilët ngasin (drejtojnë) automjetet e transportit për mallra dhe udhëtar, kushtet për të fituar të drejtën për ngasjen e automjetit, kategoritë e automjeteve, kushtet shëndetësore, procedurat për aplikim, për marrje, vazhdim dhe ndërrim të patentë shoferit si dhe çështje tjera të ndërlidhura. Në këtë ligj duhet transpozuar direktivat si në vijim: Direktiva 2006/126/KE, Direktiva 2013/47/KE për ndryshim plotësimin e Direktivës 2006/126/KE, Direktiva 2012/36/KE për ndryshimin e Direktivës 2006/126/KE, si dhe Direktiva 2003/59/KE;
- Ligji për Rregullat e Komunikacionit Rrugor - me këtë ligj përcaktohen bazat kryesore të ndërsjella të marrëdhënieve dhe sjelljeve të pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor, kushtet bazë që duhet t'i përmbushin rrugët shikuar në zhvillimin e komunikacionit rrugorë, sistemi i shenjave të komunikacionit dhe shenjat që japin personat e autorizuar zyrtar, detyrat në rast aksidentit në komunikacion rrugorë, pajisjet dhe pajimet të cilat duhen t'i kenë mjetet, dimensionet, masa ma e madhe e lejuar dhe ngarkesa boshtore e mjetit si dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësoj mjeti në komunikacion. Në këtë ligj duhet transpozuar direktivat si në vijim: Konventa Ndërkombëtare e Vjenës 1968 për Komunikacion Rrugorë. Direktiva 91/671/KE, Direktiva 2003/20/KE për ndryshim plotësimin e Direktivës 91/671/KE, Direktiva 2005/39/KE për ndryshim plotësimin e Direktivës 74/408/KE, Direktiva 92/6/KE, Direktiva 2002/85/KE për amendamentimin e Direktivës 92/6/KE, si dhe Direktiva 96/53/KE për amendamentimi e Direktivës 2007/7/KE;
- Ligji për Automjete - ky ligj rregullon kushtet për vendosjen në treg të mjeteve motorike dhe bashkëngjitime, regjistrimin e tyre dhe pjesëmarrjen e tyre në komunikacion rrugorë, për kryerjen e punëve në bujqësi dhe pylltari, kushtet për funksionimin e shërbimit teknik profesional dhe të autoriteteve regjistruese, menaxhimin e bazës së të dhënave për automjete, monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji si dhe qasje në informata për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve. Në këtë ligj duhet transpozuar direktivat si në vijim: Direktiva 2007/46/KE dhe plotësim-ndryshim e kësaj direktive, Direktiva 2014/45/KE, Direktiva 2014/46/KE për ndryshimin e Direktivës 1999/37/KE, Direktiva e Këshillit 1999/37/KE si dhe Direktiva 2014/47/KE; dhe

- Amandamentimi i Ligjit për Transportin Rrugor – qëllimi i ligjit është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese në treg, si dhe ofrimin e shërbimeve në tregun e sektorit të udhëtarëve dhe mallrave. Në këtë ligj duhet transpozuar direktivat si në vijim: Direktiva 1071/2009/KE, Direktiva 1072/2009/KE si dhe Direktiva 1073/2009/KE;
- UA për licencimin e punëtorive/serviseve dhe lëshimin e karteleve të tahografit digjital – Ky UA transponon në mënyrë të plotë Rregulloren nr. 165/2014 /BE dhe marrëveshjen AETR.

Sa i përket aktiviteteve implemetuese të planifikuara në kuadër të *transportit rrugor* për vitin 2016, parashihet të vazhdohet me implementimin e projekteve strategjike infrastrukturore të autostradës R6, finalizimi i studimit të fizibilitetit të segmentit (Besi – Merdare) të autostradës R7 si dhe vazhdimi i zgjerimit të rrugëve nacionale N2 dhe N9. Po ashtu, pritet vazhdimi i programit të rregullt të mirëmbajtjes duke përfshirë sinjalizimin e rrugëve nacionale, regionale si dhe rehabilitimin e rrjetit sekondar rrugore. Në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e sigurisë në komunikacion rrugore, do të vazhdohet me implementimin e fushatave si dhe rekomandimeve të dala nga takimet e këshillit për siguri në komunikacion rrugor. Po ashtu, parashihet që përmes inspektimeve, trajnimeve të personave përgjegjës të ngritët cilësia e automjeteve si pjesëmarrës në komunikacion. Për më tepër, pritet të krijohet sistemi elektronik për testimin e kandidatëve për shofer, data-baza për kandidatë dhe shofer, si dhe krijimi i sistemit unik i data-bazës për auto-shkolla, ligjërues profesional, shofer instruktor, ekzaminer dhe trajner.

Ndërsa, marr parasysh mungesën e mjeteve financiare, sa i përket ngritjes së kapaciteteve teknike dhe profesionale në fushën e *transportit rrugor* do të përdoret kryesisht instrumenti i TAIEX-it apo ndonjë instrument tjetër mbështetës. Për më tepër, këto kapaciteteve profesionale kryesisht do të ngritën në fushën e auditimit dhe inspektimit të sigurisë në komunikacionin rrugor.

Prioritetet afatmesme

Në kontekst të prioriteteve dhe aktiviteteve për periudhën afatmesme 2017-2020, në fushën e *transportit rrugor* parashihet të krijohet politika të reja në aspektin legjislativ dhe organizativ, konkretisht pritet plotësim-ndryshimi i ligjit të rrugëve, krijimit i Agjencionit të Rrugëve si dhe përfundimi i projekteve strategjike të infrastrukturës rrugore në segmentet e R6, R7, N2 dhe N9. Sa i përket bashkëpunimit rajonal, pritet nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit, anëtarësimi në organizmat ndërkombëtar të transportit rrugor, si dhe inicimi i marrëveshjeve dhe protokolleve ndërkombëtare me shtete tjera në fushën e transportit rrugor. Po ashtu, pritet të ndërmerren aktivitete sa i përket vazhdimin të përmirësimit dhe modernizimit të shërbimeve për transportin e udhëtarëve në vend-ndalje të autobusëve si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike në fushën e transportit rrugorë. Mbetet të analizohet dhe diskutohet më tej më të gjithë akteret e interesit shqyrtimi i mundësive dhe nevojave për krijimin e Autoritetit të Transportit Rrugor.

Hartimi i legjislacionit dhe krijimi potencial i institucioneve të reja do të bazohen në planifikimin vjetor të buxhetit të institucioneve të linjës, përkatësisht në përputhje me KASH-in. Ndërkaq projektet infrastrukturore, përveç që do të planifikohen në kornizat e buxhetit të Kosovës, dhe me përkrahje substanciale nga donatorët.

Aviacioni civil

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Në kontekst të plotësishtit dhe harmonizimit të kornizës legjislative nga fushën e *aviacionit civil* me legjislacionin e BE-së, është miratuar Ligji i Aviacionit Civil që ka qëllim rregullimin teknik, ekonomik dhe promovimin e aviacionit civil në Kosovë si dhe nxitjen e zhvillimit e sigurt të kësaj fushe në përputhje me normat ndërkombëtare. Për më tepër, ky ligji ofron bazën ligjore për transpozimin dinamik në legjislacionin sekondar nga AAC-ja dhe MI-ja të obligimeve që rrjedhin nga HPEA. Kosova është nënshkruese e marrëveshjes HPEA, dhe me këtë rast institucionet e Kosovës kanë transpozuar gjithë legjislacionin që rrjedh nga faza e I-rë, përveç Direktivës 2003/88 e cila gjendet në Projektligjin e

amandamentuar të Punës i vënë në agjendën legjislativë për vitin 2015. Po ashtu, është miratuar Ligji për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror që ka si qëllim themelimin e Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror (ASHNA) në mënyrë që për të siguroj infrastrukturën dhe shërbimet e navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për më tepër, ligji përcakton se aktivitetet e aviacionit civil në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës kryhen në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Aviacionin Civil, Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

Sa i përket strategjive dhe programeve që kanë të bëjnë me implementimin e *acquis* të BE-së në fushën e *aviacionit civil*, MPB-ja zbaton tri programe kombëtar për sigurimin e aviacionit civil si në vijim:

- Programin kombëtar për siguri të aviacionit civil ka qëllim mbrojtjen e udhëtarëve, ekuipazhit, personelit tokësor, dhe publikut të gjerë nga ndërhyrjet e paligjshme;
- Programin kombëtar të kontrollit të kualitetit të sigurimit të aviacionit civil që ka për qëllim përcaktimin e përputhshmërisë me vlerësimin e efektshmërisë së programit kombëtar të sigurimit të aviacionit civil përmes auditimeve, testeve dhe inspektimeve; dhe
- Programin kombëtar të trajnimeve për sigurimin e aviacionit civil, i cili siguron krijimin e personelit të trajnuar për zbatimin e standardizuar të sigurisë parandaluese për funksionim të sigurt të fluturimeve ndërkombëtare.

Sa i përket rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në fushën e aviacionit civil, MI-ja është përgjegjëse për zhvillimin e politikave kombëtare për transportin ajror, nxjerrjen e rregulloreve që lidhen me ekonominë e transportit ajror, përveç sigurimit të aviacionit, ekonomisë së aeroporteve ose shërbimeve të navigimit ajror, MI është përgjegjëse edhe për organizimin, zbatimin ose marrjen e masave për zhvillimin e aviacionit civil në Kosovë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Ndërkaq, AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin dhe monitorimin e sigurisë së aviacionit civil, si dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Po ashtu, Divizioni i Sigurimit të Aviacionit Civil brenda MPB-së është përgjegjëse për vendosjen, ruajtjen, mbikëqyrjen dhe rregullimin e sigurimit të aviacionit civil. Ndërsa, hetimi i incidenteve dhe aksidenteve të aviacionit civil bëhet nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve edhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), që vepron brenda Zyrës së Kryeministrit.

Masat afatshkurtra

Në kontekst të përafrimit të mëtejme të kornizës legjislativë në *fushën e aviacionit civil* me *acquis* për 2016, AAC-ja do të nxjerrë rregullore që transponojnë rregullore të BE-së si në vijim: Rregulloren (BE) nr. 1332/2011; Rregulloren (BE) nr. 646/2012; Rregulloren (BE) nr. 6/2013 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 216/2008; Rregulloren (BE) nr. 90/2012 për ndryshimin e Rregullores së (KE) nr. 736/2006; Rregulloren (BE) nr. 628/2013; Rregulloren (BE) nr. 319/2014; Rregulloren (BE) nr. 376/2014; Rregulloren (BE) nr. 452/2014; Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 255/2010; Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 448/2014 për ndryshimin e Rregullores Zbatuese (BE) nr. 1035/2011; Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 139/2014; dhe Rregulloren (KE) nr. 1070/2009.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2016 MPB-ja do të nxjerr Rregulloren që do të transpozojë Rregulloren e BE-së nr. 1141/2011 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 272/2009; Rregulloren e BE-së nr. 245/2013 për ndryshimin e Rregullores nr. 272/2009; Rregulloren e BE-së nr. 687/2014 për ndryshimin e Rregullores e BE-së nr. 185/2010.

Ndërkaq sa i përket masave implementuese për vitin 2016, AAC-ja do ta certifikoj Agjencinë për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit, varësisht prej shndërrimit të saj në agjenci buxhetore. Kurse, në kuadër të fushës së sigurimit të aviacionit civil do të realizohen në vazhdimësi auditime, vëzhgime, inspektime, anketime dhe hetime.

Ndërsa, në drejtim të plotësimit-ndryshimit të kornizës strategjike, MPB-ja do të bëjë plotësim-ndryshimet e të tre Programeve Kombëtare të Sigurimit të Aviacionit Civil për të qenë në përputhje me amandamentimet e Rregullores së (BE) nr. 185/2010 si dhe amandamentimet e përmbushjes së kërkesave të dhëna në Rregulloren (KE) nr. 300/2008.

Në anën tjetër, në kuadër të avancimit dhe reformimit të strukturës institucionale në fushën e aviacionit civil do të themelohet Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Pas themelimit, pritet të emërohet Drejtori i Përgjithshëm dhe të arrihet funksionalizimi institucional i plotë i ASHNA-s, sipas Ligjit nr. 04/L-250.

Po ashtu, në kontekst të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknike, në fushën e aviacionit civil, inspektorët e sigurimit të aviacionit në kuadër të MPB-së do të ndjekin trajnime të avancuara profesionale. Kurse, AAC-ja do të vazhdojë të zbatohet në baza vjetore planin e detajuar të trajnimeve. Përveç kësaj, KE-ja pritet të mbështet edhe një seri trajnimesh në kuadër të programit të mbështetur nga KE-ja, ISIS II, për zbatimin e legjislacionit Single European Sky I dhe II në lidhje me skemat e tarifave dhe atë të performancës. Sa i përket shtimit të stafit, AAC-ja planifikon të punësojë një zyrtar për rregullim ekonomik të aviacionit i cili mes të tjerash do të zbatohet Rregulloren e BE-së nr. 1794/2006, Direktivën nr. 2009/12/KE dhe Rregulloren nr. 390/2013 dhe një zyrtar për çështje ligjore dhe rregullatore të aviacionit, që do të ngritë kapacitetet e transpozimit të Acquis.

Prioritetet afatmesme

Sa i përket prioritetëve afatmesme 2017-2020, AAC-ja do të vazhdojë të zbatohet në mënyrë progresive kërkesat që dalin nga Faza II e Marrëveshjes HPEA. Në bashkëpunim me Projektin ISIS II, Kosova do ta zbatohet paketën SES I për skemat e tarifimit dhe performancës në përgatitje për aplikimin e Paketës SES II e cila ka si qëllim menaxhimin e trafikut ajror. Po ashtu, AAC-ja do të transpozohet paketat legjislative SES II dhe SES II+ në përgatitje për të qenë pjesë e blloqeve funksionale të hapësirës ajrore duke filluar nga Periudha Referencë 3 më 2020. Më konkretisht, deri më 2019 do të transpozohen Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) nr. nr. 390/2013 dhe 391/2013. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe AAC-ja do të transpozohet edhe Rregulloren e re të BE-së për licencat e kontrollorëve, për ndarjen e kanaleve të zërit për SES, për kërkesat për performancën dhe ndërveprimin e mbikëqyrjes në SES, dhe për identifikimin e mjeteve ajrore për mbikëqyrje në SES. Certifikimi i aeroportit ANP "Adem Jashari" bazuar në Rregulloren (BE) nr. 139/2014 është planifikuar të bëhet deri në fund të vitit 2017.

Ndërkaq, MPB-ja do të transpozohet plotësisht në legjislacionin vendas plotësim-ndryshimet e Rregullores së (BE) nr. 185/2010 si dhe plotësim-ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 300/2008. Po ashtu, në vazhden e plotësim-ndryshimeve të rregulloreve bazë të sigurimit të aviacionit civil, përkatësisht të Rregullores së BE-së nr. 185/2010 si dhe atë të Rregullores së BE-së 300/2008, do të bëhen plotësim-ndryshimet e të tre Programeve Kombëtare të Sigurimit të Aviacionit Civil.

Buxheti për realizimin e prioritetëve do të planifikohet në kuadër të KASH-it si duke përfshirë vazhdimin e përkrahjes nga donatorët.

Transporti hekurudhor

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Sa i përket përafrimit të kornizës ligjore me acquis të BE-së në fushën e *transportit hekurudhor*, Kosova ka miratuar Ligjin për hekurudha, i cili ka qëllim rregullimin dhe zhvillimin e sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor. Për më tepër ky ligj ka transpozuar pjesërisht Direktivën e BE-së 2004/49; Direktivën e BE-së 2001/14, Direktivën e BE-së 91/440 dhe 95/18, Direktivën e BE-së 2007/59, Direktivën e BE-së 2008/57, si dhe Direktivën e BE-së 2012/34.

Ndërsa, në drejtim të plotësimit dhe harmonizimit të kornizës ligjore sekondare me acquis e BE-së, në fushën e hekurudhave janë miratuar UA dhe Rregulloret të cilat transpozjnë pjesë nga direktivat e lartpërmendura, si në vijim:

- UA nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- UA nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxhereve të Hekurudhave;
- UA nr. 04/2012 për Certifikatat dhe Autorizimet e Sigurisë;

- UA nr. 02/2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore;
- UA nr. 03/2013 për Vendosjen, Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave për Qasje në Infrastrukturë Hekurudhore;
- Rregullorja nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Rregullorja nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë;
- Rregullorja nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë;
- Rregullorja nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore;
- Rregullorja nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës;
- Rregullorja nr. 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit; dhe
- Rregullorja nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve.

Sa i përket miratimit të strategjive dhe programeve që kanë të bëjnë me implementimin e legjislacionit të transpozuar të BE-së në fushën e hekurudhave, MI-ja ka miratuar SSTMM e cila ka si qëllim zhvillimin dhe lidhjen e hekurudhave me korridoret pan-evropiane, ngritjen dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve në transporti për pasagjerë dhe mallra si dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe anëtarësimit në organizata rajonale dhe ndërkombëtare.

Në kontekst të rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në fushën e hekurudhave, MI-ja, përkatësisht departamenti i transportit tokësor ka për qëllim të hartoj politikën, strategjitë zhvillimore, monitorimin, rregullimin dhe zhvillimin e sektorit hekurudhor më qëllim përmirësimin e sistemit të sigurisë, ofrimit dhe pasjes së hapur dhe jo diskriminuese ndaj operatoreve hekurudhor. Ndërkaq, rregullimi i sektorit hekurudhor bëhet nga ARH-ja në këto fusha: Licencimi, Siguria, linteroperabiliteti dhe Rrregullimi i Tregut. Nga ana tjetër, hetimet e aksidenteve hekurudhore kryhen nga KHAIA në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Masat afatshkurtra

Sa i përket planifikimeve legjislative në kontekst të përafrimit të mëtejshëm të kornizës ligjore me *aquis* të BE-së në sektorin e hekurudhave për vitin 2016, ARH-ja parasheh miratimin e rregullores për të drejtat e pasagjerëve në transportin hekurudhor, e cila do të transpozohet pjesërisht Rregulloren e BE 1370/2007 dhe Direktivën 2012/34. Po ashtu, KHAIA-ja planifikon miratimin e rregullores për hetimin e incidenteve dhe aksidenteve hekurudhore e cila rregullore pjesërisht bën transpozimin e Direktivës 2004/49.

Ndërkaq, sa i përket aktiviteteve implementuese të planifikuara për vitin 2016 në transportin *hekurudhor* përfshijnë inspektimet për siguri dhe rekomandimet për përmirësim të mëtejshëm, si dhe masat dhe aktivitetet për njoftimin e pasagjerëve me të drejtat dhe mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, pritet të fillohet realizimi i projekt- dizajni teknik për rehabilitimin e përgjithshëm të pjesës jugore të Linjës së X Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë, ndërsa më pastaj të bëhet rehabilitimi i kësaj linje hekurudhore dhe në vazhdim edhe i pjesës veriore: Fushë Kosovë – Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë).

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve me qëllim implementimin efektiv të legjislacionit në fushën e hekurudhave planifikohet si në vijim punësimi i një hetuesi për aksidente dhe incidente hekurudhore në KHAIA, si dhe trajnim të vazhdueshme për përafrim të legjislacionit përmes TAIEK-it.

Prioritetet afatmesme

Në kontekst të realizimit të prioriteteve afatmesme në hekurudha, përkatësisht aktivitetet e planifikuara për periudhën 2017-2020 janë si më poshtë:

- Fillimi i zbatimit të ë Paketës 4-të hekurudhore, e cila përfshinë standardet dhe autorizimin për mjetet lëvizëse, aftësimin e fuqisë punëtore, menaxhimin e pavarur të infrastrukturës si dhe liberalizimin e tregut të brendshëm të udhëtarëve dhe mallrave.
- Rehabilitimi i përgjithshëm dhe modernizimi i Linjës së 10 hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë)
- Projekt dizajni për linjën lindore Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë

- Projekt dizajni për linjën jugperëndimore Klinë – Prizren
- Hulumtimi i mundësive për financimin e rehabilitimit të dy linjave të përmendura më sipër.

Buxheti për realizimin e prioriteteve afatmesme do të planifikohet në kuadër të KASH-it si dhe me përkrahje nga donatorët.

3.16. Kapitulli 15 i *acquis*-së: Energjia

Kapitulli 15 përmban *acquis* e BE-së për energjinë, pra objektivat e politikës së BE-së për energjinë janë aftësia konkurruese, siguria e furnizimit dhe qëndrueshmëria. Për më tepër, legjislacioni i BE-së në kapitullin e energjisë përbëhet nga rregullat dhe politikat, veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, përfshirë sektorin e thëngjillit, kushtet për qasje të barabartë në resurset për eksplorim dhe kushtet e prodhimit në sektorin e hidrokarbureve. Gjithashtu ky kapitull përcakton kushtet e tregut të brendshëm të energjisë, promovimin e burimeve të ripërtërishme, eficientë e energjisë dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore.

Detyrimi për të përafuar legjislacionin kosovar me kapitullin 15 të legjislacionit të BE-së buron nga **neni 74 dhe neni 114 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA-së)**. Dispozitat e detyrojnë Kosovën që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë zbatimin e tij.

Fusha e energjisë mbulohet nga Neni 114 i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në të cilin theksohet se bashkëpunimi në mes palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për energjinë. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin e themelimit të Komunitetit të Energjisë, me qëllim integrimin gradual të Kosovës në tregjet Evropiane të energjisë. Neni 114 i MSA-së, gjithashtu përmban edhe mundësinë e përfshirjes për ndihmë sa i përket përmirësimit dhe shumëllojshmërisë së furnizimit dhe qasjes në tregun e energjisë, si dhe aplikimin e rregullave të BE-së në transit, transmetim, shpërndarje dhe restaurim i ndërlidhjeve energjetike me rëndësi rajonale me vendet fqinjë.

Parashihet gjithashtu edhe zbatimi i *acquis* së BE-së për eficientë e energjisë, burimeve të ripërtërishme të energjisë si dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë, duke nxitur kështu eficientë e energjisë dhe energjinë e ripërtërishme. Përcaktohet edhe ndihma në hartimin e kushteve të kornizës për ristrukturimin e ndërmarrjeve të sektorit të energjisë dhe bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve në këtë sektor në përputhje me rregullat e tregut të brendshëm të energjisë për shthurjen.

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e sigurisë së furnizimit dhe tregut të energjisë

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit energjetik në Republikën e Kosovës bëhet nëpërmjet një paketë ligjesh që janë përgjithësisht në përputhje me *acquis*-në për fushën e energjisë të Bashkimit Evropian. Ndërsa, institucionet e sektorit përfshijnë ato qeveritare, rregullatore dhe ndërmarrjet energjetike.

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike janë kryesisht termike (97%) dhe përbëhen nga dy termocentrale, TC Kosova A dhe TC Kosova B. Pjesa tjetër e energjisë së prodhuar është nga HC Ujmani dhe HC-të tjera distributive, me rreth 3%.

Me 25 tetor 2005 Kosova ka nënshkruar Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe me këtë është bërë anëtare e barabartë në Komunitetin e Energjisë.

Raporti i KE-së për Kosovën thekson se ka pasur pak progres në procesin e përafrimit të legjislacionit në sektorin e energjisë. Kosova është ende në fazën fillestare të harmonizimit me *acquis* në këtë fushë dhe duhet të fillojë zbatimin e *acquis* mbi sigurinë e furnizimit, duhet të vazhdojë përafrimin dhe zbatimin e *acquis* mbi energjinë elektrike. Në raport rekomandohet që të merret vendim përfundimtar në lidhje me kapacitetin e ri gjenerues dhe dekomisionimin e TC Kosova 'A' nga ana e Qeverisë së Kosovës. Në përgjithësi theksohet nevoja për forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e rregullimit të tregut të

energjisë në veçanti në ruajtjen e pavarësisë të Rregullatorit të Energjisë, emërimin e plotë të bordit të ZRrE-së si dhe krijimin e mekanizmave transparente për të caktuar çmimet e energjisë. Kosova ka shumë pak gjasa për të përmbushur obligimet e saj për cilësinë e ajrit që dalin nga Traktati i themelimit të Komunitetit të Energjisë si dhe nuk e ka përgatitur planin për zvogëlimin e emetimeve. Sa i përket përmirësimit të sigurimit të energjisë progresi i vogël është bërë në hapjen e tregut dhe në mundësinë që konsumatorët të zgjedhin furnizuesit e tyre që nga 1 Janari 2015 po ashtu përmenden humbjet teknike dhe komerciale në rrjetin e distribucionit që mbeten akoma të larta (28.46%). Më tej theksohet mungesa e veprimit ndaj procedurës të Komunitetit të Energjisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me tarifën doganore mbi importet e produkteve të naftës. Në raportin në fjalë, përmendet mungesa e mekanizmit financiar për të ndihmuar konsumatorët e cenueshëm si dhe moseliminimi i subvencioneve në mes të kategorive të ndryshme të konsumatorëve.

Në kuadër të studimit të fizibilitetit (2012) pika 3.7.8. (energjinë, përfshirë sigurinë bërthamore) përmban bashkëpunimin që në kuadër të MSA-së Kosova në fushën e energjisë duhet konsideroj parimet e TKE-së dhe ekonomisë së tregut. Bashkëpunimi do të fokusohet veçanërisht mbi formulimin dhe planifikimin e politikave të energjisë, në përmirësimin e interkoneksioneve, modernizimin e infrastrukturës, themelimin e tregut konkurrues të energjisë, menaxhimin më të mirë të shërbimeve në fushën e energjisë, zhvillimin e burimeve të energjisë, nxitjen e kursimit të energjisë si dhe promovimin e efikasitetit të energjisë. Kosova duhet të ristrukturojë sektorin e energjisë, përfshirë tenderimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit dhe duhet të vazhdojë kompletimin e procesit të shturjes në konformitet me rregullat e Komunitetit të Energjisë. KOSTT ende nuk merr pjesë në mekanizmat rajonale për transitin e energjisë elektrike. Si rezultat i gjendjes aktuale, Kosova humb të ardhura dhe mungesa e kontrollit rrezikon stabilitetin e sistemit energjetik të Kosovës.

Për sa i përket *Dialogut të Procesit të Stabilizimit Asociimit "Infrastruktura"* të mbajtur në maj 2015 theksohet që prioritet për Republikën e Kosovës mbetet miratimi i pakos së III të acquis së energjisë. Ndërsa tek sektori i naftës nga pala kosovare pritet që të krijohet baza ligjore primare dhe sekondare në fushën e karburanteve duke miratuar ligjin për tregtinë me naftë, produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme dhe ligjin për rezervat e obligueshme të naftës dhe produktet rezervë të naftës si dhe udhëzimin administrativ (UA) për biokarburante dhe biolëngje. Kosova duhet që të vazhdojë plotësimin e kornizës së politikave strategjike për këtë sektor dhe prandaj një nga kërkesat është edhe miratimi i Strategjisë së Energjisë 2015-2024.

Në kuadër të kapaciteteve të reja gjeneruese rekomandim është thjeshtësimi i procedurave për autorizimin e mikro-gjeneratorëve dhe përgatitja e studimit të fizibilitetit për TC Kosova 'B' dhe studimit të fizibilitetit për lidhjet potenciale me tubacionet e gazit rajonal.

Sektori i energjisë në Republikën e Kosovës rregullohet nga një sërë ligjesh të cilat janë hartuar në bazë të Pakos së II-të të acquis për energjinë.

Si rrjedhim fusha e energjisë elektrike rregullohet përmes *ligjit nr. 03/L-184 për energjinë*, i miratuar në nëntor 2010, që përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen aktivitetet në sektorin e energjisë me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji për të krijuar kushte të një tregu funksional të energjisë dhe krahas kësaj duke promovuar edhe shfrytëzimin më efikas të energjisë, rritjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimin si dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaritë energjetike. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin energjinë elektrike, ngrohjen, gazin natyror dhe burimet e ripërtërishme të energjisë. Në këtë ligj janë transpozuar pjesërisht: direktiva nr. 2003/54/KE, rregullorja nr. 1228/2003/KE, direktiva nr. 2003/55 KE, rregullorja rr. 1775/2005/KE dhe direktiva nr. 2004/8/KE.

Ligj bazik në sektorin e energjisë është edhe *ligji nr. 03/L-201 për energjinë elektrike* i miratuar në nëntor 2010. Përmes këtij ligji përcaktohen rregullat e përgjithshme për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, transmissioinit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike dhe qasjes në interkoneksion, organizimin e qasjes ndaj sistemit të transmissioinit dhe sistemit të shpërndarjes, si dhe për funksionimin dhe qasjen ndaj tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Në këtë ligj janë transpozuar pjesërisht: direktiva nr. 2003/54/KE në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike që

shfuqizon direktivën nr. 96/92/KE dhe rregulloren nr. 1228/2003/KE mbi kushtet për qasje në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

Ndërsa në sektorin e gazit ekziston *ligji nr. 03/L-133 për gazin natyror*, i miratuar në nëntor 2009 që ka për qëllim të krijojë kornizën ligjore për bartjen, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe deponimin e gazit natyror. Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen ndaj tregut, kriteret dhe procedurat e vlefshme për dhënien e autorizimeve për bartjen, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe deponimin e gazit natyror dhe operimin e sistemeve. Në këtë ligj janë transpozuar pjesërisht: Direktiva nr. 2003/55/KE në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e direktivës nr. 98/30/KE dhe rregullorja nr. 1775/2005/KE mbi kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror.

Ligj tjetër i rëndësishëm është *ligji nr. 03/L-116 për ngrohje qendrore*, i miratuar në vitin 2008, përcakton kushtet dhe standardet për kryerjen e aktivitetit të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit me ngrohje, kushtet e operimit me stabilimente e objekte të tjera të ngrohjes qendrore, organizimin e tregut të ngrohjes dhe qasjen në rrjet të distribuimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që veprojnë sipas këtij ligji. Në këtë ligj janë transpozuar pjesërisht: direktiva nr. 2004/8/KE për promovimin e bashkëprodhimit bazuar në një kërkesë për ngrohje të dobishme në tregun e brendshëm të energjisë dhe ndryshimin e direktivës nr. 92/42/KE për cilësinë e karburanteve.

Sipas ligjit nr. 03/L-185 për rregullatorin e energjisë, definohet funksionimi i zyrës së rregullatorit për energji, si agjenci e pavarur e Kosovës, themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e ZRrE-së, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. Në këtë ligj janë transpozuar pjesërisht: direktiva nr. 2003/54/KE, rregullorja nr. 1228/2003/KE, direktiva nr. 2003/55/KE, rregullorja nr. 1775/2005/KE dhe direktiva nr. 2004/8/KE.

Ndërsa në sektorin e naftës ekziston *ligji nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës*. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i sektorit të naftës dhe derivateve të naftës që ka të bëjë me tregtimin, licencimin dhe monitorimin e rregullt të tregut me naftë dhe derivate të naftës, përmes nxitjes së konkurrencës dhe eliminimit të praktikave të pa lejuara tregtare.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka hartuar sipas Pakos së II të Energjisë këto rregulla:

- Rregulla për skemën mbështetëse;
- Rregulla e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik, rregulla për vendosjen e çmimeve të gjenerimit dhe rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes, të transmisionit dhe të tregut;
- Rregulla për taksat dhe kodi i etikës profesionale;
- Rregulla për informatat konfidenciale;
- Rregulla për masat administrative dhe gjokat;
- Rregulla për licencimin e aktiviteteve të energjisë;
- Rregulla për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
- Rregulla për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë;
- Rregulla për organizimin dhe funksionimin e zyrës së rregullatorit për energji;
- Rregulla për shkyçje dhe ri kyçje të konsumatorëve në sektor të energjisë;
- Doracaku i raportimit për sektorin e energjisë;
- Procedura e menaxhimit të kodeve teknike/operacionale; dhe
- Rregullat për krijimin e sistemit të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për sektorin e energjisë deri më tani janë hartuar disa dokumente strategjike të politikave të energjisë të cilat kanë për synim orientimin strategjik për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit në fjalë.

Si rrjedhim në prill 2010 është miratuar *Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2009-2018*, që orienton politika të përshtatshme për zhvillimin e këtij sektori. Kjo strategji ka për qëllim krijimin e kushteve për furnizim me energji dhe ofrimin e shërbimeve cilësore, ekonomikisht të favorshme për konsumatorët në Kosovë dhe identifikimin e politikave dhe masave kyçe që do të ndërmerren për avancimin e reformave në sektor për të mundësuar tërheqjen e investimeve private, mbrojtjen e mjedisit dhe integrimin sa më të plotë dhe më të shpejtë të sistemit energjetik të Kosovës me ato rajonale dhe evropiane. Për më tepër, në gusht 2011 është miratuar edhe *Strategjia e Ngrohjes së Republikës së Kosovës 2011-2018* e cila identifikon politikat dhe masat kryesore që duhet të ndërmerren për zhvillimin e sektorit të ngrohjes për të ofruar shërbime cilësore të ngrohjes për të gjithë konsumatorët.

Kuadri institucional dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e energjisë janë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila është përgjegjëse për krijimin e politikave të energjisë dhe marrjen e vendimeve për sektorin e energjisë, të cilat promovojnë reformat e tregut dhe qeverisjen e mirë. Ndërsa, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) bën rregullimin ekonomik të sektorit dhe licencimin e operatorëve në tregun e energjisë gjithashtu rishikon dhe miraton tarifat, si dhe bën monitorimin e tregut të energjisë. Organet tjera të qeverisë, siç janë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), si dhe Ministria e Financave (MF) kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të industrisë së energjisë. Ndërmarrjet kryesore që operojnë në sektorin e energjisë janë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK); Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT); Kompania Distribucionit me Energji Elektrike (KEDS); Kompania e Furnizimit me Energji Elektrike (KESCO); Ngrohoret e Qyteteve (Termokos-Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan); si dhe hidrocentralet: Ujmani, Lumbardhi, Radavci, Dikanci dhe Burimi.

Procesi i reformimit të sektorit të energjisë daton nga viti 2004 me themelimin e ZRRrE-së. Ky proces ka vazhduar me shthurjen e kompanisë vertikalisht të integruar KEK, dhe krijimin e operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut-KOSTT (viti 2006) që tani operon si entitet i veçantë. Shthurja e më tejshme ka vazhduar me ndarjen e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike nga KEK. Pas shthurjes, shpërndarja dhe furnizimi janë privatizuar në maj 2013 me kalim në pronësi të konsorciumit Limak-Çalik. Në fund të vitit 2014 është bërë shthurja ligjore e shpërndarjes dhe furnizimit që ka rezultuar me krijimin e dy kompanive: KEDS (distribucioni) dhe KESCO (furnizimi).

Masat afatshkurtra

Me qëllim të harmonizimit të mëtutjeshme të legjislacionit të Kosovës me dispozitat e pakos së III të *acquis* për energji dhe me kërkesë të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (vendimi nr. 2011/02/MC i Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, i dt.06.10.2011) MZhe-ja në bashkëpunim me ZRRrE, KOSTT, KEDS, KEK si dhe institucionet tjera relevante janë në proces të hartimit të projektligjeve si në vijim:

Projektligji për energjinë, kryesisht mbetet i njëjtë në substancë me ligjin në fuqi përveç që krijon kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues. Për më tepër, qëllimi kryesor ka të bëjë me harmonizimin e pakos së III përkatësisht transpozimin e pjesës së Direktivës nr. 2009/72/KE lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregullores nr. 714/2009/KE për kushtet e qasjes në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, Direktivës nr. 2009/73/KE për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, Rregullores nr. 715/2009/KE për kushtet e qasjes në rrjetet e bartjes të gazit natyror dhe Direktivës nr. 2009/28/KE lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishe.

Në projektligjin për energjinë elektrike, përcaktohen rregullat e përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar të energjisë elektrike, si pjesë e tregut regjional dhe evropian të energjisë elektrike, si dhe përcakton rregullat që kanë të bëjnë me qasjen e palëve në rrjet, obligimet për shërbime publike, të drejtat e konsumatorëve dhe kushtet e konkurrencës. Ky projektligj është përafëruar pjesërisht me Direktivën nr. 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe

Këshillit mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, e cila shfuqizon Direktivën nr. 2003/54/KE dhe Rregulloren nr. 714/2009/KE, mbi kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

Në dispozitat e *projektligjit për rregullatorin e energjisë*, përcaktohen kompetencat, detyrat dhe funksionet e ZRrE-së, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorit të transmisionit, procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. ZRrE-ja ushtron kompetencat e agjencisë së pavarur si pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës. Ky projektligj është përafuar pjesërisht me Direktivën nr. 2009/72/KE mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregulloren nr. 714/2009/KE për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, Direktivën nr. 2009/73/KE për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, Rregulloren nr. 715/2009/KE për kushtet e qasjes në rrjetet e bartjes të gazit natyror dhe Direktivën nr. 2009/28/KE lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Për sa i përket sektorit të gazit, është hartuar projektligji për gazin natyror, që përmban një numër dispozitash për përcaktimin e kornizës ligjore për transmisionin, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe deponimin e gazit natyror, organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen ndaj tregut, kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve për transmision, shpërndarje, furnizim, përdorim, deponim të gazit natyror dhe operimin e sistemeve. Me synim të përafimit të mëtejme me *acquis* ky projektligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën nr. 2009/73/KE për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe Rregulloren nr. 715/2009/KE për kushtet e qasjes në rrjetet e bartjes të gazit natyror si dhe Direktivën nr. 2009/28/KE lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Në kuadër të zhvillimit të tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë termike është hartuar projektligji për energjinë termike. Qëllimi i tij është përcaktimi i kushteve për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë termike për ngrohje/ftohje të përqendruar, sipas ekonomisë së tregut të lirë, plotësimit të kërkesës së konsumatorit dhe mbrojtjes së mjedisit, furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial për konsumatorët që të gëzojnë të drejtë për t'u kyçur në sistemet e energjisë termike dhe për t'u furnizuar me energji termike sipas standardeve. Ky projektligj është përafuar pjesërisht me Direktivën nr. 2009/28/KE lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme. Në drejtim të plotësimit dhe harmonizimit të mëtejme të kornizës ligjore në sektorin e naftës për periudhën afat shkurt (2016) do të miratohet projektligji për rezervoat e obligueshme të naftës dhe produkteve të naftës rezervë, sipas këtij ligji institucioni përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e rezervave të naftës është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Në këtë ligj është transpozuar pjesërisht Direktiva nr. 2009/119/KE për vendosjen e obligimit mbi shtetet anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës së papërpunuar dhe derivateve të naftës. Ndërsa në projektligjin për tregtinë me naftë, produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme do të transpozohen pjesërisht Direktivat nr. 2009/30/KE, Direktiva nr. 2009/28/KE dhe Direktiva nr. 2005/33/KE. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari me naftë, produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme duke përfshirë importin, deponimin, tregtinë me shumicë dhe pakicë, prodhimin, përdorimin, si dhe për institucionet që bëjnë mbikëqyrjen dhe monitorimin e tregut në fjalë.

Në këtë periudhë parashihet edhe miratimi i *Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2015-2024* që është rishikim i *Strategjisë për Energji 2009-2018* dhe *Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2015-2017*. Programi përbën mekanizmin e domosdoshëm që MZHE-ja të jetë në gjendje t'i detajojë politikat, t'i alokojë detyrat, t'i ndërmarrë aksionet specifike dhe ta monitorojë progresin e realizimit të *Strategjisë së Energjisë*.

Në kuadër të aplikimit të rregullave të BE-së për transit, transmetim, shpërndarje dhe restaurim të ndërlydhjeve energjetike me rëndësi rajonale me vendet fqinjë përgjatë vitit 2016 do të realizohen aktivitetet e mëposhtme:

- Implementimi i marrëveshjes së përkohshme të kycjes në ENTSO-E;
- Implementimi dhe funksionalizimi i linjë interkonektive 400kV NS Kosova B-NS Tirana 2;
- Realizimi i rregullimit sekondar Kosovë-Shqipëri;
- Vendosja e infrastrukturës për rregullimin sekondar Kosovë-Shqipëri; dhe
- Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri komercial KOSTT-KEDS/OSSH.

Ndërsa sa i përket hapjes së tregut të brendshëm të energjisë elektrike, ZRrE përgjatë vitit 2016 do të ndërmerr veprime në drejtim të de-rregullimit të çmimeve të prodhimit të energjisë elektrike duke u bazuar në ligjet e reja të energjisë të Kosovës të përafuara sipas pakos së III të energjisë. ZRrE-ja, gjithashtu do të ndërmerr hapa për eliminimin e ndër-subvencionimit në mes grupeve tarifore. Kurse në kuadër të hapjes së tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe rritjes së sigurisë së furnizimit ZRRE-ja do të ndërmerr veprime të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë për zhvillimin e konkurrencës duke u mundësuar hyrjen në treg të furnizuesve të rinj të energjisë elektrike.

Në kuadër të procesit të dekomisionimit të TC Kosova 'A' (në përputhje me vendimin e Qeverisë 137 nr. 04/156) do të realizohen aktivitetet si në vijim:

- Përgatitja e manualit/udhëzuesit për procedurat ligjore për proces të dekomisionimit;
- Trajnimi për anëtarët e grupit punues dhe departamentit për dekomisionim në KEK;
- Përcaktimi i procedurave për lejet e nevojshme për dekomisionim; dhe
- Inventarizimi i të gjitha materialeve të mbeturinave si dhe përcaktimi i lokacionit për mbeturina jo të rrezikshme.

Sa i përket krijimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, përkatësisht ndërtimit të TC Kosova e RE, do të zhvillohen negociatat për përzgjedhjen e ofertuesit. Si rezultat, në vazhdim përmes prokurimit ndërkombëtar do të përzgjidhen edhe ofertuesit për inxhinieri, projektim, ndërtim, operim dhe mirëmbajtje.

Qeveria e Kosovës ndan për MZhe-së buxhetin në shumë prej 27, 4 milion Euro, nga i cili 25,1 milion nga BRK dhe 1, 3 milion Euro nga huamarrja.

Përkrahja nga ana e donatorëve kryesisht është koncentruar në projektin lidhur me procesin e dekomisionimit, Projektin për rehabilitimin e ngrohtores së Gjakovës dhe zgjerimin e rrjetit të Termokosit si dhe projektin për ndërtimin e objekteve për deponimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme. Të gjitha këto investime financiare vijnë përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit dhe arrijnë shumën rreth 33.5 milion Euro.

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatmesme në fushën e tregut të energjisë dhe sigurisë së furnizimit, në aspektin e politikave planifikohet që të bëhet rishikimi i Strategjisë së Energjisë për periudhën 10-vjeçare dhe rishikimi i Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë.

Ndërkaq sa i përket përmirësimit në sigurinë e furnizimit nga pikëpamja e transmisionit dhe nga këndvështrimi i furnizimit me energji elektrike janë planifikuar këto aktivitete:

- Harmonizimi i legjislacionit sekondar të KOSTT me pakon e III-të, përfshirë harmonizimi i kodeve teknike të KOSTT me dispozitat e Kodit të Rrjetit të ENTSO-E;
- Harmonizimi i rregullave të tregut dhe procedurave të rregullave të tregut që do të bëhet përmes rregullores nr. 543/2013/KE;
- Plotësimi i standardeve që rrjedhin nga katalogu i masave në kuadër të marrëveshjes së kycjes;
- Anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E;
- Instalimi i transformatorëve të dytë 300 MVA në NS 400/110 kV Ferizaj 2 dhe në NS 400/110 kV Pejë 3;
- Përmirësimi dhe përforcimi i nënstacioneve-NS (Mitrovica, Drenasi, Fushë Kosova, Prishtina 6 dhe Dragashi);
- Harmonizimi i legjislacionit sekondar të energjisë në përputhje me pakon e III të energjisë të BE-së nga ana e ZRrE-së.

Sa i përket procesit të dekomisionimit aktivitetet afatmesme që do të realizohen janë si në vijim:

- Përgatitja e studimit të VNM-së, planit detal për çmontim të objekteve dhe tender dosjes;
- Ndarja e mbeturinave, ruajtja e tyre në përputhje me standardet përkatëse për llojet e mbeturinave, zbatimi i çmontimit fizikë të objekteve, pastrimi i terrenit dhe ri kultivimi.
- Ndërtimi i objektit për deponimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme në nivel vendi, ku do të vendosen edhe mbeturinat e rrezikshme të cilat dalin nga procesi i çmontimit të objekteve në lokacionin e TC Kosova 'A'.

Aktivitet tjetër afatmesëm është mbikëqyrja e zhvillimit të aktiviteteve të ndërtimit të termocentralit Kosova e Re nga investitori dhe marrja e masave të tjera të nevojshme për asistim të ofertuesit të preferuar në realizimin e kërkesave të tyre pranë institucioneve publike në Kosovë.

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e efijencës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë

Kosova përmes nenit 114 të MSA do të përafroj dhe zbatoj acquis e BE-së për efijencën e energjisë, burimeve të ripërtërishme të energjisë si dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë, duke nxitur kështu kursimin e energjisë, efijencën e energjisë, energjinë e ripërtërishme si dhe hulumtimin dhe zbutjen e ndikimit mjedisor nga prodhimi dhe konsumi i energjisë. Politika e përgjithshme për promovimin e efijencës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme është nën kompetencën e MZHE-së. Këto burime zënë vend të rëndësishëm në parashikimin e investimeve në sektorin e energjisë. Gjithashtu edhe ligjet për sektorin e energjisë në Kosovë përkrahin investimet për kapacitetet gjeneruese nga BRE-të. Kriteret për investime në BRE duhet të marrin parasysh caqet e përcaktuara nga MZHE, nivelin e përballueshmërisë së konsumatorëve, stabilitetin e sistemit dhe ndikimin e tyre në balancimin e sistemit. Për me tepër, direktivat e BE-së dhe obligimet që dalin nga Traktati i themelimit të Komunitetit të Energjisë (TKE) definojnë kërkesat lidhur me BRE-të dhe Kosova si anëtare e TKE-së është e obliguar të plotësojë cakun prej 25% të energjisë të prodhuar nga BRE-të deri në vitin 2020.

Zbatimi i politikës së përcaktuar të BRE-ve bazohet në Strategjinë e Energjisë dhe në tri ligjet bazike ekzistuese të sektorit të energjisë: Ligji për energjinë, ligji për rregullatorin e energjisë dhe ligjin për energjinë elektrike si dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për BRE (2011-2020) që përmban caqet obligative dhe masat për realizimin e këtyre caqeve. Gjithashtu caqet janë të përcaktuara edhe me udhëzimin administrativ nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve.

Këto caqe është parashikuar të plotësohen nga energjia fotovoltaike, biomasa solide, era, hidrocentralet ekzistuese, të reja dhe nga HC 'Zhur'. Aktualisht në Kosovë, si burime të ripërtërishme të shfrytëzueshme për prodhimin e energjisë elektrike janë burimet ujore nga hidrocentralet (Lumbardhi, Radavci, Dikanci, Burimi dhe Ujmani), energjia e prodhuar nga era me kapacitet të instaluar 1.35 MW si dhe projekti i energjisë fotovoltaike me kapacitet 102 kW.

Sa i përket kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE-të deri në vitin 2020 parashikohet të instalohen 240 MW energji nga hidrocentralet nga era kapaciteti i instaluar 150 MW ndërsa nga energjia fotovoltaike 10 MW si dhe energjia nga biomasa me kapacitet prej 14 MW.

Kapacitetet e instaluar të energjisë së ngrohjes në vitin 2020 parashikohen të jenë: energjia gjeotermale 10 MW, energjia diellore 70 MW dhe energjia nga biomasa drusore prej drurit të zjarrit prej 264.5 ktoe.

Zyra e Rregullatorit për Energji si institucion përgjegjës për implementimin e politikave për sektorin e BRE-ve ka miratuar njërën prej masave më të rëndësishme stimuluese për BRE-të siç është tarifa nxitëse (feed in) si në vijim:

- energjia e ujit: 63.3 Euro/MWh;
- energjia e erës: 85 Euro/MWh;
- energjia nga biomasa solide: 71.3 Euro/MWh; dhe
- energjia fotovoltaike: 136,4 Euro/MWh.

Ndërsa sa i përket harmonizimit me standardet e komitetit evropian për standardizime (CEN) janë adoptuar 128 standarde në fushën e energjisë elektrike dhe 76 standarde në fushën e gazit natyror. Kurse standardet CEN në fushën e efijencës së energjisë në mbështetje të direktivës për performanca energjetike në ndërtesa janë: Neni 9 (Ndërtesat me gati zero konsum të energjisë), Neni 11 (çertifikatat e performancës energjetike), Neni 12 (çështje të çertifikatave të performancës energjetike), Neni 13 (lëshimi i çertifikatave të performancës energjetike), Neni 14 (inspektimi i sistemeve të ngrohjes), Neni 15 (inspektimi i sistemeve të ajrit të kondicionuar) dhe Neni 16 (inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar).

Sfidat e identifikuar nga *Raporti i KE-së për Kosovën* në sektorin e efijencës së energjisë dhe BRE-ve përfshijnë rishikimin e ligjit për efijencën e energjisë me qëllim që të përputhet me direktivat e fundit të BE-së. Kosova ende nuk e ka harmonizuar legjislacionin me direktivën për energji të ripërtërishme të vitit 2009 dhe nuk ka mekanizëm për monitorimin e progresit për arritjen e qaveve deri në vitin 2020. Për me tepër, Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë ka mungesë të stafit dhe nuk ka kapacitete për të monitoruar, vlerësuar dhe verifikuar progresin drejt objektivave. Sa i përket investimeve kapitale në fushën e efijencës së energjisë, Kosova përballet me vështirësi të shumta të cilat vështirësojnë zbatimin e direktivës për performancën energjetike në ndërtesa. Prandaj nga ana e Kosovës kërkohet që të ndërmarr masat e nevojshme për të krijuar një klimë të favorshme për investime në efijencën e energjisë. Ajo që rekomandon raporti i progresit është krijimi i fondit për efijencë të energjisë. Kosova gjithashtu duhet të ndërmerr hapa konkret në përmirësimin e monitorimit dhe raportimit të statistikave për energji efijente. Në kuadër kapaciteteve të reja gjeneruese sa i përket hidrocentraleve të reja duhet të respektohet legjislacioni mjedisor i BE-së.

Nga raporti i studimit të fizibilitetit për Kosovën (2012) del se Kosova ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e efijencës së energjisë. Si rezultat, institucionet që punojnë në këtë fushë duhet të forcohen dhe të kompletohet Agjencia e Kosovës për efijencë të energjisë. Kosova gjithashtu duhet të miratojë aktet nënligjore për të përmbushur objektivin e saj 9% deri më 2018. BRE-të janë të kufizuara ndërsa kuadri rregullator për zhvillimin e energjisë së ripërtërishme gjithashtu duhet të përmirësohet në qoftë se Kosova do të përmbushë objektivin e saj të planifikuar për të prodhuar 25% të energjisë së saj nga BRE-të deri në vitin 2020. Në kuadër kapaciteteve të reja gjeneruese sa i përket hidrocentraleve të reja duhet të respektohet legjislacionin mjedisor i BE-së.

Ndërsa, sfida e identifikuar në fushën e efijencës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë e dal nga takimi i Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit 'Infrastruktura' përfshinë përgatitjen e planit të tretë të veprimit për efijencë të energjisë.

Në kuadrin e *përafrimit të legjislacionit primar* në fushën e efijencës së energjisë dhe BRE-ve me direktivat e BE-së, është miratuar ligji nr. 04/L-016 për efijencën e energjisë në korrik 2011.

Ky ligj rregullon çështjen e efijencës së energjisë, përgatitjen dhe miratimin e planeve të efijencës së energjisë dhe përcaktimin e roleve, detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve si dhe adresimin e detyrimeve që burojnë nga Traktati i themelimit të Komunitetit të Energjisë lidhur me efijencën e energjisë.

Në këtë ligj janë transpozuar pjesërisht: direktiva nr. 2006/32/KE për promovimin e efijencës së energjisë të përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike dhe direktiva nr. 2010/30/KE si dhe amandamentimi i direktivës nr. 92/75/KE.

Ndërsa legjislacioni sekondar ekzistues në fushën e efijencës së energjisë dhe BRE-ve është si në vijim:

- UA nr. 01/2013 për caqet e burimeve të ripërtërishme të energjisë; që transponon pjesërisht direktivën nr. 2009/28/KE;
- UA nr. 02/2013 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga BRE; që transponon pjesërisht direktivën nr. 2009/28/KE;
- UA nr. 14/2012 për promovimin e efijencës së energjisë të përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike; që transponon pjesërisht direktivën nr. 2006/32/KE;
- UA nr. 09/2012 për etiketimin e pajisjeve elektrike që shpenzojnë energji; që transponon pjesërisht direktivën nr. 2010/30/KE; dhe

- UA nr. 01/2012 për auditimin e energjisë; që transponon pjesërisht direktivën nr. 2010/31/KE si dhe rregulloren teknike nr. 03/2009 për kursimin e energjisë termike dhe mbrojtjen termike në ndërtesa.

Sa i përket *miratimit të planeve dhe programeve* që kanë të bëjnë me implementimin e legjislacionit të transpozuar të BE-së, MZHE-ja ka miratuar më 30 shtator 2011, *Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE 2010-2018)* që është dokument bazik për implementimin e politikave për eficiencë të energjisë në Kosovë. Ky plan parasheh arritjen e caktimit indikativ prej 9% kursim të energjisë elektrike deri në vitin 2018 apo 91. 89 ktoe. Përveç kësaj përmban një numër masash për përmirësimin e eficiencës së energjisë në sektor të ndryshëm: amvisëri, shërbime, industri, bujqësi dhe transport.

Po ashtu nga Qeveria e Republikës së Kosovës është miratuar në qershor të vitit 2013 edhe *Plani i Dytë Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2013-2015* i cili ka për qëllim planifikimin e politikave të eficiencës së energjisë dhe zbatimin e tyre në Kosovë me të cilat do të nxitet financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe do të mobilizohen fondet vendore për zbatimin e masave të planifikuara të eficiencës së energjisë. Ky plan përmban cakun indikativ të ndërmjetëm të kursimit të energjisë në vlerë prej 3%.

Për zbatimin e politikës së burimeve të ripërtërishme të energjisë, MZHE ka miratuar *planin afatmesëm dhe afatgjatë të veprimit për BRE* si dhe ka caktuar caqet prej 25% të obligueshme dhe 29. 47% vullnetare deri në vitin 2020. Qëllimi i këtij plani është promovimi i shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në mënyrë efektive dhe kost-efektive duke rritur diversifikimin e prodhimit të energjisë në dobi të rritjes së sigurisë së furnizimit me energji dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Po ashtu, me këtë plan janë parashikuar edhe masat e nevojshme stimuluese për promovimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë.

Ndërsa, për zbatimin e legjislacionit në fushën e eficiencës së energjisë dhe BRE-ve janë përgjegjëse institucionet e pushtetit të nivelit qendror: MZHE, AKEE, MMPH, MBPZHR, MTI si dhe institucionet e pavarura dhe publike siç janë: ZRrE, KEK dhe KOSTT.

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE) është institucion ekzekutiv në kuadër të MZHE-së i cili zbaton politikat e eficiencës së energjisë përmes vlerësimit të mundësive të kursimit të energjisë në të gjithë sektorët e konsumit të energjisë.

Rol të rëndësishëm lidhur me energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme ka ZRrE-ja që përfshin licencimin e aktiviteteve të gjenerimit, miratimin e kontratave standarde, miratimin e rregullave të tregut që garantojnë qasje në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, miratimin e rregullave dhe rregulloreve për dhënie të certifikatave të origjinës dhe certifikatave të gjelbra si dhe miratimin e tarifave 'feed-in' për BRE-të. Po ashtu, rol domethënës në zbatimin e eficiencës së energjisë ka edhe pushteti i nivelit lokal, përkatësisht komunat e Kosovës.

Masat afatshkurtra

Në kuadër të legjislacionit primar në fushën e eficiencës së energjisë dhe BRE-ve do të miratohet *projektligji për eficiencë të energjisë* i cili do të implementon parimet e politikave të BE-së dhe kuadrin ligjor mbi eficiencën e energjisë në përputhje të pjesëshme me Direktivën nr. 2012/27/KE për eficiencë të energjisë e cila amendamenton Direktivën nr. 2009/125/KE dhe Direktivën nr. 2010/30/KE dhe shfuqizon Direktivën nr. 2004/8/KE dhe Direktivën nr. 2006/32/KE.

Po ashtu do të miratohet edhe *projektligji për performancën e energjisë në ndërtesa* që është përgjegjësi e MMPH-së e cila do të transponon pjesërisht Direktivën nr. 2010/31/KE për performancën energjetike në ndërtesa.

Sa i përket akteve nënligjore që burojnë nga ligji për performancën e energjisë në ndërtesa parashikohen të miratohen këto rregullore:

- Rregullorja për vendosjen e minimumit të performancës energjetike në ndërtesat e reja në ndërtesat e banimit, ndërtesat në renovim dhe ndërtesat e të gjitha llojeve të tjera nga ato të banimit që do të transpozon pjesërisht Direktivën nr. 2010/31/KE për performancën energjetike në ndërtesa;
- Rregullorja për certifikatën e performancës energjetike për ndërtesat e reja dhe ndërtesat tjera që do të transpozon pjesërisht Direktivën nr. 2010/31/KE për performancën energjetike në ndërtesa; dhe
- Rregullorja për sistemin e inspektimit të pajisjeve të ngrohjes dhe klimatizimit që do të transpozon pjesërisht Direktivën nr. 2010/31/KE për performancën energjetike në ndërtesa.

Ndërsa në sektorin e naftës sa i përket legjislacionet sekondar do të miratohen:

- UA për përdorimin e biokarburanteve dhe biolëngjeve që do të transpozon pjesërisht Direktivën nr. 2009/28/KE mbi promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripëtrishme; dhe
- UA për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës që do të transpozon pjesërisht Direktivën nr. 2009/30/KE të cilësisë së karburantit.

Aktivitetet tjera implementuese të planifikuara për vitin 2016 janë si më poshtë:

- Plotësimi i caqeve indikative për eficientë të energjisë përmes zbatimit të masave të EE në harmoni me Planin e Veprimit për Eficencë të Energjisë (2010-2018);
- Plotësimi i caqeve të energjisë nga BRE-të përmes zbatimit të projekteve konkrete në përputhje me parashikimin në Planin Kombëtar të Veprimit për BRE-të;
- Përgatitja e Planit të Tretë të Veprimit për Eficencë të Energjisë 2016-2018; dhe
- Përgatitja e Planit Social të Veprimit për Energji.

Në fushën e eficientë të energjisë si zbraçsi konsiderohet mungesa e fondit për eficientë të energjisë si dhe transpozimi i Direktivës nr. 2010/31/KE përmes ligjit për performancën e energjisë në ndërtesa. Sa i përket implementimin efektiv të legjislacionit ekziston nevoja e rritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknike të stafit të AKEE, përfshirë rritjen e numrin të stafit.

Në kuadër të buxhetit të siguruar dhe fondeve të asistencës së huaj teknike për të gjitha masat implementuese situata është si në vijim:

- Mbështetje për implementimin e pakos së III të ligjeve për energji me fokus në eficientë të energjisë dhe BRE-të në kuadër të IPA II me kosto prej 2.5 milion Euro;
- Projekti i Bankës Botërore për financimin e masave për eficientë të energjisë në ndërtesat e institucioneve të nivelit qendror si dhe promovimin e energjisë nga BRE-të përmes një kredie të butë me vlerë prej 31 milion dollar;
- Projekti me KfW kredi me vlerë prej 7.5 milion Euro për financimin e masave të eficientë të energjisë në ndërtesat e shërbimit publik të nivelit komunal.

Prioritetet afatmesme

- Rishikimi i Strategjisë së Energjisë për periudhën 10 vjeçare;
- Hartimi i Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së rishikuar;
- Rishikimi i rregullt i bazës nënligjore për caqet e energjisë nga BRE-të në përputhje me kërkesat e Planit Kombëtar të Veprimit për BRE (2011-2020);
- Rishikimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Eficencë të Energjisë (2010-2018) në përputhje me kërkesat e direktivës nr. 2012/27/KE; dhe
- Hartimi i rregullores për ndërtesat me kërkesë zero të energjisë që është përgjegjëse MMPH.

Përgjatë periudhës afatmesme gjithashtu do të bëhet zbatimi i masave të parashikuara në Planin Kombëtar për Eficencë të Energjisë (PKVEE 2010-2018) dhe në Planet afatmesme të eficientë të energjisë si dhe zbatimi i masave dhe projekteve të planifikuara në PKVBRE 2011-2020.

Gjithashtu do të zbatohen procedurat për projektin e HC Zhur (2016-2020) me aktivitetet e planifikuara si: vendimi për ri-nisjen e procesit për HC Zhur, formimi i njësisë për HC Zhur dhe kontraktimi i këshilltareve të transaksionit, përgatitja e dosjes së tenderit, finalizimi i procedurave tenderuese dhe

shpallja e tij, përzgjedhja e investitorëve. Për me tepër, aktivitet tjetër është studimi i para fizibilitetit për projektet e ndërtimit të sistemeve të ngrohjes qendrore në qytetet Drenas, Kastriot, Mitrovicë dhe Zveçan. Në Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve 2015-2017 lidhur me efikasitetin e energjisë dhe BRE-ve janë planifikuar të zhvillohen aktivitetet si në vijim: fushata promovuese, auditimi i energjisë dhe zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesat e shërbimit publik, kryesisht në shkolla, si dhe do të instalohet sistemi i ngrohjes qendrore në rreth 20 shkolla në komuna të ndryshme.

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe të sigurisë bërthamore

Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRrSB) është themeluar në qershor të vitit 2011, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bazë të ligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo jonizues, Jonizues dhe Siguria Bërthamore (nr. 03/L-104). Që nga korriku i vitit 2012 në bazë të ligjit nr. 04/L-067 mbi Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, Agjencia është organ i pavarur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Mandati i AKMRrSB mbi përgjegjësitë dhe fushë-veprimtarinë e tij është i përcaktuar me ligjet e lartpërmendura ku aktiviteti i Agjencisë është i përqendruar në zbatimin e politikave dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore që nënkupton mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit në funksion të mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore si rezultat i përdorimit të burimeve të rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues si dhe të materialeve radioaktive dhe bërthamore për qëllime mjekësore, kërkimore-shkencore, industriale dhe qëllime të tjera të parapara me konventat ndërkombëtare.

Për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore janë përgjegjëse: AKMRrSB; Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Ministria e Financave; Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Për më tepër, mbikëqyrja administrative e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar kryhet nga AKMRrSB.

Raporti i KE-së për Kosovën në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore thekson se nuk ka progres në përafrimin e legjislacionit në këtë fushë dhe akoma nuk është miratuar ligji i ri. Agjencia përballlet me një kombinim të sfidave që lidhen me kapacitetin e kufizuar për licencim dhe inspektim. Si rrjedhim nuk ka monitorim të rrezatimit (për shembull për lokacionet potenciale me uranium të varfëruar) si dhe nuk ekziston plani emergjent radiologjik. Për me tepër, buxheti i AKMRrSB është i pamjaftueshëm për zbatimin e mandatit dhe atë në aspektet e licencimit, sigurimit dhe shëndetit publik. Në përfundim sfidë mbetet mos zgjedhja e lokacionin për të ruajtur mbetjet radioaktive, pavarësisht marrjes së ndihmës së BE-së për këtë çështje. Pra, Kosova duhet të identifikojë deponinë e përkohshme për ruajtje të mbeturinave radioaktive ndërsa duhet të vazhdoj puna për të gjetur lokacionin e përhershëm.

Në dokumentin e *Studimit të Fizibilitetit për Kosovën (2012)* në fushën e sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi theksohet se Kosova nuk ka objekte bërthamore por duhet të përgatitet për transpozimin e mëtejshëm të acquis në këtë fushë, të fuqizohet agjencia si dhe të rritet numri i zyrtarëve.

Për sa i përket kornizës legjislative, kërkesë e dal nga takimi i DPSA 'Infrastruktura' e vitit 2015 është miratimi i amendamenteve të ligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore dhe strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve në agjenci rekomandohet forcimi i stafit që merret me licencim dhe rridhjen e prioritetëve për licencim. Sfidë tjetër është edhe inventarizimi i mbetjeve radioaktive dhe themelimi i organizatave teknike të shërbimeve (TSO). Për më tepër, agjencia duhet të adoptoj dhe të ratifikoj konventat ndërkombëtare si dhe të anëtarësohet në organizatat në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Një nga angazhimet e Kosovës që rrjedhin në kuadër të MSA-së, konkretisht nenit 114 të saj, është edhe përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimi jonizues. Për më tepër, të gjitha

dispozitat në fushën e gjenerimit të rrezatimit bërthamor, sigurisë bërthamore janë të bazuara në Traktatin EURATOM (Traktati i Krijimit të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, 1957) i cili siguron që anëtarët e Komunitetit Evropian duhet të krijojnë dhe sigurojnë standarde uniforme të sigurisë nga teknologjia bërthamore për të mbrojtur popullsinë dhe shëndetin e punëtorëve.

Prandaj sa i përket legjislacioni primar aktual në këtë fushë në shkurt 2010 është miratuar ligji nr. 03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo jonizues dhe jonizues dhe siguria bërthamore, që ka për qëllimi vendosjen e bazës ligjore për shfrytëzimin e sigurt të energjisë bërthamore, rrezatimin jonizues dhe jo jonizues, si dhe sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive. Për më tepër, në maj 2012 është miratuar edhe ligji nr. 04/L-067 për Agjencinë e Kosovës për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore që themelon AKMRrSB si agjenci ekzekutive e Qeverisë dhe përcakton statusin detyrat dhe përgjegjësitë e agjencisë, si dhe hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Ndërsa në kuadër të legjislacioni sekondar ka hartuar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Agjencisë e cilat akoma nuk është miratuar.

Për zbatimin e legjislacionit në fuqi, Agjencia është në proces të hartimit të *Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore 2015–2025*. Për më tepër, objektivi i përgjithshëm i strategjisë në fjalë është krijimi i sistemit efikas dhe transparent për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, i cili siguron një bazë për mbrojtjen e popullatës dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues sipas kornizës ligjore dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë rast siguria mbulon sigurinë ndaj rrezatimit, sigurinë bërthamore, sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive dhe sigurinë e transportit të materialeve radioaktive. Orientimet e politikave të këtij dokumenti, janë të planifikuara për dhjetë vitet e ardhshme (2015-2025) kurse Plani i Veprimit për periudhën pesë vjeçare 2015-2020. Fokusimi në dhjetë vitet e ardhshme do të jetë në harmonizimin e legjislacionit me dispozitat e BE-së, IAEA-së, implementimin e legjislacionit, monitorimin e territorit të Kosovës nga aspekti i rrezatimit në kohë reale si dhe inspektimin e rregullt me qëllim të kontrollit të zbatimit të kriteve të përcaktuara nga Agjencia, për përdoruesit e burimeve radioaktive.

Masat afatshkurtra

Në kontekst të përafrimit të mëtejme të kornizës legjislative vendore me acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, do të miratohet ligji i ri për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, brenda të cilit do të përfshihet ligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore. Prandaj, me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen: Ligji nr. 03/L-104 për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare dhe ligji nr. 04/L-067 për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore. Në këtë ligj të ri do të transpozohen pjesërisht direktivat e EURATOM-it, përkatësisht Direktiva nr. 2013/59/Euratom, që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtje kundër rreziqeve që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues, dhe Direktiva nr. 2009/71/Euratom, që përcakton kuadrin e komunitetit për sigurinë bërthamore të instalimeve bërthamore, Direktiva nr. 2011/70/Euratom për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive dhe Vendimin e 5 marsit 2008 për krijimin e dokumentit standard për mbikëqyrjen dhe kontrollin e dërgesave të mbetjeve radioaktive dhe karburanteve të shpenzuara që i referohet direktivës së Këshillit nr. 2006/117/Euratom si dhe Rekomandimin e Këshillit nr. 1999/519/KE mbi kufizimet në ekspozimin e publikut ndaj fushave elektromagnetike (0 Hz deri në 300 GHz).

Ndërsa në drejtim të plotësimit dhe harmonizimit të mëtejme të kornizës ligjore sekondare nga Agjencia do të hartohen këto rregullore:

- Rregullorja për menaxhimin e mbetjeve radioaktive, do të transpozohet tërësisht konventën e përbashkët për sigurinë e menaxhimit të karburantit të shpenzuar dhe sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive dhe direktivën e Këshillit nr. 2011/70/Euratom, Direktivën e Këshillit nr. 2013/59/Euratom që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtje kundër rreziqeve që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe direktivat e shfuqizuara 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom.

- Rregullorja për licencimin e aktiviteteve me burime radioaktive, do të transpozohet tërësisht direktivën e Këshillit nr. 2013/59/Euratom;
- Rregullorja për inspektime, që do të transpozohet tërësisht direktivën e Këshillit 2013/59/Euratom;
- Rregullorja për autorizimin e shërbimeve teknike të aktiviteteve profesionale në mbrojtjen nga rrezatimi, që do të transpozohet tërësisht direktivën e Këshillit nr. 2013/59/Euratom;
- Rregullorja për limitet e dozave të ekspozimit profesional, përfshirë ekspozimin e publikut, që do të transpozohet tërësisht direktivën e Këshillit nr. 2013/59/Euratom vendosja e standardeve themelore të sigurisë për mbrojtjen kundër rreziqeve që rrjedhin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues; dhe
- Rregullorja mbi transportin e burimeve radioaktive e cila tërësisht transpozohet direktivën nr. 2006/117/Euratom për mbikëqyrjen dhe kontrollin e dërgesave të mbetjeve radioaktive dhe karburantit të shpenzuar dhe rregulloren (Euratom) nr. 1493/93 mbi dërgesat e materieve radioaktive ndërmjet shteteve anëtare.

Si masë për zbatimin e prioritetëve afatshkurta do të jete edhe hartimi i planit për reagim në rastet emergjente radiologjike dhe bërthamore. Për më tepër do të zbatohen aktiviteteve nga plani i veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore 2015-2020.

Ndërsa, në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar përgjatë vitit 2016 në veçanti planifikohet që të ratifikohet traktati i mospërhapjes së armëve bërthamore dhe konventa mbi mbrojtjen fizike të materialit bërthamor (CPPNM 2005). Vlen të theksohet se Kosova nuk është anëtare e OKB-së, prandaj traktatet dhe konventat do të ratifikohen në mënyrë unilaterale.

Prioritetet afatmesme

Ndërkaq, aktet legjislative sekondare të cilat planifikohen të hartohen dhe përafrohen me acquis të BE-së përgjatë periudhës afatmesme janë:

- Rregullorja për kategorizimin e burimeve radioaktive (Kategorizimi i burimeve radioaktive IAEA-Tecdoc-1344);
- Rregullorja për sigurinë fizike e cila tërësisht transpozohet direktivën nr. 2003/122/Euratom për burimet radioaktive të mbyllura me aktivitet të lartë dhe burimet jetime si dhe Standardet e Sigurimit Bërthamor Seria nr. 14 e IAEA;
- Rregullorja për monitorimin e radionuklideve në ushqim, e cila do të transpozohet tërësisht rregulloren (Euratom) nr. 3954/87 që përcakton nivelet maksimale të lejuara të ndotjes radioaktive të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pas një aksidenti bërthamor ose në rast tjetër të emergjencës radiologjike, rregulloren nr. 1635/2006/KE që përcakton rregullat në detaje për aplikimin e rregullores (KEE) nr. 737/90 për kushtet që drejtojnë importet e produkteve bujqësore me origjinë në vendet e treta pas aksidentit bërthamor në Çernobil;
- Rregullorja për import, eksport dhe tranzit të burimeve të rrezatimit, e cila do të transpozohet tërësisht direktivën nr. 2013/59/Euratom që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtje kundër rreziqeve që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe rregulloren (Euratom) nr. 1493/93 mbi dërgesat e substancave radioaktive ndërmjet shteteve anëtare;
- Rregullorja për mbrojtjen e shëndetit dhe kërkesat e sigurisë për punëtorët që punojnë me burime të rrezatimit jo jonizues, e cila do të transpozohet tërësisht direktivën nr. 2004/40/KE mbi kërkesat minimale shëndetësore dhe të sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që vijnë nga agjentët fizikë (fushat elektromagnetike) dhe direktivën nr. 2006/25/KE mbi kërkesat minimale shëndetësore dhe të sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve (laserëve).

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar planifikohet nënshkrimi dhe ratifikimi i traktatit, marrëveshjes dhe konventave si me poshtë:

- Traktati mbi ndalimin e testeve bërthamore;
- Marrëveshja e masave mbrojtëse dhe protokollit shtesë;
- Konventa mbi njoftimin e hershëm të aksidentëve bërthamore;
- Konventa për ndihmë në rast aksidentit bërthamor ose emergjence radiologjike;
- Konventa ndërkombëtare për ndalimin e akteve të terrorizmit bërthamor; dhe

- Kodi i sjelljes mbi sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive dhe udhëzimet shoqëruese për import dhe eksport.

Për sa i përket mungesave dhe zbrazëtive që kanë të bëjnë me implementimin efektiv të legjislacionit është kufizues buxheti i pamjaftueshëm i agjencisë si rrjedhim i kësaj numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve të trajnuar dhe mungesa e mjeteve logjistike-teknike.

Një vështirësi tjetër me të cilën Agjencia po përballet sot, është mungesa e komunikimit me Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike (IAEA) për realizimin e objektivave të AKMRrSB. Republika e Kosovës nuk është anëtare e Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike, e për pasojë nuk mund të përfitojë nga kjo organizatë në kuadër të asistencës teknike në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe për siguri bërthamore. Për më tepër, mungesa e licencimit të shërbimeve teknike dhe profesionale në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi si dhe mungesa e rregulloreve e kufizon agjencinë në funksionim normal. Ndërkaq në kuadër të masave implementuese të legjislacionit do të zbatohen veprimet përkatëse të dala nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore 2015-2025.

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike brenda agjencie do të bëhet përmes këtyre aktiviteteve:

- Plotësimi të pozitave të planifikuara sipas rregullores për funksionimin dhe organizimin e brendshëm;
- Asistencës teknike nga BE për hartimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurisë bërthamore;
- Zbatimi i planit të trajnimit të stafit të AKMRrSB-së; dhe
- Pajisja me mjete të domosdoshme logjistike dhe teknike.

Sa i përket projekteve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore përgjatë tre viteve të ardhshme do të implementohet projekti nga asistenca e programit regional për kooperim të Ballkanit Perëndimor, qëllimi i cilës është të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore në Kosovë përmes përfundimit të kapaciteteve teknike të agjencisë rregullatore bërthamore, si dhe do të kontribuojë më tej në transpozimin e acquis të BE-së në fushën e sigurisë bërthamore dhe anëtarësimin e AKMRrSB në Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike (IAEA). Ky projekt do të mundësojë që organi rregullator në fushën bërthamore të fuqizohet me tej në kontrollin më të mirë të çështjeve radiologjike përkatësisht menaxhimin institucional të mbeturinave radioaktive, parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të materialeve nukleare dhe burimeve të rrezatimit. Në këtë mënyrë kontribuon edhe në menaxhimin e radionuklideve natyrore (NORM) dhe radionuklideve natyrore të avancuara teknologjikisht (TENORM), ndotjen e mundshme radioaktive në mjedis, instalimin e sistemeve të hershme paralajmëruese, gatishmërinë emergjente dhe kontrollin e ekspozimit mjekësor të pacientëve dhe punëtorëve.

Aktivitete zbatuese afatmesme që do ndërmerren janë si në vijim:

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- Rishikimi i planit për reagim në raste të emergjencave radiologjike dhe bërthamore;
- Anëtarësimi i AKMRrSB në organizma ndërkombëtarë me prioritet në Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike-IAEA;
- Ratifikimi i konventave, traktateve dhe protokolleve ndërkombëtare për fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- Rishikimi vjetor i zbatimit të planit të veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- Ngritja e performancës së inspektoratit përmes trajnimeve profesionale; dhe
- Vazhdimi i procesit të licencimit për përdoruesit e burimeve të rrezatimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të kritereve të përcaktuara në licenca.

Në anën tjetër, sa i përket themelimit të organeve dhe strukturave të reja ato parashihen si më poshtë:

- Operatori për menaxhimin e mbetjeve radioaktive;
- Vendoset sistemi i monitorimit të rrezatimit në mjedis (ajër, tokë dhe ujë);
- Shërbimi teknik dhe profesional për kryerjen e aktiviteteve për mbrojtje nga rrezatimi; dhe
- Fondi për menaxhimin e burimeve radioaktive të braktisura.

Në lidhje me pozitën financiare të Agjencisë, buxheti i saj për vitin 2015 është rreth 70,438 Euro nga buxheti i Kosovës, prej të cilave 45,438 Euro paga dhe mëditje dhe 25,500 Euro mallra dhe shërbime. Planifikimi i mëtutjeshëm i buxhetit të AKMRrSB duhet të harmonizohet me aktivitetet prioritare të agjencisë, domosdoshmërisht në përputhje me aktivitetet që dalin nga rishikim i Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve 2016-2018.

3.17. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet

Acquis në fushën e tatimeve konsiston në legjislacionin të harmonizuar për fushën e tatimeve indirekte (domethënë tatimin mbi vlerën e shtuar) dhe akcizat. Acquis specifikon fushëveprimin, përkufizimet dhe parimet e TVSH-së. Legjislacioni për TVSH ofron trajtim të barabartë tatimor për transaksionet vendore dhe të huaja (importi). TVSH-ja po ashtu është e bazuar në principin e neutralitetit ku tatimi i aplikuar është proporcional me çmimin pavarësisht numrit të transaksioneve të ndërmjetme.

Akciza për produktet e duhanit, pijeve alkoolike dhe produkteve të energjisë janë gjithashtu subjekt i legjislacionit të BE-së. Legjislacioni i BE-së vendos strukturën e akcizës që duhet ngarkuar si dhe sistemin e tarifave minimale për secilin grup të produkteve. Mallarat i nënshtrohen akcizës nëse prodhohen brenda BE ose importohen nga vendet e treta. Sidoqoftë, akciza është e pagueshme vetëm në shtetin anëtar në të cilin malli lëshohet në qarkullim/konsum (me disa përjashtime) dhe me tarifën e akcizës së atij shteti anëtar. Legjislacioni i BE-së përcakton Dispozitat për prodhimin, mbajtjen, lëvizjen dhe monitorimin e produkteve me akcizë.

Për sa i përket **tatimeve të drejtpërdrejta** (tatimet direkte), acquis mbulon disa aspekte të tatimeve të të ardhurave nga kursimet individuale dhe të tatimeve të korporatave. Qëllimi është në eliminimin e çrregullimeve në aktivitetet ekonomike ndër-kufitare mes kompanive të vendeve anëtare. Për më tepër, Shtetet Anëtare janë të angazhuara për përputhje me parimet e Kodit të Mirësjelljes për Tatimin e Bizneseve, që kanë për qëllim eliminimin e masave të dëmshme tatimore.

Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë në mes të shteteve anëtare synon të sigurojë funksionimin normal të tregut të brendshëm për sa i përket tatimeve dhe siguron mjete për të parandaluar evazionin fiskal dhe shmangien tatimore brenda Komunitetit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se ekzistojnë kapacitete të nevojshme për zbatim dhe fuqizim, duke përfshirë lidhjet me sistemet e kompjuterizuar të tatimeve përkatëse të BE-së. Në kuadër të **kapacitetit operativ dhe kompjuterizimit**, acquis për TVSH mbulon sistemin e shkëmbimit të informacionit që lejon shkëmbim direkt elektronik të të dhënave midis administratave të shteteve anëtare. Sisteme të ngjashme të IT-së kërkohen edhe në fushën e akcizave dhe tatimeve direkte për shkëmbim informacioni midis vendeve anëtare. Për më tepër sistem specifik i IT-së (VoeS) kërkohet për të vendosur shkëmbimin e informatave midis vendeve anëtare në lidhje me skemën e veçantë për e-shërbimet që ofrohen nga tregtarët jo-residentë të BE-së për qytetarët e BE-së.

Kërkesat e MSA-së

Fusha e tatimeve është një nga fushat e rëndësishme të cekura në Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim (MSA, neni 39, neni 40, neni 70 dhe neni 105). Neni 39 mbulon ndalimin e diskriminimit fiskal ndërsa neni 40 mbulon tarifën e natyres fiskale. Neni 105 mbulon zhvillimin e Kosovës në fushën e tatimeve dhe masat me të cilat synohet reformimi i mëtutjeshëm i sistemit fiskal në Kosovë. Përveç kësaj ky nen mbulon edhe ristrukturimin e administratës tatimore me qëllim të sigurimit të efektivitetit të vjeljes së tatimeve dhe kundër MASHTrimit fiskal.

Gjithashtu këtu merren parasysh edhe fushat prioritare që lidhen me acquis të BE-së, konkretisht ajo e luftimit kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Legjislacioni i aquis të BE mbi fushën e tatimeve, konkretisht luftën kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve bazohet në Kodin e Mirësjelljes për tatimin e biznesit, miratuar nga Këshilli dhe Përfaqësuesit e Qeverisë së Shteteve Anëtare.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të masave për parandalimin e MASHTrimit tatimor dhe shmangies tatimore, bashkëpunimi do të synojë promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë në çështjet tatimore, transparencën, shkëmbimin e informatave dhe konkurrencës së ndershme të tatimeve në Kosovë.

Lidhur me themelimin e kompanive të BE në Kosovë, Kosova do të lehtësoj ngritjen e veprimtarive në territorin e saj nga kompanitë e BE-së. Me qëllim të lehtësimit të procesit të themelimit të kompanive, Kosova do të kete trajtim të barabartë si për kompanitë e saja ose kompanitë e një vendi të tretë.

Bazuar në Raportin e KE-së për Kosovën 2015 për çështjet që lidhen me tatimet, Kosova duhet të vazhdojë të përforcojë masat e ndërmarra për luftën kundër ekonomisë jo formale dhe evazionit fiskal dhe t'i jap prioritet ngritjes së efikasitetit. Kosova në veçanti duhet të parandalojë çdo ndikim në punën e institucionit. Gjithashtu, duhet të forcohet platforma e TI-së së Administratës Tatimore të Kosovës. Kapacitetet për të zbatuar mbledhjen e tatimeve në veri të Kosovës mbeten jashtëzakonisht të kufizuara.

Gjendja aktuale

Korniza legislative

Në fushën e tatimeve, Republika e Kosovës ka përgatitur pakon e ndryshimeve legislative fiskale në përputhje me pikat e përcaktuara në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2014-2018 në funksion të arritjeve nëpërmjet të reformimit të politikave tatimore që janë në harmoni me Acquis në këtë fushë. Përmes pakos së re fiskale synohet të arrihet:

- Rritja e të hyrave të përgjithshme në buxhet, krahas mbajtjes së niveleve të ulëta tatimore, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme të investimeve të huaja;
- Ruajtja e një mjedisi të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm tatimor, kushte këto që janë të rëndësishme për rritjen e bizneseve vendore dhe tërheqjen e investitorëve të huaj;
- Zgjerimi i bazës tatimore nëpërmjet reformës fiskale si dhe
- Përmirësimet në mbledhjen e të hyrave nëpërmjet luftimit të zbrazëtirave ligjore dhe evazionit fiskal.

Në këtë drejtim është miratuar Ligji mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar (TVSH) i cili në masën më të madhe është i harmonizuar me Direktivat e BE-së që lidhen me këtë lloj të tatimit:

- Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, 28 nëntor 2006, mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar si legjislacioni bazë i rregullimit në nivel të BE-së, e që më vonë është ndryshuar me:
 - Direktivën e Këshillit 2006/138/KE, 19 dhjetor 2006 në lidhje me periudhën e zbatimit të marrëveshjeve të TVSH-së të aplikueshme të radios dhe televizionit, shërbimeve dhe disa shërbimeve të furnizuara në mënyrë elektronike;
 - Direktivën e Këshillit 2007/75/KE, 20 dhjetor 2007, në lidhje me dispozitat e caktuara të përkohshme në lidhje me normat e TVSH-së;
 - Direktivën e Këshillit 2008/8/KE, 12 shkurt 2008, në lidhje me vendin e furnizimit të shërbimeve;
 - Direktivën e Këshillit 2008/117/KE, 16 dhjetor 2008, në lidhje me luftimin e evazionit fiskal që lidhen me transaksionet ndër-komunitare;
 - Direktivën e Këshillit 2009/47/KE, në lidhje me normat e reduktuara të tatimit mbi vlerën e shtuar;
 - Direktivën e Këshillit 2009/69/KE, 25 qershor 2009, në lidhje me evazionin fiskal sa i përket importeve;
 - Direktivën e Këshillit 2009/162/BE, 22 dhjetor 2009, mbi sistemin e përbashkët të tatimit në vlerën e shtuar;
 - Direktivën e Këshillit 2010/23/BE, 16 mars 2010, në lidhje me një kërkesë opsionale dhe të përkohshme të mekanizmit të ngarkimit të kundërt në lidhje me furnizimet e shërbimeve të caktuara.

Po ashtu, janë miratuar ligjet si: Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, mbi Tatimin në të Ardhurat Personale dhe mbi Tatimin në të Ardhurat të Korporatave, ligje këto të bazuara në parimet e përgjithshme të vendeve të OECD-së.

Sa i përket akteve nënligjore janë hartuar dhe miratuar këto akte:

- UA MF nr. 05/2013 për aplikimin e normës së sheshtë të tatimit mbi vlerën e shtuar për prodhuesit bujqësor;
- UA MF nr. 01/2015 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike fiskale dhe sistemeve fiskale.
- Vendimi shpjegues publik nr. 01/2013 rregullat implementuese të ligjit për fondet pensionale të Kosovës;
- Vendimi shpjegues publik nr. 02/2013 shuma e tatueshme në furnizimet me TVSH për ndërmarrjet publike;
- Vendimi shpjegues publik nr. 03/2013 për trajtimin tatimor të furnizimeve dhe importeve kur financohen drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian;
- Vendimi shpjegues publik nr. 04/2013 Çregjistrimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar;
- Vendimi shpjegues publik nr. 01/2014 për të Ardhurat e tatueshme nga Ndërtimi Afatgjatë;
- Vendimi shpjegues publik nr. 02/2014 procedurat për transferimin e pronësisë tek ndryshimi në formën e biznesit;
- Vendimi shpjegues publik nr. 03/2014 Lindja e detyrimeve tatimore për TVSh mbi mallrat e vendosura në aranzhimet e Doganës, si: Depot Doganore;
- Vendimi shpjegues publik nr. 04/2014 Vlerësimet dhe Rivlerësimet doganore;
- Vendimi shpjegues publik nr. 05/2014 Trajtimi tatimor i përfitimeve në natyrë shujtave për të punësuarit;
- Vendimi shpjegues publik nr. 06/2014 Tatuaria e pensioneve me rastin e tërheqjes nga FKPK;
- Vendimi shpjegues publik nr. 01/2015 Metodatat indirekte të kontrollit dhe
- Vendimi shpjegues publik nr. 02/2015 Dorëzimi i kuponëve fiskal dhe rimbursimi i mjeteve.

Korniza e politikave

Në fushën e tatimeve janë miratuar dhe zbatohen disa dokumente me karakter strategjik. Plani Strategjik i ATK-së për periudhën 2015-2020 si dokument më i lartë në hierarkinë e dokumenteve të ATK-së; në këtë Plan Strategjik, ATK ka paraqitur vlerat, prioritetet dhe objektivat për periudhën 2015-2020. Në përcaktimin e këtyre prioriteteve ATK është mbështetur në sfidat e dala nga Raportet e Komisionit Evropian, Raporti i Progresit dhe për pjesën e II në raportet e DG-TAXUD. Përveç kësaj prioritetet janë caktuar duke u bazuar edhe në raportet e institucioneve të tjera ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore. Po ashtu objektivat dhe prioritetet janë të ndërlidhura me Objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Strategjia e Përbushjes për periudhën 2012-2015 përmes të cilit dokument është siguruar lehtësimi i procesit të përbushjes, duke krijuar një mjedis të përbushjes në të cilin procedurat e lehta administrative, udhëzimi sistematik i tatimpaguesve dhe një sërë shtysa, kanë mundësuar që tatimpaguesit t'i përbushin obligimet e tyre me mundësi më të madhe;

Plani i trajtimit të rreziqeve për vitin 2015, i cili përshkruan në mënyrë të detajuar aktivitetet dhe veprimet që duhet ndërmarrin operacionet përbushëse dhe mbështetjen që kjo e fundit duhet të ketë nga divizionet e ndryshme me qëllim trajtimin e rreziqeve të identifikuara i cili do shpie në zvogëlimin e hendekut tatimor.

Plani Vjetor i punës së ATK-së hartohet mbi bazën e objektivave të departamenteve dhe njësive brenda institucionit, i ndihmon ATK-së kryerjen e aktiviteteve të caktuara dhe arrijten e qëllimeve të përgjithshme të Planit Strategjik dhe Strategjisë së Përbushjes, krahas përcaktimit të të hyrave të parapara me buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin përkatës.

Institucionet do të angazhohen për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin e Progresit për çështjet që lidhen me tatimet. Në këtë kontekst, Kosova duhet të vazhdojë të përforcojë masat e ndërmarra për luftën kundër ekonomisë jo formale dhe evazionit fiskal dhe t'i jap prioritet

ngritjes se efijencës duke implementuar Strategjinë për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit 2014-2018 dhe Planit të Veprimit. Sfidat e identifikuar janë adresuar në dokumentet strategjike (Plani Strategjik i ATK 2015-2020) dhe në planet operative vjetore.

Sa i përket pjesës “Produktet e eksportuara në territorin e njëjës Palë nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumë e tatimit të tërthortë të vendosur mbi to”, Legjislacioni Tatimor i Kosovës respektivisht Ligji për TVSh (si tatim indirekt apo i “tërthortë”), trajtimin e eksportit të mallrave e bënë në përputhje me direktivën e BE-së respektivisht, eksporti i mallrave jashtë territorit të vendit është furnizim i liruar me të drejtë të zbritjes së TVSh-së (Neni 31 i Ligjit për TVSH). E drejta e zbritjes është përcaktuar me nenin 36 të Ligjit të TVSh-së dhe zbritja bëhet për TVSh-në e ngarkuar në blerje të mallrave apo shërbimeve. Pra, legjislacioni ynë është në përputhje me paragrafin 2 të nenit 39 të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim.

ATK lidhur me projektin e zëvendësimit të sistemit të teknologjisë informative, ka hartuar dokumentin “kërkesat teknike”. Projekti si kosto totale është vlerësuar se do të kushtojë 10 milionë euro. Projekti do të jetë me bashkëfinancim, nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Kosovës. Në këtë drejtim përveç koston është hartuar edhe orari i aktiviteteve të parapara deri në fazën e implementimit.

Sa i përket veprimeve të ndërmarra me qëllim të zbatimit të Planit të Veprimit për Strategjinë Kombëtare për parandalimin e ekonomisë joformale, shpëlarjes së parasë financimit të terrorizmit dhe krimin financiar, ATK në kuadër të këtij plani ka nën përgjegjësi 4 veprime për të cilat vazhdimisht ka ndërmarrë veprime, duke përfshirë edhe propozime për ndryshim të legjislacionit dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Lidhur me eliminimin e tatimit të dyfishtë, ATK si institucion zbatues ka ngritë kapacitetet e stafit me qëllim të realizimit të këtij aktiviteti. Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit është bërë me asistencë teknike nga donatorë dhe ende është duke vazhduar të mbështetet. Gjithashtu janë arritur të krijohen materiale informuese për qytetarë me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për këtë fushë.

Divizioni i ankesave- Misioni i Divizionit të Ankesave është t’i zgjidh kontestet tatimore, pa hedhje në gjyq, në baza të drejta dhe të paanshme për Qeverinë apo tatimpaguesin që do të nxisë pajtueshmëri vullnetare dhe besim publik në integritetin dhe efikasitetin e Administratës Tatimore. Divizioni i Ankesave e kryen këtë mision duke marrë vendime për lëndët që hasin në kundërshtime. ATK ka organizuar trajnime dhe ka shtuar staf në këtë divizion ku si rezultat ka arritë që të avancoj punën e këtij divizioni duke arritur rezultat në krijimin e ekspertëve të aftë të ligjeve tatimore dhe të procedurave të ankesave, të demonstrojnë praktiken më të mirë në trajtimin e lëndëve të ankesave; të sigurohen që vendimet e ankesave përbushin standardet e kërkuara; të jenë në hap me zhvillimet e legjislacionit tatimor; të rekomandojnë ndryshime në legjislacion ku janë identifikuar zona me probleme.

Korniza institucionale

Administrata Tatimore e Kosovës është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Kosovës e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe është autoriteti që ka të drejtën e implementimit të ligjeve fiskale, administrimit të taksave dhe tarifave ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i ATK-së është të ndihmojë tatimpaguesit të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e zbatueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga taksat të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke i ofruar Tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Në drejtimin të modernizimit të administratës, është themeluar Qendra e Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve dhe Qendra e Thirrjeve të cilat konsiderohen si projekte mjaftë të suksesshme.

Është lancuar produkti i vërtetimit elektronik për persona fizik. Përveç kësaj të gjitha deklaratimet e tatimeve bëhen në mënyrë elektronike përmes sistemit Electronic Declaration of Incomes (EDI) i cili u mundëson tatimpaguesve deklaratim të shpejt, të thjeshtë dhe të sigurt. Ky sistem është duke treguar

rezultate mjaft të mira. Janë krijuar module të ndryshme në sistemin e TI të cilat kanë lehtësuar deklarimet nga ana e tatimpaguesit dhe menaxhimin e proceseve të punës brenda institucionit.

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale dhe evazionit fiskal, ATK që nga viti 2012 është duke punuar sipas Planit të Trajtimin të Rreziqeve, i cili përfshin rreziqet, konkretisht fushat që konsiderohen si me rrezik për mos përmbushje të obligimeve tatimore dhe aktivitetet për trajtimin e rreziqeve. ATK është institucion përgjegjës në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit 2014-2018.

Brenda institucionit është themeluar Divizioni për Trajnim dhe Zhvillim i cili harton plane vjetore të trajnimeve për stafin e ATK dhe mesatarisht numri i stafit të trajnuar në vit është 926 punëtorë.

Me vendim të Qeverisë Nr 07/39, të datës 22.07.2015 është aprovuar Plani Inicial për Krijimin e Agjencisë së të Hyrave. Ky vendim bazohet në këto nevoja: (i) përmirësimi i shërbimit ndaj tatimpaguesve; (ii) reduktimi i 'hendekut tatimor' përmes strukturave më të thjeshta dhe më efektive të mbledhjes së tatimeve; (iii) rritjen e efikasitetit në mbledhjen e tatimeve dhe zvogëlimin e kostove gjatë këtij procesi; (iv) rritjen e autonomisë të strukturave institucionale që merren me mbledhjen e të hyrave; (v) krijimin e strukturave institucionale më efektive për implementimin e politikave tatimore dhe doganore; (vi) përmbushja e kriterëve të nevojshme për procesin e integritimit në BE.

Masat afatshkurtra

- Vazhdimi i punës drejtë zëvendësimit të sistemit informativ;
- Vazhdimi i luftimit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;
- Implementimi i Strategjisë së ATK-së 2015-2020;
- Përmbushja e objektivave sipas Planit Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Ngritja e numrit të trajnimeve që lidhen me zbatimin efektiv të legjisllacionit;
- Implementimi i Planit Vjetor të Punës për 2016;
- Implementimi i Planit të Trajtimin të Rreziqeve për vitin 2016
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë.
- Identifikimi i fushave për mbështetje nga BE-së në lidhje me ekonominë joformale;
- Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.

Prioritetet afatmesme

- Ligji 03/L-162 Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave, i harmonizuar me Kodin e Miresjelljes për tatimet në biznes;
- Ligji 03/L-161 Tatimi mbi të Ardhurat Personale, i harmonizuar me Kodin e Miresjelljes për tatimet në biznes;
- Hartimi i një rregulloreje në lidhje me shkëmbimin e detyrueshëm automatik të informacionit në fushën e tatimeve që do të jetë në harmoni me Direktivën e Këshillit 2014/107/BE të dt. 09 dhjetor 2014, e cila e ka ndryshuar Direktivën e mëparshëm të Këshillit 2011/16/BE të dt. 15 shkurt 2011 që ka të bëjë me masat e përbashkëta për të parandaluar shmangien e taksave dhe tatimeve të dyfishta;
- Përcjellja e vazhdueshme e ndryshimeve eventuale acquis, si dhe harmonizimi i legjisllacionit vendor me ndryshimet eventuale në fushën e tatimeve duke marrë parasysh edhe Kodin e Mirësjelljes për Tatimin e Biznesit të miratuar nga Këshilli dhe Përfaqësuesit e Qeverive të Shteteve anëtare, sipas konkluzioneve të dala nga takimi i Këshillit të ECOFIN me 01 Dhjetor 1997 në lidhje me politikën tatimore (98/C 2/01);
- Zëvendësimi i plotë i sistemit informativ;
- Lancimi i shërbimit elektronik "fatura elektronike e TVSh-së E-Invoicing";
- Matja e hendekut tatimor;
- Zhvillimi i mëtejme i shërbimeve elektronike, ku si synim është digjitalizimi i shërbimeve drejtë e-tatimeve;
- Zbatimi i strategjisë për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë joformale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit 2014-2018;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit me theks në fushën e menaxhimit të rrezikut;

- Republika e Kosovës do të vazhdojë të fuqizojë dhe të ristrukturojë Administratën Tatimore të Kosovës si njëri prej dy agjencioneve më të rëndësishme për mbledhjen e të hyrave publike, drejtë sigurimit të efektivitetit më të madh në vjeljen e tatimeve të brendshme dhe luftimin më efikas të evazionit fiskal.

Mbështetja e donatorëve

Administrata Tatimore e Kosovës që nga themelimi i saj është mbështetur vazhdimisht nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Komisionit Evropian përmes TAIEK ka mbështetur ATK në legjislacionin tatimor në veçanti harmonizimin e ligjit tatimor me legjislacionin e BE. Rezultatet e misionit ishin të përfshira në projektligjin e ri që pritet të miratohet së shpejti. Misioni i ardhshëm ishte në Njësinë e hetimeve tatimore dhe inteligjencës ku pas misionit ATK-ja ka implementuar disa nga rekomandimet e vënë në dukje në raportin përfundimtar të misionit. Kjo pati një ndikim pozitiv veçanërisht në rritjen e njohurive të stafit dhe në reformimin e njësive përgjegjëse për hetimet tatimore.

Misioni tjetër ishte në fushën e IT-së që ka pas për qëllim vlerësimin e sistemit tatimor të IT-së dhe kohët e fundit ATK është mbështetur në fushën e Menaxhimit të Riskut. Rezultatet e misionit kanë pasur një ndikim pozitiv në ngritjen e kapaciteteve të stafit, pasi që është pasqyruar përvoja e zyrtarëve nga institucionet nga është marr asistencë.

Kohët e fundit, IMF ka mbështetur ATK në ngritjen e përmbushjes vullnetare dhe Menaxhimit të Riskut dhe hartimin e Strategjisë së re të institucionit me kohëzgjatjen për 5 vitet e ardhshme. Më vonë, ishte projektuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me Programin e Qeverisë. Përveç kësaj, ATK u mbështet në fushën e IT, përkatësisht në përgatitjen e kërkesat e përdoruesit për sistemin e ri të TI.

GIZ ka siguruar ndihmë teknike në rritjen e kapaciteteve të stafit nëpërmjet programeve të trajnimit të vazhdueshëm në TVSH, metoda indirekte e llogaritjes, ndërtim dhe Bankare sektorët. Përveç kësaj ka një projekt në të drejtën ndërkombëtare tatimore, veçanërisht në lidhje me Marrëveshjet e dyfishta tatimore e cila ishte për 2 vjet. Përfundimet e këtij projekti ka ndikuar pozitivisht, aty u krijua një njësi e cila merret me Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë.

3.18. Kapitulli 17 i *acquis*-së: Politikat ekonomike dhe monetare

Acquis në fushën e politikave ekonomike dhe monetare përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në shtetet anëtare, duke ndaluar financimin direkt të sektorit publik nga bankat qendrore dhe duke ndaluar qasje të privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet anëtare pritet që të bashkërendojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë subjekt i Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes mbi mbikëqyrjen fiskale. Edhe Shtetet e reja Anëtare duhet të jenë të angazhuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në Traktatin në mënyrë që të jenë në gjendje të pranojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Deri atëherë, ato do të marrin pjesë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar si Shtet Anëtar i lejuar për mos-përdorimin e euros dhe do të trajtojnë normat e tyre të këmbimit si një çështje e interesit të përbashkët.

Acquis në fushën e politikës ekonomike dhe monetare përbëhet nga Titulli VIII (Art. 119 deri 144) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), dhe me legjislacionin përkatës implementues.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimet kryesore të Kosovës në kuadër të përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Evropian rrjedhin nga Neni 74 i MSA-së, gjithashtu Neni 94 i MSA-së nënvizon se BE-ja dhe Kosova do të lehtësojnë procesin e reformave ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse si dhe formulimin dhe zbatimin e politikave ekonomike në ekonomitë e tregut.

Ky kapitull jep informacion mbi zhvillimet e përgjithshme nga aspekti i politikës monetare dhe politikës

ekonomike, në kontekst të strategjisë dhe objektivave të caktuara nga Qeveria. Meqenëse Kosova përdor euron si valutë të vetën, të cilën që nga viti 2002 e ka adoptuar në mënyrë unilaterale, Kosova nuk ka politikë monetare, andaj fokusi i këtij kapitulli në rastin e Kosovës do të përqendrohet në seksionin mbi Politiken Ekonomike. Për më tepër, duke mos pasur mundësinë e shfrytëzimit të politikës monetare si alternative zhvillimore, politikat ekonomike fitojnë një rëndësi edhe më të madhe. Kapitulli do të tentojë të ofrojë edhe informacione të tjera të cilat ndihmojnë në analizimin dhe arrijtjen e qëllimeve të institucioneve, gjithmonë në kontekst të procesit të Stabilizim asociimit me Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare, ku një ndër prioritetet është edhe sigurimi i stabilitetit makroekonomik.

Bazuar në Raportin e KE-së për Kosovën 2015 për çështjet që lidhen me politikat ekonomike, nënvizohet se deficitin e vazhdueshëm tregtar reflekton një bazë të dobët të prodhimit dhe mungesë të konkurrencës ndërkombëtare. Sektori i shërbimeve publik dhe vendimmarrja ad hoc e politikave fiskale përbën rreziqe të mëdha fiskale. Mbështetja në remitanca dhe ekonominë e gjerë informale gjithashtu ulë stimujt për punësim që rezultojnë në pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore, veçanërisht në mesin e grave, shkallë të lartë të papunësisë veçanërisht në mesin e punëtorëve të rinj dhe të pakualifikuar. Gjithashtu, përmendet se Kosova duhet të reduktojë varësinë nga detyrimet doganore duke e zgjeruar bazën tatimore vendore dhe duke modernizuar mbledhjen e të ardhurave.

Politika Monetare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është subjekt juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të këtij ligji, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.

Duke u bazuar në nenin 6 (pavarësia dhe autonomia) të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore, anëtarët e organeve vendimmarrëse ose personeli i Bankës Qendrore, nuk do të marrin udhëzime nga ndonjë person apo subjekt tjetër, duke përfshirë subjektet qeveritare. Pavarësia dhe autonomia e Bankës Qendrore respektohet në çdo kohë dhe asnjë person apo subjekt nuk do të provojë të ndikojë anëtarët e organeve vendimmarrëse apo të personelit të Bankës Qendrore në realizimin e detyrave të tyre apo të ndërhyjë në aktivitetet e Bankës Qendrore. Për më tepër legjislacioni i Bankës Qendrore parasheh që llogaritë, evidencat dhe pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, të paktën një herë në vit, të auditohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nga auditorë të jashtëm të pavarur ndërkombëtar të cilët duhet të kenë reputacion të mirë dhe përvojë ndërkombëtare të njohur në auditimin e institucioneve të mëdha financiare ndërkombëtare.

Aktualisht, Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është pjesërisht në përputhje me *acquis*-in e Bashkimit Evropian. Megjithatë shumë dispozita janë të përafëruara, nevojiten përpjekje të tjera legjislative me qëllim përputhjen me parimet e përgjithshme të *acquis* së Bashkimit Evropian.

Në vitin 2002, Kosova në mënyrë të njëanshme ka adoptuar euron si valutë ligjore dhe që nga atëherë euro de facto u bë monedha e Kosovës, prandaj, politika monetare në Kosovë është shumë e kufizuar. Instrumenti i vetëm tradicional i politikës monetare i cili është plotësisht në dispozicion të Bankës Qendrore përbëhet nga kërkesat e rezervës bankare. Që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar të Kosovës, bankat kanë mbajtur vazhdimisht rezerva të tepërta; prandaj, gjatë kësaj periudhe nuk është konsideruar si e nevojshme të ndryshohet norma e rezervës së detyruar.

Përdorimi i euros e kufizon rolin e Bankës Qendrore në funksionin e saj si huadhënës i fundit („lender of last resort” - LLR) për të ofruar kredi afatshkurta për bankat që potencialisht përballen me mungesa likuiditeti. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës dhe BQK-ja themeluan Asistencën e Likuiditetit Emergjent (Emergency Liquidity Assistance - ELA); një fond urgjence për të vepruar në rast të ndonjë mungese të likuiditetit në sektorin bankar. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës gjithashtu mban një nivel të duhur të bilanceve bankare si amortizues për të reaguar ndaj goditjeve të mundshme me të cilat përballen të ekonomisë.

Masat afatshkurtra

- Rregullore për Mbështetje Emergjente me Likuiditet.

Prioritetet afatmesme

- Ngritja e kapaciteteve për administrimin e situatave emergjente në rast të krizave dhe zgjidhjen e bankave me probleme.

Politikat ekonomike

Në përgjithësi ekziston një konsensus mbi thelbin e politikave ekonomike me fokus të veçantë në orientimin e tyre drejt krijimit të kushteve për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe rrjedhimisht gjenerimin e vendeve të qëndrueshme të punës.

Qeveria e Kosovës ka si objektivi kryesor të politikës fiskale ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal gjë që ndërlidhet me obligimet që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA) lidhur me ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal dhe harmonizimin e politikave me ato të BE-së. Një tregues i përkushtimit të Qeverisë në këtë drejtim është adoptimi i rregullës fiskale e cila kufizon nivelin e deficitit të përgjithshëm në 2% të BPV-së. Qëllimi i krijimit të një mekanizmi të tillë fiskal ka qenë stabilizimi i nivelit të borxhit nën nivelin e kufizuar me ligj (40% e BPV-së).

Qeveria në fund të vitit 2014 ka hartuar Programin Qeverisës 2015-2018³⁶ i cili fokusohet në politika që stimulojnë rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Ky program gjithashtu paraqet bazën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH). Strategjia do të reflektojë, në masë të madhe, masat e propozuara në këtë program qeverisës si dhe masa që rrisin aftësinë konkurruese të ekonomisë kosovare në tregun rajonal dhe më gjerë. Objektivi kryesor i Qeverisë është gjenerimi i rritjes së qëndrueshme ekonomike, e cila siguron stabilitet makroekonomik, fiskal dhe social, si dhe reformë strukturale ekonomike, ku prodhimi vendës, promovimi i eksportit dhe i dijes do mundësojnë gradualisht zvogelimin e deficitit tregtar. Në interes të veçantë është promovimi i investimeve, duke ulur kostot për bizneset nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës adekuate rrugore dhe hekurudhore, të telekomunikimit, energjisë dhe ujërave.

Korniza legjislative

Aktet ligjore/nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe me Ligjin nr. 04/L-194
- Ligji nr. 03/L-175 Për Borxhet Publike
- Ligji nr. 05/L-046 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2015
- Ligji nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2015
- Ligji nr. 04/L-008 Për Këshillin Ekonomiko-Social
- Rregullore nr. 01/2015 Për Punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës
- Rregullore nr. 01/2015 për punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës

Vendimet e vitit 2015 që erdhën si pasojë e inicimit të ndryshimeve në politikat tatimore konform Programit të Qeverisë 2015-2018 janë si vijon:

- Vendimi 02/20 i datës 24.03.2015 mbi Miratimin e Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
- Vendimi 03/20 i datës 24.03.2015 mbi Miratimin e Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
- Vendimi 04/20 i datës 24.03.2015 mbi Miratimin e Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale
- Vendimi 16/20 i datës 24.03.2015 mbi aplikimin e normës së tatimit të akcizës në shumë prej 0.25€ cent për liter në vajra të renda për ngrohje me një përmbajtje sulfurike me tepër se 0.1% ndaj peshës por jo me tepër se 1% ndaj peshës në përputhshmëri me lejimet sipas Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 të datës 27.04.2012 në kodin tarifor 2710196410 dhe 2710196490

³⁶ Programi Qeverisës 2015-2018, <http://www.kryeministri-ks.net>.

- Vendimi 16/20 i datës 24.03.2015 mbi vendosjen e normës se tatimit të akcizës në produkte të duhanit dhe pijeve alkoolike (të specifikuar me kode doganore në vendim) dhe lirimin nga detyrimi i akcizës për alkoolin etilik për përdorim mjekësor
- Vendimi 16/20 i datës 24.03.2015 mbi kthim të pagese se tatimit të akcizës në shumën e paguarë në emër të tatimit të akcizës për sasinë e vajit të përdorur në proces të prodhimit
- Vendimi 04/21 i datës 01.04.2015 mbi Plotësim-ndryshimin e vendimit të qeverisë mbi aplikimin e akcizës në veturat e reja dhe të vjetra si dhe përmirësimi i mënyrës së përlllogaritjes së akcizës në njërin nga produktet e duhanit
- Vendimi 02/32 i datës 3.06.2015 mbi Miratimin e Projektligjit për Faljen e Borxheve Publike
- Vendimi 8/12 i datës 5.02.2015 mbi Miratimin e Koncept-dokumentit për ngritjen e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- Vendimi 04/39 i datës 22.07.2015 mbi vendosjen e tatimit të akcizës në fishekzjarrë/mjete piroteknike, ndryshimin e vendimit 16/20 mbi aplikimin e akcizës në cigare, vendosjen e tatimit të akcizës mbi lojërat e fatit, kazinotë, bastet sportive, etj.

Korniza e politikave

Programi i Qeverisë është dokumenti kryesor i cili përcakton orientimin dhe zhvillimin e politikave të Qeverisë dhe i cili paraqet bazën për vendosjen e politikave prioritare në KASH. Programi i Qeverisë është dokument i natyrës politike dhe përfshinë planet dhe zotimet e Qeverisë për periudhën afatmesme. Qeveria është e obliguar të nxjerr një deklaratë të prioriteteve e cila shërben si bazë e politikave për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, Buxhetit dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është mjeti përmes të cilit Qeveria përcakton kornizën e saj fiskale dhe shërben si dokument kryesor i planifikimit të politikave në Kosovë. Korniza fiskale përfshin planifikimet për të hyrat dhe shpenzimet për tri vitet e ardhshme; kufijtë e shpenzimit për të gjitha organizatat buxhetore që përcaktohen në bazë të prioriteteve të qeverisë, si dhe financimin e deficitit dhe nivelin e bilancit bankar.

Gjatë muajve të parë të vitit 2015 janë ndryshuar ligjet tatimore për të reflektuar reformën fiskale të paraparë me programin qeverisës. Më konkretisht, ndryshimet kryesore që mund të veçohen janë si në vijim:

- Heqjen e barrierave për fiskalizim të të gjitha bizneseve përmes ndryshimit të udhëzimit administrativ nr. 15/2010 për pajisjet fiskale me qëllim të liberalizimit të tregut të këtyre pajisjeve. Kjo masë ka për qëllim rritjen e numrit të operatorëve në këtë treg gjë që do të ndikoj edhe në uljen e kostos, si të pajisjeve ashtu edhe të mirëmbajtjes, për bizneset. Me këtë masë synohet përmbyllja e procesit të fiskalizimit të të gjitha bizneseve gjë që do të mundësojë krijimin e një ambienti më të barabartë për të gjitha bizneset që operojnë në Republikën e Kosovës. Në të njëjtën kohë, Ministria e financave ka dizajnuar masat stimuluuese për konsumatorët që mbledhin kuponët fiskal e cila rregullohet përmes një udhëzimi të veçantë administrativ. Këto masa kanë për qëllim zvogëlimin e evazionit fiskal dhe parandalimin e konkurrencës jo të barabartë dhe në të njëjtën kohë të mbrojnë konsumatorin.
- Ndryshimet në sistemin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar përmes uljes së pragut për regjistrim në TVSH nga 50.000 euro në 30.000 euro, përshkallëzimit të normës së TVSH në 8% për produkte të caktuara bazike dhe 18% për produktet tjera, heqjen e TVSH-së për linjat e prodhimit dhe inputet bazë për prodhuesit vendor.
- Me qëllim të zvogëlimit të barrierave administrative, janë shkurtuar procedurat administrative dhe këtu mund të përmendim heqjen e kërkesës për certifikatë të eksportit dhe importit pasi që tashmë të gjitha bizneset në Kosovë posedojnë një numër identik fiskal.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur sistemin relativisht të thjeshtë tatimor, me të hyra tatimore në raport me BPV-së prej 20%. Gjatë këtij viti nuk ka pasur ndryshime në normat e tatimeve. Në këtë kontekst, duke qenë se zgjerimi i bazës tatimore paraqet mjetin më efikas për rritjen e të hyrave buxhetore, Qeveria ka ndërmarrë masa për të parandaluar dhe reduktuar ekonominë joformale dhe të rrisë efikasitetin e agjencive mbledhëse të të hyrave tatimore. Konkretisht, në fillim të vitit 2014, Qeveria ka aprovuar Strategjinë për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimin e parave dhe financimin e

terrorizmit dhe planin e veprimit për zbatimin e kësaj strategjie. Gjatë vitit 2015, është bërë vlerësimi i ekonomisë jo-formale dhe është rishikuar edhe plani i veprimit për implementimin e strategjisë.

Qeveria është e orientuar në ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal dhe në të njëjtën kohë në ruajtjen e shpenzimeve produktive buxhetore. Në këtë kontekst vlen të ceket fakti që në fillim të këtij viti Qeveria e Kosovës ka negociuar një program 22 mujor me FMN. Meqenëse Kosova nuk karakterizohet me ndonjë rrezik fiskal dhe të bilancit të pagesave, si dhe nuk ka politikë monetare, ky program më shumë do të ketë fokusin në zhvillimin ekonomik të vendit. Me saktësisht, duke pasur parasysh nivelin e ulët të borxhit publik në raport në BPV-në si dhe nevojën që Kosova ka për ngritjen e infrastrukturës dhe rritjen ekonomike, marrëveshja është arritur me FMN që të krijohet një klauzolë e investimeve brenda LMFPP e cila i lejon Qeverisë financimin e projekteve jashtë rregullës fiskale përmes kredive nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare.

Per te siguruar qendrueshmeri te financave publike dhe ruajtur strukturen e shpenzimeve te buxhetit, Qeveria planifikon krijimin e një rregulli të veçantë brenda LPFPP i cili do të rregullon dhe ndërlidhë (anchor) rritjen e pagave të sektorit publik me rritje të produktivitetit. Në përputhje me këto kufizime në shpenzimet aktuale, Qeveria është e përkushtuar të mbajë një nivel të lartë të shpenzimeve kapitale gjatë periudhës 2016-2018. Ndërtimi i rrugëve të reja dhe përmirësimi i mëtejshëm i rrugëve ekzistuese dhe infrastrukturës hekurudhore, investimet në rritjen e eficiencës së energjisë, zgjerimi i sistemit të ujitjes së tokave etj. do të përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve kapitale në periudhën e ardhshme.

Të gjitha masat dhe orientimet do të bazohen në këto parime fundamentale buxhetore: (i) qëndrueshmëri buxhetore dhe stabiliteti makro-fiskal në fushën e menaxhimit të financave publike; (ii) koherencë në mes të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, duke ndjekur politikën e ngarkesave të ulëta tatimore në interes të zhvillimit të sektorit privat. Fuqizimi i sektorit privat do të vazhdojë të realizohet nëpërmjet hartimit të politikave, të cilat do të derivojnë nga dialogu publiko-privat, me synim që politikat fiskale, tregtare, tërheqjes së investimeve të jashtme, përmirësimit të mjedisit biznesor dhe zhvillimit të fuqisë punëtore, të jenë promotor i rritjes së sektorit privat dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.

MSA do të ketë impakt në të hyrat doganore. Shkrija e ATK-së dhe Doganës në një autoritet të vetëm të të hyrave do të bëhet në harmoni me proceset e integritetit, meqë tarifatat doganore do të eliminohen me shumicën e partnerëve kryesorë tregtarë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve për tregti të lirë.

Pjesë integrale e bashkëpunimit të përforcuar institucional në mes të Kosovës dhe BE-së në vitin 2014 është edhe ftesa drejtuar Kosovës që të përfshihet në dialogun e strukturuar për qeverisjen ekonomike që zhvillohet rregullisht dhe vazhdimisht midis vendeve kandidate nga njëra anë, dhe institucionet e BE-së, veçanërisht Këshilli dhe Komisioni, nga ana tjetër. Bazë për këtë dialog është Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) dhe ky dokument paraqet dokumentin e parë të Kosovës të këtij lloji. PRE është mjet i cili ka për qëllim të sigurojë udhëzime më të qartë në zbatimin e reformave duke sjellë së bashku një analizë makroekonomike afatmesme, kornizën fiskale, si dhe prioritetet e politikës së përgjithshme ekonomike.

Në anën tjetër, viti 2015 shënon vitin e fillimit të një programi të ri me FMN, ku si me çdo program, ka kritere strukturore (targets) që duhet të arrihen brenda periudhës prej 22 muajsh, pra korrespondon me gati dy vite të këtij mandati qeverisës³⁷. Me fjale tjera, korniza makro-fiskale e Kosovës do të jete e përcaktuar (në linjë të gjera) nga kriteret e programit me FMN. Megjithatë, duke pasur parasysh se "Efikasiteti i shpenzimeve, madhësia e sektorit publik dhe rregullat fiskale" është pjesë e Programit Qeverisës, programi i negociuar me FMN është tërësisht në linjë me objektivat e Qeverisë.

Korniza institucionale

MF udhëheq procesin e përgatitjes së KASH-it dhe Buxhetit të Kosovës. KASH paraqet dokumentin bazë për fillimin e procesit buxhetor. Me qëllim të përcaktimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin fiskal, Kuvendi i Kosovës miraton çdo vit Ligjin për Buxhetin e Kosovës

³⁷ Per me shume detaje, shihni dokumentet zyrtare tek <https://www.imf.org/external/np/sec/pr/2015/pr15362.htm>.

Në kuadër të Ministrisë së Financave funksionon departamenti i politikave ekonomike, publike dhe për bashkëpunim ndërkombëtar financiar i cili përbëhet nga tri divizione: divizioni i makroekonomisë, divizioni i politikave fiskale dhe publike dhe divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar financiar. Departamenti është përgjegjës për hartimin e politikave makroekonomike dhe fiskale në përputhje me objektivat e qeverisë mbi zhvillimin ekonomik, ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare si dhe rritjen e mirëqenies sociale. Gjithashtu, departamenti është përgjegjës për parashikime makro-fiskale për periudhën afatmesme me qëllim të përcaktimit të kornizës së përgjithshme makroekonomike dhe parametrave të përgjithshëm të buxhetit. Ky departament gjithashtu udhëheqë sekretariatit si mekanizëm koordinues për implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Gjithashtu, në kuadër të Ministrisë së Financave funksionon departamenti i Thesarit. Përgjegjësitë kryesore të departamentit të Thesarit janë paraqitur në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Këto përgjegjësi përfshijnë: Menaxhimin e fondit të konsoliduar të Kosovës, Menaxhimin e llogarive bankare, Menaxhimin e shpenzimit të fondeve, Vendosjen e proceseve të mbledhjes së parave publike, Themelimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave kontabël, Përgatitjen e pasqyrave financiare dhe Mirëmbajtjen e Rregullave financiare. Në kuadër të Ministrisë së Financave, është themeluar Divizioni për menaxhimin e borxhit shtetëror ('DMB'), në kuadër të Thesarit, dhe funksionon në koordinim me Departamentin e Politikave Ekonomike e Publike dhe Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave si dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si agjent fiskal i Qeverisë. DMB është përgjegjëse kryesisht për funksionet e menaxhimit të rrezikut të huamarrjes shtetërore, negocimit të kushteve financiare, menaxhimit të strategjisë së huamarrjes, raportimit, regjistrimit dhe shërbimit të borxheve shtetërore.

Departamenti i Buxhetit Qendror dhe Komunal janë në kuadër të Ministrisë së Financave. Buxheti i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës përbëhet nga buxheti i nivelit qendror dhe buxheti i nivelit komunal dhe kjo përfshin të gjitha organizatat buxhetore. Buxheti komunal përbëhet prej grantit të përgjithshëm të përcaktuar në përputhje me formulën e përcaktuar përmes Ligjit për financat lokale, të grantit për arsim dhe grantit për shëndetësi. Përveç kësaj, buxheti komunal përfshin shpenzimet e financuara nga të hyrat vetjake të mbledhura në nivel lokal. Buxheti në nivel qendror përbëhet nga të gjithë organizatat buxhetore (përfshirë komunitet).

Në kuadër të Zyrës së kryeministrit ekziston zyra për planifikim Strategjik e cila bene koordinimin e politikave si dhe ofron këshilla për Kryeministrin lidhur me çështje të rëndësishme të politikave të cilat parashtrihen për miratim në mbledhjen e Qeverisë dhe që ndërlidhen drejtpërdrejt me prioritetet Qeveritare.

Ministritë e linjës si përgjegjësi kryesore kanë formulimin e politikave në fushat për të cilat janë përgjegjëse dhe të cilat koordinohen me ZPS dhe MF parasë të aprovohen nga Qeveria.

Përveç kësaj strukture ekzistuese për hartimin e politikave, Qeveria ka themeluar edhe këshillat të cilat kanë karakter konsultativ siç janë:

- Këshillin Kombëtar për Investime: i cili ka për qëllim shqyrtimin më të gjerë të prioritetëve, priorizimit më të mirë të investimeve në sektorët me aftësi konkurruese. Në këtë format Këshilli do të përcaktohen investimet afatgjate të cilat do të ndikojnë shkallën e zhvillimit të vendit.
- Këshilli ekonomik dhe social: i cili fokusohet në vendosjen dhe zhvillimin e dialogut social në Kosovë për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësishme të veçantë, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale, që realizohen, përmes zgjidhjeve të kontesteve me marrëveshje dypalëshe apo trepalëshe.
- Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës: i cili në bashkëpunim me përfaqësuesit e sektorit të biznesit ka për qëllim shqyrtimin e politikave ekonomike për të adresuar sfidat zhvillimore të vendit

Masat afatshkurtra

- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe

Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L- 221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe me Ligjin nr. 04/L-194

- Ligji nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2016

Prioritetet afatmesme

- Politika fiskale të favorshme përfshirë përshkallëzimin e TVSH-së; uljen e pragut të TVSH-se, pushimet tatimore, integrimi i ATK-së, DK-së dhe mbledhja e TVSH-së në brendi, lirimet doganore;
- Politika tregtare konkurruese dhe përmirësimi i mjedisit biznesor përfshirë hapja e tregut, funksionalizimi i zonave të tregtisë së lirë; luftim i ekonomisë joformale, eliminimi i barrierave ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë
- Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes krijimit të fondit për garantimin e kredive dhe lehtësirave tjera administrative
- Promovimi i investimeve, krijimi i partneriteteve strategjike në fushën e investimeve, lehtësimi dhe promovimi i investimeve nga diaspora, avancimi i partneritetit publiko-privat;
- Zhvillimi i kapitalit njerëzor që mbulon zhvillimin e arsimimit bazik, avancimin e TAP dhe arsimimit terciar, përfshirja e diasporës si dhe sigurimi se rritja dhe përfitimet e saj janë gjithëpërfshirëse;
- Infrastruktura në funksion të rritjes ekonomike e që mbulon energjinë, transportin, shfrytëzimin e burimeve natyrore të Kosovës gjithnjë duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit.

3.19. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat

Acquis në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore të bazuar në parimet si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, konfidencialiteti i të dhënave individuale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare. Institutet Kombëtare Statistikore veprojnë si pika referuese për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. Acquis përfshin metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme të tilla si statistikat makro-ekonomike dhe të çmimeve, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale si dhe statistikat e biznesit, transportit, tregtisë së jashtme, bujqësisë, mjedisit dhe të shkencës dhe teknologjisë. Nuk është i nevojshëm asnjë transpozim në legjislacionin kombëtar pasi që shumica e acquis merr formën e rregulloreve.

Kërkesat e MSA-së

Kapitulli i Statistikave është i rregulluar me nenin 74 dhe 95 të marrëveshjes. MSA parasheh zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm në Kosovë të aftë për të siguruar të dhëna të besueshme, objektive dhe të sakta, të krahasueshme me statistikën Evropiane, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Kosovë. Ky sistem duhet gjithashtu t'i mundësojë Agjencisë së Statistikave të Kosovës të përmbush më mirë nevojat e shfrytëzuesve (përdoruesve) (si të administratës publike ashtu edhe të sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të jetë në përputhje me parimet e Kodit Statistikor Evropian të Praktikës dhe parimeve themelore të statistikave nga OKB, citatet e drejtës Statistikore Evropiane, dhe duhet të zhvillohet në drejtim të zbatimit të *acquis*-it të BE-së në fushën e statistikave.

Studimi i Fizibilitetit 2012 ka nënvizuar rëndësinë e statistikave në procesin e MSA-së për Kosovën. Në këtë dokument janë nënvizuar të arriturat në infrastrukturën statistikore, miratimin e Ligjit mbi Statistikat Zyrtare përmes të cilit theksohet përgjegjësia e ASK-së si prodhuesi kryesor i përpunimit dhe prodhimit të statistikave zyrtare, kalimi i përgjegjësië raportuese nga MAP në ZKM, themelimi i Këshillit statistikor, përgjegjësia e ASK-së në hartimin e programit 5 vjeçar të statistikave zyrtare, përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional, etj. Gjithashtu raporti nëvizon se kapaciteti administrativ (numër i pamjuftueshëm i stafit) i Agjencisë së statistikave të Kosovës mbetet i dobët dhe mungesa e stafit të kualifikuar (shkollë/institucion për trajnime në fushën e statistikave) është një pengesë serioze në zhvillimin e Agjencisë. Fuqizimi i pavarësisë institucionale dhe profesionale të ASK-së mbetet një sfidë kryesore për zhvillimin e institucionit dhe sistemit statistikor të Kosovës. Agjencia ka nevojë për staf shtesë për të përmirësuar cilësinë e statistikave ekzistuese dhe zhvillimin e hulumtimeve të reja, në të gjitha fushat statistikore, por sidomos për statistikën e biznesit dhe statistikën makroekonomike.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015 konstaton se Kosova përballet me vështirësi në zbatimin e legjislacionit në fushën e statistikave. Agjencia duhet të vazhdojë për të prodhuar statistika të besueshme, në kohë dhe në përputhje me standardet evropiane dhe metodologjitë ndërkombëtare. Agjencia e Statistikave përballet me mungesa të konsiderueshme në aspektin e kapaciteteve administrative, mungesa e kapaciteteve parandalojnë ASK-në nga prodhimi i statistikave të sakta dhe në kohë për bërjen e politikave të bazuara në dëshmi. Prodhimi i statistikave thelbësore makro-ekonomike dhe të biznesit mbetet i kufizuar. Disponueshmëria e të dhënave themelore për politikatat e bazuara në dëshmi duhet të trajtohet si prioritet.

Konkluzionet e dala nga DPSA e vitit 2015 kërkojnë që të miratohen ndryshimet e Ligjit për Statistika Zyrtare dhe të vazhdojë forcimin e kornizës ligjore në fusha të tilla si koordinimi dhe zotimi buxhetor. Gjithashtu, potencohet se duhet të vazhdojë zbatimi i programit pesëvjeçar statistikor dhe planit vjetor të ASK. Të marrë masa për të forcuar kapacitetet e ASK përfshirë alokimin e burimeve të mjaftueshme financiare. Duhet edhe më tej të zhvillohen llogaritë kombëtare, statistikatat e biznesit dhe statistikatat ekonomike duke përfshirë aplikimin e NACE rev 2 dhe ESA2010. Të vazhdohet me përgatitjet për regjistrimin e popullsisë për komunat të cilat nuk janë përfshirë në regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave gjatë vitit 2011.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës janë të rregulluara me Ligjin mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës 04/L-036 i cili qartëson parimet themelore për të qeverisur Statistikat Zyrtare. Disa nga këto parime janë rëndësia, paanshmëria, besueshmëria, efektiviteti shpenzues, pavarësia profesionale, dhe transparenca.

Veprimtaria në fushën e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës rregullohet në bazë të Ligjit nr. 04/L-036 për statistikatat zyrtare të Republikës së Kosovës (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 26 / 25 nëntor 2011, Prishtinë). Ligji mbi statistikatat zyrtare është pjesërisht në harmoni me rregulloren e Parlamentit Evropian nr. 223/2009 e cila trajton statistikatat në nivel të BE, duke respektuar dispozitat e Ligjit të statistikave zyrtare mbi konfidencialitetin e të dhënave, parimet fundamentale të statistikave zyrtare (E/2013/24 (2013/21)).

Me qëllim të zbatimit të Ligjit të lartcekur, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë edhe akte nënligjore përkatëse që konsistojnë në dy udhëzime administrative (UA për ruajtjen e lëndës statistikore dhe UA për përpunime të veqanta statistikore) dhe tri rregullore përfshirë edhe Rregulloren nr. 11/2013 për implementimin e standardit për klasifikimin e veprimtarive ekonomike në versionin nace-rev.2 e cila është në përputhje me rregulloren e Parlamentit evropian rregullorja (nr. 1893/2006).

Ligji nr. 03/l-237 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v / nr. 84 / 03 nëntor 2010). Ky ligj është në harmoni me rekomandimet e konferencës së statistikieneteve evropian për regjistrimet e popullsisë dhe banesave 2010, përgatitur në bashkëpunim me Eurostat.

Ligji për regjistrimin e bujqësisë, nr. 04/l-127 (gazeta zyrtare nr. 1/2013 /17.01.2013), ligji nr. 04 /L-253 për ndryshim dhe plotësim të ligjit për regjistrimi e bujqësisë, nr. 04/l-127 (gazeta zyrtare nr. 32/2014/15.05.2014). Ndërsa korniza ligjore që ndërlidhet edhe me fushën e statistikave, konsiston në këto akte ligjore:

- Ligji nr. 03/l-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (gazeta zyrtare e republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v / nr. 77 / 16 gusht 2010);
- Rregullore mbi statistikatat e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare;
- Rregullore mbi statistikatat monetare-financiare dhe llogaritë financiare;
- Ligji nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 03/l- 221, ligjin nr. 04/l-116 dhe me Ligjin nr. 04/l-194;
- Rregullore mf-nr. 03/2014 për pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore.

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e statistikave është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve, të cilat janë pjesë e sistemit Shtetëror Statistikor:

- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- Ministria e Financave;
- Organet tjera të autorizuar nga ASK-ja.

Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK, sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare koordinon sistemin shtetëror statistikor dhe është përgjegjës për harmonizimin e të dhënave zyrtare statistikore. ASK, po ashtu ka detyrë kryesore të përcaktojë nevojat e përdoruesve dhe t'i filtrojë ata për nga rëndësia. Më pastaj, ata transformojnë nevojat përkatëse të përdoruesve në koncepte të matshme për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre. ASK është koordinator kryesor në mes të prodhuesve statistikor dhe siguron koherencën dhe pajtueshmërinë e sistemit statistikor me standardet e miratuara. Momentalisht ASK është fokusuar kryesisht në mbledhjen e informacionit nga sektori real dhe zhvillimin e sa më shumë statistikave që janë të mundura në lidhje me të.

ASK është përgjegjëse për prodhimin e produkteve statistikore që japin informacione mbi aspektet ekonomike, sociale, popullsisë, bujqësisë, mjedisit, energjisë, etj. Produktet statistikore janë të prodhuara në intervale të ndryshme kohore. Produkti më i shpeshtë IÇK publikohet në bazë mujore. ASK është përgjegjëse për të siguruar informacione për Bruto Produktin Vendor, buxhetin e njësisve ekonomike familjare, punësimin dhe strukturën e bujqësisë. Këto informata vihen në dispozicion të përdoruesve çdo vit. Në fund të çdo viti ASK para shpall publikimin e kalendarit që informon për dorëzimin e produkteve statistikore gjatë vitit të ardhshëm.

ASK-ja, ka përgjegjësi të krijoj, menaxhoj, mirëmbaj dhe freskoj:

- Regjistrin e popullsisë
- Regjistrin e ekonomive familjare
- Regjistrin e shtëpive dhe banesave
- Regjistrin statistikor të bizneseve
- Regjistrin e njësisve hapësinore dhe
- Regjistrin ekonomive bujqësore dhe Regjistrat tjerë në pajtim me planet dhe vendimet

ASK është përgjegjëse që metodologjitë statistikore të përdorura në Kosovë të jenë afër me ato të përdorura në vendet e tjera në rajon dhe Evropë. Që të jetë në gjendje të zbatojë këto objektiva ASK në menyrë të vazhdueshme përditëson procedurat në përdorimin e nomenklaturave, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e të dhënave dhe shpërndarjen e të dhënave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - në aspektin e përgjegjësive statistikore, vepron në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore në Republikën e Kosovës dhe Ligjit për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

Përgjegjësitë statistikore të BQK-se janë të rregulluara edhe me Rregulloren mbi statistikën monetare-financiare dhe Llogaritë Financiare dhe Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare.

Statistikat në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të BQK-së janë statistikat për sektorin monetarë e financiarë dhe statistikat e sektorit të jashtëm. Këto statistika janë në përputhje me standardet zhvilluara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, etj. Statistikat monetare dhe financiare përfshijnë të dhënat e prodhuara nga BQK, bankat e nivelit të dytë, kompanitë e sigurimit, fondet e pensioneve, institucionet ndihmese financiare. Statistikat e Sektorit të Jashtëm përfshijnë statistikën e bilancit të pagesave, të pozicionit ndërkombëtar të investimeve dhe borxhit të jashtëm.

Ministria e Financave ka për mision të bëjë parashikime dhe analiza për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në lidhje me formulimin e politikave ekonomike. Permbushja e këtij misioni të Ministrisë së Financave është i nderlidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Thesarit dhe Departamentit të politikave ekonomike, publike dhe bashkepunimi nderkombëtar financiar (DPEPBNF) Statistikat për sektorin fiskal dhe ato të borxhit publik perpilohen dhe publikohen nga Thesari në kuadër të Ministrisë së Financave.

Organet tjera të autorizuara nga ASK-ja- Ekzistojnë edhe ofrues tjerë të informacionit dytësor që përdoren për përpilimin e statistikave zyrtare në Kosovë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për të regjistruar numrin e shkollave, nxënësve, studenteve dhe mësimdhënësve në çdo nivel arsimor, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik janë përgjegjëse për regjistrimin e numrit të institucioneve shëndetësore, pacientëve, mjekëve dhe sëmundjeve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për të ofruar informata për numrin e punëkëruesve, numrin e shërbimeve që ofron, përfitime nga papunësia, subvencione për familjen në nevojë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është e ngarkuar për të siguruar të dhënat administrative siq janë: subvencionet për fermerët dhe të dhënat tjera administrative. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është ngarkuar të hartojë Bilancin e Energjisë, sipas kërkesave të BE, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është ngarkuar të grumbullojë të dhëna mbi burimet natyrore në Kosovë dhe bio-diversitetin, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (ARBK) ofron të dhëna administrative mbi bizneset e regjistruara. Të gjitha këto të dhëna përdoren nga ASK në periudha të caktuara për të informuar publikun për gjendjen në këto fusha respekt- ive. Megjithatë ASK përpiqet për të kombinuar këto informacione me burime tjera që vijnë nga anketimet e kryera prej saj.

Sa i përket Kornizës Strategjike, fusha e statistikave ka:

- Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017/ ASK;
- Planin Strategjik 2015-2019/BQK;
- Programin e Qeverisë 2015-2018.

Si dokumenti më i rëndësishëm i politikave statistikore, Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) rregullon objektivat e sistemit statistikor të përshkruara në Ligjin për Statistikat Zyrtare, Ligji 04/L-036 Nenet 3 dhe 4 të ligjit, vendosin parimet dhe standardet cilësore mbi të cilat mbështetet sistemi statistikor. Gjithashtu, përmes të njëjtit ligj, përcaktohen çartë, kriterët dhe standardet mbi të cilat ndërtohet Programi 5 vjeçar statistikor.

Objektivi i përgjithshëm i Programit është që të arrijë të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm statistikor për Kosovën. Ai do të kujdeset të respektojë kërkesat dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe të punoj në drejtim të përmirësimit të produktivitetit dhe cilësisë së prodhimit statistikor në vend.

Objektivat specifike të sistemit statistikor, të cilat ndjekin objektivin e përgjithshëm mund të përmbledhen në dy fusha kryesore:

Efikasiteti organizativ dhe produktiv ku objektivat kryesore në këtë lëmi për periudhën 2013-2017 janë:

- Të ri-organizojë ASK-në si agjenci në qendër të sistemit që të forcojë procesin e vet planifikues;
- Të arrijë produktivitet afatgjat të sistemit 3-5% në bazë vjetore;
- Të zbatoj Rregullorën për Riorganizimin e ASK-së, të rris dhe të zhvillojë kapacitetet e burimeve njerëzore.

Cilësia dhe dobishmëria e prodhimit ku objektivat kryesore në këtë lëmi për periudhën 2013-2017 janë:

- Të dokumentojë metodat dhe përshkrimin e procesit në planifikimin vjetor;
- Të përmirësoj cilësinë e prodhimit përmes ndërveprimit me përdoruesit dhe trajnimeve;
- Të përmirësoj besueshmërinë dhe shfrytëzueshmërinë e prodhimit të të dhënave;
- Të rris numrin e prodhimeve në përputhshmëri me PSZ.

Një ndër qëllimet strategjike në Planin Strategjik 2015-2019 që ndërlihet me fushën e statistikave është pasurimi i aktiviteteve kërkimore dhe statistikore lidhur me gjendjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe

sistemit financiar. BQK-ja do t'i pasurojë aktivitetet statistikore dhe kërkimore që kanë të bëjnë me ekonominë në përgjithësi dhe sistemin financiar në veçanti përmes këtyre veprimeve strategjike:

- Avancimi i mëtutjeshëm gjithëpërfshirës i statistikave monetare dhe financiare (SMF) si dhe statistikave të sektorit të jashtëm (SMJ);
- Zhvillimi i mëtejshëm i funksionit të analizave dhe kërkimeve ekonomike dhe
- Vlerësimi i stabilitetit financiar dhe identifikimi i rreziqeve sistematike;

Programi i Qeverisë 2015-2018 nënvizon se Qeveria e Kosovës do të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi të veçantë plotësimit të kornizës ligjore dhe zbatimit të programit të statistikave zyrtare në përputhje me standardet ndërkombëtare, të rëndësishme për analizimin e gjendjes, si dhe orientimin dhe planifikimin të mirëfilltë të politikave qeveritare.

Sa i përket bashkëpunimit për çështje statistikore ASK gjithsej ka 15 marrëveshje të bashkëpunimit me ministri, agjenci, institucione të pavaruar si dhe me Bankën Botërore.

Statistikat sektoriale

Statistikat e bujqësisë

Prodhimi i statistikave të bujqësisë sigurohet nga ASK dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. ASK-ja mbulon tri fusha kryesore statistikore: statistikave të bujqësisë, statistikave agromonetare dhe ato të mjediseve.

Sa u përket statistikave të pylltarisë, disa indikator për pylltarin (sipërfaqet dhe shfrytëzimi i pyllit në sektorin privat) janë prodhuar përmes AESHB. Ndërsa nga burimet administrative mund të sigurohen të dhëna për sipërfaqet me pyje dhe shfrytëzimi i tyre në pyjet e sektorit publik. Këto të dhëna administrative mund të sigurohen nga Agjencioni Pylltarisë së Kosovës që është në kuadër të MBPZHR.

Objektivi kryesor i statistikave të Bujqësisë është të prodhohet statistika krahasuese, të besueshme sipas standardeve të Eurostatit. Statistikat e bujqësisë sigurojnë informacion të përgjithshëm dhe specifik mbi bujqësinë dhe blegtorin në baza vjetore në nivel Kosovë, Rajoni dhe në disa raste në nivel komune. Ky informacion sigurohet nëpërmjet burimeve statistikore dhe administrative nga institucionet mbajtës të dhënave si: Agjencia e statistikave të Kosovës dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të bujqësisë në vitin 2014 ka krijuar mundësinë e ndërtimit të Regjistrimit statistikor të fermave bujqësore mbi bazë të cilit do të kryhen anketat e ardhshme bujqësore statistikore.

Ky objektivi sigurohet përmes pasqyrit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuara, të treguesve të prodhuar, kostos së hulumtimeve statistikore.

ASK publikon të dhëna të cilat mbledhen përmes Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore (AESHB) mbi demografinë e ekonomive shtëpiake bujqësore, shfrytëzimin e tokës dhe strukturën e fermës, blegtorinë, kulturat bujqësore (sipërfaqet dhe prodhimi për drithërat, perimet, pemët, vreshtat, bimët foragjere, industriale) pylltarinë, inputet bujqësore, fuqinë punëtore dhe shpenzimet e fermës. Anketa synon që të ndihmojë llogaritjen e nivelit të zhvillimit të sektorit Bujqësor në Kosovë dhe të ofrojë bazat për monitorimin e ardhshëm të trendeve në këtë sektor. Anketa ka ngjashmëri me anketën Strukturore të Fermave që kryhet në BE. EASHB në një masë ka përputhshmëri me Rregulloren e KE (KE) 543/2009 por ka edhe dallime në definicione, karakteristika, variabla etj.

Kryerja e regjistrimit të bujqësisë 1 - 20 nëntor 2014 është në përputhje me ligjin për regjistrimin e bujqësisë. Kryerja e anketës post regjistruese për regjistrimin e bujqësisë 1 - 15 dhjetor 2014 në përputhje me ligjin e RB.

Instrumentet teknike për Regjistrimin e Bujqësisë (Pyetësi dhe Udhëzuesi) janë hartuar në përputhje me Programin Botëror për Regjistrimin e Bujqësisë 2010 (FAO - UN) dhe metodologjinë e Eurostat-it për kryerjen e Anketës Strukturore të Fermës: Rregullorja (KE) nr. 1166/2008 dhe Rregullorja (KE) nr. 1200/2009. Është bërë publikimi i rezultateve preliminare të RB në shkurt 2015. Publikimi i rezultateve

finale është planifikuar të behet në shtator 2015 dhe publikimi i rezultateve tjera nga regjistrimi i bujqësisë është planifikuar të behet çdo muaj në mënyrë të vazhdueshme deri në dhjetor 2015.

Komponenta e **Çmimeve dhe Indeksit të çmimeve në bujqësi** ka filluar të zhvillohet në ASK me mbështetjen e SIDA-s dhe eksperteve të statistikave Suedeze që nga vitit 2003. Aktualisht çmimet dhe indeksi i çmimeve në bujqësi prodhohet në harmoni me Udhëzuesit dhe metodologjisë së Eurostatit. Në vitin 2014 është nderruar viti bazik i Indeksit të çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi nga 2005 = 100 në 2010 = 100 me mbështetjen e Eksperteve Suedeze dhe është përmirësuar lista e artikujve për të cilët grumbullohen çmimet ashtu siç rekomandojnë udhëzuesit metodologjik të Eurostatit. Korniza metodologjike për llogaritjen e çmimeve në bujqësi përbëhet nga Udhëzuesi i BE për Statistikat e çmimeve të prodhimeve bujqësore, version 2.0 nga marsi 2008. Grumbullimi i këtyre çmimeve dhe prodhimi i indekseve të çmimeve të bujqësisë në BE është i bazuar me gentelment agreement.

Me mbështetjen e projektit të IPA 2008 është përgatitur dokumenti i Inventarizimit për çmimet dhe indeksin e çmimeve në bujqësi (përshkrimi metodologjik). Në kuadër të IPA 2011 është startuar me studimin testues për çmimet e tokës dhe qirat e tokës. (dokumenti referues Inventarizimi për EAA and API IPA 2011). Ky studim pilot ka filluar në vitin 2014.

Përpilimi i **Llogarive Ekonomike për Bujqësi** ka filluar në vitin 2010 dhe përfshinë periudhën 2005-2013 deri me tani. Zhvillimi i këtij treguesi statistikor është mbështetur nga SIDA suedeze përmes eksperteve të fushës. Frekuenca e publikimit: vjetore, duke përfshirë disa vite me seri kohore. Të dhënat janë dërguar në Eurostat për periudhën 2005-2008, ndërsa në kuadër të Programit IPA 2008 Multi-Beneficiary të BE-së - Projekti 7 "Llogaritë ekonomike për bujqësi dhe Çmimet" është përgatitur Invenatry/raporti me Përshkrimin e detajuar të metodologjisë së përdorur për hartimin e këtij treguesi dhe është dërguar në Eurostat për periudhën 2005-2008, raport i cili tregon nivelin e harmonizimit të të dhënave me standardet dhe rekomandimet e Eurostatit.

Është përgatitur edhe raporti me përshkrimin e metodologjisë së përdorur për kalkulimin e Llogaritjeve ekonomike për bujqësi në kuadër të IPA 2011, për periudhën 2009-2013.

Të dhënat janë përpiluar në bazë të Metodologjisë së përcaktuar nga Eurostat: Manuali i Llogarive Ekonomike për Bujqësi dhe Pylltari EAA/EAF 97 (Rev.1.1) dhe Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 306/2005. Llogaritë Ekonomike për Bujqësi janë llogari të shpejta (satelite) të Sistemit Europian të Llogarive Ekonomike të Integruara (ESA).

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi janë të bazuara në Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Europian (KE) Nr 138/2004 të datës 5 Dhjetor 2003 në Llogaritë Ekonomike për Bujqësi në Komunitet.

Sa i përket **Fuqisë punëtore në bujqësi (Agriculture Labour Input (ALI))**, këto statistika janë prodhuar përmes AESHB në baza vjetore së bashku me statistikën tjera të kulturave bujqësore dhe blegtoris. Së fundi me kryerjen e RB këto statistika prodhohen në përputhje me metodologjinë e BE.

Sa i përket **Statistikave të mjedisit**, Agjencioni i Statistikave të Kosovës, publikon të dhëna për indikatorët e ndryshëm mjedisor siç janë: Mbeturinat komunale, Mbeturinat industriale, Statistikat e ujit dhe broshurën Fakte mbi Mjedisin (çdo dy vite). Zhvillimi i këtyre statistikave është mundësuar me mbështetjen e vazhdueshme të SIDA-s Suedeze dhe eksperteve Suedeze që nga viti 2006.

Të dhënat e mbeturinave, grumbullohen sipas anketave të rregullta vjetore siç janë; Anketa e mbeturinave komunale dhe Anketa e mbeturinave industriale. Të dhëna grumbullohen për gjenerimi dhe përpunimi i mbeturinave, këto të dhëna janë të bazuara në klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Rev.2.

Anketat e mbeturinave (AMK dhe AMI) janë të harmonizuara me Rregulloren e Statistikave të Mbeturinave nr. 2150/2002 (KE) të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 nëntorit 2002 mbi statistikën e mbeturinave dhe Rregulloren 849/2010 (KE). Për grumbullimin e të dhënave është përdorur Katalogu

Evropian (Rregullore nr. 2000/53 (KE), të dhënat publikohen në harmoni me Nomenklaturën e Statistikave të Mbeturinave (EWC-stat) duke përdorur tabela të barasvlershme me Rregulloren 574/2004 (KE) dhe Klasifikimin e aktiviteteve sipas Rregullores nr. 574/2004 (KE). Listës Evropiane të Mbeturinave (shtojca III e Rregullores 2150/2002/KE) dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë (Nr. 02 /L-30).

Sa i përket **Statistikave të ujit**, të dhënat janë grumbulluar me Pyetsorin e përbashkët të ujit (Join Questionnaire Inland Water), raporti është bërë pjesërisht në harmoni me Direktivën e Kornizës së Ujit 2000/60/KE. Të dhënat janë dërguar në Eurostat sipas pyetsorit të përbashkët OECD/BERostat.

Statistikat sociale

Prodhimi i statistikave sociale sigurohet nga ASK, Ministria e Punës dhe Mireqenjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Struktura organizative konsiston në Departamentin Statistikave Sociale brenda ASK-së. Ky departament mbulon dy fusha kryesore statistikore: Statistikat sociale dhe statistikat e popullsisë. Përveq ASK-së në sigurimin e informacionit statistikor mbi statistikave sociale janë edhe MSH, MPMS, MPB, MAP, ATK, MKRS, etj. të cilat janë përgjegjës për mbledhjen e të dhënave administrative për treguesit social.

Objektivi kryesor i Statistikave sociale është të prodhohë statistika sociale gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të krahasueshme me standardet e Bashkimit Evropian. Statistikat sociale sigurojnë informacion lidhur me tregun e punës, standartin jetesor, jurisprudencën, kulturën dhe sportin, popullësinë, lindjet, kurorizimet, shkurozimet, arsimin, mirëqenien sociale, shëndetësinë, etj. Të dhënat publikohen në baza vjetore në nivel të vendit si dhe në nivel komune. Statistikat sociale grumbullohen nga burimet primare dhe burimet administrative.

ASK zhvillon dhe publikon të dhëna statistikore lidhur me shpenzimet, të ardhurat, konsumin si dhe të dhënat lidhur me varfërinë përmes Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF). ABEF-i, zhvillohet duke u bazuar në dokumentin LC/125/a/14/EN si dhe duke aplikuar COICOP, NACE Rev 2, ISCO 88, ISCED 97).

Zhvillimi dhe publikimi i Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) është futur në përdorim nga ana e ASK-e, që nga viti 2000. Qëllim i grumbullimit të informatave të krahasueshme për punësimin dhe papunësinë në territorin e Kosovës dhe për t'i vënë ato informata në dispozicion të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2012, metodologjia e grumbullimit të të dhënave të AFP-së, ka ndryshuar, grumbullimi i të dhënave bëhet me anë të metodës CAPI (Llaptopit). Kjo anketë zhvillohet referuar dokumentit: Rregullores së Këshillit (KE) Nr 577/98, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1575/2000, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1897/2000, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1991/2002, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 2257/2003, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1983/2003, dokumenti (OJ No L 228/18), Anketa e fuqisë punëtore e BE-së – rregulloreve: Rregullores së Komisionit (KE) Nr 2104/2002, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 430/2005, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 698/2006, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 377/2008, Rregullores së Komisionit (KE) Nr 823/2010, shenimet shpjeguese të AFP të BE-së nga 2012 e tutje; kodifikimi shtetorë nga 2012 e tutje; NUTS 2010 nga 2012 e tutje; NACE Rev.2., ISCO 88 (COM); ISCED 97, etj si dhe kodet e rajonit, komunës, vendbanimit të përcaktuara nga ASK.

Nga burimet administrative në fushën e statistikave sociale ASK, prodhon të dhënat statistikore të jurisprudencës për persona madhor dhe të mitur si dhe të dhënat statistikore për kundervajtje. Të dhënat statistikore tjera të prodhuara nga burimet administrative nga ASK në fushën e statistikave sociale janë edhe statistikave të mirëqenies sociale, të shëndetësisë, të arsimit, të kulturës dhe sportit, lindjeve, vdekjeve, kurorizimeve, shkurozimeve, etj. Për prodhimin e statistikave vitale përdoret dokumenti ECE/CES/2007/3 ndërsa për prodhimin e statistikave mbi shkaqet e vdekjes përdoret KNS -10. Prodhimi i statistikave të arsimit bazohet në ISCED 97.

Statistikat ekonomike

Prodhimi i statistikave ekonomike bëhen nga këto institucione si ASK-ja, Banka Qendrore e Kosovës si dhe nga Ministria e Financave. Prodhimi i statistikave në sektorin real është përgjegjësi e ASK-së. Prodhimi i statistikave nga sektori monetar e financiar dhe statistikave të jashtëm janë përgjegjësi e Bankës Qendrore të Kosovës. Statistikat e sektorit fiskal janë përgjegjësi e Ministrisë së Financave.

Objektivi kryesor është ofrimi i një pasqyrë gjithëpërfshirëse të statistikave zyrtare të besueshme dhe me kohë në lidhje me ekonominë e Kosovës sipas standardeve ndërkombëtare.

Sa i përket llogarive kombëtare Korniza për zhvillimin e sistemit të Llogarive Kombëtare përbehet nga sa vijon: Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare 2010 (ESA 2010) dhe Sistemin e Llogarive Kombëtare 2008 (SNA 2008), metodologjinë për llogaritjen e çmimeve konstante në kapitullin e 10 të ESA 2010 dhe SNA 2008, Vendimet e Komisionit 98/715 dhe 2002/990 (të dyja të bazuara në ESA 1995) dhe Doracakun e Eurostatit për matjen e çmimeve dhe vëllimit (i përditësuar në ESA); Llogaritë Kombëtare Tremujore (metodologjinë e Eurostatit, Doracaku mbi Llogaritë Kombëtare Tremujore, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, Doracakun mbi Llogaritë Kombëtare Tremujore), si dhe metodologjitë dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në përputhje me SNA2008 dhe ESA2010.

Sistemi i Llogarive Kombëtare paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore për të gjitha transaksionet që kanë ndodhur brenda një periudhe të caktuar kohore dhe në këtë mënyrë, një pasqyre të përgjithshme të ekonomisë kosovare. Ai ofron një përshkrim sistematik, të qëndrueshëm dhe statistikor të ekonomisë në përgjithësi dhe të raportit reciprok ndërmjet sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe në mes të ekonomisë së përgjithshme dhe pjesës tjetër të botës. Agregati më i rëndësishëm ekonomik që buron nga llogaritë kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), një matje e performancës ekonomike të një vendi në një periudhë të caktuar kohore.

Llogaritë kombëtare në Kosovës përbëhen nga llogaritë vjetore dhe tremujore (sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, të çmimeve aktuale dhe konstante).

BPV-ja sipas qasjes së prodhimit u prezantua për herë të parë në vitin 2003 për periudhën raportuese 2002-2004. Rezultatet e fundit, në bazë të BPV-së sipas qasjes së prodhimit janë për vitin 2013, të publikuara në nëntor 2014. ASK-ja ka kalkuluar BPV-në sipas qasjes së shpenzimeve në vitin 2003, për vitet 2002-2004. Rezultatet e fundit sipas kësaj metode janë për vitin 2013, të publikuara në shtator 2014. Nga viti 2015 me rekomonadime të ekspertëve të twinningut, kemi filluar të publikojmë BPV në të dy qasjet në të njëjtën kohë. Publikimi i fundit i BPV në baza vjetore për vitin 2014, në të dy qasjet (shpenzimeve dhe prodhimit) me çmime aktuale dhe konstante është publikuar në nëntor 2015.

Zhvillimi i burimeve të të dhënave ka përmirësuar cilësinë e vlerësimeve vjetore dhe mundësuar përpilimin e BPV-së tremujore (duke filluar me tremujorin e parë të vitit 2010). Ka të dhëna në dispozicion për periudhën e tremujorit të parë 2010 - tremujorin e katërt të vitit 2014. Publikimi i fundit i BPV-së tremujore në të dy qasjet (shpenzimeve dhe prodhimit) me çmime aktuale dhe konstante është për TM2 2015.

Bruto Produkti Vendor sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante (çmimet e vitit të kaluar), kalkulohet në mënyrë të pavarur, bazuar në Klasifikimin e aktiviteteve ekonomike NACE Rev. 2) dhe PRODCOM për përpilimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (PPI); dhe sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante (çmimet në vitin e kaluar), sipas niveleve të përdorimit: Shpenzimet e konsumit final nga ekonomitë familjare në bazë të Klasifikimit të konsumit individual në nivelin 4-shifror COICOP, por te publikuara në nivel 2-shifror; Shpenzimet e konsumit final të qeverisë sipas klasifikimit të funksioneve të qeverisë (COFOG); llogaritja e formimit të bruto kapitalit fiks në bazë të klasifikimit të produkti sipas aktivitetit (CPA); importin dhe eksportin e mallrave bazuar në Sistemin e Harmonizuar (HS) dhe Nomenklaturën e Kombinuar (CN).

Në përgjithësi, klasifikimet e zbatuara në sistemin statistikor dhe që përdoren për qëllime të Llogarive Kombëtare janë në përputhje me rregulloret ndërkombëtare.

Lidhur me Llogaritë Qeveritare ato paraqesin një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve në bazë të mbledhjes së të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ASK-së. Ato kanë për qëllim pajtueshmërinë maksimale të shifrave të publikuara me standardet e ESA 2010 dhe manualin e FMN-se për statistikën e Financave Qeveritare (2014). Burim i të dhënave janë Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave dhe Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Të dhënat në dispozicion janë për periudhën 2002-2014.

Gjatë këtij viti në kuadër të llogarive kombëtare, ASK ka vendosur të fillojnë të punojnë në një grup tabelash të Furnizimit dhe Përdorimit për Kosovë për vitin 2013.

Përditësimi i detajuar i "Përshkrimit të metodologjisë dhe të të dhënave të burimeve" për llogaritjen e bruto prodhimit vendor në përputhje me llogaritjet bazuar në ESA2010, bëhet në baza të rregullta.

Sa i përket Statistikave të ndërmarrjeve, objektivi kryesor i tyre është të prodhojë statistika të besueshme, krahasuese dhe Statistika të përshtatshme në fushën e prodhimit të treguesve ekonomikë financiar.

Në kuadër të statistikave të ndërmarrjeve janë këto komponente:

- Regjistri statistikor i ndërmarrjeve;
- Statistikat Strukturore të Bizneseve (SSB);
- Statistikat e PRODCOM - it;
- Statistikat afatshkurta - (STS - Industria, STS - Tregtia me pakicë, Statistikat e Transportit, Statistikat e Hotelarisë dhe turizmit, Statistikat e Ndërtimitarisë, Statistikat e shërbimeve etj.).

Sa i përket **Statistikave të Regjistrit të Bizneseve**, Regjistri Statistikor i Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm RSB) u prezantua mbështetur në legjislacionin përkatës kombëtar dhe të BE-së në aspektin e konceptit. RSB-ja është themeluar në vitin 2005 bazuar në Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr 2186/93 e 22 korrikut 1993, për koordinimin e Komunitetit mbi hartimin e regjistrave të biznesit për qëllime statistikore) dhe Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr 696/93 e 15 mars 1993 mbi njësitë statistikore për vëzhgimin dhe analizën e sistemit të prodhimit në BE.

Aktualisht jemi duke bërë ri-konstruktimin dhe përmirësimin e RSB-se e cila përputhet plotësisht me Rregulloren e BE-së (KE) Nr 177/2008 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 shkurtit 2008, duke krijuar një kornizë të përbashkët për regjistrat e biznesit për qëllime statistikore dhe shfuqizuar Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr 2186/93. Përveç këtyre akteve kemi përdorur dhe Manualin e Eurostatit mbi Rekomandimet për Regjistrin e Biznesit me rekomandime për mbajtjen e regjistrit të biznesit të Eurostatit si një instrument i rëndësishëm për menaxhim, zhvillim dhe përmirësim. RSB-ja ka filluar transmisionin e të dhënave nga Regjistri për Hulumtime Biznesore nga viti 2012 në Eurostat përmes eDAMIS ndërsa për vitin 2015 është bazuar në pyetësor të bazuar në faqe të internetit (ueb-faqe) (te ofruar nga Eurostat).

Brenda shume-përfituesish IPA 2011, nga 2013 deri në mes të vitit 2014, një sërë aktivitete po zbatohen për përmirësimin e Regjistrit Statistikorë të Biznesit. Rezultatet e arritura:

- Është prezantuar implementimi i NACE Rev.2 në RSB;
- Është prezantuar Pyetësori i Regjistrit të Bizneseve për përditësimin dhe matjen e cilësisë së RSB-së;
- Janë përcaktuara treguesit për cilësinë e RSB-së;
- Në kuadër të Projektit të BE-së për Binjakëzim, nga mesi i vitit 2014 deri në mes të 2015 janë duke u implementuar shumë aktivitete për ri-konstruktimin e sistemit të bazës së të dhënave për RSB-të;
- Dizajnimi dhe ndërtimi i një sistemi të ri të bazës së të dhënave për mbajtjen e informacionit për njësitë statistikore, gjë që e bën të mundur përditësimin kryesisht automatik dhe mirëmbajtje të lehtë.

Sa i përket **Statistikave Strukturore të Bizneseve (SSB)**, ky hulumtim ka filluar për herë të parë në vitin 2006 me të dhëna referuese për vitin 2005. Të dhënat për këtë hulumtim bazohen sipas bazës ligjore apo Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 0058/1997 dhe 0295/2008 dhe amendamenteve të mëvonshme, lidhur me statistikat strukturore të ndërmarrjeve, definicionet, afatet kohore për transmetim dhe aspekte të ndryshme të kualitetit të specifikuar për implementimin e Rregullores.

Ndarja e detajuar e niveleve të kërkuara duke filluar nga viti referues është definuar në Rregulloren e Komisionit nr. 251/2009. Ndërsa për vitet referuese të mëhershme është përfshirë në Rregulloret e Komisionit (KE) nr. 2701/1998 dhe amandemantuar me nr. 1614/2002 dhe nr. 1669/2003.

ASN përbëhet nga një modul horizontal (Aneksi I), duke përfshirë një grup të kufizuar të statistikave themelore për të gjitha aktivitetet. Shtatë anekset e sektoreve specifike mbulojnë një listë më të zgjeruar të karakteristikave specifike sektoriale. Anekset sektorit specifike janë: industria (Aneksi II), tregtia shpërndarëse (Aneksi III), ndërtimtaria (Aneksi IV), shërbimet e sigurimit (Aneksi V), institucionet kredituese financiare (Aneksi VI), fondet e pensioneve (Aneksi VII) dhe shërbimet e biznesit (Aneksi VIII).

Aneksi IX mbulon statistikën demografike të biznesit për të gjitha aktivitetet.

Aktualisht në prodhojmë statistikën sipas anekseve: I, II, III, IV, V dhe IX.

Sa i përket **Statistikave afatshkurtra**, ato zhvillohen në baze të Rregullores së Këshillit nr. 1165/98 of 19 May 1998, e ashtuquajtura Rregullorja mbi STS.

Në këtë sektor janë të përfshira statistikën afatshkurta si në vijim:

- Industria (Indeksi i prodhimit industrial, Indeksi i qarkullimit në industri, Indeksi i çmimeve të prodhimit, Indeksi i të punësuarve në industri)
- Ndërtimtaria (Indeksi i prodhimit në ndërtimtarin, Indikatorët e punësimit, Lejet e ndërtimit - Numri i kërkesave për leje me qira dhe shfrytëzimin e hapsirave dhe kateve)
- Tregtia me pakicë (Indeksi i qarkullimit, indikatorët mbi punësimin)
- Shërbimet tjera-Turizmi (Indeksi i qarkullimit, Indikatorët mbi punësimin).

Aktualisht jemi duke publikuar në baza tremujore këto statistika: Indeksi i qarkullimit në industri, Indeksi i çmimeve të prodhimit, Statistikat e tregtisë me pakicë (Indeksi i qarkullimit, indikatorët mbi punësimin),

Sa i përket **Statistikave të Energjisë**, në kuadër të statistikave të energjisë përgatetet publikimi me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë si dhe importin dhe eksportin e energjentëve tjerë. Statistikat e Energjisë publikohen në baza tremujore (t+70 dite). Ky hulumtim behet në harmoni me Rregulloren (KE) No 1099/2008 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 tetor 2008 mbi Statistikat e energjisë.

Statistikat transportit dhe telekomunikacionit hartohen në baza Rregulloreve të EU No 91/2003 të Parlamentit Evropian dhe KE të datës 16 dhjetor 2002 mbi statistikën e transportit hekurudhor. Rregullorja (KE) No437/2003 e Parlamentit Evropian dhe KE e datës 27 shkurt 2003 mbi transportin apo kujdesin e udhëtarëve, mallrave dhe postës përmes transportit ajror

Sa i përket Statistikave të Hotelarisë dhe turizmit, që nga viti 2005 është filluar me publikimin e të dhënave mbi numrin e hoteleve, numrin e të punësuarve, kapacitetet për vendosje (dhoma, shtretër), numrin e vizitorëve dhe netët e qëndrimit sipas muajve si dhe vizitorët e jashtëm sipas vendeve. Statistikat e hotelarisë publikohen në baza tremujore t+77dite). Këto statistika zhvillohen në nëharmoni me Direktivën e Këshilli No. 95/57/KE dhe propozimeve të Komisionit për amendamentin COM(2010)117.

Çmimet – Agregatet Makroekonomike (Macroeconomic aggregates)

Sa i përket Indeksit të Çmimeve të Konsumit / Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, Indeksi i Çmimeve të Konsumit në Kosovë është krijuar në maj të vitit 2002. Indeksi i Çmimeve të Konsumit publikohet në baza mujore (t+13 ditë) si dhe baza vjetore (t+ 6 muaj) ka qenë/është duke u zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht në përputhje me rregulloret dhe standardet e BE-se. Me indeksin e dhjetorit 2014, pesha të reja kryesisht të bazuara në të dhëna të Llogarive Kombëtare u prezantuan duke bërë mbulimin e IÇK-se më shumë në përputhje me Indeksën e Harmonizuar Evropian të çmimeve të konsumit. Si e tillë IÇK-ja nga dhjetori 2014 publikohet si një IHÇK. Për të reflektuar këtë, nga indeksi i muajit janar 2015, IÇK-ja u riemërua në IHÇK. IHÇK-ja do të zhvillohet vazhdimisht me qëllim të

avancimit në zbatimin e të gjitha rregulloreve aktuale dhe të ardhshme të IHÇK-ve (2495/95) dhe të udhëzimeve të cilat për momentin kanë qenë vetëm pjesërisht të zbatuara.

IHÇK-të për Kosovë janë në dispozicion nga Janari 2015. IÇK-të (të cilat kryesisht përdorin ABF-të si burim i peshave dhe mbulojnë vetëm ekonominë familjare) janë në dispozicion nga maji 2002 deri në dhjetor 2014. Popullata e synuar për IHÇK-te Kosovare janë të gjitha ekonominë familjare, e që është praktika më e mirë ndërkombëtare. IHÇK-ja e Kosovës nuk shtreson popullsinë e saj (e që është plotësisht e përshtatshme për një vend të vogël). Si ABF-ja ashtu edhe LLK-ja mbulojnë popullatën e 34 komunave.

Sa i përket Statistikave të Tregtisë së jashtme, statistikave në lidhje me tregtimin e mallrave janë të bazuara në Rregulloren e Këshillit Nr 1172/95 (versioni i konsoliduar) dhe Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 1917/2000. Doganat e Kosovës ofrojnë të dhëna të pa përpunuara në baza mujore.

Aktualisht STJ publikohen në baza mujore (sit e dhëna preliminare) me një afat t+30 dite dhe në baza vjetore si të dhëna përfundimtare me afat t+6 muaj. Statistikat e tregtisë së jashtme llogarisin treguesit e eksportit të mallrave sipas vlerës FOB (Free On Board) dhe importit sipas vlerës CIF (Cost, Insurance, Freight) në total si dhe disa tregues të tjerë më të detajuar si psh. eksport/importi sipas vendeve, grup-vendeve, grup mallrave, etj.

Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave përpunohen duke u mbështetur në parimet e sistemit e veqante të tregtisë (Special Trade System) e jo në sistemin e përgjithshëm të tregtisë (General Trade System).

Nomenklaturat e përdorura për llogaritjen e statistikave të tregtisë së mallrave janë:

- Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave, (CN),
- Klasifikimi Standard i Tregtisë Ndërkombëtare SITC, rev.4,
- Klasifikimi i vendeve dhe teritoreve ISO (International Standard Organization).

Indeksi i Çmimeve të Importit

Publikimi i indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) ka filluar në qershor të vitit 2009. Çmimet mblidhen dhe publikohen në baza tremujore (t+75 ditë). Mbulojnë kompanitë me reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave për periudhën tremujori i parë 2006- tremujori i katërt 2014. IÇIMP është përgatitur në përputhje me standardet dhe metodologjitë evropiane dhe në bashkëpunim me ekspertët nga Statistika e Suedisë dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Rezultatet janë prezantuar sipas Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave (OBD), IÇIMP është në zhvillim e sipër.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka filluar publikimin e Indeksit të çmimeve të prodhimit (IÇP) nga muaji maj 2009. IÇP-ja publikohet në bazë tremujori (t+78 ditë).

Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale grumbullohen nga ndërmarrjet prodhuese më ndikim në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor i referohen vitit 2007, ndërsa nga tremujori i parë i vitit 2009, indeksi monitorohet dhe llogaritet vazhdimisht në periudha tremujore dhe vjetore.

IÇP - Indeksi i çmimeve të prodhimit është në përputhshmëri me Klasifikimin Standard të Aktiviteteve sipas NACE rev.2 bazuar në "Rregulloren nr. 11/2013, Neni 7 për implementimin e standardit për klasifikimin e aktiviteteve". IÇP-ja është në zhvillim e sipër dhe synon të përfshijë në vazhdimësi aktivitete ekonomike të cilat për momentin nuk janë aktive, por, gradualisht pritet prodhimi nga këto aktivitete.

Indeksi i kostos së ndërtimit

Publikimi i indeksit të kostos së ndërtimit (IKN) ka filluar nga tremujori i parë i 2014, me vitin bazë 2013 (bazë 2013 = 100).

Indeksi i kostos së ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe është në proces të zhvillimit dhe përfshin gjashtë kategoritë e mëposhtme të kostos: Materialet; Pagat; Makineritë; Transportin; Energjinë; Të Tjera.

Pariteti i fuqisë blerëse

Kosova ka filluar me pilot projektin e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB) në kuadër të programit evropian për krahasim, që nga janari 2009. Ky projekt mbështetet nga fondet e IPA-së. Deri më tani kanë përfunduar dy cikle dhe aktualisht jemi në ciklin e tretë.

Sa i përket Sistemeve Informative, ASK me mbështetjen e statistikave daneze përmes projektit të binjakëzimit, ka implementuar PX-Web, një platformë moderne për shpërndarjen e të dhënave online, e që ne ASK njihet si "askdata".

Të gjithë serverët janë të instaluar në bazë të praktikave më të mira dhe për herë të parë, të gjitha serverët janë virtual. Të gjitha bazat e të dhënave nga serverët e vjetër kanë kaluar në SQL 2012. Është bërë dokumentimi i të gjithë serverëve dhe sistemit të TI-se në përgjithësi. ASK, ka zhvilluar SIPK-aplikacionin, një sistem i cili mundëson matjen e performances në ASK, duke ofruar shpërndarjen e orëve karshi produktit dhe proceseve punuese sipas përdoruesit.

Sistemi i GIS, ka një rëndësi të veçantë për punën e regjistrimeve. Në përgatitjet për regjistrimet janë nxjerre/blerë imazhe të detajuara satelitore të territorit, të cilat tregojnë çdo strukturë të ndërtuar. Këto struktura pastaj janë digjitalizuar, kështu që tani çdo ndërtesë mund të identifikohet. Gjatë punës së regjistrimeve në terren janë përditësuar hartat, proces i cili është i vazhdueshëm për azhurnimin e bazës së të dhënave të GIS-it.

Qasja e bazuar në GIS në ndërtimin dhe shpërndarjen e të dhënave hapësinore statistikore gjithashtu inkurajohet nga rekomandimet ndërkombëtare me qëllim të standardizimit të të dhënave sipas direktivave të INSPIRE (Infrastruktura e të dhënave hapësinore në Evropë) dhe GISCO (Njësia e GIS-it në EUROSTAT).

Qëllimet kryesore të përdorimit të GIS-it në ASK janë:

- Përgatitja e databazes hartografike të nevojshme për Regjistrimin e popullsisë/bujqësisë
- Mbështetja e hulumtimeve statistikore në terren me harta
- Ndërtimi i infrastrukturës hapësinore të të dhënave në fushën e Statistikës
- Analiza e të dhënave hapësinore me produkte statistikore
- Shpërndarja e të dhënave statistikore nëpërmjet hartave etj.

Me ndihmën e projektit të IPA 2009, dhe punën e realizuar nga stafi i ASK-së është arritur të behët një përshkrim i metadatave (ESMS) për 12 hulumtime të ndryshme statistikore nga fusha e statistikave ekonomike, sociale, të popullsisë si dhe të statistikave të bujqësisë. Gjithashtu me përmes projektit të IPA 2009, ASK ka ngritur qendrën për mbështetje përdoruesve për statistika evropiane ESDS, qëllimi i së cilës është që ti ndihmojmë përdoruesit tanë për të pasur qasje në Statistikat Evropiane dhe të sigurojmë mbështetje përdoruesve në gjuhët kombëtare.

Implementimi i eDAMIS, sistem i Eurostatit për shkëmbimin dhe transmetimin e të dhënave është implementuar me projektin IPA 2007.

Metodologjia, Teknologjia Informative dhe Diseminimi

Me ndihmën e projektit të IPA 2009, dhe punën e realizuar nga stafi i ASK-së është arritur të behët një përshkrim i metadatave (ESMS) për 12 hulumtime të ndryshme statistikore nga fusha e statistikave ekonomike, sociale, të popullsisë si dhe të statistikave të bujqësisë. Gjatë këtij viti është bërë azhurnimi i përshkrimit të metadatave për këto 12 produkte plus është bërë përshkrimi për dy produkte të reja me përkrahjen e Statistikave të Suedisë. Në bazë të rregullorës së Eurostatit (on reference metadata for the European Statistical System, 2009/498/KE).

Me ndihmën dhe përkrahjen e Statistikave të Danimarkës përmes Projektit të Binjakëzimit është krijuar dokumenti lidhur me politikën e cilësisë si dhe është formuar Komiteti për cilësi i cili ka në përbërje 9 antarë nga fusha të ndryshme statistikore.

Statistikat e Sektorit Monetar dhe Financiar

Përpilimi i statistikave monetare dhe financiare (SMF) është detyrë thelbësore e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Në kuadër të SMF-së përfshihen të gjitha të dhënat e sektorit financiar në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar. BQK-ja grumbullon, përpilon dhe publikon statistika mbi llogaritë e të gjitha korporatave financiare në Kosovë, duke përfshirë bankën qendrore, bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensione, ndërmjetësit e tjerë financiarë, dhe ndihmësit financiar. Një pasqyrë e agreguar me të dhëna për të gjitha korporatat financiare prezantohet në Pasqyrën e Korporatave Financiare e cila publikohet në Buletinin Mujor Statistikor dhe nën kaudër të Serive Kohore në faqen e internetit të BQK-së. Statistika të tjera të sektorin financiar të përpiluara nga BQK-ja përfshijnë pasqyrat mbi korporatat financiare, bilancet e gjendjes, pasqyrat e të ardhurave, depozitat, kreditë, normat e interesit, kursin e këmbimit, sistemi i pagesave, etj. Treguesit e qëndrueshmërisë financiare dhe të dhënat e anketës mbi qasjen financiare përpilohen dhe shpërndahen nga departamenti i mbikëqyrjes bankare i BQK-së.

Përgjegjësia për mbledhjen, përpilimin, dhe shpërndarjen e SMF-ve është e specifikuar në mënyrë të qartë në Ligjin nr. 03/L -209, të datës 22 korrik 2010, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren e BQK-së *mbi-Statistikat Monetare-Financiare dhe Statistikat e Llogarive Financiare*³⁸, e cila i jep BQK-së autoritetin për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe informacioneve të tjera të nevojshme për qëllime statistikore. Zëvendësimi i kësaj rregulloreje është i nevojshëm për shkak të standardeve të reja ndërkombëtare, si dhe kërkesave të Bashkimit Evropian dhe të BQE-se.

Të dhënat statistikore shkëmbehen në baza të rregullta ndërmjet BQK-së dhe agjencive të tjera që publikojnë statistika zyrtare për Kosovën. Kjo është e rregulluar edhe me Ligjin për BQK-në, Neni 25, pika 1.3. Te gjitha statistikave të përpiluara nga BQK-ja janë subjekt i të njëjtit regjim të konfidencialitetit i cili është i rregulluar edhe me Ligjin për BQK-në, përmes Nenit 74. Burimet njerëzore, objektet fizike dhe burimet e tjera janë të mjaftueshme për të kryer përpilimin e statistikave monetare dhe financiare.

Pavarësia dhe autonomia e BQK-së është e rregulluar me Ligjin për BQK-në, dhe nuk ka qasje të brendshme qeveritare në statistika para se ato të publikohen. BQK-ja ka Kodin e vet të Mirësjelljes. Stafi i Departamentit të Statistikave të BQK-së është i përfshirë në mënyrë aktive në një sërë komisionesh ndërkombëtare, grupe pune dhe task forca.

Lidhur me metodologjinë e përdorur për përpilimin e SMF-ve, BQK-ja ndjek standardet më të reja ndërkombëtare, isë janë: Manuali për Statistikat Monetare dhe Financiare (i publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në vitin 2000), Udhëzuesin për Përpilimin e Statistikave Monetare dhe Financiare (Fondi Monetar Ndërkombëtar 2008), Sistemin e Llogarive Kombëtare 2008, Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010). SMF të publikuara nga BQK-ja përmbajnë të gjithë komponentët standarde sipas manualit SMF 2000, që janë relevante për rrethanat e një vendi. Mbulueshmëria në fushën e SMF është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, udhëzimet, si dhe praktikave e mira ndërkombëtare. Përpilimi i statistikave të normës së interesit bëhet në përputhje me *Manualin mbi Statistikat e Normës së Interesit të IMF-ve* (Banka Qendrore Evropiane 2003).

Burimet kryesore të të dhënave për SMF-të janë raportet e rregullta mujore dhe tremujore nga të gjitha institucionet financiare. Të dhënat e SMF-ve përpilohen duke përdorur një softuer të zhvilluar nga një kompani lokale dhe programin MS Excel. Sistemi ndërkombëtar i kodimit përdoret për përpilimin e komponentëve standarde. Statistikat bankare përpilohen dhe publikohen në baza mujore; me një afat kohor 25 ditë pas përfundimit të muajit referues. Pasqyrat e Korporatave Financiare dhe Pasqyrat e Korporateve Tjera Financiare përpilohen në bazë tremujore me një afat tre muaj pas përfundimit të tremujorit referues. Të dhënat e SMF-ve janë në konsistencë të plotë të brendshme në mes vete dhe me llogari kombëtare.

³⁸ http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/english/Monetary-Financial%20Statistics%20and%20Financial%20Accounts%20Statistics.pdf.

Statistikat e SMF-ve publikohen në Buletinin Mujor Statistikor dhe në kuadër të Serive Kohore në faqen e internetit të BQK-së. Një listë e publikimeve të BQK-së është në dispozicion në faqen e saj të internetit. Statistikat publikohen sipas kalendarit të paralajmëruar të publikimeve. Metodologjia e përdorur për mbledhjen, përpunimin, dhe përpilimin e të dhënave për MFS gjithashtu është e publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

Përmirësimet e fundit në fushën e SMF janë si më poshtë:

- Miratimi i Rregullores për Statistika Monetare dhe Financiare dhe Statistika të Llogarive Financiare;
- Implementimi i versioneve të reja të Raportit Statistikor të Bankës (versioni 2.0);
- Implementimi i versioneve të reja të Raportit mbi Normat e Interesit (versioni 2.0)
- Zhvillimi i softuerit për statistikat e sektorit monetar dhe financiar;
- Publikimi i të dhënave në të tri gjuhët (Shqipe, Serbe dhe Angleze. Në të kaluarën të dhënat janë publikuar vetëm në gjuhën Angleze).

Përmirësimet afatshkurtra në fushën e SMF-ve janë si më vijon:

- Përmirësimi i mbulueshmërisë, duke futur në raportim të drejtpërdrejtë në departamentin e statistikës kompanitë e sigurimit dhe korporatat e fondeve pensionale;
- Rritja e numrit të produkteve statistikore për statistikat e normës së interesit në depozita, kredi të reja, si dhe pasqyrat financiare për institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimit dhe fondet pensionale;
- Zhvillim dhe futje në përdorim e një softueri të ri për procesim të statistikave, përpilim dhe analizim të SMF-ve;
- Përmirësimi i mëtejshëm i efikasitetit të shkëmbimit të të dhënave dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe të huaja në fushën e statistikave.
- Përmirësimi i mëtejshëm dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshëm (anglisht GDDS);
- Avancimi i mënyrës Statistikat në kuadër të faqes së internetit të BQK-së.

Përmirësimet afatmesme mbi SMF janë si më poshtë:

- Shkurtimi i afatit të mbledhjes së të dhënave për formën e anketës së korporatave depozituese nga 15 ditë në 10 ditë;
- Zhvillimi i një Politike të Revidimeve për SMF-të dhe SSJ-të;
- Plotësimi i Rregullores për Statistika Monetare-Financiare dhe Statistika të Llogarive Financiare për ta sjellë në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe të BQE-së.

Statistikat e sektorit të jashtëm

Në kuadër të statistikave të sektorit të jashtëm (SSJ) BQK-ja publikon statistika të bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, borxhit të jashtëm, tregtisë ndërkombëtare në shërbime, dhe investimeve të huaja direkte. Përgjegjësia për mbledhjen, përpunimin, dhe shpërndarjen e statistikave të SSJ-ve specifikohet qartë në [Ligjin për BQK-në](#)³⁹ dhe Rregulloren e BQK-së mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, të cilat i japin BQK-së autoritetin për të mbledhur të dhënat statistikore dhe informacione të tjera të nevojshme për qëllime statistikore.

Në periudhën afatmesme, zëvendësimi i kësaj rregulloreje është i nevojshëm për shkak të standardeve të reja ndërkombëtare, si dhe kërkesave të Bashkimit Evropian dhe të BQE-së.

Siç është raportuar më lart, të dhënat statistikore shkëmben rregullisht ndërmjet BQK-së dhe agjencive të tjera që merren me përpilimin e statistikave zyrtare. Të gjitha statistikat e përpiluara nga BQK-ja janë subjekt i të njëjtit regjim të konfidencialitetit. Burimet njerëzore, objektet fizike dhe burimet e tjera janë të mjaftueshme për të kryer përpilimin e SSJ-se, megjithëse ka hapësirë për përmirësime të mëtejshme.

³⁹ Shih Nenin 8 Detyrat (1.6), Neni 25 Mbledhja e statistikave dhe informacionit, Neni 26 Sigurimi i statistikave dhe informacionit, Neni 27 Shpërndarja e statistikave dhe informacionit dhe Neni 28 Publikime të tjera.

Sa i përket metodologjisë, BQK-ja ndjek standardet më të reja ndërkombëtare si dhe udhëzimet e praktikave më të mira ndërkombëtare për përpilimin e statistikave të SSJ. Përpilimi i bilancit të pagesave (BP) dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) bëhen në përputhje me kornizën analitike dhe të klasifikimit sipas *botimit të gjashtë të Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (BPM6)*. Statistikat e publikuara të BP-së dhe IIP-së përmbajnë të gjithë komponentët standarde sipas BPM6, dhe që janë relevante për rrethanat e një vendi. Mbulueshmëria është gjerësisht në përputhje me standardet, udhëzimet dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Përpilimi i statistikave të borxhit të jashtëm (SBJ) është bërë në përputhje me kornizën analitike dhe të klasifikimit sipas manualit mbi *Statistikat e borxhit të jashtëm: udhëzues për përpiluesit dhe përdoruesit* i botuar në vitin 2014.

Burimet kryesore të të dhënave për SSJ janë: Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN), Statistikat monetare, anketimet e ndërmarrjeve, të dhënat administrative nga institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare; dhe vlerësimet të bëra nga stafi i BQK-së. Të dhënat e SSJ-se përpilohen duke përdorur një softuer të zhvilluar nga një kompani vendore dhe në programin MS Excel. Sistemi ndërkombëtar i kodimit përdoret për përpilimin e komponentëve standarde. Të dhënat mbi Bilancin e pagesave përpilohen dhe publikohen në baza mujore, me një afat prej dy muaj pas përfundimit të muajit referues. IIP dhe SBJ përpilohen në bazë tremujore me një afat tre muaj pas përfundimit të tremujorit referues. Të dhënat e SSJ-së janë në përputhje apo rekonsilueshme brenda datasetave të ndryshme të të dhënave për SSJ-të dhe me tregtinë ndërkombëtare të mallrave, llogaritë kombëtare, si dhe statistikave monetare e financiare. Të dhënat e publikuara preliminare, të dhënat e reviduara, dhe finale shënohen me fusnotë ose këto të dhëna shënohen me shkronja të theksuara (bold).

Statistikat BP-se të Kosovës janë publikuar për herë të parë në vitin 2006 në baza vjetore, që mbulonin periudhën 2004-2005. Duke filluar nga viti 2010, këto statistika përpilohen dhe publikohen në baza tremujore, dhe që nga 2015 këto të dhëna publikohen në baza mujore. Të dhënat mbi PIN dhe SBJ janë publikuar për herë të parë në vitin 2011, duke përfshirë periudhën referuese 2007-2011, në baza vjetore. Që nga viti 2012, statistikave përpilohen dhe publikohen në baza tremujore. Në vitin 2012, Kosova ka filluar të marrë pjesë në Raportin e Koordinuar për Investimet e Huaja Direkte si dhe Raportin e Koordinuar për Investimet Portfolio (CPIS) të FMN-së.

SSJ-te publikohen në Buletinin e Statistikave Mujore dhe Seritë Kohore në faqen e internetit të BQK. Një listë e publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së. Statistikat publikohen sipas kalendarit të publikimeve. Metodologjia e përdorur për mbledhjen, përpunimin, dhe përpilimin e të dhënave për BP-të është publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

Përmirësimet e fundit mbi Statistikat e bilancit të pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare janë si më poshtë:

- Plotësimi i Rregullores për Bilancin e Pagesave dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare;
- Implementimi i plotë i metodologjisë BPM6;
- Rritja e frekuencës për bilancin e BP-se nga tremujori në muajore;
- Shkurtimi i afateve për publikimin e statistikave të BP-se nga t+90 në t+60;
- Zhvillimi i softuerit për statistikave të sektorit të jashtëm;
- Publikimi i të dhënave mbi SSJ-te në tri gjuhë (Shqip, Serbisht dhe Anglisht).

Përmirësimet që pritet të bëhen në afat të shkurtër për bilancin e pagesave dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare janë si më poshtë:

- Harmonizimi i plotë i bilancit të pagesave, IIP, statistikave të tregtisë ndërkombëtare në shërbime me *Acquis të BE-së*;
- Kodimi i të dhënave sipas rekomandimeve Vademecum; Instalimi i softuerit për Shkëmbimin e të Dhënave Statistikore dhe Metadatave (SDMX) për Statistikat Makro-Ekonomike
- Dërgimi i të dhënave për bilancin e pagesave, IIP, statistikave të tregtisë ndërkombëtare në shërbime në Eurostat dhe BQE (nëse kërkohen);
- Rritja e numrit të anketimeve për kompanitë e IHD-ve;

- Zhvillimi dhe përdorimi i softuerit të ri statistikor për përpilimin dhe analizimin e serive statistikore.

Përmirësimet që pritet të bëhen në afat të mesëm të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare janë si më poshtë:

- Përpilimi dhe shpërndarja e të dhënave për rezervat ndërkombëtare sipas FMN-së;
- Përpilimi dhe shpërndarja e të dhënave OFATS; Fillimi i raportimit të drejtpërdrejtë, si burim kryesor i të dhënave.
- Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së BQK-së mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare për të sjellë në linjë me kërkesa të Bashkimit Evropian dhe të BQE-së.

Sa i përket Statistikave të Sektorit Fiskal - Në kuadër të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048), i ndryshuar me Ligjin 03/L- 221, Ligjin 04/L-116 dhe Ligjin 04/L/194 rregullohet regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave të kontabilitetit, dhe publikimin e raporteve tremujore dhe vjetore. Ligji i mësipërm kërkon që Ministria e Financave të krijojë dhe të publikojë raporte të rregullta konform kërkesave ligjore të këtij ligji. Ministria e Financave përgadit raporte tjera fiskale konform marrëveshjeve të cilat nënshkruen nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjegjësisht Ministria e Financave me institucionet e caktuara ndërkombëtare. Raportet përmbajnë të hyrat e përgjithshme të cilat përfshijnë: Të hyrat buxhetore ku bëjnë pjesë, Të hyrat tatimore, Të hyrat jo-tatimore, Dividenda nga ndermarrjet publike, Taksa koncesionare, Tantiemat, Gjobat, tarifrat, të hyrat nga interesi, dhe Pranimet nga financimi ku bëjnë pjesë Huamarrja e brendshme dhe e jashtme, pranimet nga privtizimi, të hyrat e dedikuara dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Po ashtu raporte përmbajnë edhe shpenzimet e përgjishme të cilat përfshijnë: shpenzimet rrjedhëse, kapitale, shpenzimet e interesit për borxhe dhe pagesat për financim.

Divizioni i Raportimeve në kuadër të Thesarit përgaditë raporte financiare si vijon:

- Raporte tremujore buxhetore të cilat lidhen me nenin 45 të LMFP-së, të cilat i miraton Qeveria e më pastaj Shqyrtohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,
- Raportin vjetor financiar (Pasqyrat Financiare) për Qeverinë e Republikës së Kosovës e cila lidhet me nenin 46 të LMFP-së, të cilat i miraton Qeveria e më pastaj Shqyrtohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,
- Raporte mujore për FMN-së sipas marrëveshjeve ndërmjet FMN-së dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Raporte mujore të të hyrave dhe shpenzimeve për nevoja të Komisionit Evropian.
- Klasifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve është sipas GFSM (Government Finance Statistics Manual) 1986, duke përfshirë elemente të GFSM 2001. Përgaditja e këtyre raporteve bëhet konform LMFP-së dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme - *Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.*
- Grumbullimi i të dhënave për përgaditjen e raporteve financiare bëhet nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave në Kosovë (SIMFK)⁴⁰, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Organizatat Buxhetore⁴¹.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të kapitullit 18, do të zbatohen këto aktivitetet e afatshkurtra:

- Zbatimi i Ligjit mbi statistikën zyrtare duke përforcuar kornizën ligjore.
- Miratimi i D/Ligjit për statistikën zyrtare me ndryshime dhe plotësime sipas rekomandimeve të Eurostat-it
- Miratimi i D/Ligjit për regjistrimin e popullsisë për 4 komunat të cilat nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2011

⁴⁰ Me 1 prill 2015 është bërë kalimi i SIMFK nga vrisori 6.4 në atë 7.0

⁴¹ Organizatë Buxhetore nënkupton, të gjitha institucionet publike të cilat përfitojnë ndarje buxhetore me Ligjin e Buxhetit.

- Vazhdimi në implementimin e programit mbi statistikat zyrtare 2013-2017 përmes planit operativ të punës (plani vjetor 2016).
- Përforcimi i kapaciteteve të ASK-së duke përfshirë alokimin e resurseve financiare dhe humane me theks të veçante rritjen e numrit të stafit tekniko profesional me kualifikim të lartë.
- Zhvillimi i mëtejshëm i llogarive kombëtare dhe burimeve statistikore të tilla si anketa strukturore e bizneseve, rritja e metejme e disponueshmerisë së indikatorëve afatshkurtër të nevojshëm për përpilimin e llogarive afatshkurtëra tremujore si dhe implementimi i mëtejme i ESA2010 për të gjitha fushat tjera.
- Regjistrimi i popullsisë në komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës të cilat nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë dhe banesave 2011.

Statistikat e bujqësisë

- Realizimi i anketës së prodhimit të kultrave bujqësore bimore në përputhje të plot me Rregulloren (KE) Nr 543/2009.
- Realizimi i Anketës mbi prodhimtarin blegorale në përputhje të plot me Rregulloren (KE) nr. 1200/2009 dhe anketave të prodhimit të mishit (therjet në thertore dhe jasht thertoreve) sipas rregullores së KE 1165/2008 dhe direktivave të këshillit 96/16/KE dhe vendimit të komisionit 97/80/KE dhe prodhimin e qumshit po ashtu sipas këtyre rregulloreve.

Statistikat e pylltarisë

- Rritja e numrit të variablave dhe treguesve të publikuar për pylltarin nga burimet admistrative.

Statistikat Agromonetare

Çmimet dhe Indeksi i çmimeve në bujqësi

- Vazhdimi i studimit pilot për çmimet e tokës dhe qirat e tokës në kuadër të IPA 2012 (dokumenti referues Inventarizimi për EAA and API IPA 2012). Identifikimi i burimeve të mundshme për grumbullimin e këtyre të dhënave.

Llogaritjet ekonomike në bujqësi

- Përfshirja dhe adaptimi i rezultateve të Regjistrimit të Bujqësisë për vitin 2014 në Llogaritë Ekonomike për Bujqësi, si burimi kryesor i të dhënave.
- Vazhdimi i përditesimit të inventarizimit të llogaritjeve ekonomike për bujqësi në kuadër të projektit të IPA 2012.

Statistikat e mjedisit

Statistikat e ujit

- Përmiresimi i cilësisë së këtyre statistikave, rritja e numrit të variablave dhe treguesve statistikor vazhdimi i harmonizimit të metutjeshëm të këtyre statistikave me metodologjin e BE-së.

Statistikat Sociale

- Zhvillimin i AFP në baza tre mujore sipas Rregullorës të Komisionit (KE) Nr 2104/2002, Rregullorës të Komisionit (KE) Nr 430/2005, Rregullorës të Komisionit (KE) Nr 377/2008.
- Zhvillimi i anketës për herë të parë mbi matjen e të ardhurave dhe kushteve të jetesës (SILC) sipas SILC DOC065, 2014.
- Regjistrimi i popullsisë në 4 komunat veriore të Republikës së Kosovës, të cilat nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.
- Digjitalizimi i plotë i të dhënave të statistikave të arsimit.
- Digjitalizimi i statistikave vitale.
- Kalimi nga ISCO 88 në ISCO 08.
- Kalimi nga ISCED 97 në ISCED 2011.
- Zhvillimi i anketës LCI.

Llogaritë Kombëtare

- Aplikimi i mëtejshëm i metodologjisë për llogaritjen e bruto produktit vendor në përputhje me ESA2010;
- Vazhdimi i punës për zhvillimin e tabelës së Furnizimit-Përdorimit;
- Shkurtimi i afat kohor për publikimin e rezultateve të BPV-së;
- Revidimi i të dhënave të bazuara në burime dhe metoda të reja të të dhënave;
- Transmetimi i të dhënave në Eurostat- ESA2010 lidhur me të dhënat e llogarive vjetore kombëtare

Aktivitetet e sipershënuara rreth llogarive kombetare i referohen rregullores me qëllim të përafrimit (Rregullorja (EU) Nr 549/2013 mbi sistemin Evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkimin Evropian.

Regjistri Statistikor i Bizneseve

- Prezantimi për herë të parë i Raportit të Cilësisë së Regjistrimit të Bizneseve.
- Intensifikimi i aktiviteteve për implementimin e NACE Rev.2 në RSB dhe dizajnimi i mostrave të anketimeve të bazuara në NACE Rev.2 për anketa të bazuara në biznese
- Intensifikimi i aktiviteteve për përditësimin automatik dhe të lehtë të RSB-se me të dhëna të anketës administrative dhe statistikore.
- Kryerja e Anketimit Pilot të Regjistrimit të Bizneseve me ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha.
- Kryerja e Anketimit të vërtetë të Regjistrimit të Bizneseve në bazë të kritereve të paracaktuara.
- Koordinimi me Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë dhe Administratën Tatimore të Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në mënyrë që të merret një gamë e gjere treguesish të obligueshëm që të mbahen në RSB.
- Implementimi i mjetit për transmetimin e të dhënave për marrjen e të dhënave online nga Administrata Tatimore e Kosovës

Statistikat Strukturore të Bizneseve (SSB)

- Shkurtimi i afatit të publikimit.
- Prodhimi i statistikave sipas aneksit VI.
- Shkurtimi i afatit të publikimit.
- Prodhimi i statistikave të turizmit (Indexi i qarkullimit, Indikatorët mbi punësimin).
- Rritja e cilësisë.

Statistikat e Energjisë

- Shkurtimi i afatit të publikimit të statistikave të energjisë.
- Publikimi i statistikave të efciences sipas standardeve ndërkombetare në baza vjetore.

Statistikat e Transportit dhe telekomunikacionit

- Shkurtimi i afatit të publikimit të statistikave të transportit.

Statistikat e Hotelarisë dhe turizmit

- Shkurtimi i afatit të publikimit.

Tregtia e jashtme

- Shkurtimi afatit të publikimit dhe
- Përdorimi i PX web (format) për shpërndarjen e të dhënave.

Çmimet – Agregatet Makroekonomike

Indeksi i çmimit të Konsumit / Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

- Shkurtimi afatit të publikimit.
- Përmirësimi i cilësisë.

Indeksi i Çmimeve të Importit

- Aplikimi i klasifikimit të aktiviteteve të produktit (CPA).
- Shkurtimi i kohës së publikimeve.
- Përmirësimi i kualitetit.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

- Përmirësimi i cilësisë.
- Shkurtimi afatit të publikimit.

Indeksi i Kosotos të Ndërtimit

- Përmirësimi i cilësisë.
- Shkurtimi afatit të publikimit.

Sistemet Informative

- Zhvillimi i ueb faqes së re të ASK-së në teknologjinë ASP.NET-SIDA.
- Implementimi i një CMS.
- Sinkronizimi i përdoruesve të SIPK me Sistemin e menaxhimit të vijueshmerise në punë.
- Zhvillimi i Intranetit përmes SharePoint – SIDA.
- Zhvillimi i strategjisë për shpërndarjen e të dhënave – IPA 2012.
- Grumbullimi digjital i të dhënave të statistikave të popullsisë që posedon ARC.
- Zhvillimi i aplikacionit për Indeks të Çmimeve të Importit.
- Krijimi i një strategjie të backup-it – SIDA.

- Zhvillimi i një moduli që do të mundëson azhurnimin e platformës “askdata” në mënyrë decentralizuese.
- Publikimi i raportit “Klasifikimi Urban dhe Rural në Kosovë”.

Metodologjia

- Përshkrim i metadatave (ESMS) për hulumtime të ndryshme statistikore.
- Zgjerimi i listës së termeve statistikore.
- Llogaritja e gabimeve të mostrës (Intervali i besueshmërisë dhe Gabimi në mostër) për dy produkte statistikore (ABESH dhe AFP).

Sektori Fiskal

- Plotësimi i planit kontabël me kode të reja ekonomike dhe përfshirja e elementeve të SFQ (Statistikave Financiare Qeveritare) të vitit 2014.

Prioritetet afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të kapitullit 18, fokusi gjatë periudhës **2017-2020** do të jetë në këto prioritetet afatmesme:

Statistikat e bujqësisë

- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me ministrat dhe agjencionet e tjera qeveritare.
- Forcimit të kapaciteteve në ASK për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese.
- Shtimi i numrit të stafit.

Statistikat e pylltarisë

- Rritja e numrit të hulumtimeve në pylltari dhe harmonizimi i tyre me metodologjin e Eurostatit dhe me rregulloret e BE-së.

Statistikat Agromonetare

Çmimet dhe Indeksi i çmimeve në bujqësi

- Prodhimi i statistikave të çmimeve të tokës dhe qirat e tokës sipas kërkesave dhe metodologjive të Eurostatit.

Llogaritjet ekonomike në bujqësi

- Përgatitja e “Forecast” parashikimit (vlerësimeve për vitin e ardhshëm) dhe publikimi i të dhënave për përdorues të brendshëm në Eurostat sikurse vendet tjera të BE-së.
- Përmirësimi i burimit të të dhënave dhe cilësisë së tyre për llogaritjet ekonomike në bujqësi duke i shfrytëzuar burimet administrative.

Fuqia punëtore në bujqësi (Agriculture Labour Input (ALI))

- Zhvillimi i mëtuqjeshëm i këtyre statistikave dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.
- Harmonizimi i mëtuqjeshëm me metodologjin e Eurostatit.

Statistikat e mjedisit

Statistikat e ujit

- Prodhimi i indikatorve për “Green House Gas Emission” (GHGE) sipas metodologjisë së Eurostatit, sipas rregulloreve të BE dhe UN për GHG: 2006 IPCC udhëzime për inventarët e gazrave Kombëtare; Konventat e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike CLRTAP/UNFCCC.

Statistikat Sociale

- Prodhimi i statistikave sociale në përputhshmëri të plotë me rregulloret e lartecaktuara të BE-së.
- Zgjerimi i hulumtimeve statistikore në fushën e statistikave sociale.
- Zgjerimi i games së statistikave administrative.
- Grumbullimi i të dhënave të statistikave të jurisprudencës në formë digjitale.
- Shtimi i moduleve AFP-se, si pas kërkesave të EU – LFS.
- Përgatitjet për regjistrimin e ardhshëm të popullsisë 2021 (Korniza baze për regjistrimin e popullsisë 2021 në Kosovë do të jetë I bazuar në Legjislacionin e Kosovës, duke respektuar Rekomandimet kryesore të Eurostatit si dhe udhëzimet tjera.
- Ece/ces/stat/none/2006/4: komisioni ekonomik i kombëve të bashkuara për Evropë “konferenca e statistikantëve evropian” rekomandimet e statistikantëve për regjistrimet e popullsisë dhe ekonimive shtëpiake për vitin 2010. Përgatitur në bashkëpunim me Zyrën Statistikore të Komunitetëve Evropiane

- Anketa per emigracion (Kosova ka ligjin per azil (Ligji nr. 04/L-217 per emigrimin jane kriteret nderkombetare perfshire ato te EUROSTAT-it se kush eshte emigrant).
- Anketa mbi vemdet e lira te punes.
- Anketa e kalimit nga shkolla ne pune.

Llogaritë Kombëtare

- Përmirësimi i mëtejshëm i metodologjisë dhe rezultateve të llogaritjes vjetore dhe tremujore të BPV-së dhe Llogarive Qeveritare.
- Publikimi i rezultateve duke përdorur Tabelat për Furnizim dhe Përdorim.
- Përgatitja e të dhënave për hartimin e tabelave të inputit-outputit.
- Rritja e numrit të tabelave nga Programi i Transmetimit.
- Vlerësimi i Ekonomisë Jo Formale (EJF).
- Përmirësimi i mëtejshëm i metodologjisë dhe rezultateve të llogaritjeve vjetore dhe tremujore të agregateve makroekonomike.
- Përmirësimi i mëtejshëm mbi përpilimin e BPV-së duke përdorur Tabelën e Furnizimit dhe Përdorimit.
- Rritja e numrit të tabelave nga Programi i Transmetimit.
- Zhvillimi i mëtejshëm i të dhënave për përpilimin e tabelave të inputit-outputit, në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it.
- Përmirësimi i mëtejshëm mbi vlerësimin e Ekonomisë Jo Formale (EJF).
- Tabela e furnizimit me çmime bazë përfshirë transformimin në çmime blerëse - vjetore.
- Përdorimi i tabelave sipas çmimeve blerëse - vjetore.
- Rritja e numrit të tabelave nga Programi i Transmetimit, duke përfshirë tabelat e BPV-së tremujore.
- Përmirësim i mëtejshëm në vlerësimin e Ekonomisë Jo Formale (EJF).
- Përmirësim mbi formimin e Bruto kapitalit fiks.
- Vlerësimi i Hulumtimit dhe Zhvillimit në bazë të ESA-2010 kërkesave metodologjike.
- Rritja e numrit të tabelave nga Programi i Transmetimit, duke përfshirë edhe variablat e tjera të BPV-së.
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemit të ri të bazës së të dhënave për përditësime automatike dhe mirëmbajtje të lehtë të RSB-së me të dhëna të anketës administrative dhe statistikore.

Aktivitetet e sipershënuara i referohen rregullores me qëllim të përafritimit (Rregullorja (BE) Nr 549/2013 mbi sistemin Evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkimin Evropian.

Regjistri Statistikor i Bizneseve

- Intensifikimi i bashkëpunimit me burimet administrative: për pranim më të lehtë dhe të saktë dhe të qëndrueshëm të informacionit nga burimet administrative për nevojat e RSB-së 2017.
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemit të ri të bazës së të dhënave për përditësime automatike dhe mirëmbajtje të lehtë të RSB-ve me të dhëna të anketës administrative dhe statistikore 2017.
- Dizajni aktual i Udhëzuesit për kërkim/eksplorim të lehtë të njësive për RSB-të. 2017
- Testimi dhe implementimi i PX-WEB për përhapje të të dhënave mbi ndërmarrjet përmes bazës së të dhënave statistikore të bazuar në internet 2017.
- Përmirësim i mëtejshëm i sistemit të bazës së të dhënave për përditësimin e njësive statistikore në RSB 2018.
- Kompletimi i aktiviteteve lidhur me ndërtimin e Udhëzuesit për kërkim/eksplorim të njësive për RSB-në 2018.
- Monitorimi dhe përditësimi i rregullt i RSB-së me të dhëna nga anketat administrative dhe statistikore 2018.
- Fillimi i aktiviteteve lidhur me implementimin e Grupit të Ndërmarrjeve dhe profilizim në RSB 2019.
- Monitorim dhe përditësim i rregullt i njësive statistikore në RSB, 2019.
- Përmirësim i mëtejshëm i sistemit të bazës së të dhënave dhe Udhëzuesit për monitorimin dhe përditësimin e rregullt të njësive statistikore në RSB; 2019.
- Bashkëpunimi me burimet administrative lidhur me aktivitetet për mbajtjen dhe përmirësimin e njësive statistikore mbi RSB-të. 2019.
- Harmonizimi i plotë i RSB-së me rregulloret përkatëse të BE-së, 2020.

- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të bazës së të dhënave për monitorimin dhe përditësimin e rregullt të të gjitha ndryshimeve në njësitë statistikore në RSB; 2020.

Statistikat Strukturore të Bizneseve(SSB)

- Shkurtimi i afatit të publikimit.
- Prodhimi i statistikave sipas anekseve VII dhe VIII.
- Kalimi në baza mujore.
- Prodhimi i statistikave afatshkurtra: për ndërtimtari dhesherbimet.

Statistikat e Energjisë

- Kalimi në baza mujore të statistikave të energjisë.
- Përafrimi dhe harmonizimi me kërkesat dhe rekomandimet e Eurostatit.

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikacionit

- Realizimi i një pilot ankete për transportin rrugor të udhëtareve.
- Kalimi në baza mujore të statistikave të transporti.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kësaj komponente me qëllim të përafrimit dhe harmonizimit të plotë me kërkesat dhe Regulloret e Eurostatit (2017-2020).

Statistikat e Hotelarisë dhe turizmit

- Realizimi i një pilot ankete lidhur me statistikën e turizmit.
- Përmirësimi i kualitetit dhe shkallës së përgjigjeve të respondentëve.
- Zgjerimi i gamës së produkteve dhe indikatorëve që kërkohen në kuadër të këtyre statistikave në harmoni me Eurostatin.

Tregtia e jashtme

- Përmirësimi dhe zgjerimi i variablave duke qenë gjithnjë në harmoni dhe përputhje me zhvillimet dhe ndryshimet apo kërkesat nga Eurostat dhe Statistikat e Kombeve të bashkuara.
- Shkurtimi i afatit të publikimit dhe
- Rritja e numrit të tabelave PX ëeb (format) për shpërndarjen e të dhënave.

Statistikat Agromonetare

Indeksi i çmimit të Konsumit / Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

- Monitorimi me metoden e avancuar (laptop).
- Shkurtimi i afatit të publikimit.

Indeksi i Çmimeve të Importit

- Shtimi i observimeve të çmimeve.
- Përmirësimi i kualitetit.
- Shkurtimi i kohës së publikimit.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

- Shtimi i observimeve të çmimeve.
- Përmirësimi i kualitetit.
- Shkurtimi i kohës së publikimit.

Indeksi i Kosotos të Ndërtimit

- Shtimi i observimeve të çmimeve.
- Përmirësimi i kualitetit.
- Shkurtimi i kohës së publikimit.

Fuqia Blerëse

- Vazhdimi me të gjitha ciklet nëse mbështetemi nga IPA MB.
- Përdorimi i këtyre indekseve për deflatimin e BPV (GDP) në qasjen e shpenzimeve.

Sistemet Informative

- Zgjerimi i sistemit CAPI për mbledhjen e të dhënave- 2017.
- Centralizimi i sistemit për backup-in e të dhënave si dhe arkivimi në një platformë të re- 2017.
- Pilot projekti për zbatimin e infrastrukturës SDMX për shkëmbimin e statistikave dhe metadata në sistemin ekzistues të informacionit statistikor-2020.
- Rritja e numrit të të dhënave të dërguar në Eurostat përmes DAMIS -2020.
- Vazhdimi i dokumentimit të sistemit të TI-së - 2017.
- Krijimi i një sistemi për përdorimin e të dhënave nga burimet administrative për qëllime statistikore 2020.
- Zhvillimi i Ueb GIS-it-2018.
- Vazhdimi i azhurnimit të gjeoportalit shtetëror-2019.

- Zhvillimi i një sistemi për arkivimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e Metadatave- SIDA-2018.

Metodologjia

- Përmirësimi i vazhdueshëm i metodologjisë statistikore veqanarisht dizajni i mostrave.
- Azhurnimi i kornizës së mostrës e cila do të zhfrytëzohet për dizajnimin e mostrave (Korniza përmban ekonominë familjare që do të zgjedhen për intervistim.
- Vazhdimi i procesit të përshkrimit të metadatave (ESMS) për të gjitha hulumtimet statistikore.
- Zhvillimi i një sistemi për arkivimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e Metadatave - SIDA.
- Përcaktimi i softverit i cili do të përdoret për tabelimin dhe analizimin e rezultateve
- Vazhdimi i dokumentimit të procesit metodologjik.
- Llogaritja e gabimeve të mostrës për gjashtë produkte të tjera statistikore.
- Statistics to bring in lineëith European Union and ECB requirements.

Sektori Fiskal

- Monitorimi i vazhdueshëm në respektimin e planit kontabël.
- Ndryshimi i rregullorës për raportim vjetor të organizatave buxhetore (MF-o3/2013).

3.20. Kapitulli 19 i *acquis*-së: Politikat sociale dhe punësimi

Acquis në fushën sociale përfshinë standardet minimale në fushat e ligjit të punës, barazisë, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe anti-diskriminimit. Shtetet Anëtare marrin pjesë në dialogun social në nivel evropian dhe në proceset e politikave të BE-së në fushat e politikës së punësimit, përfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale.

Kërkesat e MSA-së

Bashkëpunimi në këtë fushë sipas neneve 82 dhe 106 të MSA-së, do të synojë mbështetjen e Kosovës në reformimin e politikave të punësimit. Gjithashtu do të nxisë dialogun social si një forcë kyçe në shtytjen e reformës ekonomike dhe sociale si dhe përafrimin ligjor mbi punësimin, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat, personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarët e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *Acquis* në fushën e Ligjit të Punës me theks në kushtet për punës për gratë si dhe për të nxitur përfshirjen e politikave sociale dhe anti-diskriminuese në Kosovë. Duhet të themelohet një sistem i mbrojtjes sociale që i mbështetë punësimin dhe rritjen gjithëpërfshirëse.

Sipas konkluzioneve të DPSA-së 2015, sa i përket *politikave të punësimit dhe politikave sociale*, duhet të sigurohen konsultime për finalizimin e amandamentimit të Ligjit të Punës si dhe të miratohet ky Ligj. Kosova duhet t'a miratojë Strategjinë Sektoriale për Punësim 2014-2020 dhe planin e saj të veprimit. Buxheti për zgjerimin e masave aktive të tregut të punës ende mbetet i ulët dhe është i pamjaftueshëm për të adresuar nevojat në mënyrë efektive. Fondet për zbatimin e Ligji mbi krijimin e Agjencisë së Punësimit, që pritet të fillojë në vitin 2015, duhet të zotohen. Për *dialogun social dhe partnerët socialë*, duhet të sigurohen kritere të qarta për anëtarësimin në Këshillin Ekonomiko-Social me Ligjin e amandamentuar për Këshillin Ekonomik Social. Kosova duhet t'a miratojë Ligjin e amandamentuar për Këshillin Ekonomik Social si dhe Ligjin e amandamentuar për Grevat me implementimin e të cilit vendi ka shumë probleme në këtë moment. Në fushën e gjithëpërfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale, Kosova duhet t'a aprovojë Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal si dhe të marrë parasysh propozimet e MPMS për grantin komunal për mbulimin e shpenzimeve të Komunave për shërbime sociale. Në këtë kontekst, duhet të sigurohet buxhet për shërbimet sociale në nivel komunal, prandaj duhet të aprovohet një formulë buxhetore për këto shërbime. Gjithashtu duhet të vazhdohet me licensimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale. Ndërsa sa i përket *shëndetit dhe sigurisë në punë*, Kosova duhet t'a rrisë numrin e inspektorëve të punës, t'a themelojë dhe funksionalizojë Këshillin për Shëndet dhe Siguri në Punë si dhe duhet të kompletotet databaza ISLI.

Bazuar në Raportin për Vëndin 2015, në fushën e *politikave të punësimit* theksohet rritja e papunësisë gjatë vitit 2014 në 35.5% krahasuar me 30% sa ishte në vitin 2013; vihet theks i veçantë në rritjen e papunësisë tek të rinjtë e cila ka arritur 61% krahasuar me 55.9% sa ishte në vitin 2013. Në fushën e *politikave sociale* sipas Raportit duhet të miratohet Ligji i plotësuar-ndryshuar për Punë, i cili është në linjë me *Acquis* të BE-së si dhe të punohet në implementimin më të kënaqshëm të këtij Ligji. Inspektorati i Punës duhet të mbështetet më tutje me rritjen e numrit të inspektorëve që të mund të ndikojë në zvogëlimin e numrit të

lëndimeve dhe vdekjeve në vend të punës dhe t'a targetojë punën informale në vend (me theks të veçantë në sektorin e ndërtimit). Në fushën e *dialogut social*, duhet të miratohet Ligji i plotësuar-ndryshuar për Këshillin Ekonomik-Social i cili duhet të ofrojë kritere konkrete për përzgjedhjes dhe anëtarësimin në Këshill si dhe të jetë në linjë me *Acquis* të BE-së. Gjithashtu Raporti thekson që Kontrata Kolektive është jo-funksionale. Në fushën e *shërbimeve sociale*, theksohet ngecja e ofrimit të shërbimeve sociale nga Komunitat për shkak të mungesës së buxhetit; si dhe theksohet që mungesa e buxhetit e ka shtyrë edhe futjen në fuqi të skemës së re pensionale. Ndërsa në fushën e *barazisë gjinore* kërkohet implemetimi më i mirë i Ligjit për Barazi Gjinore për të adresuar papunësinë e lartë në mesin e grave dhe përfaqësimin e ulët të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Duhet gjithashtu të parandalohet diskriminimi i grave në vend të punës për shkak të pushimit të lehonisë, veçanërisht në sektorin privat.

Gjendja aktuale

Korniza legislative

Në fushën e punësimit dhe politikave sociale, Kosova ka krijuar kornizë ligjore bazë nëpërmjet së cilës rregullohen çështjet e punës dhe punësimit, sigurisë dhe shëndetit në punë, inspektoratit të punës, organizatave sindikale, dialogut social, si dhe përfshirjen dhe mbrojtjen sociale. Gjithashtu, legjislacioni kryesor në fuqi rregullon çështjet e pensioneve, shërbimeve sociale dhe familjare të kujdesit, si dhe skemat për personat me nevoja të veçanta dhe të moshuarit.

Legjislacioni kosovar që rregullon fushën e punësimit dhe të politikave sociale është pjesërisht i përafëruar me *Acquis* të BE-së si dhe parimet kryesore të së drejtës së BE-së. Shkalla e përafërimit ligjor e bërë gjatë këtyre viteve, në përgjithësi mund të vlerësohet se është në nivelin fillestar të saj duke marrë parasysh se legjislacioni e BE-së nga fusha e punësimit dhe politikave sociale është shumë e gjerë dhe voluminoze. Nga të gjithë sektorët që mbulon kjo fushë, është filluar procesi i transpozimit i *Acquis* përkatës.

Ligji nr. 03/L-212 i Punës, i cili është bazë për rregullimin e marrëdhënies së punës dhe punësimit, i miratuar në vitin 2011, i sjellë standardet e Kosovës më afër atyre të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Miratimi i Ligjit të Punës ka rregulluar çështjet e punësimit deri në një masë, mirëpo kostoja e lartë e tij paraqitet si sfidë e mëtutjeshme. Zbatimi këtij mbetet i pakënaqshëm, prandaj ai duhet të ndryshohet, sidomos sa i përket kontratave të punës, pushimit të lehonisë, pushimit mjekësor dhe mbikëqyrjes së inspektoratit.

Korniza ligjore ekzistuese nga fusha e punësimit, është pjesërisht e përafëruar me direktivat përkatëse të BE-së. Në Ligjin nr. 03/L-212 e Punës dhe në aktet nënligjore të tij, deri më tani janë përfaruar këto 10 direktiva përkatëse:

- Direktiva 2003/88/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian e datës 4 nëntor 2003 rreth aspekteve të caktuara të organizimit të kohëzgjatjes së punës;
- Direktiva 94/33/KE e Këshillit Evropian e datës 22 qershor 1994 për mbështetjen e të rinjve në punësim;
- Direktiva 97/80/KE e Këshillit Evropian e datës 15 dhjetor 1997 për argumentimin e detyrimeve në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë;
- Direktiva 91/533/KEE e Këshillit Evropian e datës 14 tetor 1991 për obligimin e punëdhënësve në informimin e të punësuarve për kushtet aplikuese të kontratës ose të marrëdhënies të punëmarrësve;
- Direktiva 75/117/KEE e Këshillit Evropian e datës 10 shkurt 1975 rreth harmonizimit të ligjeve të shteteve anëtare rreth aplikimit të parimit për pagesë të barabartë për burrat dhe gratë;
- Direktiva 2001/23/KE e Këshillit Evropian e datës 12 mars 2001 për hartimin e ligjeve të Shtetit Anëtar lidhur me mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve në rast të transfereve të ndërmarra, bizneset ose pjesët e ndërmarra të bizneseve;
- Direktiva 97/81/KE e Këshillit Evropian e datës 15 dhjetor 1997 rreth marrëveshjes kornizë për punë me orar të përgjysmuar të vendosur nga UNICE, CEEP dhe ETUC;
- Direktiva 1999/70/KE e Këshillit Evropian e datës 28 qershor 1999 rreth Marrëveshjes Kornizë për punë me afat të caktuar, të vendosur nga ETUC;

- Direktiva 97/81/KE e Këshillit Evropian e datës 15 dhjetor 1997 rreth Marrëveshjes Kornizë për punët me afat të pacaktuar e vendosur nga UNICE, CEEP dhe ETUC;
- Direktiva 2010/18/BE e Këshillit Evropian e datës 8 mars 2010 mbi zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të rishikuar mbi lejen prindërore të realizuar nga BUSINESSEUROPE, UEAPME, CEEP dhe ETUC dhe shfuqizimi i Direktivës 96/34/KE.

Nga këto 10 direktiva, dy direktivat në vazhdim janë përafuar në një shkallë të pjesshme:

- Direktiva 2003/88/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian e datës 4 nëntor 2003 rreth aspekteve të caktuara të organizimit të kohëzgjatjes së punës, dhe
- Direktiva 94/33/KE e Këshillit Evropian e datës 22 qershor 1994 për mbështetjen e të rinjve në punësim.

Gjithashtu në këtë fushë, sa i përket punësimit, aftësimin dhe riaftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara, legjislacioni që e rregullon evidentimin dhe regjistrimin e të papunëve dhe punëkërkesve dhe programet mbi masat aktive të punësimit është I përfunduar. Ligji nr. 03/0-L19 për Punësim, Aftësim dhe Riaftësim Profesional është pjesërisht i përafuar me këto direktiva:

- Direktiva 2002/73/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 23 shtator 2002 për përmirësimin e Direktivës 76/207/KEE të Këshillit Evropian për implementimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë lidhur me akseset e punësimit, aftësimeve profesionale dhe reklamave, dhe kushteve të punës, dhe
- Direktiva 2000/78/KE e Këshillit Evropian e datës 27 nëntor 2000 për themelimin e kornizës kryesore për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion.

Këto direktiva janë të prekura edhe në Ligjin përkatës për Barazi Gjinore dhe Ligjit përkatës mbrojtjen nga diskriminimi.

Korniza ligjore e cila e rregullon shërbimet publike të punësimit është duke u konsoliduar. Ligji nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit është miratuar në vitin 2014, ndërsa aktet nënligjore do të finalizohen në vitin 2015.

Në fushën e *dialogut social*, legjislacioni ekzistues rregullon kornizën e përgjithshme të dialogimit të partnerëve socialë. Kjo fushë është e rregulluar me Ligjin nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social i cili është I përfunduar me parimet kryesore të legjislacionit të BE-së nga dialogimi social, përkatësisht me:

- Vendimin 2003/174/KE e Këshillit Evropian të datës 6 mars 2003 mbi krijimin e një Samiti social trepalësh për rritje dhe punësim, dhe
- Vendimin nr. 98/2000 e Këshillit Evropian të datës 24 janar 2000 që përcakton Komitetin e punësimit.

Sa i përket të drejtave të punësuarve për informimin dhe konsultim si dhe themelimi i Këshillave të Punës tek punëdhënësi, Direktiva 2002/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 11 mars 2002 që përcakton një kuadër të përgjithshëm për informimin dhe konsultim të punësuarve në Komunitetin Evropian, nuk është transponuar në kornizën ekzistuese ligjore. Kjo direktivë do të transponohet në Ligjin e Punës të amendamentuar.

Në fushën e *shërbimeve sociale*, është aprovuar Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare. Ndërsa si rezultat i plotësim-ndryshimit të këtij ligji janë aprovuar Udhëzimet Administrative, në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Gjithashtu është aprovuar Ligji nr. 04/L-096 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale dhe si rezultat i këtyre plotësim-ndryshimeve është kompletuar korniza ligjore sekondare. Skema e ndihmës sociale përpiqet të mbushë hendekun e krijuar nga mungesa e llojeve të tjera të përfitimeve si: përfitimet për fëmijë, përfitimet në rast sëmundjeje dhe përfitimet nga papunësia.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Decentralizimi i shërbimeve sociale është duke u përmirësuar, por ky proces kërkon mbështetje të mëtutjeshme financiare sidomos në ngritjen profesionale të burimeve njerëzore bartëse të këtij procesi. Në fushën e hartimit të standardeve minimale për shërbime sociale dhe familjare, numri i përgjithshëm i tyre ka arritur në 16 standarde të hartuara dhe aprovuara.

Është kompletuar korniza ligjore për licencimin e ofruesëve të shërbimeve sociale (punëtorëve social) në të tri nivelet (bazik, i mesëm dhe superior) dhe Subjekteve juridike/Organizatave. Licencimi i punëtorëve social është duke vazhduar në të tre nivelet.

Sistemi qendror i pensioneve ofron një asistencë të nivelit minimal për personat në pension. Fusha e pensioneve të financuara nga shteti, është e rregulluar me Ligjin nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti si shtylla e parë e sistemit pensional. Punëtorët nën 55 vjeç janë të mandatuar që të vendosin 10% të pagave të tyre në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Në fushën e *sigurisë dhe shëndetit në punë*, është shënuar progres në fillimin e procesit të përafrimit të legjislacionit. Kjo fushë konsiderohet të jetë fusha më voluminoze dhe më komplekse. Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i miratuar në vitin 2013, është përafruar me Direktivën 89/391/KEE e Këshillit Evropian e datës 12 qershor 1989 mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë (Direktiva Kornizë). Ky ligj, ka hapur rrugët për transpozimin e 19 direktivave individuale të cilat burojnë nga kjo direktivë. Deri me tani janë transponuar dy direktiva individuale në rregullore të veçanta, e para dhe e dyta direktiva sipas kuptimit të nenit 16 (1) i Direktivës 89/39/KEE.

Inspektorati i Punës ballafaqohet me mungesë të kapaciteteve njerëzore për zbatimin dhe kontrollin efektiv të legjislacionit, që lidhet me këtë fushë, ndërkohë është përgjegjës kryesor për zbatimin e Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë por edhe ligjet e tjera në kompetencë të tij. Numri i inspektorëve të punës mbetet shumë i ulët, janë vetëm 50 inspektorë që mbulojnë zbatimin e këtyre ligjeve.

Masat afatshkurtra

Sa i përket prioritetëve në fushën e legjislacionit për vitin 2016, MPMS do të jetë e fokusuar kryesisht në fushën e punës dhe punësimit. MPMS në mënyrë graduale do të vazhdojë të plotësojë kornizën ligjore nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë. Duke ditur se kjo fushë është shumë e gjerë dhe voluminoze, me mbështjen e Projektit të IPA 2014 “Përafrimi legjislacionit vendor për të drejtat e punëtorëve sipas *Acquis* së BE-së”, projekt ky që pritet të fillojë nga viti 2016 dhe mbaron në fund të vitit 2017, do të transponohen së paku 10 direktiva individuale të cilat burojnë nga direktiva kornizë nr. 89/391 siç janë:

- Direktiva e Këshillit 89/656/KEE e 30 nëntorit 1989 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe të sigurisë për përdorim nga punëtorët e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës (Direktiva e tretë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31989L0656;
- Direktiva e Këshillit 90/269/KEE e 29 majit 1990 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe të sigurisë për trajtimin manual i ngarkesave ku ka rrezik veçanërisht nga i lëndimi i shpinës për punëtorët (Direktiva e katërt individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 9/391/KEE), 31990L0269;
- Direktiva e Këshillit 90/270/KEE e 29 majit 1990 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran (Direktiva e pestë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31990L0270;
- Direktiva e Këshillit 92/58/KEE e 24 qershorit 1992 mbi kërkesat minimale për sigurimin e shenjave shëndetësore dhe/ose të sigurisë në punë (Direktiva e nëntë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31992L0058;
- Direktiva e Këshillit e Këshillit 92/91/KEE e 3 nëntorit 1992 lidhur me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit mbrojtjen e punëtorëve në industrinë mineral- nxjerrjen përmes shpimit (Direktiva e njëmbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89 / 391/KEE), 31992L0091;
- Direktiva e Këshillit 92/104/KEE e 3 dhjetorit 1992 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit mbrojtjen e punëtorëve në industrinë e minerale-nxjerrjes nëntokësore dhe

në sipërfaqe (Direktiva e dymbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31992L0104;

- Direktiva 1999/92/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 1999 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit mbrojtjen e punëtorëve potencialisht në rrezik nga atmosferat shpërthyes (Direktiva 15 individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktiva 89/391/KEE), 31999L0092;
- Direktiva 2002/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 qershorit 2002 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (dridhje) (Direktiva e gjashtëmbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të 89/391/KEE), 32002L0044;
- Direktiva 2003/10/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 shkurtit 2003 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (zhurma) 2007/30 / KE, 32003L0010;
- Direktiva 2009/148/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 nëntorit 2009 mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në vendin e punës (versioni i kodifikuar) (Tekst me EEA), 32009L0148.

Gjatë vitit planifikohet të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social i cili do të transpozojë vendimet e mëposhtme:

- Vendimi i Këshillit (2000/98/KE), i datës 24 janar 2000 për krijimin e Komitetit për Punësim, 32000D0098;
- Vendimi i Këshillit (2003/174/KE), i datës 6 mars 2003 për krijimin e një Samit social trepalësh për rritjen dhe punësimin, 32003D0174.

Gjithashtu planifikohet të hartohet dhe miratohet Strategjia për Këshillin Ekonomiko-Social.

Krahas hartimit të legjislacionit, në vitin 2016, Inspektorati i Punës si dhe Partnerët Socialë nga projekti në fjalë i BE-së, do të trajnohen për të gjitha aktet normative (nënligjore) të cilat do të transponohen gjatë vitit 2016. Pra, MPMS synon që krahas hartimit të legjislacionit, të ketë edhe fuqizimin e kapaciteteve monitoruese të përgatitur konform legjislacionit e përafëruar. Sipas Programit Legjislativ të MPMS për vitin 2015, Ligji i Punës është në proces të amendamentimit, i cili pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2016. Ligji i amendamentuar i Punës, për periudhën afatshkurtër, do të vazhdohet të përfarohet me dy direktivat më kryesore nga marrëdhënia e punës siç janë:

- Direktiva 2003/88/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 4 nëntor 2003 rreth aspekteve të caktuara të organizimit të kohëzgjatjes së punës;
- Direktiva 94/33/KE e Këshillit Evropian e datës 22 qershor 1994 për mbështetjen e të rinjëve në punësim.

Qëllimi i amendamentimit të këtij ligji është edhe fuqizimi i grave në tregun e punës, përkatësisht ndalimi i diskriminimit në vendet e punës.

Sa i përket legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale dhe ndihmave sociale për vitin 2016, do të vazhdohet me avancimin dhe plotësimin e akteve nënligjore, miratimin e akteve të reja nënligjore të cilat rrjedhin si rezultat i miratimit apo plotësim-ndryshimeve të ligjeve që kanë ndërlidhje me fushën e shërbimeve sociale. Më qëllim të identifikimit të nevojave për rishikim apo plotësim-ndryshimeve do të bëhet një analizë e zbatimit të legjislacionit aktual të ofrimit të shërbimeve social dhe familjare dhe do të hartohet një raport hulumtues me rekomandimet e nevojshme për ndryshimet e nevojshme që duhet të bëhen në legjislacionin e kësaj fushe. Me qëllim të fuqizimit të mekanizmave të financimit të shërbimeve sociale dhe familjare, do të hartohen akte nënligjore që krijojnë mundësi të financimit të programeve të shërbimeve sociale nga komunat, përmes përfshirjes së sektorit jo qeveritar në zbatimin e projekteve për ofrimin e shërbimeve sociale. Hartimi i standardeve minimale dhe licencimi i ofruesve të shërbimeve sociale, do të jetë një proces i vazhdueshëm, i cili do të zbatohet dhe monitorohet nga komisione profesionale të themeluara nga Ministria.

Sa i përket zvoglimit të varfërisë dhe mbështetjes së familjeve që jetojnë në varfëri do të vazhdohet me analizën e indeksit të çmimeve të shportës së ushqimeve dhe propozimeve për rritjen e shumës së

përfitimeve për familje. Po ashtu prioritet do të jetë angazhimi dhe përfshirja e përfituesëve të Skemës së Asistencës Sociale në programet e masave aktive të punësimit dhe aftësimit profesional.

MPMS krahas hartimit të legjislacionit, gjatë vitit 2016, do të ndërmerr masa drejtë fuqizimit të Inspektoratit të Punës dhe në veçanti të Partnerëve Socialë. Inspektorati i Punës, në bazë të Planit Zhvillimor të Punës 2015-2020, do të hartojë planin e veçantë të punës për zbatimin e aktiviteteve të cilat burojnë nga ky plan për vitin 2016. Prioriteti i MPMS, përkatesisht i Inspektoratit të Punës, për vitin 2016, do të jetë fokusimi në monitorimin e punës së padeklaruar apo luftimi i punësimit informal. Në këtë kontekst, MPMS synon që të rrisë numrin inspektorëve të punës dhe gjithashtu të shtojë efikasitetin e punës së inspektorëve aktual të punës. Fuqizimi i Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, do të jetë një prioritet i veçantë i MPMS. Këshilli do të jetë organi më i lartë në nivel vendi, i cili do të monitorojë sistemin e përgjithshëm të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Prioritetet afatmesme

Objektivi kryesor i MPMS në fushën e legjislacionin, është transponimi i vazhdueshëm i *Acquis* së BE-së në fushën e punësimit dhe politikave sociale deri më 2020. Planifikimet e MPMS në hartimin e legjislacionit në këtë periudhë kohore do të fokusohet në hartimin e Ligjit të ri të Punës, i cili do të transpozoi së paku 17 direktivat në vazhdim:

- Direktiva e Këshillit 91/533/KEE e datës 14 tetor 1991 mbi detyrimin e një punëdhënësi për të informuar punonjësit me kushteve të zbatueshme për të kontratës ose marrëdhënies së punës;
- Direktiva 2008/94/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2008 mbi mbrojtjen e punonjësve në rast të falimentimit të punëdhënësit të tyre;
- Direktiva 2014/67/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për zbatimin e Direktivës 96/71/KE në lidhje me postimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe për amandamentimin e Rregullores (EU) Nr 1024/2012 në administrative bashkëpunimi përmes Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm;
- Direktiva e Këshillit 98/59/KE e datës 20 korrik 1998 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me shkurtime kolektive;
- Direktiva e Këshillit 2001/23/KE e datës 12 mars 2001 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me ruajtjen e të drejtave të punëtorëve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, bizneseve ose pjesë ndërmarrjesh apo bizneset;
- Direktiva 2008/104/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 mbi punën e përkohshme të agjencisë;
- Rregulloren (BE) nr. 165/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 4 shkurt 2014 për takografët në transportin rrugor, që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3821/85 mbi regjistrimin e pajisjeve në transportin rrugor dhe ndryshimin e Rregullores (KE) Nr 561/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi harmonizimin e legjislacionit të caktuara sociale në lidhje me transportin rrugor;
- Direktiva e Këshillit 2010/18/BE e datës 8 mars 2010 për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të rishikuar për lejen prindërore të realizuar nga BUSINESSEUROPE, UEAPME, CEEP dhe ETUC dhe shfuqizimin e Direktivës 96/34/KE;
- Direktiva e Këshillit 1999/70/KE e datës 28 qershor 1999 në lidhje me marrëveshjen kornizë për punën me afat të caktuar të lidhur nga ETUC, UNICE dhe CEEP;
- Direktiva 2002/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2002 krijimin e një kuadri të përgjithshëm për informimin dhe konsultimin e punonjësit në Komunitetin Evropian;
- Direktiva e Këshillit 97/81/KE e datës 15 dhjetor 1997 lidhur me Marrëveshjen Kornizë për punën me kohë të pjesshme të lidhur nga UNICE, CEEP dhe ETUC;
- Direktiva e Këshillit 94/33/KE e datës 22 qershor 1994 mbi mbrojtjen e të rinjve në punë;
- Direktiva 2003/88/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 4 nëntor 2003 në lidhje aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE e datës 27 nëntor 2000 për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion;
- Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit;

- Direktiva 2002/7/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 shtator 2002 amendon Direktivën e Këshillit 76/207/KEE mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë sa i përket qasjes në punësim, trajnim profesional dhe promovimit, dhe kushtet e punës;
- Direktiva e Këshillit 92/85/KEE e datës 19 tetor 1992 mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve shtatzëna dhe punëtorëve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose duke ushqyer me gji (Direktiva e dhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE).

MPMS do të vazhdojë me plotësimin e kornizë ligjore nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me akte nënligjore në kuadër të cilës do të transpozohen se paku 11 direktivat në vazhdim:

- Direktiva e Këshillit 92/57/KEE e datës 24 qershor 1992 mbi zbatimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendet e përkohshme apo mobile të ndërtimit (Direktiva e tetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE);
- Direktiva e Këshillit 92/85/KEE e datës 19 tetor 1992 në lidhje me zbatimin e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve shtatzëna, punëtorët të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose duke ushqyer me gji (Direktiva e dhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE);
- Direktiva e Këshillit 91/383/KEE e datës 25 qershor 1991 për plotësimin e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve me një kohëzgjatje të caktuar të punësimit ose një marrëdhënie të përkohshme të punësimit;
- Direktiva 2002/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (dridhjet) (Direktiva e gjashtëmbëdhjetë individuale brenda kuptimit të Neni 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE);
- Korrigjimi me Direktivën e Këshillit 1999/38/KE të datës 29 prill 1999 për ndryshimin për herë të dytë të Direktivës 90/394/KEE për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj karcinogjenëve në punë dhe zgjerimin e saj në mutagjene;
- Direktiva 2006/25/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2006 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (rrezatimi optik artificial) (Direktiva 19 individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE);
- Direktiva 2013/35/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (fushat elektromagnetike) (Direktiva 20 individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE) dhe shfuqizimi i Direktivës 2004/40/KE;
- Direktiva e Këshillit 2013/59/EURATOM e datës 5 dhjetor 2013 që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtje kundër rreziqeve që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues, dhe shfuqizimi i Direktivave 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom;
- Direktiva 2000/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 shtator 2000 mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë (Direktiva e Shtatë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE);
- Direktiva 2004/37/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj karcinogjenëve ose mutagjenëve në punë (Direktiva e gjashtë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktiva e Këshillit 89/391/KEE);
- Direktiva e Këshillit 98/24/KE e datës 7 prill 1998 për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me agjentët kimikë në punë (Direktiva e katërmëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE).

MPMS, do të hartojë një ligj të ri për Inspektoratin e Punës, i cili do të jetë i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

Nga fusha e mundësive të barabarta, MPMS do të vazhdojë të përafrojë legjislacionin e saj me *Acquis* së BE-së. MPMS, deri më 2020, do të ketë një ligj, i cili do të rregullon të drejtat e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në fushë e përfitimeve financiare dhe kujdesit nga shteti. Programi i Kosovës për Barazin

Gjinore do të ofrojë një vizion të përmirësuar afatmesëm për arritjen e barazisë gjinore. Duke u bazuar në natyrën me ndikim ndërsektorial të çështjeve gjinore, objektivat e parapara në këtë program do të jenë të ndërlydhura. Papunësia dhe varfëria kërcënojnë një numër jo të vogël familjesh në Kosovë, por në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria ndikojnë negativisht në statusin social të grave dhe vajzave. Punësimi dhe pjesëmarrja e grave në ekonomi ka ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e varfërisë. Këtë proces do ta udhëheqë Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me institucionet tjera mbështetëse.

Sa i përket fushës së politikave sociale dhe përfshirjes sociale objektiv kryesor do të jetë plotësimi i Ligjit të Shërbimeve Sociale dhe Ligjit të Skemës së Ndhmës Sociale, që do ta sjellë këtë ligj në harmoni me kërkesat Komisionit Evropian për vendet të cilat aspirojnë anëtarësimin në BE. Përveç kësaj duhet të hartohet legjislacioni (ligj i veçantë) që rregullon fushën e ofrimit të shërbimeve për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuar, duke aplikuar format alternative dhe inovative për shërbime në familje, ditore dhe rezidenciale për këto kategori. Me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe kontrollit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, do të krijohen indikatorët për monitorimin e standarddeve minimale të shërbimeve sociale dhe familjare nga ofruesit qeveritar dhe joqeveritar. Decentralizimi i shërbimeve sociale duhet të jetë funksional dhe formula e financimit të përcaktojë qartë shumën e buxheteve që komunat do të alokojnë për shërbime sociale. Prioritet do të jetë zhvillimi i partneriteteve në nivel lokal në mes të ofrueseve joqeveritar dhe qeveritar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe zbatimin e programeve për përfshirjen e përfitueseve të kategorive sociale në programet e punësimit dhe aftësimin profesional. Dizajnimi dhe krijimi i një skeme të granteve për financimin dhe mbështetje në projekteve të ofrueseve joqeveritar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Nga mbrotja sociale, MPMS, do të vazhdojë të lidhë marrëveshje bilaterale me shtetet në cilat krijohen kushtet paraprake. Këto marrëveshje do të jenë në përputhje me Rregulloret dhe Direktivat përkatëse të BE-së për koordinimin e shteteve të sigurimeve sociale. Në të njëjtën kohë, MPMS do të vazhdojë të plotësojë sistemet e sigurimeve sociale të nevojshme për lidhjen e marrëveshjeve të plota mbi bazën e sigurimeve sociale.

3.21. Kapitulli 20 i acquis-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë

Legjislacioni i BE-së për këtë kapitull kryesisht përbëhet nga **parimet e politikës dhe instrumentet** që konsistojnë nga komunikata, rekomandime dhe konkluzione të Këshillit. Në masë të madhe ato zbatohen përmes Programit për Konkurrueshmëri dhe Inovacion në nivel të gjithë BE-së. Ky kapitull po ashtu përbëhet nga politikat sektoriale. Në përgjithësi, politikat e ndërmarrjeve dhe industriale janë ngushtë të lidhura me Strategjinë 2020 të BE-së.

Përmes **principeve** të përgjithshme të politikave, BE synon të promovojë dhe forcojë konkurrueshmërinë dhe strategjinë industriale. Këto principe burojnë nga fryma e nenit 173 të TFBE që ka për qëllim nxitjen e ndryshimeve strukturore duke inkurajuar krijimin e një ambienti të favorshëm për biznes, NVM, dhe investime të huaja si dhe duke mbështetur inovacionin dhe ndërmarrësin.

Instrumentet e politikave për ndërmarrjet dhe industrinë zhvillohen përmes programeve specifike që ofrojnë mbështetje (përfshirë atë financiare) për ndërmarrjet dhe politikë-bërësit. Këto programe fokusohen në promovimin e qasjes në financa, shërbime të biznesit, rrjetin e ndërmarrjeve të Evropës, politikave kombëtare për inovacion dhe NVM. Aktualisht, kjo zbatohet përmes programit për konkurrueshmëri dhe inovacion 2014-2020. **Direktiva 2011/7/BE** është një nga instrumentet e rëndësishme të politikave dhe ka të bëjë me luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet biznesore.

BE-ja promovon analiza specifike sektoriale të konkurrueshmërisë në kuadër të **politikave sektoriale për ndërmarrjet dhe industrinë**. Kjo konsiston në lancimin e iniciativave për sektorë të caktuar, studime të ndryshme, iniciativa të rrjetëzimit (networking), forume të politikave etj.

Formulimi dhe zbatimi i politikave të ndërmarrjeve dhe industrisë kërkon kapacitete të duhura administrative në të gjitha nivelet e organizimit administrativ të shtetit përfshirë edhe mekanizmat e bashkëpunimit dhe konsultimit.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat e MSA që ndërlidhen me këtë kapitull konsistojnë në nenet 51, 74, 98,99,100, 101, dhe 102 të cilat kryesisht ofrojnë kornizën dhe synimet e bashkëpunimit dhe potencojnë kërkesat për harmonizim me *acquis*. Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqitë të MSA-se të sigurojë trajtim të barabartë kompanive të BE-së me ato vendore sa i përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës. Neni 74 definon obligimet për transpozim të legjislacionit në një fazë të mëhershme për fushat primare të tregut të brendshëm dhe tregtisë. Gjithashtu ky nen kërkon implementim efektiv të këtij legjislacioni.

Neni 98 ofron kornizën për mbrojtje dhe promovim të investimeve të huaja direkte si dhe synon krijimin e klimës së favorshme për biznes. Bashkëpunimi në këtë fushë synon përmirësimin e kornizës ligjore për të favorizuar dhe mbrojtur investimet. Neni 99 përshkruan kornizën e bashkëpunimit në fushën e politikave industriale. Ndër të tjera ky nen synon modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë, inkurajimin dhe zhvillimin e konkurrueshmërisë dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar për zhvillimin e industrisë. Neni 100 ka të bëjë me bashkëpunimin në fushën e NVM-ve dhe ndërmarrjeve në përgjithësi në funksion të krijimit të një ambienti të favorshëm për bizneset. Bashkëpunimi duhet të jetë brenda kornizës së Aktit të Biznesit të Vogël dhe të marrë parasysh *acquis* në këtë fushë.

Neni 101 mbi turizmin, parasheh një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm të turizmit, duke studiuar mundësitë për operacione të përbashkëta dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të ndërmarrjeve turistike, të ekspertëve, institucioneve dhe agjencive të tyre kompetente në fushën e turizmit gjithmonë duke marrë parasysh *acquis*-in e BE-së për këtë fushë.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015₂ ndër tjerash obligon Kosovën që të ndjekë rekomandimet e Aktit të Biznesit të Vogël. Tutje, kërkohet që të iniciohen vlerësimet e impaktit rregullatorë për të zvogëluar barrën administrative për NVM-të. Në aspektin e koordinimit ndër-institucional, është kërkuar të rritet bashkëpunimi ndërmjet ministrive dhe agjencive. Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, duhet të kompletohet sa i përket numrit të stafit, si rezultat i së cilës ndikimi i saj mbetet ende i kufizuar. Në kontekstin e zbatimit është theksuar që strategjitë dhe planet e veprimit në këtë fushë duhet të zbatohen në kohë dhe të monitorohen. Bazuar në këtë të fundit, është cituar që zbatimi i Strategjisë së Sektorit Privat për Zhvillim (2013-17) dhe Akti i Biznesit të vogël të BE-së janë duke u bërë me hapa shume të ngadaltë.

Tutje, është nënvizuar që qasja në financa, zbatimi i dobët ligjor i kontratave dhe rregulloreve të biznesit, barrierat administrative, konkurrenca e pandershme nga sektori joformal, gjyqësia joefikase dhe korrupsioni vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve dhe rritjen e mëtejshme të tyre.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Ligjet që rregullojnë politikat industriale janë: Ligji 04/L-220 për Investime të Huaja që ka për qëllim të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës, tu ofrojë investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare

Ligji nr. 04/L-006 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit nr. L-123 për Shoqëritë Tregtare. Si dhe është në përgatitje e sipër Ligji për Falimentim i cili pritet të aprovohet së shpejti.

Legjislacioni primar dhe sekondar i cili rregullon politikat industriale në sektorin e ndërtimit është Ligji për produktet e ndërtimit nr. 04/L-18, i miratuar me 13 qershor 2013. Ligji është në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullores 305/2011/KE, si dhe 7 udhëzime administrative dhe 3 rregullore të cilat po ashtu janë plotësisht të harmonizuara me rregulloren e mësipërme.

Sektori i tekstilit është i rregulluar me Ligjin nr. 2011/04-L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe vlerësimin te konformitetit dhe rregulloret në vijim:

- Rregullorja Nr 11/2012 për përmbajtjen e lendes se pare dhe emërtimet e tekstilit
- Rregullorja Nr 12/2012 mbi metodat e analizave kuantitative të përzierjeve dy komponentësh të fibrave të tekstilit
- Rregullorja Nr 1/2012 për metodat e analizës sasiore të Përzierjeve tre komponentë te fibrave të tekstilit.

Ligji dhe rregulloret janë plotësisht të përafuara me Direktivën 2009/48/KE. Legjislacioni primar dhe sekondar që rregullon sektorin e këpucëve përbëhet nga Ligji nr. 2011/04-L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe vlerësimin te konformitetit si dhe Rregullorja nr 10/2012 për etiketimin e materialeve të pjesëve kryesore te mbathjeve te dedikuara për shitje ndaj konsumatorëve e cila është pjesërisht e harmonizuar me kërkesat e Direktivës 94/11 / KE.

Legjislacioni që rregullon sektorin e metaleve përbëhet nga Ligji nr. 2011/04-L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe vlerësimin te konformitetit si dhe legjislacioni sekondar i Republikës së Kosovës që rregullon politikat industrial ne sektorin e kepuceve perafrohet plotësisht me kërkesat e Direktivës 94/11/KE si Rregullorja Nr 08/2012 per etiketimin e materialeve te pjeseve kryesore te mbathjeve te dedikuara per shitje konsumatore.

Sektori i turizmit është i rregulluar me Ligjin për Turizmin nr. 04/L-176, i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën 90/314 të Bashkimit Evropian.

Ndërsa procesi i privatizimit rregullohet me Ligjin nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit me fushëveprim për të gjitha ndërmarrjet me pronësi shoqërore.

Korniza e politikave

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) formojnë pjesën kryesore të ekonomisë së sektorit privat të Kosovës dhe përbëjnë përafërsisht 80% të punësimit në ekonominë e tregut. Bazuar në informacionet nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës), në vitin 2013 kanë qenë përafërsisht 46,000 ndërmarrje të sektorit privat, të cilat kanë punësuar rreth 190,000 njerëz. Tregtia me shumicë dhe pakicë përbën sektorin dominues, duke përbërë 43% të ndërmarrjeve dhe 33% të punësimit. Prodhimi, shërbimet e biznesit dhe ndërtimtaria përbëjnë sektorin tjetër dominues në ekonomi.

Një nga dokumentet bazë të kornizës së politikave është **Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017** e cila ka pasur për qëllim të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për rritjen e aktivitetit të sektorit privat, duke përfshirë investimet e huaja dhe vendore si dhe të nxis krijimin e vendeve të punës. Si objektiva të kësaj strategjie kanë qenë krijimi i ndërmarrjeve globalisht konkurruese si dhe promovimi i investimeve dhe eksporti. Në vitin 2016, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë synon të përditësoj këtë strategji duke mbuluar periudhën 2016-2020 që i vë prioritet investimeve të huaja direkte, si një pikë e rëndësishme. Kjo strategji e përditësuar do të jetë në linjë me **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2020**, duke pasur parasysh që zhvillimi i sektorit privat përben një ndër shtyllat kyçe të ekonomisë. Ndërsa strategjia kombëtare synon të jetë një dokument gjithëpërfshirës dhe orientues zhvillimor i Kosovës.

Për më tepër, **Programi i Qeverisë 2015-2018**, nënvizon faktin që gjeneratori kryesor i rritjes ekonomike dhe vendeve te punës do te jete sektori privat, ne veçanti ndërmarrjet e vogla dhe te mesme, nëpërmjet politikave që mundësojnë rritjen e investimeve te bizneseve, sidomos ne prodhimtari dhe shërbime me vlere te larte shtuese. Objektivat kryesore prioritare të programit kanë të bëjnë me përmirësimin e mjedisit biznesor, përkrahjen për NVM-të, promovimin e investimeve sidomos atyre të jashtme, zhvillimin e turizmit dhe politikat tregtare konkurruese.

Sa u perket politikave industriale, Kosova ka përfunduar fazën e projektimit të kornizës teorike dhe themeleve praktike të **Politikës së parë Industriale**. Koncepti i Politikës Industriale përshkruan një platformë të objektivave dhe masave të propozuara që synojnë të intensifikojnë një bashkëpunim

strategjik ndërmjet të gjithë akterëve (qeverisë, industrisë dhe sektorit privat në përgjithësi, akademisë dhe komunitetit të donatorëve) në mënyrë që Kosova t'i shfrytëzojë avantazhet e saja konkurruese dhe të transformohet me kalimin e kohës, nga një ekonomi me vlerë të ulët të shtuar në një ekonomi të avancuar të bazuar në njohuri. Koncepti i Politikës Industriale është dizajnuar të trajtoj kufizimet ndër-sektoriale ndaj zhvillimit ekonomik dhe të lehtësoj zhvillimin e grupeve ndërkombëtarisht konkurruese në veçanti. Ky dokument do të përfshihet në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2016-2020 të Ministrisë së Tregtisë.

Përveç kësaj është kryer edhe analiza e konkurrueshmërisë. Ajo ka identifikuar gjashtë industri të mëdha me potencial më të madh për zhvillim, duke përfshirë: Industrinë e Përpunimit të Ushqimit, Industrinë e Metalit, Industrinë e Tekstilit, Industrinë e Drurit, Industrinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Turizmin. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka organizuar gjithsej gjashtë tryeza të rrumbullakëta, ku ishin ftuar bizneset, shoqatat dhe të gjithë akterët tjerë të ndërlidhur.

Gjithashtu, është hartuar **Plani Zhvillimor për Sektorin e Turizmit** për vitet 2015-2020. Ky plan ka për qëllim zhvillimin e fushës së turizmit dhe do të integrohet në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2016-2020.

Në takimin e Bordit të Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit (RCC)-organizatës kryesore ombrellë të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, është marrë vendimi që Kosova të anëtarësohet si pjesëmarrëse me fuqi të plota në këtë trup, si instrumenti kryesor i para-anëtarësimit në BE dhe bashkëpunimit rajonal. Kosova tani është anëtare e plotë e një numri të organizatave rajonale. Aktualisht Kosova është në proces të anëtarësimit në: Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Komisionin Ndërkombëtar të Pellgut të Lumit Sava, Rrjetin e Grave Ndërmarrëse, Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC), të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), Qendrën Rajonale të Punëdhënësve të 12 13 Adriatikut (AREC), Qendrën Rajonale Mjedisore për Evropën Jugore dhe Qendrore (REC), Bordin Këshillëdhënës të Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG), Nismën Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI), Konventën për Bashkëpunim Policor (PCCSEE), Iniciativën e Përgatitjes dhe Parandalimit të Katastrofave (DPPI) dhe në Rrjetin Shëndetësor (SEEHN).

Kosova poashtu është anëtare e **Horizont 2020** (më shumë për këtë shih kapitullin 25 Shkenca dhe Hulumtimi). Kosova është ftuar të marrë pjesë në Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve por ishte i pamundur përballimi i kostos së anëtarësimit. Aktualisht, Kosova nuk e ka statusin ligjor që të marr pjesë në programe të ndryshme të BE-së, duke përfshirë COSME. Këto mundësi, përfshirë COSME, do të mund të shfrytëzohen pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të MSA-së.

Duke iu referuar nivelit të **Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë** (IHD-së), promovimi i investimeve dhe konkurrueshmëria e sektorit privat janë masat kyçe prioritare të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, e cila është duke u hartuar aktualisht. Investimet e huaja direkte kanë arritur një mesatare prej 77.93 milionë euro nga viti 2007 deri në vitin 2015, duke arritur lartësinë më të madhe prej 440.74 milionë euro në qershor të vitit 2007 dhe uljen rekorde prej -19.12 milionë euro në prill të vitit 2014.

Komiteti Drejtues Ndërministror (KDN) ka nënshkruar kontratën për Projektin e Zhvillimit të Qendrës Turistike të Brezovicës me Konzorciumin Francez "Brezovica Resorts L.L.C." më 14 prill 2015. Është propozuar investimi në faza i cili arrin shumën prej 409 milionë euro dhe pritet të krijojë 3000 vende të punës, prej të cilave 920 do të jenë pozita në qendrën turistike.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është organ përgjegjës për procesin e privatizimit, ku gjatë vitit 2014, ka shpërndarë fonde në vlerë prej 16,023,941 € për 32,143 punëtorët e kualifikuar të 209 Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Agjencia ka nën administrim rreth 599 ndërmarrje shoqërore. Gjatë procesit të likuidimit dhe privatizimit, janë krijuar 769 ndërmarrje të reja dhe janë shitur 534 asete. Gjendja aktuale e privatizimit është si në vijim:

- Ndërmarrjet Shoqërore të privatizuara deri më tani: 329
- Ndërmarrjet Shoqërore që kanë mbetur për tu privatizuar 270
- Totali i procesit të privatizimit deri më tani: 630 milionë euro

- Investitorët e regjistruar në bazën e të dhënave të AKP-së: > 15,000
- Numri i investitorëve të “para-kualifikuar”: > 4,000

Korniza institucionale

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), **Departamenti i Industrisë**, Divizioni i Politikës Industriale në veçanti është përgjegjës për zhvillimin e politikave për industrinë në Kosovë. Ky departament përbëhet nga 6 zyrtarë të përfshirë në aktivitetet e politik-bërjes. Politikat zbatohen nëpërmjet agjencive ekzekutive të MTI-së, e cila në këtë rast është KIESA (Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë). KIESA përbëhet nga dy drejtori:

- Drejtoria për Zhvillimin e Sektorit Privat përbëhet nga Divizioni për NVM dhe Divizioni për Zona Ekonomike. Në këtë drejtori janë të punësuar gjithsej 6 zyrtarë
- Drejtoria për Promovimin e Sektorit Privat përbëhet nga Divizioni për Investime dhe Divizioni për Eksporte. Në këtë drejtori janë të punësuar gjithsej 5 zyrtarë, 3 nga të cilët i përkasin sektorit të Promovimit të Eksportit dhe 2 të tjerë sektorit të Promovimit të Investimeve.

Përveç kësaj, egziston një forum konsultativ i nivelit të lartë për adresimin e sfidave në mjedisin biznesor i quajtur Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Këshilli përbëhet nga përfaqësues të qeverisë, asociacioneve të biznesit dhe shoqërisë civile. Ai ka krijuar 4 grupe punuese të ndara në fusha tematike për të lehtësuar dhe kornizuar diskutimet. Këshilli diskuton dhe rekomandon qeverisë ndryshime legjislative dhe të politikave.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është institucion i pavarur i krijuar nga Kuvendi i Kosovës me kompetenca në privatizimin dhe menaxhimin e asetëve të ndërmarrjeve shoqërore. Ai funksionon në bazë të dy shtyllave: Shitja dhe Likuidimi dhe ato menaxhohen nga Zëvendës Drejtorët Menaxhues të AKP-së. Agjencia përbëhet nga gjashtë (6) departamente, duke përfshirë:

- Departamentin e Financave dhe Buxhetit
- Departamentin për Koordinim Rajonal
- Departamentin e Shitjes
- Departamentin për Koordinim dhe Likuidim
- Departamentin Ligjor
- Departamentin e Administratës
- Departamentin e Prokurimit Publik.

Selia e Agjencisë është e vendosur në Prishtinë; megjithatë, ekzistojnë edhe 5 zyre tjera rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe 3 zyre (Graçanicë, Shtërpçë, Leposaviq).

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushave të kapitullit 20, do të zbatohen këto masa afatshkurtra:

- Ligji për Kamatëvonesat në Transaksionet Tregtare. Ky ligj transponon Direktivën e BE-së 2011/7/BE mbi Pagesat e Vonuara.
- Përpilimi i Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2016-2020
- Miratimi i Ligjit për Fondin Garantues Implementimi i rekomandimeve të Aktit të biznesit të vogël.
- Mbështetje NVM-ve në ngritjen e kapaciteteve menaxheriale dhe atyre të prodhimit
- Mbështetje komunave dhe funksionalizimi i zonave ekonomike
- Funksionalizimi i fondit Kosovar për garantimin e kredive.

Aktivitetet e tjera të planifikuara për vitin 2016 përfshijnë:

- Rekrutimi i dy drejtorëve të drejtorateve dhe një zyrtari për promovim të investimeve në KIESA
- Rritja e konkurrueshmërisë vendore nëpërmjet zhvillimit grupor – Ka për qëllim përkrahjen e zhvillimit grupor nëpërmjet krijimit të kornizës institucionale dhe lehtësimit të krijimit të rrjeteve dhe nën-kontraktimit të furnizimit nëpërmjet organizimit ngjarjeve të rrjetëzimit Qeveria për Biznes (G2B)
- Përpilimi i raportit vjetor mbi zhvillimin Industrial – Raporti përmbledh arritjet vjetore të këtij departamenti në fushën e Zhvillimit Industrial
- Përpilimi i raportit për NVM – Raporton gjendjen e NVM-ve për vitin specifik
- Zgjerimi i kapaciteteve për politikën industriale – ka për qëllim krijimin e një sektori të ri, nën ombrellën e Departamentit të Industrisë, me fokus në industrinë e ndërtimtarisë,
- Ngritja e kapaciteteve administrative në kuadër të departamentit të industrisë dhe KIESA-s për përmirësimin e ambientit të biznesit në Kosovë
- Ngritja e kapaciteteve për Departamentin e Industrisë – Rekrutimi dhe trajnimi i zyrtarëve përgjegjës për fushën e ndërtimtarisë
- Implementimi i politikave për zhvillimin e sektorit privat, që do të ndikojnë në funksionalizimin e zonave ekonomike
- Përmirësimi i dialogut ndërmjet qeverisë lokale dhe qendrore për përmirësimin e dialogut në mes të nivelit qendror dhe lokal
- Vlerësimi i zhvillimit të sektorit privat përmes Aktit për Bizneset e Vogla
- Përkrahjen e KIESA sa i përket iniciativave të investimit dhe promovimit të tregut.

Prioritetet afatmesme

- Rritja e konkurrueshmërisë brendshme nëpërmjet zhvillimit grupor (clusters) – përkrahja e zhvillimit të grupimeve nëpërmjet krijimit të një kornize institucionale.
- Lehtësimi i krijimit të rrjeteve dhe nën-kontraktimit të furnizimit nëpërmjet organizimit të ngjarjeve të rrjetëzimit Qeveria për Biznes (G2B).
- Fuqizimi i ofrimit të Shërbimeve të Këshillimit Biznesor (ShKB) për të përmirësuar konkurrueshmërinë e NVM-ve - Zhvillimi i njësisë së ShKB-së në 5 rajone ekonomike dhe ofrimi i pakove kualitative, efikase dhe standarde për ShKB-në
- Zgjerimi i fushëveprimit të organit certifikues të standardit të cilësisë duke ofruar grante të vogla për NVM-të – Ofrimi i granteve dhe përkrahjes teknike për 2,000 përfitues të kualifikuar nga sektori i NVM për standardet e cilësisë deri në vitin 2020.
- Zhvillimi i mëtejshëm i inkubatorëve ekzistues të biznesit dhe krijimi i një inkubatori shtesë të biznesit për të lehtësuar klimën biznesore
- Funksionalizimi i plotë i fondit për garantimin e kredive dhe rritja e tij për 20% deri në vitin 2020
- Përkrahja e themelimit të grupeve natyrore
- Hapja e tre “one stop shop”-ave të rinj, me fokus komunat me shumicë serbe
- Regjistrimi online për bizneset
- Funksionalizimi i qendrës turistike Brezovica
- Kategorizimi i objekteve turistike
- Identifikimi i tregjeve të reja ndërkombëtare
- Themelimi i qendrave inovative në tre qytete tjera, me potencial industrial
- Zvogëlimi i mëtejshëm i barrierave për bizneset
- fuqizimi i fondit kosovar për garantimin e kredive
- Përmirësimi i funksionalitetit të zonave ekonomike.

Përkrahja e donatorëve

Projektet për Mjedisin Biznesor dhe për Përkrahje të Investimeve

- Partneriteti për Zhvillim i USAID-it zgjat prej majit të vitit 2014 deri në shtator të vitit 2018. Projekti ka për qëllim përmirësimin e mundësisë të mjedisit biznesor për rritjen e sektorit privat dhe zgjerimin e mundësive të punësimit në Kosovë.

- Projekti i IFC për Klimën e Investimeve në Kosovë zgjat prej marsit të vitit 2013 deri në dhjetor të vitit 2015. Projekti ka për qëllim përmirësimin e klimës investuese të vendit për investitorët vendor dhe të huaj.

Projektet mbi Qasjen e Sektorit të Industrisë

- Konkurrueshmëria e Sektorëve në Zona Rurale (CoSiRA), financuar nga Qeveria Gjermane, zgjat prej muajit dhjetor të vitit 2014 deri në mars të vitit 2016. Projekti lehtëson zhvillimin e sektorit në fushat në vijim: turizëm, përpunim i metalit, TIK, verë, si dhe manaferra dhe barishte.
- Projekti Aid for Trade i UNDP-së zgjat prej prillit të vitit 2012 deri në qershor të vitit 2015. Projekti ofron trajnim për Departamentin e Industrisë në analizën e politikave dhe promovon sektorët në vijim: turizmin, përpunimin e ushqimit, përpunimin e metalit, tekstil, TIK dhe përpunimin e drurit. Projekti ka fazën e dytë që fillon në shtator të vitit 2015.
- Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zgjat prej tetorit të vitit 2013 deri në shtator të vitit 2017. Ata ofrojnë shërbime të ndryshme për NVM-të, në veçanti në sektorin e turizmit dhe përpunimit të ushqimit. Përveç kësaj, Fondi i tyre i mundësive është një mekanizëm për dhënie të granteve që financin ndërhyrjet që testojnë ide të reja, inovative dhe të rrezikshme të cilat janë në dispozicion për të gjithë sektorët ekonomik.
- Projekti EMPOWER Sektori Privat i USAID-it zgjat prej korrikut të vitit 2014 deri në korrik të vitit 2019. Projekti EMPOWER ofron shërbime të ndryshme për NVM-të, veçanërisht në sektorin e turizmit, përpunimit të ushqimit, tekstilit, TIK-ut, përpunimit të drurit dhe të energjisë. EMPOWER do të zotoj gjithsej 2 milionë \$ për financimin e granteve deri në fund të vitit 2015, për rreth 50 grante. Shumica e kompanive janë të fokusuar në përmbushjen e kërkesës vendore.

Projektet për përkrahje të NVM-ve

- “Përkrahje për ndërmarrësit e rinj”
- “Gruaja më e suksesshme afariste për vitin 2015” – KIESA në bashkëpunim me Shoqatën Biznesore të Grave synon promovimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në ndërmarrësi
- “Konkursi Triple Helix” – Konkursi i lansuar nga OECD-ja dhe partnerët e saj në Kosovë për idenë më të mirë inovative që vjen nga academia, biznesi dhe sektori publik.
- “Ditët e Biznesit të Vogël” – një fushatë e cila synon ngritjen e vetëdijesimit për rolin e NVM-ve dhe zhvillimin e qëndrueshëm si dhe inkurajimin e dialogut publiko-privat.
- Programi i Kosovës për Promovimin e NVM (KOSME), i financuar nga SDC dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), zgjat prej tetorit të vitit 2012 deri në qershor të vitit 2016. Programi fokusohet në tri komponente: 1) përkrahja për krijimin e Lehtësirave për Garantimin e Kredive, 2) zbatimin e skemës këshilluese Voucher të NVM për këshillë të përbalueshme, dhe 3) ofrimi i trajnimit për KIESA. Agjencia Austriake për Zhvillim ka shprehur gatishmërinë e saj për bashkë-financimin e këtij projekti përtej qershorit të vitit 2016.
- Projekti Përkrahja për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme në Kosovë (Grantet MSME), i financuar nga BE-ja dhe MTI-ja, zgjat prej shkurtit të vitit 2012 deri në gusht të vitit 2016. 20-25 mikro-biznese do të fitojnë grante në shumë prej 10-20 mijë euro dhe 20-25 NVM do të fitojnë grante në shumën prej 60-200 mijë euro.
- Koncepti Dokumenti mbi themelimin e Fondit të Kosovës për Garantimin e Kredive si një institucion i pavarur është miratuar në qershor të vitit 2015. Fondi do të rrisë qasjen në financa për NVM-të duke mbuluar 50% të kolateralit që kërkohet për NVM-të për të marrë një kredi në bankë. Ky kolateral i garantuar do të reduktojë rrezikun për bankat, duke iu mundësuar bankave të ulin normat e tyre të interesit dhe t’i bëjnë produktet e tyre kreditore më të përbalueshme. USAID, KfW dhe SECO kontribuojnë me rreth 18 milionë euro dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kontribuon me 1 milionë euro për të krijuar fondin. Në vitin e ardhshëm do të miratohet dhe zbatohet ligji për krijimin e Fondit.
- Në kuadër të hartimit të Dokumentit Planifikues Sektorial mbi Konkurrueshmërinë e IPA II i cili dokument do të shërbejë si kornizë orientuese për nevojat për asistencë për periudhën afatmesme, është përfshirë edhe mbështetja për sektorët kyç të infrastrukturës së cilësisë, të

drejtat e pronësisë industriale, zbatimin e legjislacionit të tregtisë dhe komponentët për përkrahjen e NVM-ve. Hartimi i projekteve konkrete për IPA 2016 është ende në fazën fillestare.

3.22. Kapitulli 21 i *acquis*-së: Rrjetet trans-evropiane

Ky kapitull mbulon rrjetin trans evropianë që njihet ndryshe si shtylla kryesore e zhvillimit të brendshëm të tregjeve Evropiane. Qëllimi i këtij kapitulli është të krijoj rrjetin e domosdoshëm rrugorë, energjetik dhe të telekomunikimeve që lidh shtetet Evropiane me mundësi përfshirje edhe shtetet e treta. Mundëson krijimin e një infrastrukture moderne e cila lidh rrjetet regjionale dhe nacionale të cilat sigurojnë lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe fuqisë punëtore, që si rezultat të kenë efekt në krijimin dhe fuqizimin e një shoqërie të barabartë.

Kosova është anëtare e rregullt dhe pjesëmarrëse aktive e takimeve të niveleve Ministrore, komitetit drejtues dhe grupeve teknike të SEETO-së (Observatori i Transportit për Evropën Juglindore). Qëllimi i këtyre takimeve është krijimi i dokumenteve strategjike infrastrukturore dhe zhvillimi i rrjetit infrastrukturor bazik dhe gjithëpërfshirës në Evropën Juglindore, si pjesë përbërëse e Rrjetit Trans-Evropian.

Me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit në vitin 2004, të gjitha shtetet e Evropës Juglindore janë zotuar të zhvillojnë rrjetin bazik dhe gjithëpërfshirës i cili do të jetë edhe pjesë përbërëse e rrjetit bazik dhe gjithëpërfshirës trans-evropian.

Kosova tanimë e ka miratuar edhe Strategjinë e Transportit Multimodal, e cila përmban pesë qëllime kryesore të ndërlidhura me zhvillimin e rrjetit bazik dhe gjithëpërfshirës të SEETO-së. Qëllimi kyç i kësaj strategjie është: “Përmirësimi, zhvillimi, dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit e cila është e integruar në korridoret Pan Evropiane dhe është konform standardeve Evropiane”.

Rrjeti bazik dhe gjithëpërfshirës i SEETO-së përfshin edhe projektet infrastrukturore të Kosovës të cilat janë pjesë e rrjetit të Evropës Juglindore të përbëra nga projektet e infrastrukturës: rrugore, hekurudhore dhe ajrore.

Projektet prioritare të paraqitura dhe të identifikuara në planin shumëvjeçar të Evropës Juglindore si dhe në rrjetin Trans Evropian janë: Route/Rruga 6 e cila lidhë Prishtinën me Maqedoninë, Korridorin VIII, Route/Rruga 7 e cila lidhë Kosovën me Shqipërinë si dhe korridorin X në Serbi, R6a (Prishtinë - Mitrovicë) dhe R6b (Prishtinë - Pejë).

Sa i përket infrastrukturës hekurudhore, Kosova e ka të identifikuar projektin e Linjës Hekurudhore 10, e cila lidhë vendin tonë me Serbinë, Korridorin X dhe Maqedoninë Korridorin VIII.

Investimet në infrastrukturën rrugore - Republika e Kosovës tanimë ka përfunduar nëntë (9) segmentet prioritare të Route/Rrugës 7, të financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa segmenti i fundit i mbetur (Besi-Merdare) është në fazën e studimit të fizibilitetit, studim i mundësuar përmes instrumentit të WBIF (Western Balkan Investment Framework) dhe mbështetur nga BERZH. Investimet në segmentin e fundit (Besi - Merdare) pritet të përfundojnë në fund të vitit 2017 me ç’rast Kosova do të lidhet më Korridorin X.

Për më tepër, Ministria e Infrastrukturës (MI) ka filluar edhe me ndërtimin e projektit Rrugorë të Route/Rrugës 6 në drejtim të kufirit me Maqedoninë, me gjatësi prej 60 km, kostoja e se cilës është 600 milionë euro, ndërkaq periudha kohore për ndërtimin e kësaj rruge sipas planit dinamik është 42 muaj.

Po ashtu, MI është duke vazhduar me zgjerimin e aksit rrugor R6a/N2 (Prishtinë - Mitrovicë/Serbi). Për këtë projekt MI ka arritur të siguroj kredi në vlerë prej 60 milion dollarë nga Banka Islamike për Zhvillim,

Fondi Saudit për Zhvillim OFID-I, si dhe të gjitha procedurat për kredimarrje do të përfundojnë gjatë vitit 2015. Realizimi i këtij projekti parashihet të filloj në vitin 2016.

Ndërkaq sa i përket aksit rrugor R6b/N9 (Prishtine – Peje/Kufiri Mali i Zi) në bashkëpunim me WBIF dhe BERZH ka filluar studimi i fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor për segmentin Kijeve – Zahaq me gjatësi 32 km, si dhe plotësimi i projektit zbatues, si parakusht për fillimin e implementimit të projektit. Ky studim pritet të përfundoj gjatë vitit 2015, dhe më pas do të përgatitet edhe marrëveshja e kredisë për financimin e ndërtimit të këtij segmenti rrugor i cili do të vazhdoje deri në Pejë/Kufiri me Malin e Zi.

Në infrastrukturën hekurudhore, Kosova ka arritur progres në ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani, Infrakos e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore dhe Trainkos i cili merret me transport të udhëtarëve dhe mallrave. Republika e Kosovës ka krijuar edhe Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave i cili merret me rregullimin e tregut në territorin e Kosovës. Sipas raporteve të dala nga SEETO, Kosova ka arritur progres në zbatimin e ligjeve dhe standardeve të kërkuara duke siguruar që tregu hekurudhor të hapet për operatorët të jashtëm.

Një ndër projektet me prioritet, të identifikuar edhe në SEETO është linja Hekurudhore 10, e cila është edhe pjesë e rrjetit Trans Evropiane që lidhë Republikën e Kosovës me Serbinë dhe Maqedoninë, gjegjësisht me korridoret X dhe VIII.

Lidhur me linjën hekurudhore X, Kosova ka përfunduar studimin e fizibilitetit nga Fushë Kosova në drejtim të Hanit të Elezit, studim i mbështetur nga BERZH përmes WBIF, si dhe pritet të fillohet edhe me dizajnin detaj të kësaj linje hekurudhore

3.23. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Ky kapitull mbulon të gjitha aspektet e fondeve strukturore dhe atyre të kohezionit të cilat BE u akordon shteteve në kuadër të paketës së zgerimit me qëllim të harmonizimit të nivelit të zhvillimit të vendit përkatës në tërë territorin e tij dhe arritjes së konvergencës zhvillimore të të gjitha rajoneve. Kjo është e domosdoshme në mënyrë që shteti i ardhshëm anëtar të jetë në gjendje të funksionojë në tërë territorin e tij në përputhje me kriteret e përcaktuara me acquis dhe me standardet relevante. Më specifikisht, substanca e asaj që mbulon ky kapitull përfshin përpilimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe Fondit të Kohezionit, në përputhje me organizimin e territorial të vendit përkatës. Më tej, pasi që këto programe negociohen me Komisionin Evropian, por zbatimi i tyre është përgjegjësi e vendit përkatës, dhe kjo ndodh pas anëtarësimit, gjatë procesit të anëtarësimit kërkohet ndërmarrja e masave parapërgatitore në drejtim të kësaj. Acquis në këtë kapitull konsiston kryesisht në rregullore kornizë dhe rregullore për zbatim, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar, por vetëm zbatim të dispozitave ligjore të BE-së nëpërmjet legjislacionit të Kosovës, me qëllim që të sigurohet zbatimi i instrumenteve financiare të BE-së në përputhje me rregullat e vendosura nga BE.

Në përputhje me këtë, në periudhën para se të bëhet shtet kandidat, Kosova duhet të vendosë strukturat ligjore, institucionale e administrative në mënyrë që kur të vijë koha të mund të zbatojë me sukses dhe në mënyrë të duhur këto programe. Prandaj ky kapitull ofron një përmbledhje të përgjithshme të nevojave të Kosovës për sa u përket masave të tilla, dhe si dhe nevojave për t'u përgatitur për përfitim të mëtutjeshëm nga asistenca e BE-së që do të përfitojë gjatë procesit të anëtarësimit. Bazuar në këto nevoja, Kosova duhet të hartojë politikat konceptuale për fondet strukturore dhe për politikat rajonale dhe të planifikojë ngritjen e kapaciteteve të veta të qëndrueshme administrative për zbatimin e tyre.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, përkatësisht nenet 121, 122, 123, 124 dhe 125, i mundëson Kosovës qasje në asistencën e ofruar nga BE-ja si pjesë e procesit të integritit evropian të vendit. Asistenca e BE-së kushtëzohet me përmbushjen e kriterëve politike për procesin e integritit evropian dhe obligimeve nga procesi i stabilizim-asociimit dhe do të fokusohet në përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së,

zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e qeverisjes. Ajo do të jetë e bazuar në programe vjetore apo shumëvjeçare të pajtuara në mes Kosovës dhe BE-së, brenda një kornize indikative shumëvjeçare. Asistenca e BE-së mund të jepet edhe në formë të ndihmës makro-financiare, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare, në kuadër të realizimit të programeve në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Për të përmbushur obligimet e veta në kuadër të MSA-së, Kosova duhet të sigurohet që bashkëpunimi financiar do të vazhdojë të mbështesë reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale, në përputhje me procesin e stabilizim-asociimit. Kosova duhet të fuqizojë koordinimin e donatorëve dhe asistenca financiare e BE-së duhet të koordinohet ngushtë me burimet e tjera nga shtetet anëtare dhe vendet e tjera jashtë BE-së si dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Kosova obligohet që të ofrojë informata të rregullta për të gjitha burimet e asistencës.

Që nga viti 2007, Bashkimi Evropian (BE) ka ofruar ndihmë financiare për vendet kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA), në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 e datës 17 korrik 2006 që themeloi Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja Kornizë), në përputhje me nenin 17 të Rregullores Kornizë dhe me nenin 7 të Rregullores (KE) Nr 718/2007 mbi zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1085/2006. Çdo vend përfitues ka arritur një marrëveshje kornizë me Komisionin Evropian në mënyrë që të përcaktohen rregullat dhe parimet e bashkëpunimit të paraparë me Rregulloren Kornizë. Asistenca e dhënë nëpërmjet IPA-s është vazhduar për periudhën 2014-2020, me rregulloren 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që themelon një instrument të para-anëtarësimit (IPA 2), përkatësisht rregulloren për zbatimin e IPA 2. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisioni Evropian (KE) kanë nënshkruar Marrëveshjen Kornizë e cila ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015. Bazuar në Marrëveshjen Kornizë, për çdo program vjetor të IPA-s nënshkruhen marrëveshjet financiare.

Korniza legjislative

Siç u tha, *acquis* në këtë kapitull konsiston kryesisht në rregullore kornizë dhe rregullore për zbatim, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar, por vetëm zbatimin e tyre nëpërmjet legjislacionit vendor, me qëllim që të sigurohet zbatimi i instrumenteve financiare të BE-së në përputhje me rregullat e BE-së. Megjithatë, zbatimi i duhur i këtyre fondeve kërkon transpozim të *acquis*-së në fusha të ndërlidhura, sikurse ndihma shtetërore, mjedisi dhe prokurimi publik. Masat në këtë drejtim mbulohen nga kapitujt përkatës të këtij Programi.

Korniza institucionale dhe programimi

Ministria e Integrimit Evropian është përgjegjëse për planifikimin dhe koordinimin e asistencës së donatorëve në Kosovë. MIE, përkatësisht Departamenti i Asistencës Zhvillimore luan rolin e zyrës së NIPAC-ut (Koordinatorit Kombëtar për IPA), ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i MIE-së është i caktuar si NIPAC. MIE, sipas mandatit të saj, organizon takimet e Forumit të Nivelit të Lartë dhe të Grupeve Punuese Sektoriale, të cilat shërbejnë si struktura për koordinimin e donatorëve në nivel politik dhe teknik. Grupet Punuese Nën-sektoriale koordinohen në nivel teknik nga ministrinë e linjës.

Programimi i asistencës së BE-së nëpërmjet IPA-s bazohet në Dokumentin Indikativ Strategjik 2014-2020, ku përcaktohen sektorët dhe prioritetet afatgjate për periudhën 2014-2020. Programimi është sektorial, i bazuar në dokumentet planifikuese sektoriale, si dokumente të cilat përmbajnë informatat relevante për sektorët në të cilët ndodh programimi. Janë hartuar 5 dokumente për sektorët në vijim: i) sundimin e ligjit, ii) energjinë, iii) bujqësinë, iv) reformën e administratës publike; dhe v) konkurrueshmërinë. Asistenca e dhënë në kuadër të IPA-s për periudhën 2014-2020 përfshin një shumë prej mbi 600 milionë

eurosh. Në kuadër të sektorit të administratës publike, Kosova pritet të përfitojë nga përkrahja e drejtpërdrejtë buxhetore duke filluar nga viti programues 2016.

Për të koordinuar të gjitha investimet infrastrukturore në Republikën e Kosovës, të financuara nga burimet e brendshme dhe ato të jashtme, me vendim të Qeverisë më 8 korrik 2015 është themeluar Këshilli Kombëtar për Investime (NIC). NIC në fund të vitit 2015 do të miratojë listën prioritare të projekteve në nivel kombëtar, e cila do të përfshijë sektorët e mjedisit, energjisë, transportit dhe sektorin social. NIC bashkëkryesohet nga Ministri i Financave dhe Ministri i Integritimit Evropian, ndërsa Zyra e NIPAC-ut luan rolin e sekretariatit teknik, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Zyrën e Planifikimit Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Në kontekst të bashkëpunimit me shtetet e tjera, janë miratuar programet shumëvjeçare (IPA 2014-2020) për bashkëpunimit ndërkufitar me shtetet e rajonit, sikurse Kosovë-Shqipëri, Kosovë-Mal i Zi dhe Kosovë-Maqedoni. Për më tepër, janë në proces të nënshkrimit marrëveshjet financiare vjetore (për 2014 dhe për 2015) për programin e bashkëpunimit ndërkufitar në mes Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe në mes Kosovës me Maqedoninë. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të procesit të ndryshimeve ku Mali i Zi pritet të kalojë në sistem të decentralizuar të menaxhimit, është inicuar nënshkrimi i marrëveshjes bilaterale në mes Kosovës dhe Malit të Zi për programin e bashkëpunimit ndërkufitar, e cilat pritet të nënshkruhet gjatë vitit 2015.

Strukturat operative - përgjegjëse për zbatimin e programit për bashkëpunim ndërkufitar IPA II përbëhen nga Sekretariati Teknik i Përbashkët (JTS) dhe Komitetet e Përbashkëta Monitoruese (JMC) për secilin shtet bashkëpunues në këtë program. Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së e luan rolin e koordinatorit strategjik të komponentit të bashkëpunimit ndërkufitar, deleguar nga NIPAC-u.

Monitorimi

Për të siguruar monitorimin e realizimit të programeve dhe projekteve të financuara nëpërmjet burimeve të IPA-s është Komiteti i Përbashkët Monitorues i IPA-s, i cili takohet mbi baza vjetore. Monitorimi i përgjithshëm i asistencës së donatorëve dhe në veçanti i asistencës së BE-së bëhet në dy mënyra: shfrytëzimi i raportimit të rregullt të donatorëve në kuadër të Platformës për Menaxhimin e Ndhimës (PMN) dhe pjesëmarrja e zytarëve në kuadër të takimeve të Komiteteve Drejtuese të projekteve.

Masat afatshkurta

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 22, do të zbatohen këto *masa* afatshkurtra:

- Hartimi i listës prioritare të projekteve në nivel kombëtar (afati: K4 2016)
- Negocimi i i programit dhe nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes financiare për IPA 2015 (K1 2016);
- Në nivel të hartimit të politikave kombëtare, në mungesë të dokumenteve strategjike qeveritare, do të hartohet dhe miratohet një dokument konceptual për zhvillim rajonal i cili do të përcaktojë definicionin e nocionit 'zhvillim rajonal' si dhe definicionin për themelimin e strukturave institucionale për zhvillim rajonal në territorin e Kosovës, sikurse dhe kapacitetet e nevojshme për absorbim efikas të fondeve dhe programeve të ndryshme të BE-së (afati: K3 2016);
- Fillimi i përgatitjeve për përcaktimin e klasifikimit të rajoneve sipas sistemit NUTS (afati: K2 2016).

Prioritetet afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 22, gjatë periudhës 2017-2020 parashihen këto prioritete afatmesme:

- Hartimi i dokumentit planifikues sektorial për menaxhimin e financave publike me qëllim të sigurimit të përkrahjes buxhetore sektoriale (K1 2017)
- Negocimi i i programit dhe nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes financiare për IPA 2016 (K1 2017)
- Negocimi i i programit dhe nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes financiare për IPA 2017 (K1 2018)
- Negocimi i i programit dhe nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes financiare për IPA 2018 (K1 2019)
- Negocimi i i programit dhe nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes financiare për IPA 2019 (K1 2020)
- Rishikimi i dokumenteve planifikuese sektoriale për sektorët e prërkrahur nga IPA, i bazuar në vlerësimin afatmesëm të IPA-s nga Komisioni Evropian (K1 2018)

3.24. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Kapitulli 23 i acquis mbulon keto fusha: sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Politikat e Bashkimit Evropian në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas është i një rëndësie të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe një standard i lartë i gjykimeve nga gjykatat është i një rëndësie thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të fortë për të eliminuar ndikimet e jashtme mbi gjyqësorin dhe për të kushtuar burime të mjaftueshme financiare si dhe trajnime në fushën e gjyqësorit. Gjithashtu, garancitë ligjore për procedurat e gjykimit të drejtë duhet të jetë në vend. Njëkohësisht, nga Shtetet Anëtare kërkohet luftimi i korrupsionit në mënyrë efektive, pasi që kjo përbën një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Një kornizë solide ligjore dhe institucionale e besueshme janë të nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin dhe pengimin e korrupsionit. Për më tepër, shtetet anëtare duhet të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore dhe të drejtave të qytetarëve të BE-së, siç garantohet me legjislacionin e BE-së dhe me Kartën e të Drejtave Themelore.

Kërkesat e MSA-së

Kërkesat e MSA-së në fushën e sistemit gjyqësor

Në kuadër të fushëveprimit të sistemit gjyqësor, në përputhje me detyrimet dhe kërkesat e aderimit në Bashkimin Evropian që dalin nga MSA (Art. 83) kërkohet të intensifikohet bashkëpunimi me BE-në në fushën e gjyqësorit, me fokus në forcimin e institucioneve, me qëllim të konsolidimit të shtetit të së drejtës përmes forcimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor. Bashkëpunimi do të fokusohet në veçanti në administrimin e drejtësisë, zhvillimin e strukturave adekuate të gjykatave e prokurorive, dhe të organeve të tjera gjyqësore, me qëllim të përgatitjes së tyre të duhur për bashkëpunim në çështjet civile, komerciale e penale, si dhe për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Kërkesat e MSA-së në fushën e politikave kundër korrupsionit

Sipas obligimeve të dala nga MSA, neni 83 (Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës) dhe 91 (Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme), kërohet zhvillimi i strukturave adekuate të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe organeve të tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit në mënyrë që të mundësohet parandalimi, hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i veprave korruptive në mënyrë efektive (Neni 83). Gjithashtu, sipas Nenit 91, kërkohet që palët të bashkëpunojnë me qëllim të forcimit të strukturave të Kosovës për luftimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale në veçanti të korrupsionit dhe formave të tjera të krimeve të rënda me një dimension ndërkuftar / kufirit

administrativ. Në këtë drejtim kërkohet që Kosova të respektoj konventat përkatëse ndërkombëtare dhe instrumentave në këtë fushë. Në nivelin e parandalimit, Kosovës i kërkohet të synojë zbatimin e masave të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në legjislacionin përkatës të BE-së, dhe të përmbahen nga konventat përkatëse ndërkombëtare dhe instrumentave që lidhen me këtë fushë.

Kërkesat e MSA-së në fushën e të drejtave themelore, mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave themelore dhe mbrojtjes së minoriteteve, në përputhje me kërkesat që dalin nga MSA, duhet të sigurohet respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 dhe siç janë përkufizuar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të vitit 1950, në aktin final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të re (Neni 3). Gjithashtu institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë respektimin e të drejtës dhe instrumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë ato që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore, e deri tek mbrojtja e personave që u përkasin minoriteteve, pa diskriminim mbi çfarëdo baze (Neni 4).

Kërkesat e MSA-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Bazuar në obligimet që dalin nga neni 84 i MSA, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të sigurohen që legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave personale, me synim të arritjes së nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale nga Kosova të korrespondon me atë të acquis-it të BE-së. Mbrojtja e të dhënave personale, duhet të zhvillohet në atë mënyrë që t'i përshtatet kërkesave të legjislacionit të BE-së nga kjo fushë.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE

Kërkesat e tjera të aderimit në BE në fushën e sistemit gjyqësor

Sipas Studimit të Fizibilitetit për MSA, Kosova duhet të përmbush Kriteret Afatmesme në fushën e gjyqësorit. Së pari kërkohet që të përmirësohet pavarësia, efektiviteti, llogaridhënia dhe paanshmëria e gjyqësorit, duke siguruar alokimin e mjeteve të mjaftueshme buxhetore dhe burimeve njerëzore, për të realizuar reformën gjyqësore. Së dyti kërkohet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme masat e sigurisë për gjyqtarë, prokurorë, stafin mbështetës dhe dëshmitarëve. Së treti kërkohet të ngrihen kapacitetet për gjyqtarë, prokurorë dhe stafin mbështetës. Së katërti kërkohet të përfundohet procesi i përzgjedhjes për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe të plotësohet numri i pozitave vakante për minoritetet, të parapara me ligj.

Sipas të gjeturave të Raportit të KE-së për Kosovën 2015, janë identifikuar këto mangesi sa i përket funksionimit të gjyqësorit: Sistemi gjyqësor i Kosovës është në një fazë të hershme të zhvillimit të një sistemi funksional të drejtësisë, administrimi i drejtësisë është i ngadalshëm, llogaridhënia e zyrtarëve gjyqësor është e pamjaftueshme, emërimet e diskutueshme dhe mandatet e paqarta kanë dëmtuar aktivitetet e institucioneve kyçe si Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prokuroritë e Kosovës, dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Institucionet e sundimit të ligjit vuajnë nga mungesa e qëndrueshëm e financimit.

Në takimin e peste plenar të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit, në fushën e gjyqësorit kërkohet që Kuvendi të sigurojë që të gjithë anëtarët (e mbetur) të KGJK-së të zgjedhen sa më shpejt të jetë e mundur; KGJK dhe KPK të përfundojnë proceset në vijim e sipër për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; KGJK dhe KPK të sigurojnë që vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të bëhet rregullisht dhe në mënyrë sistematike duke u bazuar në kriteret e transparencës dhe objektivitetit dhe në përputhje me standardet evropexhepkastriat`Ipiane dhe standardet e tjera përkatëse; të sigurohet që trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të jetë i një standardi të lartë; dhe Ministria e Drejtësisë të sigurojë konsultime të duhura publike gjatë tërë procesit të hartimit të Ligjit mbi Akademinë e Drejtësisë.

Në takimin e gjashtë për Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit për drejtësi, liri dhe siguri, në fushën e sistemit gjyqësor kërkohet të rifillohen në mënyrë aktive takimet e rregullta të Bordit të Përbashkët

Koordinues për Sundimin e Ligjit për të siguruar një proces të përmirësuar dhe efikas; të vazhdohet me përpjekjet për finalizimin e procesit të rekrutimit për të gjitha vendet e lira të punës për gjyqtarë të ri; të sigurohet që, në ndryshimet e ardhshme legjislative, trajnimi fillestar i arsimit ligjor është përfshirë si një kërkesë e detyrueshme; të sigurohet miratimi i Planit Zhvillimor të Këshillit Prokurorial të Kosovës; të ofrohen statistika të qarta mbi rastet e hetuara dhe të ndjekura penalisht nga Prokuroria Speciale; të ofrohen informacione mbi ndjekjen penale dhe gjykimin e MASHtrimit elektoral për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014; (ky është një veprim i përbashkët i KPK-së/KGJK-së); Të vazhdohet me përpjekjet për të adresuar kontrabandën dhe korrupsionin në institucionet korrektuese dhe të vazhdohet me përpjekjet për të hetuar të gjitha rastet e korrupsionit në shërbimet korrektuese; Të vazhdohet me përpjekjet për të përmirësuar programuesit për ri-integrimin e ardhshëm në shoqëri dhe rehabilitimin profesional; Të vazhdohet me rekrutimin dhe ngritjen e kapaciteteve të SHKK-së në nivel të mjaftueshëm.

Kërkesë tjetër nga takimi i gjashtë i DPSA-së DLS, në kuadër të Reformës/rishikimit gjyqësor dhe planeve legjislative është që Ministria e Drejtësisë të sigurojë që, në përputhje me rregulloret, të hartohen koncept dokumentet për të gjithë legjislacionin dhe ndryshimet legjislative, duke përfshirë edhe për Ligjin për Akademinë e Drejtësisë; Këshilli Prokurorial i Kosovës të ofrojë raportin mbi zbatimin e Ligjit për Amnistinë, duke specifikuar kategoritë, strukturën dhe etnitetin e personave që kanë përfituar nga ligji; dhe Ministria e Drejtësisë të ofrojë një raport me shkrim lidhur me ndryshimet në amendamentimin e Ligjit për Noterinë dhe të sigurojë miratimin e tij.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE në fushën e politikave kundër korrupsionit

Sipas obligimeve të dala nga Kriteret Afatmesme të SF-së, Kosova duhet të përmbush këto kritere: Të ngrihet bashkëpunimi i institucioneve gjyqësore dhe atyre zbatuese të ligjit si dhe të përmirësohet saktësia dhe harmonizimi i statistikave në luftën kundër korrupsionit; Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesit; Të luftohet korrupsioni, nepotizmi dhe diskriminimi në sistemin e burgjeve; Të përmirësohet perceptimi publik me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në prokurim publik; Të krijohen politika adekuate rreth përmirësimit të transparencës së financimit të subjekteve politike; dhe Të përkushtohet fuqimisht në përforcimin e strukturave në Kosovë në luftimin, parandalimin, hetimin, ndjekjen penale, dhe gjykimin në mënyrë efektive të korrupsionit.

Sipas të gjeturave të Raportit të KE-së për Kosovën 2015, janë identifikuar këto mangesi sa i përket luftimit të korrupsionit: Kosova është në një fazë të hershme të luftimit të korrupsionit, progresi ka qenë i kufizuar, vullneti i fortë dhe angazhimi politik është i nevojshëm për të trajtuar këtë fenomen siç duhet. Gjithashtu kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike për të siguruar rezultatet reale në luftën kundër korrupsionit në Kosovë, ekspertiza e Kosovës është e kufizuar në trajtimin kompleks financiar, hetimet dhe për konfiskimin e pasurive kriminale në mënyrë efektive.

Sipas obligimeve të dala nga DPSA-DLS dhe DPSA plenare, Republika e Kosovës përkushtohet fuqimisht në përforcimin e strukturave në Kosovë në luftimin, parandalimin, hetimin, ndjekjen penale, dhe gjykimin në mënyrë efektive të korrupsionit. Në këtë drejtim, Kuvendi duhet të miratojë ndryshimet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke siguruar harmonizim me Kodin Penal; Të përmirësohet raportimi nga pikat fokale (në të gjitha institucionet e ndryshme që janë përgjegjëse për zbatimin e veprimeve të planit të veprimit) tek Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit; Këshilli Prokurorial i Kosovës të rrisë numrin e prokurorëve në Prokuroritë Themelore, sidomos në zyrën në Prishtinë; Këshilli Prokurorial i Kosovës të ofrojë të dhëna për asetet e sekuestruara/konfiskuara të ndërlidhura me korrupsionin; Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të propozojë ndryshime për Ligjin e Prokurimit Publik dhe të sigurojë funksionimin e duhur të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE në fushën e të drejtave themelore

Në pajtim me kërkesat e që dalin nga Kriteret Afatmesme të SF-së, duhet të sigurohet thjeshtësimi dhe strukturimi i numrit të madh të organeve që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke siguar monitorim efektiv dhe zbatim të kornizës ligjore në këtë fushë. Institucionet e Kosovës duhet të përkushtohen më tutje në zbatimin e të drejtave pronësore përmes zvogëlimit të rasteve të pakryera dhe përmirësimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative.

Bazuar në të gjeturat e RP 2015, nevojitet përditësimi i Strategjisë për të drejtat e njeriut. Duhet të sigurohet krijimi i një mekanizmi përcjellës gjyqësor për rastet e diskriminimit, përfshirë ato kundër komunitetit LGBTI. Gjithashtu, nevojitet hetimi dhe përndjekja e sulmeve kundër gazetarëve. Për më tepër, duhet sigurohet trajtimi adekuat i të burgosurve në izolim dhe strehimi i të burgosurve në pritje të gjyqimit dhe atyre të dënuar për kundërvajtje. Duhet të sigurohet mbledhja e rregullt e të dhënave të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe qasja e grave në të drejtën trashëgimore.

Sipas obligimeve të dala nga DPSA, duhet të përditësohet korniza strategjike që mbulon fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve. Të vazhdohet me luftimin e dhunës në familje dhe të krijohet një sistem uniform i bazës së të dhënave të mbledhjes së rregullt të të dhënave mbi rastet e dhunës në baza gjinore në të gjitha institucionet. Institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë zbatimin e duhur i legjislacionit për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme. Gjithashtu duhet të përmirësohet koordinimi mbi përmirësimin e zbatimit të të drejtave pronësore.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE në fushën e të mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Bazuar në obligimet që dalin nga Kriteret Afatmesme të SF institucionet e Republikës së Kosovës duhet të promovojnë një Kosovë multietnike dhe të sigurohet krijimi i kushteve për serbet e Kosovës që të ndjehen si pjesë e së ardhmes së Kosovës dhe krijimin e kushteve për kthim për personat që dëshirojnë të kthehen. Gjithashtu kërkohet zbatimi i legjislacionit që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe Kishës Ortodokse Serbe. Institucionet për sundimi të ligjit duhet të hetojnë dhe përndjekin secilin sulm me motive etnike apo fetare dhe të sjellin dorasit para drejtësisë. Angazhim i mëtutjeshëm duhet të tregohet për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët, duke përfshirë ndarjen e buxhetit të mjaftueshëm.

Sipas të gjeturave të RP 2015, duhet të përditësohet korniza strategjike për të drejtat e personave të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian. Për më tepër, nevojitet të ndërmerren masa aktive për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Institucionet e Kosovës duhet të dëshmojnë angazhim për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë rezultate konkrete në luftën kundër ndërtimeve të paligjshme dhe rrënimin e tyre.

Kurse, sipas obligimeve të dala nga DPSA duhet të vazhdohet zbatimi i Planit të Veprimit për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, përfshirë edhe alokimin e buxhetit të mjaftueshëm. Nevojitet angazhim i mëtutjeshëm i komunave në lidhje me ndarjen e tokës për komunitetet minoritare, si dhe përmirësimi i koordinimit në mes të nivelit qendror dhe lokal. Nga Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve duhet të vazhdohet me avancimin e punës për njohjen e diplomave.

Kërkesat e tjera të aderimit në BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Në pajtim me kërkesat që dalin nga Kriteret Afatmesme të SF, duhet të sigurohet harmonizimi i legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve të BE-së dhe përqendrimi në zbatimin sidomos në përgatitjen e legjislacionit sekondar në ndërtimin e kapaciteteve administrative.

Bazuar në RP 2015, nevojitet avancimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve të ASHMDhP-së, duke përfshirë kualifikimin e stafit dhe alokime të nevojshme financiare.

Përveç harmonizimit të legjislacionit me Acquis të BE-se në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duhet të intensifikohet bashkëpunimi me të gjitha institucionet me qëllim të implementimit të legjislacionit gjatë trajtimit të të dhënave personale dhe vendosja e mekanizmeve sanksionuese në rast të mos-përputhjes. Gjithashtu me qëllim të arritjes së objektivave të përshkruara në strategjinë kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të sigurohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

Korniza legjislative

Korniza legjislative në fushën e sistemit gjyqësor

Në fushën e Gjyqësorit, Republika e Kosovës ka konsoliduar kornizën ligjore me qëllim të sundimit të ligjit, forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet (në fushën e administratës në përgjithësi dhe administrimit të zbatimit të ligjit/drejtësisë në vecanti), fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies së gjyqësorit dhe përmirësimin e efikasitetit, zhvillimin e strukturave të përshtatshme për policinë, prokurorët, gjyqtarët dhe organet e tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit, reduktimin e lëndëve të vjetra, implementimin e reformës gjyqësore, sigurimin e masave për gjyqtarë, prokurorë, stafin gjyqësor, dëshmitarë etj, dhe sigurimin e premisave të përshtatshme ku mbahen gjykimet dhe në përputhje me procedurat e gjykatave.

Funksionimi i sistemit gjyqësor rregullohet nga funksionimi i katër ligjeve kornizë të gjyqësorit: Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Këshillin Prokurorial, Ligji për Këshillin Gjyqësor. Përveç këtyre, në vijim janë aktet tjera kryesore ligjore të cilat rregullojnë sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Provimin e Jurisprudencës, Ligji për Noterinë, Ligji për Ndihmë Juridike Falas, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Ligji për Avokatinë, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji për Ndërmjetësim, Ligji për Procedurën Përmbartimore, Ligji për Institutin Gjyqësor të Kosovës etj, si dhe aktet tjera nënligjore të kësaj fushe.

Në mënyrë që të sigurohet një sistem i pavarur gjyqësor dhe prokurorial është miratuar korniza ligjore e katër ligjeve duke siguruar harmonizimin e dispozitave ligjore që rregullojnë të njëjtat çështje në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial, rritjen e transparencës së punës së sistemit gjyqësor në raport me publikun, si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive. Si kërkesë e MSA-së neni 83, Raportit të Progresit, Liberalizimit të Vizave dhe DPSA-së është identifikuar nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të pakos së gjyqësorit. Si rrjedhojë plotësim/ndryshimet e këtyre ligjeve në vija të përgjithshme kanë pasur për qëllim:

- Harmonizimin e ligjeve për sa i përket kritereve për emërim dhe shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve; dhe
- Rritjen e pavarësisë dhe llogaridhënies, përmes institucionalizimit të mekanizmeve të sigurimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së punës së gjykatave dhe prokurorive.

Pavarësia e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial është forcuar duke ju siguruar pavarësi buxhetore, ku Këshillat përpos që do të menaxhojnë buxhetin e tyre ata gjithashtu do ta përgatisin propozimin e buxhetit vjetor dhe ta dërgojnë për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, është paraparë themelimi i Komisioneve për Vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, vlerësimi i të cilit mund të shërbejë si bazë për ngritjen, uljen ose shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ligji për Gjykatat rregullon organizimin, funksionimin dhe juridikcionin e gjykatave në Republikën e Kosovës. Ky ligj ka përcaktuar kushtet për emërimin e kandidatëve për gjyqtarë (kushtet e përgjithshme dhe të veçanta) të cilat janë bërë në pajtim me praktikën më të mirë të shteteve të BE-së. Në këtë kontekst është bërë edhe harmonizimi i kritereve për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Një ndër çështjet më

të rëndësishme të këtij ligji është rritja e transparencës së gjykatave duke obliguar nëpublikimin e vendimeve të formës së prerë.

Ligji për Prokurorin e Shtetit themelon dhe rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit. Me qëllim të harmonizimit me Ligjin për Gjykata janë plotësuar dispozitat për organizimin dhe definimin e qartë të shkallëve të prokurorisë dhe përcaktimin e ushtrimit të funksioneve në kuadër të këtyre niveleve të prokurorit të shtetit. Një ndër ndryshimet kryesore në kuadër të ligjit për Prokurorin e Shtetit, ndërlidhet me emërimin e prokurorëve të rinj. Gjithashtu, thjeshtëzimi i procedurave për seleksionimin e prokurorëve dheroli i theksuar i Këshillit janë bërë në përputhje me standardet evropiane duke pasur parasysh nevojat dhe pengesat në terren si dhe përmbushjes së qëllimit në rritjen e numrit të kuadrove të rinj që bëhen pjesë e sistemit gjyqësor.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës rregullon organizimin dhe funksionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke përfshirë procedurat për rekrutim, emërim, riemërim, transferime, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; për menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit; dhe themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.

Ligji për Këshillin Prokurorial rregullon Këshillin Prokurorial të Kosovës, një institucion tërësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta. Këshilli siguron se të gjithë personat që kanë qasje të barabartë në drejtësi dhe prokurorët ta ushtrojnë funksionin në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme. Këshilli siguron se Prokurori i Shtetit pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Këshilli është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për zyrën prokuroriale si dhe vlerëson, ngrit në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve. Së bashku me Kryeprokurorin e Shtetit, Këshilli është përgjegjës për dërgimin dhe menaxhimin e buxhetit të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Ligji për Provimin e Jurisprudencës rregullohen kushtet, kriteret, procedura dhe programi për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Ligji për Noterinë rregullohen organizimi dhe funksionimi i noterisë si veprimtari publike në Kosovë, kushtet dhe metodat e punës si dhe çështje tjera me rëndësi për ushtrimin e detyrës së noterit.

Ligji për Ndihmë Juridike Falas ka për qëllim të krijoj një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Ligji për Avokatinë rregullon kushtet për ushtrimin e avokatisë, mënyrat dhe format e punës, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e avokatëve dhe praktikantëve, organizimi dhe puna e Odës së Avokatëve të Kosovës, si dhe çështje tjera të rëndësishme për ushtrimin e avokatisë.

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale Qëllimi i këtij ligji është ekzekutimi i sanksioneve penale, sanksioneve kundërvajtëse dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, dhe aplikimi i masës së paraburgimit

Ligji për Ndërmjetësim rregullon procedurën e ndërmjetësimit në përgjithësi, themelimin, organizimin, funksionimin e Komisionit të Ndërmjetësimit, si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve. Caktohen rregullat e procedurës së ndërmjetësimit në marrëdhëniet kontestuese në raportet juridiko-pasurore të subjekteve të së drejtës, tregtare, familjare, të punës, raporte të tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo e një organi tjetër kompetent.

Ligji për Procedurën Përmbartimore rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbartimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbartimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në përmbartimin në anije dhe në mjet fluturues përveç nëse kjo çështje rregullohet me ligj të veçantë. Ky ligj rregullon edhe kryerjen e veprimtarisë së përmbartuesve privat.

Ligji për Institutin Gjyqësor të Kosovës themelon Institutin Gjyqësor të Kosovës si organ i pavarur profesional i cili gëzon statusin e personit juridik. IGJK mund të lidhë marrëveshje pune, bashkëpunimi dhe veprimtarie shkencore, profesionale me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare. IGJK-ja si institucion kryesor për aftësim brenda sistemit gjyqësor të Kosovës duhet të kryefunksionet e veta bazuar në parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë dhe efikasitetit. IGJK-ja është organ i pavarur i cili vepron në bashkëpunim me KGJPK-në ose Institucionet të cilat trashëgojnë përgjegjësitë e tij për koordinimin e nevojave për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës, për aftësimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor të Kosovës.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohet pa dhunën penale juridike. Parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penal juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore. Me këtë Kod, janë transpozuar pjesërisht këto akte të *acquis* së BE-së:

- Vendimi Kornizë për luftimin e krimit të organizuar (Vendimi Kornizë 2008/841/JHA);
- Vendimi Kornizë për vendosjen e sanksioneve penale kundër falsifikimit të EURO-së (Vendimi Kornizë 2000/383/JHA, i ndryshuar me Vendimin Kornizë 2001/888/JHA) dhe Vendimi i Këshillit për mbrojtjen e BE-së kundër falsifikimit (Vendimi 2001/887/JHA);
- Vendimi Kornizë për luftimin e MASHTrimit dhe falsifikimit të mjeteve që nuk përfshijnë pagesa me para të gatshme (Vendimi Kornizë 2001/413/JHA);
- Direktiva 2011/36 e BE-së për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore;
- Direktiva 2011/92 E BE-se për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2004/757/JHA për dispozitat minimale për elementet përbërëse të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikut të drogës të paligjshëm.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës - Me këtë Kod përcaktohen rregullat e procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod. Me këtë Kod caktohen rregullat që garantojnë se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa dënimi ose sanksioni tjetër penal mund t'i shqiptohet vetëm personit i cili ka kryer veprë penale sipas kushteve të parapara me Kodin Penal dhe me ligjet tjera të Kosovës në bazë të të cilave janë paraparë veprat penale sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme para gjykatës kompetente. Para marrjes së aktgjykimit të formës së prerë, liritë dhe të drejtat tjera të të pandehurit mund të kufizohen vetëm sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kod. Ky Kod është përafuar me legjislacionin Evropian lidhur me çështjet e procedurës penale. Për të reflektuar *acquis* të BE-së, ky Kod u përafua me:

- Direktivën 2010/64/BE për të Drejtën në Interpretim dhe Përkthim në Procedurën Penale;
- Direktivën 2012/13/BE për të Drejtën në Informim në Procedurën Penale;

- Direktivën 2013/48/BE, për të Drejtën e Qasjes në Mbrojtës/Avokat në procedurën penale dhe në procedurë Urdhër Arrestit Evropian, dhe me të Drejtën e Informimit të një personi të tretë për kufizimin e lirisë dhe të komunikojë me personat e tretë dhe me autoritetet konsulare lidhur me kufizimin e lirisë;

Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik - Me këtë ligj rregullohet përgjegjësia e personave juridik për vepra penale, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personave juridik dhe dispozitat e posaçme që e rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik.

Korniza legjislativë në fushën e politikave kundër korrupsionit

Fusha e politikave kundër-korrupsion në Republikën e Kosovës rregullohet me këto ligje:

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të gjithë Zyrtarëve të Lartë Publikë që është i harmonizuar me Kodin Penal ashtu që tani mos deklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rrejshëm klasifikohet si vepër penale.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik dispozitat e të cilit përcaktojnë rregulla të detyrueshme për zyrtarët e lartë publik që gjatë ushtrimit të funksionit të parandalojnë konfliktin e interesit të tyre në mes të interesave publike dhe private, si dhe përcakton kufizimet bazë për zyrtarët e lartë publik për ushtimin e funksionit publik dhe funksioneve tjera që nuk janë të natyrës publike. Në plotësim-ndryshimin e këtij ligji është bërë harmonizimi me Kodin Penal.

Ligj për Agjencinë Kundër Korrupsionit përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë kundër Korrupsionit në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. Ky Ligj është i përafuar me Konkluzionet e Këshilli të datës 8 maj 2003(2003/C 137/01) dhe dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Rezoluta 58/4 e 31 tetorit 2003.

Ndalimi i veprave penale korruptive gjithashtu rregullohet me legjislacionin penal përkatësisht *Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, kapitullin XXXIV Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale kundër Detyrës Zyrtare*, ku penalizohen veprat si: keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar, keqpërdorimi i informatës zyrtare, konflikti i interesit, përvetësimi në detyrë, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit etj.

Ligj për Mbrojtjen e Informatorëve, ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për nxitjen e zyrtarëve për paraqitjen e veprimeve kundërligjore, ku si përkufizim i informatorit ka kuptimin: çdo person, i cili si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa dhunën penalo juridike. Parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penalo juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore.

Me këtë Kod, janë transpozuar pjesërisht këto akte të acquis së BE-së:

- Vendimi Kornizë për luftimin e krimit të organizuar (Vendimi Kornizë 2008/841/JHA);
- Vendimin Kornizë mbi korrupsionin në sektorin privat (Vendimi Kornizë 2003/568/JHA);

- Konventa sipas Nenit K.3 (2) (c) të Traktatit për Bashkimin Evropian për luftimin e korrupsionit që përfshinë zyrtarët e institucioneve të Bashkimit Evropian ose zyrtarët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, është miratuar duke pasur parasysh standardet e njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat në mënyrë të veçantë i garantojnë secilit parimin e barazisë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Ky Kod përkufizon standardet e etikës dhe sjelljes profesionale që duhet të respektohen nga gjyqtarët dhe shkelja e të cilave përbën bazë për sanksione.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, gjithashtu parasheh standardet e kërkuara si më lartë dhe mbështetet në parimet e përgjithshme për respektimin e standardeve të larta të sjelljes profesionale dhe personale, kryerjen e detyrave të prokurorit konform standardeve të njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut si dhe shmangjen e çdo sjellje apo situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetin apo paanshmërinë e prokurorit etj.

Nga përmbajtja e këtyre ligjeve mund të konkludohet se pjesa më e madhe e punës së Agjencisë shtrihet në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe si aktivitete të cilat kanë për qëllim parandalimin e korrupsionit konsiderohen:

- Deklarimi i pasurisë nga zyrtarët e lartë publik dhe deklarimi i dhuratave nga të gjithë personat zyrtarë;
- Parandalimi i konfliktit të interesit në sektorin publik;
- Parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik;
- Edukimi i publikut.
- Zbatimi i Strategjisë kundër Korrupsionit.

Ligji mbi Financimin e Subjekteve Politike, rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

Ligji për Prokurimin Publik, siguron mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do tëzbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet etj. Gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit.

Ligji për Shërbimin Civil, rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale, si dhe përcakton rregullat për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, rregullat për pranimin në të, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimin në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë.

Korniza legjislativë në fushën e të drejtave themelore

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Republikën e Kosovës janë të mbrojtura dhe rregullohen sipas parimeve të parapara me Kushtetutë. Konventat **dhe instrumentet ndërkombëtare kryesore që garantojnë këto të drejta** zbatohen drejtpërdrejtë dhe kanë epërsi në rast konflikti me legjislacionin vendor. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe protokollet e saj, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventa Kornizë e Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Pakicave

Kombëtare, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAË), Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, garantohen me Kushtetutë dhe janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.

Me qëllim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me miratimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Ligjit për Barazi Gjinore është kompletuar korniza ligjore që mbron këto të drejta. Kjo pako e ligjeve ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, ngritjen e shkallës së barazisë efektive dhe realizimin e parimit të trajtimit të barabartë para ligjit të personave në Kosovë, garantimin, mbrojtjen dhe promovimin e barazinë gjinore midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, organeve të administratës publike, organeve tjera shtetërore, si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, të cilat janë të garantuara me legjislacionin vendor në fuqi si dhe me aktet ndërkombëtare.

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në çfarëdo baze, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Ky Ligj është në përputhshmëri të plotë me Direktivën 2000/43/KE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktivën 2000/78/KE që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktivën 2004/113/KE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, kurse pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe të profesionit.

Ligji për Avokatin e Popullit, ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.

Ligji për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ligji është në përputhshmëri me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAË); plotësisht në përputhje me Direktivën 2000/78/KE për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion dhe Direktivën 2004/113/KE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis meshkujve dhe femrave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime; ndërsa janë pjesërisht në përputhje me Direktivën 2006/54/KE për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtim të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështjet e punësimit dhe profesionit; Direktivën 79/7/KEE në zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështjet e sigurimit shoqëror, Direktivën 2010/41 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis meshkujve dhe femrave të angazhuar në një aktivitet në një kapacitet të vetë-punësuar.

Ligji për Familjen, rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktime të dhunës në familje,

duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara; si dhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

Kodi Penal i Kosovës, parashikon veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa dhunën penalo juridike. Me këtë Kod, janë transpozuar pjesërisht këto akte të *acquis* së BE-së:

- Direktiva 2011/36 e BE-së për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore;
- Direktiva 2011/92 E BE-se për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual te fëmijëve.

Kodi i Procedurës Penale, përcakton rregullat e procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale. Me këtë Kod caktohen rregullat që garantojnë se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa dënimi ose sanksioni tjetër penal mund t'i shqiptohet vetëm personit i cili ka kryer veprë penale sipas kushteve të parapara me Kodin Penal dhe me ligjet tjera të Kosovës në bazë të të cilave janë paraparë veprat penale sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme para gjykatës kompetente. Për të reflektuar *acquis*të BE-së, ky Kod u përafraua me:

- Direktivën 2010/64/BE për të Drejtën në Interpretim dhe Përkthim në Procedurën Penale;
- Direktivën 2012/29/BE për të Drejtën në Informim në Procedurën Penale;
- Direktivën 2013/48/BE, për të Drejtën e Qasjes në Mbrojtës/Avokat në procedurën penale dhe në procedurën e Urdhër Arrestit Evropian, dhe me të Drejtën e Informimit të një personi të tretë për kufizimin e lirisë dhe të komunikojë me personat e tretë dhe me autoritetet konsulare lidhur me kufizimin e lirisë;
- Vendimin kornizë të Këshillit 2005/212/JHA dhe Vendimin kornizë të Këshillit 2000/383/JHA.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur, rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur. Kodi i Drejtësisë për të mitur është hartuar në harmoni me Konventën për të drejtat e fëmijës. Kodi i Drejtësisë për të mitur është përafrauar me:

- Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur ("Rregullat e Pekinit"), miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40 / 33 e 29 nëntorit 1985;
- Konventën mbi të Drejtën e Fëmijës, miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 44/25 e 20 nëntorit 1989;
- Opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian për parandalimin e delikucencës së të miturve; Mënyrat e që kanë të bëjnë me delikucencën e të miturve dhe rolin e sistemit të drejtësisë për të mitur në Bashkimin Evropian;
- Konventën për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), Karta Sociale Evropiane;
- Konventën Evropiane mbi Shtetësinë;
- Konventën Evropiane për Njohjen dhe Zbatimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët;
- Konventën Evropian (Lanzarote) për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit;
- Konventën e Këshillit Evropian për marrëdhëniet me fëmijët (2003);
- Udhëzime evropiane për Drejtësi Miqësore për fëmijët;
- Rregullat Evropiane për të mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave;
- Rekomandimin 2000(20) i Këshillit Evropian mbi rolin e ndërhyrjes së hershme psiko sociale në parandalimin e kriminalitetit;
- Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve;

- Konventën e Gjenevës IV për Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Luftë;
- Protokollin I të Konventave të Gjenevës lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare;
- Protokollin II të Konventës së Gjenevës lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura jo-ndërkombëtare;
- Vëzhgimet e përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Komenti nr. 10 (2007) drejtave të fëmijëve në Drejtësinë për Mitur.

Ligji për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, ka për qëllim sigurimin e kthimit të shpejtë të fëmijës që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit, si dhe sigurimi i respektimit i të drejtës së kujdestarisë dhe të kontaktit me fëmijët, të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës apo të një shteti kërkues. Ligji është në pajtim me Konventën e Hagës si dhe me praktikat më të mira të siguruara nga Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, qëllimi i të cilit është ekzekutimi i sanksioneve penale, sanksioneve kundërvajtëse dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, dhe aplikimi i masës së paraburgimit. Sipas këtij ligji sanksionet penale janë dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese dhe vërejtja gjyqësore. Ligji është në pajtueshmëri me Rekomandimin (2006)2 të Këshillit Evropian, Rekomandimin e Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe Konventën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, ç'njerëzor ose poshtëruese.

Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës, ka për qëllim të rregulloj përdorimin e mbikëqyrjes elektronike në procesin e drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutim efektiv të vendimeve të gjykatës, duke i respektuar plotësisht të drejtat e personave të përfshirë.

Ligji për Ndihmë Juridike Falas, ka për qëllim të krijoj një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedure civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Ligji për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar rregullon dhe përcakton të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësim, riaftësim profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm. Ky ligj është pjesërisht i përafuar me Direktiva e 2002/73/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 shtatorit 2002 të përmirësimit të Këshillit të Direktivave të 76/207/KEE të implementimit të parimit të trajtimit të barabartë për meshkujt dhe femrat siç janë lidhur me akseset e punësimit, aftësimeve profesionale dhe reklamave, dhe kushteve të punës, dhe me Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për themelimin e kornizës kryesore për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion

Ligji për Personat e Verbër i cili rregullon të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbërve. Me këtë ligj personat e verbër mbrohen nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme rregullon të drejtën për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyrën e realizimit të kësaj përkrahje materiale

Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë rregullon çështjen e mbrojtjes së të drejtës së gazetarëve për të ruajtur burimin e informacionit, duke u bazuar në nenin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ligji i Punës ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Në Ligjin e Punës dhe në aktet nënligjore të saj, deri më tani janë përfaruar përafriht 10 direktiva përkatëse. (Ju lutem referojuni Kapitullit 19 “Politikat sociale dhe të punësimit”).

Ligji për Siguri dhe Shëndetin në Punë përcakton masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë dhe përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve. Ligji i ri për siguri dhe shëndetë në punë, i miratuar në vitin 2013, është përafuar me Direktivën e Këshillit 89/391/KEE të 12 qershorit 1989 mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë (Direktiva Kornizë). Kjo direktivë është transponuar në shkallë të lartë në Ligjin e ri për siguri dhe shëndet në punë. Ky ligj, ka hapur rrugët për transponimin e 19 direktivave individuale të cilat burojnë nga kjo direktivë. Deri me tani janë transponuar dy direktiva individuale në rregullore të veçanta, e para dhe e dyta direktiva sipas kuptimit të nenit 16 (1) i Direktivës 89/39/KEE. (Ju lutem referojuni Kapitullit 19 “Politikat sociale dhe të punësimit”).

Korniza legjislative në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Korniza legjislative për mbrojtjen e minoriteteve është mjaft solide. Konventa e Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës në përputhshmëri me Kushtetutën. Ligjet të cilat mbulojnë fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore janë si në vijim:

Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve dhe është në harmoni me Konventën Kornizë e Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Në bazë të këtij ligji të gjithë personat që i përkasin komuniteteve kanë të drejtë ti gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që janë të përcaktuara me obligimet ligjore ndërkombëtare.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, siguron përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike; status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, si dhe të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor. Ligji është hartuar bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe në Protokollin e saj, Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, dhe duke pasur parasysh Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare dhe Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, Udhëzimet mbi përdorimin e gjuhëve minoritare në mediat transmetuese, si dhe me qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve,

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura siguron mbrojtjen e Manastireve Ortodokse Serbe, Kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb si dhe për komunitetet e tjera në Republikën e Kosovës, nëpërmjet themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura. Me qëllim të monitorimit dhe implementimit të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, është funksionalizuar Këshilli Zbatues Monitorues.

Korniza legjislative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Neni 36.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton që secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë drejtim, Republika e Kosovës ka miratuar kornizën themelore ligjore dhe

të politikave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Më konkretisht, është miratuar Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të dhënave personale është miratuar në prill të vitit 2010. Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejt të aplikueshme edhe në vendin tonë. Konventat dhe direktivat evropiane, të cilat rregullojnë fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë janë: Konventa 108/KE dhe protokollet shtesë (për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale); Direktiva 95/46/KE; Direktiva 2002/58/KE (e-privatësia dhe komunikimet elektronike).

Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themeloi institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave. Ligji në fjale me qëllim të refletimit të *acquis* të BE-së, është përafshuar pjesërisht me aktet në vijim:

- Direktivën 95/46/KE për mbrojtjen e individëve në lidhje me procedimin e të dhënave personale si dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2008/977/JHA lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Korniza e politikave

Korniza e politikave në fushën e sistemit gjyqësor

Korniza e politikave në fushën e gjyqësorit përbëhet nga Strategjitë dhe Planet e Veprimit si në vijim:

Strategjia dhe Plani i Veprimit për reduktimin e Lëndëve të Vjetra - Qëllimi i strategjisë është paraqitja e një vizioni të përgjithshëm strategjik për adresimin e lëndëve të vjetra të cilat ekzistojnë nëpër gjykatat e Kosovës. Strategjia do të udhëzojë përpilimin e politikave, të rregulloreve të brendshme, të procedurave, standardeve, si dhe të nismave, ndërhyrjeve dhe veprimeve. Synim i kësaj strategjie gjithëpërfshirëse është zhvillimi i një qasjeje tre-faqore me qëllim të adresimit të çështjes së reduktimit të lëndëve të vjetra nëpërmjet këtyre institucioneve: (1) Këshilli Gjyqësor i Kosovës i cili do të sigurojë përpilimin e politikave të përgjithshme, do të sigurojë liderhipin dhe përkrahjen e brendshme dhe të jashtme për zbatimin e Strategjisë dhe të nismave dhe aktiviteteve të cilat ndërlidhen me të. (2) Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të sigurojë përkrahjen operacionale, buxhetore, teknike, administrative dhe logjistike për zbatimin e Strategjisë dhe të nismave dhe aktiviteteve të cilat ndërlidhen me të. (3) Gjykatat e Kosovës do të sigurojnë mbikëqyrjen e përditshme gjyqësore dhe menaxheriale për zbatimin e Strategjisë dhe të nismave dhe aktiviteteve të cilat ndërlidhen me të.

Plani Strategjikë për Teknologji të Informimit dhe Komunikimit 2012 -2017 i KGJK-së - Vizioni i Strategjisë është që teknologjia e informimit dhe komunikimit e vënë në përdorim të mbështesë vizionin të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ta krijuar një sistem gjyqësor që është efikas, transparent, llogaridhënës për punën e tij dhe i qasshëm për të gjithë. Shtyllat kryesore të zhvillimit të strategjisë janë: përgatitjen e bazës ligjore dhe rregullative, të siguroj sponzorimin dhe mbështetjen e vendimmarrjes, sigurojë infrastrukturë adekuate softuerike dhe harduerike të TIK-ut dhe resurse njerëzore kompetente për të mirëmbajtur sistemet dhe përkrahur përdoruesit në përdorimin e infrastrukturës. Projektet kryesore që synohen të realizohen përmes zbatimit të strategjisë janë *Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve*, *Sistemi i Audio Incizimit të seancave penale*, si dhe sigurimi dhe vënia në përdorim e sistemeve të avancuara audio dhe video në shtatë gjykatat themelore për të siguruar edhe dhënien e dëshmisë së mbrojtur direkt në seanca gjyqësore të dëshmitarëve të mbrojtur. Deri më tani, përmes strategjisë është arritur të sigurohet zbatimi i Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve, projekt i cili është në zbatim e sipër. Për sistemin a audio incizimit dhe sistemeve për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk është arritur të sigurohen fonde për zbatimin e tyre.

Plani i punës përgatitor për projektin e menaxhimit elektronik të lëndëve Faza e parë ose faza përgatitore e projektit ka filluar në janar 2014 dhe ka përfunduar me suksese të plotë në qershor 2015. Të gjitha objektivat e parapara të realizohen gjatë fazës përgatitore janë realizuar dhe raportuar te donatori, që në këtë rast është Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Në bazë të rezultateve të arritura në fazën

përgatitore është aprovuar dhe është nënshkruar edhe marrëveshja e grandit edhe për fazën kryesore, e cila tashmë ka filluar dhe do të zgjasë tre vite. Kjo fazë ka për qëllim të zëvendësojë punën manuale në gjykata dhe prokurori me sistemin elektronik, i cili do të mundësojë një përpunim dhe menaxhimin e materialeve elektronike. Kjo do të krijojë kushte më të mira për punë, të cilat do të jenë në përputhje me kërkesat e sotme dhe zhvillimet e teknologjisë dhe shoqërisë në përgjithësi. Sistemi i menaxhimit të lëndëve do të lejojë rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, të cilat janë gjithashtu detyrime ligjore. Kjo do të realizohet përmes menaxhimit proaktiv të gjykatave dhe prokurorive të bazuara në të dhëna të sakta në kohë reale që do të jenë në dispozicion përmes sistemit.

Strategjia për reduktimin e lëndëve dhe procedurave alternative synon të reduktoj numrin e lëndëve nëpër gjykata duke patur për qëllim që lëndët e natyrave më të lehta të përfundojnë në prokurori pa pasur nevojë të dërgohen në gjykata. Me këtë qasje fokusi i prokurorëve në të ardhmen do të jetë prioritetizimi dhe marrja me lëndët e mëdha, qoftë të korrupsionit, krimit ekonomik, konfiskimit, apo ndjekjes së personave me pozita të larta.

Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit 2016-2019- synon të përmirësojë kushtet për sundim të qëndrueshëm të ligjit dhe avancim në procesin e integritetit evropian përmes planifikimit, programimit dhe përmirësimit të efektivitetit të asistencës së donatorëve në përputhje me prioritetet strategjike nacionale.

Plani Zhvillimor i Ministrisë së Drejtësisë 2012-2016 - me qëllim të realizimit të objektivit kryesor anëtarësimin në Bashkimin Evropian, parasheh pesë objektivat strategjike, si në vijim:

- Krijimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i integritetit evropian;
- Avancimi i mëtejshëm i sistemit të ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar;
- Sigurimi i parakushteve dhe administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale;
- Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të mjekësisë ligjore, gjetja dhe identifikimi i personave të zhdukur gjatë luftës dhe hulumtimi i krimeve të luftës;
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale me qëllim të avancimit të reformave dhe përfundimit më efikas të fushë-veprimtarisë së Ministrisë.

Korniza e politikave në fushën e politikave kundër korrupsionit

Korniza e politikave në fushën e anti-korrupsionit përbëhet nga politikat si në vijim:

Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2013-2017 është miratuar dhe vlen në zbatim për Ky dokument përmban politikat kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë së re kundër korrupsionit është të kontribuojë në reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit dhe ndërtimin e besimit të qytetarëve në institucionet e qeverisjes publike dhe për të promovuar parimin e tolerancës zero ndaj korrupsionit, për zbatimin e standardeve ndërkombëtare kundër korrupsionit, e cila ndihmon sundimin e ligjit efektiv dhe funksional në Kosovë. Përveç kësaj, Strategjia do t'i ndihmojë strukturave qeverisëse për të ndryshuar kulturën institucionale të tyre kundër korrupsionit dhe qëndrimin ndaj qasjes më orientim kah rezultatet. Kjo kërkon angazhim pro-aktiv nga të gjitha institucionet publike, organet e tjera të pavarura, shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar. Kjo strategji ka ndjekur strukturën e dokumentit të mëparshëm, përderisa ajo përmban objektivat horizontale (të ndërthurura), si dhe objektivat specifike në secilin sektor prioritar vertikal, domethënë: Sektori Politik, Qeverisja Lokale, Administrata Qendrore, Zbatimi i Ligjit – Prokuroria - Gjyqësori, Financat Publike-Prokurimi Publik, Sektori Privat/Mjedisi Afarist, Shoqëria Civile dhe Mediet si dhe bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Rajonal.

Planit i Veprimit kundër Korrupsionit përmban masat konkrete kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) në bashkëpunim me institucionet e tjera publike dhe organizatat e shoqërisë civile, ka përgatitur Strategjinë aktuale kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit (2013-2017). Këto dokumente parashohin objektivat konkrete dhe të fokusuara si dhe masat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit gjatë ciklit të tretë strategjik në Kosovë, që pason ato të 2004-2007 dhe 2009-2011.

Procesi i Rishikimit të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017 ka ndryshuar aktivitetet apo masat e Planit të Veprimit të cila janë modifikuar, disa janë fshire, dhe disa janë shtuar të reja. Ndryshimet kanë përfshirë të gjithë sektorët, po ashtu janë ndryshuar edhe afatet kohore të këtyre masave. Përveç vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të rrezikut në fushat prioritare kryesore, bazë për hartimin e Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit ishte edhe raporti i fundit i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, si dhe vlerësime të tjera ndërkombëtare dhe të pavarura të fushave të ndjeshme ndaj korrupsionit në Kosovë.

Vlerësimi vjetor i rrezikut të korrupsionit u përfundua në prill 2015 në sektorin politik, qeverinë lokale, administratën qendrore (veçanërisht duke u fokusuar në zonat me rrezik të lartë, të tilla si planifikimi hapësinor, arsimi dhe shëndetësia dhe autoritetet tatimore), ndjekjen penale, gjyqësorin, dhe politikën financiare dhe të prokurimit publik. Ky vlerësim ka shërbyer për të shqyrtuar Planin e Veprimit Antikorrupsion 2013-2017 i cila është finalizuar në korrik 2015. Vlerësimi vjetor I rrezikut të korrupsionit ka theksuar:

- Ndryshimin e legjislacionit në fusha të ndryshme për evitimin e zbrazëtirave ligjore që potencialisht mund të gjenerojnë korrupsion
- Rritjen e bashkëpunimit më të madh ndërmjet mekanizmave të drejtësisë me institucione
- Shmangien e konfliktit të interesit
- Rritjen e përgjegjësisë dhe mbikëqyrjes në punë
- Forcimin e kontrollit mbi sistemin e prokurimit publik dhe proceset në lidhje me shpenzimet buxhetore (efektiviteti dhe efikasiteti i përdorimit të fondeve buxhetore)
- Plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit legjislativ kundër korrupsion.

Mekanizmi percjelles per ngritjen e bashkepunimit nderinstitucional - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka realizuar krijimin e bazës së të dhënave/Mekanizmin percjelles me qëllim të harmonizimit të raporteve statistikore në mes të subjekteve parashtruese të kallëzimeve penale. Kjo ka mundur ngritjen e bashkëpunimit nderinstitucional dhe unifikimin e statistikave. Në këtë drejtim, KPK ka hartuar Planin për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në luftimin e korrupsionit. Gjithashtu, KPK ka caktuar koordinatoren nacional dhe ka themeluar komisionin për mbikëqyrjen dhe verifikimin e të dhënave të dërguara nga Prokuroritë Themelore dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e planit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në luftimin e korrupsionit.

Korniza e politikave në fushën e të drejtave themelore

Korniza e politikave e cila e mbulon fushën e të drejtave të njeriut përfshinë strategjitë dhe planet e veprimit si në vijim:

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 synon të ofrojë një kornizë të qëndrueshme të veprimeve konkrete që adresojnë sfidat dhe pengesat, promovojnë një shoqëri gjithëpërfshirëse, si dhe do i shërbejnë procesit të koordinimit dhe integritetit të të gjitha politikave dhe nismave relevante në fushën e Aftësisë së Kufizuara. Gjithashtu, Strategjia shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që parimet të cilat janë të mishëruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara janë inkorporuar në politikën dhe programet që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës.

Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 ka për qëllim përmirësimin e gjendjes aktuale duke zbatuar me përpikëri të gjitha fushat prioritare të përzgjedhura në Strategji Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023. Plani i Veprimit është i mbështetur në objektivat strategjike por gjithsesi duke i detajuar, specifikuar apo zbërthyer me veprime konkrete, tregues të matshëm, specifik, të arritshëm, real, si dhe institucione përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet, me afate kohore dhe linja buxhetore.

Programi Kombëtar për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave ka për qëllim të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse e cila do të përmirësojë përfshirjen e personave të shurdhër në të gjitha sferat e jetës në Republikën e Kosovës. Ky program fokusohet kryesisht në dy fusha që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave si dhe mësimin në gjuhën e shenjave. Ofrimi i shërbimeve do të arrihet përmes krijimit të një strukture për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave nga ku do të shërbehen të gjitha institucionet e vendit për çdo nevojë komunikuese që kanë qytetarët e saj. Ndërsa mësimi në gjuhën e shenjave do të realizohet duke krijuar kushte në të cilat personat e shurdhër mund maksimalisht të realizojnë potencialet e tyre deri në gradat më të lartë të kualifikimit akademik.

Kurse sa i përket fushës së barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, dokumentet strategjike që mbulojnë këtë fushë janë:

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013 (PKBGJ), synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe specifik për ndryshime në kushtet e jetesës së grave dhe vajzave në Kosovë, si dhe për eliminimin e ndasive të cilat janë të lidhura ngushtë me varfërinë. Ky dokument është fokusuar në 6 fusha specifike; (i) integrimi i grave në ekonomi; (ii) integrimi i grave në tregun e punës dhe përkujdesja sociale për kategoritë e prekura nga problemet sociale; (iii) gratë në proceset e vendimmarrjes, (iv) përkujdesja shëndetësore dhe qasja e femrave dhe meshkujve në shërbimet shëndetësore, (v) arsimimi; dhe, (vi) përfaqësimi dhe kontributi i tyre në kulturë dhe media.

Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, mundëson koordinimin dhe bashkërendimin e strategjive dhe përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse të ministrive të ndryshme dhe organizatave joqeveritare për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje. Parandalimi, Mbrojtja dhe Siguria, si dhe Përkrahja dhe Trajtimi dhe Re-integrimi janë tri shtyllat kryesore në të cilat është i fokusuar ky program.

Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 siguron promovimin dhe zbatimin e Rezolutës së KB 1325 në Kosovë. Nëpërmjet masave dhe veprimeve që parashihen në këtë plan, Kosova do të kontribuojë në zbatimin e Rezolutës 1325 në nivel lokal, rajonal dhe global duke koordinuar veprimet e përbashkëta të shtetit, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit për të zbatuar Rezolutën 1325 dhe programet e tjera që promovojnë çështjen gjinore në Kosovë. Plani bën të mundur që nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta dhe formave të tjera të informimit të publikut, të promovojë Rezolutën 1325 në Kosovë.

Procedurat Standarde të Veprimit Kundër Dhunës në Familje, kanë për qëllim krijimin e një sistemi të koordinuar të institucioneve të Kosovës, të cilat reagojnë në formë të menjëherëshme dhe të vazhdueshme në rastet e dhunës në familje me qëllim të ofrimit të ndihmës cilësore dhe mbrojtjes së viktimës së dhunës në familje. Me hartimin dhe zbatimin e këtyre procedurave standarde të veprimit, mekanizmat institucionalshtetëror dhe partnerët tjerë, do të harmonizojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin, në fazat e aktiviteteve të identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit Me këto masa përfshihet mbrojtja e pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje dhe në veçanti fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar.

Korniza e politikave në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Në kuadër të përpjekjeve për të ofruar mundësi për personat e kthyer është miratuar:

Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2014-2018), e cila shërben si udhërrëfyes gjatë procesit të kthimit i cili përfshin jo vetëm ndërtimin e njësive të banimit por edhe çështjen e qasjes në shërbimet publike si: marrjen e dokumenteve personale, shërbimet mjekësore; çështjen e sigurisë dhe lëvizjes së lirë, mundësinë e edukimit në gjuhën amëtare, mundësinë e punësimit dhe qasje në infrastrukturë. Strategjia përmban katër objektiva, të cilat MKK synon të realizojë gjatë pesë viteve të ardhshme 2014-2018: 1. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit, personave të zhvendosur në: Serbi, Mal të Zi dhe IRJM; 2. Fuqizimi dhe stabilizimi i komuniteteve në Kosovë; 3. Hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe integrim dhe 4. Avancimi i sistemit të menaxhimit të brendshëm të MKK.

Strategjia për integrimin e komuniteteve RAE (2009-2015), e cila synon promovimin dhe forcimin mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë dhe integrimi i tyre i plotë në shoqerine kosovare, si dhe sigurimi se legjislacioni është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Gjithashtu kjo strategji ka për qëllim përkrahjen dhe inkurajimin punës së OJQ-ve që përfaqësojnë interesat e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, thellimi i bashkëpunimit me to, duke përfshirë Institucionin e Ombudspersonit. Me përfundimin e periudhës zbatuese të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE, është duke u hartuar Strategjia e re që ka për qëllim përmirësimin e kushteve për këto komunitet. Mbetetet të përmirësohet alokimi buxhetor për zbatimin e kësaj strategjie.

Në kuadër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, është funksionale *Baza elektronike e të dhënave mbi trashëgiminë kulturore*, duke siguruar informacione mbi monumentet, vendet arkeologjike si dhe objektet të luajtshme trashëgimore. Objektet fetare dhe kulturore të trashëgimisë serbe në Kosovë janë në mbrojtje nga Njësia speciale e policisë duke siguruar në këtë mënyrë përmbushjen e kërkesave që dalin nga Raporti i SF.

Korniza e politikave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Sa i përket kornizës së politikave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale ka hartuar *Strategjinë e Mbrojtjes së të dhënave personale 2014-2017*, e cila ka për qëllim mundësimin e përmbushjes së zotimeve të agjencisë ndaj qytetarëve dhe institucioneve shtetërore përkatëse, në një ambient sfidues e në zhvillim e sipër. Përmes këtij dokumenti, gjithashtu, informohen palët e interesit se si do të zbatohen në praktikë detyrat ligjore të agjencisë.

Korniza institucionale

Korniza institucionale në fushën e sistemit gjyqësor

Korniza institucionale e gjyqësorit përbëhet nga institucionet në vijim:

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e drejtësisë, zbaton politika për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë, pa diskriminim; mbikëqyrë sistemin e noterisë, ndërmjetësimit dhe provimin e jurisprudencës; ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi etj..

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion i pavarur i cili siguron që gjykatat e Kosovës janë të pavarura, profesionale dhe të paanshme dhe reflektojnë natyrën multi-etnike në Kosovë. KGJK është përgjegjës për zgjedhjen dhe propozimin e gjykatësve për emërim, vlerësimin e performancës së tyre, procedurave disiplinore si dhe elaborimin e politikave dhe menaxhmentit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është një institucion plotësisht i pavarur me mandat që të administroj dhe menaxhojë sistemin prokurorial në Kosovë. KPK në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit siguron që krimi të luftohet në mënyrë efektive në Kosovë dhe si e tillë kontribuon në sundimin e ligjit.

Instituti Gjyqësor i Kosovës është institucion i pavarur i cili ofron trajnimin për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionist tjetër ligjorë në Kosovë. Gjatë punës së vet IGJK zhvillon plane aftësimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efikase, efektive dhe të paanshme si dhe kryen edhe veprimtari të tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet evropiane.

Gjykatat themelore, janë gjykata e shkallës së parë, dhe organizimi i brendshëm i kësaj gjykate me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre ka këto departamente:

- Departamenti për Çështjet Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë,
- Departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;
- Departamenti i Përgjithshëm që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore;
- Departamenti për të Mitur, që vepron në kuadër të gjykatave themelore.

Gjykata e Apelit, është gjykatë e shkallës së dytë, e cila është kompetente të shqyrtojë: të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore; të vendosë në shkallë të tretë, sipas ankesës që është lejuar me ligj dhe për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore; të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore; etj.

Gjykata Supreme është institucion publik që përfaqëson instancën më të lartë gjyqësore, me juridiksion në gjithë territorin e vendit. Gjykata Supreme është kompetente për: vendosjen në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj; kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj; revizionin kundër vendimeve të shkallës së dytë të gjykatave në çështjet kontestimore, siç është paraparë me ligj; përcaktimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës; etj.

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Si institucione te tjera që mbulojnë fushën e sistemit të drejtësisë janë edhe Oda e Notereve të Kosovës, Oda e Avokateve të Kosovës, Agjensioni për ndihme juridike falas etj.

Korniza institucionale në fushën e politikave kundër korrupsionit

Korniza institucionale e politikave kundër korrupsionit përbëhet nga institucionet në vijim:

Agjencia kundër Korrupsionit si institucion i pavarur, sipas Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit ka për mision parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit. Rrjedhimisht, në funksion të këtij misioni Agjencia i zbaton edhe Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë si dhe Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Task Forca Speciale Anti-Korrupsion e PSRK-së (2010) ka për detyrë luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë. Mandati i Task Forcës është të hulumtoj dhe të luftoj fenomenin negativ të korrupsionit në Kosovë.

Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundër Korrupsionit - Zyra e Prokurorisë së Shtetit ka emëruar koordinatorin për të koordinuar luftën aktuale të prokurorisë së shtetit ndaj korrupsionit. Koordinatori mbetet i përfshirë kryesisht në koordinimin e raportimit të zyrës së prokurorisë shtetërore në luftë kundër korrupsionit.

Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit është themeluar nga Presidentja e Republikës së Kosovës nëpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet në fuqi dhe ka për qëllim bashkërendimin e punës dhe aktivitetëve të institucioneve/agjencive, në kuadër të kompetencave dhe të fushëveprimit të tyre, për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Gjithashtu, funksionet tjera të Këshillit përfshijnë koordinimin e aktivitetëve në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, identifikimin e aktivitetëve në përkrahje të zbatimit të strategjisë kombëtare në luftimin e korrupsionit, përcaktimin e prioritetëve dhe politikave për zbatimin e agjendës legjislative në ngritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe ngritjen e vetëdijes së shoqërisë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Prokuroritë Themelore janë përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, përfshirë në ndërlidhje me krimin e organizuar, kurse *Gjykatat Themelore* janë përgjegjëse për të gjykuar dhe ndëshkuar rastet e korrupsionit, përfshirë në ndërlidhje me krimin e organizuar. Në ndërlidhje me këtë, *KPK* është përgjegjës për aspektet e politikave të përgjithshme operacionale, menaxhimin dhe monitorimin e raportimin e gjithmbarshëm të punës së prokurorive themelore në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit. *KGJK* ka të njëjtat përgjegjësi në raport me Gjykatat Themelore në këtë fushë.

Korniza institucionale në fushën e të drejtave themelore

Korniza institucionale që mbulon fushën e të drejtave themelore përbëhet nga institucionet në vijim:

Zyra për Qeverisje të Mirë vepron në kuadër të ZKM dhe është përgjegjëse që të ofron këshilla për Qeverinë, në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e barazisë, monitoron zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi. Jep mendime për projekt legjislacionin e përgatitur nga Qeveria, në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi dhe të praktikave të qeverisjes së mirë dhe konsultohet me përfaqësuesit e grupet e ndryshme të interesit. Sipas nevojës krijon organe këshillëdhënëse për shqyrtimin e qeverisjes së mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësitë e barabarta dhe çështjet kundër diskriminimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur kushtetues monitoron, mbron dhe promovon të drejtat dhe liritë e njeriut. Me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Institucioni i Avokatit të Popullit

është përcaktuar të jetë mekanizëm ankese për rastet e diskriminimit mbi çfarëdo baze, kurse me Ligjin për Barazi Gjinore është përcaktuar të jetë mekanizëm ankese për rastet e diskriminimit gjinor. Ai po ashtu do të veprojë edhe si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese. Avokati i Popullit, ka krijuar *Njësinë për Barazi Gjinore*, e cila ka mandat që të trajtojë të gjitha ankesat/ rastet e shkeljes së rregullave të barazisë gjinore kundër individëve apo grupeve të individëve të cilat janë kryer nga autoritetet publike.

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila ka mandat të zbatojë dhe të monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, duke promovuar vlerat dhe mundësitë e barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. Inicion dhe harton akte ligjore konform mandatit të saj në fushën e barazisë gjinore. Bashkëpunon ngushtë me mekanizmat institucional dhe shoqërinë civile në promovimin e agjendës pro gjinore.

Zyrtarët për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna, të cilët kryejnë detyrat e koordinatorit për çështje gjinore. Zyrtarët për barazi gjinore janë përgjegjës për përmbushjen e detyrave nga aspekti i barazisë gjinore, në kuadër të kompetencave të ministrisë, duke u bazuar në këtë Ligj dhe në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës.

Agjencia Kosovare e Pronës është themeluar si Agjenci e pavarur mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.

Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara në Programin Kundër Dhunës në Familje. Kurse Grupi Ndër-Ministror është i përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse, mandat i të cilëve është që të koordinojnë zbatimin e politikave, monitorimin, dhe të raportojnë periodikisht mbi progresin e shënuar, në Zyrën e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje, përkatësisht në Sekretariatit Kundër Dhunës në Familje.

Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve, u themelua me qëllim të koordinimit të politikave, programeve dhe proceseve në lidhje me çështjen e të drejtave të fëmijëve, për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe për t'u ofruar atyre mundësi të barabartë për pjesëmarrje aktive në shoqëri. Ky mekanizëm kujdeset rreth zhvillimeve të fundit në zbatimin e politikave, legjislacionit, programeve dhe masave të tjera të aprovuara në drejtim të realizimit të të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e personave nga komuniteti LGBTI, ka për qëllim që të krijojë partneritet dhe bashkëpunim të rregullt ndërmjet institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare që punojnë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit (LGBTI) në Republikën e Kosovës. Për më tepër, Grupi i shërben qëllimit të nismave për aktivitete të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit si dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut, me theks të veçantë në të drejtat e komunitetit (LGBTI).

Shërbimi Korrektues i Kosovës është përgjegjës për administrimin e të burgosurve, paraburgosurve, dënuarve, miturve në bazë të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, si dhe konventave Evropiane dhe rregulloreve të tjera të lëshuara në institucionet përkatëse. SHKK-ja është përgjegjës për menaxhimin e institucioneve të niveleve të ndryshme të sigurisë dhe mbikëqyrjen e personave nën kujdesin e SHKK-së.

Shërbimi Sprovues i Kosovës është organ qendror i administratës shtetërore në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe është përgjegjës për kryerjen e punëve lidhur me: organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të ri integritit shoqëror të personave të dënuar (punët sprovuese); ekzekutimin e masave të diversitetit dhe masave edukative për të mitur; vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale etj.

Inspektorati i MD-së për SHKK, të bëjë Inspektimin e punës së bërë në këto institucione dhe mbarëvajtjes së funksioneve të tij në fusha si: disiplina dhe ndëshkimet, mjetet shtrënguese, përdorimi i forcës, përdorimi i armëve të zjarrit, ankesat e të burgosurve, pranim-regjistrimi i të burgosurve, ndarja-kategorizimi, akomodimi, higjiena personale, veshmbathja- shtroajtj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, jonjerëzore ose poshtëruese: me Ligjin për Avokatin e Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit është përcaktuar si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP). Në kuadër të këtyre përgjegjësive ligjore, IAP do të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut; po ashtu do të jap rekomandime për përpunshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore apo administrative, udhëzuesve dhe të praktikave të aplikuara në Kosovë, me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është organ i pavarur, përgjegjës për sigurimin e ndihmës juridike falas, në lëmit civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilëve ju mohohet qasja në drejtësi, për shkak të mungesës së mjeteve materiale, dhe të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.

Departamentet për të mitur brenda gjykatave dhe prokurorive, merren ekskluzivisht me rastet ku të miturit janë të përfshirë në vepra penale.

Policia e Kosovës, Njësia për të drejtat e njeriut, ka përgjegjësi hartimin e politikave në këtë fushë si dhe mbikëqyr respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë barazinë gjinore. Rastet e dhunës në familje dhe delikuencës për të mitur trajtohen përmes Sektorëve të veçanta. Në kuadër të çdo drejtorie rajonale të PK janë funksionale sektorë të veçanta të dhunës në familje dhe për delikuencë të të miturve. Për më tepër, vetëm zyrtarë të certifikuar në këtë fushë merren me trajtimin e këtyre rasteve. Në kuadër të PK janë funksionale edhe Dhomat e veçanta për intervistimin e të miturve.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ofron dhe siguron qasjen e barabartë në drejtësi, për qytetarët e Republikës së Kosovës, duke konfirmuar gatishmërinë e institucioneve të Kosovës në promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e parimeve të të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Për të siguruar respektimin e të drejtave themelore, Agjencia ofron ndihmë juridike në gjuhën e palës.

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar është organ këshillëdhënës dhe orientues mbi prioritetet dhe politikat nacional në fushën e Aftësisë së Kufizuar. Qëllimi i Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar është të punoj për krijimin e mundësisë së barabartë, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar, të siguroj që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime për diç që ndikon në gjendjen e personave me aftësi të kufizuar. Rekomandimet e Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar, janë në pajtueshmëri me Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara mbi Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe instrumentet tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Komisioni për monitorim raportim dhe zbatim të politikave nacionale për personat me aftësi të kufizuara, vepron një mekanizmi monitorues përgjegjës për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit si dhe përfaqësuesit e organizatave që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Korniza institucionale në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Korniza institucionale që mbulon fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe atë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është si në vijim:

Këshilli Konsultativ për Komunitete, vepron në kuadër të Presidencës së Republikës së Kosovës, dhe ka mandat që të ndihmojë në organizimin dhe artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to; të ofrojë një forum për konsultim dhe bashkërendim midis komuniteteve dhe të sigurojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, të ofrojë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore; të ju ofroj mundësinë komuniteteve që në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo të politikave të cilat mund të përgatiten nga Qeveria ose Kuvendi.

Ministria për Komunitete dhe Kthim, zhvillon politika dhe promovon e zbaton ligje për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës; promovon krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim dhe siguron një qasje ndaj kthimit; zhvillon apo menaxhon programe dhe mekanizma për të ndihmuar integrimin në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, që aktualisht banojnë në Republikën e Kosovës, si dhe për të siguruar kthimin e qëndrueshëm të të shpërngulurve dhe të refugjatëve.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka mandatin për zhvillimin e politikave dhe implementimin e legjislacionit për promovimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore dhe lidhjen me anëtarët e të gjitha komuniteteve etnike, fetare dhe gjuhësore, duke përfshirë ato që përkohësisht ose përherë jetojnë jashtë Kosovës.

Këshilli Zbatues Monitorues, monitoron zbatimin e dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë, duke përfshirë në veçanti dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Qendrën Historike të Prizrenit dhe Fshatit Hoçë e Madhe.

Zyra e Komisionarit për Gjuhët, vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nën udhëheqjen e Komisionerit për Gjuhët, i cili është përgjegjës për menaxhimin e Zyrës dhe ekzekutimin e kompetencave të saj, për të këshilluar Qeverinë dhe institucionet nën juridiksionin e Zyrës në lidhje me miratimin dhe zbatimin e masave që sigurojnë përdorimin dhe statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare, përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në komuna si dhe mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë. Zyra mbështetet nga dy mekanizma: Bordi për Politika të Gjuhëve dhe Rrjeti i Politikave për Gjuhët.

Zyra për Çështje të Komuniteteve, vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe koordinon të gjitha çështjet e lidhura me komunitetet përfshirë: Koordinimin e organeve qeveritare, agjencive të pavarura dhe institucioneve / nivel ministror dhe komunal; Koordinimin e donatorëve dhe të organizatave ndërkombëtare për të siguruar që çështjet e komuniteteve janë marrë parasysh në mënyrë të efektshme në tërë Kosovën; eliminimin e përsëritjes së përpjekjeve dhe sigurimin e barazisë në ndarjen e fondeve dhe shfrytëzimin efektiv të tyre.

Komitetet Lokale për Siguri Publike, janë trupa konsultativë për policinë në identifikimin, adresimin dhe në partneritet me policinë bëjnë zgjidhjen e problemeve lokale në bashkësi.

Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, janë forume të sigurisë që kanë për qëllim rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal dhe ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi.

Korniza institucionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Republika e Kosovës ka themeluar:

Agjencioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Agjencioni funksionon si institucion i pavarur dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mbështetja e donatorëve

Mbështetja në fushën e gjyqësorit

Sa i përket asistencës së BE-së dhe asaj bilaterale në fushën e gjyqësorit, këto janë projektet e realizuara:

- *Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve* – ka për qëllim mbështetjen e institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Ky projekt, i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ka për qëllim të siguroj asistencë teknike Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në automatizimin e funksionimit të punës në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.
- *Programi I ngritjes së kapaciteteve 2012-2016* në kuadër të sistemit prokurorial dhe gjyqësor për mes shkollimit postdiplomik, studime master, postudimit nje vjeçar në Universitetet Amerikane. Ky projekt financohet nga Ambasada e SHBA-së. Deri më tani, në SHBA, janë shkolluar katër gjenerata, tri nga të cilat I kanë për funduar studimet një vjeçare dhe këta prokuror dhe gjyqtarë pas shkollimit janë kthyer sistemit prokurorial dhe gjyqësor duke bartur me vete përvoja dhe praktika të drejtësisë nga SHBA. Gjenerata e katërt ka filluar shkollimin në muajin gusht dhe pritet të përfundoj në fund të vitit të ardhshëm akademik. Deri më tani nga këto katër gjenerata, studimet në SHBA I kanë ndjekur 7 prokurorë dhe 6 gjyqtarë.
- *Projekti për publikimin e aktykimeve* – me kërkesë të KGJK, TAIEX ka aprovuar projekt propozimin e KGJK-së për ndihmë në organizimin e punëtorisë si hap i parë në zhvillimin/draftimin e rregullores për publikimin e aktykimeve.
- *Projekti i BE-së për asistencë të KGJK-së dhe KPK-së 2013-2016* – qëllimi i projektit është të asistoj KGJK dhe KPK në ngritje profesionale në kompetencat kyce si emërimi, riemërimi, transferimi, disiplinimi, etj. Poashtu, ky projekt ka asistuar në ngritjen e njësitit për evidencë penale duke ndihmuar draftimin e rregullores për Evidencë Penale. Projekti pritet të përfundoj në mars 2016 dhe i njëjti do të vazhdohet me një projekt të ining në pranverën 2016 qëllimi i të cilit është i njëjtë me objektivat e projektit aktual.
- *Projekti i USAID/Effective Rule Of Law Programe (EROL) 2011-2015* – avancimi i administrimit të gjykatave duke bërë renovimin fizik të gjitha gjykatave në Kosovë, si gjykata model. Shuma totale e projektit mbi 20 milion euro. Vazhdimi i këtij projekti do të bëhet në fund të vitit 2015 si Justice Sector Reform Program, qëllimi i të cilit është ndihmë i KGJK-së për integrimin e strukturave në Veri si dhe vazhdimin e aktiviteteve në funksion të reduktimit të lëndëve të vjetra.
- *Projekti UNDP 2015 – 2017* – qëllimi për të ngritur bashkëpunimin ndërinstiucional në mes KGJK-së, KPK-së, IgJK-së dhe MD-së dhe mbështetje profesionale duke asistuar nga afër në funksionimin më të mirë të gjyqësorit në tërësi.

Sa i përket asistencës së BE-së dhe asaj bilaterale në fushën e të drejtave themelore, janë duke u zhvilluar këto projekte:

- Projekti i binjakëzimit të BE-së “Lufta kundër homofobisë dhe transfobisë”, i cili projekt ka filluar të zbatohet nga muaji maj 2014. Ky projekt synon të adresojë rritjen e vetëdijes dhe zhdukjen e dhunës, paragjykimet dhe diskriminimin ndaj komunitetit LGBTI në Kosovë. gjithashtu ofron ndërtim të kapaciteteve dhe rritjen e vetëdijes dhe qasjes profesionale te autoriteteve të Kosovës, sidomos të policisë, gjyqësorit, mësimdhënësve dhe medieve ndaj pjesëtareve të komunitetit LGBT. Projekti adreson 4 komponenta-fusha:
 - Komponenti 1: legjislacioni / politikat
 - Komponenti 2: rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimet
 - Komponenti 3: strukturat e këshillimit ligjore dhe psikologjike
 - Komponenti 4: rrjetet dhe bashkëpunimi instiucional.

Masat afatshkurtra në fushën e sistemit gjyqësor

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, do të zbatohen këto masa legislative afatshkurtra në këtë fushë:

- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për te drejtën ndërkombëtare private*, ku do të transpozohen pjesërisht këto akte të acquis-së: Rregullorja e PE dhe Këshillit mbi të Drejtën Kompetente për Detyrimet Kontraktuese që Inkorporon Konventën e parë të Romës; Rregullorja nr. 864/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (11 korrik 2007) mbi të Drejtën Kompetente për Detyrimet jashtë Kontraktuese që inkorporon Konventën e dytë të Romës; Rregullorja nr. 1215/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (12 Dhjetor 2012) mbi kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe komerciale, që inkorporon Konventën e parë të Brukselit; Rregullorja nr. 2201/2003 e Këshillit (27 nëntor 2003 lidhur me kompetencën dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet martesore dhe çështjet lidhur me përgjegjësinë prindërore, që inkorporon Konventën e dytë të Brukselit, e amendementuar nga Rregullorja 2116/2004 sidhe Rregulloren nr. 4/2009 e dates 18 Dhjetor 2008 lidhur me juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjendhezbatimin e vendimevedhebashkëpunimitlidhur me qështjet e detyrimevetëmbajtjes.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Ndërmjetësim* me qëllim të transpozimit të pjesëshëm të Direktivës 2008/52/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit te datës 21 maj 2008 në Disa Aspekte të Ndërmjetësimit ne Çështjet Civile dhe Komerciale.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Prokurorin Disiplinor (ZPD)* do të hartohet dhe miratohet në mënyrë që të rregullojë aspektet materiale dhe procedurale si: kualifikimi istafit të ZPD-së dhe stafit mbështetës të ZPD-së, përzgjedhja, afatet, përgjegjësitë dhe detyrimet disiplinore të stafit të ZPD-së, konflikti i interesit dhe parandalimi nga detyrat e drejtorit/prokuroreve disiplinor, buxheti i ZPD-së, mbajtja e dosjeve dhe konfidencialiteti, parashkrimi, kriteret për pranueshmëri, caktimi i lëndeve, përfaqësimi i ZPD-së, ri-referimi i rasteve në ZPD, dhe shumë çështje tjera lidhur me këtë fushë. Rregullat te cilat do te parashihen në ligj do të jenë më të qarta dhe për pasojë do të kenë më shumë efikasitet dhe efektivitet në zbatimin e tyre.
- Hartimi dhe miratimi i një *Ligji për Akademinë e Drejtësisë* do të miratohet, ky ligj do të ngritë IGJK-në në nivelin e Akademisë.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Kundërvajtje* do të miratohet i cili rregullon kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedurën e kundërvajtjes, procedurën e veçantë për të mitur dhe procedurën e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2010/64/BE Parlamentit Evropian dhe Këshillit e tetorit 2010 për të Drejtën në Interpretim dhe Përkthim ne Procedurën Penale dhe pjesërisht me Direktivën 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 maj 2012, për të Drejtën në Informim në Procedurën Penale.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për procedurën Përmbarimore* në mënyrë që të reflektojë ndryshimet themelore për një zbatim më efikas të kësaj fushe.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Noterinë*, do të rregullojë tutje kompetencat funksionale te noterëve dhe do të harmonizojë këtë ligj me legjislacionin përkatës ne fuqi.
- Ligji per jurisprudencen i cili do të i rregulloj ceshtjet e përgatitjes së kuadrove për gjyqtarë, prokurorë dhe avokat, dhe në këtë mënyrë kontribuon në përmbushjen e kriterëve për gjyqësor të pavarur dhe funksional. Ai specifikisht do të rregullojë kriteret dhe procedurat për mbajtjen e provimit të jurisprudencës.

Gjithashtu me qëllimin e rregullimit të mëturjeshëm të fushës së gjyqësorit si dhe sigurimin e transparencës dhe efikasitetit të tij, do të miratohen edhe disa akte nënligjore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Në këtë drejtim, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka

identifikuar aktet nënligjore që duhet të hartohen dhe miratohen në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore të parapara me Ligjin nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës të specifikuar në matricë.

- Rregullorja për vlerësimin e gjyqtareve
- Rregullore për procedurën e publikimit të aktgjykimeve nga të gjitha gjykatat
- Rregullorja për gjyqtarë porotë
- Rregullore për shpenzimet e dëshmitarëve gjatë procedurës penale
- Rregullorja për ekspertë gjyqësor
- Rregullorja për përkthyes dhe interpret gjyqësore
- Rregullorja për zgjedhjen e anetarve të KPK
- Rregullorja për percaktimin e rregullave dhe procedurave për percaktimin e kandidatëve për prokuror
- Rregullorja për emerimin e Kryeprokuroreve të Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore
- Rregullorja për organizimin e brendshëm të prokurorisë
- Rregullorja për percaktimin e rregullave për organizimin e provimit për kandidat për prokurorë
- Rregullore për punën dhe funksionimin e KPK-së
- Rregullore për transferin dhe avansimin e prokurorëve
- Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e sekretariatit të KPK-së
- Rregullore për Punën e Komisionit për Buxhet dhe Financa
- Rregullore për ndarjen e lëndëve
- Rregullore për Avokatura Shtetërore.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, gjatë periudhës afatshkurtër fokusi do të jetë në këto *masa zbatuese* afatshkurtra në këtë fushë:

- Në drejtim të avancimit të politikave me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:
 - Rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra;
 - Hartimi dhe Miratimi i Strategjisë për ekzekutimin e sanksioneve penale;
 - Hartimi dhe Miratimi i Planit Vjetor të trajnimeve për prokurorë dhe gjyqtarë;
 - Rishikimi i Strategjisë për Reduktimin e Lëndëve dhe Procedurave Alternative.
 - Kryerja e një analize gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale sa i përket transpozimit të *acquis* në këtë fushë (me qëllim të vlerësimit të hollësishëm të gjendjes aktuale dhe percaktimit të prioritetëve afatmesme në këtë fushë).
- Në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të *kornziës institucionale* do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:
 - Funksionalizimi i Departamentit për Krime të Luftës brenda PSRK-së
 - Themelimi i Komisioneve si pasojë e plotësim-ndryshimit ndryshimit të ligjit për KPK-në janë: Komisioni për çështje normative, Komisioni për buxhet dhe financa, Komisioni për administrimin e prokurorëve, Komisioni disiplinor, Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve.
 - Funksionalizimin e Divizionit për kontestet lidhur me investitorët e huaj në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë të funksionojë me juridiksion për tërë territorin e Kosovës.
 - Funksionalizimi i zyrës për menaxhimin e evidencës penale në kuadër të KGJK-së.
 - Themelimi dhe funksionalizimi i Akademisë së Drejtësisë (përmes transformimit të IGJK-së në një nivel më të lartë) në pajtueshmëri me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.
 - Themelimi i Zyrës për menaxhimin e licencave dhe interpretëve gjyqësor në kuadër të KGJK-së.
 - Zhvillimi i sistemit të integruar elektronik për menaxhimin e rasteve dhe Plani i Punës për fazën përgatitore të projektit për sistemin e menaxhimit elektronik të rasteve.

- Rritja e mëtejshme e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe komunitetin pakicë serb për të cilat korniza ligjore rezervon një numër të konsiderueshëm të pozitive
- Në drejtim të zbatimit në praktikë në këtë fushë gjatë vitit 2016 institucionet përgjegjëse do të fokusohen në:
 - Reduktimin e rasteve trashëguara deri në 30% në vitet vijueseduke u orientuar në ngritjen e vetëdijës së popullsisë mbi mënyrat alternative të zgjedhjes së kontesteve
 - Përmes procedurave alternative (ndermjetesimit, pezullimit dhe marrëveshjes për pranimin e fajësise) KPK do ta reduktoj numrin e lendeve të mbetura deri në 30%. Përmes reduktimit të lëndëve, do të kryhet punë më efikase dhe më produktive dhe për një kohë më të shkurtër;
 - Rritja e numrit të noterëve, përmbartësve privatë, ndërmjetësuesve, administratorëve falimentues;
 - Zhvillimi i një fushate për vetëdijësimin e publikut për format alternative të zgjidhjes së kontesteve;
 - Rritja e numrit të marrëveshjeve për pranimin e fajësise;
 - Rritja e numrit të rasteve ku është kërkuar pezullimi i hetimeve;
 - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së gjykatave ndaj publikut.

Masat afatshkurtra në fushën e politikave kundër korrupsionit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, do të zbatohen këto masa zbatuese afatshkurtra në këtë fushë:

- Në drejtim të avancimit të politikave me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të ndërmerren këto masa afatshkurtra
 - Hartimi dhe Miratimi i Strategjia 2015-2020 për luftimin e korrupsionit;
 - Miratimi i një kornize të politikave për rolin e gjyqësorit në fushën kundër korrupsionit
 - Rishikimi i mandatit të Agjencionit Kundër Korrupsionit
 - Krijimi i një sistemi efektiv për luftimin e korrupsionit
 - Hartimi dhe Miratimi i Strategjisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
- Në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës institucionale do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:
 - Prioriteti i institucioneve të Kosovës është avancimi i legjislacionit në fushën e ndjekjes së kryesve të veprave penale dhe në veçanti në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar me veprë penale. Hartimi i ligjit përkatës i cili do të rregullojë aspektin e përfitimit të pasurisë së pajustificueshme do të bëhet në përputhshmëri me Direktivën nr. 2014/42 /BE për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave në BE.
 - Dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit duhet të harmonizohen me Kodin Penal. AKK në periudhën afatshkurtër planifikon që të inkurajojë institucionet publike dhe të kontribuojë në hartimin e Planeve të Integritetit. Kjo detyrë rrjedh nga Plani i Veprimit kundër Korrupsionit.
 - Rregullorja e punës së Agjencisë do të hartohet dhe miratohet pasi të plotësohet ndryshohet ligji për konflikt të interesit. Rregullorja e Punës plotëson dispozitat e Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, ato të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, Ligjit nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë si dhe të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës, rregullat për organizimin dhe funksionimin e punës në Agjencinë kundër Korrupsionit. Dispozitat e Rregullores zbatohen gjatë

- kryerjes së detyrave zyrtare nga të gjitha njësitë organizative të Agjencisë si dhe nga personat e angazhuar për kryerjen e shërbimeve të veçanta për Agjencinë.
 - Përmirësimi i cilësisë së kallëzimeve penale
 - Trajnime të specializuara për zbatimin e procedurës së konfiskimit
 - Trajnime të specializuara për zyrtarë të AKK-së
 - Prioritizimi i rasteve të nivelit të lartë për korrupsion
- Në drejtim të *zbatimit në praktikë* në këtë fushë gjatë vitit 2016 institucionet përgjegjëse do të fokusohen në:
 - Si prioritet mbetet edhe përmirësimi i raportimit të pikave të kontaktit të cilat shërbejnë si ura lidhëse në mes të institucioneve publike dhe AKK-së. Duke qenë se mbetet sfiduese raportimi nga pikat e kontaktit (në të gjitha institucionet e ndryshme që janë përgjegjëse për zbatimin e veprimeve të planit të veprimit kundër korrupsionit), AKK do të përmirësojë nivelin e raportimit në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, duke deleguar përgjegjësinë e pronësisë nga akterët relevantë mbi zbatimin e veprimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Në këtë drejtim do të theksohet fuqizimi i përgjegjësive të zyrtarëve kontaktues (zyrtar të caktuar nga institucionet e Kosovës si koordinator të punëve me Agjencinë) lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë.
 - Sigurimin e konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme gjatë hetimeve
 - Trajtimin e rasteve të korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik
 - Vazhdimin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë
 - Rritjen e numrit të rasteve të trajtuara të konfliktit të interesit sipas Kodit Penal
 - Ngritjen e vetëdijes në fushën e luftës kundër korrupsionit

Masat afatshkurtra në fushën e të drejtave themelore

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, do të zbatohen këto *masa legislative* afatshkurtra në këtë fushë:

- Hartimi dhe miratimi i (plotësim-ndryshimi) i *Kodit të drejtësisë për të mitur*, i cili do të rregullojë procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë*, që do të rregullojë statusin dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara*, i cili do të krijojë mekanizma lehtësuese për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë*, i cili ka për qëllim promovimin e tolerancës ndërmjet bashkësive fetare dhe është në frymën e Kushtetutës dhe në përputhshmëri me Opinionin i Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), Opinioni nr. 743/2013 i miratuar në sesionin e 98-të plenar.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve*, mbron fëmijën nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, lënies pas dore, apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të tij; sigurojë, në interesin më të mirë të fëmijës, bashkëpunimin, koordinimin, monitorimin dhe llogaridhënien, ndërmjet institucioneve në nivel

qendror dhe në nivel lokal, si dhe me organizatat që punojnë në fushën e mbrojtjes dhe përkujdesit të fëmijës. Ligji do të jetë nëpajtuueshmëri me Konventën mbi të drejtat e fëmijës.

- Hartimi dhe miratimi i *Ligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës*. Ky ligj ndërlihet me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krahësimin e zgjidhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit të punës*, që ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve të punës. (Ju lutem referojeni Kapitullit 19: Politikë sociale dhe punësimi).
- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Këshillin Ekonomik-Social*. (Ju lutem referojeni Kapitullit 19: Politikë sociale dhe punësimi).

Në kuadër të legjislacionit sekondar që del nga pako e ligjeve për të drejtat e njeriut, dhe që do të kontribuoj në thjeshtëzimin e strukturave që merren me të drejtat e njeriut dhe koordinimin në mes tyre, do të miratohet:

- Rregullorja për mënyrën e koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me Zyrën për Qeverisje të Mirë, të mekanizmave institucional për mbrojtje nga diskriminimi;
 - Rregullore për detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrarëve përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna
 - Rregullore komunale për mbrojtjen e te drejtave të fëmijëve, në nivel komunal
 - Rregullore për organizimin, strukturimin dhe funksionimin e Agjencisë për Barazi Gjinore.
- Gjithashtu me qëllimin të përmirësimit të kushteve të burgosurve do të miratohen:
- UA për arsimimin e te burgosurve;
 - UA Mbatja e evidencës.

Kurse, me qëllim të avancimit të drejtave të grave në trashëgimi dhe bashkëpronësi do të hartohet:

- UA për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve;

Për më tepër pritet miratimi i Rregullores për procesin e njohjes dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale, si dhe Rregulloreve komunale për mbrojtjen e te drejtave të fëmijëve, në nivel komunal (në 28 Komuna të cilat akoma nuk e kanë miratuar këtë rregullore).

Në drejtim të avancimit të *politikave* me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të miratohen strategjitë dhe programet si në vijim:

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut (2016-2020);
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të drejtat e fëmijëve (2016 – 2020);
- Strategjia për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Rreziqet në Internet (2015-2019);
- Strategjia për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- Strategjia për Këshillin Ekonomiko Social.;
- Strategjia Kombëtare kundër dhunës në familje;
- Plani Nacional i Veprimit për Parandalimin e Vetëvrasjeve dhe Tentim Vetëvrasjeve në Republikën e Kosovës 2015 – 2017;
- Strategjia për Rritjen e Sigurisë në Institucionet e Arsimit Para universitar;
- Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore;
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore; dhe

Në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të *kornizës institucionale* do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Do të funksionalizohet Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, jonjerëzore ose poshtëruese, duke punësuar stafin e nevojshëm;

- Do formohet dhe funksionalizohet Komisioni për verifikimi e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Në drejtim të *zbatimit në praktikë* në këtë fushë gjatë vitit 2016 institucionet përgjegjëse do të fokusohen në:

- Qartësimi dhe përcaktimi i kompetencave të njësive/zrytarëve për barazi gjinore në ministri dhe komuna;
- Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit në mes të mekanizmave për zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi;
- Ngritja e kapaciteteve të zrytarëve komunal dhe shoqërisë civile në nivel lokal për zbatimin e pakos ligjore për të drejtat e njeriut;
 - Vetëdijësimi dhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre në rast të shkeljeve të këtyre të drejtave;
 - Vetëdijësimi në nivel nacional dhe lokal për çështje të dhunës në familje dhe delikuençës së të miturve nga Policia e Kosovës;
 - Përfshirja e rasteve të dhunës në bazë gjinore në programin SMIL;
- Rishikimi i kurrikulave shkollore në të gjitha nivelet si pjesë e edukimit të publikut për të drejtat e tyre (në pajtim me pakon e të drejtave të njeriut);
- Përfshirja e komponentës së të drejtave të njeriut në kurrikulën e trajnimeve për shërbyes civil në nivel lokal dhe qendror;
 - Fokusimi në inspektimet e privilegjeve të jashtëligjshme për të burgosurit, si bazë e mundshme e korrupsionit nga ana e stafit të SHKK-së;
 - Inspektimet e vazhdueshme të rasteve të kontrabandës, identifikimi i përgjegjësve dhe ndërmarrja e masave ligjore kundër të burgosurve kontrabandues dhe stafit të përfshirë në kontrabandë;
 - Rritja e inspektimeve në funksion të zbatimit të ligjit të punës;
 - Aplikimi i procedurave alternative nga ana e prokurorëve, me qëllim të shkurtimeve të kohëzgjatjes së procedurave dhe në pajtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut;
 - Trajnime të vazhdueshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve të cilën merren me rastet ku janë të përfshirë të miturit;
 - Trajnimi i zrytarëve policor në fushën e të drejtave të njeriut.

Masat afatshkurtra në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga dokumentet e mekanizmat e të aderimit në BE, në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore për vitin 2016 si masë legjislative është paraparë:

- Hartimi dhe miratimi i *Ligjit për Trashëgimi Kulturore*, i cili rregullon mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore si dhe përcakton edhe mekanizma tjerë teknik dhe profesional. Projektligji rregullon dhe avancon edhe kornizën institucionale (institucionet vartëse-përgjegjëse të trashëgimisë kulturore) duke përfshirë dhe Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore. Projektligji për Trashëgimi Kulturore do të harmonizohet me direktivat e BE-së si: Direktiva 93/7/KEE, 15 mars 1993 për kthimin e objekteve kulturore të marra jashtëligjshëm; Rregulloren (KE) No 116/2009, 18 Dhjetor 2008 për eksportin e të mirave kulturore.

Sa i përket legjislacionit sekondar, do të miratohet:

- *Rregullore për kthimin e personave të zhvendosur*, e cila do të adresoj procesin e kthimit të personave të zhvendosur dhe integrimin e tyre.

Kurse, *masat zbatuese* që do të zbatohen gjatë vitit 2016 në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të *kornizës institucionale* janë:

- Themelimi i data bazës për të mbledhur dhe ruajtur të dhëna mbi numrin dhe lokacionin e të kthyerve;
- Profilizimi i personave të zhvendosur brenda Kosovës;
- Harmonizimi i sistemit të statistikave të Prokurorisë së Shtetit me Policinë e Kosovës përkitazi me nenin 147 të Kodit Penal të Kosovës që ka të bëjë me: “*Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik*”. Për të harmonizuar këto statistika është futur edhe neni 147 në bazën e shënimeve kriminale⁴².

Në drejtim të avancimit të *politikave* me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve do të ndërmerren këto masa:

- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për integrimin e komuniteteve RAE;
- Hartimi dhe miratimi Strategjisë për Përmirësimin e Zbatimit të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve;
- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore;
- Hartimi dhe miratimi i Politikave Nacionale për Trashëgimi Kulturore;
- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Siguri në Bashkësi 2016 – 2021.

Në drejtim të *zbatimit në praktikë* në këtë fushë gjatë vitit 2016 institucionet përgjegjëse do të fokusohen në:

- Zyra për Çështje të Komuniteteve të vazhdojë përkrahjen në punësimin e komuniteteve jo-shumicë;
- Përmirësimi i qasjes së pjesëtarëve të komuniteteve në arsim dhe ulja e numrit të braktisjes së shkollave;
- Avancimi i njohjes së diplomave nga Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve
- Përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil të për komunitet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Implementimi i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjit për Hoqën e Madhe.

Masat afatshkurtra në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, gjatë vitit 2016 do të ndërmerren këto *masa legislative* afatshkurtra:

- Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të transpozimit të pjesshëm të: (1) Direktivës 95/46/KE për mbrojtjen e individëve në lidhje me procedimin e të dhënave personale si dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe (2) Vendimit Kornizë të Këshillit 2008/977/JHA lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale;
- Rishikimi i *Strategjisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale* për periudhën 2014-2017.

Masat zbatuese që do të zbatohen gjatë vitit 2016 ndahen në masa institucionale, të kornizës së politikave dhe ato të zbatimit në praktikë:

- Zhvillimin dhe zbatimin e dispozitave të përgjithshme dhe veçanta për sigurinë e të dhënave personale;
- Emërimi i zyrtarëve komunal për mbrojtjen e të dhënave personale në dy komunat e mbetura
- Ngritja e kapaciteteve të kontrollorëve me anë të trajnimeve të specializuara;
- Numri i inspektimeve të kryera mbi zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Numri i rekomandimeve dhe i opinionëve të lëshuara;

⁴² KriMKorr është një bazë e të dhënave e themeluar në vitin 2013 në të gjitha prokuroritë e Kosovës. Në këtë bazë përfshihen të dhënat për veprat penale karakteristike dhe shërben si mjet për harmonizimin e tyre me të gjitha agjencitë e zbatimin të ligjit, prokuroritë dhe gjykatat. Pasi që të dhënat për veprat penale nga Neni 147 i Kodit Penal të Kosovës - Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, janë të një rëndësie të veçantë për shtetin e Kosovës në rrugëtimin e saj në proceset integruese Evropiane, KPK, ka bërë modifikimin e Bazës ekzistuese, duke shtuar edhe Modulin veprat penale nga Neni 147, me qëllim të harmonizimit të këtyre shënimeve me agjensionet e cekura si më sipër.

- Numri i inspektimeve të kryera në agjencitë për zbatim të ligjit.

Prioritetet afatmesme

Prioritetet afatmesme në fushën e sistemit gjyqësor

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, gjatë periudhës 2017-2020 do të fokusohemi në këto *prioritete afatmesme* në këtë fushë:

- Hartimi dhe miratimi i një Kodi Civil dhe legjislacionit përcjellës, me qëllim të unifikimit të legjislacionit në këtë fushë, përfshirë çështjet pronësore;
- Hartimi dhe miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare për sistemin e drejtësisë (e cila do të bazohet në një analizë të hollësishme të tërë sistemit, me fokus në kornizën funksionalitetin e tij
- *Rishikimi i Sistemit të Drejtësisë* me qëllim të ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, duke bërë analizën e sistemit të drejtësisë në tërësi. Më detajisht, rishikimi do të fokusohet në nivel vertikal, horizontal, legjislativ dhe nivel substancial. Më konkretisht Rishikimi do të përqëndrohet në njërin anë në nivel strukturor, në aspektin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve. Në lidhje me rishikimin vertikal, qëllimi do të jetë për të analizuar institucionet dhe organet që janë funksionale në Kosovë në aspektin e efikasitetit dhe profesionalizmit të tyre. Përveç kësaj, ekziston nevoja për një rishikim horizontal të kompetencave potencialisht kontradiktore, në mes të shumë institucioneve që janë krijuar me të njëjtën fushëveprimin e punës. Kjo shpesh çon në mos përgjegjësinë e institucioneve për dështimet e performancës. Në kushtet e rishikimi institucional, një komponent i fortë i rishikimit vertikal është hierarkia e institucioneve dhe nënshtrimit dhe kompetencave. Lidhur me aspektin legjislativ, në mënyrë të ngjashme do të shqyrtohet legjislacioni me qëllim të gjetjes të dispozitave kundërthënëse, së pari brenda vetë ligjeve, atëherë brenda ligjeve të ndryshme që mbulojnë të njëjtën fushë. I tërë ky rishim do të bëhet me qëllim të krijimit të një baze për Hartimin e një Strategjie Gjithëpërfshirëse për gjyqësorin e cila do të adresonte të gjitha problemet.
- Avancimi i meritokracisë në mënyrë që një prokuror do të mund të avancohet vetëm nëse tregon rezultate konkrete në implementimin e procedurave alternative por edhe suksesit konkret në konfiskim të pasurisë së paligjshme dhe rezultatit konkret të ndjekjes së një kryesi me peshë sipas pozitës (deputet, ministër, prokuror, gjykatës etj.)
- Shtimi i buxhetit për KPK duke alokuar dhe mundësuar PSH-së stimulimin e prokurorëve që tregojnë rezultate në trajtimin e rasteve të ndjeshme të korrupsionit apo personave me peshë të lartë.
- Procedurat Standarde të Veprimit mbi shënjestrimin e krimeve më të rënda dhe bashkëpunimit ndër-institucional në fazën afatmesme pritet që koordinimi mes institucioneve kryesore zbatuese të ligjit të rritet në nivel më të lartë edhe sipasojë e përvojës që do të arrihet ndërkohë dhe kjo pritet të sjellë rezultatet në dënimet e personave për të cilët në disa raste tashmë janë ngritur aktakuzat. Në fazën afatmesme por edhe atë afatgjatë, ky mekanizëm parasheh të sjellë para drejtësisë rastet më të mëdha që ka vendi e që i përkasin natyrës korruptive.
- Burimi i korrupsionit rrjedh nga procedurat tenderuese. Në mënyrë që të shmanget dhe parandalohet kjo dukuri, KPK në bashkëpunim me KGJK, PK, AKK, Doganat, ATK, NJIF, KRPP dhe Auditorin e Përgjithshëm parasheh trajnime të specializuara të vazhdueshme 2017-2020, për Prokurorë, Gjyqtarë, Policë, Doganier etj., në fushën e procedurave tenderuese.
- Rishikimi i strukturës institucionale për menaxhimin e sistemit gjyqësor

Prioritetet afatmesme në fushën e politikave kundër korrupsionit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, gjatë periudhës 2017-2020 do të fokusohemi në këto *prioritete afatmesme* në këtë fushë:

- Në periudhe afatmesme, AKK planifikon të bëj rishikimin e mandatit të Agjencisë në vitin 2017 si dhe të rishikoj *Ligjin 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit*, në mënyrë që të rriten kompetencat dhe të riprofilizohet Agjencia. *Agjencia kundër Korrupsionit* do të iniciojë debat në lidhje me ridefinimin dhe ripërcaktimin e kompetencave të AKK-së, me qëllim që Agjencia të fuqizohet sa më shumë.
- Pasi të realizohet Analiza për mandatin dhe misionin e AKK-së, do të bëhet rishikimi i *Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë*, me qëllim të rregullimit më ligj të çështjes së prejardhjes së pasurisë si dhe krijimi i mekanizmave që të vertetohet prejardhja e kësaj pasurie.
- Gjithashtu, AKK do të bëj hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2018-2022. Struktura organizative e Agjencisë mund të ndryshojë në bazë të rekomandimeve të cilat mund të dalin pas analizës për mandatin
- Analiza për mandatin e AKK dhe misionin të Agjencisë (në fund të 2016) Në bazë të kësaj analize parashihen procedurat për ndryshimin e ligjeve. Baza ligjore parashihet që gjatë periudhës 2017-2018 të adaptohet.
- Rishikimi i mandatit të agjencisë në 2017 - në fund të vitit 2016 - ka qëllim të bëjë një analizë të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse për të arriturat dhe nevojën e ristrukturimit të Agjencisë. Rishikimi i misionit të Agjencisë ndërlidhet me vlerësimin e rrezikut të përgjithshëm dhe në rend të parë me konsolidimin e Prokurorisë së Shtetit. Duhet të rishikohet nevoja e ekzistimit të një mekanizmi që ka nevojë të ushtrojë hetime paraprake, të cilat Agjencia tani i ndërmer. Deklarimi i pasurisë, dhuratave dhe parandalimi i konfliktit të interesit dhe korrupsionit në tërësi duhet të jenë bazë e misionit. Analiza do të përfshijë të gjithë akterët e mekanizmave anti- korrupsion, zyrtarët e Agjencisë dhe ekspertët ndërkombëtarë, të cilët do t'i prezantojnë përvojat ndërkombëtare të mekanizmave që kanë për mision të përafërt me Agjencinë. Si pasojë e rishikimit të misionit parashihet që struktura organizative e Agjencisë gjatë periudhës 2018-2019 të ristrukturohet dhe të funksionalizohet plotësisht.

Prioritetet afatmesme në fushën e të drejtave themelore

Prioriteti i Qeverisë së Kosovës në fushën e të drejtave themelore gjatë periudhës 2017-2020 do të jetë implementimi i ligjeve aktuale dhe fokusimi në përditësimin e strategjive për të drejtat e njeriut, duke siguruar qasje afatgjatë në këtë drejtim. Sipas planifikimeve buxhetore, implementimi i *Ligjit për Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë* do të fillojë që nga viti 2017.

Gjithashtu, do të miratohet *Ligji për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara*, i cili do të rregullojë çështjen e kategorizimit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në periudhën afatmesme 2017-2020, planifikohet harmonizimi i dispozitave të Ligjit për Barazi gjinore në lidhje me kuotën gjinore, me Ligjin për Zgjedhje. Për më tepër, duhet të harmonizohen dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit me dispozitat e Ligjit për të verbër, në mënyrë që të sigurohet qasja e personave të verbër në dokumente publike.

Gjithashtu do të hartohet dhe miratohet Ligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndihmë juridike falas.

Bazuar në Deklaratën e politikave afatmesme prioritare do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të reja infrastrukture në Shërbimin Korrektues dhe sprovues të Kosovës dhe rindërtimi i atyre ekzistuese, ngritjen profesionale të stafit korrektues dhe sprovues dhe ndërmarrjen e masave në risocializimin e të dënuarve. Në një periudhë afatmesme parashihet rishikimi i Kodit të drejtësisë për të mitur me qëllim të harmonizimit me direktiva të BE-së.

Me qëllim të ofrimit të ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, parashihet hapja e zyrave të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

MD do të hartojë dhe miratojë Kodin Civil i cili do të përafrohet me legjislacionin e BE-së dhe do të rregullojë aspektet civile të të drejtave të njeriut përfshirë:

- Çështjet pronësore dhe kompensimin për prona;
- Çështje detyrimore dhe të kontratave;
- Marrëdhëniet familjare dhe trashëgimore.

Për më tepër, siç planifikohet me Strategjinë Kombëtare për Çështje Pronësore, çështja e qasjes së trashëgimisë së grave në prona do të rregullohet me legjislacion të veçantë.

Prioritetet afatmesme në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore

Ministria për Komunitete dhe Kthim do të angazhohet për kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur nga Kosova dhe ri integrimin dhe stabilizimin e komuniteteve në Kosovë. Prioritet i Qeverisë në fushën e arsimit do të jetë zbatimi i Planit të veprimit për integrimin e komuniteteve RAE dhe Planit Kombëtar kundër Braktisjes.

Në një periudhë afat mesme, do të ndërmerren masa për përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe të komuniteteve minoritare në arsimin e lartë. Në të njëjtën kohë duhet të vazhdohet me angazhimin për përmirësimin e qasjes së refugjatëve dhe personave të zhvendosur në prona të tyre dhe shërbime publike, si dhe tu ofrohen mundësi më të mëdha ekonomike.

Në periudhën afatmesme do të miratohet:

- Ligji për Rikthimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore të Marra Ilegalisht;
- Ligji mbi Eksportin e të Mirave Kulturore.

Për më tepër, Qeveria e Kosovës do të angazhohet në rritjen e fondeve për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore: historike, kulturore dhe fetare. Gjatë periudhës 2017 – 2020 do të miratohet:

- Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme,
- Plani i Veprimit për Parandalimin e Trafikimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore;
- Regjistri Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Në funksion të mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore vëmendje e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar dhe përfshirjes së zonave të trashëgimisë në Kosovë në agjendat rajonale të zhvillimit të turizmit kulturor.

Prioritetet afatmesme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, gjatë periudhës 2017-2020 do institucionet përkatëse do të fokusohen në këto prioritetet:

- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për agjencinë;
- Edukimi (trajnimii) i kontrollorëve;
- Zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit përmes inspektiveve dhe kontrolleve;
- Zhvillimi i fushatave vetëdijësuese me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale;

3.25. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria

Kapitulli 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) i *acquis* mbulon këto fusha: menaxhimin e kufirit, migrimin, parandalimin dhe kontrollimin e migracionit të parregullt, politikën e vizave, sigurinë e dokumenteve, luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimin policor, luftën kundër terrorizmit, luftimin e narkotikëve dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe civile. Fusha e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë është ndër fushat më dinamike të politikave në kuadër të BE-së dhe politikat e BE-së në këtë fushë synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë dhe të garantojnë sigurinë, të drejtat dhe lëvizjen e lirë në BE. Legjislacioni (*Acquis*) i Bashkimit Evropian (BE) në këtë fushë bazohet mbi parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian, Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Fushat e mbuluara përfshijnë harmonizimin e së drejtës private ndërkombëtare, marrëveshjet e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, politikat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të kufirit, vizave, migracioni, politikat e azilit, bashkëpunimi policor dhe gjyqësor si dhe luftimi i krimit (përfshirë luftimin e terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të narkotikëve, trafikimit me njerëz, krimit kibernetik etj.). Kosova si shtet aderues duhet të bëjë transpozimin gradual të *acquis*-së në këtë fushë, dhe të zhvillojë e zbatojë një kornizë adekuate politikash si dhe institucione me kapacitete për të zbatuar *acquis*-në e transpozuar. Njëkohesisht, nga Shtetet Anëtare kërkohet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative brenda agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve e tjera relevante, të cilat duhet arritur standardet e nevojshme në këto fusha. Edhe pse pjesa më e detajuar e politikave të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është *acquis* Shengen, ku përfshihet heqja e kontrolleve të brendshme kufitare në BE, megjithatë, për vendet e reja anëtare pjesët thelbësore të *acquis* Shengen zbatohen pas vendimit të veçantë të Këshillit të ndërmarrë pas anëtarësimit.

Sa i përket *sundimit të ligjit*, *Kërkesat e MSA-së* dhe nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE konsistojnë në fuqizimin dhe konsolidimin e institucioneve të sundimit të ligjit. Kjo sidomos vihet në dukje nga neni 83 i MSA i cili thekson se, bashkëpunimi në këtë fushë do të fokusohet veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Në lidhje me këtë, është veçanërisht i domosdoshëm zhvillimi i kapaciteteve profesionale nga radhët e pjesëtarëve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve për të parandaluar, hetuar, ndjekur dhe gjykuar veprat e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Kërkesat e MSA-së

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në anën tjetër, në mënyrë eksplicite vendosë një sërë obligimesh për Kosovën, të përfshira në Titullin VII, përkatësisht nga Nenet 83-93 të MSA-së.

Sipas MSA-së, në *fushën e menaxhimit të kufirit*, Kosova do të përkujdeset në përafrimin e legjislacionit përkatës në përputhje me *acquis* të BE-së, intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, shkëmbimin e informatave, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe luftimin e krimit ndërkufitar. *Sa i përket politikës së vizave*, Kosova do të përkujdeset që të transpozojë në një periudhë afatshkurtër legjislacionin përkatës vendor në harmoni me *acquis* të BE-së. Në veçanti, Kosova do të përkujdeset që të zgjerojë dhe funksionalizojë rrjetin e sistemit të lëshimit vizave.

Lidhur me *migrimin* përgjithësisht, Kosova do të harmonizojë legjislacionin vendor me *acquis* të BE-së, lidhur me kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të ligjshëm të të huajve në Kosovë, kushtet e punësimit të tyre, bashkimit familjar, qëndrimin afatgjatë, studimin, hulumtimin, punëtorët e kualifikuar, punëtorët sezonal, lëvizjen e punëtorëve brenda ndërmarrjeve dhe masat ndëshkuese ndaj punëdhënësve. Për menaxhimin e migrimit të rregullt, Kosova do të respektojë parimin e trajtimit të drejtë dhetë barabartë të të huajve, gjithashtu duke promovuar integrimin e tyre.

Sa i përket parandalimit dhe kontrollit të migrimit të parregullt, Kosova do të vazhdojë të ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin dhe kontrollin e migrimit të paligjshëm, përfshirë trafikimin dhe

kontrabandimin me migrantë, po ashtu do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave themelore të migrantëve dhe ofrimin e asistencës për migrantët në nevojë.

Kosova do të vazhdojë riatdhesimin dhe kthimin e shtetasve të Kosovës, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të cilët kanë hyrë në territorin e ndonjë shteti të BE-së përmes Kosovës ose që kanë hyrë në territorin e Kosovës përmes ndonjë shteti anëtarë të BE-së. Gjithashtu, Kosova do të fillojë negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve më qëllim të përcaktimit të procedurave specifike për riatdhesimin e këtyre personave. Po ashtu, Kosova do t'i pajisë qytetarët e saj me dokumente përkatëse të identitetit dhe do të ofrojë lehtësira administrative për këtë qëllim. Kosova do të vazhdojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjeve për riatdhesim brenda mundësive, me shtetet që janë pjesë e procesit të Stabilizim Asociimit, dhe do të merr masa të nevojshme për sigurimin e zbatimit të shpejtë dhe fleksibil të këtyre marrëveshjeve.

Në politikën e azilit, Kosova do të garantojë standardet ndërkombëtare në përputhje me Konventën e Gjenevës lidhur me statusin e refugjatëve 1951, dhe Protokollin lidhur me statusin e refugjateve 1967. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet të drejtave të azilkërkuesve, duke respektuar parimin "non-refoulement". Në një periudhë afatshkurtër, Kosova do të sigurojë harmonizimin e legjislacionit vendor me acquis të BE-se, veçanërisht rreth pranimit të azilkërkuesve, trajtimit të kërkesave për azil dhe në menaxhimin e kthimit të azilkërkuesve në vendin e origjinës.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera ilegale Kosova do të harmonizojë legjislacionin me Acquis të BE-se dhe do të forcojë mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar. Kosova do të marrë pjesë dhe do të bashkëpunojë me mekanizmat regjional dhe ndërkombëtarë në luftimin e krimit të organizuar dhe do t'u përmbahet konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë.

Sa i përket shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, Kosova do të ndërmarrë masat e nevojshme në mënyrë që të parandalojë përdorimin e sistemeve financiare me qëllim të shpëlarjes së të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe financimit të terrorizmit. Kosova do të harmonizojë legjislacionin vendor me acquis të BE-së dhe do të forcojë mekanizmat për luftimin e shpëlarjes së parasë, dhe financimit të terrorizmit, njëkohësisht duke adaptuar standardet ndërkombëtare në këtë fushë e veçanërisht standardet e rekomanduara nga FATF (Financial Action Task Force).

Sa i përket bashkëpunimit në luftimin e drogave të paligjshme, Kosova do të vazhdojë bashkëpunimin për të siguruar një qasje të balancuar dhe të integruar sa i përket çështjeve të drogës, duke harmonizuar legjislacionin me acquis të BE-së dhe duke forcuar strukturat për luftimin e drogave të paligjshme. Kosova do të fokusohet po ashtu, në menaxhimin e pasojave shëndetësore dhe sociale të abuzimit të drogave dhe në menaxhimin efektiv të prekursorëve, në harmoni me parimet e përbashkëta të strategjisë së BE-së për droga dhe dokumentet tjera përkatëse.

Në fushën e luftës kundër terrorizmit, Kosova do të vazhdojë me harmonizimin e legjislacionit me acquis të BE-së dhe do të fuqizojë mekanizmat institucional për parandalimin, luftimin dhe financimin e terrorizmit, duke siguruar sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, liritë themelore, të drejtën ndërkombëtare për refugjatë dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Kosova do t'u përmbahet konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë

Pjesë e kësaj fushe është edhe ajo e sigurisë së dokumenteve dhe ajo e politikave të vizave. Sa i përket politikës së vizave, Studimi i Fizibilitetit (SF) nënvizon se fokusi duhet të jetë në shkëmbimin e statistikave dhe informatave mbi legjislacionin dhe praktikën, trajnimin e stafit, si dhe sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe zbulimin e dokumenteve të falsifikuara.

Sa i përket *luftës kundër shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit*, SF-MSA nënvizon se korniza themelore ligjore tashmë është vendosur, por akoma duhet t'i përshtatet standardeve evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, një strategji gjithëpërfshirëse e cila duhet të përfshijë disa aktorë institucionalë sikurse Departamentet dhe Njësitë e Policisë, NJIF dhe task forcën e Prokurorisë Speciale është e nevojshme për të luftuar shpërlarjen e parave.

Sa i përket *luftimit të krimit të organizuar*, SF-MSAse duhet të demonstron përkushtimi i qartë në arritjen e rezultateve konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë nisjen e hetimeve. Në bazë të rekomandimeve nga dokumentet e lartpërmendura Kosova duhet të intensifikojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe të avancojë kapacitetet institucionale lidhur me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me narkotikë, krimeve ekonomike, MASHTrimeve në prokurim publik dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Në fushën e *luftës kundër terrorizmit*, përkundër arritjeve në këtë fushë, mbetet të kompletohet korniza ligjore dhe e politikave për luftimin e terrorizmit, të demostohen rezultate konkrete në luftimin e terrorizmit si dhe të ngriten kapacitetët në këtë fushë.

Sipas SF-MSA, Kosova duhet të përmbush Kriteret Afatmesme në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar ku kërkohet të intensifikohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, të ngrihen kapacitetet e DBNJ-së dhe të sigurohet zbatimi vendimeve civile dhe penale si dhe të sigurohen mekanizma për zbatimin e ligjeve dhe vendimeve të gjyqësorit. Në takimin e gjashtë për DPSA për drejtësi, liri dhe siguri, në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar kërkohet të vazhdohet me përpjekjet për t'i trajtuar shpejt kërkesat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

Në fushën e *menaxhimit të kufirit*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 2015 thekson që duhet zbatuar tërësisht një qasje e Policimit të Udhëhequr nga Inteligenca, duke përfshirë shfrytëzimin e tërësisht të potencialit të QKMK-së si dhe duhet të ketë komunikim më të qartë në mes të nivelit qëndror, rajonal dhe lokal mbi kërkesat e inteligjencës. Poashtu, është e nevojshme që të punohet më shumë për zbatimin e planit zhvillimor të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK).

Sa i takon fushës së *azilit*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 2015 potencon që nevojiten mekanizma më efektiv për identifikimin e vendeve të origjinës dhe profilizimit të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Në fushën e *migrimit*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 2015 identifikon disa sfida duke përfshirë numrin e madh të azilkërkuesve Kosovar në shtetet e BE-së si dhe nevojën për masa efektive afatgjate në mënyrë që të parandalohen situatat e ngjashme në të ardhmen. Për më tepër, duhet të vazhdohet me ripranimin e këtyre personave si dhe riintegrimin e qëndrueshëm të tyre. Për këtë qëllim, ky raport thekson nevojën për shpenzimin më efektiv të fondit për riintegrim me qëllim të shfrytëzimit të plotë të burimeve të disponueshme për këtë proces, si dhe rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të nivelit komunal në mënyrë që të arrihet një menaxhim efektiv i procesit të riintegrimit në këtë nivel.

Sa i takon fushës e *shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 2015 thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Njësisë së Inteligjencës Financiare në Ministrinë e Financave dhe organeve kyçe kundër pastrimit të parave, si dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin më të mirë, në veçanti të Policisë dhe Prokurorisë. Në fushën e financimit të terrorizmit, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 2015 thekson se Korniza legislative e Kosovës për sekuestrim dhe konfiskim nuk përmbanë dispozitat specifike për të mundësuar autoritetet të marrin masat e nevojshme parandaluese dhe ndëshkuese për të ngrirë dhe, nëse është e nevojshme, konfiskuar pa vonesë, fondet ose asete të tjera të lidhura me aktivitetet terroriste në pajtim me rezolutat relevante të OKB-së.

Sa i takon *fushës së luftimit të narkotikëve*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 thekson se Kosova duhet të caktojë një pikë kombëtare kontakti ose të themelojë një obseRaporti i KE-së për Kosovën 2015ator operacional të drogës, i cili do të lehtësojë bashkpunimin me Qendrën Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Varësinë nga Droga, si dhe se duhet të emërohet Koordinator Nacional kundër trafikimit me narkotikë. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar ndërgjegjësimin të publikut për pasojat e abuzimit me drogën.

Sa i takon *fushës së luftimit të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit policor*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 thekson që gjatë vitit në vijim, Kosova duhet të fokusohet në: hetimin e krimit dhe marrjen e vendimeve për dënime përfundimtare, që si rrjedhojë do të shpërbënin grupet kriminale aktive në vend; aplikimin në mënyrë sistematike të mjeteve për hetimet financiare dhe konfiskimin e aseteve me qëllim të ngritjes së numrit të konfiskimeve permanente, dhe ngritjes së ekspertizës në të gjitha nivelet; si dhe zhvillimin e një qasjeje proaktive të policimit të udhëhequr nga intelijenca dhe mbledhjen, harmonizimin, analizimin dhe përdorimin e statistikave përkatëse penale, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin më të mirë ndër-institucional.

Sa i takon *luftës kundër terrorizmit*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 thekson që Kosova duhet të bëjë më shumë përpjekje për të identifikuar, parandaluar dhe penguar rrjedhën e luftëtarëve terroristë të huaj që udhëtojnë në zonat e konfliktit të tilla si Iraku dhe Siria.

Sa i takon *fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile*, RAPORTI I KE-SË PËR KOSOVËN 2015 thekson mungesën e konkludimit të marrëveshjeve në këtë fushë me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e menaxhimit të kufirit

Sa i përket kornizës legjislative në fushën e menaxhimit të kufirit dhe përputhshmërisë së saj me *acquis*, një analizë e gjendjes është bërë në vitin 2013. Si pasojë, në shtator 2013 është miratuar Ligji nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, duke siguruar përfshirjen e dispozitave të Rregullores nr. 562/2006/KE (Kodi i Kufijve të Shengenit) si dhe të Rregullores(KE) 1931/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillin që vendos rregulla mbi Trafikun Lokal Kufitar. Këto dy rregullore janë transpozuar edhe në UA nr. 08/2010 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Vendosjes së Shenjave Paralajmëruese dhe Shenjave të Shkruara në Pikat e Kalimit të Kufirit dhe në Zonën e Kufirit, UA nr. 03/2010 për Shënjimin e Vijës Kufitare, si dhe në UA nr. 30/2012 mbi Rregullat e Trafikut Lokal Kufitar. Poashtu është miratuar edhe Ligji nr. 04/L-216 për Bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit i cili reflekton Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufirit mbi bashkëpunimin e jashtëm të BE-së.

Në *fushën e vizave*, Republika e Kosovës ka miratuar kornizën themelore ligjore. Përkatësisht Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Udhëzimin Administrativ MPJ nr 01/2014 për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt nga misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës që reflektojnë dispozitat e Rregullores (KE)Nr. 810/2009 (Kodi i Vizave).

Sa i përket *politikave* në fushën e MIK-ut, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka miratuar Strategjinë Kombëtare për MIK 2013-2018, e cila bazohet në legjislacionin vendorë dhe në aktete legjislative dhe dokumentet strategjike të BE-së si: Konkluzionet e Këshillit të 4-5 dhjetorit 2006 mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2768 Takimi i Këshillit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, mbajtur në Bruksel), Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në bashkëpunim e jashtëm të BE 2009, rekomandimet e dala nga Katalogu i Shengenit lidhur me kontrollin e kufijve të jashtëm, (rekomandimi i këshillit të BE-

së 7864/09), Dokumentin EU Blueprint për Dogana) dhe Rregullorja (KE) nr. 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009 për krijimin e një Kodi të Komunitetit për Viza (Kodi i Vizave) dhe praktikat më të mira të BE-së.

Korniza legjislativë dhe ajo e politikave në fushën e menaxhimit të migrimit

Sa i përket menaxhimit të migrimit, Republika e Kosovës ka miratuar legjislacionin relevant, përkatësisht Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligjin nr. 03/L-208 për Ripranim,, Ligjin nr. 04/L-217 për Azil dhe Ligjin nr. 04/L-215 për Shtetësinë si dhe Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Ligji për të Huajt rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj është transpozuar me aktet e BE-së në vijim:

- Rregulloren (KE) nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Mbi themelimin e Kodit të Komunitetit për vizat" – e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2009/52/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjësit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm" – e transpozuar plotësisht;
- Direktivën 2009/50/KE të Këshillit "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune" – e transpozuar plotësisht;
- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet e anëtare për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt" – e transpozuar plotësisht;
- Direktivën 2005/71/KE të Këshillit "Mbi procedurat specifike për pranimin e shtetasve të vendeve të treta për qëllime të kërkimeve shkencore" – e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2004/81/KE të Këshillit, "Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente" – e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2004/114/KE të Këshillit, "Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim studimi, programe të shkëmbimit për nxënës, trajnim pa pagesë ose shërbim vullnetar" – e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2003/109/KE të Këshillit, në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë – e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2003/86/KE të Këshillit, "Mbi të drejtën e bashkimit familjar," e transpozuar plotësisht;
- Direktivën 96/71/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve – e transpozuar plotësisht;
- Direktivën 2011/98/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Mbi procedurën unike të aplikimit për leje unike për shtetasit e vendeve të treta për qëndrim dhe punë në territorin e një Shteti Anëtar dhe në një sërë të drejtash të përbashkëta" – e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2001/51/KE të Këshillit që plotëson dispozitat e Nenit 26 të Konventës që zbaton Marrëveshjen e Schengenit të 14 Qershorit, 1985- e transpozuar pjesërisht;
- Direktivën 2002/90/KE të Këshillit mbi definimin e lehtësimit të hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar – e transpozuar plotësisht.

Ligji për Ripranim përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi sa i përket bashkëpunimit për ripranim me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për ripranim. Ligji në fjalë është përafuar me aktet e BE-së dhe ato ndërkombëtare në vijim:

- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta të Shteteve Anëtare për rikthimin e qytetarëve të vendeve të treta që qëndrojnë ilegalisht;

- Dispozitat e kësaj direktive janë transpozuar poashtu edhe në UA nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës
- Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;
- Konventën e OKB-së mbi Statusin e Refugjatit (Konventën e Gjenevës, 1951) si dhe Protokollin Zbatues të saj (Protokollin e Nju Jorkut, 1967);
- Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës; dhe
- Kartën e të Drejtave Thelemore të Bashkimi Evropian

Poashtu, deri më tani, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar 21 marrëveshje bilaterale të Ripranimit.

Ligji për Shtetësinë përcakton mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Njëlloj, janë miratuar një sërë dokumentesh strategjike siç janë Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombëtar 2013-2018 për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, të cilat bazohet në legjislacionin vendor dhe në aktet legjislative dhe dokumentet strategjike të BE-së si: Konkluzionet e Këshillit të 4-5 dhjetorit 2006 mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve (Takimi i Këshillit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, mbajtur në Bruksel), Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në Bashkëpunimin e Jashtëm të BE-së, 2009, rekomandimet e dala nga Katalogu i Shengenit lidhur me kontrollin e kufijve të jashtëm, (rekomandimi i Këshillit të BE-së 7864/09), Dokumentin EU Blueprint për Dogana) dhe Rregulloren (KE) nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 13 korrikut 2009 për Krijimin e një Kodi të Komunitetit për Viza (Kodi i Vizave), si dhe praktikat më të mira të BE-së. Gjithashtu janë miratuar Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit për Migrim 2013-2018 dhe Strategjia Kombëtare për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar 2013-2018 të cila bazohen në legjislacionin vendor dhe në aktet ndërkombëtare, si: Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Konventën e Gjenevës 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatit dhe Protokollin i saj i vitit 1967, Konventën e Nju Jorkut për Personat pa Shtetësi, Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas, Konventën e OKB-së 1984 kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Mizor, Johuman dhe Poshtëruës, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollin e saj.

Poashtu është miratuar Profili i Zgjeruar i Migrimit për vitet 2012 dhe 2013, i cili është një dokument gjithëpërfshirës, me të dhëna standarde për migrimin dhe të dhëna lidhur me fushat e tjera të cilat potencialisht ndikojnë në fenomenin e migrimit siç janë: situata ekonomike dhe sociale, tregu i punës, kapitali njerëzor, arsimimi, tregtia etj. Synimi i këtij dokumenti është ndërtimi i një sfondi solid për zhvillimin e politikave koherente në fushën e migrimit dhe zhvillimit.

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e azilit

Në fushën e Azilit, Republika e Kosovës ka miratuar kornizën themelore ligjore dhe të politikave në fushën e Azilit. Me konkretisht është miratuar *Ligji për Azil* në korrik të vitit 2013. Ky ligj është harmonizuar pjesërisht me Direktivën 2003/9/KE të Këshillit mbi Kushtet e Pranimit për Azil-kërkues; Direktivën 2004/83/KE të Këshillit mbi Standardet Minimale për Kualifikimin dhe Statusin e Shetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si Refugjatë apo Persona që kanë Nevojë për Mbrojtje Ndërkombëtare (Direktiva mbi Kualifikimet); Direktivën 2011/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Standardet dhe Kualifikimin e Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si përfitues të Mbrojtjes Ndërkombëtare, për një Status Uniform të Refugjatit ose për Personat e Kualifikuar për Mbrojtje Shtesë (Recast); dhe Direktivën 2005/85/KE të Këshillit mi Procedurat e Azilit.

Korniza legjislative në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Baza themelore ligjore në luftë kundër shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit është Ligji nr 03/1-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, Ligji nr. 03/L-15 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, i cili me që për të qenë në përputhje me Acquis, duhet të harmonizohet me Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Task Forca për Veprim Financiar (FATF).

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë, i cili rregullon procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë, të hyrat dhe detyrimet e zyrtarëve të lartë publik, anëtarëve të familjes si dhe parasheh sanksionet në rast të shkeljeve. Ky ligj po ashtu rregullon procedurën e deklarimit, kontrollit dhe prejardhjes së dhuratave të pranuar nga të gjithë personat zyrtarë.

Sa i përket kornizës së politikave në fushën e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Qeveria e Kosovës ka miratuar *Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën Kundër Ekonomisë Joformale, Shpërlarjes së Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve financiare 2014-2018*. Ky dokument strategjik shërben si udhërrefyes për drejtimin dhe kontrollimin e aktiviteteve të institucioneve përkatëse kombëtare lidhur me rreziqet e mundshme në të ardhmen sa përket ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë.

Korniza legjislative në fushën e luftës kundër narkotikëve

Baza themelore ligjore sa i përket veprave penale kundër narkotikëve rregullohet me dispozitat e kapitullit XXIII të Kodit Penal nr. 04/L-082 të Republikës së Kosovës si dhe Kodin nr. 04/L-123 e Procedurës Penale. Për më tepër, është miratuar Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, si dhe UA nr. 10/2010 për administrimin dhe përdorimin e metadonit për programe mbajtëse.

Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë ka për qëllim përcaktimin e masave të përgjithshme preventive dhe luftën kundër abuzimit me bimë narkotike, barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë. Duke marrë parasysh që ky Ligj është miratuar në vitin 2008 nuk ka marrë në bazë legjislacionin e BE-së gjatë hartimit, mirëpo Ligji bazohet në Konventat si në vijim:

- Konventa e ndarë e Kombeve të Bashkuara për droga narkotike (NeëYork 30 mars 1961), siç është amandamentuar nga Protokoli I vitit 1972 (Gjenevë, 25 mars 1972);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për substance psikotropike (Vienë 21 shkurt 1971);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotropike (Vienë, 20 dhjetor 1988). Kjo Konventë vlen gjithashtu për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale.

Sa i përket kornizës së politikave në luftën kundër narkotikeve, Republika e Kosovës ka hartuar dhe miratuar *Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Narkotikëve 2012-2017*. Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, dhe problemet që janë pasojë e keqpërdorimit të drogave si dhengritja e vetëdijes së individit dhe shoqërisë në përgjithësi e cila mundëson marrjen e vendimeve dhe përgjegjësive lidhur me keqpërdorimin e drogave.

Korniza legjislative në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit policor

Në vijim janë aktet kryesore ligjore të për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar: në Republikën e Kosovës:

*Kodi Penal i Republikës së Kosovës me qëllim të reflektimit të *acquis* të BE-së, është përafuar pjesërisht me atket në vijim:*

- Vendimin Kornizë për luftimin e krimit të organizuar (Vendimi Kornizë 2008/841/JHA),
- Vendimin Kornizë për vendosjen e sanksioneve penale kundër falsifikimit të euro-së (Vendimi Kornizë 2000/383/JHA, i ndryshuar me Vendimin Kornizë 2001/888/JHA) dhe
- Vendimi Kornizë për luftimin e MASHTrimit dhe falsifikimit të mjeteve që nuk përfshijnë pagesa me para të gatshme (Vendimi Kornizë 2001/413.JHA),
- Direktivën 2001/36 te BE-se për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore
- Direktivën 2011/93E BE-se për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve,
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2004/757/JHA për dispozitat minimale për elementet përbërëse të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikut të drogës të paligjshëm;

*Kodi i Procedurës Penale, i cili për të reflektuar *acquis* të BE-së është përafuar me legjislacionin Evropian lidhur me çështjet e procedurës penale si në vijim:*

- Direktivën 2010/64/BE për të Drejtën në Interpretim dhe Përkthim në Procedurën Penale; Direktivën 2012/29/BE për të Drejtën në Informim në Procedurën Penale;
- Direktivën 2012/29/BE që themelon standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/220/JHA
- Direktivën 2013/48/BE, për të Drejtën e Qasjes në Mbrojtës/Avokat në procedurën penale dhe në procedurë Urdhër Arrestit Evropian, dhe në të Drejtën e Informimit të një personi të tretë për kufizimin e lirisë dhe të komunikojë me personat e tretë dhe me autoritetet konsullore lidhur me kufizimin e lirisë;
- Vendimin kornizë të Këshillit 2005/212/JHA dhe Vendimin kornizë të Këshillit 2000/383/JHA.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve rregullon masat e posaçme dhe urgjente, mënyrat dhe procedurat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë ka për qëllim parandalimin dhe luftimin memasa konkrete, parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike, duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Ligji për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar nr. 03/L-141 është përafuar me Vendimin Kornizë të Këshillit 2005/212/JHA, Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA, dhe Vendimin Kornizë të Këshillit 2006/783/JHA.

Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në çështjet Penale, rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera. Ky ligj është përafuar me Vendimin Kornizë të Këshillit 2003/577/JHA, Vendimin Kornizë të Këshillit 2006/783/JHA për aplikimin e parimit të pranimit të përbashkët të urdhrave të konfiskimit, Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA; Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA; si dhe Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA.

Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për nxitjen e zyrtarëve për paraqitjen e veprimeve kundërligjore, ku si përkufizim i informatorit ka kuptimin: çdo person, i cili si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimet kundërligjor.

Ligji për Policinë rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

Ligji për Barnat narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë rregullon prodhimin, qarkullimin me shumicë dhe pakicë, importin, eksportin, kalimin transit, transportin, blerjen, furnizimin, shitjen, posedimin, konsumimin, përdorimin dhe propagandimin e bimëve prej të cilave mund të përfitohen narkotikët, barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët. b) Përcakton obligimet e autoriteteve kompetente të cilat kanë lidhshmëri me këto substanca; c) Bënë klasifikimin e bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në bazë të rrezikshmërisë së tyre, gjatë përdorimit në mjekësi dhe veterinar; d) Përcakton masat e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimit të bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve; e) Përcakton masat ndëshkimore në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji, dhe akteve normative në bazë të këtij ligji. Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren (KE) NR 1258/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 nëntorit 2013 që e amandamenton Rregulloren (KE) e 273/2004 e 11 shkurt 2004 për prekursorë.

Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2011/36/BE mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre.

Ligji për Kompensimin e viktimave të krimit, qëllimi i të cilit është krijimi dhe funksionalizimi i programit për kompensim të viktimave të krimit. Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2004/80/KE lidhur me kompensimin e viktimave të krimit, ku ky ligj reflekton kërkesën e direktivës, lidhur me procedurat për kompensim të viktimave të krimit në rastet ndër-kufitare si dhe themelimin e autoriteteve vendimmarrëse dhe asistuese në rastet e kompensimit të viktimave.

Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror rregullon kontrollin kufitar, kompetencat e policisë brenda shtetit, bashkëpunimi ndërmjet organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në menaxhimin kufitar.

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka për qëllim ekzekutimin e sanksioneve penale, sanksioneve kundërvajtëse dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, dhe aplikimi i masës së paraburgimit

Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, i cili në bazë të neneve 65(1) dhe 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës themelon Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë e cila ka për qëllim të mbledh, analizojë dhe shpërndajë informata inteligjente në mënyrë të shpejtë dhe përgjegjshme.

Ligji për Prokurorin e Shtetit themelon dhe rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit.

Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë qëllimi i së cilit është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informacioneve që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës si dhe për verifikimin e sigurisë së personave që kanë qasje në këto informacione.

Ligji për Gjykatat rregullon organizimin, funksionimin dhe jurisdikcionin e gjykatave në Republikën e Kosovës.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themelon institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të të dhënave.

Ligj për përgjimin e komunikimeve elektronike rregullon procedurat dhe kushtet mbi përgjimin e komunikimeve elektronike që realizohen për nevoja të procedurës penale nga institucionet shtetërore të themeluara me ligj, dhe procedurat dhe kushtet e përgjimit për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj të themeluara me ligj.

Sa i përket strategjive dhe politikave përkatëse, Kosova ka miratuar dokumentet e nevojshme strategjike për luftimin e krimit të organizuar:

- *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar 2012-2017;*
- *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës kundër Narkotikëve 2012-2017;*
- *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit 2012-2017;*
- *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2015-2018;*
- *Strategjia Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca 2014- 2017;*
- *Strategjia për kontrollimin dhe mbledhjen e armëve të vogla dhe të lehta 2013-2017*

Korniza legjislativë në fushën e luftimit të terrorizmit

Sa i përket luftës kundër terrorizmit, ekziston korniza themelore ligjore, përkatësisht dispozitat e Kodit Penal nr. 04/L-082 të Republikës së Kosovës dhe Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale. Për më tepër, janë hartuar Ligji nr. 04/l-178 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 03/l-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, si dhe Ligji nr. 05/l-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura jashtë Territorit të Vendit.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit që përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura jashtë Territorit të Vendit, i cili përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Sa i përket kornizës së politikave në fushën e shpërlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, Qeveria e Kosovës ka miratuar aktet në vijim:

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizmit 2012-2017, e cila ka për qëllim edhe fuqizimin e mekanizmave institucional të dedikuar për parandalim dhe luftim të terrorizmit, ngritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional në nivel vendi por edhe ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Shpërlarjes së Parasë, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 shërben si dokument strategjik shërbën si udhërrëfyes për drejtimin dhe kontrollimin e aktiviteteve të institucioneve përkatëse kombëtare në lidhje me rreziqet e mundshme në të ardhmen sa përket ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë.

Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie Në Terrorizëm 2015 – 2020, ka për qëllim adresimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës që ndikojnë në radikalizimin e popullsisë, në veçanti të rinjve. Përmes arritjes së katër objektivave strategjike: Identifikimi i hershëm - i shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të targetuara; Parandalimi - i ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm; Intervenimi - me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizimi i dhunshëm; De-radikalizimi dhe riintegrimi - i personave të radikalizuar si dhe objektivat specifike/masat në kuadër të tyre Qeveria e

Republikës së Kosovës ka për qëllim që të parandaloj dhe zvogëloj rrezikun nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm.

Korniza legjislative në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Në vijim janë aktet kryesore ligjore në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile në Republikën e Kosovës

Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në çështjet Penale, rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera. Ligji përcakton se bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të realizohet edhe në lidhje me organizatat apo institucionet ndërkombëtare, atëherë kur është i nevojshëm. Në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të huaj, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit. Procedurat gjyqësore të ofrimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar rregullohen me dispozitat e procedurës penale, përveç nëse ndryshe është paraparë me këtë ligj. Republika e Kosovës duhet të zbatoj formalitetet dhe procedurat e përmendura shprehimisht nga shteti kërkues, nëse formalitetet dhe procedurat e tilla nuk janë në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës vendore. Ky ligj është përafuar me:

- Vendimin Kornizë të Këshillit 2003/577/JHA mbi ekzekutimin e urdhërave të ngrirjes së pronës ose dëshmive në Bashkimin Evropian;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2006/783/JHA mbi aplikimin e parimit të njohjes reciproke të urdhërave të konfiskimit;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA i 6 Dhjetorit të 2007 lidhur me bashkëpunimin në mes të Zyrrave të Konfiskimit të Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, ose pasurisë tjetër të lidhur, nga/ me krimin;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA i 28 majit të 2001 mbi luftimin e MAShTrimit dhe falsifikimit të mënyrave të pagesave që nuk përfshijnë para të gatshme;

Korniza institucionale

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e menaxhimit të kufirit

Agjencitë kryesore të Republikës së Kosovës të përfshira në MIK, duke i kategorizuar ato sipas funksionit të tyre, kontroll të personave dhe kontroll të mallrave, janë: Policia e Kosovës; Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).

Policia e Kosovës, më saktësisht Departamenti për Kufij i Policisë së Kosovës operon me 1,142 punonjës dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin në PKK, përgjatë Kufirit të Gjellbër dhe Kufirit të Kaltër, brenda Republikës së Kosovës lidhur me çështjet kufitare; lëshimin e dokumente të përkohshme për kalim ndërkufitar, sigurinë në aeroportet ndërkombëtare në bashkëpunim me operatorin e aeroportit dhe autoritetet relevante të autorizuar; parandalimin e akteve terroriste në partneritet me të gjitha agjencitë për zbatimin e ligjit, përcaktimin e së drejtës së çdo personi që dëshiron të hyjë apo të lëshojë Kosovën lidhur me kërkesat për viza dhe hyrje, mbylljen e përkohshme të kufijve (mbështetur në vendimin e Qeverisë) si dhe dhënien e autorizimit të përkohshëm për të kaluar Kufirin e Gjellbër dhe të Kaltër. Ky departament është i organizuar në nivel qendror, rajonal, dhe lokal. Në nivel rajonal, departamenti përbëhet nga Rajoni i Veriut, Lindjes, Perëndimit dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

Dogana e Kosovës ka përgjegjësi të zbatojë procedurat dhe operationet të cilat kërkohen nga Kodi për Dogana dhe Akciza për mallërat që hyjnë, dalin dhe kalojnë nëpër territorin e Kosovës, si dhe të adresojë çfarëdo parregullësie në këtë aspekt (duke përfshirë edhe shqiptimin e gjobave)

AUV, përveç tjerash, ka përgjegjësi që të kontrollojë kafshë dhe mallërat e tjera ushqimore që hyjnë, dalin dhe kalojnë në PKK-të e Republikës së Kosovës.

Në mënyrë që të sigurohet bashkëpunimi dhe koordinimi adekuat në mes këtyre agjencive, janë themeluar edhe strukturat e nevojshme për këtë qëllim. Bëhet fjalë për Bordin Ekzekutiv për MIK i cili përbëhet nga Koordinatori Nacional për MIK; Drejtori i Departamentit të Policisë për Kufij; Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës; Kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës; Sekretari i Përgjithshëm i MIE; dhe përfaqësues nga institucionet tjera në rast nevojë.

Për më tepër, MIK-ut i shërben poashtu edhe Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar që ka funksionin e koordinimit të aktiviteteve dhe operacioneve që dalin nga kërkesat e autoriteteve të përfshira në MIK, duke i ofruar atyre mbështetje dhe lehtësuar shkëmbimin e informatave QKMK ka për detyrë që përmes sistemit të fotografimit, regjistrimit dhe mbikëqyrjes përmes kamerave TVQM (CCTV) dhe lexuesit automatik të tabelave (ANPR), të monitorojë aktivitetet në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK), të informojë me kohë personat përgjegjës për aktivitetet e dyshimta në PKK dhe vijën e gjelbër/kaltër, dhe të bashkërendoj veprimet e autoriteteve të përfshira në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit. Në kuadër të qendrës funksionon po ashtu Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënime (NjPIARK) që ka për detyrë grumbullimin, vlerësimin, analizimin, krahasimin dhe harmonizimin e të dhënave dhe informatave ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira në MIK dhe në baza të këtyre informatave harton analiza të përbashkët të rrezikut dhe kërcënimeve në baza javore, mujore dhe vjetore.

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të kufirit, deri me tani janë nënshkruar 23 Marrëveshje për Bashkëpunim Policor në fushën e Kufirit me Shqipërinë, Maqedoninë, me Malin e Zi dhe Serbinë. Ndërsa janë nënshkruar 12 marrëveshje për bashkëpunim doganor me Shqipërinë, Malin e Zi, Finlandën, Hungarinë, Maqedoninë, Slloveninë, Turqinë, Francën, Italinë, Poloninë, Austrinë dhe Britaninë e Madhe.

Përpos nevojës për përafrimin e legjislacionit vendorë me atë të BE-së, ekzistojnë edhe një sërë aspektesh tjera që duhet përmirësuar në mënyrë që menaxhimi i kufijve të jetë më efikas. Në aspektin teknik, Sistemi për Menaxhimin e Kufijve duhet të avancohet me tej, pasi që nuk ka kapacitete të mjaftueshme teknike për të lexuar të dhënat e integruara në dokumentet e udhëtimit. Po ashtu, duke marrë parasysh rëndësinë e QKMK-së si qendër që mbledh në një vend zyrtarët e policisë, doganave dhe agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë, ekziston nevoja që kjo qendër të avancohet tutje si në aspektin teknik ashtu edhe në atë të ngritjes së kapaciteteve përmes hartimit të planeve adekuate të zhvillimit.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e politikës së vizave

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e regjimit të vizave është *Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)*. Që nga 1 korriku 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur regjim vizash për shtetasit e 88 shteteve që planifikojnë të hyjnë në Republikën e Kosovës. *Departamenti Konsullor* përkatësisht *Divizioni i Vizave* në këtë ministri është përgjegjës për dhënien e vendimit lidhur me miratimin, refuzimin, revokimin ose anulimin e vizës (pas marrjes së rekomandimit nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, DSHAM dhe vlerësimit të lëndës në tërësi). Regjimi i vizave vazhdon të zbatohet me legjislacion të kompletuar dhe sistem funksional të KVIS në 15 misione diplomatike të Kosovës dhe 7 PKK.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e menaxhimit të migrimit

Republika e Kosovës ka avancuar kornizën institucionale me qëllim të arritjes së standardeve ndërkombëtare në fushën e migrimit si dhe përmirësimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Institucionet përgjegjëse për mbikëqyrje dhe zbatim të politikës të migrimit në Republikën e Kosovës janë si në vijim:

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjëse kryesore për parandalimin dhe luftën e migracionit të parregullt nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve, kontrollit të të huajve në procedurat e aplikimit për vize për të hyrë në Republikën e Kosovës, kjo në bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera relevante, të kontrollit kufitar mbi kushtet dhe kritereve për të hyrë, qëndruar dhe

transit në Republikën e Kosovës, për pajisjen e të huajve me leje qëndrimi; për kontrollin e ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit vullnetar, largimit me force, deportimin, ndalimin e të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës apo në vendin transit nga kane ardhur; për zbatimin e Marrëveshjeve për Ripranim me vendet e tjera, si dhe informimin e tyre mbi mundësitë e përfitimit nga programi i riintegritimit në Kosove, për bashkëpunimin rajonale dhe me gjere në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e parregullt, për identifikimin dhe trajtimin e viktimave të trafikuar në bashkëpunim me institucionet tjera.

Strukturat e MPB-së që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë në fushën e migracionit janë: Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migracion (Divizioni për të Huaj, Divizioni për Shtetësi, Divizioni i Azilit, Divizioni për Ripranim dhe Kthim, Divizioni për Planifikim, Strategji dhe Statistika), Departamenti për Ri-integrim e Personave të Riatdhesuar dhe Policia e Kosovës, (Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, Departamenti për Hetimin e Krimin të Organizuar) etj. Po ashtu, është funksionale databaza për menaxhimin e të dhënave të migracionit.

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DShAM) harton politikën, strategjitë, planet e veprimit dhe siguron koordinim të ngushtë me institucionet dhe organizatat tjera përkatëse si dhe zhvillon direktiva administrative, procedurale dhe udhëzime operationale në bashkëpunim me Departamentin Ligjor. Poashtu kontribuon në përpunimin dhe zbatimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e migracionit. Kujdeset për ripranimin e personave që kthehen nga shtetet dërguese, shqyrton dhe vendos për aplikimet për shtetësi dhe vendos rastet e privimit, poashtu edhe për aplikimet për azil dhe mbrojtje ndërkombëtare dhe aplikimet për leje të hyrjes. DSHAM mbikëqyr edhe Qendrën për Azil dhe Qendrën e Mbajtjes për të Huaj, si dhe koordinon dhe bashkëpunon me ministritë dhe komunat përkatëse në lidhje me personat e ripranuar.

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) është përgjegjës për menaxhimin e programit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, koordinon procesin e ri-integritimit në nivelin qendror dhe lokal, përfshirë ofrimin e shërbimeve për riintegrim të qëndrueshëm të shtetasve kosovarë të riatdhesuar. Në kuadër të këtij departamenti funksionon edhe Sistemi për menaxhimin e Rasteve (SMR) në të cilin vendosen të dhënat dhe përcjellen rastet e përfituesve nga Programi për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, i cili funksionon që nga viti 2010. Strukturat vendimmarrëse dhe koordinuese që merren me riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivel qendror dhe lokal janë: Departamenti për Riintegrim në kuadër të MPB-së, Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe Komisionet Komunale për Riintegrim. Po ashtu, funksionon edhe Komisioni për rishqyrtimin e ankesave të personave të riatdhesuar në nivel qendror. Për mëtepe, është funksionalizuar edhe Sistemi për Menaxhimin e Rasteve me qëllim të menaxhimit të çështjeve të riintegritimit.

Policia Kufitare - Është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve kundër migrimit të parregullt dhe trafikimit me njerëz. Policia Kufitare bashkëpunon dhe ndërvepron me organet të cilat kanë kompetencë në çështjet me azil, refugjatë dhe qëndrimin e të huajve, me qëllim të arritjes së kontrollit dhe menaxhimit efektiv të migrimit, si dhe mbikëqyrë pikë kalimet kufitare dhe vijën e gjelbërt dhe blu. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj është përgjegjëse për plotësimin e kërkesës fillestare për azilkërkuesit.

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (PK) - si drejtori e specializuar brënda Policisë Kufitare, është e ngarkuar me trajtimin e qëndrimeve të parregullta brënda Kosovës, kontrollin e hyrjes dhe lëvizjes në Republikën e Kosovës. Kjo Drejtori kryen inspektime të lokacioneve të dyshimta me qëllim të parandalimit dhe identifikimit të 94 Kosovës 22/11/2013 qëndrimeve të parregullta të shtetasve të huaj. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj është përgjegjëse për plotësimin e kërkesës fillestare për azilkërkuesit dhe gjithashtu me ekzekutimin e vendimeve për deportimin e të huajve.

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit (PK)– Si organ i specializuar i Policisë së Kosovës është i ngarkuar me përgjegjësinë e hetimit, arrestimit dhe ndjekjes penale të trafikantëve dhe kryersve të veprave penale të trafikimit me njerëz.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e azilit

Sa i takon kornizës institucionale, si institucion përgjegjës për menaxhimin e fushës së Azilit është *Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim* në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më konkretisht *Divizioni për Azil*. Në kuadër të këtij Departamenti ekziston Qendra për Azilkërkues e cila është funksionale, me kapacitet për të akomoduar deri në 50 azilkërkues. Qendra për Azilkërkues organizon akomodimin, kontrollin mjekësor, ndihmën mjekësore dhe sociale të personave të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Qendra është e tipit të hapur që nënkupton se azilkërkuesit e akomoduar janë të lirë të lëvizin duke respektuar rregullat e brendshme të Qendrës. Qendra në fjalë funksionon 24/7 dhe me kapacitete të plota.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
Institucionet kryesore të përfshira në luftimin e shpëlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit janë:

Njësia e Inteligjencës Financiare e themeluar me Ligjin 03/L-196 si institucion qendror i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me shpëlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit.

Ministria e Financave e cila përmes mekanizmave të saj, Doganës së Kosovës, dhe Administratës Tatimore, përmes ushtrimit të funksionit të tyre të kontrollit të mallrave dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës kontribuojnë në parandalimin, identifikimin, raportimin, hetimin dhe bllokimin e burimeve të financimit të aktiviteteve terroriste dhe shpëlarjes së parave.

Ministria e Punëve të Brendshme, përmes drejtorisë kundër krimeve ekonomike brenda PK, është përgjegjëse për hetimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit ekonomik, përfshirë shpëlarjes e parasë dhe financimit të terrorizmit.

Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike i cili ofron mbështetje administrative dhe funksionale për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për luftimin e krimeve ekonomike 2014-2018.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e luftimit e narkotikëve

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit narkotikëve në Republikën e Kosovës, institucionet kryesore të përfshira në këtë fushë janë:

Ministria e Punëve të Brendshme e cila përmes Policisë së Kosovës si Agjencia për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, ka përgjegjësinë e plotë në luftimin kundër përdorimit, blerjes, posedimit, shitjes, shpërndarjes, importimit, eksportimit, përpunimit, kultivimit, dhe përgatitjes së substancave ose preparateve që janë të shpallura të rrezikshme si droga. Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Drogave është organi përgjegjës brenda PK-së që kryen hetime lidhur me drogat. Drejtoria përbëhet nga 96 zyrtarë që punojnë në ekipe të ndryshme përfshirë Njësinë për Parandalimin dhe Hetimin. Kjo Drejtori mbështetet nga departamente tjera brenda PK-së si dhe agjenci tjera (Doganat, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Inspektorët e Shëndetit, dhe Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Medicinale, Agjencia Kosovare për Forenzikë, Departamenti i Mjekësisë Ligjore etj).

Koordinatori Nacional, i cili është personi përgjegjës mandati i të cilit është të koordinojë, bashkërendojë, monitorojë dhe të raportojë për implementimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me drogat.

Sekretariati i MPB-së Është organ i ri, roli i të cilit është mbledhja e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave – përmes Doganave të Kosovës si agjenci e zbatimit të ligjit, ka rol në kontrollimin e të gjitha mallrave që hyjnë dhe dalin nga Kosova. Dogana e Kosovës për shkak të prezencës kapilare në të gjithë territorin e Kosovës dhe rolit funksional të saj në kontrollimin e mallrave në Kufi është institucion i rëndësishëm e cila bashkë me Policinë e Kosovës bën kontrollimin dhe identifikimin e tregtive dhe transporteve të paligjshme. Strategjia Shtetërore e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Plani Veprues, duhet të përcillet me qëllim të përforsimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të dy organeve kryesore që luftojnë përdorimin, tregtinë, transportin dhe prodhimin e drogave të paligjshme.

Ministria e Drejtësisë përgatit dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë; 2. Koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale; 3. Do të funksionalizoj me kapacitet të plota agjencinë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar, për menaxhim efikas të sendeve të konfiskuar. 4. Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike të shërbimit korrektues për të luftuar të gjitha dukurit negative në burgje duke përfshirë luftën kundër narkotikëve me qëllim të krijimit të një ambienti të sigurt për personat e burgosur. 5. Përmes shërbimit sprovues mbikëqyr ndihmon kryerësit me dënime alternative dhe të varurit nga droga të cilit i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues që zbatohet në liri.

Ministria e Shëndetësisë e cila merr pjesë në parandalimin, trajtimin, rehabilitimin mjekësor të individëve. Këtë e realizon përmes akteve ligjore, strategjive, planeve përkatëse, protokolleve klinike, trajnimeve dhe sigurimit të materialit dhe medikamenteve.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Republikën e Kosovës do të jenë të pavarura, profesionale si dhe të pa anshme. KGJK-po ashtu është kompetent edhe për inspektimin dhe administrimin e gjykatave. *Gjykatat*- Sigurohen që të gjykojnë çështjet penale ndaj personave të akuzuar që merren me trafikim. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të identifikoj gjyqtarët për specializimin e tyre me qëllim të gjykimit të rasteve lidhur me trafikim.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit policor Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës, detyrë dhe përgjegjësi në këtë fushë kanë këto institucione:

Ministria e Punëve të Brendshme ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar. **Policia e Kosovës** si agjenci për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, ka përgjegjësinë e plotë në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar. Policia e Kosovës dhe Dogana, së bashku me institucionet tjera janë akter kyç në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve kriminale jo vetëm në Kufirin e Kosovës por edhe në gjithë territorin e Kosovës. Drejtoritë përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar në kuadër të Policisë së Kosovës janë:

- Drejtoria kundër Krimit të Organizuar
- Drejtoria kundër trafikimit me Narkotik,
- Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
- Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, e cila në kuadër të Divizionit të Hetimeve është e organizuar si në vijim: Sektori i Hetimeve të Krimeve Ekonomike; Sektori i hetimeve të Korrupsioni; dhe Sektori i Hetimeve të Krimeve Financiare;
- Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve
- Njësia kundër Terrorizmit
- Sektori i Hetimeve të Krimeve Kibernetike.

Ministria e Financave, e cila përmes Doganave, Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore ndihmon në parandalimin e qarkullimit ndërkufitarë të mallrave dhe materialeve të cilat kanë për qëllim veprimtaritë që ndërlidhen me të gjitha format e krimit të organizuar.

Ministria e Drejtësisë – e cila angazhohet në forcimin dhe funksionalizimin e sundimit të ligjit, krijon kushte të nevojshme për prokuroritë në parandalimin e krimit dhe harton plane dhe programe për risocializimin dhe ri-integrimin e të burgosurve dhe kryesve me dënime alternative.

Koordinatori Nacional është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me luftën kundër krimit të organizuar.

Sekretariati, që ka për detyrë themelore dhe përgjegjësi për mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera, me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.

Agjencia Kosovare për Inteligjencë mbledh, vlerëson dhe përcjell informacione në lidhje me kërcimet nga aktivitetet kriminale.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme, me qëllim që sistemi gjyqësorë të jetë sa më efikas në luftë kundër krimit të organizuar dhe formave tjera të kriminalitetit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që sistemi prokurorial në Kosovë të jetë i pavarur, i paanshëm dhe profesional në ushtrimin e ndjekjes, hetimit dhe zbulimit të veprave penale dhe të përfaqëson në gjykata aktet akuzuese në emër të shtetit

Prokuroritë dhe Gjykatat janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të kryesve ndëshkimin adekuat të tyre, për konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të aktiviteteve kriminale.

Përveç harmonizimit të legjislationit me Acquis të BE-se dhe forcimit të mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar, prioritet në këtë fushë mbetet ofrimi i rezultateve konkrete në hetimet e të gjitha formave të krimit dukë përfshirë këtu ngritjen e numrit të urdhërave për konfiskimin e përhershëm të asetëve. Prioritet tjetër në këtë fushë mbetet ndërlidhja e bazave të të dhënave të institucioneve të sundimit të ligjit si dhe krijimi i një baze të të dhënave për regjistrat penal si dhe specializimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar në të gjitha fushat e krimit të organizuar. Përkundër faktit se Republika e Kosovës ka pasur rezultate në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, si në shkëmbimin e informatave dhe po ashtu në pjesëmarrjen në hetimet dhe operacione ndërkombëtare të përbashkëta, prioritet në fushën e bashkëpunimit policor vazhdon të mbetet anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të zbatimit të ligjit si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare me shtetët e treta.

Korniza dhe kapacitetet institucionale në fushën e luftës kundër terrorizmit

Institucionet kryesore të përfshira në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit janë:

Ministria e Punëve të Brendshme, e cila përmes mekanizmave të saj, ndihmon në sigurimin e informacioneve si dhe ndërmerr aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste.

Agjencia Kosovare për Inteligjencë, e cila mbledhë, analizon dhe shpërndan informacione me qëllim të parandalimit të aktiviteteve terroriste që zhvillohen në dëm të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe sigurisë globale.

Njësisë së Inteligjencës Financiare e cila është përgjegjëse për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjenpublike të informacionit në lidhje me financimin e terrorizmit.

Ministria e Financave e cila përmes mekanizmave të saj, Doganës së Kosovës, Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore, përmes ushtrimit të funksionit të tyre të kontrollit të mallrave dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës kontribuojnë në parandalimin, identifikimin, raportimin, hetimin dhe bllokimin e burimeve të financimit të aktiviteteve terroriste.

Koordinatori Nacional për luftën kundër terrorizmit, i cili është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me luftën kundër terrorizmit.

Përkundër faktit se Republika e Kosovës ka shënuar rezultate të prekshme në luftën kundër terrorizmit, sfidë mbeten kapacitetet e limituara në luftën kundër terrorizmit, si dhe niveli i pamjaftueshëm i bashkëpunimit me shtetet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së për këtë problematikë. Me qëllim të kompletimit të kornizës së politikave në këtë fushë Republika e Kosovës mbetet të miratojë Strategjinë për parandalimin a radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në të gjitha fushat në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa afatshkurtra*:

Masat afatshkurtra në fushën e menaxhimit të kufirit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa legislative afatshkurtra* në këtë fushë:

- Harmonizimi i pjesshëm i *Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror* me
 - *Rregulloren (BE) nr. 610/2013* të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që amandamenton *Rregulloren (KE) nr. 526/2006* të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që themelon një kod të komunitetit mbi rregullat që drejtojnë lëvizjen e personave nëpër kufij (Kodi i Kufijve Schengen) Konventën që zbaton Marrëveshjen e Schengenit, *Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1693/95* dhe (KE) nr. 539/2001 dhe *Rregulloren (KE) nr. 767/2008* dhe (KE) nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit; dhe
 - *Rregulloren (BE) nr. 1051/2013* të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që amandamenton *Rregulloren (KE) nr. 562/2006* me qëllim që të sigurohen rregulla të përbashkëta mbi rivënien në përdorim të kontrolleve kufitare në kufijtë e brendshëm në rrethana të jashtëzakonshme.
- Miratimi i *UA-së për Kategorizim të PKK-ve* duke e transpozuar në mënyrë të pjesshme *Rregulloren (BE) nr. 610/2013* dhe *Rregulloren (BE) nr. 1051/2013*, të lartcekura.

Korniza e politikave në këtë fushë do të avancohet me:

- Finalizimin e manualit për inspektime kufitare të AUV;
- Hartimin e Doracakut të Praktikave më të Mira në Menaxhimin e Informatave; dhe
- Rishikimi i PSO-ve aktuale dhe përpilimi i PSO-ve të reja në fushën e menaxhimit të kufirit në përgjithësi, e në veçanti në aktivitetet që lidhen me punën e QKMK-së.

Sa i përket *kornizës institucionale* dhe *ngritjes së kapaciteteve* në këtë fushë do të ndërmerren masat si vijojnë:

- Themelimi i Qendrës së Përbashkët tre-laterale Kosovë-Shqipëri-Mal i Zi;
- Themelimi i Njësisë për Analizë dhe Vlerësim të Rrezikut në kuadër të AUV;
- Avancimi i sistemit të BMS dhe ndërlidhja me databazat relevante;
- Rekrutimi i stafit të nevojshëm në QKMK dhe ofrimi i trajnimeve bazike dhe të avancuara në këtë fushë; dhe
- Avancimi i infrastrukturës dhe pajisjeve në QKMK dhe PKK.

Veprimet kryesore *praktike* në këtë fushë janë:

- Sigurimi i kontrollimit të rregullt dhe sistematik i kufirit shtetëror, në përputhje me konceptin e MIK, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar;
- Zbatimi efektiv i planit zhvillimor të QKMK-së, duke përfshirë një komunikim më të qartë të të gjitha niveleve mbi kërkesat e inteligjencës;
- Zbatimi me përpikëri i rregullave dhe procedurave për lëshimin e vizave, që ndërlidhet me politikën e vizave; dhe
- Përmirësimi i sigurisë së dokumenteve, duke siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe legjislacionit vendor.

Masat afatshkurtra në fushën e azilit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa legjislative* afatshkurtra në këtë fushë:

- Harmonizimi i pjesshëm i *Ligjit për Azil* me:
 - *Direktivën e Këshillit 2001/55/KE* mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rast të një fluksi masiv të personave të shpërngulur dhe për masat që promovojnë një balancë të përpjekjeve të Shteteve Anëtare në pranimin e këtyre personave dhe ballafaqimit me pasojat që vijnë nga kjo;
 - *Direktivën e Këshillit 2003/86/KE* mbi të drejtën e bashkimit familjar;
 - *Direktivën 2013/33/BE* e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që cakton standardet e pranimit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare (recast);
 - *Direktivën 2013/32/BE* e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi procedurat për dhënien dhe revokimin e mbrojtjes ndërkombëtare (recast);
 - *Direktivën 2011/95/BE* e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status të përbashkët të refugjatëve dhe personave që plotësojnë kushtet për mbrojtje shtesë, dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë (recast); dhe
 - *Direktivën 2011/51/BE* e Parlamenti Evropian dhe të Këshillit që amandamenton Direktivën e Këshillit 2003/109/KE për të zgjeruar fushëveprimin e saj tek përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare.
- Miratimi i *UA-së për Kushtet e Pranimit dhe Trajtimit Fillestar të Azilkërkuesve* duke transponuar pjesërisht *Direktivën 2013/33/BE* dhe *Direktivën 2013/32/BE*, të lartcekura

Sa i përket *ngritjes së kapaciteteve* në këtë fushë, do të ndërmerren këto masa të përgjithshme:

- Trajnime për personelin mbi identifikimin dhe profilizimin e azilkërkuesve, sidomos të atyre pa dokumente identifikimi, dhe numri i pjesëmarrësve; dhe
- Trajnime të specializuara për gjyqtarët që merren me rastet e azilit.

Këto masa mëtojnë të kenë pastaj ndikim në *zbatim praktik* në mënyrë që të sigurohen kushte të përshtatshme për trajtim të duhur të azilkërkuesve, duke siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe

legjislacionit të transpozuar. (Statistika periodike do të gjenerohen për matjen e efektshmërisë së këtyre masave zbatuese).

Masat afatshkurtra në fushën e menaxhimit të migracionit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa legjislative* afatshkurtra në këtë fushë:

- Harmonizimi i pjesshëm i Ligjit për të Huajt me:
 - Rregulloren (KE) nr. 767/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me Sistemin e Informacionit për Viza (SIV) dhe shkëmbimin e të dhënave në mes të Shteteve Anëtare mbi vizat për qëndrim afatshkurtër (Rregullorja SIV);
 - Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonal; dhe
 - Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimi të shtetasve të vendeve të treta në suaza të transfereve brenda kompanive.
- Miratimi i UA-së për Leje-qëndrimet duke transpozuar në mënyrë të pjesshme Direktivën 2014/36/BE dhe Direktivën 2014/66/BE, të lartcekura.

Korniza e politikave në këtë fushë do të përmirësohet edhe më tej me:

- Hartimin dhe përditësimin e Profilit të Lehtë të Migracionit;
- Hartimin e Rregullores për Integrimin e të Huajve;
- Hartimin e Planit të Veprimit Emergjent për flukse të mëdha të migrantëve;
- Miratimin e Planeve Komunale të Riintegrimit

Sa i përket *kornizës institucionale* dhe *ngritjes së kapaciteteve* në këtë fushë do të ndërmerren këto masa:

- Finalizimi i analizës së mekanizmave për menaxhim të migracionit (me fokus integrimin e të huajve);
- Krijimi i një moduli shtesë për të huajt në kuadër të bazës së të dhënave të DSHAM; dhe
- Kompletimi i stafit të Qendrës për Mbajtjen e të Huajve.

Zbatimi në praktikë për këtë fushë fokusohet në:

- Përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ripranimit;
- Fokusimin në riintegrim të qëndrueshëm të personave të ripranuar;
- Avancimin e bashkëpunimit të autoriteteve në parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt; dhe
- Sigurimin e një procedure efikase për trajtimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Kosovë.

Masat afatshkurtra në luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa legjislative* afatshkurtra në këtë fushë:

- Hartimi dhe miratimi i Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit
- Harmonizimi i Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit me standardet ndërkombëtare të Task forcës për Veprim Financiar (FATF) dhe Direktivën 2015/849/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të *kornizës institucionale* do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorë me anë të trajnimeve të specializuara në fushën e shpëlarjes së parasë dhe krimit financiar dhe financimit të terrorizmit
- Promovimi i procedurave të inteligjencës, hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare
- Ngritja e numrit të urdhrave për konfiskim të përhershëm dhe sekuestrim të aseteve nga ana e gjyqësorit
- Ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në aspektin strategjik dhe operativ ndërmjet autoriteteve rajonale të zbatimit të ligjit me qëllim të luftimit të krimeve financiare
- Anëtarësimi i NJIF-K në Egmont Group

Masat afatshkurtra në luftën kundër narkotikëve

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa legislative* afatshkurtra në këtë fushë:

- *Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë* do të përafrohet me Rregulloren (KE) NR 1258/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 nëntorit 2013 që e amandamenton Rregulloren (KE) e 273/2004 e 11 shkurt 2004 për prekursorë;

Në drejtim të avancimit të *politikave* me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Kryerja e një analize gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale sa i përket transpozimit të *acquis* në këtë fushë (me qëllim të vlerësimit të hollësishëm të gjendjes aktuale dhe përcaktimit të prioriteteve afatmesme në këtë fushe).

Në fushën e *luftës kundër narkotikëve*, Masat zbatuese për vitin 2016 ndahen në masa institucionale, të kornizës së politikave dhe ato të zbatimit në praktikë:

- Zbatimi dhe monitorimi më efektiv i Strategjisë dhe planit të veprimit kundër narkotikëve. ngritja e rezultateve sa i përket konfiskimit dhe hetimeve të suksesshme,
- Emërimi i Koordinatorit të ri Nacional kundër trafikimit me narkotikë
- Themelimi i Observatorit të drogave
- Rritja e numrit të aktakuzave dhe dënimeve për krimet e lidhura me narkotikë
- Avancimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër narkotikëve, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare si EMCDDA, UNODC, etj.

Masat afatshkurtra në fushën e kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimit policor

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, në drejtim të avancimit të *politikave* me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Miratimi i Strategjisë së re nacionale dhe PV për Siguri në Bashkësi 2016-20214.
- Miratimi i Strategjisë së re për kontrollimin dhe mbledhjen e armëve të vogla dhe të lehta 2016-2021
- Hartimi i Manualit të përbashkët për standardizimin e procedurave KPK/PK
- Hartimi i rregullores përmes së cilës rregullohet veprimtaria e komisionerit nacional për mbikëqyrjen e procesit të përgjimeve
- Nënshkrimi i marrëveshjes në mes të agjencive për zbatim të ligjit me qëllim të themelimit e këshillit koordinues për IT i cili përcakton prioritetet në fushën e parandalimit të krimit të organizuar
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim policor me Turqinë
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim policor me Estoninë
- Inicimi i marrëveshjeve për bashkëpunim policor me Italinë, Belgjikën, Danimarkën dhe Lituanië

- Gjetja e modaliteteve të bashkëpunimit me EUROPOL pas qershorit 2016 (pas skadimit të mandatit të EULEX-it)
- Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bilaterale me shtetet e treta
- Fushata vetëdijesuese për parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore

Në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të *kornizës institucionale* do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Emërimi i Komisionerit nacional për mbikëqyrjen e procesit të përgjimeve nga KGJK
- Sigurimi i pajisjeve dhe teknologjisë informative se nevojshme për zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit
- Themelimi dhe funksionalizimi i Njësisë Ndërlidhëse në KPK përfshirë hapësirën, PSO-të relevante, rekrutimin e stafit të nevojshëm, trajnimin e stafit dhe teknologjinë informative si pjesë e zbatimit të ligjit për përgjime.
- Profilizimi i sektorit të hetimeve të krimeve kibernetike dhe plotësimi me personel të kualifikuar
- Ngritja e kapaciteteve teknike, teknologjike dhe logjistike në fushën e mbështetjes së hetimeve;
- Vendosja e përgjimit ligjor të linjave fikse dhe internetit, si dhe fuqizimi i kapaciteteve përgjimit ligjor duke u pajisur me pajisje shtesë të avancuara;
- Zhvillimi i qasjes pro-aktive në luftimin e krimit të organizuar (ngritja e kapaciteteve analitike në DIA, ngritja e numrit të informatave inteligjente, ngritja e bashkëpunimit me komunitetin, bashkëpunimi me OJQ, shoqëri civile,)

Masat afatshkurtra në luftën kundër terrorizmit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, do të zbatohen këto *masa legjislative* afatshkurtra në këtë fushë:

- Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Infrastruktura Kritike, i cili do të përafrohet me direktivën e Këshillit 2008/114/KE e 8 dhjetorit 2008 për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturës kritike dhe nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre

Në drejtim të avancimit të *politikave* me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Përpilimi dhe azhurnimi i listës dhe grupeve terroriste
- Lansimi i fushatës për vetëdijesimin dhe informimin për hyrjen në fuqi të ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;

Masa afatshkurtra në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, në drejtim të avancimit të *politikave* me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të aderimit në BE do të ndërmerren këto masa afatshkurtra:

- Hartimi i Plani Zhvillimor i Ministrisë së Drejtësisë 2012-2016 - me qëllim të realizimit të objektivit kryesor (anëtarësimin në Bashkimin Evropian), parasheh pesë objektivat strategjike, si në vijim:
 - Krijimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i integritimit evropian;
 - Avancimi i mëtejshëm i sistemit të ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar;
 - Sigurimi i parakushteve dhe administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale;
 - Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të mjekësisë ligjore, gjetja dhe identifikimi i personave të zhdukur gjatë luftës dhe hulumtimi i krimeve të luftës;
 - Zhvillimi i kapaciteteve profesionale me qëllim të avancimit të reformave dhe për funksionim më efikas të fushë-veprimtarisë së Ministrisë.

- Nënshkrimi i marrëveshjeve në këtë fushë me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë

Prioritetet afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në fushat në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, fokusi gjatë periudhës 2017-2020 do të jetë në këto prioritetet afatmesme:

Prioritetet afatmesme në fushën e menaxhimit të kufirit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 *prioritete afatmesme* në këtë fushë janë:

- Përcjellja e vazhdueshme e ndryshimeve eventuale të Shengen acquis, si dhe harmonizimi i legjislacionit vendor me ndryshimet përkatëse në këtë fushë;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritete si Frontex, Selec, etj.;
- Hapja e pikë-kalimeve kufitare të reja me vendet fqinje;
- Shtirja e SIVK-ut në misionet tjera diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës; dhe
- Ofrimi i mundësisë së pajisjes me viza në vende ku nuk ka misione diplomatike dhe konsullore përmes ofruesve të jashtëm të shërbimeve.

Prioritetet afatmesme në fushën e azilit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 do të fokusohemi në këto *prioritete afatmesme* në këtë fushë:

- Përcjellja e vazhdueshme e ndryshimeve eventuale të Shengen acquis, si dhe harmonizimi i legjislacionit vendor me ndryshimet përkatëse në këtë fushë;
- Avancimi i mekanizmave për kthimin të azilkërkuesve në vendim e origjinës dhe në kthimin e vendeve të treta të sigurta; dhe
- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm në bashkëpunim me institucionet e tjera të nivelit qendror dhe lokal për azilkërkues që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Prioritetet afatmesme në fushën e menaxhimit të migracionit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 do të fokusohemi në këto *prioritete afatmesme* në këtë fushë:

- Përcjellja e vazhdueshme e ndryshimeve eventuale të Shengen acquis, si dhe harmonizimi i legjislacionit vendor me ndryshimet përkatëse në këtë fushë;
- Hartimi i Profilit të Lehtë dhe të Zgjeruar të Migrimit;
- Fuqizimi i Autoritetit për Monitorimin e lëvizjeve të Migracionit (AQM);
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftimin e migrimit të parregullt; dhe
- Gjithëpërfshirja më efektive e institucioneve relevante të të gjitha niveleve në luftën dhe parandalimin e migrimit të parregullt.

Prioritetet afatmesme në luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 *prioritete afatmesme* në këtë fushë paraqiten në vijim:

- Përafrimi i legjislacionit vendor me acquis të BE-së, duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale sa i përket transpozimit të acquis në fushën e luftës kundër narkotikëve e cila parashihet të përfundojë gjatë vitit 2016.

- Azhurnimi / ndryshimi i Procedurave Standarde të Operimit për të siguruar implementimin e plotë dhe korrekt të Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit dhe proceseve efikase të punës në NjIF-K
- Vlerësimi i II i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- Vlerësimi dhe Implementimi i rrezikut sektorial për sektorët më të ndjeshëm ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare
- Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve të rendit dhe zbatimit të ligjit, me qëllim të forcimit të luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar
- Fuqizimi i mekanizmeve ndër-institucional dhe te inteligjencës në fushën e shpëlarjes së parave, rimëkëmbjen e aseteve, krimit financiar dhe korrupsionit
- Anëtarësimi i Kosovës në Moneyval.

Prioritetet afatmesme në luftimin e narkotikëve

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 *prioritete afatmesme* në këtë fushë janë:

- Harmonizimi i legjislacionit vendor me acquis të BE-së duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale sa i përket transpozimit të acquis në fushën e luftës kundër narkotikëve.
- Miratimi i strategjisë kombëtare kundër narkotikëve bazuar në parimet e e Strategjisë Evropiane Kundër Narkotikëve 2013-2020
- Avancimi i bashkëpunimit me EMCDDA.

Prioritetet afatmesme në luftën kundër krimit të organizuar

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 *prioritete afatmesme* në këtë fushë janë:

- Harmonizimi i legjislacionit vendor me acquis të BE-së duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale sa i përket transpozimit të acquis në fushën e luftës kundër krimit të organizuar
- Krijimi i një baze të të dhënave për regjistrat penal apo një sistem të integruar për menaxhimin e rasteve të tilla;
- Ngritja numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe specializimi i tyre në fushën e krimit të organizuar;
- Vlerësimi në baza vjetore i kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimeve të rënda (SOCTA);
- Funkcionalizimi i plote databazave të agjencive të zbatimit të ligjit si dhe ndërlidhja e tyre;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale në fushën e krimit të organizuar;
- Ngritja e kapaciteteve teknike të laboratorëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, dhe
- Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të Inspektoratit Policor të Kosovës në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit
- Funkcionalizimi i Sistemit Menaxhues Informativ të Lëndëve (SMIL)
- Krijimi i bazës së të dhënave për mbajtjen e evidencës për personat e dënuar

Në drejtim të *zbatimit në praktikë* institucionet përgjegjëse do të fokusohen në:

- Rritjen e numrit të urdhrave për konfiskim të aseteve dhe në përgjithësi përmirësimi i rezultateve në konfiskimin e përhershëm të aseteve të përfituara në mënyrë të paligjshme;
- Zvogëlimin e lëndëve në gjykata/reduktimi lëndëve

Prioritetet afatmesme në luftën kundër terrorizmit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, gjatë periudhës 2017-2020 do të fokusohemi në këto *prioritete afatmesme* në këtë fushë

- Harmonizimi i legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale sa i përket transpozimit të *acquis* në fushën e luftës kundër terrorizmit
- Miratimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorizmit
- Identifikimi, parandalimi, hetimi dhe ndjekja penale e individëve dhe grupeve që kryejnë vepra penale
- Ngritja e kapaciteteve teknike, logjistike dhe teknologjike në fushën e terrorizmit
- Ngritja e numrit të informatave inteligjente të shkëmbyera me shtetet tjera dhe ndërmarrja e hetimeve të përbashkëta

Mbështetja e donatorëve

Ministria e Punëve të Brendshme momentalisht mbështetet nga Komisioni Evropian përmes instrumentit të IPA-së si dhe nga donatorë tjerë bilateral në këto fusha:

Projektet aktuale në kuadër të IPA

Fuqizimi i Menaxhimit efektiv të Migrimit dhe Azilit

Përshkrimi: Mbështetje për institucionet e Kosovës për menaxhimin e flukseve të migrimit dhe azilit nga dhe drejt Kosovës.

Përfituesi: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Diasporës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Periudha: 2015-2017.

Mbështetje të mëtutjeshme për Akademinë e Sigurisë Publike – Faza I & II

Përshkrimi: Mbështetje për ofrimin e cilësisë së lartë të arsimit në fushën e sigurisë publike në Kosovë duke fuqizuar kapacitetet trajnuese të Akademisë Kosovare për Siguri Publike dhe agjencive të sigurisë publike, si dhe duke fuqizuar programin e bachelorit në AKSP.

Përfituesi: AKSP, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencioni për Ushqim dhe Veterinë, Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave, Inspektorati i Policisë së Kosovës.

Periudha: Faza I (2015-2017); Faza II (2018-2020)

Digjitalizimi i librave të regjistrimit civil

Përshkrimi: Krijimi i një arkivë elektronike të kopjeve të skanuara të librave të kthyer nga Serbia me qëllim që ato të jenë të qasshme dhe të kërkueshme në sistemin e gjendjes civile, si dhe të rritjes së cilësisë dhe besueshmërisë së sistemit të gjendjes civile

Përfituesi: Agjencioni i regjistrimit civil

Periudha: 2015-2016

Ngritja e kapaciteteve hetuese në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit

Përshkrimi: Fuqizimi i kapaciteteve hetuese në nivel qendror dhe lokal me qëllim të luftimit efektiv të krimit të organizuar dhe korrupsionit

Përfituesi: Policia e Kosovës, Këshilli prokurorial i Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës

Periudha: 2014-2016

Fuqizimi i institucioneve të Kosovës në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore – Faza I & II

Përshkrimi: Mbështetje në avancimin dhe përmirësimin e luftës kundër trafikimit me njerëz në mënyrë më efektive. Qëllimi specifik i projektit është që të ngritë nivelin e koordinimit dhe zbatimit të masave në

luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Gjithashtu, Faza I e projektit, që pritet të nisët në fillim të vitit 2016, do të mbështesë edhe strehimoret për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore me grante.

Përfituesi: MPB/MPMS

Periudha: Faza I (2016-2018); Faza II (2018-2020)

Mbështetje në luftën kundër krimit financiar/shpëlarjes së parasë

Përshkrimi:Projekti ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të të gjitha institucioneve të zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit financiar dhe konfiskimit e rimëkëmbjen e aseteve.

Përfituesi: MPB/MF

Periudha: 2016-2018

Ngritja e kapaciteteve të shërbimeve forenzike

Përshkrimi:Projekti ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe koordinimit të të gjitha shërbimeve forenzike, përfshirë këtu ngritjet e kapaciteteve në analizën e ADN-se, si dhe mbështetje në fushën e eksplozivëve dhe armeve të zjarrit.

Përfituesi: MPB/MD

Periudha: 2016-2018

Mbështetje për Regjistrimin civil dhe sigurinë e dokumenteve

Përshkrimi:Vazhdimësi e mbështetjes së ofruar deri më tani për Agjencionin e Regjistrimit Civil në nivelin qendror dhe komunal

Përfituesi: MPB/ARC

Periudha: 2016-2019

Mbështetje për reforma në polici në harmoni me standardet e BE-së

Përshkrimi:Ndihmë në implementimin e reformave në polici, duke përfshirë zbatimin e policimit të udhëhequr nga inteligjenca, luftimin e krimit kibernetik, ofrimin e trajnimeve dhe pajisjeve lidhur me teknika të avancuara të hetimit në fushën e trafikimit me narkotike, qenie njerëzore, etj; krijimin e një sistemi të paralizimit të hershem të drogave të reja; adresimin e çështjes së uljes së moshës mesatare në policinë e Kosovës.

Përfituesi: MPB/PK

Periudha: 2016-2019

Misioni BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX) mbështet dhe ndihmon autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, veçanërisht në fushën e policisë, gjyqësorit, dhe doganës. Si mision teknik, EULEX monitoron dhe këshillon autoritetet e Kosovës përderisa i mbetet një numër i kufizuar i përgjegjësive ekzekutive, si në rastin e Zyrës së Prokurorisë Speciale. Detyra e këtij institucioni është të merret me raste sensitive si rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit financiar dhe korrupsionit, si dhe krimit të organizuar.

Ministria e Punëve të Brendshme, përveç mbështetjes së Komisionit Evropian është vazhdimisht përfituese e projekteve të mbështetjes nga ICITAP, që e ndihmon Kosovën në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të gjyqësorit, prokurorisë dhe të sundimit të ligjit për luftimin e krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore, korrupsionit, shpëlarjes së parasë dhe terrorizmit. Programi i ICITAP-it financohet nga Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit në kuadër të Departamentit të Shtetit të SHBA-se.

ICITAP aktualisht mbështet Kosovën me këto programe:

Mbështetje për menaxhmentin ekzekutiv të policisë së Kosovës – ky program ofron këshilla për Drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës lidhur me bashkëpunimin me Policinë e Serbisë, shtrirjen e sundimit

të ligjit në veri të Kosovës, ngritjen e nivelit të profesionalizmit, llogaridhënies dhe integritetit brenda nivelit ekzekutiv dhe të mesëm në polici.

Mbështetje për Ministrinë e punëve të brendshme për përmirësimin e praktikave të menaxhmentit ekzekutiv, si dhe mbështetje për Inspektoratin policor të Kosovës në ngritjen e kapaciteteve për hetimin e krimit dhe korrupsionit dhe për kryerjen e inspektimeve për pajtueshmërinë e performancës.

Mbështetje në fushën e luftimit të trafikimit me njerëz dhe hetimet komplekse kriminale, që ka për qëllim të përmirësoj kapacitete e MPB-së për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe përmirësimin e kapaciteteve të departamentit për hetimin e krimit brenda PK-së, për të kryer hetime të rasteve komplekse duke përdorur teknika moderne hetimore.

ICITAP gjithashtu ofron mbështetje në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit, si dhe në fushën e sigurisë në bashkësi. Për më tepër, MPB përfiton nga mbështetja e ofruar nga UNDP, veçanërisht përmes projektit për minimizimin e rrezikut nga armët e zjarrit dhe eksplozivëve. Gjithashtu, MPB është përfituese e projektit për 'Mbështetje në procesin e integritetit evropian' i cili mbështet departamentin për integrim evropian dhe koordinim të politikave brenda MPB-së lidhur me ngritjen e kapaciteteve të koordinimit në procesin e liberalizimit të vizave. Projekti gjithashtu ofron mbështetje për departamentin për shtetësi, azil dhe migrim, si dhe departamentin për ri-integrim të personave të riatdhesuar

3.26. Kapitulli 25 i *acquis*-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore

Acquis për këtë kapitull nuk kërkon transpozimin e rregullave të BE në rendin ligjor kombëtar por kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë kapacitetet e nevojshme zbatuese për të ndjekur objektivat dhe aktivitetet e BE-së në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik. Kapacitetet e nevojshme zbatuese lidhen me ekzistencën e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen në programet e BE-së për hulumtim dhe inovacion për të lehtësuar integrimin në Zonën Evropiane të Kërkimit (ERA), kontribuimin në Zonën e Bashkimit për Inovacion (IU) dhe Strategjisë Evropë 2020 në përgjithësi.

Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 118 të MSA-së palët duhet të inkurajojnë bashkëpunimin në hulumtime shkencore dhe zhvillimin teknologjik mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë duke marrë parasysh burimet e disponueshme, qasjen adekuate në programet përkatëse duke iu nënshtruar niveleve të përshtatshme të mbrojtjes efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare. Bashkëpunimi duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknik.

Sipas konkluzioneve të DPSA-së 2015, sa i përket *shkencës dhe hulumtimit*, Kosova duhet të rrisë dhe të stimulojë nivelin e pjesëmarrjes në Horizon 2020, duke përfshirë edhe rritjen e numrit të propozimeve aplikimeve.

Në Raportin për Vendin 2015, theksohen kapacitetet e limituara të universiteteve për hulumtime që ndikon negativisht në kualitetin e programeve post-diplomike si dhe në inovacion. Buxheti i vendit për hulumtime vazhdon të mbetet i ulët. Ligji për Veprimtarinë Kërkimore nuk implementohet për shkak të mungesës së fondeve.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Shkenca dhe hulumtimet në Kosovë rregullohen me Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore. Ky ligj ka përfshirë praktikën e mira evropiane të cilat e përkahin hulumtimin shkencor me fokus në zhvillimin ekonomik dhe social. Gjithashtu, ligji posedon dispozita që rregullojnë lidhjen e hulumtimit

shkencor me ekonominë dhe industrinë. Si strukturë përgjegjëse për administrimin e prioritetëve kombëtare të kërkimit është Këshilli Kombëtar i Shkencës, ndërsa Departamenti për Shkencë dhe Teknologji në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është institucioni kryesor për politikëbërje në fushën e shkencës dhe hulumtimeve.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Për zhvillimin e mëtutjeshëm të hulumtimit dhe inovacionit, në zbatim është implementimi i Programit Kornizë për Kërkim Shkencor dhe Inovacion 'Horizon 2020' të Bashkimit Evropian, program ky i cili ofron mbështetje për aktivitete të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Tashmë ekzistojnë pikat e kontaktit nëpër të gjitha fushat në kuadër të këtij programi. Në funksion të pjesëmarrjes në programin Horizon 2020, Kosova ka marrë pjesë në vetëm katër projekte të FP7 në cilësinë e partnerit. Në funksion të rritjes së pjesëmarrjes në këtë program MASHT do të ndajë një buxhet për mbulimin e shpenzimeve të ekspertëve për zhvillimin e projekteve për çdo aplikacion që i plotëson kushtet për aplikim në programin Kornizë. Kosova gjithashtu është pjesë e Strategjisë Evropiane dhe Strategjisë Ballkanike për Inovacion, Hulumtim, Zhvillim.

Masat afatshkurtra

Kosova në sektorin e Shkencës dhe Hulumtimit në periudhën afatshkurtër do të fokusohet në kompletimin e kornizës ligjore. Rrjedhimisht, është duke u punuar në hartimin dhe miratimin e Udhëzimit Administrativ për Licencimin e revistave shkencore dhe Udhëzimit Administrativ për Përsosjen Shkencore të Shkencëtarëve të Rinj. Gjatë kësaj periudhe pritet Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë nga ana e Qeverisë dhe hartimi dhe miratimi Planit Kombëtar të Shkencës 2016-2020. Gjithashtu është planifikuar hartimi i masave shtetërore për specializimin e mençur (smart specialization). Planifikohet edhe forcimi i pikave të kontaktit dhe krijimi i një mekanizmi i cili i ofron informacionet nga pikat e kontaktit tek komuniteti shkencor përkatës.

Prioritetet afatmesme

Në aspektin ligjor, Kosova në periudhën afatmesme do të punojë në hartimin dhe miratimin e Ligjit për Financimin të Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore. Gjithashtu duhet të krijohet një mekanizëm ndërministror i cili do t'a menaxhojë lidhjen ndërmjet inovacionit dhe hulumtimit (lidhja hulumtim-industri dhe ekonomi).

Për ngritjen e kapaciteteve në fushën e inovacionit dhe hulumtimit, synohet vazhdimi i ndarjes së bursave për PhD dhe në këtë mënyrë të bëhet edhe ndërkombëtarizimi përmes hulumtuesve kosovarë në vendet e zhvilluara. në kuadër të këtij synimi, do të bëhet edhe pajisja e institucioneve shkencore me infrastrukturë të nevojshme për hulumtime shkencore.

Gjithashtu gjatë periudhës afatmesme, Kosova shpreson që do të arrijë të marrë statusin e asocuar në Horizon 2020.

3.27. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimit dhe kultura

Fushat e arsimit dhe trajnimit, rinisë, sportit dhe kulturës janë kryesisht kompetencë e Shteteve Anëtare. Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) parashikon që Bashkimi të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe mbështetjen duke plotësuar veprimet e tyre, duke respektuar plotësisht përgjegjësinë e tyre për përmbajtjen e mësimin, organizimin e sistemeve të arsimit dhe trajnimit profesional, dhe diversitetin kulturor kombëtar dhe rajonal.

Acquis për arsim dhe kulturë përbëhet kryesisht nga një kornizë bashkëpunimi, duke përdorur programe dhe metodën e hapur të koordinimit (MHK) për të lëvizur drejt konvergencës së politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit, trajnimit dhe të rinjve, Shtetet Anëtare duhet të kenë kornizën ligjore, administrative dhe financiare, si dhe kapacitetet e nevojshme implementuese në vend për të siguruar menaxhim të shëndoshë, duke përfshirë menaxhimin financiar, të programeve të decentralizuara të BE-së. *Acquis* përmban gjithashtu një Direktivën për edukimin e fëmijëve të punëtorëve emigrantë dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për rastet që lidhen me mosdiskriminimit ndërmjet shtetasve të një shteti anëtar të BE-së dhe një shtetasi tjetër të BE-së.

Objektivat e sistemeve të arsimit dhe trajnimit miratuar në vitin 2001, si dhe procesi i Kopenhagës për trajnim profesional dhe të procesit të Bolonjës për arsimin e lartë, japin udhëzime për përmirësimin e cilësisë së sistemeve të arsimit dhe trajnimit. Programi i punës "Edukimi dhe Trajnimi 2010" dhe korniza strategjike "Edukimi dhe Trajnimi 2020" i integrojnë të gjitha veprimet në nivel evropian, dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së sistemeve të arsimit dhe trajnimit. Objektivat e përbashkëta për politikën rinore të BE-së janë përcaktuar në Strategjinë e BE-së Rinisë (2010-2018) e cila bazohet në një metodë të hapur të koordinimit. Në fushën e sportit, Komunikata e Komisionit e vitit 2011 "Zhvillimi i dimensionit evropian në sport" propozon veprime konkrete për të mbështetur dhe të koordinuar masat e politikave, me qëllim të miratimit të mundshëm të Planit shumëvjeçar të Punës së BE-së për sportin nga Këshilli.

Sa i përket politikës kulturore, Shtetet Anëtare duhet të mbështesin parimet e parashikuara në nenin 167 të TFEU dhe në veçanti, të sigurohen që angazhimet e tyre ndërkombëtare lejojnë zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe instrumenteve që synojnë ruajtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor. Në përputhje me këto parime, Konventa UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore është një element kryesor i *acquis* në fushën e kulturës. Komunikimi Komisioni në Agjendën Evropiane për kulturë në një botë të globalizuar prezantuar një dialog të strukturuar me sektorin e kulturës dhe një metode të hapur të koordinimit, në mënyrë që të zbatohen tri grupe të përbashkëta të objektivave: diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor; kultura si një katalizator për kreativitet; dhe kultura si një komponentë kyçe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kërkesat e MSA-së

Prandaj, neni 107 i MSA-së kërkon bashkëpunimin në mes të palëve me synim të ngritjes së nivelit të arsimit në përgjithësi, arsimin profesional, trajnimit si dhe zhvillimit të politikave për punën e të rinjve në Kosovë me qëllim të zhvillimit të shkathëtësive, punësimit, gjithëpërfshirjes sociale dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë. Një nga prioritetet për sistemin e arsimit të lartë duhet të jetë arritja e standardeve adekuate të cilësisë së institucioneve dhe programeve në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës dhe Deklaratën e saj. Palët duhet të bashkëpunojnë me qëllim të sigurimit që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë është bëhet pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, prejardhjes racore apo etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Gjithashtu nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në Kosovë duhet të adresohen.

Ndërsa neni 108 i MSA-së kërkon bashkëpunimin në mes të palëve duke synuar promovimin e bashkëpunimit kulturor për të rritur kapaciteteve të operatorëve dhe ngritjen e mirëkuptimit ndërmjet individëve dhe minoriteteve. Ky bashkëpunim duhet të mbështesë diversitetin kulturor në vend në bazë të parimeve të Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore.

Bazuar në Raportin për Vëndin 2015, kërkon që të bëhet implementimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe kurrikulës bazë në vend. Duhet të sigurohet funksionimi i pavarur i institucioneve të arsimit të lartë dhe të miratohet një Ligj i ri për Arsimin e Lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Kërkohet edhe fuqizimi i kapaciteteve në fushën e hulumtimit dhe kërkimit përmes reformës së institucioneve të arsimit

të lartë. Raporti gjithashtu vë theks të veçantë në përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet si dhe përmirësimin e qasjes në arsim cilësor për të gjitha grupet e marginalizuara.

Gjendja aktuale

Korniza legislative

Arsimi

Fusha e arsimit të lartë, rregullohet me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë të miratuar në vitin 2011, dhe ky ligj është baza kryesore për organizimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Kosova zyrtarisht nuk i është bashkuar procesit të Bolonjës ende, por aplikimi për pranim formal është dorëzuar në vitin 2014. Baza ligjore harmonizon praktikat aktuale arsimore me prioritetet e deklaratave të Grupit të Bolonjës, sidomos në lidhje me harmonizimin e dispozitave të caktuara të ligjit me Ligjin No. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare dhe Kornizën Kombëtare për Kualifikime, lehtësimin të njohjes së mësimin paraprak dhe kualifikimeve të fituara në vendet tjera përmes qendrës NARIC.

Ligji nr. 04 /L-138 për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës dhe Ligji Nr 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare përbëjnë kornizën kryesore ligjore për rregullimin e arsimit profesional dhe aftësimin e të rriturve në Kosovë. Ligji për arsimin profesional konsiderohet të jetë pjesërisht i harmonizuar me *acquis* (respektivisht Vendimin e Këshillit 63/266/EEC) ndërsa zbatimi i tij bëhet përmes 3 Udhëzimeve administrative që rregullojnë fushën e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur.

Arsimi parashkollor rregullohet me Ligjin nr. 02/L-52 për Edukimin Parashkollor dhe me Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Para-universitar. Tek niveli i arsimit parashkollor është rritur përqindja e fëmijëve të cilët marrin shërbime në edukimin e hershem për moshën 0-5 vjeç, nga 3% sa ishte vlerësuar nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për 2014 në 4%. Kjo përqindje është rritur me hapjen e 120 institucioneve parashkollore private. Ndërsa moshën e fëmijëve 0-6 vjeç të cilët marrin shërbime edukative është 15.48% (në shkallë bruto) e regjistrimit në nivelin e arsimit parashkollor dhe parafillor dhe që përfshinë të gjitha moshat e fëmijëve të nivelit parashkollor.

Çështja e *braktisjes së shkollës* është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 19/2012 për Krijimin dhe Fuqizimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos-Regjistrimit në Arsimin e Obliguar.

Kultura

Legjislacioni që rregullon sferën e kulturës përfshinë Ligjin nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës; Ligjin nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 203/24 për Sport; Ligjin nr. 04/L-056 për Ansablin e Këngëve dhe Valleve Shota; Ligjin nr. 04/L-59 për Filarmoninë, Operën dhe Baletin; Ligjin nr. 2004/22 për Kinematografinë; Ligjin nr. 02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore; Ligjin nr. 04/L-106 për Teatrot.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Sa i përket mekanizmave të jashtëm për sigurim të cilësisë së arsimit të lartë, në vitin 2014 është konfirmuar anëtarësimi i plotë i Kosovës në ENQA (Rrjetin Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë). Kosova zbaton Udhëzimet Standarde të Cilësisë dhe ka adoptuar praktikat e zbatueshme në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Në anën tjetër Agjencia e Akreditimit të Kosovës ka vazhduar vlerësimin e jashtëm të institucioneve dhe programeve. Në vitin 2014 numri i përgjigjeshim i programeve të akredituara ka arritur në 573.

Kosova si rezultat i një marrëveshjeje midis Komisionit Evropian dhe MASHT-it merr pjesë në programin e Bashkimit Evropian për arsim Tempus që nga viti 2003. Programi Tempus, ka kontribuar në vazhdimësi drejtpërdrejtë në zhvillimin e kurrikulave, bashkëpunimin me shoqërinë, menaxhimin e universitetit, trajnimin e mësimitdhënësve si dhe projektet për sigurimin e cilësisë, të cilat mbulojnë pothuaj tërë sektorin e arsimit të lartë në Kosovë. Pasardhës i Tempusit tashmë është programi Erasmus+ i cili zbaton projektet përmes Zyres Erasmus+ për Kosovën. Kjo zyre është e përqendruar në fushën e arsimit të lartë dhe kontribuon në ngritjen e vetëdijes, dukshmërisë, përshtatshmërisë, qëndrueshmërisë, qasjes efektive në dimension ndërkombëtar të Programit Erasmus+. Sfidë aktuale e rritjes së pjesëmarrjes në skemat relevante të Erasmus+ është se institucionet e arsimit të lartë nuk kanë kapacitete adekuate (për shembull themelimi apo konsolidimi i zyrave për bashkëpunim dhe projekteve, mekanizmat e bashkëpunimit në nivel të Fakulteteve) për shkrim të projekteve në adresim të nevojave të zhvillimit të institucioneve dhe programeve të tyre.

Dokumenti bazë strategjik i cili përcakton objektivat zhvillimore në sistemin e Arsimit në Republikën e Kosovës është Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016, i miratuar nga Qeveria e Kosovës. Ky plan strategjik është një dokument strategjik gjithëpërfshirës, i cili përfshinë të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, duke filluar nga niveli para-fillor deri të niveli universitar. Dokumente tjera strategjike në funksion të zhvillimit të arsimit janë: Strategjia e Komunikimit; Strategjia Kundër Braktisjes së Shkollimit; Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit 2009-2018, Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2017-2017 dhe Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017.

Përveç shkollave profesionale janë ngritur 4 qendra të Kompetencës. Sistemi i paraparë me legjislacionin në fuqi për Arsim dhe Aftësim Profesional është 3+1+1 është në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Janë hartuar 142 planprograme mësimore të shtrirë në 17 fusha-sektorë dhe 29 standarde të profesionit dhe është bërë pilotimi i kornizës së kurikulit. Megjithatë, në zhvillimin e aftësimin profesional ka mungesë të bashkëpunimit mes shkollave profesionale dhe bizneseve për realizimin e mësimin praktik.

Është duke vazhduar pilotimi i kurrikulit të Kosovës i filluar në vitin 2014 me 10 shkollat e para pilot për klasa parafillore 1,6,10 dhe në vitin 2014/2015 ka vazhduar edhe me 82 shkolla tjera (gjithsej 92) për klasat parafillore 1,2,6,7,10,11. Në anën tjetër janë trajnuar edukatorët e të gjitha grupeve edukative për implementimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme dhe janë botuar dokumentet plotësuese për ta implementuar këtë dokument. Janë bërë analiza dhe vlerësime për procesin e zbatimit të kurrikulës së re nga Divizioni i Planprogrameve dhe teksteve shkollore i MASHT, nga Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe nga Projekti i Binjakëzimit.

Për të avancuar *menaxhimin e cilësisë në arsimin parauniversitar*, MASHT ka vënë theksin tek udhëzimet e ngritjes së cilësisë së brendshme, zbatimin e mekanizmave për vlerësim të cilësisë së jashtme dhe ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit. Në aspektin e fuqizimit të mekanizmave të jashtëm për matje të cilësisë, MASHT ka realizuar Testin e Arritshmërisë për nxënësit e klasës së nëntë dhe Testin e Maturës Shtetërore. Mirëpo, risi dhe e arritur qenësore këtë vit është pilotimi dhe zbatimi i vlerësimit ndërkombëtar PISA. MASHT i ka dhënë gjithashtu prioritet zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe për modernizimin trajnimit e mësuesve në përputhje me kornizën e re kurikulare të Kosovës.

Sa i përket *arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta*, deri më tani janë funksionalizuar ekipet vlerësuese pedagogjike për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta në 28 komuna, është hartuar udhëzuesi me instrumente të vlerësimit dhe janë trajnuar të gjitha ekipet vlerësuese. Janë trajnuar 2500 mësimitdhënës, zyrtarë të arsimit, drejtorë të shkollave dhe prindër për arsimin gjithëpërfshirës.

Është hartuar programi “Mësimdhënia sipas fushave të aktiviteteve”, program ky për nxënësit që kanë dëmtime të rënda dhe të shumëfishta. Nga muaji shtator 2015 fillon pilotimi i tij në 7 qendra burimore ku janë nxënësit me nevoja të veçanta.

Ka përfunduar programi 3 vjeçar (2013-2015) për aftësimin e 15 asistentëve dhe inspektorëve të gjuhës së shenjave, të cilët janë personat e parë në Kosovë që aftësohen për përdorimin e gjuhës standarde të shenjave. Sa i përket kërkesave të BE-së për pajisjen e shkollave për fëmijët me nevoja të veçanta, 5 qendrat burimore janë pajisur me pajisje të përgjithshme të klasës, pajisje për TIK dhe pajisje sportive. Me të njëjtat janë pajisur edhe 125 shkolla të rregullta, ku nga këto pajisje përfitojnë edhe nxënësit me nevoja të veçanta.

MASHT gjithashtu ka realizuar shumë aktivitete lidhur me *arsimimin e komuniteteve joshqiptare*. MASHT ka nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi me REF (Roma Education Found nga Budapesti) dhe një marrëveshje me VoRAE (Voice of Roma, Ashkali and Egjiptian). Në kuadër të këtyre marrëveshjeve dhe në bashkëpunim ndërmjet MASHT, REF, VORAE, Ambasadës Britaneze, Ambasadës Norvegejeze dhe HEKS, është siguruar përkrahje financiare për nxënësit dhe studentët e këtyre komuniteteve. Si rezultat, vitin e kaluar janë ndarë 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet RAE. Gjithashtu MASHT ka ndarë edhe 33 bursa për studentet e komuniteteve RAE në Universitete Publike. Në kuadër rritjes së përfshirjes së komuniteteve RAE në arsim, janë siguruar edhe 2 tekste shkollore për nxënësit të cilët mësojnë gjuhën romë (Gjuha Rome për klasën 3 dhe klasën 4).

Masa të ndryshme janë ndërmarrë për të *parandaluar braktisjen*, që konsistojnë në dhënien e teksteve falas për nxënësit e arsimit të obliguar (për klasët 1 deri 9), financimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara, lirim nga pagesa e arsimit joformal për rastet sociale, masat afirmative për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas (bursat, krijimi i lehtësive për regjistrim në klasat e 10-ta, mbështetja financiare e qendrave arsimore që ndihmojnë fëmijët në rritjen e performancës së të nxënësve, etj.). Tutje, MASHT angazhohet në ri-integrimin në arsim të rasteve të referuara nga strehimoret dhe qendrat për punë sociale; mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore, etj.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën ka pësuar rënie nga viti në vit. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët numri ka rënë nga 1485 (0.5%) sa ishte në vitin shkollor 2010/2011 në 354 (0,13%) në vitin shkollor 2013/2014. Situata është përmirësuar edhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, ku nga 354 (0,13%) sa ishte në vitin shkollor 2010/11 numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën në vitin shkollor 2013/2014 ka rënë në 354 (0,13%).

Sistemi i menaxhimit të informatave për arsimin (SMIA) ofron të dhënat statistikore për nivelin e arsimit parauniversitar. Sistemi është në proces të plotësimit me të dhëna të reja sa i përket përfshirjes së statistikave demografike dhe atyre financiare. Sistemi pritet të avancohet më tutje dhe të zgjerohet edhe me të dhëna që përfshinë edhe nivelin e arsimit të lartë dhe integrimin e të dhënave nga segmentet tjera të arsimit.

Masat afatshkurtra

Arsimi

Në planin afatshkurtër, sa i përket *sektorit të arsimit* në aspektin ligjor planifikohet të bëhet harmonizimi i Ligjit për Arsim dhe Aftësim Profesional me Direktivën 2005/36/KE për Certifikimin e Kualifikimeve Profesionale -32005L0036 si dhe rishikimi i Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Institucioneve Parashkollore Private. Gjithashtu, parashihet finalizimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë për Sigurinë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar dhe Planin e Veprimit si dhe finalizimin dhe fillimin e zbatimit të Strategjisë për Cilësinë në Arsim. Do të vazhdojë zbatimi i planit të veprimit nga Strategjia ndërministrorë për Shkollat Promovuese të Shëndetit 2009-2018.

Në sektorin e arsimit të lartë parashihet të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe të bëhet harmonizimi i akteve nënligjore të këtij ligji. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe parashikohet të bëhet miratimi i Ligjit për Agjencinë për Provimet Shtetërore.

Në kuadër të *menaxhimit të cilësisë së arsimit parauniversitar* do të bëhet edhe programi bazik për arsim gjithpërfshirës për të gjithë mësimdhënësit. Poashtu planifikohet të bëhet hartimi i standardeve të profesionit dhe planprogrameve sipas kërkesave të tregut të punës si dhe rishikimi i të gjitha kurrikulave ekzistuese dhe lidhja e tyre me tregun e punës.

Për *Arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta* do të bëhet hartimi i një pakoje të materialeve për informimin e prindërve rreth cilësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe shpjegimi i procedurave të regjistrimit. Në këtë kontekst do të bëhet Hartimi i udhëzuesit për mësimdhënësit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në mësimnxenie si dhe finalizimi i formulës së parametrave të financimit për nxënësit me nevoja të veçanta. Gjithashtu do të bëhet zbatimi i planit individual i arsimit nga mësimdhënësit në shkolla të rregullta të cilët kanë nxënës me nevoja të veçanta. Për Qendrat e Kompetencës (në Ferizaj dhe Prizren) do të bëhet hartimi i materialeve për klasën e 12. Do të bëhet edhe pajisja e 3 qendrave burimore (2 në komunën e Mitrovicës dhe 1 në Prishtinë) me pajisje të teknologjisë informative si: kompjuter laptop, tablet PC dhe tabela rrjet internet.

Në kuadër të *arsimit parashkollor*, parashihet të bëhet finalizimi i pilotimit të kurrikulës bërthamë për nivelin e edukimit parashkollor dhe implementimi i dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç.

Ndërsa për parandalimin e *braktisjes së shkollave* do të bëhet themelimi dhe fuqizimi i Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM).

Për *mbështetjen e rinisë* do të bëhet mbështetja financiare për ndërmarrësit e rinj në moshë (nga fondi i themeluar për përkrahjen e ndërmarrësve të rinj, me përkrahje rreth 30% të të rinjëve në hapjen e bizneseve) si dhe rritja e mbështetjes financiare për organizatat rinore, Këshillat e Veprimit për Rini dhe Qendrat Rinore.

Kultura

Në planin afatshkurtër në sektorin e *kulturës* planifikohet të bëhet hartimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturor. Ndërsa në kuadër të avancimit të mëtutjeshëm të institucionit, planifikohet të bëhet rishqyrtimi dhe plotësimi i sistemit të inventarizimit të trashëgimisë kulturore dhe në këtë kuadër të bëhet gjithashtu edhe përmirësimi i kujdesit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.

Prioritetet afatmesme

Arsimi

Për avancimin e *arsimit të lartë* në vend, MASHT do të fokusohet në profilizimin e institucioneve të arsimit të lartë për nevojat e tregut të punës përmes zhvillimit të strategjive të universiteteve. Poashtu, planifikohet të inkurajohet rritja e mobilitetit ndërkombëtar për stafin akademik, studentët dhe hulumtuesit nga Kosova nëpërmjet ofrimit të bursave dhe granteve. Në këtë kontekst duhet të bëhet zbatimi i konceptit të ri financiar për arsimin e lartë. Rrjedhimisht, është shumë e rëndësishme që të bëhet edhe përmirësimi i infrastrukturës akademike dhe kërkimore në institucionet e arsimit të lartë në vend.

Në sektorin e *arsimit parauniversitar* do të bëhet rishikimi i Ligjit për Edukim Parashkollor. Do të bëhet edhe hartimi i strategjisë ndërsektoriale për edukimin në fëmijërinë e hershme. Në këtë aspekt do të vazhdohet me zbatimin e planeve strategjike dhe strategjisë ekzistuese (Plani Strategjik për Arsim 2016-2020; Plani Strategjik për Gjithpërfshirjen e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar 2016-2020, Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar 2016-2020), si dhe do të fillohet me zbatimin e Kurrikulës së re të Arsimit Parauniversitar në të gjitha shkollat në Kosovë.

Për avancimin e mëtutjeshëm të standardeve të profesionit planifikohet të vazhdohet me hartimin e standardeve të reja. Planifikohet që në Komunitet në të cilat nuk ka fare institucione parashkollore publike të bëhet ndërtimi i tyre dhe të bëhet rrjetëzimi i arsimit dhe aftësisimit profesional.

Për mbështetjen e rinisë planifikohet të bëhet ndërtimi i 3 qendrave rinore në Komunat të ndryshme.

Kultura

Në planin afatgjatë në sektorin e kulturës pritet të Miratohet Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme si dhe të bëhet kompletimi i Regjistrimit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Planifikohet gjithashtu edhe rritja e fondeve për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore (historike, kulturore dhe fetare).

3.28. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi

Ky kapitull mbulon politikën mjedisore të BE-së të cilat kanë për qëllim të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Ato janë të bazuara në veprimin preventiv sipas parimit 'ndotësi paguan', për të luftuar dëmin mjedisor në burim, ndarjen e përgjegjësisë dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikën tjera të BE-së. Acquis përfshin mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal dhe sekondar (vlerësimin e ndikimit në mjedis, vlerësimin strategjik mjedisor, cilësinë e ajrit, menaxhimin e mbeturinave, cilësinë e ujit, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rrezikut, kimikatet, ndryshimet klimatike, zhurmën dhe mbrojtjen civile). Pajtueshmëria me acquis kërkon investime të konsiderueshme. Për aplikimin dhe zbatimimin e acquis është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e pajisur mirë - në nivel kombëtar dhe lokal.

Kërkesat e MSA-së

Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit në nenet 115, 116 dhe 117 përcakton bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me BE-në në fushën e Mjedisit, Ndryshimeve Klimatike dhe Mbrojtje Civile si në vijim:

- Neni 115 - Mjedisi: Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në fushën e mjedisit me detyrën shumë të rëndësishme të ndalimit të degradimit të mëtejshëm mjedisor dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Në veçanti, Palët do të krijojnë bashkëpunim, me qëllim të fuqizimit të strukturave dhe procedurave administrative të Kosovës, për të siguruar planifikimin strategjik për çështjet mjedisore dhe koordinimin midis aktorëve relevantë, në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së dhe të përshtatur me acquis të Euratom.
- Neni 116 - Ndryshimet klimatike: Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që të ndihmohet Kosova në zhvillimin e politikave për ndryshime klimatike respektivisht për zbutje (zvogëlim të emetimeve të gazrave serrë) dhe përshtatje ndaj tyre (ndryshimeve klimatike), duke marrë në konsideratë politikën tjera përkatëse ku përfshihen sektorët; energjia, transporti, industria, bujqësia, shëndetësia, arsimiti, etj. Një bashkëpunim i tillë, gjithashtu do të mbështesë përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së mbi ndryshimet klimatike, në veçanti për monitorimin, raportimin dhe verifikimin efektiv të rezultateve, për emetimet e gazrave serrë, si dhe përfshirjen e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar.
- Neni 117 - Mbrojtja civile: Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në përmirësimin e parandalimit, përgatitjes dhe reagimit ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri. Në veçanti bashkëpunimi do të synojë rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes civile, të Kosovës dhe në përafrimin gradual të Kosovës me acquis të BE-së lidhur me menaxhimin e katastrofave.

Kërkesat nga Raporti i KE-së për Kosovën

Nga Raporti i KE-së për Kosovën 2015, në nënpikën 5.2.3 Mjedisi dhe ndryshimet klimatike, vlerësohet se Kosova mbetet në fazë fillestare të harmonizimit me acquis-in në këto fusha. Nuk ka pasur progres në

mjedis dhe ndryshime klimatike, dhe gjatë vitit të ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të përmirësoj cilësinë e monitorimit mjedisor për ajër dhe ujë, si dhe të krijoj planifikim sistematik strategjik për veprimet ndaj ndryshimeve klimatike.

Në aspektin e harmonizimit të legjislacionit me *acquis* si dhe zbatimin e ligjeve ekzistuese duhet te ketë më shumë progres. Për më tepër në aspektin e legjislacionit horizontal, sa i përket vlerësimet të ndikimit mjedisor dhe vlerësimit strategjik mjedisor edhe pse niveli i transpozimit është arritur tërësisht, duhet të zbatohen më mirë, veçanërisht në nivel lokal.

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, kapacitetet e komunave dhe operatoreve sa i përket zbatimit të legjislacionit duhet të fuqizohen, si dhe të shikohen mundësit për të rritur investimet. Në anën tjetër, konceptet e riciklimit dhe rikuperimit duhet te inkorporohen në legjislacionin aktual duke rritë kështu mundësinë për përfshirjen e sektorit privat ne ketë fushë.

Përpjekje të mëdha janë të nevojshme për të integruar veprimet e klimës në të gjitha politikat dhe strategjitë sektoriale përkatëse. Po ashtu, bashkëpunimi i mëtutjeshëm efektiv ndërministror për të mundësuar miratimin dhe zbatimin e politikave të rritjes së ulët të karbonit është i nevojshëm.

Kosova duhet të forcoj kapacitetet e saj administrative në sektorët e mjedisit dhe klimës, si dhe përpjekje më të mëdha janë të nevojshme për të rritur ndërjegjësimin e mëtutjeshëm për çështjet mjedisore.

Kërkesat nga Studimi i Fizibilitetit

Sipas përmbledhjes së përgjithshme të kërkesave në kuadër të Studimit të Fizibilitetit (Pika 3.7.9. **Mjedisi dhe ndryshimet klimatike**), bazuar në MSA, Kosova duhet të forcojë bashkëpunimin e saj me BE-në në luftën kundër përkeqësimit të mjedisit sa i përket cilësisë së ajrit dhe ujit, menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtës së natyrës, monitorimin dhe reduktimin e shkarkimeve industriale, promovimin e eficiencës së energjisë dhe sigurinë në impiantet industriale, mbrojtjen e tokës, klasifikimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve dhe të planifikimit urban.

Kërkesat nga DPSA

Nga konkluzionet e takimeve të DPSA-së, sfidat e identifikuar në sektorin e mjedisit në Kosovë përfshijnë financimin e pamjaftueshëm për projekte të rëndësishme infrastrukturore, mungesën e stafit teknik në nivel qendror dhe lokal, dhe mungesën e vetëdijesimit publik. Kjo e bënë jo të lehtë procesin e implementimit të legjislacionit mjedisor.

Kosova duhet të vendosë sektorin e mjedisit si prioritet në Programin e Qeverisë dhe të shoh mundësitë për stimulime të mjaftueshme ekonomike qasje e cila do të kontribuonte në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik/mjedisor. Për më tepër Institucionet e Qeverisë së Kosovës duhet dukshëm të përmirësojnë koordinimin në fushën e mjedisit duke e pas parasysh që ky sektor është multidimensional.

Gjendja aktuale

Korniza ligjore

Legjislacioni horizontal

Kosova është angazhuar në përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së, në fushën e mjedisit dhe sa i për ketë kornizës ligjore horizontale në direktivat për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Direktiva nr. 2001/42/KE) dhe për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Direktiva nr. 85/337/KEE) dhe Direktiva mbi Pjesëmarrjen e Publikut (Direktiva nr. 2003/35/KE), janë raportuar si të transpozuar tërësisht. Sa i përket Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ajo është transpozuar 100% në Ligjin për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis dhe zbatohet në vend që nga 31 Dhjetor 2010. Ndërsa, Direktiva mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Direktiva mbi Pjesëmarrjen e Publikut janë tërësisht të zbatueshme që nga viti

2011. Megjithatë, lidhur me këtë të fundit (Direktiva mbi Pjesëmarrjen e Publikut) është vlerësuar se transpozimi nuk është bërë në nivel të duhur. Për ta bërë transpozimin e plotë të kësaj direktive këtë vitë MMPH ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 09/2011 për Informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas Ligjit nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i cili transponon pjesërisht Direktivën mbi Pjesëmarrjen e Publikut (2003/35/BE).

Direktiva mbi Themelimin e Infrastrukturës për Informim Hapësinor (INSPIRE Direktiva nr. 2007/2/KE) është duke u transpozuar në Projektligjin për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, i cili do të ofrojë kornizën ligjore për krijimin e infrastrukturës për informimin hapësinor dhe aktualisht është në fazën e draftimit të tij. Përpijekjet e zbatimit të kësaj direktive planifikohen të realizohet gjatë periudhës 2017-2020.

Zbatimi i Direktivës mbi Përgjegjësinë e Mjedisit (Direktiva nr. 2004/35/KE) dhe Direktiva e Krimit Mjedisor (Direktiva nr. 2008/99/KE) janë në fazat e hershme të tyre. Masat e synuara për sigurimin e zbatueshmërisë së plotë të këtyre direktivave janë të planifikuara të realizohen gjatë periudhës 2017-2020. Në anën tjetër, me qëllim të implementimit të legjislacionit të transpozuar të BE-së, MMPH ka të miratuar Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013 – 2022 dhe Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis për vitin 2013-2017, në Qeveri me datën 17.07.2013, Vendimi nr. 05/140.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit horizontal mjedisor është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Masat afatshkurtra

Për harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit, në vitin 2016 planifikohet:

- Hartimi i Ligjit për krijimin e infrastrukturës dhe informatën hapësinore që tranzponon Direktivën 2007/2/KE INSPIRE.

Për zbatimin e legjislacionit do të bëhet edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet mjedisore i të gjitha grupeve të interesit, ndërsa në këtë periudhë nuk paraqitet nevoja për themelimin e strukturave të reja institucionale dhe rekrutimit të stafit të ri por duhet të vazhdohet me trajnimet nga programi i ECRAN-it, për zbatimin e legjislacionit si dhe asistencës teknike nga TAIEX-i. Po ashtu, duhet hulumtuar mundësitë për mbështetje edhe nga donatorët tjerë.

Për ndërmarrjen e aktiviteteve që nevojiten për zbatimin e legjislacionit dhe aktiviteteve nga dokumentet strategjike, buxheti i MMPH për vitin 2015 është rritur për EUR 725,598.00 në krahasim me vitin paraprak. Buxheti për investime/ projekte infrastrukturore për vitin 2016 përafërsisht është rreth 6 milion Euro të dedikuara për çështje mjedisore. Mungesa e një mekanizmi për vjeljen e taksave ekologjike determinon krijimin e një fondi të veçantë për investime në fushën e mjedisit. MMPH është duke shikuar mundësinë që nga taksa ekologjike të siguroj përafërsisht 50% të të hyrave për projekte mjedisore. Krahas buxhetit vendor, sektori i mjedisit përfiton edhe nga ana e donatorëve, çoftë përmes granteve të ndryshe ashtu edhe nga kreditë nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare IFN që operojnë në Kosovë. Me themelimin e Ekofondit do të rriten mundësit për investime më të mëdha në projekte mjedisore.

Gjatë 3 viteve të fundit, niveli i investimeve nga institucionet qendrore në infrastrukturën mjedisore është EUR 9,864,512.79 (EUR 4,716,395.30 në vitin 2009, EUR 3,877,626.14 në vitin 2010 dhe EUR 1,270,491.37 në vitin 2011). Ndarja buxhetore për vitin 2012 ishte EUR 4,265,000.00.

Për periudhën 2009-2012, aktivitetet e mbështetura nga donatorë të huaj arrijnë shumën prej 23,3 milion Euro. Projekte të tjera, të cilat kanë pasur ndikim në mjedis dhe janë zbatuar nga komunat arrijnë shumën prej 42,775,536 Euro.

Prioritetet afatmesme

Në periudhën afat mesme, për harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit, planifikohen të ndryshohen këto ligje:

- Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit nr. 03/L-0225 për Mbrojtjen e Mjedisit i cili do të transpozoi pjesërisht Direktivat nr. 2004/35 EC mbi Përgjegjësinë e Mjedisit dhe 2003/04 EC për qasje në Informacion, rregulloren EC/66/2010 Eko-Etiketa, Rregulloren EC/1221/2009 mbi pjesëmarrjen vullnetare të organizatave për skemat e eko-menaxhimit dhe auditimit - EMAS, si dhe Rregulloren nr. 2011/832/BE EMAS Global;
- Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, për shkak se BE ka nxjerrë Direktivën e re për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis 2014/52/BE (e cila është nxjerrë me plotësim-ndryshimin e Direktivës nr. 2011/92/BE).
- Hartimi i legjislacionit sekondar që del nga Ligji i VNM, në funksion të harmonizimit të mëtutjeshëm të legjislacionit me direktivat e reja të BE (Direktiva nr. 2014/52/BE për VNM);
- Ligji për Inspektoratin i cili do të transpozoi Direktivën nr. 2001/331/KE për inspektimet mjedisore, RMCEI;
- Hartimi i legjislacionit për transpozimin e Direktivës nr. 2004/35/KE mbi përgjegjësitë mjedisore (Environmental Liability Directive);
- Hartimi i legjislacionit për transpozimin e Direktivës nr. 2003/4/KE për Qasje në informacion;
- Hartimi i legjislacionit për transpozimin e Direktivës nr. 66/2010/ Eko-etiketë (Ecolabel); dhe
- Hartimi i legjislacionit për transpozimin e Rregulloreve EC 1221/2009 EMAS dhe 2001/832/BE, EMAS Global.

Po ashtu do të hartohen, katër UA të cilat derivojnë nga Ligji nr. 03/L -025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe transpozojnë Direktivën nr. 2004/35 EC mbi Përgjegjësitë Mjedisore, Direktivën nr. 2003/04 EC për Qasje në Informacion, Direktivën nr. EC/66/2010 Eko-etiketë, Rregullorja EC /1221/2009 EMAS, si dhe 2011/832/BE EMAS Global.

Si masë për zbatimin e prioriteteve afatmesme në këtë periudhë do të bëhet Hartimi i Planit të Veprimit në Mjedis 2017-2021. Ky plan do të përmbajë një numër të madh projektesh të cilat do të ndikojnë në zbatimin e prioriteteve.

Hartimi i legjislacionit do të bëhet me planifikimin vjetor të buxhetit të MMPH, ndërsa buxheti për realizimin e veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit në Mjedis do të planifikohet me KASH dhe mundësia nga përkrahja e donatorëve.

Clësia e ajrit

Për transpozimin e mëtutjeshëm të Direktivës Kornizë të cilësisë së Ajrit nr. 2008/50/KE, Ligji nr. 03/L-160, për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, është në proces të plotësimit dhe ndryshimit edhe pse pjesa me e madhe e Direktivës është transpozuar përmes Udhëzimit Administrativ për Normat e Cilësisë së Ajrit, nr. 02/2011.

Progres i konsiderueshëm është arritur në transpozimin e Direktivës shtesë të IV, për Cilësinë e Ajrit (4th Daughter Directive). Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ nr. 21/2013 për Arsenin, Kadmium, Merkur, Nikel dhe Hidrokarburet Aromatike Policiklike në Ajër ka siguruar pothuajse transpozimin e plotë të kërkesave të Direktivës. E vetmja dispozitë e mbetur për t'u transpozuar ka të bëjë me dënimet për shkeljet e dispozitave përkatëse. Kështu që plani për transpozimin e dispozitave të mbetura do të jetë afatgjatë.

Në fazat fillestare të implementimit është Direktiva nr. 1999/32/KE mbi Përmbajtjen e Sulfurit në Lëndë Djegëse të Lëngëta. Transpozimi kësaj direktive është bërë përmes Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 për Cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, si dhe Ligjit nr. 03/L-138 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 2004/05 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës.

Direktiva e Këshillit të BE, nr. 1999/13/KE, mbi kufizimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme për shkak të përdorimit të tretësve organikë në aktivitete të caktuara dhe instalimet, është vlerësuar si e transpozuar pothuajse tërësisht. Instrumenti kryesor i transpozimit është UA nr. 04/2009 për kontrollin e emisioneve të bashkëdyzimeve organike të avullueshme, gjatë deponimit, mbushjes dhe transportimit të karburanteve, i miratuar nga Qeveria. Sa i përket transpozimit të Fazës së II-të Direktivës, është në fazën e hershme të saj, deri më tani pak definicione janë transpozuar në U. A- të e lartë përmendura.

Shumica e obligimeve të vendosura në Direktivën për Përmbajtjen e Sulfurit në Lëndët Djegëse të Lëngëta, veçse janë të zbatueshme në vend. Në anën tjetër të dhënat e ofruara në Tabelën e Përputhshmërisë (ToC) sugjerojnë atë se legjislacioni vendor është larg nga ajo që mund të konsiderohet si e përafëruar me kërkesat e BE-së.

Zbatueshmëria e Direktivës Faza II VOCs Stacionet e Benzinës është mjaft e avancuar. Tetë (8) terminalët për ruajtjen dhe ngarkimin e benzinës janë identifikuar, por xhiroja e tyre vjetore ende nuk është matur. Për implementimin e këtij legjislacioni është hartuar dhe miratuar Strategjia për Cilësinë e Ajrit për vitin 2013-2022 e cila është aprovuar në Kuvend me datën 19.12. 2013, nr. 04/V-741.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për cilësinë e ajrit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit/ Instituti Hidrometeorologjik me gjithsejtë 9 zyrtarë. Institucionet tjera që ndërlidhen me këtë fushë janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Infrastrukturës (MI), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Integritimit Evropian (MIE).

Masat afatshkurtra

Gjatë vitit 2016, për harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit nga fusha e cilësisë së ajrit janë paraparë masa të cilat do të bëjnë transpozimin e mëtutjeshëm të legjislacionit të BE-së.

Sa i përket legjislacionit primar, në vitin 2016 është paraparë miratimi i plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nr. 03/L-160.

Me ndryshimin e Ligjit të lartpërmendur do të pasoj edhe ndryshimi i legjislacionit sekondar që dalin nga ky ligj, edhe atë:

- UA nr. 06/2007 për Rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes, i cili duhet të rishqyrtohet dhe harmonizohet me Direktivën 2010/75/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- UA për Normat e cilësisë së ajrit nga burimet e lëvizshme, nr. 03/2011- i cili transponon Direktiva nr. 70/220/KEE. Në këtë UA duhet të përfshihen kushtet për kategorinë E6 të automjeteve, e cila nuk është e përfshirë në këtë Udhëzim Administrativ. Po ashtu duhet të shqyrtohen mundësitë për hartimin e legjislacioni për transpozimin e Direktivës nr. 2001/81/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi tavanet kombëtare të emetimeve, për disa ndotës.

Në këtë periudhë planifikuese gjithashtu parashihet përgatitja e Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (PVCA) dhe e Planit Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE).

Objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit të përcaktuara në Strategjinë për Cilësinë e Ajrit, do të realizohen përmes Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit. Qëllimi i këtij Plani është që masat dhe projektet e përcaktuara në këtë dokument të sigurojnë përfitime të rëndësishme në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kosova është anëtare e traktatit të Komunitetit të Energjisë, me të cilin kërkohet përgatitja e Planit Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (NERP). Për përgatitjen e NERP, MMPH duhet të zhvillojë një analizë solide të të dhënave ekzistuese/ dokumenteve për të përcaktuar mënyrën e zvogëlimit të emisioneve, në këtë rast në termocentralet Kosova A (njësia 3, 4, 5) dhe B, në mënyrë që ato rekomandime të reflektohen në NERP. NERP duhet të paraqes qasjet e ndryshme që mund të miratohen dhe që do të ndihmojë Kosovën për të arritur objektivat për zvogëlimin e emetimeve.

Në kuadër të masave për zbatimin e legjislacionit dhe politikave për vitin 2016, do të bëhet matja e emisioneve nga Impiantet me djegie të madhe, të cilat rezultate janë të nevojshme për përgatitjen e Planit Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (NERP) dhe po ashtu inicimin për përgatitjen e Inventarit të emisioneve në ajër. Kjo do të bëhet me projektin “Ekspertët për Kontrollin e ndotjes së ajrit JFY 2015” e mbështetur nga Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA).

Edhe pse në sektorin e ajrit një pjesë e acquis të BE-së është bartë në nivel nacional, zbrastëtitë në kuadër të legjislacionit mbesin të adresohen në të ardhmen, për arsye se në një pjesë të legjislacionit pjesërisht janë transpozuar Direktivat përkatëse dhe po ashtu ka edhe direktiva të cilat janë amandamentuar dhe duhet të transpozohen në legjislacionin vendor, për këtë fushë.

Gjithashtu duhet të përmirësohet monitorimi dhe raportimi mbi cilësinë e ajrit, me numrin e matjeve, pajisjet dhe instalimin e softuerit të përgjithshëm për grumbullimin e të dhënave.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet mjedisore i të gjitha grupeve të interesit gjithashtu do të jetë komponentë për promovimin e rëndësisë së ajrit të pastër.

Për zbatimin e legjislacionit dhe masave të planifikuara me legjislacionin ekzistues nuk parashihet themelimi i institucioneve të reja dhe as riorganizimi i atyre ekzistuese. Por ekziston nevoja për rritjen e numrit të zyrtarëve veçanërisht për pjesën e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe monitorimin e emisioneve.

Duhet të vazhdohet me trajnimet nga programi i ECRAN-it, si dhe ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të IHMK-së për përcjelljen e cilësisë së ajrit dhe emisioneve nga burimet e palëvizshme të ndotjes së ajrit, grumbullimin dhe raportimin sa më të mirë të të dhënave që do të bëhet me mbështetjen e ekspertëve të JICA-s.

Në këtë periudhë do të zhvillohet Projekti i JICA “Ekspertët për Kontrollin e ndotjes së ajrit JFY 2015” me vlerë të përafërt rreth 264,319.00 Euro që do të ketë ndikim të mirë në ngritje të kapaciteteve.

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatmesme nga fusha e mbrojtjes së ajrit do të vazhdohet me amandamentimin e një numri të UA-ve të cilat do vazhdojnë transpozimin e legjislacionit të BE -së, si në vijim:

- UA nr. 02/2011 për Normat e cilësisë së ajrit (Direktiva nr. 2008/50/KE Ambient Air Quality);
- UA nr. 15/2010 për Kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave (Direktiva nr. 2008/50/KE Ambient Air Quality);

- UA. nr. 21/2013 për Arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër. Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (Direktiva nr. 2004/107/KE dhe Regulloren EC 219/2009);
- UA nr. 04/2009 për Kontrollin e emisioneve të bashkëdyzimeve organike të avullueshme gjatë deponimit, zbrajes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve (Direktiva nr. 94/63/KE VOCs petrol); dhe
- Hartimin e aktit ligjor për transpozimin e Direktivës nr. 2009/126/BE Stage II VOCs petrol.
- Në periudhën afatmesme përveç plotësimit të legjislacionit nga kjo fushë, planifikohet fillimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit, krijimi i Inventarit të ndotësve të ajrit dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore.
- Buxheti për kompletimin e legjislacionit hyn në kuadër të planifikimit buxhetor të MMPH, ndërsa buxheti për realizimin e veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit do të parashihen në këtë plan.

Menaxhimi i mbeturinave

Republika e Kosovës ndodhet në fazën e hartimit dhe rishqyrtimit intensiv të legjislacionit për administrim të mbeturinave që mbështetën në direktiva dhe rregullore të BE-së.

Ligji nr. 04/060 për Mbeturinat ka transpozuar shumicën e dispozitave të direktivës përkatëse të mbeturinave Direktiva nr. 2008/98 /KE. Është bërë një progres i mirë në harmonizimin e dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2013 për Vlerat Kufitare të Përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina me Direktivën nr. 91/689/KE për mbeturina të rrezikshme. Gjithashtu Direktiva nr. 86/278/KEE për lymën e ujërave të ndotura është transpozuar në Udhëzimin Administrativ nr. 29/2014 për Menaxhimin e lymit nga trajtimi i ujërave të ndotura. Ndërsa UA nr. 20/2012 për Export, Import dhe Tranzit të mbeturinave ka transpozuar dispozitat nga Rregullorja nr. 1013/2006/KE.

UA nr. 27/2014 për Menaxhimin e mbeturinave nga ambalazhet dhe paketimet është instrumenti kryesor i transpozimit. Transpozimi i dispozitave të mbetura të direktivës, siç janë dy definicione në lidhje me kthimin e energjisë dhe marrëveshjes vullnetare, si dhe kërkesave të Nenit 6 në lidhje me obligimet për publikimin e masave dhe objektivave për kthimin dhe riciklimin planifikohen të bëhen në të ardhmen.

Miratimi i Udhëzimit Administrativ nr. 19/2012 për Menaxhimin e Automjeteve Mbeturinë dhe Komponentët e Tyre, rezulton se ka transpozuar gati tërësisht dispozitat e Direktivës nr. 2000/53/KE për Automjetet Mbeturinë (ELV).

Ndërsa, transpozimi i Direktivës mbi Kufizimet për Substancat e Rrezikshme dhe Direktiva për Mbeturinat nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike janë transpozuar tërësisht përmes miratimit të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike dhe Kufizimin e Përdorimit të Substancave të Rrezikshme në Pajisjet Elektrike dhe Elektronike.

Transpozimi i plotë i Direktivës së Deponive është siguruar përmes legjislacionit primar dhe sekondar, siç janë: Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturinat, UA nr. 15/2012 për Menaxhimin e deponive të mbeturinave, në të cilin plotësisht është transpozuar Direktiva për deponi nr. 1999/31/KE. Ndërsa edhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2010 për Menaxhimin e Mbeturinave Biodegraduese, Udhëzimit Administrativ nr. 01/2009 mbi Kushtet për Përcaktimin e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponive, si dhe UA nr. 09/12 mbi Licencimin e menaxhimin të mbeturinave, janë harmonizuar në mase të mirë me legjislacionin e BE – se për mbeturina.

Për më tepër UA-të tjera të miratuara në fushën e mbeturinave janë:

- UA nr. 15/2012 për Menaxhimin e deponive të mbeturinave (Direktiva e Këshillit nr. 1999/31/KE);
- UA nr. 19/2012 për Menaxhimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre, Ligji për mbeturina nr. 04/L-060 (Direktiva nr. 2000/53/KE ELV);
- UA nr. 20/2012 për Eksport, import dhe tranzit të mbeturinave (Rregullorja 1013/2006);
- UA nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave (Vendimi nr. 2000/532/KE);
- UA nr. 16/2013 për Vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina (Direktiva nr. 2008/98/KE, Rregullorja nr. 1272/2008 (CLP) dhe Direktiva nr. 91/689/KE);
- UA nr. 27/2014 për ambalazhin dhe ambalazhet mbeturinë (Direktiva nr. 94/62/KE);
- UA nr. 25/2014 për Administrimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike (Direktiva nr. 2012/19EU WEEE, dhe Direktiva nr. 2011/65 EU RoHS);
- UA nr. 26/2014 për Mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar, (Direktiva nr. 2006/66EC);
- UA nr. 21/2014 për Menaxhimin e mbeturinave nga Industria ekstraktive dhe minierave (Direktiva nr. 2006/21/KE);
- UA nr. 29/2014 për Menaxhimin e lymit nga trajtimi i ujërave të ndotura (Direktiva nr. 86/278 EEC); dhe
- UA nr. 02/2011 për Administrimin e mbeturinave nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur (Direktiva nr. 2000/55/KE dhe Rregullorja (KE) nr. 1102/2008).

Së fundi me rëndësi të veçantë është edhe transpozimi i Direktivës nr. 2006/21/KE për mbeturinat nga industria ekstraktive dhe minierave, që është bërë në nivel të lartë, në Udhëzimin Administrativ nr. 21/2014 për Menaxhimin e mbeturinave nga Industria ekstraktive dhe minierave.

Tani, për shkak të problemeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave industriale, nga grupet e ndryshme të interesit, kërkohet që me ligj të veçantë të rregullohet kjo fushë dhe të hartohet një Ligj për mbeturinat nga industria ekstraktive dhe minierat.

Për implementimin e këtij legjislacioni, është hartuar dhe miratuar Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave për vitin 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për vitin 2013-2017 është aprovuar në Qeveri me datën 25.10.2013, me Vendim nr. 02/153.

Këto dokumente sugjerojnë që legjislacioni i hartuar për mbeturina të bëhet në harmoni të plotë me legjislacionin e BE- së. Strategjia kombëtare për mbeturina theks të veçantë i jep parimeve për menaxhimin e mbeturinave, të cilat i përshkruan Direktiva e Mbeturinave nr. 98/2008/KE.

Parime bazë që strategjia e fokuson është parimi i menaxhimit të mbeturinave sipas hierarkisë/prioriteteve dhe parimit ndotësi paguan.

Sipas Ligjit për Mbeturina Neni 13, autoriteti kompetent i përcaktuar për administrimin e mbeturinave është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Komunitet e Republikës së Kosovës. Në kuadër të MMPH funksionon Departamenti i mbrojtjes së mjedisit, respektivisht, Divizioni për kemikate dhe mbeturina, si dhe Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit/me gjithsejtë 8 zyrtarë.

Institucionet tjera që përfshihen në forma të ndryshme në sektorin e mbeturinave janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Ministria e Integritimit Evropian (MIE). Ndërsa komunitet sipas Ligjit për Mbeturina janë kompetente për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, mbeturinat vëllimore, mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Masat afatshkurtra

- Në kuadër të legjislacionit sekondar, planifikohet të hartohet ndryshim plotësim i Udhëzimit Administrativ nr. 07/2009 për Administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, i cili transponon Direktivën nr. 87/217/ EEC, dhe Udhëzimit Administrativ për krijimin e sistemit të informimit të mbeturinave (Direktiva kornizë për Mbeturina nr. 2008/98 /KE) si dhe Udhëzimit Administrativ për listën e katgorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës dhe përmbajtjes. - Lista Y (Rregullorja nr. 440/2008/KE dhe Konventa e Baselit për qarkullim ndërkufitar të mbeturinave të rrezikshme).

Gjithashtu gjatë këtij viti, kuadri i politikave për menaxhimin e mbeturinave do të plotësohet me këto masa:

- Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave duke financuar projektet e infrastrukturës dhe furnizimin e pajisjes për trajtimin e mbeturinave, duke e zhvilluar softuerin për sistemin e informimit të menaxhimit të mbeturinave, përgatitjen e Masterplanit për menaxhimin e mbeturinave dhe zhvillimin e ndërgjegjësimit publik përmes fushatave;
- Përmirësimi i qasjes, cilësisë, qëndrueshmërisë financiare të performancës mjedisore të sektorit të menaxhimit të mbeturinave- përmes vlerësimit të sektorit të menaxhimit të mbeturinave, mbledhjes së të dhënave, analizimit të kuadrit ligjor dhe rregullimit institucional, përgatitjes së planit të reformës të menaxhimit të mbeturinave të ngurta, përgatitjes së një inventarit të mbeturinave të rrezikshme dhe vlerësimi i gjendjes së tyre, dhe studimi i parafizibilitetit për deponitë e mbeturinave komunale në Gjilan dhe Dragash;
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet mjedisore i të gjitha grupeve të interesit.

Vështirësi në zbatimin e mirëfilltë të legjislacionit dhe strategjisë në fuqi paraqet mungesa e një metode të përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave, nevoja për zhvillimin e kapaciteteve të menaxhimit të mbeturinave, përfshirë reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin në nivel qendror dhe lokal. Po ashtu Kosova ende nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për ruajtjen ose trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, dhe themelimi i një sistemi informues për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

Kurse sa i përket institucioneve, tani për tani nuk planifikohet të themelohet ndonjë institucion apo organ që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave. Ndryshimet në strukturimin e sektorit janë bërë në vitin e kaluar.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbeturinave, duhet të vazhdohet me trajnimet nga programi ECRAN. Komunitat duhet të përkrahen me seminare dhe trajnime për të ngritur sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunitet e Kosovës, dhe ngritjen e kapaciteteve të këtij niveli për hartimin e Planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave si dhe hartimin e legjislacionit Komunal për përcaktimin e standardeve dhe kushteve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.

Në funksion të implementimit të masave, në përkrahje të donatorëve është duke u realizuar projekti " Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë" i përkrahur nga Programi IPA 2013, dhe WBIF - raundi i VII, në vlerë prej 1,089,800.00 Euro; dhe projekti i financuar nga Banka Botërore (BB) "Vlerësimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave, plani i zhvillimit të sektorit dhe studimi i parafizibilitetit", në vlerë prej: 259,940.00 Euro. Asistenca teknike e përfituar nga KE- përmes programit IPA dhe nga BB do të definojnë nevojën lidhur me projektet për infrastrukturë të mbeturinave.

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatmesme në fushën e mbeturinave prioritet do të jetë hartimi i legjislacionit primar në funksion të harmonizimit të mëtutjeshëm të legjislacionit me direktivat e BE-së. Për vitin 2017

planifikohet hartimi i Ligjit për mbeturinat nga industria ekstraktive dhe minierave (Direktiva nr. 2006/21/KE).

Kurse nga legjislacioni sekondar, gjatë kësaj periudhe janë planifikuar amandamentimi i këtyre UA:

- UA nr. 07/2009 për Administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest (Direktiva nr. 87/217/KEE); dhe
- UA nr. 37/07 për Administrimin e bifenileve dhe trefenileve të polikloruara (Direktiva nr. 96/59/KE).

Me qëllim të zbatimit të legjislacionit, politikave mjedisore dhe përmirësimit të mirëqenies për qytetarët e Kosovës, do ndërmerren këto masa: do të bëhet ndërtimi i objektit për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme, ndërtimi i impiantit për klasifikimin e mbeturinave dhe zgjerimi i transferstacionit të mbeturinave në Ferizaj. Gjithashtu do të bëhet edhe ndërtimi i impiantit për klasifikimin e mbeturinave dhe qendrës për kompostim- Prizren, si dhe ndërtimi i impiantit për klasifikimin e mbeturinave - Pejë.

Për realizimin e masave, me programimin IPA 2014 në kuadër të projektit “Dekomisionimi i Kosovës A” do të përkrahët “Ndërtimi i objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme” në vlerë prej 12 (Dymbëdhjetë) milion Euro.

Cilësia e ujrave

Korniza legjislative e fushës së ujërave është plotësuar në vitin 2013 me miratimin e Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili ka siguruar transpozimin e pjesëshëm të Direktivës nr. 2000/60/KE.

Transpozimi i Direktivës nr. 91/271/KEE për trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane është bërë pjesërisht përmes miratimit të Udhëzimit Administrativ nr. 30/2014 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujor (mbi kërkesat, metodat, parametrat dhe vlerat kufizuese për shkarkim e ujërave të zeza në sistemin kanalizimin publik dhe në mjedisin pritës), e cila siguron transpozimin e definicioneve dhe kërkesave të vendosura në Nenin 5, 12 dhe Aneksin II.

Direktiva 98/83/KE për Cilësinë e Ujit që Synohet të Përdoret për Konsum Njerëzor është transpozuar pjesërisht përmes Udhëzimit Administrativ nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor, e cila ka transpozuar shumicën e dispozitave të direktivës në fjalë.

Përafrimi i legjislacionit vendor më Direktivën nr. 91/676/KE në Lidhje me Mbrojtjen e Ujërave Kundër Ndotjes të Shkaktuar nga Nitratet nga Burimet Bujqësore është në fazat e hershme të saj, me vetëm disa dispozita të transpozuar.

Republika e Kosovës vazhdon të zbatojë Direktivën nr. 98/83/KE për Kualitetin e Ujit që Synohet të Përdoret për Konsum Njerëzor, për të cilën është përgjegjës institucioni kyç, Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.

Direktiva nr. 2007/60/KE mbi Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve të Përmbytjeve është në fazat e hershme të zbatimit të saj. Lidhur më koordinimin dhe zbatimin e kërkesave që rrjedhin nga direktiva në fjalë, si dhe Direktiva nr. 2000/60/KE për Krijimin e një Kornize për Veprimet që duhet të Ndërmarrë Komuniteti Evropian në Fushën e Politikës së Ujërave, koordinimi i aktiviteteve dhe veprimeve përkatëse bëhet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, saktësisht Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, si dhe në këtë proces komunat kontribuojnë në nivel lokal.

Për implementimin e këtij legjislacioni është hartuar drafti final i Strategjisë Shtetërore të Ujërave 2015-2034.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për menaxhimin dhe mbrojtjen e ujërave është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht Departamenti i Ujërave/ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit /me gjithsejtë 30 zyrtarë. Institucionet tjera që kanë të bëjnë me fushën e ujërave janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Integrimit Evropian (MIE), si dhe Zyra e Rregullatorit për ujë dhe kanalizim (ZRRUK).

Masat afatshkurtra

Fusha e ujërave si prioritet afatshkurtër do të plotësohet me hartimin dhe miratimin e 6 Udhëzimeve Administrative:

- Plotësim-ndryshimi i UA për strukturën e pagesave të ujit (Direktiva kornizë për ujërat nr. 2000/60/KE);
- UA për përcaktimin e përmbajtjes, mënyrat dhe procedurat e programit për mbrojtjen e veprimeve të dëmshme të ujërave (Direktiva nr. 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime);
- UA mbi mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike (Direktiva nr. 2000/60/KE);
- UA për klasifikimin e trupave ujqorë sipërfaqësorë (Direktiva nr. 2000/60/KE);
- UA për kriteret për zona për larje (Direktiva nr. 2006/7/KE për ujërat larëse); dhe
- UA për klasifikimin e trupave ujqorë nëntokësorë (Direktiva nr. 2006/118/KE për ujërat nëntokësorë).

Si aktivitete implementuese, nga fusha e ujërave do të përcaktohen tarifat për shfrytëzimin e ujërave, shkarkimin e ujërave, inerteve dhe koncesioneve; do të përcaktohen kriteret: për prurjen e pranueshme ekologjike; për klasifikimin e trupave ujqore sipërfaqësorë; për definimin e zonave larëse; dhe për klasifikimin e trupave ujqore nëntokësore.

Kuadri i politikave/ programeve mjedisore do të plotësohet gjatë vitit 2016 me:

- Programin për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave.

Për zbatimin e masave planifikuese për përmirësimin e gjendjes në këtë sektor, mosmiratimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra (SSHU) paraqitet si mangësi e vërtetë. Po ashtu kostoja e lartë financiare për implementimin e SSHU mund të paraqes një sfidë në periudhën e ardhshme në sektorin e ujërave. Gjithashtu mos kompletimi i kornizës legjislative me legjislacion sekondar që rrjedhin nga Ligji i Ujërave nr. 04/L-147, me të cilin do të bëhej transpozimi i mëtutjeshëm i Direktivës për Ujëra (2000/60/KE) dhe direktivave tjera paraqet një mangësi. Monitorimi jo në shkallën e duhur (i pjesshëm) i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë (i mangët) nga ana e AKMM –së, respektivisht IHMK-së në vijimësi është duke paraqitur pengesa në planifikimet afatgjatë dhe njohjen me sasinë e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Sa i takon monitorimit të plotë të ujit të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor i aprovuar në dhjetor 2012 mbetet sfidë themelimi i Qendrës për Ujë të Pijshëm për shkak të mungesës së buxhetit.

Në kuadër të reformave institucionale dhe fuqizimit të kapaciteteve institucionale, si kërkesë nga legjislacioni në fuqi planifikohet themelimi:

- Themelimi i autoritetit të rajonit të pellgjeve lumore,
- Themelimi i Institutit për Ujëra.

Për arritje të objektivave në këtë sektor, duhet të vazhdohet me trajnimet nga programi ECRAN për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet e ujërave i të gjitha grupeve të interesit. Stafi i sektorit të ujërave në vazhdimësi është pjesëmarrës i takimeve të organizuara nga

ECRAN në të cilat diskutohet rreth implementimit të direktivave të BE-së sa i takon fushës së mjedisit në përgjithësi dhe në veçanti resurseve ujore (DKU 2000/60 EC etj).

Në këtë sektor aktualisht nuk ka ndonjë përkrahje nga donatorët.

Prioritetet afatmesme

Në fushën e ujërave në periudhën afatmesme, kuadri ligjor sekondar do të plotësohet edhe me këto UA:

- UA për Përcaktimin e masave dhe veprimeve për mbrojtje nga erozioni (kornizën afatmesme legjislativë 2017-2020, ndërlidhet me Direktivën për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime (2007/60/KE)
- UA për Strukturën e pagesave të ujit e cila lidhet Direktiva kornizë për ujërat nr. 2000/60/KE;
- UA për përcaktimin e përmbajtjes, mënyrat dhe procedurat e programit për mbrojtjen veprimeve të dëmshme të ujërave (Direktiva për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime nr. 2007/60/KE);
- UA mbi mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike (Direktiva kornizë për ujërat nr. 2000/60/KE);
- UA për klasifikimin e trupave ujorë sipërfaqësorë (Direktiva kornizë për ujërat 2000/60/KE);
- UA për klasifikimin e trupave ujorë nëntokësorë (Direktiva për ujërat nëntokësorë nr. 2006/118/KE); dhe
- UA për Kriteret për zona për larje (Direktiva për ujërat larëse nr. 2006/7/KE).

Gjerë në vitin 2020 në këtë sektor, për zbatimin e legjislacionit do të ndermirren këto masa:

- Identifikimi dhe përcaktimi i zonave (hapësirave/sipërfaqeve) vërshuese (kjo masë implementon Direktivën për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime nr. 2007/60/KE);
- Hartimi i një metodologjie për kompensimin e dëmeve që ndodhin për efekt të vërshimeve (kjo masë implementon Direktivën për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime nr. 2007/60/KE);
- Përcaktimi i trupave ujorë sipas kriterëve të klasifikimit UA -së (masa i reflekton në implementimin e Direktivës për ujërat nëntokësorë nr. 2006/118/KE);
- Identifikimi dhe përcaktimi i zonave potenciale për larje (bazuar në kriteret) (masa i reflekton në implementimin e Direktivës për ujërat larëse nr. 2006/7/KE).

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit, gjithashtu në këtë periudhë, do të përgatiten edhe këto dokumente strategjike:

- Plani për menaxhimin e pellgjeve lumore,
- Programi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe
- Ndërtimi i infrastrukturës për ujërat e zeza.

Në kuadër të reformave institucionale dhe fuqizimit të kapaciteteve institucionale, si kërkesë nga legjislacioni në fuqi planifikohet themelimi i sektorit për vlerësimin ekologjik të ujërave sipërfaqësorë në kuadër të AKMM-IHMK.

Si masa zbatuese parashihen:

- Hartimi i regjistrit për zonat e mbrojtura ujore (Ibër, Morava e Binçës) (formati i regjistrit do të punohet në programin kompjuterik Excel ose Access i integruar me programin GIS, gjithashtu i disponueshëm edhe për web faqen e institucionit për shërbime të publikut. Përkrahë implementimin e shtojcës IV të Direktivës Kornizë të Ujërave, faqe 41.).
- Avancimi i rrjetit për monitorimin e ujërave nëntokësorë (pretendohet që brenda kësaj mase të realizohen 20 shpime hidrogeologjike në basenin e Dukagjinit dhe sipas standardeve teknike të konstruohen 20 piezometrave për monitorimin e ujërave nëntokësore);

- Përpunimi dhe raportimi i të dhënave (kjo masë do të arrihet përmes metodologjive të referueshme për përpunim statistikore të të dhënave të matura, ndërsa raportimi do të nënshtrohet standardeve, modeleve dhe praktikave të aplikueshme në vendet e BE-së apo rajonit);
- Ndërtimi i fabrikës (impianitit) për trajtimin e ujërave të ndotura (zeza) në Prizren. (Këto masa kanë ndikim direkt në përmirësimin e statusit/gjendjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Ndërtimi i këtyre impianteve reflekton me pozitivitet në arrijtjen e objektivave mjedisore për sa i takon mbrojtjes së resurseve ujore dhe biodiversitetit në ujë rrjedha. Po ashtu kontribuojnë dhe përkrahin implementimin e direktivave për sa i takon cilësisë së ujërave sipërfaqësorë, favorizon përdorimin e ujërave në sektorin bujqësor dhe industrial (procese teknologjike /ftohje, larje etj.). Trajtimi i ujërave të ndotura (zeza) minimizon shkallën e ndotjes akuiferëve aluvial nëntokësorë, duke pasur përsyshë se ky tip akuiferi (horizontin ujëmbajtës) ka shkallë të dyanshme të komunikimit hidraulik (Lumi ushqen akuiferin dhe anasjelltas).

Këto aktivitete do të planifikohen në përputhje me parashikimet buxhetore të cilat do të planifikohen për një periudhë tri vjeçare me Korniza Afat Mesme të Shpenzimeve dhe do të shihet mundësia e përkrahjes nga donatorët.

Mbrojtja e natyrës

Deri më tani Kosova ka nënshkruar Rezolutën për zhvillimin e Qëndrueshëm të Regjionit të Harkut Dinarik (Resolution on the Sustainable Development of the Dinaric Arc Region, (09.03.2011 Kranj, Sloveni) dhe Marrëveshjen mes shteteve të rajonit Dinarik për ruajtjen më të mirë të natyrës në kuadër të Regjionit të Harkut Dinarik, (02.10.2013 në Budvë, Mali i Zi).

Në legjislacionin për natyrën janë transpozuar Direktivat në vijim:

- Direktiva nr. 2009/147/KE e 30 nëntorit 2009 "Për ruajtjen e zogjve të egër" e ndryshuar me Direktivën nr. 2013/17/BE;
- Direktiva e Këshillit nr. 92/43/KEE e 21 majit 1992 "Për ruajtjen e vendbanimeve natyrore, florës dhe faunës së egër", e ndryshuar me Direktivën nr. 97/62/KE, Direktivën nr. 2006/105/KE dhe Rregulloren (KE) nr. 1882/2003;
- Direktiva e Këshillit nr. 1999/22/KE e 29 marsit 1999 lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike;
- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 338/97 e 9 Dhjetorit 1996 për mbrojtjen e llojeve të florës dhe faunës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre, me amendamentet;
- Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3254/91 e 4 nëntorit 1991 që ndalon përdorimin e kurtheve në Komunitet dhe futjen në Komunitet të gëzofit dhe prodhimeve të disa llojeve të faunës së egër me origjinë nga vendet që i kapin ato duke përdorur metodat e kurtheve që nuk plotësojnë standardet humane ndërkombëtare të kapjes;
- Rregullore (BE) nr. 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton obligimet e operatorëve të cilët qesin drurin dhe prodhimet e drurit në treg;
- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 2173/2005 e 20 Dhjetor 2005 mbi krijimin e një skeme të licencimit FLEGT për importet e lëndës drusore në Komunitetin Evropian;
- Direktiva nr. 83/129/KEE e 28 marsit 1983 lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve që dalin prej tyre; dhe
- Rregullore e Këshillit nr. 348/81/KEE e 20 Janarit 1981 për rregullat e përbashkëta për importin e balenave dhe produkteve të tjera të cetaceve dhe amendamentet.

Direktivat e përmendura me sipër në masë të ndryshme janë transpozuar përmes Ligjit nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjit nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Ligjit nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri", Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës me ndryshimet dhe plotësimet

2004/29 dhe 2010/03-L-153; Ligjit nr. 2006/41 për Gjuetinë si dhe akteve nënligjore që dalin nga këto ligje, si në vijim:

- UA nr. 12/2011 për llojet e vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore, transponon Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE;
- UA nr. 01/2012 për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shënimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim, transponon Direktivën e Këshillit nr. 1999/22/KE;
- UA nr. 16/2012 për vendkalimet shtazëve të egra, transponon Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE;
- UA nr. 18/2012 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura, transponon Direktivën nr. 2009/147/KE;
- UA nr. 26/2012 për qarkullimin dhe tregtinë ndërkuftare me llojet e egra të mbrojtura, mundëson zbatimin e Rregullores e Këshillit (KE) nr. 338/97;
- UA nr. 14/2013 për mënyrën e hartimit dhe zbatimit të studimit për vlerësimin e rrezikut nga futja, ri-futja dhe kultivimi i llojeve të egra, transponon Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE;
- UA nr. 19/2013 për vlerësimin e pranueshmërisë së planit, programit ose ndërhyrjes në rrjetën ekologjike, transponon Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE;
- UA nr. 03/156 për Shpalljen e Rrjetit ekologjik, transponon Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE;
- UA nr. 02/2015 për lejimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, transponon Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE;
- Vendimi nr. 01/178 për shpalljen nën mbrojtje të Ligatinës së Hencit/Radevës si Zonë e Veçantë e Mbrojtur për zogjtë;
- Vendimi nr. 5034/14 për shpalljen nën mbrojtje të racës së Gjelit Kosovar Këndim gjatë lloj vendor i zbutur;
- Vendimi nr. 5035/14 për shpalljen nën mbrojtje të racës së qenit Deltari Ilir lloj vendor i zbutur; dhe
- Vendimi nr. 514/15 për Miratimin e Listës së Kuqe të Florës Vaskulare të Kosovës.

Transpozimi i plotë i Direktivave relevante për mbrojtjen e natyrës në legjislacionin kombëtar është gati i arritur. Pjesa e mbetur e dispozitave do arrihet gradualisht krahas me progresin në anëtarësimin e Kosovës në BE. Direktiva “Për ruajtjen e zogjve të egër” është transpozuar në shkallë 97% dhe atë në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjin për Gjuetinë, UA për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura dhe Vendimi për shpalljen nën mbrojtje të Ligatinës së Hencit/Radevës si Zonë e Veçantë e Mbrojtur për zogjtë.

Për sa i përket Direktivës për ruajtjen e vendbanimeve natyrore, florës dhe faunës së egër, dispozitat e kësaj Direktive janë transpozuar në tërësi 100% dhe atë me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe UA për llojet e vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore.

Sa i përket Direktivës lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike transpozimi në legjislacionin kombëtar është 80% përmes Ligjit për Mbrojtjen e natyrës dhe UA për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim.

Kuadri strategjik për mbrojtjen e natyrës në Republikën e Kosovës përbëhet nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020; Strategjia e Pyjeve 2010-2020; Strategjia Kombëtare për sektorin e produkteve pyjore jo drurore 2014-2020 dhe Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë.

Direktiva e Zogjve të Egër dhe Direktiva e Vendbanimeve janë transpozuar plotësisht. Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233 dhe UA për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të

mbrojtura nr. 18/2012 kanë siguruar harmonizimin e kornizës ligjore kombëtare me kërkesat e këtyre dy Direktivave.

Transpozimi i Direktivës është siguruar me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233 dhe UA nr. 14/2012 për Kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës, janë hartuar dokumentet strategjike:

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 - 2020 është miratuar në Kuvend me datën 10.10.2011;
- Strategjia e Pyjeve 2010-2020, e miratuar në 2010;
- Strategjia Kombëtare për sektorin e produkteve pyjore jo drurore 2014-2020, e miratuar në 2014; dhe
- Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë, e miratuar në 2012.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për mbrojtjen e natyrës është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht departamenti i mbrojtjes së mjedisit, divizioni për mbrojtjen e natyrës, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit /me gjithsejtë 15 zyrtarë. Institucionet tjera që kanë të bëjnë me fushën e natyrës janë kryesisht: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Integritimit Evropian (MIE) dhe Kuvendet Komunale (KK) të cilat në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peisazhore, secila për sferën vetanake të përgjegjësive.

Masat afatshkurtra

Në vitin 2016, në fushën e mbrojtjes së natyrës do të bëhet plotësimi i kuadrit të politikave, gjegjësisht programeve mjedisore si në vijim me:

- Miratimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", dhe
- Miratimi i Planit të Veprimit për Biodiverzitetin 2016 - 2020.

Gjithashtu, në kuadër të mbrojtjes së natyrës, gjatë vitit 2016 do të ndërmerren këto masa:

- Përgatitja për themelimin e rrjetit të zonave NATURA 2000;
- Përgatitja e Vlerësimit mbi statusin e zbatimit dhe identifikimit të hapave për themelimin e Rrjetit NATURA 2000 në Kosovë;
- Inventarizimi i llojeve të bimëve, shtazëve tipave të vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre, për vitin 2016 me KASH janë planifikuar 534,330.00 € nga Buxheti i Kosovës; dhe
- Kopshti Botanik në Prishtinë, për të cilin për vitin 2016 me KASH janë planifikuar 40,000.00 € nga Buxheti i Kosovës.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet që kanë të bëjnë me rendësin e mbrojtjes dhe ruajtjes së biodiversitetit do të realizohet me të gjitha grupet e interesit.

Edhe pse transpozimi i Direktivës së Vendbanimeve nr. 92/43/KEE pothuajse ka përfunduar (ekziston Korniza ligjore solide), zbatimi në praktikë nuk ka filluar ende për shkak të kapacitetit të dobët për zbatim të institucioneve kyçe ekzekutive.

Për shkak të mungesës së mbështetjes financiare, vlerësimi gjithëpërfshirës në nivel kombëtar të ekzistencës dhe lokacioneve që strehojnë llojet e vendbanimeve natyrore të listuara në Aneksin I të

Direktivës së Vendbanimeve dhe llojet e listuara në Aneksin II, që janë autoktone në territorin kombëtar nuk është përfunduar.

Aktualisht, struktura institucionale dhe humane për zbatimin e legjislacionit dhe masave në këtë sektor është e kompletuar në njëfarë mase dhe nevojitet ndërtimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Prioritetet afatmesme

Në periudhën afatmesme, Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës i cili transponon në masë të madhe Direktivat relevante dhe mundëson zbatimin e Rregulloreve të Këshillit do të ketë një amendamentim gjatë kësaj periudhe. Me amendamentim do të arrihet harmonizimi i plotë me Legjislacionin e BE-së.

Gjithashtu në këtë periudhë do të amendamentohen edhe Ligji nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Ligji nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri".

Nga legjislacioni sekondar për periudhën afatmesme janë planifikuar:

- Nxjerrja e Vendimeve për shpalljen ose ri-shpalljen e Rezervateve strikte natyrore sipas Ligjit në fuqi, dhe
- Nxjerrja e Akteve ligjore bazuar në iniciativat e reja nga institucionet kompetente për iniciimin e shpalljes së zonave të reja të mbrojtura.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës në periudhën afatmesme për zbatimin e legjislacionit në fuqi, do të bëhen:

- Inventarizimi i vendbanimeve natyrore me qëllim të zbatimit të NATURA 2000;
- Miratimi i Librit të Kuq i Faunës së Kosovës;
- Identifikimi i regjioneve biogeografike;
- Emërimi i Grupit Koordinues për themelimin e rrjetit kombëtar të zonave NATURA 2000; dhe
- Hartimi i Planit të Menaxhimit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

Sipas KASH-it 2017–2020 është bërë vlerësimi i planifikimit për mjetet për zbatimin e dy projekteve: inventarizimi i llojeve të bimëve, shtazëve tipave të vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre, ku për vitin 2017 me KASH janë planifikuar 414,330.00 Euro nga Buxheti i Kosovës, dhe për Kopshtin Botanik në Prishtinë për vitin 2017 me KASH janë planifikuar 200,000.00 Euro nga Buxheti i Kosovës.

Kontrolli i ndotjes industriale

Transpozimi i Direktivës nr. 2010/75/KE për Emisionet Industriale, në legjislacionin e Kosovës është mjaft i avancuar, i cili është vlerësuar me notë transpozuese prej 69%. Dispozitat e Ligjit nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, UA nr. 06/2007 mbi Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Palëvizshme të Ndotjes, Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturinën, janë identifikuar si instrumente kryesore të transpozimit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është autoriteti përgjegjës për transpozimin dhe implementimin e kësaj Direktive.

MMPH ka identifikuar 30 instalime të cilat duhet të pajisen me LMI, në bazë të Ligjit nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes. MMPH ka ende punë për të bërë në kompletimin dhe vlerësimin e të gjitha instalimeve, për të cilat zbatohet ky ligj respektivisht kjo direktivë.

Sa i përket inspektimit mjedisor ky autoritet është krijuar dhe është operacional. Inspektorati i Mjedisit siguron dhe kontrollon përputhshmërinë e operatorëve me kushtet e LMI.

Miratimi i UA nr. 10/2011 për Pengimin e Aksidenteve të Mëdha ku Përfshihen Substancat e Rrezikshme ka siguruar përputhje të pjesshme me kërkesat e Direktivës SEVESO III (Direktiva 2012/18/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 4 korrik 2012 për Kontrollin e Rreziqeve të Mëdha-Aksidenteve ku Përfshihen Substancat e Rrezikshme).

UA nr. 06/2007 mbi Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Palëvizshme të Ndotjes ka siguruar transpozimin e disa dispozitave të Direktivës (Direktiva nr. 2004/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 21 prillit 2004 mbi kufizimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme për shkak të përdorimit të tretësve organikë në ngjyra të caktuara dhe llaqe dhe produkteve për përfundim të automjeteve).

Për implementimin e Ligjit nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes fillimisht është hartuar legjislacioni sekondar si me poshtë:

- UA për Procedurat e zhvillimit dhe miratimit të dokumenteve të referimit për teknikat më të mira të mundshme;
- UA për Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje të integruar;
- UA për Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të lejeve të integruara; dhe
- UA për Kushtet e lejes për llojet specifike të operimeve dhe impianteve.

Me përkrahje nga BE gjatë zhvillimit të projektit të binjakëzimit, për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, është trajnuar stafi i MMPH për krijimin dhe implementimin e sistemit për procesin e lëshuarjes së LMI.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për kontrollin e ndotjes industriale është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit, respektivisht Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotjes Industriale me asistencë të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit/me gjithsejtë 15-20 zyrtarë. Institucionet tjera që sipas nevojës, ndërliidhen me këtë fushë janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Operatorët Industrial, etj.

Masat afatshkurtra

Për të bërë transpozimin e mëtutjeshëm të Direktivës nr. 2010/75/KE, për Emisionet Industriale, në vitin 2016 planifikohet:

- UA nr. 06/2007 për Rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes i cili del nga Ligji i për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, pasi që ky UA përfshinë disa kapituj të Direktivës së lartpërmendur, siç është cekur në kapitullin – Cilësia e ajrit.

Kurse në kuadër të masave për zbatimin e legjislacionit dhe politikave mjedisore, për vitin 2016 do të bëhet matja e emisioneve nga Impiantet me djegie të madhe të cilat rezultate janë të nevojshme për përgatitjen e Planit Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve, i cili do të miratohet gjatë vitit 2016.

Po ashtu edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet mbrojtjes nga ndotja industriale planifikohet, për të gjitha grupet e interesit, e cila do të bëhet përmes organizimit të tryezave punuese, seminareve, etj.

Gjatë zbatimit të sistemit të procesit të lëshuarjes së LMI është vlerësuar shumë e rëndësishme që të forcohet edhe më shumë bashkëpunimi në mes të zyrtarëve përgjegjës për shqyrtimin e aplikacioneve për LMI dhe inspektoratit për mjedis.

Për zbatimin e legjislacionit të lartpërmendur, në këtë periudhë planifikuese nuk ka nevojë të themelohen institucione, organe tjera apo riorganizim të atyre ekzistuese.

Për forcimin e kapaciteteve njerëzore nga kjo fushë, planifikohet që të shfrytëzohen trajnimet e organizuara nga projekti ECRAN dhe projekti i JICA (i cili është përmend në kapitullin për Cilësinë e ajrit. Gjithsesi do të hulumtohen edhe mundësi tjera për mbështetje me ekspertë nga donatorë të tjerë). Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës për kontrollin e ndotjes së ajrit, përmes përkrahjes së donatorëve do të siguron mjete financiare në shumë prej 264,319.00 Euro.

Prioritetet afatmesme

Në periudhën afatmesme në këtë fushë, planifikohen këto aktivitete:

- Amandamenti i Ligjit nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- Hartimi i akteve nënligjore që dalin nga Ligji i ndryshuar për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, dhe
- Ngritja e mëtejme e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit.

Si masë zbatuese planifikohet: Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave acidike të minierës së Artanës. Buxheti për kompletimin e legjislacionit dhe implementimin e tij, hynë në kuadër të planifikimit buxhetor të MMPH.

Kimikate

Kosova është duke u bërë progres gradual drejt transpozimit të Rregullores nr. 1907/2006/KE REACH dhe Rregullores nr. 1272/2008/KE (CLP) për Klasifikimin, Paketimin dhe Etiketimin e Substancave të Rrezikshme. Niveli i transpozimit nuk është shumë i madh pasi që në fushën e kimikateve kanë ndryshuar dispozitat e shumta ekzistuese me qëllim të harmonizimit global të rregullave për kimikate. Gjerë më tani është arritur transpozim i mirë sa për të funksionuar pa pengesa të mëdha tregu i kimikateve, sidomos janë transpozuar dispozitat më të nevojshme për zbatim që është siguruar përmes Udhëzimit Administrativ nr. 10/2012 për listën Teknike të sigurisë nga kimikate dhe mënyrën e plotësimit të sajë, dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2014 për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin të Kimikateve të Rrezikshme, Ligjit nr. 04/L-197 për kimikate, si dhe me shpalljen e Vendimit të Ministrit nr. 4222-14- 564295 për Listën e substancave të rrezikshme nga Rregullorja nr. 1272/2008 /KE - CLP.

Megjithatë, përafrimi i kornizës ligjore nevojitet të zgjerohet përmes instrumenteve ligjore, të cilat kërkojnë përpjekje shtesë. Ky objektivi do të arrihet pjesërisht përmes miratimit të Udhëzimeve Administrative për metodat e vlerësimit të rrezikut nga kimikate të cilat do të hartohen gjatë 3 viteve të ardhme.

Sa i përket veprimeve që duhet ndërmarrë për të siguruar kapacitetet për të kontrolluar përputhshmërinë me rregullat e klasifikimit, etiketimit dhe paketimit të substancave të rrezikshme, inspektimet bëhen nga inspektorati fitosanitar që bënë kontrollat doganore. Në këtë kontekst, inspektimi është kompetencë edhe për Inspektoratin e Tregut, e cila është në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Inspektorati i Mjedisit e cila është në kompetencë të MMPH-së janë operative dhe funksionale.

Transpozimi i Direktivës për Asbest (Direktiva e Këshillit nr. 87/217/KEE e 19 mars 1987 mbi parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbest e ndryshuar nga Direktiva nr. 91/692/KEE dhe Rregulloren (KE) 807/2003), është në nivel mjaft të avancuar. Lidhur me këtë, është Udhëzimin Administrativ nr. 07/2009 për Administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest dhe i cili është duke u amandamentuar. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunat janë përcaktuar si autoriteti kompetent për zbatimin e kësaj direktive.

Në këtë fushë, tashmë janë marrë masat për kufizimin dhe vendosjen në treg dhe/ose masat për përdorimin e fibrave asbest do të hyjnë në fuqi në vitin 2015 nga MMPH, ndërsa disa masa veçse janë ndërmarrë për reduktimin e emisioneve të asbest në burim, për shembull ndalimi i operimeve të fabrikës ekzistuese të cilat përdorin asbest (siç është Fabrika Sharr- Salonit për prodhimin e çimentos asbest). Ndërsa, procesi i pastrimit në lumin Lepenc i cili përmban mbeturina të çimentos asbest është në vazhdim.

Transpozimi i Direktivës nr. 98/8/KE për Produktet biocide është mjaft i avancuar që është siguruar përmes dispozitave të Ligjit nr. 03/L-119 për Produkte Biocide. Ligji në fjalë do të ndryshohet gjatë vitit 2016, pasi që tani e tërë Direktiva për produktet biocide është zëvendësuar me Rregulloren për produkte biocide nr. 528/2012/BE që përcakton dhe rregullon kushtet për vendosjen në treg dhe përdorim të substancës/ve të cilat përdoren për prodhimin e produkteve biocidale në territorin e Republikës së Kosovës. Kështu që kjo Rregullore do të transpozohet në tërësi në Ligjin e ri për produkte biocide.

Përpjekjet aktuale të transpozimit janë të fokusuar në hartimin e Udhëzimit Administrativ për eksport import- PIC Procedure të Mbeturinave të rrezikshme duke u harmonizuar me Rregulloren (KE) nr. 689/2008 eksport import të kimikateve, respektivisht me Rregulloren nr. 649/2012 /BE për export import -PIC procedure.

Gjithashtu transpozim i plotë është bërë nga Rregullorja nr. 648/2004/KE për Detergjentet, e transpozuar në Rregulloren e Kosovës nr. 02-2015 për detergjentet e aprovuar nga Ministri në vitin 2015.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Inspektorati për Mjedis, si dhe Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik e cila është nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë janë përcaktuar si autoritete kompetente për zbatimin e këtyre direktivave. Mungesa e kapaciteteve administrative pengon zbatimin e një sistemi për autorizimin e produkteve biocide.

Gjerë më tani, ende nuk është hartuar ndonjë program, strategji apo plan rreth menaxhimit të kimikateve.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për kontrollin e ndotjes nga kimikatet është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit, divizioni për kimikate dhe mbeturina, si dhe Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit / me gjithsejtë 4 zyrtarë. Institucionet tjera që kanë të bëjnë me fushën kimikateve janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Ministria e Integritimit Evropian (MIE).

Masat afatshkurtra

Për periudhën afatshkurtër në këtë fushë planifikohet:

- Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Produkte Biocide nr. 03/L-119 e cila do të transpozohet pjesërisht Direktivën nr. 98/8/KE dhe Rregulloren (EU) nr. 528/2012.

Kurse si masë implementuese parashihet edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet mjedisore i të gjitha grupeve të interesit.

Mungesa e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për menaxhimin e kimikateve dhe mungesa e kapaciteteve për përgatitjen e tyre në këtë periudhë paraqitet si sfidë.

Tani për tani nuk planifikohet të themelohet ndonjë institucion apo organ që ka të bëjë me menaxhimin e kimikateve. Ndryshimet në strukturimin e sektorit janë bërë në vitin e kaluar.

Për këtë sektor duhet të vazhdohet me trajnimet me programi me ECRAN. Gjithashtu lidhur me zbatimin e legjislacionit për kimikate, përmes komunave do të duhet të organizohen seminare trajnime për të ngritur sistemin e menaxhimit të kimikateve nga bizneset që do të merren me menaxhimin e kimikateve, si prodhuesit, importuesit, formulatorët dhe përdoruesit e kimikateve.

Nuk ka një buxhet të planifikuar për krijimin e sistemit për menaxhimin e kimikateve në Kosovë.

Prioritetet afatmesme

Në periudhën afatmesme, planifikohet ndryshimi dhe plotësimi i akteve që dalin nga Ligjit për Kimikate nr. 04/L-197 (Rregullorja (KE) nr. 1907/2006, dhe Rregullorja (KE) nr. 1272/2008).

Gjithashtu për kimikatet si nën-sektor mjaft i rëndësishëm, në periudhën afatmesme, do të plotësohet Korniza legjislative sekondare dhe Rregulloret si më poshtë:

- UA nr. 10/2012 për Listën teknike të sigurisë për kimikate dhe mënyrën e plotësimit të saj (Direktiva nr. 1907/2006/KE REACH);
- UA nr. 17/2014 për Klasifikim etiketim dhe paketim të kimikateve të rrezikshme (Direktiva nr. 1272/2008/KE, CLP);
- Vendim nr. 4222-14_564295 për listën CLP të substancave të rrezikshme (Direktiva nr. 1272/2008/KE, CLP);
- UA mbi shënimet e përbërjes së detergjenteve në paketimet e tyre (Direktiva nr. 648/2004/KE/ Regulation of detergents);
- UA për Import, eksport dhe tranzit të kimikateve të rrezikshme, Direktiva nr. 649/2012/KE, dhe Rregullorja nr. 649/2012/KE for export and import).
- UA për metodat për caktimin e vetive fizike të kimikateve (Rregullorja (KE) nr. 1907/2006)
- UA për metodat për caktimin e toksicitetit dhe efektet tjera shëndetësore (Rregullorja (KE) nr. 1907/2006), dhe
- UA për metodat për caktimin e ekotoksicitetit (Rregullorja (KE) nr. 1907/2006).

Në periudhën afatmesme në këtë nënsektor fokusi do të jetë në zbatimin e legjislacionit të miratuar primar dhe sekondar, hartimin e politikave të reja-strategjive, programeve dhe në ngritje të kapaciteteve. Buxheti për realizimin e aktiviteteve do të planifikohet sipas KASH.

Mbrojtja nga zhurma

Në funksion të përafërimit të mëtejshëm të legjislacionit vendor me acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes nga zhurma, Kosova ka marrë vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2016. Përmes këtij Ligji do të bëhet transpozimi i plotë i Direktivës nr. 2002/49/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 qershor 2002, në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis.

Për të implementuar ligjin në fjalë, për fillim planifikohet hartim i legjislacionit sekondar që del nga ky ligj dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore për implementimin e këtij legjislacioni, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal.

Autoriteti kompetent për mbrojtjen nga zhurma në mjedis është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, dhe Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit/ Instituti Hidrometeorologjik me gjithsejtë 4 zyrtarë. Institucionet tjera që ndërliken me këtë fushë janë kryesisht: Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Infrastrukturës (MI), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Komunitet.

Masat afatshkurtra

Në vitin 2016 planifikohet të miratohen këto akte legislative:

- Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 02/L-102 për Mbrojtje nga Zhurma;
- UA për Menaxhimin e zhurmes në ambientet e mbyllura (Direktiva nr. 2002/49/KE);
- UA për Vlerat kufitare të zhurmes, në varësi të llojit të burimit të zhurmes, kohën dhe vendin (Direktiva nr. 2002/49/KE); dhe
- UA për Vlerat kufitare të zhurmes në mjedis (Direktiva nr. 2002/49/KE).

Në këtë periudhë do të punohet në edukimin dhe ndërgjegjësimin për çështjet e mbrojtjes nga zhurma.

Mangësi dhe sfidë paraqitet fakti se gjerë më tani nuk janë realizuar matje të nivelit të zhurmes në mjedis, për shkak të mungesës së pajisjeve për matje dhe nuk ka staf të trajnuar për të zhvilluar hartat strategjike të zhurmes.

Aktualisht struktura institucionale është e mjaftueshme por në të ardhmen do të paraqitet nevoja për rritjen e numrit të stafit dhe është shumë i nevojshëm trajnimi i stafit, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal, për të zbatuar Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma dhe akteve nënligjore. Po ashtu, trajnimi i zyrtareve të IHMK-s për matjen e zhurmes në mjedis.

Për hartimin e këtij legjislacionit buxheti është në kuadër të planifikimit buxhetor të MMPH-së.

Prioritetet afatmesme

Në periudhën afatmesme lidhur me çështjet e mbrojtjes nga zhurma planifikohet:

- Rishikimi i legjislacionit dhe transpozimi i mëtejshëm i legjislacionit të BE-së (në se është i nevojshëm);
- Krijimi i sistemit për monitorimin e zhurmes në mjedis; dhe
- Forcimin e kapaciteteve administrative.

Në këtë periudhë do të ndërmerren këto masa:

- Sigurimi i pajisjeve për matjen e zhurmes në mjedis;
- Sigurimi i trajnimeve për zhvillimin e hartave Strategjike të Zhurmes;
- Zhvillimi i Hartave Strategjike të zhurmes; dhe
- Hartimi i Planeve të Veprimit.

Sa i përket buxhetit për realizimin e këtyre aktiviteteve, sigurimi i pajisjeve hynë në kuadër të planifikimit buxhetor të MMPH, kurse Zhvillimi i Hartave Strategjike të zhurmes dhe Hartimi i Planeve të Veprimit do të sigurohen dhe planifikohen nga institucionet përgjegjëse për përgatitjen e këtyre dokumenteve.

Pylltaria

Korniza ligjore në sektorin e pylltarisë përbëhet nga Ligji nr. 2005/49 për Pyjet, Ligjin nr. 02/L-53 për Gjuetinë dhe ligjet e tjera si Ligji nr. 2010/03/-L-233 mbi Mbrojtjen e Natyrës, Ligji nr. 2010/03 -L- 230 mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji nr. 2006/02- L41 mbi Mbrojtjen nga Zjarri, Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, Ligji nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësor, Ligji nr. 10/ 03/-L- 163 mbi Minierat dhe Minerat, Ligji nr. 2004/13 për Materialin Fidanor, Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe Ligjin nr. 2011/04-L- 040 për rregullimin e Tokës.

Ligji për pyjet e Kosovës bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, konservimit të lloj-llojshmërisë biologjike, si dhe masat paraprake dhe parandaluese për mbrojtjen e pyjeve dhe ruajtjen e mjedisit ashtu si janë përshkruar në deklaratën e parimeve për konsensusin global mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve të dhëna në aneksin III të raportit të Konferencës së Kombeve të

Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Zheneiro, 3-14 qershor, 1992). Ndërkaq Ligji nr. 02/L-53 për Gjuetinë siguron një menaxhim të qëndrueshëm të sektorit duke konsideruar florën dhe faunën si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë, ruajtje e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), në drejtim të përmirësimit të strukturës organizative, strukturës të menaxhimit me pyje, toka pyjore dhe kafshë të egra, ka një bazë të konsoliduar të legjislacionit sekondar (deri më tani ekzistojnë 38 UA. të cilat rregullojnë këtë sektor).

Politikat, strategjitë dhe planet e veprimit për zhvillimin e sektorit pyjor në Kosovë të aprovuara nga Qeveria e Kosovës janë të përmbledhura në dokumentin “Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020”. Qëllimi i kësaj strategjie është shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore përmes ofrimit të një kornize institucionale dhe rregullative duke siguruar mekanizmat e përhershëm financiar për zhvillimin e sektorit.

Deri më tani në sektorin pyjor, janë bërë përpjekje për të vendosur sanksione për prerjet e paligjshme, kjo është edhe sfidë e dalur nga Raporti Progresit 2015 (*në nën-pikën 5.2.2 Bujqësia dhe peshkataria*), ku theksohet se vëllimi i prerjeve të paligjshme është ende shumë i lartë për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve. Sfidat tjera sektoriale janë: parcelizimi i pyjeve private, çështjet pronësore të pazgjidhura etj. Niveli i ulët i investimeve në zhvillimin e sektorit- sidomos në pyllëzimin e sipërfaqeve të reja- mbetet sfidë për tu adresuar. Dhe në fund Kosova duhet të siguroj një vetëdije dhe informim më të mirë për qytetarët sa i përket ruajtjes, shfrytëzimit efikas dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Qeveria e Kosovës duhet që të bëjë përpjekje të mëtutjeshme në përmirësimin e bashkëpunimit në nivel qendror lokal për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të resurseve pyjore si dhe të kompletoj modelin institucional i cili do jetë efikas në zbatimin e politikave në këtë sektor. Sa i përket kornizës legjislative, ajo mbetet që edhe më tutje të plotësohet me atë të BE-së deri në përafrimin e plotë.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për Pylltarinë është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si organi më i lartë i administrimit dhe menaxhimit të pyjeve në Kosovë, respektivisht Departamenti i Pylltarisë dhe Agjencia Pyjore e Kosovës. Numri i të punësuarve në departament të Pylltarisë është 7 ndërsa, APK si autoritet ekzekutiv ka 140 të punësuar. Institucionet tjera që kanë të bëjnë me fushën e pylltarisë janë kryesisht: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore (MMPH), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Ministria e Integritimit Evropian (MIE).

Spektori i pylltarisë përveç buxhetit të vendit ka gëzuar përkrahje të madhe edhe nga ana e donatoreve. Deri më tani ky sektor është përkrahe me shumë të përafërt rreth 13.7 milion.

Masat afatshkurtra

Me qëllim të harmonizimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së, MBPZHR, është në proces të plotësim-ndryshimit të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr. 2003/3 si dhe akteve nënligjore për zbatimin ligjit. Ky draft Ligj do të merr parasysh Rregulloret e BE-së si: Rregulloren (BE) nr. 691/2011 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 6 korrik 2011 për Mjedisin Evropian dhe Llogaritë Ekonomike; Rregulloren (BE) nr. 995/2010 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 20 tetor 2010 e cila përcakton obligimet e operatoreve të cilët plasojnë drurin dhe produktet drunore në treg, gjithashtu e ashtuquajtur “EU TR”; dhe Rregulloren (BE) nr. 995/2010 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 20 tetor 2012 e cila përcakton obligimet e operatoreve të cilët plasojnë drurin dhe produktet drunore në treg.

Gjatë kësaj periudhe parashihet edhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për Gjuetinë 02/L-53, me të cilin rregullohet menaxhimi i qëndrueshëm, kultivimi, mbrojtja, gjuetia dhe shfrytëzimi i faunës së egër si

pasuri natyrore me interes të përgjithshëm. Ligji për Gjuetinë do të përafrohet me konventat ndërkombëtare dhe direktivat e BE si: Konventa Evropiane për mbrojtjen e llojeve të kafshëve të egra dhe mjediseve të tyre (Konventa e Bernës), Konventa për mbrojtjen e llojeve migruese të kafshëve të egra (Konventa e Bonit), Konventa ndërkombëtare për tregtinë me bimë dhe kafshë të rrezikuara (CITES), Konventa e Kombeve të Bashkuara për llojlojshmërinë biologjike (Konventa e Rios), Direktiva e BE-së nr. 92/43/KEE për ruajtjen e mjediseve natyrore dhe florës e faunës së egër, dhe Direktiva e BE-së nr. 79/409/KEE për shpezët.

Për të përmirësuar politikat sektoriale dhe për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve pyjore jo drunore MBPZhR do të hartojë dhe miratojë "Strategjinë për produkte pyjore jo drusore 2015-2020" i cili mbështetet nga GIZ (20,000.00 Euro). Me këtë strategji synohet të vendoset korniza për mbrojtjen, kultivimin, grumbullimin, shfrytëzimin dhe tregtimin e produkteve pyjore jo drusore në funksion të zhvillimit ekonomik të zonave rurale të Kosovës. Kjo strategji sektoriale është e harmonizuar me Udhëzimet e OBSH-së për GACP (Guidelines on Good Agricultural and Collection Practices 2003), Udhëzimet e Agjencionit Evropian të Mjekësisë EMEA-s (2006), Versioni standard 2.0 i FairWild (2010) dhe Asociacionit Evropian të kultivimit të bimëve mjekësore EUROPAM GACP versioni 8.0 (2010).

Sa i përket draftimit të politikave brenda sektorit të pylltarisë dhe ndërmarjes së masave për zbatimin e legjislacionit dhe politikave, gjatë kësaj periudhe do të bëhet hartimi dhe miratimi i Programit Nacional për Pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura 2016-2025, i cili përcakton veprimet, masat dhe buxhetin për pyllëzimin e tokave pyjore sipas politikave, strategjive të aprovuara dhe përafuara me legjislacionin e BE-së dhe praktikave të mira menaxhuese; si dhe zhvillimi i Sistemit Informativ Pyjor të Kosovës (FIS-KOS) i cili integron edhe sistemet tjera në programet, softuerët dhe të gjitha procedurat administrative në menaxhimin e pyjeve nga niveli lokal deri të ai qendror. Të dyja këto do të mbështeten nga SIDA dhe FAO me shumë të përafërt prej 325,000.00 Euro.

Prioritetet afatmesme

Në prioritetet afatmesme planifikohet:

- Hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë 2020-2030;
- Hartimi i programit nacional për menaxhimin e faunës së egër dhe gjuetisë 2018-2028;
- Zhvillimi i softuerit për planet 10 vjeçare të menaxhimit me pyje;
- Ristrukturimi i Agjencisë Pyjore të Kosovës sipas mandatit të ri të propozuar me draft-ligjin e ri për pyjet;
- Ristrukturimi i inspektionit pyjor; dhe
- Hartimi i udhëzimeve administrative për zbatimin e ligjeve të aprovuara.

Ndryshimet klimatike

Qeveria e Kosovës ka miratuar UA nr. 20/2013 për Zbatimin e Mekanizmave për Zhvillim të Pastër i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën për Tregtimin të Emisioneve nr. 2003/87/KE. Transpozimi do të zhvillohet më tej përmes miratimit të UA mbi Mekanizmat për Monitorimin e Emisioneve të Gazeve Serrë, i cili pritet të miratohet në fund të vitit 2015. MMPH ka përgjegjësi për definimin dhe zbatimin e politikave dhe masave për të kufizuar emisionet gazrave serrë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Deri me tani është përgatitur Inventari i gazeve serrë. Mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe obligimet e raportimit ende nuk janë krijuar dhe nuk ka studime për projeksione të emisioneve deri në vitin 2020.

Miratimi i UA nr. 16/2013 mbi Substancat që Hullojnë Shtresën e Ozonit dhe Gazeve Serrë të Fluoruara do të avancojnë zbatimin e Rregullores së F-Gazeve. Në anën tjetër, MMPH, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Doganat e Kosovës ndajnë përgjegjësinë mbi zbatimin e këtij UA.

Me qëllim të krijimit të sistemit për zbatimin e këtij UA janë të nevojshme trajnime dhe programe profesionale për forcimin e kapaciteteve institucionale të palëve të përfshira në këtë proces dhe shikimi i mundësisë së marrjes së përvojave nga vendet e zhvilluara.

Progresi në transpozimin e Direktivës së Cilësisë së Benzinë dhe Derivateve të Naftë vazhdon më tej. Me miratimin e UA nr. 07/2012 për Cilësinë e Naftës dhe Karburanteve të Lëngëta Rrjedhëse, në periudhën paraprake vlerësohet si transpozim i nivelit më të lartë. Miratimi, i UA për biokarburantet, i cili planifikohet për qershor 2015, do të transpozohet shumicën e dispozitave të Direktivës në fjalë.

Megjithatë, nuk ka plane të sakta për përafrimin e legjislacionit kombëtar me dispozitat e Direktivës mbi Monitorimin (Neni 8 dhe 8.a), i cili do të bëhet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Zbatimi i Direktivës së Cilësisë së Benzinë dhe Karburanteve të Naftës nr. 2009/30/KE është mjaft e përparuar. Megjithatë, janë ende përpjekjet të nevojshme për kryerjen e vlerësimit të plotë të konsumit kombëtar të karburantit dhe të krijimit të bazës së të dhënave për cilësinë e karburantit. Në këtë drejtim, zbatimi i plotë i kësaj direktive që është planifikuar më parë për vitin 2013 është shtyrë për vitin 2015.

Për sa i përket autoriteteve të caktuara për zbatimin e kësaj Direktive, Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës dhe të Mallrave Strategjike është përgjegjës për rregullimin e sektorit të naftës dhe për mbledhjen e të dhënave të cilësisë së karburantit, ndërsa Inspektorati i Tregut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e programit të monitorimit të cilësisë së karburanteve, në bashkëpunim me inspektoratin përkatës dhe laboratorët e autorizuar.

Zbatimi i Rregullores mbi Standardet e Emetimit për Makinat e Reja të Pasagjerëve mbetet në një fazë të hershme. MMPH dhe Ministria e Brendshme janë autoritetet kompetente për rregullimin e standardeve të performancës së emisionit për automjete të reja të lehta komerciale. Në këtë drejtim, autoritetet e përcaktuara duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre në krijimin e sistemit për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave.

Transpozimi i Direktivës së Informimit të Konsumatorit nr. 2011/83/BE ka përparuar në këtë periudhë të monitorimit me miratimin e UA nr. 19/2013 mbi Disponueshmërinë e të Dhënave për Ekonominë e Karburantit dhe Emetimet e CO₂ nga Makinat e Reja të Pasagjerëve, në të cilin është bërë transpozimi i plotë i kësaj Direktive.

Për implementimin e legjislacionit për Ndryshimet Klimatike janë miratuar këto UA si në vijim:

- UA nr. 16/2013 për Substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serë të fluoruara (Rregullorja (KE) nr. 1005/2009 Ozone Depleting Substances, dhe Rregullorja (KE) nr. 842/2006 F-Gases);
- UA nr. 19/2013 për Qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin CO₂ të automjeteve të reja personale (Direktiva nr. 1999/94/KE Consumer Information);
- UA nr. 20/2013 për Zbatimin e mekanizmave fleksibil për zhvillim të pastër (Direktiva nr. 2003/87/KE Emission Trading); dhe
- UA nr. 20/2015 për Mekanizmat e përcjelljes së emisioneve të gazrave serë (Rregullorja nr. 525/2013/KE).

Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2014-2024 është miratuar nga Ministri me datë, 26 mars 2014.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për ndryshime klimatike është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, dhe Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit/ Instituti Hidrometeorologjik me gjithsejtë 9 zyrtarë. Institucionet tjera që ndërliken me këtë fushë janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE),

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Infrastrukturës (MI), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Ministria e Integritimit Evropian (MIE). Për më tepër, me datë 21.08.2015 me vendim të Qeverisë 05/45 është themeluar Komiteti Kombëtar për Ndryshime Klimatike.

Masat afatshkurtra

Në periudhën afatshkurtër planifikohet hartimi dhe miratimi i 2 UA-ve:

- U. A. për Mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serë (Rregullorja (BE) nr. 525/ 2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian), dhe
- UA për përcjelljen e emisioneve të gazrave serrë (Rregullorja (BE) nr. 525/ 2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian).

Për zbatimin e legjislacionit, në këtë periudhë planifikohet hartimi i tri planeve që kanë Dispozita për zbatim të legjislacionit nga Ndryshimet Klimatike si në vijim:

- Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE);
- Përgatitja e Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (PVCA); dhe
- Përgatitja e Planit të Veprimit për Ndryshime Klimatike (PVNK).

Gjithashtu, edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet të ndryshimeve klimatike i të gjitha grupeve të interesit do të jetë komponent e rëndësishme për këtë fushë.

Kapacitetet administrative në kuadër të sektorëve të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike kanë nevojë për ngritje edhe më tutje dhe duhet të vazhdohet me trajnimet nga programi i ECRAN-it, për zbatimin e legjislacionit. Po ashtu, ngritjen e kapaciteteve të zyrtareve të IHMK-s për përcjelljen e emisioneve të gazrave serrë, grumbullimin dhe raportimin sa më të mirë të të dhënave.

Sa i përket buxhetit për realizimin e këtyre aktiviteteve, buxheti, për kompletimin e legjislacionit hynë në kuadër të planifikimit buxhetor të MMPH, ndërsa buxheti për realizimin e veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike do të parashihen në këtë plan.

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatmesme nga fusha e ndryshimeve klimatike do të amandamentohen një numër i UA-ve të cilat do vazhdojnë transpozimin e legjislacionit të BE -së, dhe hartimin e UA tjera. Përcaktimi për hartimin e UA të reja do të bëhet varësisht prej kushteve socio ekonomike të Kosovës respektivisht, mundësisë së implementimit të tyre.

Legjislacioni i BE që duhet të transpozohet në legjislacionin e Kosovës janë:

- Direktiva nr. 2003/87/KE - krijimit të një skeme për tregtimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit me të cilën amandamentohet Direktiva nr. 96/61/KE;
- Direktiva nr. 2004/101/KE me të cilën amandamentohet Direktiva nr. 2003/87/KE - krijimit të një skeme për tregtimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit lidhur me mekanizmat e Kyoto Protokolit;
- Direktiva nr. 2008/101/KE me të cilën amandamentohet Direktiva nr. 2003/87/KE - krijimit të një skeme për tregtimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit;
- Direktiva nr. 2009/29/KE me të cilën amandamentohet Direktiva nr. 2003/87/KE për të përmirësuar dhe zgjeruar sistemin e tregtimit të emisioneve brenda komunitetit;
- Direktiva nr. 2009/30/KE me të cilën amandamentohet Direktiva nr. 98/70/KE e në lidhje me specifikimet e benzinës dhe naftës si dhe naftës së gazit si dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e emisioneve të gazrave serë;

- Vendimi nr. 406/2009/KE për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogëlojnë emisionet e gazrave serë që ti plotësojnë obligimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazrave serë deri më 2020;
- Vendimi i Komisionit nr. 2011/278/BE për përcaktimin e rregullave kalimtare në nivel të Bashkësisë për shpërndarjen pa pagesë të kuotave të njësive të emisioneve në përputhje me nenin 10, të Direktivës nr. 2003/87/BE;
- Rregulloren (BE) nr. 1005/2009 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për materiet të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit;
- Rregulloren (BE) nr. 842/2006 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për gazrat serë të fluoruara të caktuara;
- Vendimi nr. 280/2004/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mekanizmin e përcjelljes së gazrave serë në Bashkësi dhe për zbatimin e Protokollit të Kyotos;
- Rregullores të Komisionit (BE) nr. 1031/2010 për ndarjen, udhëheqjen dhe aspektet tjera të ndarjes së kuotave të emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës nr. 2003/87/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për vendosjen e sistemit të tregtimit me kuota të emisioneve të gazrave serë brenda Bashkësisë; dhe
- Vendimi i Komisionit nr. 2007/589/BE me të cilën merren vendimet për përcjelljen dhe raportimin e emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës nr. 2003/87/BE, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Vendim të Komisionit nr. 2011/540/BE.

Deri në fund të vitit 2020, për zbatimin e kërkesave që dalin nga MSA planifikohen këto masa:

- Përpjekjet për përfshirjen e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar dhe për të ndihmuar zvogëlimin e emetimeve që kontribuojnë në përkeqësimin e ndryshimit të klimës;
- Përafrimin gradual i legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së, për Ndryshimet Klimatike;
- Zbatimi i veprimeve të dala nga Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike, ku përveç veprimeve për ulje të gazrave serrë përfshihen edhe veprimet për përshtatje me ndryshimet klimatike; dhe
- Ngritja e kapaciteteve të duhura administrative dhe procedurave për koordinim ndërmjet akterëve relevant, për të mundësuar zbatimin e politikave për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë, që kontribuojnë në përkeqësimin e ndryshimit të klimës.

Buxheti për kompletimin e legjislacionit hyn në kuadër të planifikimit buxhetor të MMPH, ndërsa buxheti për realizimin e veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike do të parashihen në këtë plan.

Mbrojtja civile

Fusha e menaxhimit të fatkeqësive në vendin tonë është e rregulluar me Ligjin nr. 04/L-27 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe një numër i rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të miratuara deri më sot. Pastaj është Ligji nr. 04-L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Ligji nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri dhe Ligji nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim.

Legjislacioni i cili mbulon fushën e parandalimit dhe reagimit në raste të aksidenteve kimike (në industri) i cili pjesërisht transpozon Direktivën nr. 2012/18/BE- Seveso III, janë;

- UA për nr. 05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave;
- UA nr. 10/2011 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme; dhe
- UA nr. 17/2012 për regjistrin e impiantëve në të cilët është vërtetuar prezenca e substancave të rrezikshëm.

Deri me tani Kosova ka hartuar Planin e Reagimit Kombëtar. Autoriteti kompetent i përcaktuar për Mbrojtje Civile është: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH)- Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit respektivisht Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, AMMK- Instituti

Hidrometeorologjik; Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencës me gjithsejtë 7 zyrtar. Institucionet tjera që kanë të bëjnë me fushën mbrojtjes civile janë kryesisht: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik; njësia e zjarrfikësve të Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Ministria e Integrimit Evropian (MIE).

Masat afatshkurtra

Në periudhën afatshkurtër planifikohet:

- Rishikimi i legjislacionit ekzistues me qëllim të përafrimit të mëtutjeshëm me legjislacionin e BE;
- Miratimi i Strategjisë për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë.

Do të vazhdohet me edukimin dhe ndërgjegjësimin për çështjet lidhur me fushën e mbrojtjes civile i të gjitha grupeve të interesit.

Si mangësi në këtë fushë është koordinimi jo i mjaftueshëm ndërinstytucional lidhur me aktivitet që duhet ndërmarrë. Gjithashtu, me vlerësimin e bërë, legjislacioni për këtë fushë, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, ka të transpozuar 27% të Direktivës nr. 2012/18/BE- Seveso III që është nivel i ulët i transpozimit dhe për këtë arsye, për vitin 2016 planifikohet ndryshimi dhe plotësimi i UA nr. 10/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.

Me legjislacionin ekzistues nuk parashihet themelimi i institucioneve të reja dhe as riorganizimi i atyre ekzistuese.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përgatitë Draft Planin e Intervenimit në Rast të Aksidentit Mjedisor, i cili veçanërisht trajton rastet e aksidenteve për parandalimin dhe reagimin në raste të aksidenteve kimike (në industri), në anën tjetër Ministria e Punëve të Brendshme ka të miratuar Planin e Reagimit Kombëtar. Për të ndarë përgjegjësit mes këtyre dy planeve, është e nevojshme që nga ana e këtyre dy institucioneve të rishqyrtohen këto dy plane me qëllim të pengimit të dyfishimit të kompetencave dhe përgjegjësi gjatë zbatimit të këtyre planeve.

Duhet të vazhdohet me trajnimet nga programi i ECRAN-it, për zbatimin e legjislacionit dhe politikave në këtë sektor. Po ashtu, ngritjen e kapaciteteve të zyrtareve për parashikim të katastrofave dhe raportimin si dhe kërkimin e mundësive për fitimin e përvojave nga vendet e zhvilluara. Aktualisht nuk ka përkrahje nga asistenca e jashtme për këtë fushë.

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatmesme me qëllim të transpozimit të mëtutjeshëm të Direktivës nr. 2012/18/BE- Seveso III, planifikohet ndryshimi dhe plotësimi i:

- UA. nr. 10/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme;
- UA. për nr. 05/2011 për Metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave; dhe
- UA. nr. 17/2012 për Regjistrin e impiantëve në të cilët është vërtetuar prezenca e substancave të rrezikshme.

Në këtë periudhë për implementimin e legjislacionit dhe aktiviteteve të planifikuara planifikohen këto masa:

- Miratimi i Draft Planit të Intervenimit në Rast të Aksidentit Mjedisor;
- Ngritja e kapaciteteve të duhura administrative dhe procedurave për koordinim ndërmjet akterëve relevant, për të mundësuar zbatimin sa masave në nivel sa më të lartë.

3.29. Kapitulli 28 i *acquis*-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Legjislacioni i BE për kapitullin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik konsiston në masa rregullatore, rekomandime, koordinim dhe mbështetje për aktivitetet e vendeve anëtare përfshirë mbështetjen financiare. Kapitulli ka të bëjë me interesat e qytetarëve sa i përket politikave të sigurisë së konsumatorit, interesit ekonomik dhe shëndetit publik.

Acquis në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit** përfshin mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë e produkteve, shitjen e produkteve konsumuese dhe garancionet e tyre, kushtet e padrejta të kontratës, shitjen në distancë, shitjen derë më derë, marketingun keq informues, praktikatat e padrejta komerciale, kreditë e konsumatorit, dhe bashkëpunimin dhe zbatimin ndër-kufitar. Këtu bën pjesë edhe Sistemi i Alarmimit Rapid të BE-së (RAPEX).

Në fushën e **shëndetit publik**, legjislacioni i BE-së merret me çështjet që lidhen me kontrollin e duhanit, sëmundjeve të transmetueshme, gjakun, indet, qelizat dhe organet, sëmundjet mentale, parandalimin e abuzimit me drogën, dhe diagnostifikimet për kancer. Acquis e kësaj fushe gjithashtu rregullon të drejtat e pacientëve në shërbimin shëndetësor ndërkufitar, promovimin e ambientit të shëndetshëm dhe parandalimin e lëndimeve.

Implementimi i politikave për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik kërkon kapacitete adekuat administrative dhe infrastrukturë në të gjitha nivelet e organizimit administrativ. Për mbrojtjen e konsumatorit kjo nënkupton mbikëqyrje efektive të tregut dhe mekanizma gjyqësor dhe jo-gjyqësor adekuat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesave. Politikatat e BE gjithashtu synojnë angazhimin e publikut në konsultimet e politikave dhe aktivitetet e vetëdijësimit në mbrojtjen e konsumatorit.

Kërkesat e MSA-së

Sa i përket **Mbrojtjes së Konsumatorit**, Neni 81 i MSA-së obligon Kosovën të krijoj politika për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën e BE-së, duke përfshirë rritjen e informimit dhe zhvillimit të organizatave të pavarura në Kosovë, harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit në Kosovë me atë ekzistues në BE, mbrojtjen efikase ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit dhe ruajtja e standardeve të duhura të sigurisë, monitorimi i rregullave nga autoritetet kompetente dhe sigurimi i qasjes së kompensimit përkatës ligjor në rastet e mosmarrëveshjeve si dhe shkëmbimi i informatave mbi produktet e rrezikshme.

Bazuar në raportin e progresit 2014 dhe takimin e DPSA 2015, sfidë mbetet plotësimi i kornizës ligjore për Mbrojtjen e Konsumatorit, krijimi i kornizës së politikave, krijimi i mekanizmit për inspektimin e ankesave si dhe ngritja e kapaciteteve administrative për trajtimin e plotë të ankesave të konsumatorëve.

Përderisa në fushën e **Shëndetit Publik**, detyrimet që dalin nga Neni 106, paragrafi 2, përfshijnë sigurimin e përafrimit të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së, përmirësimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve në popullatë, krijimin e strukturave administrative të pavarura dhe efektive, posedimin e kompetencave për zbatimin, sigurinë e kërkesave thelbësore për kujdesin shëndetësor dhe sigurinë, për të mbrojtur të drejtat e pacientëve, për të mbrojtur qytetarët nga kërcënimet shëndetësore dhe sëmundjet si dhe për të promovuar jetesë të shëndetshme.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015, sa i përket **Mbrojtjes së Konsumatorit**, deklaron që duhet të punohet tutje në rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre.

Në lidhje me **Shëndetin Publik**, ky raport nënvizon faktin që buxheti i dedikuar për shëndetin publik mbetet ndër më të ulët në rajon, gjë që po pengon zbatimin dhe fuqizimin e reformave dhe politikave në vend. Si rezultat i mungesës së fondeve, pengon aftësinë për të përmbushur nevojat e nënës dhe fëmijës.

Si pasojë e kësaj të fundit, vdekshmëria e foshnjave është vlerësuar si më e larta në Evropë. Sa i përket pjesës legislative mbetet të plotësohet tutje korniza ligjore në sektorin e shëndetit publik, me që rast duhet të zbatohet Ligji për Sigurime Shëndetësore, i cilit do të mundësonte themelimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore. Gjithashtu duhet të adoptohet Plani i Veprimit të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2014-2020 si dhe miratimi i ligji për Transplantimin e Indeve dhe qelizave. Në kuadër të legjislacionit sekondar Plani për sëmundjet e rralla 2013-2015 duhet të zbatohet.

Gjendja aktuale

Korniza legislative

Mbrojtja e konsumatorit

Legjislacioni bazë për fushën e mbrojtjes së konsumatorit përbëhet nga Ligji nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit i miratuar më 20 nëntor 2012. Përmes këtij ligji rregullohen dhe mbrohen të drejtat themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave tjera në tregun e lirë si dhe detyrimet e shitësit, prodhuesit dhe furnizuesit.

Ligji transponon plotësisht Direktivën 97/7/KE për Kontratat nga Distanca dhe Direktivën 2006/114/KE në lidhje me Reklamat MASHTruese dhe Krahasuese si dhe pjesërisht Direktivën 2009/22/KE për Mbrojtjen Kolektive të Konsumatorëve, Direktivën 1999/44/KE për Aspektet e Caktuara të Shitjes së Mallrave për Konsumatorin dhe Garancionet tjera Ndërlidhëse, Direktivën 2005/29/KE mbi Praktikant MASHTruese ndaj Konsumatorëve, Direktivën 2008/48/KE mbi Marrëveshjet e Kredive për Konsumatorët dhe Direktivën 98/6/KE për Indikatorët e Çmimeve.

Legjislacioni dytësorë për implementimin e ligjit bazë për Mbrojtje të Konsumatorit përbëhet nga:

- Rregullorja nr. 09/2013 për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore e cila transponon pjesërisht Direktivën 2000/13/KE në lidhje me Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore;
- Rregullorja nr. 05/2014 për Përcaktimin e Çmimeve dhe Shitjes së tyre me Zbritje e cila transponon pjesërisht Direktivën 98/6/KE për Përcaktimin e Çmimeve.

Mbrojtja e konsumatorit në fushën e *shërbimeve financiare*, aktualisht në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, është e rregulluar me Ligjin nr. 04/L-155 mbi Sistemin e Pagesave për Shfrytëzuesit e Shërbimeve të Pagesave, i cili transponon pjesërisht Direktivën 2007/64/KE për Shërbimet e Pagesave në Tregun e Brendshëm. Ndërsa për adresimin e ankesave të shfrytëzuesve të sigurimeve, baza ligjore konsiston në Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i cili transponon pjesërisht Direktivën Evropiane 2009/13/KE si dhe Rregulloren nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesit e Sigurimit. Tutje, ekziston edhe Rregullorja për Normën Efektive dhe Kërkesat për Shpalosje e cila transponon pjesërisht Direktivën 2008/48/KE për Marrëveshjet e Kredive Konsumuese që ndër të tjera Definon Kalkulimin e Normës Efektive.

Gjithashtu, në kuadër të kornizës rregullative për mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve financiare, është edhe Rregullorja për Procesin e Brendshëm të Trajtimin të Ankesave, e cila përcakton rregullat për trajtimin e ankesave nga ana e institucioneve financiare me qëllim të krijimit të një fushëveprimi të barabartë për të gjitha institucionet financiare dhe për të siguruar trajtim të drejtë të konsumatorëve.

Për me tepër, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, interesat e konsumatorit janë të mbrojtura edhe nga ligjet tjera të cilat rregullojnë fusha të ndryshme të të drejtave të konsumatorit si: Ligji për Tregti, Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, Ligji për Mbikëqyrjen e Tregut, Ligji për Kërkesat Teknike për produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit, Ligji për Sigurinë e Ushqimit, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji i Metrologjisë, Ligji i Standardizimit, Ligji për Turizmin dhe Shërbimet turistike, Ligji

për Komunikime Elektronike, Ligji për Energjinë, Ligji për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave etj.

Mbrojtja e shëndetit

Legjislacioni bazë që rregullon këtë fushë konsiston nga Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, i cili synon mbrojtjen e shëndetit publik, të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit. Me këtë ligj përcaktohen masat për ndalimin, kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit, përbërësve të duhanit, parandalimin e pasojave të dëmshme nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit. Ligji në fjalë transpozon pjesërisht Direktivën 2001/37/KE lidhur me Prodhimin, Prezentimin dhe Shitjen e Produkteve të Duhanit, Direktivën 2003/33/KE lidhur me Reklamimin dhe Sponsorizimin e Produkteve të Duhanit si dhe Rekomandimin e Këshillit të vitit 2002 për Parandalimin e Pirjes së Duhanit dhe Inicativat për Përmirësimin e Kontrollit të Duhanit.

Korniza legislative në fushën e Mbrojtjes së Shëndetit përbehet edhe nga ligjet në vijim:

- Ligji nr. 04/L-192 për Transplantim të Indeve dhe Qelizave i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2014. Ligji përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e transplantimit të indeve dhe qelizave në fushën e mjekësisë për njerëz. Ai adreson sfidën e evidentuar në raportin e progresit për mungesën e legjislacionit për produkte me origjinë humane, qelizat dhe indet. Ky ligj transpozon pjesërisht Direktivën 2004/23/KE për Vendosjen e Standardeve të Kualitetit dhe Sigurisë për Dhurimin, Prokurimin, Testimin, Procedimin, Ruajtjen, Magazinimin dhe Distribuimin e Qelizave dhe Indeve Njerëzore.
- Ligji nr. 02/L-181 për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri, i cili ka për qëllim që të kontribuoj në sigurimin e të ushqyerit adekuat të foshnjës. Ky ligj transpozon pjesërisht Direktivën 2006/141/KE për Formula Qumështore dhe Formula Pasuese.
- Ligji nr. 02/L-101 për Transfuzionin e Gjakut, Kontrollin e Gjakut dhe Produktet e tij. Ky ligj nuk përcakton strukturë unike të organizimit të QKTGJK dhe njërive për transfuzionin e gjakut andaj edhe raportimi për veprimtari profesionale të njërive karshi QKTGJK nuk është e rregulluar.

Ligje të tjera të cilat kontribuojnë në rregullimin e fushës së mbrojtës së shëndetit përfshijnë Ligjin për Shëndetin Mendor Nr.05/L-025; Ligjin 02/L-78 për Shëndetësi Publike; Ligjin 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, Ligjin 02/L-109 për Sëmundjet Ngjitëse. Legjislacioni zbatues përbehet nga UA nr. 06/2013 për Frynmin e Asistuar Mjekësor; UA nr. 05/2011 për Parandalimin dhe Kontrollin e Infeksioneve brenda Spitalore dhe UA nr. 05/2010 për Vaksinoprofilaks, Seroprofilaks dhe Kimioprofilaks.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Mbrojtja e konsumatorit

Institucion përgjegjës për fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit është Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit (DMK), i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. DMK është përgjegjës për hartimin dhe sigurimin e zbatimin të dokumenteve strategjike të politikave dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, zhvillon sistemin e trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe mjeteve alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ofron mbështetje në zhvillimin e fushatave për ndërgjegjësimin e konsumatorit dhe punon në sensibilizimin dhe njoftimin e vazhdueshëm të konsumatorit. Aktualisht, DMK realizon aktivitetet nën përgjegjësi të tij nëpërmjet veprimtarisë së 3 nëpunësve civil.

Organi kryesor zbatues për këtë fushë është Inspektorati i Tregut, i cili është organ i pavarur dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Inspektorati i tregut aktualisht veprimtarinë e tij e ushtron mbi bazën e Ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të afër 15 ligjeve dhe mbi 30 akteve nënligjore në një numër të fushave ndër të cilat është edhe Mbrojtja e konsumatorit. Inspektorati i tregut shqyrton ankesat të cilat vijnë përmes

Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorit dhe ankesat të cilat parashtrohen direkt në inspektorat. Ankesat shqyrtohen nga sektori për çështje juridike i cili pastaj lëndën e përcjellë tek inspektorët e fushës përkatëse për trajtim të më tej. Në inspektoratin e tregut në zyrat qendrore të MTI-së vepron 16 inspektorë të cilët janë të ndarë në katër sektorë (sektori i tregut, sektori i naftës, sektori i sigurisë dhe sektori për çështje juridike).

Mbrojtja e konsumatorëve të **sektorit financiar** dhe trajtimi i ankesave të tyre bëhet në kuadër të Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave të Shfrytëzuesve të Shërbimeve Financiare në BQK duke u bazuar në memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar në mes të MTI dhe BQK. Divizioni për shqyrtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në kuadër të BQK-së, në pajtim me rregulloren për trajtimin e ankesave shqyrton ankesat e paraqitura nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe produkteve bankare, të sigurimeve, pensione dhe shërbimeve tjera financiare. Divizioni i ankesave aktualisht punëson 1 person.

Organ tjetër i rëndësishëm në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit është Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtje të Konsumatorit. Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë të cilët janë përfaqësues të MTI-së, Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit (AVUK), Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB), Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit (SHMK) dhe një ekspert të pavarur. Përgjegjësitë e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit janë këshillëdhënëse në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe po ashtu Këshilli është përgjegjës për hartimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe monitorimin e implementimit të Programit për Mbrojtje të Konsumatorit.

Në funksion të koordinimit të aktiviteteve për mbrojtjen e konsumatorit, pranimin dhe zgjidhjen efikase të ankesave nga konsumatorët, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit bashkëpunon ngushtë me Inspektoratin e Tregut (MTI), Inspektoratin e Metrologjisë (MTI), Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AVUK), Inspektoratin e Administratës Tatimore (ATK-MF), Inspektoratin Shëndetësorë (MSH), Inspektoratin e Autoritetit të Aviacionit Civil (MI), Inspektoratin e Transportit (Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit), Inspektoratin e Mjedisit (MMPH), Inspektoratin e Arsimit (MASHT), Komisionin e Pavarur për Media, Zyrën e Rregullatorit për Komunikime Elektronike dhe Postare, Zyrën Rregullative të Ujit dhe Mbeturinave si dhe Zyrën Rregullative të Energjisë.

Në Kosovë aktualisht janë të regjistruara dy Organizata Jo Qeveritare për Mbrojtje të Konsumatorit. Organizata "Konsumatori" dhe "Iniciativa për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve" IMDK. Organizatat për mbrojtjen e konsumatorit kanë një rol në fushën e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, duke rregulluar mundësitë për ta që të marrin pjesë në adresimin e shqetësimeve që kanë të bëjnë me konsumatorët nëpërmjet Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili është përgjegjës ti bëjë rekomandime Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të ngritë çështjet në të cilat konsumatorit i paraqiten vështirësi në marrjen e shërbimeve si ujit, rrymës, internetit, etj. Për më tepër, organizatat për mbrojtjen e konsumatorit mund të deponojnë kërkesë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për iniciimin e procedurës për mbrojtjen kolektive të interesave të konsumatorëve.

Në kuadër të kornizës së politikave, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, e hartuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, paraqet elementet e ndërlidhura me aktivitetet e sektorit që kjo ministri mbulon, duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e konsumatorit, e që janë pjesë e orientimit dhe vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Qëllimi i kësaj Strategjie është që të adresojë sfidat si dhe të adoptojë ndryshimet që kanë të bëjnë me zhvillimin e industrisë dhe të sektorit privat, e që janë ndryshimi në kornizën ligjore, atë institucionale dhe të politikave.

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorit posedon gjithashtu Programin për Mbrojtjen e Konsumatorit 2016-2020, i miratuar në fund të vitit 2015, i cili synon të avancojë fushën e mbrojtjes së konsumatorit duke

e shndërruar atë në një mbrojtje cilësore, të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në relacion me shëndetin publik, ambientin, tregun e qëndrueshëm dhe krijimin e kushteve të favorshme për biznesin. Gjithashtu programi parasheh implementimin efektiv të legjislacionit, respektivisht transpozimin e legjislacionit të BE-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit.

Mbrojtja e shëndetit

Organ kryesor në fushën Mbrojtjes së Shëndetit është Ministria e Shëndetësisë. Organet kompetente për zbatimin dhe monitorimin e ligjit për kontrollin e duhanit janë: Inspektoratet qendrore të ministrive të linjës: Inspektorati Shëndetësor (MSH), Inspektorati Sanitar (AVUK), Inspektorati i Tregut (MTI), Inspektorati i Punës (MPMS), Inspektorati i Arsimit (MASHT), Inspektorati i Transportit (MTT), Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Inspektoratet komunale. Kapacitetet administrative aktuale për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit janë aktualisht të pamjaftueshme.

Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut të Kosovës është organ kompetent qendror për aktivitetet për transfuzion të gjakut. Institucion përgjegjës për transfuzionin e gjakut dhe produktet e tij janë edhe njësitë për transfuzionin e gjakut të nivelit dytësor në kuadër të shtatë spitaleve rajonale. Inspektorati Shëndetësor vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka të punësuar 20 inspektor.

Këshilli Ndërmintor për Kontroll të Duhanit është themeluar nga Qeveria e Kosovës në bazë të Ligjit për Kontrollin e Duhanit dhe ka 15 anëtarë: përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë; Arsimit, Shkencës e Teknologjisë; Financave; Punës dhe Mirëqenies Sociale; Drejtësisë; Punëve të Brendshme; Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Infrastrukturës; Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Kulturës, Rinisë e Sporteve; profesionistë shëndetësor, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe shoqëria civile. Ky këshill është kompetent për propozimin e masave parandaluese, të vetëdijesimit, edukimit dhe njëkohësisht bënë monitorimin e zbatimit të tyre.

Institucionet tjera për zbatim të legjislacionit në fushën e shëndetësisë janë edhe Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike, Komunitat/Inspektoratet, Institucionet shëndetësore dhe Bordi Nacional për Kontrollin e Kancerit.

Sa i përket kornizës së politikave, institucioni kompetent për zhvillim të politikave për mbrojtje të shëndetit është Ministria e Shëndetësisë. Ky institucion për zbatim të legjislacionit posedon një numër strategjisë, programe dhe plan veprimi si në vijim:

Strategjia për Shëndetin e Nënës Fëmijës, Adolehentit dhe Shëndetin Riprodhues 2011-2015 paraqet dokumentin kryesor strategjik të sektorit të shëndetësisë që adreson të gjitha aspektet e shëndetit të nënës, fëmijës dhe shëndetit riprodhues. Qëllimi i strategjisë është ulja e vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve. Në funksion të zbatimit të strategjisë janë zhvilluar aktivitetet të planifikimit familjar, kujdes efektiv perinatal, promovim dhe edukim shëndetësor si dhe është bërë trajnimi i profesionistëve shëndetësor. Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar në uljen e vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve prej 17% në vitin 2012 deri në 12% në vitin 2014.

Programi i zgjeruar i imunizimit paraqet dokumentin që përcakton vaksinat e obliguara me ligj me të cilat imunizohen fëmijët e moshës së caktuar në interval kohor të caktuar. Me qëllim të adresimit të pabarazive, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me partneret relevant dhe mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka filluar procesin e riorientimit të programit me qëllim të rritjes së nivelit të vaksinimit të fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptias. Për këtë qëllim janë duke u zhvilluar një varg aktivitete që do të ndikojnë në përfshirjen e këtyre fëmijëve në kuadër të vaksinimit të rregullt.

Ndër tjerash janë edhe:

- Plani strategjik për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse;

- Strategjia e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore 2012-2016;
- Strategjia për shërbimin profesional të shëndetit mendor të Kosovës 2014-2020;
- Strategjia për HIV/AIDS 2015-2019;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për rezistencën antimikrobike 2011-2015;
- Programi Nacional i Kontrollit të Kancerit në Kosovë 2014-2020.

Masat afatshkurtra

Mbrojtja e konsumatorit

Në planin afatshkurtër, Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorit do të bëjë plotësim-ndryshimin e ligjit për Mbrojtje të Konsumatorit i cili do të transpozoi plotësisht direktivat: Direktiva 85/374/KEE mbi Përgjegjësinë për Produkte të Dëmtuara, Direktivën 2002/65/KE mbi Distanca Marketingun e Shërbimeve Financiare të Konsumatorit, Direktivën 2008/122/KE për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Lidhje me Aspekte të Caktuara të Ndarjes Kohore, Produkteve të Pushimit Afatgjatë, Rishitje dhe Shkëmbim Kontratash, Direktiva 2011/83/BE për të Drejtat e Konsumatorëve, Direktiva 2013/11/BE për Zgjidhjen Alternative të Konflikteve për Konsumatorët si dhe Rregullorja 524/2013 për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve Elektronike për Konsumatorët.

Tutje do të zhvillohet korniza e politikave për mbrojtje të konsumatorit, me që rast do të bëhet miratimi i Programit për mbrojtje të Konsumatorit 2016-2020.

Sa i përket kapaciteteve administrative, në planin afatshkurtër, do të bëhet organizimi i një trajnimi nga projekti “ Mbështetja për Lëvizjen e Lirë të Mallrave” për stafin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit mbi teknikat e komunikimit nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit të cilat përdoren edhe nga vendet e BE-së, trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe mbi mbrojtjen e konsumatorit në fushën e ushqimit. Gjithashtu, parashihet organizimi i një trajnimi mbi hartimin e strategjive për nxitjen e formimit të shoqatave për mbrojtjen e konsumatorit.

Lidhur me Masat zbatuese, duke u bazuar në Planin e Punës së Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorit për vitin 2016 parashihet organizimi i 2 tryezave për mbrojtjen e konsumatorit. Organizimi i tryezës me temën “Cilësia e naftës dhe shërbimet e ofruara nga Pompat e benzines” dhe tryezës “Shërbimet Elektronike dhe Postare”

Gjithashtu në planin afatshkurtër në kuadër të kampanjës për vetëdijësimin e konsumatorëve parashihet shpërndarja e fletëpalosjeve informuese në shkolla të mesme dhe në sheshe, transmetimi i spoteve për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe mbajtja e ligjëratave në shkolla dhe universitete për vetëdijësimin e nxënësve dhe studenteve mbi fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Mbrojtja e shëndetit

Në aspektin legjislativ, në planin afatshkurtër, parashihet miratimi i Ligjit për Transfuzionin e Gjakut, i cili do të transpozoi pjesërisht Direktivën 2002/98, Direktivën nr. 2005/61 dhe Direktivën 2005/62.

Sa i përket legjislacionit sekondar, me qëllim të implementimit të Ligjit 04/L-192 për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave, parashihet miratimi Udhëzimit Administrativ për Kushtet për Inspektim dhe masat e Kontrollit, në Fushën e Transplantimit të Indeve dhe Qelizave i cili do të transponoj pjesërisht Vendimin nr. 2010/453 të Komisionit Evropian. Gjithashtu, miratimi i Udhëzimit Administrativ për Importin dhe Eksportin e Indeve dhe Qelizave i cili do të transponoj pjesërisht Direktivën nr. 2015/566 për zbatimin e Direktivës 2004/23.

Në zbatim të Ligjit 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit do të miratohet UA për Vërejtjet e Kombinuara, i cili do të transpozoi plotësisht Vendimin 2003/641/KE, Vendimin C (2005) 1452 dhe Vendimin C (2006) 1502 BE.

Sa i përket kapaciteteve institucionale, në planin afatshkurtër parashihet, Transferim i njësive të transfuzionit të gjakut nga spitalet regjionale në Qendrën kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të cilat do të jenë pjesë përbërëse e Qendrës Kombëtare për Transfuzion të Gjakut të Kosovës. Tutje, me qëllim të zbatimit të Ligjit për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave nr. 2013/04/L-192 parashihet të bëhet emërimi i koordinatorit nacional për transplantim. Gjithashtu do të bëhet trajnimi i shtatë zyrtarëve të Qendrës së Transfuzionit të Gjakut për menaxhimin e shërbimeve kualitative të transfuzionit të gjakut me përkrahjen e Projektit KSV 017 në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë.

Sa i përket masave zbatuese aktivitetet në vijim planifikohen të realizohen:

- Miratimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2016-2020;
- Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës shëndetësore dhe adresimit të çështjeve të shëndetit mendor dhe parandalimit të abuzimit të drogave Ministria e Shëndetësisë planifikon të kryejë fazën e parë të projektit për ndërtimin e Qendrës për Sëmundje të varësisë në shumë prej 65.000 € nga buxheti i Kosovës.
- Me qëllim të zbatimit të Programit Nacional të Kontrollit të Kancerit në Kosovë 2014-2020, parashihet zhvillimi i aktiviteteve për skriningun e kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës; Aktivitetet e planifikimit familjar dhe aktivitetet për kujdes efektiv perinatal për zbatimin e Strategjisë së shëndetit të nënës, fëmijës dhe shëndetit riprodhues.

Prioritetet afatmesme

Mbrojtja e konsumatorit

Në planin afatmesëm, prioritet do të ketë implementimi i Programit për Mbrojtje të Konsumatorit 2016-2020, i cili parasheh harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit, forcimin dhe zhvillimi e mëtutjeshëm të kapaciteteve administrative si dhe informimin dhe edukimin e vazhdueshëm të konsumatorëve.

Mbrojtja e shëndetit

Në aspektin legjislativ, në planin afatmesëm, do të vazhdoj harmonizimi i legjislacionit primar dhe sekondar me Acquis në fushën e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndër kufitar, shëndetin mendor, gjaku, indet, qelizat dhe organet, parandalimi i lëndimeve, sëmundjet infektive, sëmundjet e rralla, duhani, alkooli, ushqyeshmëria, aktiviteti fizik dhe psikik.

Konventat që parashihen të procedohen për ratifikim gjatë kësaj periudhe:

- Konventa kornizë për kontrollin e Duhanit (22004A0615);
- Rregullorja ndërkombëtare për shëndetësi 2005;

Në aspektin e kapaciteteve institucionale, fokusi do të bie në funksionalizimin e Qendrës për koordinim të transplantimeve që përcaktohet në bazë të Ligjit për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave.

Sa i përket masave zbatuese, do të fokusohet në zbatimin e Strategjive ekzistuese me theks të veçantë strategjitë për: luftimin e kancerit, promovim dhe edukim shëndetësor, shëndetin mendor, shëndetin e nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues, vaksinimin, cilësisë së shërbimeve edhe HIV-AIDS.

Asistenca nga donatorët

Mbrojtja e konsumatorit

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit është pjese e projektit “Mbështetja për Lëvizjen e Lirë të Mallrave 2014 – 2016, që financohet nga Bashkimi Evropian. Projekti do të mbështesë Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit me ngritjen profesionale të stafit, mbështje në përpjekjet për te iniciuar

dialogun me Ministrinë e Drejtësisë dhe për të gjetur një alternative për zgjidhjen e kontesteve, mbështetje për OJQ-te. Buxheti i projektit për Departamentin Mbrojtjes së Konsumatorit është €24.000.

Mbrojtja e shëndetit

Spektori i shëndetësisë është pjesë e projektit “Mbështetje e sistemit shëndetësor” 2013-2017 që financohet nga Qeveria Italiane. Buxheti i projektit do të jetë €1,732.000.00 dhe do të fokusohet në zhvillimin e kardiokirurgjisë me qëllim të funksionalizimit të klinikës së kardiokirurgjisë përmes trajnimeve të stafit profesional, ofrimit të ekspertizës nga ekspertët italian dhe blerjes së pajisjeve.

Banka Botërore/IDF mbështet sektorin e shëndetësisë përmes projektit “Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë për Financimin Shëndetësor (AFSH)” 2013-2016 në ndërtimin e kapaciteteve të AFSH, mbështetje përmes ofrimit të konsulencës dhe trajnimeve të stafit të Agjencionit për Financim Shëndetësor me buxhet prej €520,000.00. Gjithashtu në kuadër të sigurimit të infrastrukturës dhe pajisjeve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore do të bëhet furnizimi me pajisje për gjinekologji, obstetrikë dhe neonatologji për shtatë (7) spitale rajonale dhe dy (2) klinika të QKUK në shumë prej 1.800,000 €.

Qeveria e Luksemburgut ka ofruar mbështetje përmes projektit “Partneriteti për përmirësimin e shëndetit të grave dhe fëmijëve në Kosovë” 2012-mars 2016 në shumë prej €2,523.500. Projekti do të mbështes aktivitetet promovuese me qëllim të përmirësimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës në Kosovë. Gjithashtu sektori i shëndetësisë do të vazhdohet të përkrahet nga Qeveria e Luksemburgut përmes projektit Mbështetja e sistemit shëndetësor të Kosovës KOS 017 (faza e 2-të) 2015-2018. Projekti do të vazhdojë të mbështesë sektorin e shëndetësisë në zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor për 35% të institucioneve shëndetësore në Kosovë me buxhet prej €6,000.000.

Fondi Global si organizatë ndërkombëtare financiare ka aprovuar financimin e vazhdimin të projektit “Parandalimi i HIV në Kosovë” për periudhën qershor 2015 – qershor 2016 në shumë prej €1,105,095.

3.30. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor

Acquis në fushën e bashkimit doganor përbëhet thajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është direkt detyrues për Shtetet Anëtare. Ai përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, nomenklaturës së kombinuar, tarifës të përbashkët doganore dhe dispozitat për klasifikimin tarifor, lirim nga detyrimet doganore, pezullime doganore dhe kuota të caktuara tarifore dhe dispozita të tjera të tilla si ato në kontrollin doganor të mallrave të falsifikuara, prekursorëve të drogës, eksporti i mallrave kulturore si dhe mbi asistencën reciproke administrative në çështjet doganore dhe transitit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se ekzistojnë kapacitetet e nevojshme të zbatimit dhe fuqizimit, duke përfshirë lidhjet me sistemet përkatëse të kompjuterizuara doganore të BE-së. Shërbimet doganore duhet gjithashtu të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar rregullat të veçanta të përcaktuara në fushat e lidhura me acquis të tilla si tregtia e jashtme.

Kërkesat e MSA-së

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, nenet 17, 18, 19, 39, 48, 75, 93 dhe 104. Nenet 17, 18, 19, 39, 48 dhe 93 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 49 dhe Protokollin 3 përcakton rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti neni 104 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin që palët do të vendosin një bashkëpunim në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor të Kosovës me atë të BE-së, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në këtë Marrëveshje dhe për përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës për doganat me atë të *acquis* të BE-së. Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen

me *acquis* të BE-së në fushën e doganës. Në këtë fushë protokoli 4 vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganës. Gjithashtu, me qëllim të sigurimit të tregtisë së lirë, Dogana do të zhvilloj kapacitetet administrative në fushën e luftimit të ekonomisë joformale, në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale (Kreu VI, Neni 4.3). Ndërsa protokoli 3 rregullon rregullat e origjinës së produkteve të nevojshme për zbatimin e shkëmbimeve tregtare mes palëve. Në kuadër të këtij protokoli, Kosova duhet që pas hyrjes në fuqi të MSA-së të nënshkruajë dhe ratifikojë Konventën Pan Euromed për Rregullat Preferenciale të Origjinës, si konventë që zbaton MSA-në për pjesën e tregtisë.

Fusha e Doganës karakterizohet si një ndër fusha kyçe në implementimin e detyrimeve të dala nga MSA mbi lëvizjen e lirë të mallrave nga njëra anë zbatimin e masave lehtësuese tregtare si dhe luftimin e evazionit fiskal, kontrabandës dhe piraterisë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Këtu mbulohet legjislacioni i harmonizuar/adoptuar me *Acquis*, dokumentet strategjike, strukturimi i Administratës doganore, kapacitetet administrative dhe sundimi i ligjit.

Bazuar në Raportin e KE-së për Kosovën 2015 për çështjet që lidhen me doganën, Kosova duhet të vazhdojë të zbatoj legjislacionin doganor në përputhje me praktikën e BE-së, të përforcojë masat e ndërmarrja për luftën kundër ekonomisë jo formale dhe të parandaloj çdo ndikim në punën e institucionit. Raporti nënvizon se Dogana e Kosovës vepronë në të gjithë Kosovën, por në një masë të kufizuar në veri. Mospërputhjet në mes të kodit doganor dhe akcizës dhe kodit penal vazhdojnë të pengojnë luftën kundër krim doganore.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Dogana, në vitet e fundit ka bërë progres të dukshëm dhe ka ndërmarrë një numër hapash pozitive në proceset e modernizimit dhe zhvillimit, që kanë për qëllim përafrimin e procedurave dhe sistemeve të administratës me ato të BE-se.

Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës në fushën e detyrimeve doganore është vlerësuar të jetë në përputhje me *acquis* dhe kornizën doganore të BE-së.

Dogana e Kosovës si legjislacioni primar zbaton Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Ligjit nr. 03/L-109 i datës 10 nëntor 2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-099, i datës 3 maj 2012. Ky ligj është pjesërisht në harmoni me Kodin Doganor të BE-se, me konkretisht me Rregulloren e Këshillit (KEE) 2913/92/ "Për Themelimin e Kodit Doganor Komunitar" (GZ L 302, 19.10.1992, f. 1-50) e amendamentuar dhe korrigjuar si vijon:

Ndryshuar nga:

- Rregullorja (KE) nr. 82/97 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 19 dhjetor 1996
- Rregullorja (KE) nr. 955/1999 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 13 prill 1999
- Rregullorja (KE) nr. 2700/2000 Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 16 nëntor 2000
- Rregullorja (KE) nr. 648/2005 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 13 prill 2005
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1791/2006 më 20 nëntor 2006

Ndryshuar nga:

- Akti i Pranimi të Austrisë, Suedisë dhe Finlandës (miratuar nga Vendimi i Këshillit 95/1/KE, Euratom, ECSC)
- Akti në lidhje me kushtet e pranimi të Republikës Çeke, Republikës së Estonisë, Republikës së Qipros, Republikës së Letonisë, Republikës së Lituaniës, Republikës së Hungarisë, Republikës së Maltës, Republikës së Polonisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Sllovakisë dhe përshtatjen me Traktatet përmes të cilave është themeluar Bashkimi Evropian Gazeta Zyrtare nr. L236 faqe 33 e datës 23.9.2003

Korrigjuar nga:

- Korrigjimi, GZ L152, 11.6.1997, fq. 34 (2913/92)
- Korrigjimi, GZ L 179, 8.7.1997, fq. 11 (82/97)

Dispozitat zbatuese të Kodit të Doganës janë të përfshira në udhëzimin administrativ 11/2009 të vitit 2009, të nënshkruar nga Ministria e Financave. Me hyrjen në fuqi të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, janë nxjerr 64 akte nënligjore (Udhëzime Administrative dhe Udhëzime të Brendshme).

Nga aspekti i dokumenteve strategjike Dogana e Kosovës operon bazuar në Strategjinë Operative. Kjo strategji përcakton qëllimet dhe objektivat e parapara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të gjeturat e dala nga Raporti i Progresit, DPSA-të, Plani i Veprimit për MSA dhe Blueprint për Dogana.

Dogana e Kosovës operon në tërë territorin doganor të Kosovës, përfshirë edhe në pjesën veriore në dy pikat kufitare me Serbinë, në zbatim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (nr. 03/L 109) duke unifikuar procedurat doganore.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Administrata Doganore e Kosovës është autoriteti në kuadër të Ministrisë së Financave që është përgjegjës për zbatimin e politikave doganore në Republikën e Kosovës, Dogana përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga Degët Doganore. Dogana e Kosovës është themeluar në gusht të vitit 1999 nga shtylla e BE-së, për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Me 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u shndërrua në Doganën e Kosovës. Kodi i ri doganor i miratuar me 11 nëntor 2008 nga Kuvendi i Kosovës, mundësoi këtë tranzicion. Kodi doganor në fjalë është në pajtim me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe ndër të tjera ka si objektiv edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Dogana e Kosovës është përgjegjëse për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra. Krahas përgjegjësisë për të grumbulluar detyrimet doganore, Dogana e Kosovës është institucion kyç edhe për vjelën e TVSH-së dhe Taksave mbi Akcizën të cilat vjelën nëpër kufij, dhe për më tepër është përgjegjëse për mbrojtjen e shoqërisë nga kontrabandimi i mallrave të tjera të ndaluara dhe me efekt të dëmshëm të krimit ekonomik, dhe evazionit fiskal.

Dogana Kosovës është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe është i financuar tërësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe aktualisht i ka rreth 574 punëtorë. Dogana tenton dhe investon në stafin e saj ashtu që të mbajë hapin me zhvillimet e reja, gjithnjë në pajtim të Strategjisë Operative të Doganës dhe Blue-printit (Dokumenti i Unionit Evropian).

Dogana e Kosovës vjelë rreth 58% e të hyrave të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. FMN ka lavdëruar vazhdimisht Shërbimin për performancën e tij, duke e krahasuar në një nivel me Shërbimet e Evropës Perëndimore.

Dogana ka zhvilluar reforma të brendshme në mënyrë që ti përshtatet nevojave të biznesit, të zvogëlojë shpenzimet e tyre dhe ul numrin e procedurave burokratike të cilat reforma në mënyrë indirekte do kontribuojnë edhe si masa parandaluese të anti-korrupsionit.

Në aspektin e lehtësimit të tregtisë, Dogana bënë përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur një ekuilibër mes kontrollit dhe lehtësimit të tregtisë, duke krijuar kushte të përshtatshme për procedurat e zhdoganimit dhe përshpejtimin e tyre. Kanali i gjelbër dhe kanali i kaltër ju mundëson bizneseve legjitime të përfundojnë procedurat doganore brenda 30 minutave nga momenti i hyrjes në kontroll doganor. Gjithashtu, së fundi është prezantuar konceptin *Paperless* për zhdoganimin e mallrave. Me

qëllim të ngritjes së mëtejshme të performancës dhe lehtësimit të tregtisë do të vazhdoj reformimi për gjithë administratën dhe do të rris numrin e bizneseve që do të përdorin kanalin Gjelbër.

Një hap i rëndësishëm është edhe prezantimi i Linjës së Sigurt (thirrje telefonike falas) e cila ka rezultuar me rritjen e veprave dhe rritjen e informatave për vepra korruptive. Mbi 95% e informacionit të marrë nga qytetarët ka rezultuar me saktësi. Meqenëse ky mekanizëm ka treguar rezultatet e para, do të vazhdohet tutje me njoftimin e opinionit publik për një partneritet më të fuqishëm dhe më të besueshëm për të luftuar dukuritë negative.

Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar doganor, Kosova ka nënshkruar 12 marrëveshje/memorandume dypalëshe me vendet e rajonit dhe të BE-së, ndërsa marrëveshjet tjera janë në negociim e sipër. Gjithashtu, Kosova synon marrjen e statusit joformal të vëzhguesit në Konventën e Përbashkët të Transitit, si dhe në organizata ndërkombëtare me karakter doganor.

Sa i përket mbrojtjes së të Drejtës së Pronësisë Intelektuale (DPI), Dogana e Kosovës zbaton Ligjin për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (Ligji nr. 03/L 170) si pjesë e Këshillit Shtetërorë për Pronësi Intelektuale, që synon të rris nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional. Si tërësi, secili nga institucionet e lartpërmendura ngërthen në vete përgjegjësi të caktuara të cilat kontribuojnë në zhvillimin vital të sektorit të DPI-së.

Me gjithë progresin e arritur në sektorin e DPI-së, akoma ekziston nevoja për përmirësim të mëtutjeshëm të bazës ligjore, kapaciteteve institucionale dhe veprimeve tjera teknike.

Ne qershor, 2015, është funksionalizuar sistemi elektronik INES për administrim dhe monitorim të kërkesave për veprim, përderisa mbetet sfide funksionalizimi për aplikim *online*.

Masat afatshkurtra

- Zbatimi i legjislacionit tatimor në harmoni me praktikat e BE-së;
- Plotësim-ndryshimi i KDA-se në harmoni me legjislacionin që rregullon veprat penale doganore;
- Ligjit për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Pronësisë Intelektuale sipas Rregullores 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 qershorit 2013;
- Udhëzim Administrativ për zbatimin e Ligjit për Masat Doganore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Pronësisë Intelektuale sipas Rregullores 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 qershorit 2013;
- Udhëzim Administrativ për deklaratën paraprake para - arritjes për zbatimin e Ligjit 04/L-099 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave të Kosovës në harmoni me Rregulloren (KE) nr. 648/2005 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 prill 2005 që ka ndryshuar Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2913/92/ "Për Themelimin e Kodit Doganor Komunitar";
- Harmonizimi i sistemit elektronik INES me COPIS.
- Modernizimi i mëtejshëm i Administratës Doganore bazuar në Planin e Veprimit;
 - Vazhdimi i Luftimit të ekonomise joformale;
 - Përmirësimi i objekteve tek disa pika të kalimit kufitar (PKK);
 - Ngritja e kapaciteteve administrative në lehtësimin e tregtisë, bashkëpunimit doganor, vlerësimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektual si dhe për aplikimin e drejtë të rregullave të origjinës, bazuar në rregullat e Konventës Pan-Euro- Mediterane (Protokolli 3 i MSA).

Prioritetet afatmesme

- Harmonizimi i Kodit Doganor me Rregulloren e Këshillit 2913/92/KEE "Për Themelimin e Kodit Doganor Komunitar" (GZ L302,19.10.1992,fq.1) e amendamentuar dhe korrigjuar;

- Adaptimi i Udhëzimit Administrativ për implementim të Kodit Doganor;
- Adaptimi i Udhëzimit Administrativ për Operatorët Ekonomik të Autorizuar në harmoni me Rregulloren (KE) nr. 648/2005 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 prill 2005 që ka ndryshuar Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2913/92/ "Për Themelimin e Kodit Doganor Komunitar";
- Zbatimi i Konventës Pan-Euro-Med.

Meqenëse Konventa Pan Euromed për Rregullat Preferenciale të Origjinës ka mundësi të nënshkruhet deri në fund të vitit 2015 nga ana e Kosovës, kjo nuk është përfshirë në matricën e masave për vitin 2016. Në rast se kjo nuk ndodh, nënshkrimi dhe ratifikimi i kësaj konvente nga ana e Kosovës do të jetë një nga prioritetet kryesore në pjesën e parë të vitit 2016 pasi që kjo shërben për implementimin e pjesës tregtare të MSA midis BE dhe Kosovës.

3.31. Kapitulli 30 i *acquis*-së: Marrëdhëniet me jashtë

Acquis në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni BE-së që drejtpërdrejt është i aplikueshëm dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar. Ky legjislacion i BE-së rezulton në thelb nga angazhimet shumëpalëshe dhe dypalëshe të BE-së në fushën e tregtisë, si dhe nga një numër i masave tregtare autonome. Në fushën e kredive të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, disa direktivat kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar.

Në këtë kontekst, vendeve kandidatë u kërkohet që në mënyrë progresive të harmonizojnë politikën e tyre drejt vendeve të treta si dhe të harmonizojnë qëndrimet e tyre brenda organizatave ndërkombëtare (p.sh. OBT, OECD) me politikën dhe pozicionet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare.

Në fushën e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare, shtetet anëtare të BE-së duhet të përputhin me legjislacionin e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet dhe në politikathumanitare të BE-së.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 74 MSA-së, dispozitë nga cila Kosova ka jo vetëmdetyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por edhe të sigurohet se ajo të zbatohet.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një pjesë kryesore të tregtisë së lirë midis Kosovës dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat ose detyrimet ndërkombëtare. Po ashtu, MSA rregullon edhe bashkëpunimin ekonomik me BE dhe vendet tjera që kanë MSA në fuqi, bashkëpunimin doganor (protokolli për bashkëpunim doganor), zbatimin e rregullave të OBT-së për tregti të lirë etj. Detyrimet e Kosovës sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare dhe bashkëpunimin ekonomik në mënyrë të përmblendhur për këtë kapitull janë në vijën: 20, 23, 24, 27, 31, 33, 38, 39, 45, 60, 64, 74, 75, 76, 94, 104. Këto obligime në këtë program adresohen nga kapitujt përkatës për lëvizjen e lirë të mallrave, doganat, politikën ekonomike dhe monetare etj.

Gjendja aktuale dhe perspektiva

Në kuadër të marrëdhënieve ekonomike dhe kornizës së përgjithshme të perspektivës së integritimit në BE, Kosova aktualisht përfiton nga masat preferenciale tregtare të BE-së për eksportin e Kosovës. Për më shumë rreth bashkëpunimit ekonomik me BE-në ju lutem shihni kapitullin e kriterëve ekonomike dhe atë për politikën ekonomike dhe monetare. Gjithashtu Republika e Kosovës tashmë është anëtare e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe disa institucioneve ndërkombëtare financiare. Kosova po ashtu përfiton nga sistemi tregtar preferencial unilateral i SHBA për eksportet e disa produkteve në

SHBA. Ndërsa brenda bashkëpunimit ekonomik me vendet tjera, Kosova ka nënshkruar disa marrëveshje bilaterale për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Marrëveshja për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) është marrëveshje / konventë në mes të dy shteteve për tatimin apo eliminimin e Tatimit të Dyfishtë. Pra, ka për qëllim të përcaktoj shtetin se cili ka të drejtën e tatimit për të njëjtat të ardhura ose kapital, në rastet kur një person është i tatueshëm në të dy shtetet.

Kosova ka në zbatim 10 marrëveshje dypalëshe për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë të cilat janë aktualisht në fuqi. Disa nga këto konventa ishin lidhur edhe nga ish-Republika Socialiste Federative Jugosllave me shtetet tjera. Vendet me të cilat Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë janë: Belgjika në fuqi nga 13.04.2012, Britania e Madhe në fuqi nga SFR Jugosllavia 01.04.1982 ndërsa në fuqi në RKS nga 06.09.2010, Finlanda në fuqi nga SFR Jugosllavia 1987 ndërsa në fuqi në RKS nga 08.09.2011, Gjermania në fuqi nga SFR Jugosllavia 26.05.1983 ndërsa në fuqi në RKS nga 02.04.2010, Holanda në fuqi nga SFR Jugosllavia 06.02.1983, Hungaria në fuqi nga 12.03.2014, Maqedonia në fuqi nga 11.04.2013, Sllovenia në fuqi nga 18.06.2015, Shqipëria në fuqi nga 11.03.2015 dhe Turqia e ratifikuar nga Kosova 07.11.2012.

Marrëveshja e CEFTA-së

CEFTA (Central European Free Trade Agreement) është marrëveshja e tregtisë së lirë në të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnjadhe Hercegovina dhe Moldavia. Kosova ka nënshkruar marrëveshjen e CEFTA-së në vitin 2006 si UNMIK e cila ka hyrë në fuqi nga viti 2007.

Marrëveshja e parë e CEFTA-së u nënshkrua nga Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia në Dhjetor 1992 dhe hyri në fuqi në Korrik 1994. Njëpërmjet CEFTA-së këto vende pjesëmarrëse u mobilizuan për t'iu qasur institucioneve politike, ligjore dhe ekonomike të Bashkimit Evropian, duke forcuar në këtë mënyrë demokracinë dhe ekonominë e tyre të tregut. Meqenëse në 2007 të gjitha palët e mëparshme të CEFTA-së kishin hyrë në Bashkimin Evropian dhe kishin dale nga CEFTA, u vendos që CEFTA të shtrihej në pjesën e Ballkanit të mbetur jashtë BE-së.

Vlen të ceket që deri tani është negociuar tregtia e lirë e mallrave dhe se aktualisht janë duke u zhvilluar negociatat për shërbimet midis vendeve të CEFTA-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova). Negociatat janë të ndara në 6 grupe dhe kanë filluar në vitin 2014 me një fokus kryesor në shërbimet profesionale, turizëm, mjedis, shërbime rekreative, komunikim, shërbimet në ndërtim dhe shërbimet e distribuimit, arsimit dhe ato shëndetësore.

Marrëveshjet e tjera

Republika e Kosovës deri më tani ka nënshkruar rreth 70 marrëveshje të karakterit ekonomik, përfshirë ato me SHBA-të, Unionin Ekonomik Belgjikë-Luksemburg, Slloveninë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe (7 marrëveshje).

Marrëveshje për *Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Udhëtarëve dhe Mallrave* kemi të nënshkruar me 9 shtete, ndër to edhe me Belgjikën, Zvicrën, Austrinë, Italinë. Marrëveshje në fushën e *Bashkëpunimit në Nxitjen e investimeve*, kemi të nënshkruar me Unionin Ekonomik të Belgjikës dhe Luksemburgut dhe SHBA-të.

Me Gjermaninë (Banka Gjermane për Zhvillim KfW) kemi të nënshkruar disa marrëveshje financiare. Marrëveshje mbi *Bashkëpunimin dhe Ndihmën Reciproke në Çështjet doganore*, kemi të nënshkruar me 7 shtete ndër to edhe me Finlandën, Austrinë, Slloveninë, Turqinë.

Republika e Kosovës planifikon të vazhdojë edhe në të ardhmen bashkëpunimin në fushën ekonomike me Belgjikën, Holandën dhe Gjermaninë.

Më specifikisht, Kosova deri më tani ka nënshkruar këto marrëveshje të karakterit ekonomik:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në çështjet doganore (publikuar më 13.11.2009)
- Marrëveshja për nxitje të investimeve ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës (publikuar më 15.09.2009)
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Republikës së Turqisë lidhur me bashkëpunimin ekonomik (publikuar më 29.05.2009)
- Marrëveshja për “Bashkëpunimin në Zhvillim” në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e nënshkruar në Prishtinë më 9 tetor 2009, publikuar më 02.04.2010, është në fuqi prej 1 Majit 2010;
- Marrëveshja për Kredi dhe Financim, e datës 28 të 12. 2009, Ndërmjet KfË Frankfurt am Main (“KfË”) Dhe Republika e Kosovës E përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (“Huamarrësi”) Dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a. KOSTT, Prishtinë (“Agjensioni për Ekzekutimin e Projektit”) Për EUR 33,500,000.(Publikuar më 07 Prill 2010);
- -Marrëveshja ne mes te Qeverise se Republikes se Kosoves dhe Qeverise se Republikes se Austrisë per promovimin dhe mbrojtjen e investimeve. është nënshkruar në Prishtinë më 22 janar 2010. (publikuar më 25.02.2010). Hyja në fuqi më datë 1 shkurt 2012;
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë në bashkëpunim dhe ndihmë reciproke në çështje doganore (publikuar më 25.02.2010)
- - Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë në transportin rrugor ndërkombëtar të ushtarëve dhe mallrave (publikuar më 03.06.2010)
- - Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës për bashkëpunim financiar dhe teknik, dhe ndihmë humanitare (publikuar më 09.12.2010)
- - Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në lidhje me bashkëpunim dhe ndihmë reciproke në çështje doganore (publikuar më 06.09.2010)
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në çështjet doganore, e nënshkruar në Helsinki më 03 Qershor 2010 (publikuar më 15.06.2010)
- - Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës (unionit ekonomik belgo-luksemburgas) dhe Republikës së Kosovës (publikuar më 02.04.2010)
- - Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (publikuar më 02.04.2010)
- Marrëveshja Ndërkombëtare Dypalëshe për “Promovimin Reciprok dhe Mbrojtjen e Investimeve” ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unionit Ekonomik të Belgjikës dhe Luksemburgut, e nënshkruar në Prishtinë më 9 mars 2010. Publikuar me 03 Qershor 2010);
- Marrëveshja Ndërkombëtare Dypalëshe për “Transportin Ndërkombëtar Rrugor”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, e nënshkruar në Bruksel më 18 qershor 2010. (publikuar më 06.09.2010);
- Marrëveshja për “Financimin e Projektit ndërmjet” KfË Frankfurt am Main dhe Republikës së Kosovës (Pranuesi)-Ministria e Ekonomisë; dhe Financave-, agjensioni për ekzekutimin e projektit -Kompania Ujësllësit Regjional Prishtina për 10,862,500 EUR – Furnizimi me Ujë dhe Largimi i Ujërave të Zeza, Prishtinë, Faza e II-të. Nënshkruar në Prishtinë më 07 Shtator 2010, (Publikuar më 30 Maj 2011);
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave (publikuar më 17.10.2011)
- Marrëveshja për ndihmë reciproke në çështjet doganore në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë (publikuar më 08.09.2011)
- Marrëveshja për ndihmë financiare ushtarake në mes të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (publikuar më 17.10.2011)

- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane për promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve (publikuar më 17.11.2011)
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për transport rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave (publikuar më 17.10.2011)
- Marrëveshja mbi transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë (publikuar më 08.09.2011)
- Ratifikimi i Marrëveshjas ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, ndërmjet r. së Kosovës dhe Maqedonisë (publikuar më 06.06.2011)
- Marrëveshja për Financimin e Projektit ndërmjet KFË-Frankfurt Am Main – e Republikës federale të Gjermanisë dhe Republika e Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave (Përfituesi) dhe Fondi për Sigurimin e Dispozitave të Kosovës , e nënshkruar në Prishtinë me 30 Shtator 2011. Publikuar në Gazetën Zyrtare me 23 Dhjetor 2011;
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut “për Zbatimin e Fondacionit Caritas” për strategjinë rajonale të Luksemburgut për Ballkanin (2011-2013) “zbutja e varfërisë përmes zhvillimit të qëndrueshëm”, është nënshkruar në Luksemburg më 21 Qershor 2011. (Publikuar më 08 Shtator 2011)
- Marrëveshja “për Promovimin Reciprok dhe Mbrojtjen e Investimeve” ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal Zviceran e nënshkruar me 27 Tetor 2011. (Publikuar me 17 Nëntor 2011)
- Marrëveshja për “Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve dhe të Mallrave” ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal Zviceran me datë 21 nëntor 2011. (Publikuar me 23 Dhjetor 2011);
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në çështjet doganore. Nënshkruar më 14 Shtator 2012 (publikuar më 09.10.2012). Hyrja në fuqi prej 01 Dhjetor 2013;
- Marrëveshja e bashkëpunimit financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë (publikuar më 07.09.2012)
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për promovimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve (publikuar më 01.10.2012)
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë mbi shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat (publikuar më 08.11.2012)
- Ligji nr. 04/1-132 për Ratifikimi në Marrëveshja s financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga ministria për financa dhe Bankës Gjermane kë lidhur me fabrikën e ujit në Shkabaj (publikuar më 18.10.2012)
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunim ekonomik (publikuar më 03.12.2012). Hyrja në fuqi me datën 23 Shtator 2013;
- Marrëveshja për “Bashkëpunim Ekonomik dhe Teknik” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e nënshkruar me datën 29.03.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës;
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Sllovenisë për “Transportin Ndërkombëtar rrugor të Mallrave dhe Njerëzve” nënshkruar në Lublane, me datë 26 Qershor 2013.
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për “Fondin e Mirëbesimit”, nënshkruar në Prishtinë, me datë 4 dhjetor 2013.
- Marrëveshja Amendamenti i Marrëveshjas së Grantit për Objektivat Zhvillimore I Amendamenti 1 ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës (publikuar më 19.12.2013).

- Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim rreth bashkëpunimit dhe aktiviteteve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë (publikuar më 08.04.2013).
- Ligji nr. 04/1-207 për Ratifikimi n e Marrëveshjas kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon aktivitetet e bankës evropiane...(publikuar më 22.08.2013).
- Ligji nr. 04/1-222 për Ratifikimi n e neneve të Marrëveshjas themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BERZH (publikuar më 29.10.2013)
- Ligji nr. 04/1-207 për Ratifikimin e Marrëveshjas kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon aktivitetet e bankës evropiane.(publikuar më 22.08.2013)
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për “Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave dhe në Transport të Kombinuar” , nënshkruar më 21 qershor 2013, publikuar më 13 Mars 2014. Hyrja në fuqi më 1 shtator 2014);
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për “Transportin Ndërkombëtar të Udhëtarëve në Transport jo të Rregullt dhe në Transport të Rregullt” nënshkruar më 21 qershor 2013, publikuar më 19 Mars 2014). Hyrja në fuqi më 1 shtator 2014;
- Marrëveshja financiare ndërmjet qeverisë së republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfË, për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes qendrore, 14 nëntor 2011. Publikuar ne Gazetën Zyrtare me: 24 Janar 2012;
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Turqisë për “Tregti të Lirë “ nënshkruar në Ankara nënshkruar në Ankara më 27.09.2013. nga ana jonë ende nuk është ratifikuar)
- Marrëveshja për alokim të mjeteve financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Gjermanisë (publikuar më 18.03.2013)
- Marrëveshja për bashkëpunim doganor në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë nënshkruar më datë 25.06.2013
- Marrëveshja Financiare ushtarake e bashkëpunimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, si dhe Protokollit për zbatimin e asistencës me mjete, e nënshkruar më 07 Nëntor 2013 në Prishtinë dhe më 30 Nëntor 2013 në Ankara. Hyrja në fuqi nga 20 Maj 2015;
- Marrëveshja Kornizë për bashkëpunim mes së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim, *Marrëveshja për financimin e rrugës M2*. nënshkruar më 21 Maj 2013.
- Marrëveshja mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për heqjen e tatimit të vlerës së shtuar në import për librat, produktet e përafërta me librin, gazetatat, revistat, periodikët si dhe materialët e ngjashme të shtypit të publikuara në Republikën e Shqipërisë apo në Republikën e Kosovës (nënshkruar 28 mars 2014, hyrja në fuqi më 20 qershor 2014);
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal (nënshkruar më 28 mars 2014).
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për “Shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”, nënshkruar më datë 26 qershor 2013; publikuar më 7 prill 2014, hyrja në fuqi më 16 prill 2014)
- Marrëveshja kornizë për ekonomi, tregti, bashkëpunim kulturor shkencor dhe teknik mes Republikës së Kosovës dhe Togos (nënshkruar më 21 korrik 2014).
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Çekisë për “Shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat” nënshkruar në Prishtinë, më 26 nëntor 2013; (dekretuar më 24 mars 2014).

- Marrëveshjas për Shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi te ardhurat dhe mbi kapitalin, në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë, e nënshkruar në Prishtinë më 03 tetor 2013 , (publikuar më 13.01.2014) Hyrja në fuqi nga 12 Mars 2014;
- Financimi dhe Projekt-Marrëveshja për mënjanimin e ujërave të zeza në jugperëndim të Republikës së Kosovës, Faza III-të, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane Kfë, Frankfurt am Main, është nënshkruar në Prishtinë, më 24 Tetor 2014. (Publikuar më 09 Korrik 2015)
- Marrëveshja për Rregullimin reciprok të transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtareve dhe mallrave, në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, e nënshkruar në Prishtinë 24 korrik 2014 (publikuar më 19.09.2014);. hyrja ne fuqi nga data 26 Mars 2015.
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për “Bashkëpunim financiar ushtarak”, si dhe Protokolli i implementimit në lidhje me Marrëveshjan. Është nënshkruar në qytetin e Budvës në Mal të Zi më 16 Tetor 2014.(Marrëveshja dhe Protokolli në fjalë janë nënshkruar për një periudhë të kohëzgjatjes për 5 vite) Është publikuar në Gazetën Zyrtare më 07 Maj 2015. Hyrja në fuqi më 23 Korrik 2015;
- Marrëveshja për Bashkëpunim Ekonomik, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, e nënshkruar më 26 prill 2015 (publikuar më 04.06.2015)
- Marrëveshja për Hapjen e Kalimit Kifitar të Përbashkët Kotlovë – Kuqishtë për Trafikun rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, e nënshkruar më 26 mars 2014 (publikuar më 07.05.2015)
- Marrëveshja për Bashkëpunimin Ekonomik në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, e nënshkruar më 10 prill 2015 (publikuar më 07.05.2015. Marrëveshja hyne ne fuqi nga data 18 Dhjetor 2015 ;
- Marrëveshja për Zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të instrumentit të asistencës para anëtarësimit IPA II në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, e nënshkruar më 30 janar 2015 (publikuar më 03.04.2015)
- Marrëveshja për Bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e Tregtisë, në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar në Shkup më 22 Janar 2015 (publikuar më 09.03.2015)
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Qeverisë Republikës së Kosovës Republikës dhe Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 (Projekti i subvencioneve). Është nënshkruar në Prishtinë, më 08 Shtator 2015. Hyrja në fuqi nga data 05 Tetor 2015
- Marrëveshja e huas lidhur me financimin e projektit "Modernizimi i shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës" në mes të Republikës së Kosovës duke vepruar përmes Ministrisë së Financave dhe UNICREDIT BANK AUSTRIA AG;
- Marrëveshja për Bashkëpunim Ekonomik, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, e nënshkruar më 26 prill 2015 (publikuar më 04.06.2015);
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore për “Shmangien e Tatimit të dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal Lidhur me Tatimet Mbi të Ardhurat dhe Mbi Kapitalin”. Është nënshkruar më 04 Qershor 2015 në Prishtinë. Publikuar në Gazetë Zyrtare më 09 Korrik 2015
- Kontratën për Grant (Marrëveshja për dhënie të grantit) të nënshkruar në Prishtinë, më datë 29 janar 2015, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Zyrës së Jashtme të Komonuelthit, përfaqësuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë.
- Marrëveshja ndërmjet Qeverise se Republikës se Kosovës dhe SHBA-ve për te përmirësuar përputhshmërinë e rregulloreve tatimore ne nivelin ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve te FATCA-s, e nënshkruar me 26 shkurt 2015, ne Prishtine. Hyrja në fuqi nga data 04 Nëntor 2015;

- Deklarata e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për Bashkëpunim në Fushën e Zhvillimit Rajonal në Zonat Ndërkufitare Kosovë-Shqipëri”. Nënshkruar në Tiranë me 23 mars 2015.
- Marrëveshja për “Bashkëpunim në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë” në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e nënshkruar në Prizren me datë 11 janar 2014. Hyrja në fuqi 11 mars 2015.
- Protokoll për zbatimin e Marrëveshjes kuadër mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për Bashkëpunimin në nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë”. Nënshkruar në Tiranë me 23 Mars 2015.

Anëtarësimi në OBT

Kosova ende nuk është anëtare e OBT-së por është duke u punuar në aktivitetet që ndërlidhen me këtë proces. Në këtë drejtim, drafti i parë i Memorandumit për regjimin e tregtisë së jashtme që është i nevojshëm për aplikim në OBT, është përgatitur në bashkëpunim me një projekt të BE-së. Gjatë vitit 2016 pritet që Kosova të aplikojë për anëtarësim në OBT.

Prioritetet afatmesme

- Përgatitja për anëtarësim dhe anëtarësimi (në fazën e parë me statusin e vendit vëzhgues) në OBT
- Vazhdimi i negociimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Bashkëpunimi për zhvillim dhe ndihma humanitare

Ministria e Punëve të Jashtme po shqyrton mundësinë për ngritjen e një divizioni për “Politikat e zhvillimit dhe ndihmës”. Duke qenë se ky proces përfshin edhe brenda dhe jashtë këtij institucioni, do të nisë një proces konsultimi edhe me Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Financave, etj si dhe me konsulentët ndërkombëtare.

3.32. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë dhe Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje janë të bazuara në akte ligjore, duke përfshirë marrëveshjeve ligjërishit detyruese ndërkombëtare, dhe në dokumentet politike. *Acquis* përbëhet nga deklaratat politike, vendime dhe marrëveshje. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të kryejnë dialog politik në kuadrin e Politikës së Jashtme të Përbashkët dhe të Sigurisë (PJPS), të lidhur me deklaratat e BE-së, për të marrë pjesë në veprimet e BE-së dhe për të aplikuar ne sanksione për masat kufizuese. Vendet aplikante janë të nevojshme në mënyrë progresive të harmonizohen me deklaratat e BE-së, dhe të aplikojnë për sanksione dhe masa kufizuese kur dhe ku kërkohen ato.

Dialogu politik zhvillohet intensivisht në disa nivele ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës edhe atyre të Bashkimit Evropian për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në procesin e integritimit, fillimisht përmes nënshkrimit, ratifikimit dhe implementimit të MSA-së.

Dialogu politik dhe dialogu për politika, sipas nevojës, kontribuojnë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Kosova zotohet për angazhim të vazhdueshëm drejt përmirësimit të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë. Ky proces do të sigurojë që të dyja vendet të mund të vazhdojnë rrugën e tyre përkatëse evropiane, duke shmangur bllokimin e njëjës apo tjetrës palë në këto përpjekje dhe gradualisht të shpien në normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, në formën e një marrëveshje ligjërishit të detyrueshme, ku të dy vendet do të jenë në gjendje të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre. Rrjedhimisht, Kosova vazhdimisht duhet të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë dhe të respektoj plotësisht parimet e bashkëpunimit gjithëpërfshirës rajonal.

Gjithashtu, detyrimet që dalin nga dispozitat e MSA-së parashohin që Kosova të zgjidh përmes dialogut dhe frymës së kompromisit çështjet e tjera të pazgjidhura, në bazë të zgjidhjeve praktike dhe të qëndrueshme dhe do të bashkëpunoj për çështjet e nevojshme teknike dhe ligjore me Serbinë; të bashkëpunojë në mënyrë efektive me misionin e Politikës së Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes përgjatë mandatit të tij dhe do të kontribuon në mënyrë aktive në përmbushjen e plotë dhe të papenguar të mandatit të tij në tërë Kosovën.

Komisioni i Stabilizim Asociimit do të rishikojë rregullisht progresin në këtë proces dhe mund të marrë vendime dhe të lëshojë rekomandime në këtë drejtim. KSA mund të ndihmoj këtë proces në përputhje me nenin 129.

Republika e Kosovës, ka marrë seriozisht përgjegjësinë e ofrimit të sigurisë për qytetarët dhe territorin të saj. Kosova e njeh rëndësinë e vazhdimin të ngritjes së aftësisë për institucionet e veta për të ofruar siguri të gjithë qytetarëve të Kosovës. Prandaj, si pjesë e procesit të marrjes graduale të më shumë përgjegjësi për sigurinë e saj, në mars të vitit 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka iniciuar Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), një rishikim gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve të saja të sigurisë. Qëllimi i RSSS-së është të bëhet një analizë e hollësishme të të gjitha aspekteve të sigurisë në Republikën e Kosovës për ti analizuar sfidat e sigurisë e së tashmes dhe së ardhmes; të përcaktohen qartë rolet e secilit institucion në sektorin e sigurisë për t'ju shmangur dyfishimit dhe për t'i maksimalizuar kapacitetet institucionale; si dhe të identifikohen kapacitetet e nevojshme për të ofruar mbrojtje dhe siguri qytetarëve të Kosovës.

Republika e Kosovës aspiron të jetë pjesë përbërëse e strukturave të sigurisë rajonale dhe globale, e në veçanti e BE-së, NATO-së, OSBE-ës dhe OKB-së. Në këtë contest, siguria kombëtare e Kosovës është e lidhur ngushtë me sigurinë rajonale dhe sigurinë më të gjerë Euro-Atlantike

Gjendja aktuale

Integrimi evropian i Kosovës është objektiv strategjik nacional, dhe garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit. Në këtë aspekt, qeveria e Republikës së Kosovës ka vullnet të plotë për të ndërmarrë të gjitha reformat e duhura në kuadër të procesit të integrimit evropian. Më tej, Kosova mbështet fuqimisht politikën e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si një entitet me influencë politike gjithnjë në rritje në politikën ndërkombëtare.

Korniza ligjore në fushën e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes është e vendosur dhe vazhdon të konsolidohet me ligjet e nevojshme me synim të trajtimit të të gjitha çështjeve që derivojnë nga kjo fushë. Korniza ligjore në fjalë është në përputhje me parimet dhe objektivat e BE-së dhe ndër të tjera përbëhet nga Ligji për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit; Ligjit për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit; Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, Strategjisë Kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2012-2017, Urdhërit Administrativ për parandalimin dhe zbulimin e shpërlarjes së parasë dhe Urdhërit Administrativ për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit.

Ndërsa, struktura institucionale përgjegjëse për politikë të jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes përbëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme, përfaqësitë diplomatike, si dhe koordinatorët kombëtarë në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal dhe Iniciativën Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjatë (MARRI).

Ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Kosovës mbetet avancimi i partneritetit strategjik me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, përfshirë vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me këto organizata, në rrugën drejt integritimeve Euro-Atlantike.

Kosova ka pikësypnim zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, përkatësisht marrëdhëniet të mira me vendet fqinje, si dhe dhënien e ndihmës për realizimin e axhendës së Brukselit për një rajon stabil, demokratik dhe të integruar në BE e NATO. Republika e Kosovës konsideron se bashkëpunimi rajonal është jo vetëm parakusht i integritetit evropian por edhe domosdoshmëri për stabilitetin rajonal. Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës ka të caktuar Koordinatorin Nacional përgjegjës për të gjitha nismat dhe mekanizmat rajonal (Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor).

Ky orientim i politikës sonë të jashtme gjithashtu reflektohet në pjesëmarrjen tonë proaktive në nismat dhe organizatat multilaterale që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Kosova është anëtare e 21 nismave rajonale, në mes tjerash bashkëpunimit në fushën e tregtisë, sigurisë, edukimit, teknologjisë, ambientit.

Për sa i përket gjendjes aktuale të sigurisë, është me rëndësi të theksohet se pas përmbylljes së procesit të RSSH-se dhe miratimit të Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës me Vendimin e Qeverisë nr. 01/173 të datës 04.03.2014, Qeveria ka ndjekur të gjitha procedurat për ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues mbi bazën e rekomandimeve të dala nga RSSH, duke përfshirë edhe amandamentimin e Kushtetutës.

Më datë 06.03.2014, Qeveria i ka propozuar Kuvendit të Kosovës Amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mbi këtë bazë, Kuvendi më datë 11 mars 2014 i ka paraqitur **Gjykatës Kushtetuese** propozimin e Qeverisë për të vlerësuar paraprakisht nëse amendamentet e propozuara nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liri të garantuara me Kapitullin dy (II) të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese më Aktgjykimin e saj nr. KO44/14, të datës 31 mars 2014, ka aprovuar propozim-amandamentet duke vlerësuar se të njëjtat nuk i pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin dy (II) të Kushtetutës.

Duke pasur parasysh shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës, amendamentet kushtetuese janë kthyer për riprocedim nga Qeveria.

Qeveria me Programin Legjislativ të vitit 2015, ka caktuar datën 30 qershor 2015, si datë të fundit për miratimin e këtyre amendamenteve.

Në të njëjtën kohë, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit dhe ministritë e linjës, kanë hartuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës. Ky Projektligj është shqyrtuar dhe harmonizuar edhe me këshilltarët e Ekipit të NATO-së si dhe është mbështetur nga Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-ve.

Me këtë Projektligj plotësohen dhe ndryshohen 39 (tridhjetë e nëntë ligje) që ndërlidhen me rekomandimet e dala nga Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Çështjet që ndërlidhen me plotësimet dhe ndryshimet kanë të bëjnë kryesisht me emrin, misionin, detyrat dhe strukturën e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës

Dialogu politik me Serbinë

Sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kosova mbetet e përkushtuar me pjesëmarrjen e saj në dialogun e nivelit teknik, në mënyrë që të arrihet përparim në implementimin e marrëveshjeve në mes të dyja palëve të përfshira.

Kosova vlerëson seriozisht rëndësinë e dialogut të Brukselit, jo vetëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të marrëdhëniet bilaterale mes dy shteteve, por sepse ky dialog është aktualisht kontribuuesi më i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës, si palë konstruktive dhe serioze në Dialogun e Brukselit, i jep rëndësi të veçantë zbatimit të gjitha Marrëveshjeve të Brukselit të katër viteve të fundit dhe marrëveshjeve potenciale që priten të arrihen në periudhën në vijim.

Ka pasur progres të caktuar në arritjen e marrëveshjeve në mes Kosovës dhe Serbisë, megjithatë gjetjet e Raportit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (2015) tregojnë për një progres të ulët në zbatimin e marrëveshjeve në përgjithësi. Duke parë marrëveshjet veç e veç, Raporti identifikon nivele të ndryshme progresi në disa fusha dhe mungesë progresi në shumicën e fushave.

Masat afatshkurtra:

- Strategjia kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2012-2017;
- Arritja e marrëveshjeve në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë
- RKS do të vazhdojë të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë;
- Ngritja e kapaciteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit dhe luftimin e terrorizmit.
- Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes të MSA-së, dialogu politik Kosovë-BE do të zhvillohet në formatin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit (KSA) dhe strukturave të tjera të përbashkëta. Planifikohet që të trajnohet stafi që do të jetë i përfshirë në mekanizmin për implementimin e MSA-së. Do të organizohen vizita në shtetet anëtare të rajonit si dhe shtetet kandidatë në mënyrë që të shkëmbehen sa më shumë informata mbi implementimin e MSA-së.
- Do të vazhdojë trajnimi i shërbyesve civil në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në këtë fazë, prioritet do të kenë shërbyesit civil nëpër ministri që ndjekin implementimin e MSA-së si dhe ata që janë direkt të involvuar në zbatimin e MSA-së.
- Planifikohet aplikimi për anëtarësim në disa organizata ndërkombëtare, europiane, si dhe rajonale (UNESCO, Interpol, Këshillin e Europës,...).
- Aderim në konventa ndërkombëtare
- Miratimi i amendamenteve kushtetuese për ngritjen e Forcave të Armatosura të Kosovës.
- Miratimi i Projektligjit për plotësimi dhe ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura- Projekt ky, që plotëson dhe ndryshon 39 ligje që përfshijnë fudhën e mbrojtjes.
- Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë;
- Draftimi dhe finalizimi i Strategjisë së Mbrojtjes.

Prioritetet afatmesme:

- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Punë të Jashtme;
- Do të vazhdojë trajnimi i shërbyesve civil në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Prioritet do të kenë ata që kanë për detyrë implementimin e masave kufizuese dhe kontrollit të armëve. Gjithashtu, përmes vizitave në shtetet anëtare, do të shkëmbehen përvojat mbi implementimin sa më efektiv të masave kufizuese.
- Republika e Kosovës do të vazhdojë të kontribuojë në përmirësimin e dialogut politik me BE-në dhe të jetë një aktor aktiv në këtë dialog. Republika e Kosovës do të vazhdojë të implementojë aktet ligjore të BE-së në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë.
- Sa i përket bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, Republika e Kosovës do të vazhdojë të jetë anëtare aktive në organizata ndërkombëtare (Komisionin e Venedikut, Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Frankofoninë, etj). Republika e Kosovës gjithashtu do të vazhdojë të luajë rol proaktiv në vijë me të gjitha obligimet në organizatat rajonale si partner i barabartë (SEECP, RCC,...)
- Gjithashtu, Republika e Kosovës do të vazhdojë të implementojë masat kufizuese të imponuara nga Këshilli. Në këtë mënyrë, Kosova do të krijojë mekanizmin për implementimin e masave restriktive.
- Miratimi i akteve të brendshme ligjore nga MFSK.

3.33. Kapitulli 32 i *acquis*-së: Kontrolli financiar

Ky kapitull mbulon dy fusha kryesore të politikave: (a) kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP) dhe auditimin e jashtëm (AJ) dhe (b) mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe mbrojtjen e Euros nga falsifikimi. Për sa i përket fushës së KBFP-së dhe Auditimit të Jashtëm, nuk ka legjislacion specifik të BE-së që do të përdorej në përafrimin e ligjeve kombëtare. Në vend të kësaj, vendet angazhohen që të përvetësojnë standardet ndërkombëtare të kontrollit dhe auditimit të jashtëm të definuara nga Organizata Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSAI) si dhe praktikat e mira të BE-së.

Kontrolli i brendshëm i Financave Publike është pjesë e integruar e menaxhimit të financave publike dhe përfshinë gjithë buxhetin publik. Në veçanti, parimet e Kontrollit Financiar kërkojnë ekzistencën e i) sistemeve efektive dhe transparente të kontrollit dhe menaxhimit financiar (përfshi inspektimet dhe kontrollet financiare adekuate ex-ante, të vazhdueshme dhe ex-post); ii) sistemeve funksionale të pavarura të auditimit të brendshëm; iii) strukturave përkatëse organizative (përfshi koordinimin qendror); dhe iv) auditimit të jashtëm funksional dhe financiarisht të pavarur, ndër të tjera, duke vlerësuar cilësinë e sistemeve të krijuara të KBFP-së. Në fushën e **auditimit të jashtëm** vendet kandidatë pritet që të zbatojnë standardet INTOSAI, në veçanti Deklaratat e Limës dhe Meksikës për pavarësinë funksionale, financiare dhe institucionale si dhe zbatim të auditimeve të financiare (të rregullsisë) dhe performacës.

Sa i përket **mbrojtjes financiare të interesave të BE-së**, Traktati për Funksionimin e BE-së (neni 325) kërkon që vendet anëtare të ndërmarrin masa kundër MASHTrimeve që ndikojnë në interesat financiare të BE-së. Vendet anëtare obligohen të koordinojnë veprimet dhe të bashkëpunojnë me Komisionin Evropian. Mbrojtja e interesave të BE-së përfshin përafrimin e legjislacionit kriminal vendor me Konventën për Mbrojtjen e Interesit Financiar të BE-së (PFI Convention) dhe tri protokollet e saj për bashkëpunim midis autoriteteve kombëtare dhe Komisionit. Vendet kandidatë kërkojnë të nominojnë një shërbim kombëtar kundër MASHTrimit si pikë kontakti për të facilituar koordinimin me Komisionin dhe vendet anëtare.

Sa i përket **mbrojtjes së euros kundër falsifikimit**, ky kapitull adreson aspektet jo-penale, ndërsa aspektet penale adresohen në kapitullin 24. Principet kryesore kundër falsifikimit të parasë janë të definuara në Konventën e Gjenevës dhe detajuar më tutje në *acquis* relevante. Legjislacioni relevant përfshinë procedura për mbledhjen, ruajtjen dhe shkëmbimin e informatave për bankënotat e falsifikuara, ndalimin e metaleve të ngjashme me monedhat e euros, obligimin që institucionet financiare të kontrollojnë autenticitetin, tërheqjen nga qarkullimi të bankënotave false dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimet e Republikës së Kosovës për Kapitullin e Kontrollit Financiar rrjedhin nga Neni 97 i MSA.

Neni 97 kërkon që bashkëpunimi mes palëve të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik. Në veçanti Palët të bashkëpunojnë me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të zbatimit të kontrollit efikas të brendshëm dhe sistemit funksionalisht të pavarur të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, në përputhje me kornizën e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikat e mira të BE-së. Gjithashtu, bashkëpunimi duhet të përqendrohet në krijimin dhe forcimin e njësive qendrore harmonizuese për menaxhimin financiar dhe kontroll.

Në fushën e Auditimit të Jashtëm, Neni 97 kërkon që palët të bashkëpunojnë veçanërisht me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të auditimit të jashtëm të pavarur funksional në Kosovë në përputhje me

standardet e pranuar ndërkombëtare dhe praktikat e mira të BE-së. Bashkëpunimi gjithashtu të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Raporti i KE-së për Kosovën 2015 konstaton se në fushën e Kontrollit Financiar duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për zbatimin e KBFP-së në të gjitha nivelet e administratës dhe në ndërmarrjet në pronësi publike. Gjithashtu, nënvizon se duhet të fillojë zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara në strategjinë e KBFP 2015-2017 dhe të miratohet legjislacioni i rishikuar për KBFP. Në të njëjten kohë duhet të sigurohen veprime sistematike në gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm. Ndikimi i auditimit të jashtëm duhet të përmirësohet më tej. Të ngriten kapacitetet administrative në NjQH si dhe Kosova të ndajë fonde të mjaftueshme për certifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional të auditorëve. ZAP duhet të ketë pavarësi funksionale, operacionale dhe financiare, në përputhje me standardet e INTOSAI. Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së mbetet i dobët. Gjithashtu, Raporti nënvizon se Kosova nuk ka marrëveshje formale bashkëpunimi me Komisionin Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane për mbrojtjen e euros nga falsifikimi.

Gjendja aktuale

Korniza ligjore

Në Kosovë, ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative që rregullon fushën e Kontrollin të Brendshëm të Financave Publike, duke përfshirë: ligjet, udhëzimet, rregulloret, standardet e tjera ndërkombëtare, politikat e Qeverisë së Kosovës.

Baza ligjore **për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike** është përcaktuar nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), ndryshim dhe plotësim i Ligjit nr. 03-L-048, nr. 2010/03-L-221 ndryshim plotësimi i LMFPP nr. 03-L-048, nr. (2012/04-L-116); ndryshim, plotësim i LMFPP nr. 03-L-048, nr. 2013/04-L-194. Korniza ligjore ekzistuese për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike përmban parimet e përgjithshme dhe i referohet standardeve të INTOSAI, Kornizës COSO, Standardeve të Institutit të Auditimit të Brendshëm (IIA).

Legjislacioni primar në fushën e *Auditimit të Brendshëm* përfshin Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048 dhe Ligjin nr. 3/L-128 për Auditim të Brendshëm, ndërsa legjislacioni sekondar përfshin:

- Doracaku për AB;
- UA nr. 22/2009 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurën e pajisjes me licencë të përkohshme të auditorëve të brendshëm të sektorit publik, i cili përcakton kushtet për licencimin e auditorëve me licenca të përkohshme;
- UA nr. 23/2009 për Themelimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Sektorin Publik, i cili përcakton kriteret për krijimin e funksionit të auditimit të brendshëm;
- UA nr. 11/2010 për funksionimin e komiteteve të auditimit në subjektin e sektorit publik, prezanton mënyrën e krijimit dhe funksionit të komiteteve të auditimit;
- UA nr. 05/ 2012 për Procedurën e pajisjes me licencë profesionale të auditorëve të brendshëm të sektorit publik, prezanton kriteret për licencimin e auditorëve të brendshëm me licenca profesionale e cila licencë jepet pas certifikimit.

Legjislacioni primar në fushën e *Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit* përfshin Ligjin nr. 03/L-048 MFPP, ndërsa legjislacioni sekondar përfshin:

- Rregulli financiar i Thesarit nr. 01/2010 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nga 30.07.2010, prezanton kornizën COSO dhe parimet e llogaridhënies në kontekstin e zinxhirit të përgjegjësisë në sektorin publik të Kosovës. Shumica e dispozitave në këtë rregullore janë përcaktuar në Ligj. Për shembull llogaridhënia e deputetëve të Kuvendit dhe Kryesuesve

ekzekutiv të qeverisë qendrore dhe lokale, e tërë terminologjia e MFK-së dhe interpretimi i saj në kontekstin e sektorit publik në Kosovë.

- Rregulli financiar nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e fondeve publike trajton shpenzimet dhe kontrollin e brendshëm dhe decentralizimin e menaxhimit të shpenzimeve tek organizatat buxhetore.
- Doracaku i Procedurave të MFK-së, që është në fuqi nga viti 2011, përmban 14 procedura që synojnë mbulimin e të gjitha fushave të ciklit buxhetor. Doracaku i MFK-së do të mund të ishte përdorur nga organizatat buxhetore po të kishin sistem të duhura informative të menaxhimit, ku kontrollet janë pjesë e proceseve me pak udhëzime të ofruara nga NjQH/MFK-ja dhe nëse do të kishte llogaridhënie të rreptë dhe mekanizma raportimi. Këto kushte nuk kanë qenë në zbatim në kohën e fuqizimit të Doracakut të MFK-së.

Nga Ministria e Financave janë nxjerrë edhe disa Udhëzime Administrative (UA) në lidhje me kontabilitetin, raportimin financiar, caktimin e kostos së politikave të reja dhe menaxhimin e pasurive jo-financiare:

- UA nr. 01/2013/MF për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave për caktimin e kostos së nismave të reja të politikave;
- Rregulli Financiar nr. 02/2013/MF për Raportimin e borxheve nga organizatat buxhetore;
- Rregullorja nr. 03/2013 për Pasqyrat Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore;
- Rregullorja e MF - nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo-financiare nga organizatat buxhetore. Ligji mbi Auditimin e Brendshëm (Ligji nr. 03/L-128).

Përveç legjislacionit të lartpërmendur, ka edhe ligje të tjera që kanë ndërlidhje me KBFP, duke përfshirë:

- Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111);
- Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Nr. 04/L-111);
- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/L-049);
- Ligjet vjetore mbi Miratimin e Buxhetit të Kosovës
- Ligjin për Prokurimin Publik (Ligji nr. 04-L-042);
- Ligjin për Administratën Shtetërore (Ligji nr. 03/L-189);
- Ligjin për Themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral (Ligji nr. 03/L-075);
- Ligjin Anti-Korrupsion (Ligji nr. 2004/34);
- Ligjin mbi Shërbimin Civil (Ligji nr. 2010/03-L-149);
- Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil (Ligji nr. 03-L-147) dhe
- Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (Ligji nr. 03/L-215).

Sa i përket **Auditimit të Jashtëm**, Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës theksojnë se ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë janë primare për funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm. Këto dy parime janë vendimtare për institucionin tonë. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm dhe ligjor; në pajtim me standardet e pranuar ndërkombtarisht të auditimit në sektorin publik dhe një kodi të brendshëm për mirësjelljen profesionale. Mandati dhe funksionimi rregullohet me anë të legjislacionit primar:

- Kushtetutës së Kosovës nenet 136, 137, 138;
- Ligjin nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë.

Legjislacioni tjetër relevant për fushën e auditimit përfshin:

- Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligji për prokurim publik;
- Ligji për shërbimin civil;

- Ligji për ndërmarrjet publike;
- Ligji për pagat e Nëpunësve Civil;
- Ligji për Anti-korrupsion; etj

Politikat dhe Strategjitë në fushën e KBFP

Dokumenti i Politikave të KBFP 2011 konfirmon përkushtimin e Qeverisë për të trajtuar përgjegjësitë e saja sipas Kushtetutës, Kapitullit 32 të Acquis në kontekstin e prioritetëve vendore.

Strategjia për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike për vitin 2015-2019 - Qëllimi i strategjisë është të përmirësoj sistemin e MFK-së si dhe të AB-së, duke mundësuar shpenzim efikas publik, shërbime më të mira, sigurim të transparencës, shpenzim adekuat të buxhetit të Republikës së Kosovës, granteve, donatorëve dhe fondeve të huazuara. Strategjia e KBFP-së sjell një qasje moderne të menaxhimit, e cila karakterizohet nga menaxhimi i bazuar në rrezik, shfrytëzimit intensiv të menaxhimit të sistemeve të informimit, kontrolleve të integruara për zvogëlimin e rrezikut me një nivel të lartë automatizimi. Kjo qasje moderne kërkon njohuri profesionale shtesë, llogaridhënie menaxheriale dhe auditim të avancuar të brendshëm për t'i ndihmuar organizatat në arritjen e objektivave të tyre.

Që nga viti 2009 **Zyra e Auditorit të Përgjithshëm** ka adoptuar Strategjinë e Zhvillimit Korporativ. Tani është amandamentuar Strategjia dhe kjo paraqet rrugën e ZAP-it deri në vitin 2020 dhe është e përafëruar me Strategjinë e Integritimit Evropian. Zyra në vazhdimësi kujdeset në zhvillimin profesional të auditorëve për të siguruar kualifikimet e duhura për të kryer punën tonë si auditor.

Sa i përket **mbrojtjes së euro-s kundër falsifikimit** Banka Qendrore e Kosovës në kuadër të kompetencave të saj më 14 mars, 2007 ka nxjerrë UA mbi Shmangien e Kartëmonedhave dhe Monedhave Euro të Falsifikuara nga Qarkullimi, udhëzim që vlen për të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë dhe të cilat janë të licencuara nga BQK-ja. Qëllimi i këtij Udhëzimi është vendosja e masave të nevojshme për arsye të shmangies së kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara euro nga qarkullimi.

Institucionet financiare, konkretisht institucionet e kreditimit dhe çdo institucion tjetër i angazhuar me ndarjen dhe shpërndarjen e kartëmonedhave dhe monedhave publikut si një veprimtari profesionale, duke përfshirë institucionet, veprimtaria e së cilave konsiston në këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave të valutave të ndryshme, si p.sh. zyrat e këmbimit, do të jenë të detyruara të heqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të pranuar prej tyre, të cilat ata i dinë ose kanë arsye të mjaftueshme të besojnë që janë të falsifikuara. Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshura si të falsifikuara duhet menjëherë t'i dorëzohen autoritetit kompetent (në këtë rast Policia dhe Policia ia paraqet ato Agjencisë Kosovare për Forenzikë). BQK-ja gjithashtu ka lëshuar një dokument "Këshilla të vlefshme për operuesit me para të gatshme" që përcakton veprimet hap-pas-hapi se si t'i trajtoni paratë e dyshuara si të falsifikuara.

Korniza institucionale

Qeveria ka krijuar një kornizë institucionale të përbërë nga organizatat e sektorit publik duke punuar me drejtimin e Njësisë Qendrore Harmonizuese, përkatësisht për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) dhe Auditimin e Brendshëm (AB) si dhe nën mbikëqyrjen e auditorit të jashtëm për të krijuar një zinxhir të llogaridhënies.

Koncepti i "Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike" së pari është zyrtarizuar në vitin 1999 nga Komisioni Evropian. Ai i referohet "sistemeve të kontrollit të brendshëm të qeverisë të synuara në mbrojtjen e interesave financiare të qeverisë në tërësi". KBFP u krijua si strategji e mirë për të ndihmuar procesin e reformës në zhvillimin e sistemeve publike të kontrollit të brendshëm në vendet të cilat dëshirojnë të bëhen candidate për anëtarësim në BE. Sistemi i KBFP-së përkufizohet si sistem i cili

përbëhet nga elementët funksionale të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) dhe Auditimit të Brendshëm (AB) bashkë me institucionet përgjegjëse për harmonizimin e këtyre funksioneve përgjatë qeverisë (NjQH=(MFK + AB).

Subjektet e sektorit publik (organizatat buxhetore)

Llogaridhënia përbëhet nga një zinxhir i pjesëmarrësve ku secili është përgjegjës për arritjen e qëllimeve të caktuara dhe secili duhet t'i jap llogaridhënie një autoriteti të nivelit më të lartë për arritjen e këtyre qëllimeve. Niveli më i lartë i autoritetit në këtë zinxhir mbahet nga qytetarët të cilët përfaqësohen nga deputetët e zgjedhur në Kuvend dhe në qeveritë komunale. Subjektet në sektorin publik bartës të KBFP janë:

- Kuvendi - Në kuadër të Kuvendit të Kosovës është krijuar Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike i cili ka autoritetin për mbikëqyrjen e shpenzimeve të parasë publike përmes raporteve nga ZAP, NjQH etj;
- Qeveria e Kosovës - cakton kompetencat dhe përgjegjësit për Ministrat e saj për të zbatuar politikat e Qeverisë nëpërmjet rregulloreve, politikave dhe aranzhimeve administrative me menaxhmentin e lartë të organizatave buxhetore.
- Ministri i Financave - është përgjegjëse për zhvillimin e rregullave dhe procedurave të detajuara për KBFP (MFK dhe AB), për trajnimin dhe ofrimin e mbështetjes teknike për të gjitha palët në lidhje me zbatimin e rregullave të MFK-së dhe AB;
- Menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik - mban përgjegjësinë e plotë për zbatimin e KBFP-së dhe është përgjegjës për performancën e tyre në përdorimin e resurseve publike për të arritur objektivat organizative.

Në fushën e **auditimit të jashtëm**, Zyra Kombëtare e Auditimit luan një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e shpenzimeve publike dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe qeverisjes së mirë. Sigurimi i pavarësisë funksionale dhe financiare mbetet një prioritet në fushën e auditimit të jashtëm. Në periudhë afatshkurtër pritet të zhvillohen më tutje procedurat dhe kapacitetet administrative për kryerje të auditimeve jo-statutore⁴³ për të vlerësuar nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet ekonomikisht dhe në mënyrë efikase dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre. Në periudhë afatmesme zhvillimi i qëndrueshëm institucional, ruajtja e cilësisë dhe zhvillimi i procedurave dhe kapaciteteve administrative për të siguruar mbrojtje efektive të interesave financiare të Bashkimit Evropian (BE) do të jetë një prej prioriteteve kyçe.

Neni 136 i Kushtetutës së Kosovës definon Auditorin e Përgjithshëm si institucioni më i lartë për kontroll ekonomik dhe financiar. Auditori i Përgjithshëm është i përzgjedhur nga Kuvendi me votë të shumicës të të gjithë deputetëve bazuar në propozimin e Presidentes/it. Kuvendi vendos në shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm me (2/3) e shumicës të të gjithë deputetëve nga propozimi i Presidentes/it ose në bazë të propozimit të një të tretës (1/3) të të gjithë deputetëve. Mandati i AP është pesë (5) vjeçar me mundësi vazhdimi për rizgjedhje edhe për një mandat. Kjo e fundit nuk është optimale. Një mandat i vetëm prej 7-8 vite do të ishte i preferuar. Kjo do të forconte pavarësinë.

Neni 137 i Kushtetutës mund të azhurnohet në pajtim me definicionet e tanishme të SNISA sa i përket rolit dhe mandatit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Aktualisht cek se Auditori i Përgjithshëm kontrollon: (1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë; (2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal; (3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Mënyra e tanishme e definimit në Kushtetutë nuk është ndonjë pengesë në zhvillimin e më tutjeshëm të auditimit të jashtëm publik. Por, mund të konsiderohet për amandamentim kur është e përshtatshme.

⁴³ Auditimet jo-statutore janë auditimet e performancës që nuk janë kërkesë vjetore e parashikuar me ligj.

Ligji 03/L-075 është pjesërisht i vjetruar. Nuk e adreson pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare në mënyrë të mjaftueshme. Kështu, Ministria e Financave si sponzorizues të këtij projektligji ka draftuar një projektligj të ri për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit. Ky projektligj adreson shumë më mirë këto çështje dhe në korrik 2015 ka kaluar nga Qeveria dhe është dërguar në Kuvend për procedim të mëtutjeshëm.

Mjetet e punës:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit;
- Manuali i Auditimit të Rregullsisë;
- Udhëzuesi i menaxhimit të cilësisë të auditimit;
- Udhëzimi për Auditim të Performancës;
- Kodi Etik dhe i Mirësjelljes Profesionale;
- Strategjia për Zhvillim të Përbashkët;
- Politikat dhe strategjitë tjera sekondare;
- Rezoluta A/66/209 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Skema e Certifikimit për Auditorët e Rregullsisë

Një program i certifikimit për Auditim të Rregullsisë është i vendosur dhe implementohet bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit për sektor publik (SNISA). Programi është i ndarë në katër pjesë: Hyrja, Përgatitja, Pjesa Teknike dhe Zhvillim i Vazhdueshëm Profesional. Pjesa teknike kryhet nga një shoqatë vendore⁴⁴ e certifikuar nga IFAC. Programi financohet nga buxheti i Kosovës. Koha që zakonisht është 3.5 vite për t'u certifikuar dhe ky vendim i certifikimit merret bazuar në rezultatet e provimeve, përvojën dhe rezultatet e vlerësimeve të stafit.

Skema e Certifikimit për Auditorët e Performancës

Një program i certifikimit për auditorët të performancës është elaboruar dhe viti i parë i kësaj skeme është në implementim. Një skeme e plotë për këtë lloj profesioni është në përpunim.

Sa i përket **mbrojtjes së parasë kundër falsifikimit në Republikën e Kosovës**, në vazhden e marrëdhënieve të bashkëpunimit reciprok ndërmjet Policisë së Kosovës (PK-ja) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK-ja) me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së parasë kundër falsifikimit në Republikën e Kosovës, më 11 shtator 2009 PK-ja dhe BQK-ja kanë nënshkruar marrëveshjen mbi themelimin e Komitetit Qendror të Analizave të Parave të Falsifikuara (Komiteti).

Komiteti është i përbërë nga tre përfaqësues të lartë të PK-së dhe tre përfaqësues të lartë të BQK-së. Përfaqësuesit e Komitetit takohen në suaza të rregullta me qëllim të shqyrtimit të çështjeve që dalin nga roli i këtij komiteti. Komiteti nuk ka fuqi vendimmarrëse.

Roli kryesor i komitetit është:

- Përforcimi i masave të nevojshme me qëllim të shmangies së kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara nga qarkullimi;
- Mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave teknike dhe statistikore lidhur me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara; dhe
- Sigurimi i informatave dhe udhëzime si dhe trajnimeve për institucionet financiare, institucionet e tjera relevante dhe publikun e gjerë në lidhje me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara.

Komiteti ka kompetenca të themelojë grupe punuese sipas nevojës për të studiuar më tutje çështjet e caktuara dhe për t'i bërë rekomandime mbi atë çështje Komitetit. Grupet punuese do të kenë statusin ad hoc me mandat dhe kornizë kohore të qartë.

⁴⁴ Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës.

Në Republikën e Kosovës, organi kompetent për analizën dhe ekspertizën e parave që dyshohet të jenë të falsifikuara është Agjencia Kosovare për Forenzikë - Laboratori për dokumente dhe dorëshkrime, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (më parë kishte operuar në kuadër të PK).

Masat afatshkurta

Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike

Bazuar në Strategjinë për KBFP:

- Implementimi i aktiviteteve të përcaktuara në strategjinë e KBFP 2015-2017;
- Vazhdimi i veprimeve sistematike në gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm;
- Plotësim-ndryshimi i LMFPP;
- Plotësim-ndryshimi i Ligjit të Auditimit të Brendshëm;
- Azhurnimi i legjislacionit sekondar (udhëzimet, rregulloret, procedurat, doracaku);
- Krijimi i skemës së qëndrueshme vendore (bazuar në standardet e CIPFA) për certifikim të auditorëve të brendshëm;
- Krijimi i skemës së qëndrueshme për trajnimin e Zyrtarëve Kryesor Financiar (ZKF);
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional;

Auditimi i jashtëm

- Adoptimi i ligjit të Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit – ky projektligj në fund të muajit korrik ka kaluar nga Qeveria. Ky projektligj është në përputhje me standardet e njohura ndërkombtarisht të auditimit për sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane;
- Draftimi i udhëzuesve dhe rregulloreve në përputhje me ligjin e ri dhe implementimi i tyre;
- Implementimi i Planit të Strategjisë së Zhvillimit Korporativ 2015-2020;
- Rritja e numrit të auditorëve të profesionalizuar që kalojnë nivele të ndryshme të skemës së re të certifikimit për auditor të rregullsisë;
- Softueri për një auditim më efektiv i instaluar dhe funksional;
- Një qasje e vazhdueshme dhe fleksibile në bashkëpunimet me partnerët ndërkombëtar (projektet e financuara nga BE dhe BB dhe bashkëpunimet bilaterale me ZKA të Suedisë
- Një qasje pjesëmarrëse (gjithëpërfshirëse) në zhvillimin e strategjive dhe fokusit (shoqëria civile, akademinë, media, donatorë, institucione private dhe publike);
- Audimet e obligueshme të Rregullsisë për të gjithë shpenzuesit buxhetor të përfunduara (përfshirë të gjitha komunat) në përputhje me SNISA;
- Numri i auditimeve të Përformances (përfshirë auditimet e teknologjisë informative) në rritje dhe të kryera sipas SNISA;
- Raporti Vjetor i Auditimit i publikuar në kohë dhe me cilësi të mjaftueshme dhe i diskutuar në Kuvend;
- Pasi që emërohet Auditori i Përgjithshëm të rishikohet Plani Korporativ nëse ka nevojë për azhurnim që të reflektojë prioritetet e tij/saj.

Prioritetet afatmesme

Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike

- Avancimi dhe integrimi i sistemeve të teknologjisë informative;
- Përmirësimi i buxhetimit sipas programit dhe raportimit me objektiva dhe tregues të performancës (planifikimi strategjik lidhet me burimet buxhetore). Menaxhimi i rrezikut nga organizatat buxhetore;
- Vendosja e një sistemi të përcaktuar mirë të KBFP-se, që siguron llogaridhënien e menaxhmentit për sistemet e MFK-se dhe një funksion të AB, që mbulon të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit kombëtarë (përfshirë fondet e jashtme), dhe siguron pajtueshmëri me

legjislacionin relevant, përshkrimet e buxhetit dhe parimet e menaxhimit të mirëfilltë financiar, transparent, efikas, efektiv dhe ekonomik, nën ombrellën e Dokumentit të Politikave të KBFP-së

- Kontrollat ex-ante dhe ex-post që bazohen në analiza zyrtare të rreziqeve;
- Një funksion funksionalisht të pavarur të auditimit të brendshëm, që plotëson standardet e pranuar ndërkombëtare;
- Trajnimi për menaxherët e të gjitha institucioneve për zbatimin e llogaridhënies menaxheriale dhe trajnimi i auditorëve të brendshëm;
- Monitorimi i Subjekteve të sektorit publik dhe NjAB-ve të përzgjedhura.
- Ndarje të përgjegjësive, për t'ju shmangur konfliktit të interesave në menaxhimin dhe kontrollimin e fondeve publike;
- Institucione që kanë personel dhe fonde adekuate, për të siguruar harmonizim qendror të MFK-së si dhe AB-së; dhe
- Krijimi i kapaciteteve të auditimit për auditimin e projekteve të financuara / bashkë- financuara nga BE-ja;
- Mbrojtje të interesave financiare të Komunitetit Evropian.

Auditimi i jashtëm

- Rishikimi i Planit Korporativ për të vlerësuar se çka është arritur dhe azhurnimi sipas nevojës;
- Zhvillimi i qëllimeve për marrëdhëniet tona me komunitetin e SAI;
- Gjetja e formave të pjesëmarrjes tonë në INTOSAI që nuk varet nga statusi jonë kombëtar;
- Gjetja e mundësive për të kontribuar në zhvillimin regjional të Institucioneve Supreme të Auditimit përmes pjesëmarrjes në Komisione, kontributit në artikujt profesional, dhe formave tjera;
- Rishikimi i fushëveprimit për rishikim të operacioneve tona nga kolegët⁴⁵;
- Zhvillimi i mëtejshëm i relevancës së auditimit duke kryer në mënyrë gradual më shumë auditime të performancës;
- Gjetja e një hapësire shtetërore të akomodimit e përshtatshme dhe afatgjate;
- Fillimi i zbatimit të udhëheqjes sipas sistemit të menaxhimit të buxhetit;
- Gjetja e formave të përshtatshme dhe duhura për kompensimet;
- Drejtorët dhe senior auditorët angazhohen në mentorim në çdo nivel përgjatë Zyrave të auditimit;
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me NjQH AB dhe gjetja e mundësive që të zvogëlohet sasia e përgjithshme e punës së auditimit;
- Zhvillimi i marrëdhënieve të punës me ekzekutivin në fushën e Reformës së Administratës Publike;
- Të vazhdohet me prodhimin e Raportit Vjetor të Auditimit në kohë, me cilësi më të mirë dhe rekomandime efektive, bazuar në relevancë më të madhe të auditimit;
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimeve të TI;
- Fokusim më i madh në fushat e interesit për menaxhim të decentralizuar të fondeve të IPA.

3.34. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Ky kapitull mbulon rregullat lidhur me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së (burimet vetjake). Këto burime përbëhen kryesisht nga kontributet e shteteve anëtare, bazuar në burimet e veta tradicionale nga dogana dhe taksat bujqësore dhe të sheqerit; në burime të bazuara në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në burime të bazuara në nivelin e të ardhurave kombëtare bruto. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitete të duhura administrative për të koordinuar në mënyrë adekuate dhe për të siguruar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e burimeve të veta. Acquis në këtë fushë është drejtpërdrejt e detyrueshme dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

⁴⁵ Peer review.

Kërkesat MSA-së

Neni 74 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *Acquis* të BE-së, që përfshin edhe këtë kapitull.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Aktet ligjore kryesor relevante për këtë Kapitull përfshijnë:

- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ligji nr. 05/L -046 për Plotësimin dhe Ndryshimin E Ligjit nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 05/L -037 për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar;
- UA MF-NR. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar;
- Ligji nr. 04/L-099 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave të Kosovës;
- Udhëzim Administrativ MF - nr. 05/2014 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 për implementimin e kodit doganor dhe të akcizave, të plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2010 dhe me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2013.

Sistemi i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në territorin e Republikës së Kosovës rregullohet me Ligjin nr. 05/L -037 për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar përfshinë aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe e cila llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, që në fund bartet nga konsumatori i fundit.

TVSH ngarkohet me normën standarde prej tetëmbëdhjetë përqind (18%), ndërsa norma e reduktuar në TVSH llogaritet dhe paguhet prej tetë përqind (8%) për disa mallra dhe shërbime bazike, si dhe importit të tyre.

Procedurat e mbledhjes dhe të kontrollit për detyrimet doganore dhe taksat e importit kryhen nga Dogana e Kosovës. Dogana e Kosovës është nën autoritetin e funksioneve të Ministrisë së Financave, në bazë të Ligjit nr. 03/L-109 i datës 10 nëntor 2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-099, i datës 3 maj 2012 Kodi Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Ky ligj është pjesërisht në harmoni me Kodin Doganor të BE-se, me konkretisht me Rregulloren e Këshillit (KEE) 2913/92/ “Për Themelimin e Kodit Doganor Komunitar”.

Sa i përket Buxhetit, bazuar në nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Departamenti i Buxhetit është i autorizuar dhe përgjegjës për:

- Përgatitjen e Propozim Buxhetit të Republikës së Kosovës,
- Përgatitjen e Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve,
- Zbatimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës,
- Vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore,
- Vlerësimin e ndikimit financiar të politikave qeveritare dhe
- Ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit me ligj.

Departamenti i Buxhetit Komunal është i autorizuar dhe përgjegjës për:

- Përgatitjen e Propozim Buxhetit të Komunave,

- Përgatitjen e pjesëzës së Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale si pjesë integrale e KASH-it,
- Ndhimje në zbatimin e Buxhetit të Komunave të Republikës së Kosovës,
- Shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore dhe ushtrimin e të gjitha përgjegjësive të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit Komunal me kuadrin ligjor.

Korniza institucionale

Institucioni kryesor për këtë kapitull është Ministria e Financave. Në kuadër të Ministrisë së Financave strukturat kontribuuese janë Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës po ashtu në kuadër të Ministrisë Departamenti i Buxhetit, Departamenti i Buxhetit Komunal si dhe Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar Financiar.

Masat afatshkurtra:

- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit vjetor për vitin 2017. Për këtë projektligj institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe për dërgimin për miratim në Qeverinë e Kosovës është Ministria e Financave. Më pas këtë projektligj Qeveria e dorëzon për miratim në Kuvend. Ky projektligj duhet të miratohet nga Kuvendi deri më 31 dhjetor të vitit 2017.
- Miratimi i ndryshimeve lidhur me obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare, bazuar në nenin 7 të Ligjit vjetor të Buxhetit. Institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Qeverinë e Kosovës të tabelave të buxhetit është Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit.
- Nxjerrja e Qarkores së parë buxhetore 2017/01 për organizata buxhetore deri me 15 maj 2016 ku ofrohen udhëzimet e para për përgatitjen e buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimeve 2018-2019, kalendari kohor si dhe dhënia e kufijve të parë fillestar për vitin 2017 dhe vlerësimeve për vitet 2018 – 2019.
- Nxjerrja e Qarkores së dytë buxhetore 2017/02 për organizata buxhetore, dhënia e kufijve të fortë për vitin 2017, vlerësimeve për vitet 2018–2019 si dhe orarin e dëgjimeve buxhetore.
- Sipas nevojës, nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore 2017/03.
- Dhënia e opinionit të pavarur të Departamentit të Buxhetit lidhur me vlerësimin e ndikimit buxhetor të një legjislacioni të propozuar.

Prioritetet afatmesme:

- Harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së për TVSH;
- Ngritja e kapaciteteve administrative dhe institucionale për të aplikuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte rregullat e burimeve vetanake të BE-së;
- Harmonizimi i komponentëve për llogaritjen e të Ardhurave Kombëtare Bruto me standardet ESA 95;
- Deri më 30 prill 2016 Qeveria do t'ia dorëzojë Kuvendit Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal 2017 si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale 2018-2019.
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit vjetor për vitin 2017.
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit vjetor për vitin 2018.
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit vjetor për vitin 2019.
- Përgatitja e Dokumentit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2017 – 2019
- Përgatitja e Dokumentit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018 – 2020
- Përgatitja e Dokumentit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019 - 2021

Për më shumë informacion referohuni kapitullit 16 “Tatimet” dhe 29 “Unioni doganor”.

3.35. Kapitulli 34 i acquis-së: Institucionet

Ky kapitull i acquis-së nuk mbulohet nga ky program në këtë fazë të aderimit në BE.

3.36. Kapitulli 35 i acquis-së: Çështjet e tjera

Ky kapitull i acquis-së nuk mbulohet nga ky program në këtë fazë të aderimit në BE.

MATRICA E MASAVE AFATSHKURTRA

MASAT LEGJISLATIVE

Nr.	Objektivat / Referenca kornizë	Aktet kombëtarë që do të harmonizohen	Aktet e acquis-së së BE-së që do të transpozohen	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afatet kohore	Niveli i harmonizimit	Buxheti		
							TOTALI	BRK	Donatorët
1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE									
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit									
1.1.1. Kushtetuta, Parlamenti dhe sistemi zgjedhor									
1.1.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
1.1.1.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Ligji për Kuvendin e Kosovës (ligj i ri)	N/A	Kuvendi ZKM MF MAP MIE	K4 2016				
1.1.1.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës (rregullore e re)	N/A	Kuvendi	K4 2016				
1.1.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
1.1.1.	Nuk është planifikuar ndonjë masë afatshkurtër në kuadër të kësaj kategorie të këtij kapitulli të programit.								
1.1.2. Sistemi gjyqësor									
1.1.2.	Shihni kapitullin 3.24 <i>Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore</i>								
1.1.3. Administrata publike									
1.1.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	LIGJI NR. 03/L-149 SHËRBIMIN CIVIL (plotësim-ndryshim)	N/A	MAP	K4 2016				
1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Ligji për Administratën Publike (ligj i ri)	N/A	MAP	2016	N/A			
1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Ligji për Pagat nga Buxheti i Kosovës (ligj i ri)	N/A	MAP MF	K4 2016	N/A			
1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (ligj i ri)	Drektiva 2006/123/ KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm".	MAP	K1 2016	T			
1.1.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Aktet nënligjore të Ligjit për Shërbimin Civil (plotësim-ndryshim)	N/A	MAP	K4 2016	N/A			

1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Aktet nënligjore të Ligjit për Administratën Publike (plotësim-ndryshime)	N/A	MAP	K4 2016	N/A			
1.1.3.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së mbi administratën publike (neni 120)	Aktet nënligjore që derivojnë nga Ligji për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit (plotësim-ndryshim)	N/A	ASHI/MAP	K4 2016	N/A			
1.1.4. Avokati i Popullit									
1.1.4.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
1.1.4.	Nuk është planifikuar ndonjë masë afatshkurtër në kuadër të kësaj kategorie të këtij kapitulli të programit. Shihni gjithashtu kapitullin 324 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore								
1.1.4.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
1.1.4.	Nuk është planifikuar ndonjë masë afatshkurtër në kuadër të kësaj kategorie të këtij kapitulli të programit. Shihni gjithashtu kapitullin 324 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore								
1.1.5. Politikat kundër korrupsionit									
1.1.5.	<i>Shihni kapitullin 3.24 Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore</i>								
1.1.6. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë									
1.1.6.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
1.1.6.	Te zbatohen dispozitat e MSA-së mbi sundimin e ligjit (neni 3, 12)	1. Amandamentet kushtetuese që kanë të bëjnë me ristrukturimin e Forcës së Sigurisë dhe misionin e Forcave të Armatosura; (Amandament për ngritjen Institucionit të Komisionerit Parlamentar)	N/A	MFSK Kuvendi AKI ZKM MPB MPJ MD MF	K4 2016	N/A			
1.1.6.	Te zbatohen dispozitat e MSA-së mbi sundimin e ligjit (neni 3, 12)	2. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës	N/A	MFSK Kuvendi AKI ZKM MPB MPJ MD MF	K4 2016	N/A			
1.1.6.	Te zbatohen dispozitat e MSA-së mbi sundimin e ligjit (neni 3, 12)	3. Ligji për Komisionerin për Forcat e Armatosura dhe Policinë e Kosovës	N/A	MFSK Kuvendi AKI ZKM MPB MPJ MD MF	K4 2016	N/A			
1.1.6.	Te zbatohen dispozitat e MSA-	4. Ligji për ndryshimin	N/A	MFSK	K4 2016	N/A			

	së mbi sundimin e ligjit (neni 3, 12)	dhe plotësimin e Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë		Kuvendi AKI ZKM MPB MPJ MD MF					
1.1.6.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
1.1.6.	Nuk është planifikuar ndonjë masë afatshkurtër në kuadër të kësaj kategorie të këtij kapitulli të programit. Shihni gjithashtu kapitullin 324 <i>Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.</i>								
1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve									
1.2.	Shihni kapitullin 3.24 <i>Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore'</i>								
1.3. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare									
1.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
1.3.	Nuk është planifikuar ndonjë masë afatshkurtër në kuadër të kësaj kategorie të këtij kapitulli të programit.								
1.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
1.3.	Te zbatohen dispozitat e MSA-së mbi bashkëpunimin rajonal dhe obligimet ndërkombëtare (neni, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10,11, 12, 13, 14, 16,17,19)	Projekt rregullorja e cila përcakton procedurën për shfrytëzimin, regjistrimin, përjashtimin dhe shkëmbimin e të dhënave, verifikimin dhe menaxhimin e tyre (Projekt Rregullore për Regjistrin Qendror)	Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 1950; Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut 1948; Direktiva 2002/58/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 korrik 2002 Lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva mbi Privatësinë dhe Komunikimet Elektronike)	ZKM MF MIE	K2 2016				
2. BLOKU II - KRITERET EKONOMIKE									
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut									
2.1.	Masat në kuadër të këtij kapitulli janë të listuara në pjesën narrative të programit.								
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit									
2.2.	Masat në kuadër të këtij kapitulli janë të listuara në pjesën narrative të programit.								
3. BLOKU III - STANDARDET EVROPIANE - PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË									
3.1. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së									
3.1.	Ky kapitull i Programit përmban vetëm pjesën narrative, përfshirë masat afatshkurtra.								
3.2. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave									
3.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.2.	Zbatimi i nenit 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Ligji për Standardizim (ligj i ri)	Rregullorja Nr. 1025/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 Tetor 2012 për Standardizim Evropian	MTI MZHE MMPH MPB MSH MI	K4 2016	P			
3.2.	Zbatimi i nenit 20, 80 dhe 74	Ligji për Akreditim (ligj i ri)	Rregullorja (KE) Nr. 765/2008 e	MTI	K2 2016	T			

	pika 3 të MSA-së	ri)	Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 9 Korrik 2008 që përcakton kërkesat për Akreditim dhe mbikëqyrje të tregut	MZHE MMPH MPB MSH					
3.2.	Zbatimi i nenit 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Ligji Nr.03/1-184 për Eficiencën e Energjisë (plotësim-ndryshim)	Direktiva 2010/30/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 19 Maj 2010 për Etiketimin e Produkteve të lidhur me Energjinë	MZHE MTI	K4 2016	P			
3.2.	Zbatimi i nenit 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Ligji Nr. 03/L-119 për Produktet Biocide (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva 98/8/KE për produktet biocide 2. Rregullorja (BE) 528/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Maj 2012 lidhur me Ofrimin në Treg dhe Perdorimin e Produkteve Biocide 3. Rregullorja 1907/2006 për regjistrimin, evaluimin, autorizimin dhe ndalesën e kimikateve-REACH 4. Rregullorja nr. 1272/2008 për për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme-CLP	MMPH MSh MTI MBPZHR	K4 2016	P			
3.2.	Zbatimi i nenit 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Ligji Nr. 2007/02-L-128 për Barna Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursor (plotësim/ndryshim)	1. Rregullorja (KE) Nr 1920/2006 për Barnat dhe Varësisë nga Barnat 2. VendimiiKëshillit 2001/419 për transmetimin e mostrave të substancave të kontrolluara 3. Vendimi i Këshillit 2005/387 në Shkëmbimin e Informacionit, Vlerësimin e Rrezikut dhe Kontrollin e Substancave të Reja Psikoaktive	MSh	K4 2016	P			
3.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
3.2.	Zbatimi i Neneve 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA-së	UA për Menyren e Autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit (akt nënligjor i ri)	Vendimi 768/2008/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 9 Korrik 2008 mbi një Kornizë të Përbashkët për Marketingun e Produkteve	MTI MZHE MMPH MSh MBPZHR MPB ARKEP	K1 2016	P			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20, 80 dhe 74	UA për Njohjen e	Vendimi 768/2008/KE e Parlamentit	MTI	K1 2016	P			

	pika 3 të MSA-së	Dokumente të Huaja për Konformitet (akt nënligjor i ri)	Evropian dhe Këshillit e datës 9 Korrik 2008 mbi një Kornizë të Përbashkët për Marketingun e Produkteve	MZHE MMPH MSH MBPZHR MPB ARKEP DK					
3.2.	Zbatimi i Neneve 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Instrumentet Matëse (MID) (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2014/32/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënjen e Instrumenteve Matëse në Treg	MTI AKM ASK DAK	K4 2016	T			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Instrumentet Jo-automatike të Peshimit (NAël) (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2014/31/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënjen e Instrumenteve Jo-automatike të Peshimit (NAël) në Treg.	MTI AKM ASK DAK	K4 2016	T			
3.2.	Zbatimi i nenit 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Pajisjet e Tensionit të Ulët (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2014/35/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me Vënjen e Pajisjeve të Tensionit të Ulët në Treg.	MTI	K2 2016	T			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi pajtueshmërinë elektromagnetike (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2014/30/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me Pajtueshmërinë Elektromagnetike.	MTI ARKEP ASK DAK	K2 2016	T			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Sigurinë e Ashensorëve (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2014/33/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare mbi Sigurinë e Ashensorëve.	MTI ASK DAK	K4 2016	T			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja për Radio-pajisjet (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2014/53/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 16 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për Vendosjen e Radio Pajisjeve në Treg.	ARKEP MTI	K4 2016	T			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Pajisjet me Gaz (akt nënligjor i ri)	Direktiva 2009/142/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 30 Nëntor 2009 mbi Pajisjet e Gazit	MTI ASK	K4 2016	T			

				DAK MZHE					
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Pajisjet nën Presion (akt nënligjor i ri)	Direktiva Nr. 2014/68/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 15 Maj 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për vënjen në Treg të Pajisjeve nën Presion.	MZHE	K4 2016	P			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Enët e Thjeshta nën Presion (akt nënligjor i ri)	Direktiva Nr. 2014/29/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 16 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për Vendorsjen mbi Vendorsjen në Treg të Veglave të Thjeshta nën Presion.	MZHE	K4 2016	P			
3.2.	Zbatimi i Neneve 20 dhe 74 pika 3 të MSA-së	Rregullorja mbi Kërkesat e Eficiencës për Bojlerët e Rinj të Ujit të Nxehtë të Ndezur me Lëndë Djegëse të Lëngët ose të Gaztë (akt nënligjor i ri)	Direktiva 92/42/KEE e Këshillit e datës 21 Maj 1992 mbi Kërkesat e Eficiencës për Bojlerët e Rinj të Ujit të Nxehtë të Ndezur me Lëndë Djegëse të Lëngët ose të Gaztë	MZHE MMPH MTI	K4 2016	P			
3.3. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve									
3.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.3.	Zbatimi i nenit 79 Paragrafi 9 të MSA-së	Ligji Nr. 04/L-069 për të Huajt (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonal 2. Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimi të shtetasve të vendeve të treta në suaza të transfereve brenda kompanive	MPB MPMS	K4 2016	P			
3.4. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve									
3.4.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.4.	Zbatimi i nenit 51, 56, 58 të MSA-së	Ligji për Shërbime (ligj i ri)	Direktiva 2006/123/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 12 Dhjetor 2006 për Shërbimet në Tregun e Breshëm të BE-së.	MTI MASH MPB MPMQ MD MAPL MIE MZHE MSH ZKM MF	K4 2016	T			

3.4.	Zbatimi i nenit 101 të MSA-së	Ligji për Turizëm (ligj i ri)	1. Direktiva 2006/123/KE on services in the internal market. 2. Direktiva 2008/122/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 Janar 2009 për Mbrojtjen e Konsumatorëve Lidhur me Aspektet e Ndryshme të Ndarjeve Kohore, Produktit Pushimor Afatgjatë, Kontratave të Rishitjes dhe Shkëmbimit.	MTI	K4 2016	P			
3.4.	Zbatimi i nenit 56 të MSA-së	Ligji për Profesionet e Rregulluara (ligj i ri)	1. Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 Shtator 2005 për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale 2. Direktiva 2013/55/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 Nëntor 2013 për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale	MAShT	K4 2016	P			
3.4.	Zbatimi i Neneve 85 dhe 86 të MSA-së	Ligji për të Huaj (plotësim -ndryshim)	1. Rregullorja (KE) Nr. 767/2008 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me Sistemin e Informacionit e datës 9 Korrik 2008 për Viza (SIV) dhe Shkëmbimin e të Dhënve në mes të Shteteve Anëtare mbi Vizat për Qëndrim Afatshkurtë (Rregullorja SIV) 2. Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 Shkurt 2014 mbi Kushtet e Hyrjes dhe Qëndrimin të Shtetasve të Vendeve të Treta me Qëllim të Punësimit si Punëtorë Sezonal 3. Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Maj 2014 mbi Kushtet e Hyrjes dhe Qëndrimin të Shtetasve të Vendeve të Treta në Suaza të Transfereve Brenda Kompanive	MPB MPJ MPMS MTI Policia e Kosovës (Drejtoria per Kufi).	K4 2016	T			
3.5. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit									
3.5.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.5.	Zbatimi i nenit 89 të MSA-së	Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe	Direktiva (KE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Majit	MF	K1 2016	P			

		Parandalimin e Financimit të Terrorizmit. (ligj i ri)	2015 mbi Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për qëllim të Pastrimit të Parave apo Financimit të Terrorizmit.	NJIF-K BQK DK PK ATK MIE						
3.5.	Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative									
3.5.	Zbatimi i nenit 64 të MSA-së	Regullorja për Sistemin e Numrave Standard të Llogarive Bankare për pagesat kombetare dhe zbatimi përmes përshtatjes së sistemeve. (plotësim ndryshim)	Direktiva 2007/64/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 Nentor 2007 mbi Sistemin e Pagesave në Tregun e Brendshëm	BQK	K4 2016	P				
3.5.	Zbatimi i nenit 64 të MSA-së	Regullorja për instrumente elektronike. (Akt nënligjor i ri)	Directive 2009/110/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi marrjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike.	BQK	K4 2016	P				
3.5.	Zbatimi i nenit 64 të MSA-së	Regullorja e Sistemit Ndërbankar të Pagesave KIPS (Akt nënligjor i ri)	Standardi BIS (Banka ndërkombtare për shlyerje që e rregullon sistemin e pagesave) ISO20022	BQK	K4 2016	T				
3.5.	Zbatimi i nenit 89 të MSA-së	Regullorja për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit për institucionet financiare. (rregullore e re)	Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Majit 2015 mbi Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar me qëllim të Pastrimit të Parave apo Financimit të Terrorizmit.	BQKNJIF-KMF	K4 2016	P				
3.5.	Zbatimi i nenit 89 të MSA-së	Nxjerrja e vendimit bazuar në Ligjin Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare në lidhje me Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Sanksionet Ndërkombëtare	Rregullorja (KE) Nr. 881/2002 e datës 27 Maj 2002, siç është ndryshuar.	MPJ MF MD NJIF-K BQK DK	K3 2016	P				
3.6. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik										
3.6.	Legjislacioni kornizë									

3.6.	Zbatimi i nenit 79 të MSA-së	Ligji për Prokurim Publik Nr. 04/L 042 (plotësim-ndryshim)	<p>1.Direktiva 2014/25/e BE-së</p> <p>2.Direktiva 2014/24/e BE-së Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian mbi Prokurimin Publik që Shfuqizon Diketiven 2004/18/të BE-së</p> <p>3.Direktiva 2014/25 /e BE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimet nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare që shfruqizon Direktivën 2004/ 17 /të BE -së</p> <p>4.Direktiva 2007/66 /e BE-së e Parlamentit Evropain dhe e Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2007 për përmirësimin e efektivitetit dhe procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave publike</p>	<p>MF</p> <p>KRPP OSHP AQP</p>	K1 2016	P			
3.6.	Zbatimi i nenit 79 të MSA-së	Rregullorja për Prokurim Publik A01 (Plotësim/Ndryshim)	<p>1.Direktiva 2014/24/e BE-së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian mbi Prokurimin Publik që Shfuqizon Diketiven 2004/18/të BE-së</p> <p>2.Direktiva 2014/25 /e BE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimet nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare që shfruqizon Direktivën 2004/ 17 /të BE -së</p> <p>3.Direktiva 2007/66 /e BE-së e Parlamentit Evropain dhe e Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2007 për përmirësimin e efektivitetit dhe procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave publike</p>	<p>KRPP</p> <p>OSHP AQP</p>	K2 2016	P			

3.6.	Zbatimi i nenit 79 të MSA-së	Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (Plotësim/ndryshim)	<p>1.Direktiva 2014/24/BE-së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian mbi Prokurimin Publik që Shfuqizon Diketiven 2004/18/të BE-së</p> <p>2.Direktiva 2014/25 /e BE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimet nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare që shfuqizon Direktivën 2004/ 17 /të BE -së</p> <p>3.Direktiva 2007/66 /e BE-së e Parlamentit Evropain dhe e Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2007 për përmirësimin e efektivitetit dhe procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave publike</p>	KRPP OSHP AQP	K3 2016	P			
------	------------------------------	------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------	---------	---	--	--	--

3.7. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive

3.7.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.7.	Zbatimi i nenit 51 të MSA-së , pika 1, 2, 3	Ligji për Shoqëritë Tregtare (I ri)	<p>Direktiva 2011/35/KE-se, Parlamentit Evropian dhe keshillit 5 prill 2011 për bashkimin e kompanive publike me përgjegjësi te kufizuara.</p> <p>2. Direktiva 2009/101/KE-se e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 16 shtatore 2009 për koordinimin e masave mbrojtëse dhe mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, ku kërkohet nga Shtetet Anëtare të kompanive brenda paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit, me qëllim për të bërë të tilla masa mbrojtëse ekuivalente</p> <p>3. Direktiva 2009/102 / KE-se te Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 16 shtator 2009 në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare për kompanitë private per je anetare te vetem me përgjegjësi të kufizuar</p> <p>4. Rregullorja e Këshillit (KE-se) Nr</p>	MTI MF ZKM MIE	K2 2016	P			

			2157/2001 e datës 8 tetor 2001 mbi Statutin për një kompani evropiane (SE) 5. Direktiva 2012/30/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 25 tetorit 2012, për koordinimin e masave mbrojtëse për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, kërkohet nga shtetet anëtare të kompanive brenda paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, në lidhje me formimin e kompanive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me synimin për të bërë garanci të tilla ekuivalente. 6. Direktiva 2006/43 / KE, Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 majit 2006 mbi auditimet statusore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, ndryshimin Direktiva e Këshillit 78/660 /KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 84/253/KEE						
3.7.	Zbatimi i nenit 51 te MSA-se, pika 1, 2, 3	Ligji Nr.4/L014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (plotësim/ndryshim)	Direktiva 4 (për logarit vjetore të disa llojeve të Kompanive) Direktiva 7 (për logarit e konsoliduara) dhe Direktiva 8 (mbi miratimin e përsosurave përgjegjëspër të kryar auditimet statutore)	MF MTI ZKM MIE	K1 2016	P			
3.7.	Zbatimi i nenit 51 te MSA-se, pika 1, 2, 3	Aprovimi i ligjit për falimentim (ligj i ri)	Rregullorja (BE) 2015/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 Maj 2015 mbi Procedurat e Falimentimit	MTI MF MD	K1 2016	P			
3.8. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale									
3.8.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.8.	Zbatimi i Neni 77 dhe 78 të MSA-së	Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave Pronësore Intelektuale Nr. 03/L-170 (Plotësim/Ndryshim)	Rregullorja e BE-së Nr 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 12 Qershor 2013 që ka të bëjë me Doganat zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale e cila e shfuqizon rregullorën e Këshillit (EC /1383 /2003	MF DK	K4 2016	T			
3.8.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								

3.8.	Zbatimi i Neni 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 10/2012 për Procedurat e Regjistrimit të Patentave (plotësim-ndryshim)	1.Direktiva 2008/95/e KE -së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Tetor 2008 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për Markat Tregtare 2.Direktiva 98/44/ e KE-së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 06 Korrik 1998 mbi Mbrojtjen Ligjore dhe Shpikjeve Bioteknologjike 3.Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 Prill 2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale 4.Regullorja(KE) No 469/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 06 Maj 2009 për Çertifikaten Shtesë për Produktet Mjekësore 5.Regullorja(KE) No 1610/96 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 Korrik 1996 lidhur me krijimin e një çertifikate të mbrojtjes shtesë për produktet për produktet për mbrojtjen e bimeve 6.Regullorja(KE) No 816/2006e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 Maj 2006 mbi licencimin e detyrueshëm të patentave që lidhen me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vendet me probleme në shëndetin publik.	MTI DK PK IT MSH	K2 2016	T			
3.8.	Zbatimi i Neni 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 13/2012 për Regjistrimin e Markave Tregtare (plotësim-ndryshim)	1.Direktiva 2008/95/e KE -së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Tetor 2008 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për Markat Tregtare 2.Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 Prill 2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale	MTI DK PK IT MSH	K2 2016	T			
3.8.	Zbatimi i Neni 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 11/2012 për Regjistrimin e Dizajnit Industrial (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva No 98/71/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 Tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të dizajneve 2. Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 Prill	MTI DK PK IT MSH	K3 2016	T			

			2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale						
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 12/2012 për Tarifat Administrative të Regjistrimit të Objekteve të Pronësisë Industriale (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 Prill 2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale 2. Regullorja e BE-së No 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 21 Nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë për prokultet bujqësore dhe ushqimore	MTI DK PK IT MSH	K2 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	Amandamenti i UA Nr. 05/2014 për Procedurat e Regjistrimit të Treguesit Gjeografik dhe Emërtimit të Origjinës (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 Prill 2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale	MTI DK PK IT MSH	K2 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 08/2013 për Përfaqësues të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale (plotësim-ndryshim)	Nuk ka Direktiva për këtë është legjislacioni i vendeve që lejon shumëshkallshmërinë -Ligji i Procedurës Administrative tek ne)	MTI DK PK IT MSH	K3 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 09/2012 për kompetencat, mandatin dhe punën e Komisionit të Ankesave në Zyrën e Pronësisë Industriale (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva 2008/95/e KE -së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Tetor 2008 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për Markat Tregtare 2. Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 Prill 2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale	MTI DK PK IT MSH	K2 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 01/2012 për Ekzaminim të Parakohshëm të Aplikacioneve për Mbrojtjen e Markave Tregtare (plotësim-ndryshim)	N/A	MTI DK PK IT MSH	K3 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	Regullorja për Ndërmjetësimin e Kontesteve në të Drejtën e Autorit Nr.05/2013 (plotësim-ndryshim)	1. Direktiva 98/83/e BE-së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 27 Shtator 1993 mbi lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit	MKRS DK PK IT MSH	K3 2016	T			

			dhe ritransmetimit kabllorë.						
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	Rregullorja për kompenzimet e veçanta (E Re)	Direktiva 2001/29/e BE-së e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Maj 2001 mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë e informacionit.	MRKS DK PK IT MSH	K2 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	UA Nr. 07/2010 për Zbatimin e Ligjit për Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale	Rregullorja e BE-së Nr 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 12 Qershor 2013 që ka të bëjë me Doganat zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale e cila e shfuqizon rregullorën e Këshillit (EC /1383 /2003	MF DK PK IT MSH	K4 2016	T			
3.8.	Zbatimi i nenit 77 dhe 78 të MSA-së	UA për Komisionin e Ankesave	N/A	MRKS MTI DK MSH	K4 2016	T			
3.9. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës									
3.9.	Ndihma shtetërore								
3.9.	<u>Legjislacioni kornizë</u>								
3.9.	Nuk është planifikuar ndonjë masë afatshkurtër në kuadër të kësaj kategorie të këtij kapitulli të programit.								
3.9.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
